

Remzije Istrefi / Iliriana Islami / Qerim Qerimi

TË DREJTAT E NJERIUT SIPAS JURISPRUDENCËS SË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

PËRMBLEDHJE TË RASTEVE



TË DREJTAT E NJERIUT SIPAS JURISPRUDENCËS SË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

PËRMBLEDHJE TË RASTEVE



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



I publikuar nga:

Akademia e Drejtësisë së Kosovës

Autorët:

Remzije Istrefi / Iliriana Islami / Qerim Qerimi

Kontribuesit:

Dafina Buçaj

© 2018 Remzije Istrefi, Iliriana Islami, Qerim Qerimi dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës

Të gjitha të drejtat rezervohen. Akademia e Drejtësisë së Kosovës dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH nuk pranojnë kurrfarë përgjegjësie për përmbajtjen e pasqyruar dhe nuk janë përgjegjës për aktualitetet, korrektësinë, tërësinë apo cilësinë e informacioneve të paraqitura. Prandaj do të refuzohen të gjitha pretendimet rreth dëmit të shkaktuar nga shfrytëzimi i informatave të dhëna, përfshirë edhe informatat të cilat janë të pakompletuara apo të pasakta.

Informacion

Të drejtat e autorit për materialet e krijuara nga autorët dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës janë të rezervuara. Nuk lejohet kopjimi / shumëzimi i materialit apo shfrytëzimi i objekteve, siç janë imazhet etj. në publikimet e tjera pa pëlqimin shprehimor nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës dhe autorët.

Nëse ndonjë pjesë apo shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme apo korrekte, përmbajtja apo vlefshmëria e pjesëve të tjera mbetet e paprekur nga ky fakt.

Shtypur në Prishtinë

Hartimi dhe botimi i kësaj Përmbledhje është mundësuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti për Reformë Ligjore dhe Administrative në Kosovë, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës.

Hyrje

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) është një traktat ndërkombëtar i miratuar më 1950 i cili hyri në fuqi në vitin 1953. KEDNJ përfaqëson konventën e parë të Këshillit të Evropës (KE) që merret me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Shtetet me rastin e anëtarësimit në organizatë duhet të ratifikojnë Konventën dhe njëkohësisht bëhen palë pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) është një ndër institucionet gjyqësore më të rëndësishme në Evropë dhe mekanizmi kryesor në zbatimin e dispozitave të Konventës. Përgjatë ekzistencës së vet Gjykata ka dhënë më shumë se 10.000 aktgjykime, të cilat janë obligative për shtetet palë dhe që kanë dërguar në ndryshimin e legjislacionit dhe praktikave administrative në këto shtete. Vendimet e GjEDNJ obligojnë shtetet kontratuese në tri modalitete: detyrimi për t'i dhënë fund shkeljes ekzistuese, detyrimi për të paguar shpërblim të drejtë (për të eliminuar pasojat e veprimeve të cilat kanë shkelur të drejtën ndërkombëtare), dhe detyrimi për të shmangur shkeljet e ngjashme në të ardhmen (për të mos përsëritur shkeljen).

Përderisa për palët kontraktuese detyrimi për të ekzekutuar gjykimet lind nga përgjegjësia e supozuar e një shteti i cili ka dështuar të përmbushë detyrimin e tij thelbësor sipas Nenit 1 të Konventës, në Kosovë ky detyrim lind nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Fillimisht, Nenin 22 i Kushtetutës së Kosovës garanton zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të së drejtës ndërkombëtare dhe disa instrumenteve dhe konventave ndërkombëtare, ndër të tjera përfshihet edhe "Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj". Si rezultat KEDNJ dhe Protokollet kanë efekt ligjor të drejtpërdrejtë në Kosovë, me prioritet mbi ligjet e tjera. Për më tepër, në nenin 53 të Kushtetutës përcaktohet qartë se "të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë do të interpretohen në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Kështu, edhe pse Kosova akoma nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe nuk është palë nënshkruese e KEDNJ-së, ajo është drejtpërdrejt e ndikuar nga jurisprudenca e GjEDNJ. Në praktikë megjithatë kjo bëhet problematike pasi që gjyqtarët kanë qasje të limituar në jurisprudencën e GjEDNJ-së për shkak se burimet në gjuhën shqipe janë të limituara.

Në këtë prizëm, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) e ka parë të nevojshme përpilimin e këtij vëllimi të rasteve të përmbledhura të disa nga vendimeve më të rëndësishme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e të cilat janë në interes të komunitetit ligjor në Kosovë.

Vëllimi në fjalë, përmban raste nga praktika gjyqësore e GjEDNJ që ndërlidhen me zbatimin e të drejtave të njeriut për të gjitha nenet respektive të KEDNJ, duke filluar që nga e drejta në jetë; e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, liria e shprehjes, e drejta për të mos iu nënshtruar torturës apo trajtimit çnjerëzor; e drejta për

tubim; të drejtat procedurale të personave të akuzuar apo të burgosur dhe një numër i gjerë të drejtash themelore dhe procedurale që burojnë nga Konventa. Kjo përmbledhje, megjithatë nuk përmban raste nga jurisprudenca e GjEDNJ bazuar në protokollet shtesë.

Vëllimi do të vëhet në dispozicion të profesionistëve në fushën e drejtësisë në Republikën e Kosovës, duke përfshirë këtu gjyqtarë të gjykatave të të gjitha shkallëve të gjyqësorit, avokatë, student dhe profesionistë të ndryshëm të drejtësisë, anëtarë të shoqërisë civile dhe të organizatave të të drejtave të njeriut. Publikimi i këtij vëllimi ka për qëllim tu shërbej akterëve të lartëcektur në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës dhe avancimin e mëtejshëm në këtë sferë të së drejtës.

Ky botim është realizuar në kuadër të Projektit “Legal and Administrative Reform Project” (LARP) si një cikël botimesh me tematika të ndryshme ligjore.

Valon Kurtaj
Drejtor Ekzekutiv,
Akademia e Drejtësisë

Mirënjohje

Akademia e Drejtësisë dëshiron të shprehë mirënjohje dhe falënderim zyrtarëve të Projektit Legal and Administrative Reform Project (LARP) të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët morën pjesë dhe kontribuan në dy punëtoritë e organizuara nga GIZ për harmonizimin dhe koordinimin e hartimit të kësaj përmbledhjeje.

Akademia e Drejtësisë shprehë mirënjohje dhe falënderim të veçantë për përgatitjen e këtij volumni për përpiluesit:

Remzije Istrefi

Iliriana Islami

Qerim Qerimi

Dafina Buçaj

Përmbajtja

Neni 1 - Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut	17
<i>Pisari kundër Republikës së Moldavisë dhe Rusisë</i>	18
<i>Behrami dhe Behrami kundër Francës dhe Saramati kundër Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë</i>	23
<i>Issa dhe të tjerët kundër Turqisë</i>	28
<i>Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	33
<i>Arlewin kundër Suedisë</i>	36
<i>Solomou dhe të tjerët kundër Turqisë</i>	39
Neni 2 - E drejta për jetën	43
<i>Sašo Gorgiev kundër “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”</i>	44
<i>Anderou kundër Turqisë</i>	49
<i>Putinseva kundër Rusisë</i>	52
<i>Gorovenky dhe Bugara kundër Ukrainës</i>	56
<i>Andreas Manitaras dhe të tjerët kundër Turqisë</i>	60
<i>Isayeva kundër Rusisë</i>	64
Neni 3 - Ndalimi i torturës	69
<i>Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	70
<i>Selmouni kundër Francës</i>	74
<i>Peers kundër Greqisë</i>	78
<i>Milić dhe Nikezić kundër Malit të Zi</i>	82
<i>X dhe Y kundër Holandës</i>	87
<i>Tali kundër Estonisë</i>	90
Neni 4 - Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar	94
<i>Zarb Adami kundër Maltës</i>	95
<i>Meier kundër Zvicrës</i>	99
<i>C.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	102
<i>Chitos kundër Greqisë</i>	108
<i>Graziani-Weiss kundër Austrisë</i>	111
<i>C.N. dhe V. kundër Francës</i>	114
Neni 5 - E drejta për liri dhe siguri	118
<i>Schwabe dhe M.G. kundër Gjermanisë</i>	119
<i>McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	123
<i>Baranowski kundër Polonisë</i>	127
<i>Velinov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë</i>	130
<i>Quinn kundër Francës</i>	134
<i>Smirnova kundër Rusisë</i>	138
Neni 6 - E drejta për një proces të rregullt	143
<i>Bellet kundër Francës</i>	144
<i>Moroko kundër Rusisë</i>	148
<i>Salduz kundër Turqisë</i>	153
<i>Philis kundër Greqisë</i>	157
<i>Agrokompleks kundër Ukrainës</i>	161
<i>Masson dhe Van Zon kundër Holandës</i>	166

Neni 7 - Nuk ka dënim pa ligj	169
<i>Dallas kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	170
<i>Ruban kundër Ukrainës</i>	175
<i>C.R. kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	177
<i>Varvara kundër Italisë</i>	180
<i>Kokkinakis kundër Greqisë</i>	185
<i>Puhk kundër Estonisë</i>	189
Neni 8 - E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare	192
<i>Berrehab kundër Holandës</i>	193
<i>Iglesias Gil dhe A.U.I. Kundër Spanjës</i>	196
<i>K.U. kundër Finlandës</i>	201
<i>Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	204
<i>Krasniqi kundër Austrisë</i>	207
<i>Kroon dhe të tjerët kundër Holandës</i>	211
Neni 9 - Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë	214
<i>Hasan and Eylem Zengin kundër Turqisë</i>	215
<i>Buscarini dhe të tjerët kundër San Marinos</i>	218
<i>Bayatyan kundër Armenisë</i> -	221
<i>Hasan dhe Chaush kundër Bullgarisë</i>	226
<i>Leela Förderkreis E.V. dhe të tjerët kundër Gjermanisë</i>	230
<i>Pavlidis dhe Georgakis kundër Turqisë</i>	235
Neni 10 - Liria e shprehjes	240
<i>Nagla kundër Latvisë</i>	241
<i>Tillack kundër Belgjikës</i>	245
<i>Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	248
<i>Butkevich kundër Rusisë</i>	251
<i>Antović dhe Mirković kundër Malit të Zi</i>	254
<i>Egill Einarsson kundër Islandës</i>	257
Neni 11 - Liria e tubimit dhe e organizimit	260
<i>Partia Komuniste e Bashkuar e Turqisë dhe të Tjerët kundër Turqisë</i>	261
<i>Partia Socialiste dhe të tjerët kundër Turqisë</i>	267
<i>Partia Kombëtare Baske - Organizata Rajonale e Iparralde kundër Francës</i>	270
<i>Partidul Comunistilor (Nepeceristi) dhe Ungureanu kundër Rumanisë</i>	273
<i>Nurettin Aldemir dhe të tjerëve kundër Turqisë</i>	278
<i>Kasparov dhe të tjerët kundër Rusisë</i>	281
Neni 12 - E drejta për t'u martuar	284
<i>Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	285
<i>V.K. kundër Kroacisë</i>	288
<i>B. dhe L. kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	291
<i>F. kundër Zvicrës</i>	293
<i>X, Y dhe Z kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	296
<i>Lashin kundër Rusisë</i>	298
Neni 13 - E drejta për zgjidhje efektive	301
<i>Oosterwijck kundër Belgjikës</i>	302
<i>Iliev dhe të tjerët kundër Bullgarisë</i>	305

<i>Burdov kundër Rusisë</i>	310
<i>Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	314
<i>Shalyavski dhe të tjerët kundër Bullgarisë</i>	317
<i>Horvat kundër Kroacisë</i>	321
Neni 14 - Ndalimi i diskriminimit	326
<i>Thlimenos kundër Greqisë</i>	327
<i>Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	330
<i>Leitner kundër Austrisë</i>	334
<i>Mazurek kundër Francës</i>	338
<i>Di Trizio kundër Zvicrës</i>	343
<i>Çam kundër Turqisë</i>	347
Neni 15 - Derogimi në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme	350
<i>Lawless kundër Irlandës</i>	351
<i>Aksoy kundër Turqisë</i>	354
<i>Sakik dhe të Tjerët kundër Turqisë</i>	358
<i>Demir dhe të tjerët kundër Turqisë</i>	361
<i>Nuray Şen kundër Turqisë</i>	364
<i>Şahin Alpay kundër Turqisë</i>	367
Neni 16 - Kufizime ndaj veprimtarisë politike të të huajve.....	371
<i>Piermont kundër Francës</i>	372
<i>Jevgenijs Jegorovs kundër Letonisë</i>	375
<i>Perinçek kundër Zvicrës</i>	380
Neni 17 - Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave	385
<i>Vajnai kundër Hungarisë</i>	386
<i>Garaudy kundër Francës</i>	390
<i>Lehideux dhe Isorni kundër Francës</i>	393
<i>Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar</i>	398
Neni 18 - Kufiri i zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave	401
<i>Gusinskiy kundër Rusisë</i>	402
<i>Cebotari kundër Moldavisë</i>	405
<i>Ilgar Mammadov kundër Azerbaixhanit</i>	409

GLOSSARY/FJALORTH

Ad hoc Judge - Gjyqtari <i>ad hoc</i>	Gjyqtari <i>ad hoc</i> emërohet nga Qeveria përkatëse kur gjyqtari i zgjedhur në emër të asaj Pale Kontraktuese të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk merr pjesë në shqyrtimin e çështjes për shkak të pamundësisë, tërheqjes ose përjashtimit.
Applicant - Ankuesi/Ankuesja	Parashtruesi i kërkesës pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që pretendon shkelje të të drejtave të garantuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj Shtesë.
Attorney General - Prokuror i përgjithshëm	Zyrtari kryesor ligjor i cili përfaqëson një shtet në procedurat ligjore dhe i jep këshilla juridike qeverisë. Kreu i Departamentit Amerikan të Drejtësisë.
Affirmative action - Veprim afirmativ	Veprimi i ndërmarrë nga qeveria ose bizneset private për të kompensuar diskriminimin e kaluar, për shembull, arsimimin dhe punën kundër, për shembull, grave, atyre të racave të veçanta, grupeve etnike, feve apo aftësive të kufizuara.
Arbitration - Arbitrazhi	Një proces me të cilin, në vend që të shkojnë në gjykatë, palët kontestuese kërkojnë nga një person i tretë që të dëgjojnë argumentet e tyre dhe pastaj të marrin një vendim, të cilin ata bien dakord për të ndjekur.
Battery - Sulm	Krimi i kërcënimit të një personi së bashku me shtrëngimin me kontakt fizik.
Bail applications - Aplikacionet e dorëzarisë	Premtim me shkrim i njohur si një ndërmarrje me kusht që personi i akuzuar të paraqitet në gjykatë në një datë të caktuar.
Barrister - Avokat	Avokat që ka të drejtë të ushtrojë profesionin e avokatit, veçanërisht në gjykatat më të larta.

**Case awaiting classification -
Rasti në pritje të klasifikimit**

Rast për të cilin klasifikimi - nën mbikëqyrje standarde ose të zgjeruar - ende duhet të vendoset nga Komiteti i Ministrave.

**Contempt of court -
përçmimi i gjykatës**

Vepra e mosbindjes ose mosbindjes ndaj një gjykate dhe zyrtarëve të saj në formën e sjelljes që kundërshton autoritetin, drejtësinë dhe dinjitetin e gjykatës.

**Cursory review of a document -
mënyrë e përciptë e shqyrtimit**

Mënyrë sipërfaqësore e kontrollimit të një dokumenti e kryer me nxitim, me vëmendje të vogël në detaje.

**Coroners and Justice Act 2009 -
Akti i Koronerëve dhe i Drejtësisë
2009**

Është një akt i Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar. Ai ndryshoi ligjin për gjykatësit dhe drejtësinë penale në Angli dhe Uells. Ndër dispozitat e tij janë: parandalimi i kriminelëve që të përfitojnë nga publikimet për krimet e tyre.

Debriefing - bisedë e strukturuar

Një bisedë e strukturuar ndërmjet lehtësuesve dhe pjesëmarrësve për të rishikuar një aktivitet eksperimental dhe pjesëmarrës; për të folur për atë që ndodhi dhe si ndjenin njerëzit. Qëllimi është të ndihmojë pjesëmarrësit të sqarojnë mendimet dhe ndjenjat e tyre në një ambient të sigurt.

Derogation - derogim

Veprim me anë të të cilit një palë kontraktuese mund të informojë Gjykatën se për shkak të një situate të jashtëzakonshme nuk do ti përmbahet Konventës në tërësi apo pjesërisht për zonën në fjalë.

**Deadline for the payment
of the just satisfaction -
Afati i fundit për pagesën
e plotësisht të drejtë**

Kur Gjykata Evropiane i jep të drejtë paditësit/aplikuesit, gjykata tregon në përgjithësi një afat brenda të cilit shteti i paditur duhet të paguajë shumat e dhëna; normalisht, afati kohor është tre muaj nga data në të cilën aktgjykimi bëhet i formës së prerë.

**Friendly settlement -
Zgjidhje miqësore**

Marrëveshje ndërmjet aplikantit dhe shtetit të paditur që ka për qëllim të japë fund aplikimit para Gjykatës. Gjykata miraton zgjidhjen nëse konstaton se respektimi i të drejtave të njeriut

nuk justifikon mbajtjen e kërkesës. Vendimi pasues i transmetohet Komitetit të Ministrave i cili do të mbikëqyrë ekzekutimin e kushteve të zgjidhjes miqësore siç është përcaktuar në vendim.

**Interim measures -
masat e përkohshme**

Pas marrjes së një kërkesë, Gjykata mund t'i kërkojë Shtetit të paditur që të marrë disa masa të përkohshme, ndërkohë që vetë Gjykata vazhdon shqyrtimin e çështjes. Kjo do të thotë që Shtetit përkatës i kërkohet që të mos ndërmarrë asnjë veprim deri në vendimin e saj të radhës.

**Interim solution -
Zgjidhje e përkohshme**

Forma e vendimit të miratuar nga Komiteti i Ministrave që ka për qëllim tejkalimin e situatave më komplekse që kërkojnë vëmendje të veçantë.

**Just Satisfaction -
shpërblimi (satisfaksioni) i drejtë**

Kur Gjykata, sipas nenit 41 të Konventës, konsideron se e drejta e brendshme e shtetit të paditur nuk lejon kompensimin e plotë të pasojave të kësaj shkelje të Konventës për aplikantin, ai mund të japë shpërblim të drejtë. Kënaqësia e drejtë shpesh merr formën e shumës së parasë që mbulon dëmet materiale dhe / ose morale, si dhe kostot dhe shpenzimet e bëra.

Leading case - Rasti kryesor

Rast i cili është identifikuar si zbulimi i problemeve të reja strukturore dhe / ose sistematike, ose nga Gjykata drejtpërdrejt në gjykimin e saj, ose nga Komiteti i Ministrave gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit.

**Order of committal -
urdhri i dërgimit**

Term ligjor i përdorur nga sistemet ligjore të Kanadasë dhe Mbretërisë së Bashkuar, e cila lejon një magjistrat ose gjyqtar të zbatojë një gjykim apo urdhër kundër një personi ose korporate që ka refuzuar ose lënë pas dore të veprojnë në përputhje me një vendim ose urdhër gjykate të njohur brenda një periudhë kohore të caktuar.

**Principal State Counsel -
Këshilltar kryesor shtetëror**

Profesion ligjor / i mandatuar me ligj dhe përfshinë përfaqësimin e shtetit në të gjitha gjykimet penale për krimet që kanë ndodhur në juridiksionin gjeografik të avokatit të shtetit.

**Protocol to the Convention -
Protokoll i Konventës**

Protokolli i Konventës është një tekst që i shton një ose më shumë të drejta Konventës fillestare, ose ndryshon disa dispozita të caktuara të saj. Protokollet janë të detyrueshme vetëm për ato Shtete që i kanë nënshkruar dhe ratifikuar ato.

Pilot judgement - Gjykim pilot

Kur Gjykata identifikon një shkelje që rrjedh nga një problem strukturor dhe / ose sistemik i cili ka ngritur ose mund të shkaktojë kërkesa të ngjashme kundër shtetit të paditur, Gjykata mund të vendosë të përdorë procedurën e gjyimit pilot.

**Preliminary Objections -
Kundërshtimet fillestare**

Kundërshtimet fillestare janë argumentet që paraqet qeveria e paditur në mbështetje të pretendimeve të saj se çështja nuk duhet të shqyrtohet në merita.

Remand - paraburgim

Kujdestari/paraburgim është procesi i ndalimit të një personi i cili është arrestuar dhe akuzuar për një vepër penale deri në gjykimin e tij/saj.

Repetitive case - Rasti përsëritës

Çështja që ka të bëjë me një problem strukturor dhe / ose të përgjithshëm të ngritur tashmë para Komitetit në kontekstin e një ose disa rasteve kryesore; rastet e përsëritura zakonisht grupohen së bashku me rastin kryesor.

Royal Assent - Pëlqim Mbretëror

Miratimi ose sanksioni i Mbretërisë është metoda me të cilën monarku i një vendi zyrtarisht miraton një akt të parlamentit të atij vendi. Në disa vende, një miratim i tillë e bën ligjin e aktit, ndërsa në miratimin e vendeve të tjera është i ndryshëm nga shpallja.

**Standard supervision -
Mbikëqyrja standarde**

Procedura e mbikëqyrjes aplikohet në të gjitha rastet, përveç nëse, për shkak të natyrës së saj specifike, një rast garanton konsideratë nën procedurën e zgjeruar.

**Striking out of a case -
Ç'registrim i rastit**

Veprim me të cilin gjykata largon një rast nga lista e asteve në pritje për shqyrtim si pasojë e mos plotësimit të kushteve paraprake për dorëzim të kërkesës.

The magistrate - gjyqtar

Një nëpunës civil apo gjyqtar porotë që administron ligjin, veçanërisht ai që kryen një gjykatë që merret me kundërvajtje dhe mban seanca paraprake për ato më serioze.

**Unilateral Declaration -
Deklarimi i njëanshëm**

Deklarata e paraqitur nga shteti i paditur në Gjykatë, duke pranuar shkeljen e Konventës dhe duke marrë përsipër të sigurojë dëmshpërblim adekuat, duke përfshirë edhe aplikantin.

Unanimous - Njëzëri

Formë e vendimmarrjes së gjykatës në të cilin rast vendimi merret me miratimin e të gjithë gjyqtarëve pa ndonjë kundërshtim.

**Writ of amparo -
ndihmë ligjore *amparo*
(recurso de amparo)**

Mjet juridik që perdoret në vendet ku flitet gjuha spanjishte - mjet juridik në dispozicion për cilindo person të cilit e drejta për jetë, liri dhe siguri i është shkelur ose kërcënuar me shkelje nga një veprim ose mosveprim i paligjshëm i një zyrtari ose punonjësi publik ose i një individi ose subjekti privat.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Neni 1

Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut

Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre, të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Seksionin I të kësaj Konvente.

Pisari kundër Republikës së Moldavisë dhe Rusisë - 42139/12

21 prill 2015 [Seksioni i Tretë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 2 në ndërlidhje me Nenin 1

Shkelje e të drejtës në jetë si pasojë e vrasjes dhe dështimit të ndjekjes efektive ndaj kryesit të veprës / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: ekstrateritorialitet / juridiksion / pika kontrolli / mbrojtje e domosdoshme / vrasje / përgjegjësi shtetërore / status i viktimës / qasje në procedura

Ankuesit: z. Simion Pisari dhe znj. Oxana Pisari, shtetas Moldavez

Faktet e rastit

Rasti ka të bëjë me vrasjen e djalit 18 vjeçar të ankuesve, Vadim Pisari, nga një ushtar rus, V.K., në një pikë kontrolli paqeruajtës të vendosur në territorin e Moldavisë pas konfliktit të armatosur Transdniestrian. Faktet që kanë të bëjnë me historikun e çështjes, duke përfshirë konfliktin e armatosur Transdniestrian i viteve 1991-92 dhe ngjarjet e mëvonshme, janë vendosur në *Ilaşcu, Ivanţoc, Leşco dhe Petrov-Popa kundër Moldavisë dhe Rusisë* dhe në *Catan dhe Të tjerët kundër Republikës së Moldavisë dhe Rusisë*¹

Djali i ankuesve, Vadim Pisari, jetonte në Piritu një fshat që ndodhej në bregun e majtë të lumit Dniestër, por të kontrolluar nga Autoritetet Kushtetuese Moldave. Në mëngjesin e 1 janarit 2012, pas një feste të Vitit të Ri në të cilën pije alkoolike ishin konsumuar, Vadim Pisari, i shoqëruar nga një mik i tij mori një makinë që i përkiste një tjetër miku të tyre dhe doli për një shetitje, duke pasur nevojë për karburante vendosën të shkojnë në një stacion benzine të vendosur në bregun e djathtë të lumit Dniestrit në qytetin Vadul lui Vodă. Për të arritur stacionin e benzinës ata duhej të kalonin përmes një ure mbi lumin Dniestër në të cilën ishin të vendosura pikat e kontrollit paqeruajtës në të dy skajet e urës ("pikë kontrolli i majtë" dhe "pikë kontrolli i djathtë").

Pikat e kontrollit ishin të kontrolluara nga forcat ushtarake paqeruajtëse që i përkasin Federatës Ruse, Republikës së Moldavisë dhe Republikës së vetëshpallur të Transdnjestrit. Në kohën e ngjarjeve, secila Pikë e kontrollit ishte e drejtuar nga tetë ushtarë, nga të cilët katër ishin rusë, dy Moldave dhe dy Transdnjestrit. Komanda e pikës së kontrollit të majtë mbikëqyrej nga një rreshter rus, V.K., i cili ishte i vetmi person i armatosur me një armë në kohën e ngjarjeve. Komanda e Pikës së djathtë të kontrollit u sigurua gjithashtu nga një rreshter rus. Në çdo pikë kontrolli ishin të vendosura blloqe betoni dhe barriera metalike në rrugë në një mënyrë të tillë që makinat do të detyroheshin të ngadalësoheshin në mënyrë që të kalonin nëpër to.

¹ *Ilaşcu, Ivanţoc, Leşco and Petrov-Popa kundër Moldavisë dhe Rusisë* ([DhM], nr. 48787/99, §§ 28-183, GjEDNj 2004-VII); dhe në *Catan dhe Të tjerët kundër Republikës së Moldavisë dhe Rusisë* nr. 43370/04, 8252/05 dhe 18454/06, §§ 8-42, GjEDNj 2012

Distanca midis pikës së djathtë të kontrollit dhe pikës së majtë të kontrollit ishte rreth 600 metra.

Makina e Vadim Pisarit arriti tek pika e kontrollit të majtë diku në orën 07:10. Tre ushtarë, duke përfshirë edhe V.K., po ruanin rrugën, e ushtarët tjerë ishin brenda kazermeve. Kur kaloi përmes Pikës së kontrollit, Vadim Pisari jo vetëm që nuk arriti të ndalonte, por goditi dhe kaloi shenjën "Stop" dhe të gjitha pengesat e vendosura. Pasagjeri i tij shpjegoi më vonë se xhami i makinës ishte pjesërisht i mbuluar me akull, pasi që sistemi i ngrohjes së makinës nuk kishte funksionuar dhe pamja e shoferit kishte qenë e kufizuar. V.K. urdhëroi shoferin të ndalonte makinën, por ky i fundit nuk iu bind dhe vazhdoi rrugën e tij. V.K. menjëherë kontaktoi pikën e djathtë të kontrollit dhe i kërkoi rreshterit rus në komandë të ndalonte makinën që po afrohej. Megjithatë, makina nuk u ndal në pikat e tjera të kontrollit.

Njëzet minuta më vonë, afërsisht në orën 7:30, Vadim Pisari dhe pasagjeri i tij u kthyen prapa në urë. Një ushtar më vonë në deklaratat e tij për policinë moldave deklaroi se askush nuk u përpoq ta ndalte makinën kur ajo kishte kaluar, por që ata menjëherë kishin informuar pikën e kontrollit të majtë për afrimin e makinës. Në deklaratat e tij dhënë një hetuesi rus në 6 janar 2012, V.K. paraqiti se përveç dy pengesave ekzistuese, dy shirita tjerë ishin vendosur në hyrje dhe dalje të majtë të pikave të kontrollit, ndonëse nuk kishin kohë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë gjerësinë e rrugës. Deklarata të njëjta janë bërë për një hetues rus nga ushtari Transdniestrian i përmendur më lart dhe nga një ushtar tjetër rus nga pikat e kontrollit të majtë. Kur Vadim Pisari iu afrua pikës së kontrollit të majtë në makinë, V.K. e urdhëroi atë të ndalet. Megjithatë, ai përshpejtoi dhe shmangu pengesat. Sipas V.K., makina u vërsul në të dhe atij i ishte dashur të kërcente për të mos u goditur nga ai. V.K. bëri të njëjtën deklaratë për hetuesit rus më 6 janar 2012, por jo në deklaratën e tij për policinë moldave të dhënë menjëherë pas incidentit. Në mënyrë të ngjashme, deklaratat e dy ushtarëve të tjerë që kishin qenë dëshmitarë të incidentit, të dhëna menjëherë pas incidenti ndaj policisë moldave, nuk përmendes se V.K. ishte rrezikuar nga makina.

V.K. pastaj i kërkoi vozitësit të makinës që të ndalej ose ai do të qëllojë, dhe shtiu në ajër. Vadim Pisari nuk u ndal, por e përshpejtoi makinën, kështu që V.K. gjuajti me tre të shtëna në drejtim të makinës, duke synuar gomat e saj, dhe sipas tij nuk kishte për qëllim të qëllonte pasangerët. Sipas ankuesve dhe një ushtari të pranishëm nga plumbat u rrezikua edhe një ushtar që gjendej në afërsi, ndërsa Vadim Pisari ishte qëlluar dhe kishte vdekur nga plagët disa orë më vonë.

Autoritetet Moldovase filluan procedurat e hetimit menjëherë pas ngjarjes. Personi i akuzuar menjëherë u transferua tek institucionet e brendshme në Rusi, ku sipas një njoftimi të Ministrisë së Jashtme të Rusisë, institucionet përkatëse atje do të zhvillojnë një hetim paralel. Më 2 Janar 2012, u krijua një komision i përbashkët tripartit i përbërë nga forcat e Republikës Moldovase, Ruse dhe të ashtuquajturës Republika Transdniestriane. Një raport u dorëzua nga Qeveria Ruse, por siç pretendohet nga Qeveria Moldave nuk ishte nënshkruar nga përfaqësuesi Moldav andaj nuk kishte efekt. Ndër tjera në raport thuhej se viktima ishte përgjegjës për shkeljen e ligjit dhe rrezikimin e jetëve të ushtarëve dhe se nuk kishte masa ndaluese të duhura në pikën e kontrollit. Tutje më 14 Janar 2012 një zyrtarë i lartë uhstarak Rus lëshoi një raport

sipas të cilit V.K. kishte vepruar në përputhje me rregullat e aplikueshme në rrethana të tilla me qëllim të ndalimit të Vadim Pisarit.

Në anën tjetër më 10 Janar 2014 Prokurori Gjeneral i Moldavisë kishte njohur statusin e viktimës së z. Vadim Pisari dhe kishte lëshuar urdhër-arrest për vrasësin e tij. Pas disa kërkesave për informata ankuesit ishin informuar se kryesi nuk mund të ekstradohej në Moldavi sepse Rusia nuk ekstradonte qytetarët e vet. Institucionet Ruse kishin zhvilluar hetimet e tyre duke marrë në pyetje ushtrarët rus që gjendeshin në pikën në fjalë, deklaratat e të cilëve korrespondonin me atë të të akuzuarit. Si rezultat më 24 Dhjetor 2012 insitucionet Moldave ishin njoftuar se i akuzuari V.K. ishte liruar nga të gjitha aktakuzat. Vendimi i institucioneve Ruse nuk iu dorëzua familjes së viktimës nën arsyetimin se ata nuk kishin qenë palë në procedurat në Rusi, e më të njëjtin arsyetim edhe ankesa e tyre ndaj vendimit ishte hedhur poshtë.

Më 22 gusht 2013 Zyra e Prokurorit në Moldavi pushoi të gjitha procedurat në rastin në fjalë.

Permbledhje e pretendimeve

Ankuesit pretenduan se djali i tyre, Vadim Pisari, ishte vrarë nga agjentët shtetërorë dhe se autoritetet vendase nuk kishin arritur të ndërmarrin një hetim efektiv për vdekjen e tij. Ata u mbështetën në Nenin 2 të Konventës. Ata përshkruan kontekstin në të cilin ndodhi incidenti duke deklaruar se asnjëher paqeruajtësit nuk ishin në rrezik nga qytetarët, dhe se biri i tyre kishte qenë i pa-armatosur. Më tutje ankuesit deklaruan se pikat e kontrollit paqeruajtës ishin nën komandën e forcave ushtarake ruse, kështu që qeveria Ruse ishte përgjegjëse për veprimet e ushtarëve. Sipas ankuesve, Federata Ruse mban përgjegjësi për veprimet e ushtarit rus, V.K. Së fundi, ankuesit argumentuan se hetimi i kryer nga autoritetet ruse nuk kishin qenë efektiv. Hetimi ishte fokusuar vetëm në atë nëse udhëzimet në lidhje me përdorimin e armëve të zjarrit ishin respektuar e jo nëse përdorimi i një arme ishte e nevojshëm në rrethanat në fjalë. Për më tepër, autoritetet ruse kishin dështuar të përfshinin familjen e viktimës në procedurat hetimore.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me pranueshmërinë e rastit Gjykata përsëriti se në këtë kontekst, në disa raste rrethanat e përdorimit të forcës nga agjentët e shtetit që veprojnë jashtë territorit të saj mund të sjellë çështjen e kontrollit të autoritetve të shtetit në kuadër të juridiksionin e Shtetit sipas Nenit 1 të Konventës.² Kjo mund të përfshijë ushtrimin e juridiksionit jashtë territorial nga shteti kontraktues kur në pajtim me traktat apo marrëveshje të tjera, autoritetet e saj kryejnë funksione ekzekutive në territorin e një shteti tjetër. Në rastin në fjalë, pika e kontrollit e vendosur në zonën e sigurisë, ishte e drejtuar dhe komanduar nga ushtarët rus në përputhje me Marrëveshjen për përfundimin e konfliktit ushtarak në rajonin Transdnistri të Moldavisë. Gjykata konsideron se, në rrethanat e këtij rasti, Vadim Pisari ishte nën juridiksionin e Federatës Ruse brenda kuptimit të Nenit 1 të Konventës. Gjykata vëren se ankuesit kishin deklaruar se nuk e shihnin të

² *Al-Skeini dhe Të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], nr. [55721/07](#), § 136, GjEDNj 2011; *Jaloud kundër Holandës* [DhM], nr. [47708/08](#), § 139, 20 Nëntor 2014

arsyeshme të parashtronin ankesë kundër Qeverisë Moldave meqë ishte e qartë se djali i tyre ishte vrarë në një ushtar rus. Si pasojë Gjykata e konsideron të panevojshme trajtimin e pretendimeve kundër Moldavisë dhe e deklaroi të pranueshme pjesën tjetër të pretendimeve.

Lidhur me pretendimet e ankuesve për shkelje të Nenit 2 të Konventës, bazuar në faktet e rastit në fjalë për Gjykatën nuk ka dyshime se Vadim Pisari u vra nga të shtënat me armë automatike të gjuajtur nga V.K. Gjykata e ka parasysh që qëllimi i të shtënave ishte për të kapur shoferin e makinës. Prandaj, veprimi i ushtarit rus u mor për qëllimin e arrestimit të ligjshëm brenda kuptimi i Nenit 2 § 2 (b) të Konventës. Megjithatë, Gjykata duhet të shqyrtoj nëse forca e përdorur për arrestimin ishte "absolutisht e nevojshme" në rrethanat e rastit. Në lidhje me pohimet e autoriteteve ruse se arma e zjarrit është përdorur kundër automjeti dhe jo kundër njerëzve në të, Gjykata nuk sheh asnjë arsye për të dyshuar se V.K. kishte një qëllim të tillë. Megjithatë, Gjykata duhet të peshojë shkallën e rrezikut të paraqitur nga përdorimi i një arme zjarri ndaj rrezikut të paraqitur nga ikja e një shoferi dhe nevoja urgjente për ta ndaluar atë. Gjykata vëren që V.K. ka gjuajtur tre të shtëna të vetme nga një armë në drejtim të automjetit të drejtuar nga Vadim Pisari. Materialet e rastit nuk bëjnë të qartë distancën nga e cila u hodhën të shtënat dhe / ose mjeshhtërinë e V.K. në të shtënat me armë automatike. Megjithatë, pohimi se një nga plumbat nga arma me të cilën ka qëlluar V.K. shpërtheu pallton e një ushtari tjetër në pikën e kontrollit që nuk ishte larg nga makina, nuk është kontestuar. Kjo është e mjaftueshme për Gjykatën të konstatojë se përdorimi i armës nga V.K. paraqet një rrezik shumë serioz jo vetëm për jetën e Vadim Pisarit por edhe për atë të ushëtarëve të tij dhe madje edhe për atë të ushtarit i cili pothuajse u godit nga një prej plumbave. Fakti që vetëm Vadim Pisari u godit nga një plumb duket se ka qenë një çështje e rastit. Një shkallë e tillë e lartë e rrezikut për jetën mund të justifikohet vetëm nëse arma e zjarrit u përdor si masë e mjetit të fundit për të shmangur një situatë shumë të qartë dhe rrezikun e afërt të paraqitur nga shoferi i makinës.

Në anën tjetër, Gjykata nuk është e bindur se V.K. rrezikohet të goditet nga automjeti i viktimës dhe prandaj nuk gjen ndonjë indikacion të dukshëm të rrezikut të paraqitur nga vozitesi i makinës nëse i njëjti do të lejohej të arratiset. Edhe duke supozuar se veprimet e viktimës ishin potencialisht të rrezikshme, Gjykata nuk e konsideron se niveli i kërcënimit në këtë rast kërkonte ndalimin e tij të menjëherëshëm me armë zjarri. Në të vërtetë, duket nga faktet e rastit se përfaqësohet një kilometër larg pikës së kontrollit të majtë në rrugën që çon në fshat kishte një pikë kontrolli policor që mund të ishte paralajmëruar nga V.K. Gjykata nuk është e bindur se vrasja e Vadim Pisarit përbënte përdorimin e forcës që nuk ishte më shumë se absolutisht e domosdoshme për qëllim të kryerjes së një arrestimi të ligjshëm brenda kuptimi i Nenit 2 § 2 (b) të Konventës. Prandaj, Gjykata konstatoj se ka pasur shkelje të Nenit 2 të Konventës në aspektin substancial nga ana Federatës Ruse.

Së fundi, Gjykata vëren se autoritetet ruse nuk përfshinë ankuesit në hetimin e rrethanave të vrasjes së birit të tyre. Ankuesve nuk u lejohej të ushtronin asnjë të drejtë procedurale dhe nuk ishin as të informuar për ndërprerjen e procedurave kundër V.K. Gjykata ka theksuar në shumë raste se përfshirja e të afërmëve shërben si mjet për të siguruar përgjegjësinë publike të autoriteteve dhe shqyrtimi publik i veprimeve të

tyre në situata të tilla.³ Në këtë rast, ankuesit kishin një interes të fortë dhe të ligjshëm për sa i përket hetimeve të kryera nga autoritetet ruse, të cilat do të kishin shërbyer duke u dhënë atyre statusin që kërkonin në procedurën penale kundër V.K. Qeveria Ruse nuk ka prezantuar asnjë argument që shpjegon pse ankuesve iu ishte refuzuar statusi i viktimave në procedurat penale dhe nuk u është lejuar qajse në këto procedura. Për këtë Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Nenit 2 të Konventës nga Federata Ruse edhe në aspektet substanciale dhe procedurale.

Bazuar në Nenin 41 të Konventës, duke patur parasysh gjetjen e shkeljeve për sa i përket Nenit 2 të Konventës, Gjykata konstaton se ankuesit kanë pësuar dëme dhe për këtë cakton dëme jo-materiale në vlerë prej 35.000 EUR. Gjykata gjithashtu u aprovon kërkuesve shumën e kërkuar prej 5,580 EUR për shpenzimet dhe kostot procedurale.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendos se ka shkelje procedurale dhe substanciale të Nenit 2 të Konventës nga autoritetet Ruse, dhe vendos të çregjistroj pjesën tjetër të ankesës kundër Moldavisë [njëzëri].

³ *Anguelova kundër Bullgarisë*, nr. 38361/97, § 140, GjEDNj 2002-IV

***Behrami dhe Behrami kundër Francës dhe Saramati kundër Francës, Gjermanisë
dhe Norvegjisë - 71412/01;78166/01***
2 maj 2007 [Dhoma e Madhe]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 2

Shkelje e të drejtës në jetë si pasojë e dështimit për parandalim të vdekjes dhe lëndëimit të ankuesve nga KFOR-i (*Rasti Behrami*) / e papranueshme

Nenet 1, 5, 6 dhe 13

Shkelje e të drejtës për liri dhe siguri dhe gjykim të drejtë si pasojë e mbajtjes joligjore në paraburgim nga KFOR-i dhe mungesa e mjeteve efektive, si dhe dështim të Francës dhe Gjermanisë për të respektuar të drejtat e njeriut (*Rasti Saramati*) / ankesa kundër Gjermanisë *hedhet poshtë*; ankesa e mbetur e papranueshme

Fjalët kyçe: dështim për të mbrojtur / e drejta në jetë / liri dhe siguri / administrim territori / misione ndërkombëtare / përgjegjësia e OKB-së / paraburgim i paligjshëm / juridiksion / UNMIK / KFOR

Ankuesi/t: Agim Behrami, i lindur në vitin 1962, dhe i biri i tij, Bekim Behrami, i lindur në vitin 1990. Që të dy jetojnë në komunën e Mitrovicës. Agim Behrami ka paraqitur ankesë edhe në emër të djalit tjetër të tij, Gadaf Behramit, i lindur më 1988, që tashmë ka ndërruar jetë (*Rasti Behrami*). Në anën tjetër Ruzhdi Saramati, i lindur në vitin 1950. Gjithashtu, me origjinë nga Kosova (*Rasti Saramati*).

Faktet e rastit

Behrami dhe Behrami kundër Francës

Në mars të vitit 2000, që është koha kur janë zhvilluar ngjarjet relevante për rastin, Mitrovica ka qenë pjesë e sektorit të sigurisë brenda brigadës shumëkombëshe të forcave të NATO-s në Kosovë (KFOR), të udhëhequra nga Franca. Kjo është një prej katër brigadave shumëkombëshe të pranisë së forcave ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë, të njohur si KFOR, e mandatuar në bazë të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999.

Më 11 mars të vitit 2000, Gadaf dhe Bekim Behrami po luanin me fëmijë të tjerë në kodrën rreth fshatit Shipol të Mitrovicës. Ata kishin gjetur një numër bombash kasetore të paeksplozuara, të cilat kishin mbetur nga bombardimet e NATO-s të vitit 1999, me të cilat kishin filluar të luanin. Njëri prej fëmijeve e kishte hedhur një bombë në ajër. Kjo bombë kishte eksplozuar dhe lënë të vrarë Gadaf Behramin. Bekim Behrami, ndërkaq, kishte pësuar lëndime serioze; më vonë, u ishte nënshtruar një sërë operacionesh në sy dhe kishte humbur shikimin.

Misioni i UNMIK-ut në Kosovë, gjithashtu i manduar në bazë të rezolutës 1244 të KS të OKB-së, e kishte hetuar rastin. Në raportin për këtë rast, të datës 18 mars 2000, të hartuar nga policia e UNMIK-ut thuhej se Gadaf Behrami ka vdekur nga lëndimet e shumta të marra pas eksplodimit të një bombe kasetore, dhe e kualifikoi incidentin si

“vrasje e paqëllimshme e kryer nga pakujdesia”. Në maj të po këtij viti, Agim Behrami, prindi i fëmijës, ishte informuar nga UNMIK-u që nuk do të ketë procedim penal për rastin, pasi bomba nuk ka eksploduar gjatë sulmeve ajrore të NATO-s. Ai ishte informuar po ashtu se kishte të drejtë të hapte rast penale brenda tetë (8) ditësh.

Më 25 tetor të vitit 2000, Agim Behrami u ankua te Zyra e Ankesave se Franca, që kishte përgjegjësi si udhëheqëse e brigadës shumëkombëshe, nuk kishte respektuar dispozitat e rezolutës 1244 në lidhje me çmontimin e minave. Pretendimi ishte hedhur poshtë me arsyetimin se pastrimi i minave ishte përgjegjësi e Kombeve të Bashkuara që nga data 5 korrik 1999.

Saramati kundër Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë

Në prill të vitit 2001, ankuesi, Ruzhdi Saramati ishte arrestuar nga policia e UNMIK-ut dhe më pas paraburgosur. Me 23 maj 2001, një prokuror kishte ngritur aktakuzë për veprat penale tentim vrasje, shkaktim të lëndimeve serioze trupore, posedim të paligjshëm të armëve ose eksplodim substancash, që kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe sjellje të dhunshme. Apeli i tij kundër një urdhëri tjetër për paraburgim ishte i suksesshëm dhe ai u lirua.

Me 13 korrik 2001, ankuesi është arrestuar sërish nga dy zyrtarë policorë të UNMIK-ut. Ai fillimisht kishte deklaruar se ishte një zyrtar gjerman i KFOR-it që kishte dhënë urdhër gojor për arrestim dhe e kishte informuar atë se po arrestohej me një urdhër të Komandatit të KFOR-it, që në atë kohë ishte një ushtarak norvegjez. Ai ishte transportuar në një kamp të KFOR-it dhe ishte përcjellë nga ushtarë amerikan të KFOR-it. Me 14 korrik 2001, Komandati i KFOR-it kishte autorizuar paraburgimin edhe për 30 ditë të tjera.

Përfaqësuesit ligjorë të z. Saramati ndërkohë kishin adresuar një letër me të cilën e vënin në dyshim ligjshmërinë e arrestimit dhe mbajtjes së tij në paraburgim. Me 26 korrik 2001, këshilltari ligjor i KFOR-it ishte përgjigjur se KFOR-i kishte autoritet për paraburgim në bazë të rezolutës 1244 dhe sipas nevojës për të “mbajtur një mjedis të qetë dhe të sigurtë” në Kosovë dhe për të mbrojtur trupat e KFOR-it. Arsyetimi i KFOR-it ishte se kishte informacion për përfshirjen e ankuesit në grupet e armatosura që operonin në rajonin kufitar ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë. KFOR-i ishte mjaftuar me këtë për të ardhur në përfundimin se ankuesi paraqiste kërcënim për sigurinë e KFOR-it dhe të atyre që jetonin në Kosovë.

Me 11 gusht 2001, ankuesit i ishte zgjatur sërish paraburgimi. Me 6 shtator të po të njëjtit vit, rasti i ankuesit ishte transferuar në gjykatën e qarkut për gjykim. Gjatë secilës seancë dëgjimore, nga 17 shtatori 2001 deri më 23 janar 2002, përfaqësuesit ligjorë të ankuesit kishin kërkuar lirimin e tij. Në të gjitha rastet, gjykata ishte përgjigjur se paraburgimi i tij ishte përgjegjësi e KFOR-it. Me 3 tetor 2001, një gjeneral francez ishte zgjedhur komandant i KFOR-it.

Me 23 janar 2002, ankuesi ishte dënuar për veprën tentim vrasje dhe tri ditë më vonë, me 26 janar 2002, ishte transferuar nga KFOR-i në qendrën e paraburgimit të UNMIK-ut në Prishtinë. Me 9 tetor 2002, Gjykata Supreme e Kosovës prishi dënimin e ankuesit dhe e ktheu rastin e tij për rigjykim në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës. Gjithashtu, Gjykata urdhëroi lirimin e tij nga paraburgimi.

Përmbledhje e pretendimeve

Behrami dhe Behrami kundër Francës

Ankuesit pretendonin se vdekja e Gadaf Behramit dhe lëndimet e Bekim Behramit ishin shkaktuar nga dështimi i trupave franceze të KFOR-it për të shenjzuar dhe/ose detonuar bombat kasetore të paeksploduar, për të cilat KFOR-i e dinte se ndodheshin në atë vend, duke pretenduar kështu të shkeljes së Nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Saramati kundër Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë

Ankuesi ka paraqitur pretendimet e tij në bazë të Nenit 5 dhe Nenit 13 të Konventës në lidhje me paraburgimin nga ana e KFOR-it ndërmjet periudhës prej 13 korrikut 2001 deri me 26 janar 2002. Ai, gjithashtu, u ankua në bazë të Nenit 6 § 1 për atë se ai nuk kishte qasje në gjykatë, dhe në bazë të Nenit 1 pasi Franca, Gjermania dhe Norvegjia kishin dështuar t'ua garantonin të drejtat e njohura me Konventë individëve që jetonin në Kosovë.

Ankuesi fillimisht kishte deklaruar se një oficer gjerman i KFOR-it kishte qenë i përfshirë në arrestimin e tij. Po ashtu, ai i referohej faktit se Gjermania ishte shteti udhëheqës i forcës shumëkombëshe në juglindje. Qeveria Gjermane ishte përgjegjës se, pavarësisht hetimeve të detajuara, nuk kishte qenë në gjendje të vërtetonte përfshirjen e ndonjë zyrtari gjerman të KFOR-it në arrestimin e ankuesit.

Ankuesi ka deklaruar se pohimet e tij janë bërë në mirëbesim, porse nuk ka qenë në gjendje të ofrojë ndonjë dëshmi objektive mbështetëse për deklaratën e tij. Më tej, ka vlerësuar se kontrolli i KFOR-it gjerman në sektorin përkatës të sigurisë ishte bazë e pamjaftueshme për ta vënë atë brenda juridiksionit të Gjermanisë. Kësisoj, ankuesi ka kërkuar tërheqjen e rastit të tij kundër Gjermanisë. Duke gjetur se respektimi i të drejtave të njeriut nuk kërkonte shqyrtimin e mëtejshëm të rastit të z. Saramatit kundër Gjermanisë (Neni 37 § 1), Gjykata vendosi që ta ç'regjistroj nga lista rastin në lidhje me Gjermaninë.

Arsyetimi i Gjykatës

Në rastin *Behrami dhe Behrami*, Gjykata ka vërejtur se ankuesit kanë paraqitur ankesë rreth mosveprimit të dyshuar të trupave të KFOR-it. Ndërsa, z. *Saramati* është ankuar rreth paraburgimit nga dhe me urdhër të KFOR-it. Kryetari i Gjykatës është pajtuar që t'i bashkojë të dy rastet dhe të kufizohet në shqyrtimin e pranueshmërisë së tyre.

Në vlerësimin e Gjykatës, çështja e ngritur nga të dy rastet nuk kishte të bënte me atë nëse shtetet e përfshira ushtronin juridiksion ekstra-territorial në Kosovë, aq sa me pyetjen nëse Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ishte komepente që të shqyrtonte, mbi bazën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kontributin e këtyre shteteve ndaj pranisë civile dhe ushtarake ndërkombëtare që ushtronte kontroll në Kosovë.

Gjykata vlerësoi se lëshimi i urdhërave për paraburgim binte brenda mandatit të sigurisë së KFOR-it, ndërsa mbikëqyrja e de-minimit binte brenda mandatit të UNMIK-ut. Gjykata vazhdoi tutje me përcaktimin nëse veprimet e dyshuara të KFOR-it (paraburgimi i z. Saramatit) dhe mosveprimi i UNMIK-ut (dështimi i pretenduar për de-minim në rastin Behrami) mund t'u atribuoheshin (mvisheshin) Kombeve të

Bashkuara. Në këtë drejtim, Gjykata së pari konstatoi se Kapitulli VII i Kartës së KB-ve mund të lejojë delegimin e pushteteve të Këshillit të Sigurimit të KFOR-i në fushën e sigurisë dhe të UNMIK-u në fushën e administrimit civil. Dhe, sipas arsyetimit të Gjykatës, pasi KFOR-i ushtronte në mënyrë të ligjshme kompetencat e deleguara sipas kapitullit VII të Kartës nga ana e Këshillit të Sigurimit dhe pasi UNMIK-u ishte organ ndihmës i KB-ve i krijuar në bazë të Kapitullit VII, veprimi i dyshuar dhe mosveprimi, në parim, i “atribuohet” Kombeve të Bashkuara, të cilat kishin subjektivitet juridik të ndarë nga ai i shteteve anëtare dhe që, gjithashtu, nuk ishin palë kontraktuese e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pas përcaktimit të mësipërm, Gjykata shqyrtoi çështjen e kompetencës së saj për të vlerësuar përputhshmërinë me Konventën të veprimeve të shteteve të përfshira, veprime këto të ushtruara në emër të Kombeve të Bashkuara; dhe, në kontekst edhe më të përgjithshëm, për të vlerësuar marrëdhënien ndërmjet Konventës dhe Kombeve të Bashkuara, të cilat ishin duke vepruar mbi bazën e Kapitullit VII të Kartës.

Gjykata rikujton se objektivi parësor i Kombeve të Bashkuara është ruajtja e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Ndonëse është njëlloj e qartë se siguri i respektit për të drejtat e njeriut përbën kontribut të rëndësishëm në arritjen e paqes ndërkombëtare, fakti është se Këshilli i Sigurimit ka përgjegjësi parësore, si dhe mundësi të gjera në dispozicion, për të përmbushur këtë objektivi, përfshirë përmes masave shtrënguese. Në rastin konkret, sipas Gjykatës, Kapitulli VII i Kartës ka lejuar Këshillin e Sigurimit që të miratojë masa konkrete si reagim ndaj një konflikti të identifikuar, që është konsideruar si kërcënim për paqen, pra rezolutën 1244 me të cilën është themeluar UNMIK-u dhe KFOR-i.

Pasi veprimet e përcaktuara në rezolutat e miratuara sipas Kapitullit VII të Kartës ishin themelore për misionin e Kombeve të Bashkuara për të siguruar paqen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe pasi këto rezoluta, për qëllime të zbatimit dhe efikasitetit, mbështeteshin në ndihmën ose kontributin e shteteve anëtare, Konventa nuk mund të interpretohet në një mënyrë që i bën veprimet ose mosveprimet e shteteve palë, të cilat mbuloheshin nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit, subjekt vlerësimi nga ana e Gjykatës. Vlerësimi i përputhshmërisë së këtyre veprimeve ose mosveprimeve në raport me Konventën, sipas Gjykatës, do të paraqiste ndërhyrje në zbatimin e misionit kyç të KB-ve, duke përfshirë këtu edhe zhvillimin efektiv të operacioneve të misionit. Kjo gjithashtu do të ishte e barazvlershme me vendosjen e kushteve për zbatimin e rezolutës së Këshillit të Sigurimit, të cilat nuk ishin përcaktuar në vetë tekstin e rezolutës.

Përfundimisht, Gjykata gjen se UNMIK-u ishte organ ndihmës i krijuar nga Kombet e Bashkuara në bazë të Kapitullit VII të Kartës dhe KFOR-i ushtronte kompetencat e deleguara në mënyrë të ligjshme nga ana e Këshillit të Sigurimit, gjithashtu, në bazë të Kapitullit VII. Kësisoj, veprimet ose mosveprimet e UNMIK-ut dhe KFOR-it i atribuoheshin drejtpërdrejtë Kombeve të Bashkuara, organizatë kjo me juridiksion universal, duke përmbushur objektivin e saj madhor të sigurisë kolektive. Në këto rrethana, Gjykata vjen në përfundimin se ankesat e ankuesve duhen shpallur të papajftueshme me juridiksionin *ratione personae* të Gjykatës në bazë të dispozitave të Konventës.

Në vijim të këtij përfundimi, Gjykata e vlerëson të panevojshme që të shqyrtojë pretendimet e mbetura të palëve rreth pranueshmërisë së ankesës, përfshirë kompetencën *ratione loci* të Gjykatës për të shqyrtuar ankesat kundër shteteve të përfshira rreth veprimeve ose mosveprimeve të tyre ekstra-territoriale; apo për të vlerësuar nëse ankuesit kanë shterur mjetet efektive juridike që kanë pas në dispozicion sipas kuptimit të dhënë në Nenin 35(1) të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendos të ç’regjistroj nga lista e saj e rasteve ankesën e *Saramatit* kundër Gjermanisë [njëzëri]. Gjykata vendosë, gjithashtu, ta shpallë të papranueshme ankesën e *Behramit* dhe *Behramit* dhe pjesën e mbetur të ankesës së *Saramatit* kundër Francës dhe Norvegjisë [me shumicë].

Issa dhe të tjerët kundër Turqisë - 31821/96

16 nëntor 2004 [Seksioni i Dytë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 1

Pretendim i shkeljes së të drejtave të garantuara me Konventë nga trupat turke të futura në zonën e Irakut Verior / *nuk ka juridiksion - të papranueshme*

Nenet 2, 3, 5, 8, 13, 14 dhe 18

Shkelje e të drejtave të garantuara me Konventë si pasojë e vrasjes së të afërmve nga forcat turke të futura në zonën e Irakut verior / *e panevojshme për shqyrtim*

Fjalët kyçe: autoritet jashtë territorit / juridiksion / zonë jashtë shtetit / konflikt / barinjë / vrasje / mungesë e dëshmime

Ankueset: znj. Halima Musa Issa, znj. Beebin Ahmad Omer, znj. Safia Shaëan Ibrahim, znj. Fatime Darëish Murty Khan, znj. Fahima Salim Muran dhe znj. Basna Rashid Omer, shtetase irakiane.

Faktet e rastit

Ankueset, gjashtë baresha të Irakut verior, sollën ankesën në emër të tyre dhe të familjarëve të tyre të ngushtë të cilët kishin humbur jetën në mëngjesin e 2 prillit të vitit 1995.

Me datën 1 prill, ankueset kishin mësuar se ushtria Turke e cila kishte kaluar në anën irakiane më herët, ishte në rajonin e tyre. Ato kishin parë aktivitete ushtarake, dhe helikopterë duke transportuar ushqim në rrafshin poshtë fshatit të tyre.

Në mëngjesin e 2 prillit, Ismail Hassan Sherif, Ahmad Fatah Hassan, Abdula Teli Hussein, Abdulkadir Izat Khan Hassan, Abdulrahman Mohammad Sherriff, Guli Zekri Guli dhe Sarabast Abdulkadir Izatthe, së bashku me ankuesen e parë, të tretë, të katërt dhe të pestë, kishin lënë fshatin e tyre, për të dërguar delet që kishin në male. Ankuesja e dytë dhe e gjashtë kishin qëndruar në shtëpi për t'u përkujdesur për fëmijët e tyre. Pasi ky grup i njëmbëdhjetë personave kishin filluar te ecnin për pesëmbëdhjetë minuta në drejtim të Spna, me katër gratë duke i prirë grupit, ata kishin hasur në ushtarët turq. Këta të fundit, kishin filluar t'i sulmojnë fizikisht që të njëmbëdhjetë barinjët irakianë, duke i urdhëruar gratë që të kthehen në shtëpi, ndërsa kishin ndaluar burrat.

Gjatë kësaj kohe, ankuesja e dytë dhe e gjashtë, kishin dëgjuar të shtëna armësh, dhe një bashkëfshatar i kishte informuar se usharët turk ndodheshin afër fshatit të tyre. Këto dy gra, së bashku me tri gra të tjera të fshatit, nga brengosja, kishin dalur të kërkojnë familjarët e tyre. Kur këto i arritën ushtarët turq, panë edhe barinjët me ta. Në ato momente, ushtarët turq kishin filluar të shtinin me armë zjarri në drejtim të tyre, për t'i larguar nga aty. Kështu gratë duke u kthyer, hasën në një grup tjetër ushtarësh, dhe kërkuar leje që të flasin me burrat e tyre. Usharët kishin drejtuar armët në drejtim të tyre, kështu që ato kishin vazhduar rrugën.

Në vend se të ktheheshin në fshat, ato kishin provuar të fshiheshin në rrafshin poshtë fshatit, mirëpo ishin zbuluar nga ushtarët të cilët i kishin kërcënuar se do t'i vrisnin nëse nuk largohen nga aty. Në atë kohë, ato kishin parë një helikopter duke ateruar. Gratë prapë kishin kërkuar që të bisedonin me burrat e tyre, por ata kishin refuzuar. Kështu, pas një kërkimi të pasuksesshëm deri në orën 13:00, ato ishin kthyer në fshat dhe kishin ndarë me bashkëfshatarët tjerë, të gjitha ato që kishin parë dhe që ju kishte ndodhur.

Disa nga burrat e fshatit, të shoqëruar nga anëtarë të Partisë Demokratike Kurdistane (KDP), kishin shkuar në Anshki, një qytezë afër fshatit, ku ndodhej një tog i madh i ushtrisë turke, e cila shikonte të gjitha operacionet në rajon. Burrat kërkuar disa herë gjatë ditës që të liroheshin barinjte sa më parë, pasi që ata ishin vetëm civilë të pafajshëm. Zyrtari i ushtrisë në detyrë, në fillim kishte thënë që nuk ishte në dijeni për rastin, e më vonë kishte thënë që ata do të liroheshin. Ai gjithashtu kishte dhënë leje që burrat nga fshati të merrnin delet e barinjve për t'i kthyer në fshat. Kur burrat kishin kërkuar prapë që të liroheshin barinjte, zyrtari ishte nervozuar, dhe duke bërë titur u kishte thënë burrave të mos i kërkonin ata më. Kështu ata ishin larguar. Kur burrat kishin marrë delet, kishin kërkuar barinjte, mirëpo nuk i kishin gjetur.

Më 3 prill 1995, ushtria turke ishte larguar nga rajoni rreth fshatit, dhe kështu burrat e fshatit ishin nisur në drejtim të Spna, për të kërkuar barinjte e zhdukur. Në një zonë afër vendit ku ishin parë për herë të fundit, burrat kishin gjetur trupat e pajetë të Ismail Hassan Sherif, Ahmad Fatah Hassan, Abdulkadir Izat Khan Hassan, Sarabast Abdulkadir Izat dhe Abdulrahman Mohammad Sherriff. Trupat kishin marrë shumë plagë nga plumbat, si dhe shumë pjesë të trupit - veshetë, gjuhët, dhe gjenetalet - ju mungonin. Trupat ishin dërguar për autopsi në spitalin e Dohuk.

Me 4 prill, Partia Demokratike Kurdistane (KDP), kishte mbajtur një konferencë për shtyp, dhe drejtuesi i rajonit Amedi Z. SN, kishte thënë se sapo kishin pranuar informacionin se disa barinjë ishin arrestuar nga ushtarët turq, ai kishte vizituar komandantin e ushtrisë turke në rajonin e Kadish-it dhe kishte kërkuar lirim të tyre. Komandanti kishte thënë se barinjte do të lirohen, mirëpo ata nuk ishin liruar as pas katër ose pesë vizitave të Z. SN. Pasi që forcat turke ishin larguar nga rajoni gjatë natës, SN ishte rikthyer te komandanti në mëngjesin e radhës. Këtë herë, komandanti kishte mohuar se barinjte ishin arrestuar. Gjatë konferencës për shtyp, SN kishte treguar listën me emrat e shtatë barinjëve të cilën ia kishte dhënë komandantit turk. Në konferencë ishin prezente edhe gjashtë ankueset për t'u përgjigjur pyetjeve. Më 5 Prill 1995, ishin gjetur edhe trupat e Abdula Teli Hussein dhe Guli Zekri Guli në një gjendje të ngjashme me trupat e pesë barinjëve të tjerë të gjetur më herët.

Më 7 Prill 1995 gjashtë ankuesit dhe dëshmitarët tjerë ishin intervistuar nga Dr RA dhe Z. Kerim Yildiz në prezencë të *muhtar*-it të regjionit Tamim të provincës së Sarsang-ut. Gjashtë ankueset që nga atëherë kanë dorëzuar disa peticione tek autoritetet e regjionit, duke kërkuar hetime për vdekjet e familjarëve të tyre. Ato parashtruan ankesë edhe te Guvernatori i Dokut-ut dhe dhanë deklaratat, ku ky i fundit kishte premtuar se se vdekjet do të hetoheshin. Sidoqoftë, ankueset nuk kanë pranuar ndonjë informacion për ndonjë veprim të Guvernatorit mbi rastin.

Përmbledhje e pretendimeve

Qeveria turke, në vërejtjet preliminare kishte ngritur çështjen e “juridiksionit” të interpretuar në Nenin 1 të Konventës, duke sfiduar pranimin e ankesës në bazat e Nenit 35 § 1 të Konventës, edhe pse ata asnjëherë nuk e kishin mohuar praninë e tyre në Irak gjatë asaj kohe, duke potencuar se ushtarët turk nuk kanë qenë prezent në zonën që pretendohet nga ankuesit, pra në zonën në të cilën pretendohet se ka ndodhë ngjarja. Prandaj për Qeverinë, prezenca e trupave turke për kohë të kufizuar dhe për qëllim të kufizuar në Irakun verior nuk është sinonim i “juridiksionit”. Për ankueset, ky fakt ishte i papranueshëm, dhe se juridiksioni i Turqisë nuk kishte qenë asnjëherë në pikëpyetje, për t’u pranuar rasti. Sido që të jetë, Qeveria përfundoi se, duke marrë parasysh interpretimin e Gjykatës për nocionin e “juridiksionit” në rastin *Bankovic dhe të tjerët*⁴, juridiksioni i Turqisë nuk shtrihej deri në Irakun verior, për dhunimet e pretenduara të Konventës dhe protokollit të saj, si dhe përgjegjësia për shkeljen e Konventës për rastin në fjalë nuk duhet t’i atribuohet Turqisë.

Ankueset në anën tjetër argumentuan se juridiksioni në këtë rast nuk kishte ngjashmëri me rastin *Bankovic dhe të tjerët* dhe duke ju referuar Konventës, parashtruan se në rastin në fjalë viktimat e rastit janë qartë viktimat e Qeverisë turke, dhe se ushtria e saj kishte fuqi *de facto* mbi territorin e Irakut Verior në atë periudhë kohore. Ankueset theksuan gjithashtu që barinj të vrarë binin në kategorinë e personave të mbrojtur, sipas Nenit 5 në Konventën e Katërt të Gjenevës, së vitit 1949.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me Nenin 1 të Konventës, pavarësisht nga fakti se Qeveria nuk e kishte ngritur në mënyrë eksplicite çështjen e juridiksionit në kuptim të Nenit 1 të Konventës përpara vendimit të pranueshmërisë, sipas rregullës 55 të Rregullores së Gjykatës, Qeverisë nuk mund t’i mohohet kjo e drejtë në rastet kur kjo ishte një çështje e drejtpërdrejtë dhe e lidhur pashmangshmërisht me faktet ku bazohen pretendimet e ankuesve. Si i tillë është lënë të shqyrtohet mënyrë implicite për fazën e meritave.

Nga Neni 1 i Konventës rrjedh që shtetet palë duhet të përgjigjen për çdo shkelje të të drejtave dhe lirive të mbrojtura nga Konventa kundër individëve të vendosur nën "juridiksionin" e tyre. E gjykatës tregon se koncepti i "juridiksionit" për qëllimet e Nenit 1 të Konventës duhet të konsiderohet për të pasqyruar kuptimin e termit në të drejtën ndërkombëtare publike, sipas të cilës kompetenca juridiksionale e shtetit ishte kryesisht territoriale. Megjithatë, koncepti i "juridiksionit" brenda kuptimit të Nenit 1 të Konventës nuk është domosdoshmërisht i kufizuar në territorin kombëtar të shteteve palë. Në rrethana të jashtëzakonshme, aktet e shteteve palë që kryhen jashtë territorit të tyre ose që kanë prodhuar efekte atje mund të arrijnë të përshihen brenda juridiksionit të tyre në kuptimin e Nenit 1 të Konventës. Kështu, shteti mund të thirret në përgjegjësi kur, si pasojë e veprimit ushtarak - qoftë i ligjshëm apo i paligjshëm - ai shtet në praktikë ushtron kontroll efektiv të një zone që ndodhet jashtë territorit të saj kombëtar. Për më tepër, Gjykata më parë ka theksuar se një shtet gjithashtu mund të jetë përgjegjës për shkeljen e të drejtave dhe lirive të Konventës të personave që ndodhen

⁴ *Bankovic dhe të tjerët kundër Belgjikës dhe 16 Shteteve tjera kontraktuese* (vend.) [DhM], ankesa nr. 52207/99, §§ 14-27, GjENDNj 2001-XII.

në territorin e një shteti tjetër, por që gjenden nën autoritetin dhe kontrollin e shtetit të mëparshëm nëpërmjet agjentëve të saj që veprojnë - qoftë në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme - në këtë shtet të fundit. Përgjegjësjësia në situata të tilla rrjedh nga fakti se Neni 1 i Konventës nuk mund të interpretohet ashtu që të lejonte një shtet palë të kryejë shkelje të Konventës në territorin e një shteti tjetër, të cilin nuk mund të kryejë në territorin e vet.

Duke aplikuar parimet si më lartë në faktet e rastit në fjalë, Gjykata fillimisht duhet të konstatojë nëse të afërmit e ankuesve kishin qenë nën autoritetin dhe / ose kontrollin efektiv, dhe për këtë arsye brenda juridiksionit të shtetit të paditur, si rezultat i veprimeve jashtë territoriale të këtij të fundit. Në lidhje me këtë, ishte e padiskutueshme midis palëve se forcat e armatosura turke kishin kryer operacione ushtarake në Irakun verior gjatë një periudhe gjashtë javore midis 19 marsit dhe 16 prillit 1995.

Megjithatë, pavarësisht nga numri i madh i trupave të përfshirë në këto operacione ushtarake, nuk duket se Turqia kishte ushtruar kontroll të përgjithshëm në të gjithë zonën e Irakut verior. Çështja esenciale për t'u shqyrtuar për Gjykatën është, pra, nëse në kohën përkatëse trupat turke kishin kryer operacione në zonën ku ndodhën vrasjet. Standardi i provës i përdorur nga Gjykata për të përcaktuar këtë çështje duke pasur parasysh dokumentet dhe provat e tjera, është "përtej dyshimit të arsyeshëm".

Gjykata vuri në dukje ndër të tjera se ankueset nuk kishin dhënë ndonjë hollësi lidhur me identitetin e komandantit ose të regjimentit të përfshirë në aktet e kontestuara apo një përshkrim të hollësishëm të uniformave të ushtarëve. Për më tepër, nuk kishte ndonjë dëshmi të pavarur të dëshmitarëve për praninë e ushtarëve turq në zonën në fjalë apo ndalimin e barinjve. Për më tepër, Gjykata nuk ishte në gjendje të përcaktojë, në bazë të provave në dispozicion të vet, nëse vdekjet ishin shkaktuar nga armët e zjarrit të shkarkuara nga trupat turke. Në lidhje me këtë, Gjykata nuk mund të shpërfillte faktin se zona ku u vranë të afërmit e ankuesve ishte skenë e luftimeve të ashpra mes militantëve të PKK dhe peshmergave të KDP në kohën përkatëse. Për më shumë, megjithëse raportet e lajmeve dhe të dhënat zyrtare konfirmuan kryerjen e operacioneve ndërkufitare dhe prezencën e ushtrisë turke në Irakun verior në atë kohë, këto materiale nuk mbështetën përfundimin me ndonjë siguri të madhe që trupat turke shkuan aq larg sa fshati Azadi në zonën e Spna.

Së fundi, pohimet e ankuesve se ato kishin bërë prezente ndaj oficerëve të ushtrisë turke nuk mund të konstatohej se ishin të vërtetuara. Ankueset nuk arritën të ofrojnë ndonjë provë bindëse dhe të fortë për të kundërshtuar pretendimet e Qeverisë se një ankim i tillë nuk ishte bërë kurrë për oficerët e ushtrisë turke në Irakun e veriut.

Në bazë të gjithë materialit në posedim të saj, Gjykata konsideroi se nuk ishte vërtetuar në standardin e kërkuar të provave se forcat e armatosura turke kishin kryer operacione në zonën në fjalë dhe, më saktë, në kodrat mbi fshatin Azadi ku, sipas deklaratave të ankuesve, viktimat ishin në atë kohë. Prandaj, Gjykata nuk ishte e bindur se të afërmit e ankuesve kishin qenë brenda "juridiksionit" të shtetit të paditur (Turqisë) për qëllimet e Neni 1 të Konventës.

Ky konstatim e bëri të panevojshme shqyrtimin e ankesave substanciale të ankuesve sipas Neneve 2, 3, 5, 8, 13, 14 dhe 18 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se veprimet e vrasjeve të të afërmëve të ankuesve nuk bie brenda juridiksionit të shtetit të paditur në kuptim të Nenit 1 të Konventës dhe se për këtë nuk është e nevojshme të shqyrtohen ankesat e ankuesve sipas Neneve 2, 3, 5, 8, 13, 14 dhe 18 të Konventës [*njëzëri*].

Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar - 35763/97
21 nëntor 2001 [Dhoma e Madhe]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3 në ndërlidhje me Nenet 1 dhe 13

Dështim në garantimin e mbrojtjes nga tortura si pasojë e akordimit të imunitetit ndaj Qeverisë së Kuvajtit / *nuk ka shkelje*

Neni 6 § 1

Qasja në gjykatë dhe hedhja poshtë e procedurave ankimore për shkak të imunitetit të shtetit/*nuk ka shkelje*.

Fjalët kyçe: *torturë / dëme psikike / kompensim / padi civile / imunitet shtetëror / raporte miqësore / juridiksion*

Ankuesi: z. Sulaiman Al-Adsani, me shtetësi të dyfishtë të Mbretërisë së Bashkuar dhe Kuvajtit

Faktet e rastit

Ankuesi shërbeu si pilot në Kuvajt gjatë Luftës së Gjirit dhe mbeti në Kuvajt pas pushtimit të Irakut si pjestar i forcave rezistente. Ai erdhi në posedim të video-kasetave me përmbajtje seksuale që përfshinin një Sheik i cili ishte ngushtë i lidhur me Emirin e Kuvajtit person ky që konsiderohej të ketë një pozitë me ndikim në Kuvajt. Sipas ankuesit, sheiku, i cili kërkoi përgjegjësi nga ankuesi për faktin se kasetat kishin dalur në domenin publik, me datë 2 Maj 1991 hyri në shtëpinë e tij së bashku me dy persona tjerë, e rrahën atë dhe e morën me armë në Burgun e Sigurisë së shtetit, ku u burgos për disa ditë dhe u rrah në mënyrë të vazhdueshme nga rojet. Ai u mor më vonë me armë dhe u dërgua në një pallat ku ai u mbajt në mënyrë të vazhdueshme nën ujë në një pishinë para se të dërgohej në një dhomë të vogël ku Sheiku i vuri zjarrin dyshekëve të lagur me benzinë, si rezultat i së cilës ankuesi pësoi djegie të rënda. Ai u lirua më 5 maj 1991, pasi u detyrua të nënshkruante një të deklaratë të rreme.

Fillimisht ankuesi u trajtua në një spital të Kuvajtit dhe më pas më 17 maj 1991 ai u kthye në Mbretërinë e Bashkuar ku kaloi gjashtë javë në spital duke u trajtuar për djegiet që mbulonin 25% të sipërfaqes të trupit të tij. Ai gjithashtu pësoi dëm psikologjik dhe u diagnostifikua se vuan nga një formë e rëndë e çrregullimit të stresit post-traumatik, i rënduar nga fakti se, ai mori kërcënime duke e paralajmëruar atë që të mos veprojë dhe të mos bëjë publike gjendjen e tij të vështirë. Autoriteti shtetëror i Kuvajti deklaroi se nuk ishte ne gjendje të vertetojë saktësinë e pretendimeve të ankuesit.

Pas kthimit në Mbretërinë e Bashkuar, ankuesi kishte filluar procedurat civile kundër sheikut dhe Qeverisë së Kuvajtit. Procedurat civile u inicuan bazuar në pretendimet e ankuesit, se ka pasur tre elemente që tregojnë përgjegjësinë e Shtetit për ngjarjet në Kuvajt: së pari, ishte dërguar në një burg të Shtetit; së dyti, transporti qeveritar ishte përdorur më 2 dhe 7 maj 1991; dhe, së treti, në burg ai ishte keqtrajtuar nga zyrtarët

publikë. Megjithatë, gjykatat angleze refuzuan kërkesën e ankuesit ndaj shteti të Kuvajtit për shkak të imunitetit shtetëror. Edhe në ankesën pranë Gjykatës së Apelit u hodh poshtë nën konkludimin se se qeveria e Kuvajtit ka të drejtë për imunitet shtetëror, dhe gjithashtu u refuzua leja për të apeluar në Dhomën e Lordëve.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi pretendon se gjykatat angleze, duke i dhënë Shtetit të Kuvajtit imunitet nga padia, dështuan ti garantonin atij gëzimin e së drejtës për mos t'u torturuar të garantuar me Nenin 3 në ndërlidhje me Nenet 1 dhe 13 të Konventës. Ankuesi gjithashtu pretendon se i është mohuar qasja në gjykatë për sa i përket ankesës së tij kundër Shtetit të Kuvajtit, në kundërshtim me Nenet 6 § 1 dhe 13 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet e ankuesit për shkeljen e Nenit 3 në ndërlidhje me Nenin 1 dhe Nenin 13, Gjykata përseriti se megjithëse Nenet 1 dhe 3 të marra së bashku vendosin një numër të detyrimeve pozitive ndaj Shteteve, të dizajnuara për të parandaluar dhe siguruar dëmshpërblim për tortura dhe keqtrajtme të tjera, detyrimi zbatohet vetëm në lidhje me veprimet e pretenduara të kryera brenda juridiksionit të Shtetit. Neni 3 ka disa kufizime, aplikimi jashtë territorit të shtetit kontraktues (aplikimi ekstraterritorial), vjen në shprehje për aq sa përgjegjësia e shtetit mund të ngritet në rastin e përjashtimit /ekstradimit të një individi në një vend ku ka arsye të konsiderueshme se ekziston një rrezik real i nenshtrimit ndaj torturës apo keqtrajtimit. Megjithatë, Gjykata vëren se përgjegjësia e shtetit dëbues/perjashtues do të lind nëse dëshmohet se shtetit dëbues ka ndërmarrë veprime që kishin si pasojë të drejtpërdrejtë ekspozimin e individit ndaj një trajtimi të tillë. Në rastin konkret, pasi që ankuesi nuk pretendoi se tortura e supozuar u bë brenda juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar apo se autoritetet Mbretërisë së Bashkuar kishin ndonjë lidhje shkakësore me ndodhjen e saj, nuk mund të thuhet se Shteti ishte nën një detyrim për të siguruar një mjet juridik civil në lidhje me torturën e pretenduar se ishte kryer nga autoritetet kuvajtiane. Për këtë Gjykata gjen se se nuk ka shkelje të Nenit 3.

Në lidhje me pretendimet për shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës Gjykata përseriti se nëse një person ka një kërkesë që është e bazuar në ligjet nacionale realizimi i kësaj kërkesë varet jo vetëm nga përmbajtja substanciale e së drejtës siç përcaktohet në ligjin kombëtar, por realizimi i kërkesës kërkon edhe dëshmi për ekzistencën e pengesve procedurale. Nuk do të ishte në përputhje me rregullin e sundimit të ligji ose parimin themelor të Nenit 6 § 1 nëse një shtet mundet, pa kontroll nga organet e Konventës, të bëjë largimin nga juridiksioni i gjykatave vendore të një game të tërë të kërkesave civile ose të jap imunitete për grupe apo kategori të caktuara të njerëzve. Në rastin aktual, Gjykata vëren se procedurat të cilat ankuesi kishte për qëllim të ndjekë kishin të bënin me një shkak të veprimit të njohur, përkatësisht dëmet për lëndime personale dhe dhënia e imunitetit nuk kualifikohet si një e drejtë thelbësore, por përbënte një pengesë procedurale në autoritetin e gjykatave për të përcaktuar të drejtën. Kështu ekzistonte një mosmarrëveshje serioze dhe e bazuar në lidhje me gëzimin e të drejtave civile dhe aplikimin e Nenit 6 të Konventës. Sipas Gjykatës e drejta e qasjes në gjykatë mund t'u nënshtrohet kufizimeve, me kusht që ato të mos dëmtojnë thelbin e së drejtës. Kufizime

të tilla duhet të synojnë që të ndjekin një qëllim të ligjshëm dhe të jenë proporcionale. Gjykata konsideron se dhënia e imunitetit sovran një shteti në procedurat civile ka për qëllim që të ndjekë qëllimin legjitim të respektimit të së drejtës ndërkombëtare dhe të nxis kultivimin e marrëdhënieve të mira midis shteteve.

Sa i përket proporcionalitetit, Gjykata vëren se që sa më shumë të jetë e mundur Konventa duhet të interpretohet në harmoni me rregullat e tjera të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë ato që kanë të bëjnë me imunitetin e Shtetit. Kështu, masat e marra nga një shtet i cili reflekton rregullat e pranuar ndërkombëtarisht, siq është në këtë rast ligji për imunitetin shtetëror nuk mund të konsiderohet në parim si imponues apo kufizim joproporcional në të drejtën e qasjes në gjykatë. Në këtë drejtim, statusi përkatës i Mbretërisë së Bashkuar është në përputhje me Konventën e Bazelit të vitit 1972. Megjithatë, kërkuesi pretendonte se ndalimi i torturës kishte fituar statusin e normës *jus cogens*, duke marrë përparësi mbi ligjet vendore, traktatet dhe rregullat e tjera të ligjeve ndërkombëtare. Për më shumë akuzat e tij kurrë nuk ishin vërtetuar, dhe keqtrajtimi i supozuar mund të kategorizohej si torturë në kuptim të Nenit 3 të Konventës. Gjykata pranon argumentet e ankuesit se e drejta e garantuar në Nenin 3 të Konventës është absolute, edhe disa traktate tjera ndërkombëtare ndalojnë gjithashtu torturën; përveç kësaj, shumë deklarata gjyqësore janë bërë dhe tashmë ndalimi i torturës ka statusin e një norme imperative ose *jus cogens*. Megjithatë, sipas Gjykatës rasti aktual nuk ka të bëjë me përgjegjësinë penale individuale por ka të bëjë me imunitetin e një shteti në procedurat civile dhe nuk kishte asnjë bazë në instrumentet ndërkombëtare, autoritetet gjyqësore ose materiale të tjera për të konkluduar se, si një çështje e të drejtës ndërkombëtare, një shtet nuk gëzon më imunitet nga padia civile në gjykatat e një shteti tjetër në lidhje me pretendimet për torturë. Rrjedhimisht, statuti i Mbretërisë së Bashkuar nuk ishte në kundërshtim me ato kufizime të pranuar përgjithësisht nga Kombet e Bashkuara si pjesë e doktrinës së imunitetit të shtetit dhe zbatimi i dispozitave të tij nuk mund të thuhet që ka qenë një kufizim i pajustificuar i qasjes së ankuesit në gjykatë. Për këtë, Gjykata konsideron se nuk ka asnjë shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se nuk ka pasur shkelje të Nenit 3 të Konventës dhe gjithashtu gjen se nuk ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës. [*njëzëri / me tetë vota nga nëntë*]

Arlewin kundër Suedisë - 22302/10

1 mars 2016 [Seksioni i Tretë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 1

Pretendime se mungon juridiksioni *ratione personae* për shkak të transmetimit të programit jashtë juridiksionit të suedisë / *bashkohet me meritat*

Neni 6

Shkelje e të drejtës për qasje në gjykatë si pasojë e refuzimit të kompetencës për të vendosur nga ana e gjykatave suedeze në bazë të së drejtës suedeze / *ka shkelje*

Nenet 8 dhe 13

Dështim i shtetit për ti ofruar mbrojtje të duhur të privatësise dhe ofrimit të mjeteve efektive juridike / *nuk ngritet çështje ndaras*

Fjalët kyçe: *juridiksion /ratione temporis / mjete (jo) efektive / e drejta në proces gjyqësor / emision televiziv / shpifje*

Ankuesi: z. Raja Arlewin, shtetas suedez i vetëpunësuar dhe udhëheq një biznes.

Faktet e rastit

Në prill të viti 2004 një televizion komercial Suedez kishte publikuar një episodë të një emisioni ku për qendër kishte biznese dhe transaksione të dyshimta, e ndër tjera portretizonte ankuesin si figurën qëndrore të krimit të organizuar. Programi në fjalë moderohet nga personi X, gjithashtu shtetas suedez dhe Drejtor Ekzekutiv i programi televiziv, i cili e ka akuzuar ankuesin për përfshirje në veprimtari kriminale.

Programi televiziv ishte prodhuar në Suedi, shfaqur në Suedi, krijuar për një audiencë suedeze dhe, po ashtu, ishte në gjuhën suedeze. Sidoqoftë, programi ishte dërguar nga Suedia përmes satelitit të një kompani televizive në Mbretërinë e Bashkuar (*Viasat Broadcasting UK*). Kompania britanike pastaj e kishte shfaqur atë në Suedi. Ankuesi ishte përpjekur që të ngriste padi kundër X-it për shpifje të rëndë, në lidhje me pretendimet se ai ishte i përfshirë në krim të organizuar.

Gjykata e Qarkut të Stokholmit kishte hedhur poshtë padinë, pasi programi nuk kishte prejardhjen nga Suedia. Megjithatë, Gjykata e kishte rezervuar vendimin për pretendimin në lidhje me të drejtën penale për një fazë të mëvonshme, pasi të kishte dëgjuar palët. Ankuesi kishte apeluar vendimin tek Gjykata e Apelit, e cila kishte hedhur poshtë ankesën, duke e lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Qarkut. Megjithatë, kjo gjykatë kishte vërejtur se ankuesi mund të ngriste padi në Mbretërinë e Bashkuar. Ankuesi e kishte apeluar edhe këtë vendim tek Gjykata Supreme e Suedisë e cila e kishte refuzuar ankesën.

Në ankesën e paraqitur pranë Gjykatës Supreme, ankuesi kishte ngritur pretendimin se qëndrimi i gjykatave suedeze ishte në kundërshtim me të drejtën e BE-së. Në këtë drejtim, ai kishte kërkuar që çështja e interpretimit të Rregullores së njohur si *Brukseli I*,

me numër 44/2001 në lidhje me juridiksionin dhe njohjen e zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështje civile dhe tregtare t'i referohej Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian për vendim paraprak. Sipas tij, Rregullorja i jepte të drejtë nje personi që ngritë pretendime për dëme jo-kontraktore të ndërmarrë veprime në territorin ku dëmi faktikisht ka ndodhur, në këtë rast në Suedi. Gjykata Supreme kishte hedhur poshtë edhe këtë kërkesë për referim të pyetjes për interpretim të Gjykata e Drejtësisë e BE-së.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi pretendon se gjykatat suedeze kanë refuzuar të shqyrtojnë meritat e rastit të tij për shpifje të sjellë kundër X, kësisoji duke mos i ofruar atij mjete efektive për mbrojtjen e reputacionit. Sipas ankuesit, kompetenca e gjykatave suedeze ishte e mbështetur në meritat e padisë.

Qeveria e Suedisë, në anën tjetër parashtrori argumentin se, në pajtim me Direktivën e Shërbimeve të Mediave Audiovizuale 2010/13/EU, *Viasat Broadcasting UK* ishte kompani e themeluar në Mbretërinë e Bashkuar dhe se vendimet editoriale rreth shërbimit medial audiovizuel ishin marrë në Mbretërinë e Bashkuar dhe jo në Suedi. Kësisoji, Mbretëria e Bashkuar, përmes Zyrës së saj të Komunikimit (*Ofcom*) kishte kompetencë mbikëqyrëse ndaj programeve të kompanisë. Sipas Qeverisë Suedeze, rasti binte jashtë kompetencës së gjykatave suedeze, pasi programi (që ishte shfaqur në Mbretëri të Bashkuar) kishte çuar te shkelja e mundshme dhe jo deklaratat brenda programit të shfaqur.

Çështja para Gjykatës ishte që të vendosë nëse kishte shkelje të së drejtës së ankuesit për qasje në gjykata, duke hedhur poshtë pretendimet e tij për shpifje mbi bazën e mungesës së kompetencës për të vendosur.

Arsyetimi i Gjykatës

Në arsyetimin e vet, Gjykata gjeti se çështja nëse Suedia kishte juridiksion në këtë rast, përbrenda kuptimit të Nenit 1 të Konventës ishte aq ngushtë e ndërlidhur me meritat e rastit sa asaj i duhej të shqyrtonte çështjen e kompetencës në ndërlidhmëri me meritat.

Në parashtrimet preliminare Qeveria Suedeze kishte argumentuar se ankuesi nuk ka shterur mjetet e brendshme juridike përpara se të paraqesë çështjen pranë Gjykatës. Qeveria ka deklaruar, gjithashtu, se ankuesi nuk kishte arritur të ngriste pretendime për dëme nga ana e shtetit. Vetë ankuesi ka kundër-argumentuar se veprimi ose padia origjinale në këtë rast përfshinte një palë të tretë dhe jo shtetin, një karakteristikë kjo që e bën rastin të veçantë.

Gjykata ka hedhur përfundimisht poshtë argumentin e Qeverisë se ankuesi nuk kishte shterur mjetet juridike, duke gjetur se kjo ishte një situatë e veçantë dhe se Qeveria, gjithashtu, nuk kishte identifikuar “një mjet që do të mund t'i ofronte mbrojtje ankuesit në lidhje me shkeljen e pretenduar dhe të cilin mjet do të ishte dashtë ta ndiqte.”⁵ Si rezultat i kësaj, Gjykata ka shpallur ankesën të pranueshme.

Tutje ankuesi pretendoi shkelje të Nenit 6 të Konventës, për shkak se qasja e tij në gjykata është cënuar përmes refuzimit nga ana e gjykatave suedeze për të dëgjuar pretendimet e tij në lidhje me rastin; sipas tij, e vetmja gjë që ka ndodhur në Mbretërinë

⁵ *Arlewin kundër Suedisë*, Nr. 22302/10, para. 48 (2016).

e Bashkuara, pra jashtë Suedisë, ka qenë transmetimi satelitor i programit. Ndonëse mund të kishte në dispozicion mjete efektive gjyqësore në Mbretërinë e Bashkuar, një gjë e tillë nuk ishte as ekonomike dhe as praktike për ankuesin. Nga ana e saj, Qeveria e Suedisë ka argumentuar se kompetenca mbikëqyrëse u ka takuar vetëm gjykatave të Mbretërisë së Bashkuar, pasi kompania televizive ka qenë e vendosur në atë shtet. Prandaj, sipas Qeverisë, mjetet e përshtatshme juridike për ankuesin ekzistonin në gjykatat e Mbretërisë së Bashkuar.

Në arsyetimin e vet sa i përket ligjit të zbatueshëm, Gjykata gjen se Rregullorja *Brukseli I* është ligji i zbatueshëm në këtë rast, që përcakton çështjen e kompetencës. Sipas Neneve 2 dhe 5 të Rregullores, të dy shtetet, Mbretëria e Bashkuar dhe Suedia, kanë kompetencë osë juridiksion në rastin konkret. Kjo për arsytet si në vijim: X ka vendbanimin në Suedi, derisa *Viasat Broadcasting UK* është e regjistruar dhe vendosur në Mbretërinë e Bashkuar, dhe ngjarja dëmtuese mund të argumentohet se ka ndodhur në cilindo prej të dyja vendeve, pasi programi televiziv është shfaqur nga Mbretëria e Bashkuar dhe dëmi i pretenduar i reputacionit të ankuesit është manifestuar në Suedi. Sipas Gjykatës, kjo është e mjaftueshme për të krijuar “detyrim *prima facie* për shtetin suedez, që të sigurojë të drejtat e ankuesit, duke përfshirë të drejtën për qasje në gjykata.”⁶ Si rezultat i kësaj, edhe pse ankuesi do të mund të kishte të drejtë qasjeje në gjykatat britanike, kjo nuk i liron gjykatat suedeze nga detyrimi për të ofruar të njëjtën të drejtë.

Në këtë rrethanë, shteti suedez ka pasur detyrim sipas Nenit 6, paragrafi 1, që t’i ofrojë ankuesit qasje efektive në gjykatë. Në mungesë të kësaj qasjeje, ai është vënë në pozicionin në të cilin nuk mund ta mbajë askend përgjegjës sipas të drejtës suedeze për pretendimet e tij për shpifje dhe dëmtim të reputacionit të tij. Kërkesa për të zhvilluar procedurat në Mbretërinë e Bashkuar nuk mund të thuhet se ka qenë alternativë e arsyeshme, efektive dhe praktike. Prandaj, sipas në pikëpamjen e Gjykatës, kufizimet e vëna ndaj të drejtës së ankuesit për qasje në gjykatë ka pasur efekte të gjera dhe nuk mund të konsiderohet, në rastin konkret, se kanë qenë proporcionale.

Lidhur me pretendimet e ankuesit bazuar në Nenet 8 dhe 13 për dështim të shtetit për ti ofruar mbrojtje të duhur të privatësisë dhe ofrimit të mjeteve efektive juridike, Gjykata konstaton se të njëjtat janë trajtuar në kuadër të Nenit 6 dhe nuk ngriten si çështje të ndara.

Gjykata urdhëron Suedinë t’i paguajë ankuesit 12,000 EUR në lidhje me dëmin jo-material dhe 20,000 EUR për kostot dhe shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës. Gjykata, ndërkaq, nuk gjen çështje të ndara në bazë të Nenit 8 dhe 13 të Konventës [njëzëri].

⁶ *Id.* para. 65.

Solomou dhe të tjerët kundër Turqisë - 36832/97

24 qershor 2008 [Seksioni i Katërt]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 1 në ndërlidhje me nenin 2

Shkelje e të drejtës në jetë si pasojë e vrasjes në territorin që kontrollohej nga Turqia dhe dështim për realizimin e hetimeve efektive /ka shkelje

Nenet 3, 8 dhe 14

Pretendim për përdorim të torturës dhe shkele të së drejtës në shtëpi dhe diskriminim / e panevojshme për shqyrtim

Fjalët kyçe: konflikt / ndarje / zonë e okupuar / kalim i zonës / vrasje / forcë e tëpërt / demonstrata / hetime efektive

Ankuesi-ti: Spyros, Antonis, Panayiotis, Maria, Costas, Niki dhe Paraskevi Solomou, shtatë shtetas qipriot

Faktet e rastit

Me 14 gusht 1966 Solomos Solomou, djali respektivisht vëllau i ankuesve, ishte pjesëmarrës në një funeral të një personi i cili ishte vrasë gjatë demonstratave kundër okupimit turk të pjesës së Qipros, me ç'rast me disa persona të tjerë të ndërmarrin veprim dhe hynë në zonën neutrale të kontrollit të Kombeve të Bashkuara, afër qendrës ku edhe vritet. Në pjesën jugore përgjatë vijës së zonës neutrale deri në pikën e kontrollit, zona kontrollohej nga Garda Nacionale Qipriote përderisa pjesa veriore kontrollohej nga Trupat turke të Republikës së Qipros Veriore.

Përkundër përpjekjeve të Forcave të Kombeve të Bashkuara në Qipro si dhe Policisë Civile të Kombeve të Bashkuara disa demonstrues duke përfshirë edhe Solomos Solomou hynë në zonën neutrale. Solomos Solomou me disa demonstrues të tjerë vrapuan në anën turke të zonës neutrale të cilët ndiqeshin nga ushtari britanez i Kombeve të Bashkuara, i cili bëntë përpjekje t'i tërhiqte nga zona. Solomos Solomou arriti të lirohej nga ustari britanez dhe kaloi telat turke të linjës së armëpushimit duke hyrë në zonën e okupuar.

Më pas Solomos Solomoi filloi të ngjitej në shtyllën ku flamuri turk valëvitej. Ai ishte i paarmatosur. Gjersa arriti të ngjitej për afërsisht tre metra në shtyllë, ai u gjuajt me pesë të shtëna nga për afërsisht tre persona nga pjesa turke dhe u plagos shumë rëndë, sa vdiq në vend.

Përmbledhje e pretendimeve

Qeveria Turke pretendoi se nuk ka juridiksion apo kontroll të 'Trupave Turke të Republikës së Qipros Veriore', prandaj sipas tyre ankuesve, nuk mund t'u jepet statusi i viktimës, pasi që asnjë akt i autoriteteve nuk është drejtuar kundër tyre personalisht. Sipas pretendimeve të Qeverisë, vdekja e Solomos Solomou duhet të shihet në natyrën e zhvillimit historik, të ndarjes së pjesës veriore nga pjesa jugore dhe duke krijuar

‘Trupat Turke të Republikës së Qipros Veriore’, duke krijuar strukturë të Qeverisë Demokratike dhe të pavarur, që nuk mund të përshkruhet si ’nënshtrim i administrimit lokal’ nga Turqia. Më tutje, Qeveria konsideron se vdekja ishte rezultat i veprimeve të papërgjegjshme të demonstruesve Greko-Qipriot me përkrahje aktive të autoriteteve Greko-Qipriote duke krijuar kështu një situatë shumë të rrezikshme. Sipas Qeverisë, veprimet arsyetohen sipas Nenit 2 paragrafit 2 të Konventës, dhe se vrasja e Solomos Solomout nuk ishte e qëllimshme.

Sipas ankuesve në anën tjetër faktet e paraqitura mund t’i mvishen autoriteteve Turke sipas Konventës, pasi që veprimet janë bërë direkt në pjesën veriore apo nëpërmes autoriteteve të ‘Trupave Turke të Republikës së Qipros Veriore’. Sipas ankuesve edhe nëse qëllimi nuk ka qenë për të vrarë, forca vdekjeprurëse e përdorur ishte joproporcionale. Ankuesit parashtuan se forcat Turke kanë gjuajtur në grupin e civilëve të paarmatosur duke protestuar në zonën neutrale. Për me tepër nuk ka pasur gjuajtje me armë, si paralajmërim por është gjuajtur direkt. Tutje sipas tyre Solomos Solomou nuk ka paraqitur kërcënim për asnjë, pasi që nuk ka demonstruar dhunë/sjellje të paligjshme. Për më tepër situata në zonën neutrale nuk ka paraqitur rebelim, sepse demonstruesit kanë qenë të kontrolluar nga forcat e K.B. dhe nuk ka mund të jetë asnjë kërcënim për ushtarët dhe policët turk të cilët ishin të armatosur shumë rëndë. Prandaj, përdorimi i forcës nuk ka qenë ‘absolutisht i domosdoshëm’ në rrethanat e rastit.

Sipas Qeverisë së Qipros vdekja është shkaktuar pa ndonjë armëgjuajtje apo të shtënë në shenjë vërejtjeje paraprake. Solomos Solomou është vrarë nga së paku tre persona turk, dy nga të cilët kanë qenë në uniformë. Solomou ishte i paarmatosur dhe i vetmi që ka kaluar linjën e armëpushimit dhe nuk ka paraqitur asnjë kërcënim për pozitën turke në territorin e okupuar.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me vrasjen e z. Solomou, në arsyetimin e saj Gjykata fillimisht vëren se Neni 2 i Konventës, i cili garanton të drejtën për jetë dhe përcakton rrethanat kur privimi nga jeta mund të arsyetohet, e paraqet njërin nga Nenet më themelore të Konventës, prej të cilit nuk lejohet asnjë shmangie. Sidoqoftë, Neni 2 duhet të interpretohet ashtu që garantimi i tij të jetë praktik dhe efektiv.

Përfshirjet e përshkuara në paragrafin 2 tregojnë se kjo dispozitë shtrihet, por nuk lidhet ekskluzivisht me vrasjen e qëllimshme. Teksti i Nenit 2, i lexuar në tërësi, tregon se paragrafi 2 nuk përcakton kryesisht rastet kur lejohet qëllimisht të vrasë një individ, por përshkruan situatat kur lejohet "të përdorë forcën" që mund të rezultojë, si produkt i padëshiruar; privimin nga jeta. Sidoqoftë, përdorimi i forcës nuk duhet të jetë më shumë se "absolutisht i domosdoshëm" për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në nënparagrafët (a), (b) ose (c). Prandaj edhe Gjykata duhet ta shqyrtojë privimin nga jeta në hollësitë më të mëdha jo vetëm nga veprimet e agjentëve po edhe rrethanat e rastit.

Gjykata gjithashtu vuri në dukje vështirësitë për ankuesit për të pasur qasje në dëshmitë të nevojshme për t’i mbështetur pretendimet, në ato raste kur Qeveria e paditur ka dokumentacionin përkatës dhe nuk ia dorëzon Gjykatës ato. Andaj, barra e provave bie

mbi Qeverinë nëse ajo dështon, si pasojë, t'i paraqes argumentet, me ç'rast çështja ngritet sipas Nenit 2 apo 3.⁷

Për më tepër Gjykata vëren se Solomou vullnetarisht ka hyrë në zonën neutrale të Kombeve të Bashkuara, mirëpo palët nuk pajtohen rreth origjinës së plumbave. Sipas ankuesve dhe palës qipriote, plumbat u gjuajtën nga dy persona në uniformë turke dhe nga një person tjetër që ishte turk në rroba civile dhe i cili ishte në terracë në pozitë të observatorit. Në të kundërtën, Qeveria pretendon se z. Solomou ishte viktimë e kryqëzimit të gjuajtjeve të cilat shpërthyen kur demonstratat Greko-Qiriote u shndërruan në rebelim. Një version të tillë të pretendimeve Gjykata nuk mund ta pranojë, për shkak se deklaramet e dëshmitarëve të paraqitura nga ankuesit, dokumentet duke përfshirë edhe video-filmin dhe fotografitë kundërshtojnë versionin e Qeverisë dhe demostrojnë qartë se ka pasë kryqëzim gjuajtjesh. Më në fund sipas Gjykatës, duhet të përmendet fakti se viktima është gjuajtur nga pesë plumba, gjë që duhet të trajtohet si çështje se a ka qenë gjuajtja e qëllimshme apo jo.

Gjykata vëren se nuk mund të pranohet se gjuajtja e Z.Solomou mund të arsyetohet se ka qenë 'në mbrojtje të dhunës së paligjshme', pasi që i vdekuri ishte i paarmatosur dhe nuk e kishte sulmuar asnjërin, ai ishte ngjitur në shtizë dhe tymoste cigare. Po ashtu nuk mund të argumentohet se forca e përdorur ka qenë 'absolutisht e domosdoshme' apo se ishte 'efekt i arrestit të ligjshëm'. Po ashtu sipas Gjykatës edhe nëse supozohet se ai e ka kaluar linjën e armëpushimit, vrasja e tij nuk arsyetohet, sepse është shumë e qartë që ai nuk do të mund të ikte nga vendi ku kanë ndodhur ngjarjet. Për më tepër, nuk ka pasë as të shtëna si paralajmërim.

Palët nuk pajtohen rreth shumicës së fakteve. Përderisa ankuesi dhe pala qipriote pretendojnë se demonstruesit ishin nën kontroll të forcave të Kombeve të Bashkuara, Qeveria turke argumenton se ka pasë eskalim të dhunës nga demonstruesit Greko-Qipriot. Sipas Gjykatës faktori kryesor që nuk është kontestuar është se i vdekuri ka qenë i paarmatosur dhe të shtënat i janë drejtuar atij dhe jo demonstruesve. Në këtë kontekst, Gjykata përsërit se përdorimi i forcës duhet të jetë "absolutisht i domosdoshëm" për të ndjekur një ose më shumë nga qëllimet e parashtruara në paragrafin 2 të Nenit 2 dhe se një veprim potencial i paligjshëm ose i dhunshëm i një grupi personash nuk mund si i tillë, të justifikojnë të shtënat e menjëhershme dhe vrasjen e një ose më shumë individëve të tjerë të cilët vetë nuk paraqesin kërcënim. Prandaj, Gjykata konsideron se ka pasur shkelje të Nenit 2 të Konventës kur autoritetet turke kanë gjuajtur mbi z. Solomos Solomou, i cili gjendej i vetëm në zonën neutrale.

Lidhur me pretendimin e ankuesve për çështjen e mungesës së mbarëvajtjes së hetimeve, Gjykata vëren se ky nen kërkon që të ekzistojë një formë e hetimit zyrtar efektiv kur individët janë vrarë si rezultat i përdorimit të forcës nga ana e autoriteteve shtetërore. Po ashtu, konsideron se qëllim esencial është që hetimi të sigurojë realizim të ligjeve nacionale të cilat mbrojnë të drejtën për jetë. Për të qenë një hetim efektiv për vrasjen e supozuar të paligjshme nga ana e agjentëve shtetërorë përgjithësisht sipas Gjykatës mund të konsiderohet si e nevojshme që personat përgjegjës për kryerjen e hetimeve të jenë të pavarur nga ata që janë të përfshirë në ngjarje. Kjo nënkupton jo

⁷ *Toğcu kundër Turqisë*, nr. 27601/95, § 95, 31 Maj 2005; *Akkum dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 21894/93, § 211, GjEDNj 2005-II

vetëm mungesën e lidhjes hierarkike apo institucionale, por edhe një pavarësi praktike. Autoritetet duhet të jenë po ashtu efektive në kuptimin që të jenë në gjendje të përcaktojnë se forca e përdorur është e justifikuar. Autoritetet do të duhej të siguronin të dhëna për incidentin, që përcaktojnë shkaqet e vdekjes si dhe përgjegjësinë e personit. Një shpejtësi dhe ekspeditim i arsyeshëm është i nënkuptuar në këtë kontekst. Duhet të pranohet se mund të ketë pengesa ose vështirësi që pengojnë përparimin e një hetimi në një situatë të caktuar. Megjithatë, Gjykata vëren se një përgjigje e shpejtë nga autoritetet në hetimin e përdorimit të forcës vdekjeprurëse mund të konsiderohet në përgjithësi si thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut në ruajtjen e sundimit të ligjit dhe në parandalimin e shfaqjes së fshehtësisë ose tolerancës ndaj veprimeve të paligjshme.

Gjykata thekson se në rastin në fjalë, Qeveria e paditur nuk ka paraqitur dëshmi që tregojnë se ishte kryer një hetim për rrethanat e vdekjes së Solomos Solomou. As nuk mund të pretendohet se, më shumë se njëmbëdhjetë vjet pas incidentit, ata që ishin përgjegjës për vrasjen e tij do të mund të identifikoheshin dhe akuzohen para një gjykate vendase. Në këtë drejtim, Gjykata gjen se autoritetet nuk arritën të kryenin një hetim penal efektiv në rrethanat që kishin të bënin me vdekjen e Solomos Solomou. Prandaj, Gjykata konsideron se ka pasur shkelje të Nenit 2 edhe në këtë aspekt.

Lidhur me pretendimet për shkeljen e Neneve 1, 3, 8 dhe 14 të Konventës, Gjykata konsideron se, për shkak të përfundimit të arritur në bazë të Nenit 2 të Konventës, nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse ka pasur shkelje të Neneve 1, 3, 8 dhe 14 të Konventën.

Gjykata përcaktoi shumën që duhet ta paguajë Turqia si dëmshpërblim jo material prej 35,000.00 EUR për ankuesin e parë si dhe shumën prej 15,000.00 EUR për secilin nga shtatë viktimat (vëllezërit dhe motrat) si dhe 12,000.00 EUR për shpenzimet gjyqësore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 2 në lidhje me vrasjen e kërkuesit dhe dështimin e shtetit të paditur për të zhvilluar hetim efektiv mbi rrethanat e vdekjes; ndërsa Gjithashtu konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse ka pasur shkelje të Neneve 1, 3, 8 dhe 14 të Konventës [njëzëri].

Seksioni I

Të drejtat dhe liritë

Neni 2

E drejta për jetën

1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i privohet jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjykatë pas dënimit për një krim për të cilin dënimi është parashikuar me ligj.
2. Privimi nga jeta nuk konsiderohet të shkaktohet në kundërshtim me këtë Nen në rastet kur ky privim vjen nga përdorimi i forcës, që është jo më shumë se absolutisht i domosdoshëm:
 - a) në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;
 - b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të ndaluar ligjërisht;
 - c) për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.

Sašo Gorgiev kundër “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” - 49382/06

19 prill 2012 [Seksioni i Pestë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 2

Shkelje e të drejtës në jetë si pasojë e veprimit rrezikues për jetën nga një zyrtar shtetëror policie, veprim ky i cili duhet t’i mvishet shtetit / *ka shkelje*

Neni 6

Pretendim për shkelje të procesit të rregull gjyqësor si pasojë e procedurave të tejzgjatura në mënyrë të paarsyeshme / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: rrezikim i jetës / plagosje me armë / organ shtetëror / obligim i shtetit / polic / përgjegjësi e shtetit

Ankuesi: z. Sašo Gorgiev, shtetas maqedonas, i lindur në Shkup në vitin 1972

Faktet e rastit

Ankuesi punonte si shërbyes në një kafene në Shkup. Në orën 3:50 të mëngjesit të datës 6 janar 2002, R.D., një polic rezervë, ka shtënë me armë, duke qëlluar ankuesin në kraharor. Sipas certifikatës mjekësore të lëshuar nga Qendra Klinike e Shkupit, ankuesi ishte pranuar me urgjencë në një “gjendje serioze”. Krahu i tij i djathtë është i paralizuar. Përfundimi ishte se ankuesi kishte pësuar lëndime serioze trupore me dëmtime që paraqisnin rrezik për jetën dhe pasoja aftgjata. Ai ishte operuar dy herë.

Me 27 mars 2003, gjykata e shkallës së parë në Shkup e kishte dënuar R.D. në mungesë, për “krime serioze kundër sigurisë”. Ai ishte dënuar me dy vite burgim. Pasi kishte dëgjuar dëshmitë gojore të R.D., ankuesit dhe gjashtë dëshmitarëve, si dhe kishte konsultuar dëshmi të tjera materiale, Gjykata kishte vendosur se R.D., në gjendje të intoksikuar, në mënyrë të paqëllimshme, kishte shkrepur armën e tij zyrtare dhe qëlluar ankuesin, i cili kishte qenë në një distancë prej një metre largësi. Ankuesi ishte udhëzuar që të ndiqte kërkesën e tij për dëmshpërblim përmes një padie të veçantë civile. Vendimi mori formën e prerë me 8 maj 2003. Pas fillimit të vuajtjes së dënimit, R.D. kishte kërkuar rihapjen e rastit, por sërish ishte gjetur fajtor dhe dënuar me dy vite burgim. Nuk janë dhënë informacione nëse ky vendim i datës 12 mars 2009 ishte apeluar apo kishte marrë formën e prerë.

Me 11 nëntor 2002, ankuesi kishte bërë padi civile kundër shtetit/Ministrisë së Brendshme, duke kërkuar dëmshpërblim për dëmin material dhe jo-material të pësuar si rezultat i dëmtimeve të shkaktuara nga R.D. Ankuesi pretendoi se shteti duhej mbajtur përgjegjës, marrë parasysh faktin se R.D., në vend se të ishte në detyrë në një stacion policie, ai e kishte qëlluar atë në një kafene. R.D. kishte përdorur armën zyrtare dhe ishte në uniformë. Pas pesë seancave të organizuara, gjykata e shkallës së parë në Shkup hodhi poshtë padinë e ankuesit, me arsyetimin se Ministria nuk mund të paditej sipas ligjit për dëmin e shkaktuar nga R.D., i cili, duke qenë polic rezervë, konsiderohej si zyrtar shtetëror. R.D. ishte i ngarkuar me detyrën për të bërë roje ndërmjet mesnatës

së 5 janarit 2002 dhe orës 01:00 të mëngjesit dhe ndërmjet orës 06:00 dhe 07:00 të mëngjesit me 6 janar 2002. Pas orës 01:00 me 6 janar 2002, në vend se të kthehej në stacion të policisë, R.D. kishte shkuar në një kafene, pa informuar eprorin e tij. Ai ishte në uniformë dhe kishte armën e tij zyrtare. Në kafene, në praninë e mysafirëve të tjerë dhe nën ndikimin e alkoolit, e kishte shkrepur armën dhe qëlluar ankuesin që ishte përballë tij. Në arsyetimin e gjykatës së shkallë së parë të Shkupit, përveç tjerash, thuhej se, “Fakti që (R.D.) ishte në uniformë dhe e kishte përdorur armën e tij zyrtare nuk nënkupton vetpërvete se ai ishte duke vepruar në kapacitet zyrtar. R.D. nuk përdori armën në lidhje me ushtrimin e detyrave të tij, por si mysafir në një kafene...” Kjo gjykatë përfundoi se, ankuesi kishte megjithatë të drejtë të kërkonte dëmshpërblim nga R.D.

Me 3 mars 2004, ankuesi e apeloji vendimin, duke argumentuar sërish se Ministria e Brendshme duhej mbajtur përgjegjëse për veprimet e R.D., pasi ai kishte vepruar duke qenë në detyrë, ishte në uniformë dhe kishte shtënë me armën e tij zyrtare. Ankuesi e mbështeti përgjegjësinë e Ministrisë në Nenin 103 të Ligjit të Punës, sipas të cilit Ministria mund të kërkonte pagim nga R.D. Së fundmi, ai paraqiti se kishte pësuar dëme të riparueshme nga incidenti, pasi krahu i tij i djathtë ishte paralizuar përgjithmonë. Me 27 prill 2004, Gjykata e Apelit të Shkupit hodhi poshtë ankimimin e ankuesit, duke mos gjetur arsye për të devijuar nga arsyetimi i gjykatës më të ulët se veprimet e R.D. në kafene nuk lidheshin me detyrat e tij zyrtare si oficer policie. Dhe pasi R.D. nuk po vepronte si zyrtar policie dhe nuk ishte duke ushtruar detyrat e tij zyrtare, sipas gjykatës, kjo nënkuptonte se Ministria nuk kishte përgjegjësi. Gjykata më tej konfirmoi të drejtën e ankuesit për të kërkuar dëmshpërblim nga R.D.

Me 21 korrik 2004, ankuesi paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme, duke argumentuar, përveç tjerash, se Gjykata e Apelit nuk kishte trajtuar argumentet e tij rreth përgjegjësisë së Ministrisë sipas Ligjit të Punës. Me 31 maj 2006, Gjykata Supreme hodhi poshtë ankesën e ankuesit, duke ripërsëritur arsyet e dhëna nga gjykatat më të ulëta.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi pretendon shkelje të Nenit 2 të Konventës, me arsyetimin se ka qenë viktimë e një veprimi me rrezik për jetën të ndërmarrë nga R.D., zyrtar shtetëror. Ai, po ashtu, ka paraqitur ankesë sipas Nenit 6, me pretendimin se gjykatat vendore kanë dështuar të njohin ose pranojnë përgjegjësinë e shtetit. Fakti që R.D. ishte mbajtur përgjegjës sipas të drejtës penale nuk e liron shtetin nga përgjegjësia në lidhje me dëmin që R.D. ka shkaktuar derisa ka qenë në detyrë.

Qeveria nga ana e saj ka argumentuar se R.D. nuk ka pas për qëllim të vrasë ankuesin. Dhe se kjo është vërtetuar gjatë procedurave penale kundër tij. Sipas Qeverisë, përgjegjësia e shtetit ka përfunduar me procedurat penale si pasojë të cilave R.D. është gjykuar dhe dënuar. Qeveria, gjithashtu, pretendonte mos-shterimin e të gjitha mjeteve efektive. Në veçanti, ankuesi nuk kishte kërkuar dëmshpërblim nga R.D., megjithëse ishte këshilluar ta bënte këtë nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë. Ankuesi, nga ana e tij, ka kundërshtuar këto argumente.

Gjykata vlerëson në këtë rast se çështja e zbatimit të Nenit 2 të Konventës dhe kundërshtimet e ngritura nga Qeveria janë ngushtë të lidhura me meritat e ankesës së

ankuesit. Kësisoji, shqyrtimi i këtyre çështjeve do të bashkohet me vlerësimin e meritave të ankesës. Në këtë drejtim, Gjykata përfundon se ankesa nuk është qartazi e pabazuar në kuptimin e Nenit 35, paragrafi 3 (a); për pasojë, ajo duhet shpallur si e pranueshme.

Arsyetimi i Gjykatës

Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, keqtrajtimi fizik nga ana e zyrtarëve shtetërorë që nuk rezulton në vdekje mund të shpалosë shkelje të Nenit 2 të Konventës vetëm në raste të jashtëzakonshme.

Në rastin konkret, nga dëshmitë e përcaktuara prej gjykatave vendore, është e qartë se R.D. kishte qëlluar ankuesin në anën e djathtë të kraharorit. Gjykata e pranon deklarinimin e Qeverisë se nuk është përcaktuar asnjë lloj qëllimi për vrasjen e ankuesit nga ana e R.D. Megjithatë, ajo vëren se fakti që ankuesi nuk ishte vrarë ishte rastësi. Në këtë kuptim, Gjykata i jep vlerë faktit që R.D. ka shtënë me armë drejt ankuesit në distancë shumë të afërt. Ankuesi kishte pësuar lëndime serioze, të cilat ishin identifikuar si lëndime të natyrës me rrezik për jetën. Kjo e ka lënë atë me humbje afatgjatë të funksionimit. Serioziteti i lëndimeve të tij nuk është kundërshtuar nga palët. Në dritën e këtyre rrethanave, Gjykata vjen në përfundimin se, pavarësisht nëse R.D. kishte për synim ta vriste ose jo, ankuesi ishte viktimë e sjelljes, e cila sipas vetë natyrës së saj, e kishte vënë jetën e tij në rrezik, pavarësisht që, në këtë rast, ai kishte mbijetuar. Neni 2 është pra i zbatueshëm në këtë rast konkret.

Gjykata rikujton se Neni 2 nuk ka të bëjë vetëm me vdekjet që vijnë nga përdorimi i forcës prej zyrtarëve të shtetit, por gjithashtu, siç përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë, përcakton detyrime pozitive ndaj shteteve për të marrë hapa të përshtatshëm që mbrojnë jetët e atyre që janë brenda juridiksionit të tyre.⁸ Ky detyrim pozitiv përfshinë mbi të gjitha detyrimin e shtetit për të krijuar një kornizë ligjore dhe administrative që ka për qëllim të ofrojë parandalim efikas. Kjo kornizë duhet të përfshijë rregullore të krijuara enkas për aktivitete të caktuara, veçanërisht në lidhje me nivelin e rrezikut të tyre të mundshëm ndaj jetëve njerëzore. Shteti pra duhet të tregojë kujdesin më të lartë dhe të përcaktojë rrethanat e kufizuara në të cilat zyrtarët për zbatimin e ligjit mund të përdorin armët e zjarrit. Në pajtim të mëtejme me praktikën gjyqësore të Gjykatës, detyra e shtetit për të mbrojtur të drejtën në jetë duhet të përfshijë edhe ndërmarrjen e masave të arsyeshme për të garantuar sigurinë e individëve në vende publike dhe, në rast të lëndimeve serioze ose vdekjes, pasjen e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe efektiv që siguron përdorimin e mjeteve të nevojshme ligjore për të përcaktuar faktet, për të mbajtur përgjegjës ata që janë fajtorë, dhe për të ofruar zhdëmtim për viktimat.⁹ Sidoqoftë, detyrimi pozitiv, sipas Gjykatës, duhet interpretuar në atë mënyrë që nuk krijon një barrë të papërballueshme për autoritetet, marrë parasysh në veçanti paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operacionale që duhen bërë në kuptim të përparësive dhe burimeve.¹⁰

⁸ *Makaratzis kundër Greqisë* [DhM], nr. 50385/99, §§ 49-55, GjEDNj 2004-XI

⁹ *Ciechońska kundër Polonisë*, nr. 19776/04, § 67, 14 Qershor 2011

¹⁰ *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 27229/95, § 90, GjEDNj 2001-III, dhe *A. dhe të Tjerët kundër Turqisë*, nr. 30015/96, §§ 44-45, 27 Korrik 2004

Duke marrë parasysh parimet e mësipërme të njohura në praktikën e saj përkatëse gjyqësore, Gjykata fillon së pari me vlerësimin e rrethanave konkrete në të cilat R.D. kishte qëlluar ankuesin. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata vëren se R.D., në kohën përkatëse, ishte polic rezervë dhe për pasojë zyrtar shtetëror. Kjo ishte konfirmuar nga gjykatat civile të vendit. Në kohën kritike, R.D. ishte në detyrë në një stacion policie, ku ishte ngarkuar që të bënte roje në mesnatën e 5 janarit dhe në orën 06:00 të mëngjesit të 6 janarit, secila detyrë me nga një orë kohëzgjatje. Në orën 01:00 të mëngjesit të datës 6 janar 2002, pasi detyra e tij e rojës kishte përfunduar, dhe duke mos i informuar eprorët e tij, ai kishte lënë stacionin e policisë për të shkuar në një kafene. Ai ishte në uniformë dhe kishte armën e tij zyrtare. Në orën 03:50 të mëngjesit të asaj dite, ai kishte shtënë me armë dhe qëlluar ankuesin në kraharor. R.D. vepër për të cilën ishte dënuar, fillimisht në mungesë, me dy vite burgim për kryerjen nga pakujdesia të një krimi serioz kundër sigurisë. Në procedurë civile, ankuesi kishte kërkuar nga gjykatat vendore që të vërtetonin përgjegjësinë e shtetit për dëmet që kishte pësuar. Gjykatat e kishin hedhur poshtë këtë kërkesë, pasi shteti nuk kishte cilësitë e nevojshme për t'u paditur.

Gjykata ka rikujtuar se, në bazë të praktikës së saj gjyqësore, shteti është drejtpërdrejt përgjegjës për aktet e dhunës të kryera nga zyrtarët policorë në ushtrimin e detyrave të tyre. Rasti i tanishëm megjithatë është i ndryshëm, pasi ka të bëjë me veprim të dëmshëm të një zyrtari shtetëror, të ndërmarrë jashtë detyrave të tij. Për të përcaktuar nëse shteti mund të mbahet përgjegjës për veprimet e paligjshme të zyrtarëve të tij të ndërmarra jashtë detyrave të tyre zyrtare, Gjykata duhet të vlerësojë tërësinë e rrethanave dhe të shqyrtojë natyrën dhe rrethanat e sjelljes në fjalë. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se incidenti ka ndodhur gjatë orëve të punës së R.D. Nuk është në dyshim që R.D., në kohën përkatëse, pritej të ishte në detyrë në stacion të policisë. Ai kishte lëshuar vendin e tij të punës pa autorizimin e eprorëve të tij dhe në gjendje intoksikimi, ishte përfshirë në sjellje të rrezikshme, duke e vënë jetën e ankuesit në rrezik. Palët nuk e kanë kontestuar mospërputhshmërinë flagrante me rregullat e punës, të cilat kanë çuar në incidentin në fjalë. R.D. ishte në uniformë kur ka shtënë në ankuesin. Në këto rrethana, nuk është e paarsyeshme të thuhet se ai ishte perceptuar nga publiku si zyrtar i zbatimit të ligjit. Për më tepër, ai kishte qëlluar ankuesin, duke përdorur armën e tij zyrtare, e cila i ishte dhënë atij nga autoritetet.

Gjykata e pranon se autoritetet nuk kanë mundësinë që objektivisht të parashohin sjelljen e secilit zyrtar; sidoqoftë, nënvizon faktin se shteti duhet të krijojë dhe zbatojë në mënyrë të rreptë një sistem mbrojtjeje të përshtatshëm dhe efektiv, që ka si qëllim të parandalojë zyrtarët e vetë, sidomos rezervistët e mobilizuar përkohësisht, që të abuzojnë me armët zyrtare, të cilat u jepen atyre në kontekst të kryerjes së detyrave zyrtare. Qeveria nuk kishte paraqitur informacion të ekzistimit të ndonjë rregulloreje në fuqi në këtë aspekt.

Tutje, Gjykata rithekson se shtetet kërkohet që të përcaktojnë standarde të larta profesionale brenda sistemeve të tyre të zbatimit të ligjit dhe të sigurojnë se personat të cilët shërbejnë në këto sisteme i plotësojnë kriteret e kërkuara. Në veçanti, kur shteti pajisë forcat policore me armë zjarri, jo vetëm që duhet ofruar trajnim teknik, por zgjedhja e zyrtarëve që u lejohet bartja e këtyre armëve duhet gjithashtu t'i nënshtrohet një shqyrtimi të posaçëm. Në rastin konkret, Qeveria nuk ka ofruar informacion nëse

është bërë ndonjë vlerësim nga ana e autoriteteve shtetërore nëse R.D. ishte i përshtatshëm të rekrutohej dhe pajisej me armë, gjë e cila ka çuar në incidentin në fjalë. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se veprimi i dëmshëm që R.D. ka ndërmarrë në kafene duhet t'i atribuohet (mvishet) shtetit. Si rezultat i kësaj, Gjykata hedh poshtë kundërshtimin e Qeverisë për mos-shterje të mjeteve juridike dhe gjen se ka shkelje të Nenit 2 të Konventës në pjesën përmbajtësore të tij. Ndërkaq, në mungesë të një ankesë shprehimore nga ankuesi, Gjykata nuk ka nevojë të vlerësojë nëse shteti ka vepruar në përputhshmëri me detyrimin procedural sipas Nenit 2 të Konventës.

Ankuesi, gjithashtu pretendon shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës duke argumentuar se procedurat civile kanë qenë të tejzgjata në mënyrë të paarsyeshme. Gjykata ka vënë re se procedurat në fjala kanë filluar me 11 nëntor 2002 dhe kanë përfunduar me 31 maj 2006, kur Gjykata Supreme ka hedhur poshtë kërkesën e ankuesit. Pra, në tërësi, kanë zgjatur tri vite e gjashtë muaj dhe njëzet ditë në të trija nivelet. Gjykata ka vlerësuar se rasti nuk ka qenë kompleks dhe, dukë marrë parasysh materialin përpara saj, nuk vlerëson se ankuesi ka kontribuar në zgjatjen e procedurave. Sa u përket autoriteteve ndërkaq, Gjykata ka vlerësuar se përveç vonesës prej dy vitesh në procedurat para Gjykatës Supreme, që ka qenë disi e gjatë, nuk ka pasur vonesa të tjera që mund t'u atribuohen atyre. Marrë parasysh kriteret e përcaktuara në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata vlerëson se marrë në tërësinë e tyre, procedurat në rastin konkret ishin zhvilluar brenda një kohe të arsyeshme dhe ankesa e ankuesit në lidhje me zgjatjen e tyre është qartazi e papabuar dhe duhet refuzuar.

Lidhur me dëmet materiale bazuar në Nenin 41 të Konventës Gjykata ka vendosur që të miratojë shumën e kërkuar nga ankuesi në vlerë prej 3,390 EUR si shumë për dëmin e shkaktuar material, që ankuesi e ka pësuar si pasojë e drejtpërdrejtë e dëmtimit të tij nga R.D. dhe e shpenzimeve mjekësore të dëshmuara me anë të faturave. Më tutje, Gjykata pranon se ankuesi ka pësuar dëme jo-materiale, të cilat nuk mund të kompensohen vetëm me gjetje të shkeljes së Nenit 2 të Konventës. Duke e bërë përcaktimin e saj në baza të drejtshmërisë, Gjykata i kërkon shtetit që t'i paguajë ankuesit një shumë prej 12,000 EUR, përfshirë taksat që mund të zbatohen në këtë rast. Ankuesi nuk ka kërkuar mbulim të kostove dhe shpenzimeve gjyqësore, Prandaj, Gjykata nuk përcakton ndonjë shumë në këtë aspekt.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata e shpallë ankesën të pranueshme në lidhje me Nenin 2 të Konventës dhe pjesën tjetër të ankesës të papranueshme, dhe gjen se ka shkelje të Nenit 2 të Konventës [njëzëri].

Anderou kundër Turqisë - 45653/99

27 tetor 2009 [Seksioni i Katërt]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 2

Shkelje e të drejtës në jetë si pasojë e plagosjes së kërkueses nga autoritetet shtetërore / *ka shkelje*

Neni 3 dhe 8

Pretendim së forca e përdorur kishte rezultuar në torturë dhe shkelje të së drejtës në shtëpi / *e panevojshme për shqyrtim*

Fjalët kyçe: *zonë neutrale / plagosje / demonstrata / tejkalim i linjës neutrale / dhunë joproporcionale / trajtim çnjerëzor*

Ankuesja: Georgia Anderou, shtetase britanike 59 vjeçare. Pas vdekjes së saj rasti ishte vazhduar nga trashëgimtarë e ankueses

Faktet e rastit

Me 14 gusht 1999, ankuesja u plagos nga autoritetet turke në zonën neutrale në mes të Turqisë dhe Qipros Veriore. Ngjarja kishte ndodhur kur një grup i motoçiklistëve ishin nisur drejt zonës neutrale, në shenjë revolte kundër autoriteteve/qeverisë Turke, të cilat kishin vrarë një shtetas Qipriot - Anastasios Isaak, tri ditë më herët, gjatë një demonstrate të dhunshme. Pas funeralit të tij, një grup i indinjuar i Greko-Qipriotëve ishin nisur të paarmatosur drejt kufirit tek zona neutrale e monitoruar nga paqëruajtës te Kombeve te Bashkuara. Situata kishte eskaluar kur njëri nga demonstruesit, Solomos Solomou, kishte kaluar vijën kufitare, dhe kishte kaluar nga ana Turke, duke tentuar të largonte flamurin turk nga shtylla. Kur demonstruesi ishte tri metra lart i ngjitur në shtyllë, tre persona të autoriteteve turke, dy nga të cilët me uniformë turke, dhe një nga ta nga një ballkon i një pike monitoruese turke, kishin shtënë me armë zjarri në drejtim të tij, duke shkaktuar direkt vdekjen e të riut.

Menjëherë pas vrasjes se Z. Solomou, ankuesja, kishte parë ushtarë duke shtënë me armë zjarri nga zona e cila ishte nën kontroll të forcave të armatosura Turke. Si pasojë, një numër njerëzish ishin plagosur, duke përfshirë dy ushtarë Britanikë të Kombeve te Bashkuara ne Qipro (UNFICYP), dhe ankuesja, e cila ishte goditur nga një plumb në abdomen. Si pasojë e goditjes me plumb ajo ishte dërguar të operohej menjëherë dhe përveç largimit të njërës nga veshkat, ajo kishte pasur edhe komplikime të tjera të shumta shëndetësore. Ankuesja gjithashtu ishte diagnozuar me stres post-traumatik dhe depresion. Si pasojë e komplikimeve të shumta shëndetësore pas plagosjes, ankuesja kishte ndërruar jetë më 29 nëntor 2005. Trashëgimtarët e saj me pranimin e kërkesës nga Gjykata, morrën përsipër rastin në vend të së ndjerës.

Përmbledhje e pretendimeve

Qeveria turke deklaroi se për incidentin që i kishte ndodhur ankueses, mban përgjegjësin administratën greko-qipriote dhe Kishën Ortodokse Greke, me pretendimin se kishin inkurajuar demonstruesit të tejkalonin zonën neutrale nën administrim të Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu, Qeveria turke kishte deklaruar se ankuesja do të duhej të kishte marrë parasysh se prania në demonstrata të tilla të dhunshme vinte me një rrezik. Për më tepër, ata shtuan se autoritetet turke kanë qenë totalisht të justifikuar për veprimet e marra, duke marrë parasysh Nenin 2 të Konventës, i cili lejon gjitha masat mbrojtëse të ndërmerren për qëllim të evitimit të rrezikut apo për mbrojtje të jetës së tjerëve.

Në anën tjetër, ankuesja deklaroi se versioni i fakteve nga ana e Qeverisë turke nuk ishte i saktë. Ajo tha se nuk mund të argumentohej se një demonstratë e dhunshme kishte ndodhur atë ditë, dhe se nuk kishte faktorë të besueshëm se ndonjë masë mbrojtëse do të duhej të ndërmerrej për mbrojtjen e jetës së ndonjë personi. Ajo shtoi se para të shtënave UNFICYP kishte kontaktuar forcat e armatosura turke dhe kishte kërkuar nga ata “të përmbaheshin dhe të mos reagonin në mënyrë joproporcionale me situatën”. Pasi që ankuesja ishte vetëm duke e shikuar demonstratën jashtë zonës neutrale, ajo ishte shembulli tipik i një “soditësi të pafajshëm”. Tutje sipas ankueses, gjuajtja me armë zjarri kishte qenë totalisht e pajustificueshme, e panevojshme dhe aq disproporcionale me situatën, saqë as demonstruesit e as ankuesja nuk kishin mundur ta parashikonin. Andaj, ankuesja pretendonte se jeta e saj ishte rrezikuar në kundërshtim me Nenin 2 të Konventës, dhe se përdorimi i tepruar i forcës ndaj saj, respektivisht plagosja, përbënte trajtim çnjerëzor dhe degradues dhe kishte pasur pasoja të rënda shëndetësore në shkelje të Nenit 3 dhe 8 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata në këtë rast duhet të vendosë nëse forca e përdorur kundër ankueses ishte potencialisht vdekjeprurëse dhe çfarë sjellje kishin zyrtarët turk jo vetëm në lidhje me integritetin fizik të ankueses, por edhe për të drejtën e saj për jetë.

Gjykata nuk kishte asnjë arsye për të dyshuar për pavarësinë dhe besueshmërinë e UNFICYP dhe Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së; për më tepër, përshtkrimi i tyre i ngjarjeve të 14 gushtit 1996 ishte bazuar në deklaratat e dëshmitarëve okularë. Sidocoftë Gjykata vëren se gjuajtja me armë pa dallim dhe në mënyrë të pajustificuar mbi turmën që po grumbullohej brenda dhe jashtë zonës së amortizatorëve, kishte vënë në rrezik jetë të shumta. Fakti që ankuesja nuk ishte vrarë në vendngjarje ishte i rastësishëm, dhe se serioziteti i lëndimeve të saj, të vërtetuara nga raportet mjekësore, nuk ishte kontestuar nga palët. Prandaj, Gjykata konsideroi se, pavarësisht nëse ushtarët kishin pasur për qëllim të vrisnin znj. Andreou, ajo kishte qenë viktimë e sjelljes që për nga vetë natyra e kishte rrezikuar jetën e saj, megjithëse ajo kishte mbijetuar. Prandaj, Neni 2 ishte i aplikueshëm në rastin e ankueses.

Gjykata ishte e mendimit se qitja mbi turmë më 14 gusht 1996 kishte përbërë një përdorim jo proporcional të forcës në rrethanat e asokohe dhe nuk mund të justifikohej nga argumenti, siç sugjerohet nga Qeveria, se ishte e nevojshme që të shuhej "trazira apo kryengritja". Megjithëse demonstruesit, të cilët kishin shkopinj dhe shufra hekuri, kishin hedhur gurë në forcat turke, një qitje e tillë mund dhe shkaktonte lëndime serioze tek demonstruesit, përcjellësit dhe anëtarët e forcave të OKB-së. Në të vërtetë,

sipas dëshmitarëve okularë, hapja e zjarrit ishte krejtësisht e pajustificuar dhe as e paraprirë nga një goditje paralajmëruese. Andaj Gjykata vën në pah se një veprim i tillë ishte më shumë një masë parandaluese, e ndërmarrë për të dekurajuar dhunën e mëtejshme përpara se turma të kishte kohë për të reaguar ndaj goditjes së z. Solomou. Tutje Gjykata konsideron se përdorimi i tepruar i forcës ndaj ankueses, nuk ishte pasojë e domosdoshmërisë së shtetit për ta shuar këtë demonstratë; e as nuk ishte kundërpërgjigje ndaj sjelljes personale të saj. Ajo nuk ishte e armatosur, as nuk ishte sjellur në mënyrë të dhunshme, apo rezistuar policisë, e as nuk paraqiste kërcënim për rendin publik. Për më tepër, ajo nuk e kishte shkelur as linjën e armëpushimit, sjellje kjo që e bënte "absolutisht të domosdoshëm" kryerjen e " një arrestimi të ligjshëm"; ajo ishte goditur nga plumbi ndërkohë që qëndronte jashtë zonës së OKB-së.

Së fundi, Gjykata vëren se Turqia kishte dështuar të tregonte nëse forcave të saj të sigurisë i ishin dhënë udhëzime të qarta dhe trajnime të përshtatshme për të shmangur përdorimin arbitrar dhe / ose abuziv të forcës potencialisht vdekjeprurëse. Sipas Gjykatës, në Nenin 2 të Konventës, përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga zyrtarët policor është i justifikueshëm në disa raste, mirëpo ai nuk garanton një *carte blanche* apo fuqi absolute. Në këtë rast, përdorimi i forcës potencialisht vdekjeprurëse ndaj ankueses nuk ishte "absolutisht i nevojshëm" dhe nuk ishte i justifikuar nga asnjë nga përjashtimet e lejuara në Nenin 2. Prandaj, Gjykata gjeti se kishte pasur shkelje të atij Neni. Duke pasur parasysh këtë përfundim, Gjykata më tej e konstaton nuk ishte e nevojshme të shqyrtonte ankesat e ankueses sipas Neneve 3 dhe 8 të Konventës.

Bazuar në Nenin 41 të Konventës, Gjykata vendosi se shteti turk do t'u paguajë trashëgimtarëve e ankueses brenda tre muajsh nga gjykimi final shumat në vazhdim: 585.68 EUR (pesëqind e tetëdhjetë e pesë EUR e gjashtëdhjetë e tetë cent) për dëme materiale, 40,000.00 EUR (katërdhjetëmijë EUR), plus çdo taksë për dëme jomateriale, si dhe 10,000.00 EUR (dhjetëmijë EUR), plus çdo taksë që mund t'i vendoset trashëgimtarëve të ankueses për shpenzime. Këto pagesa duhet të bëhen ne Bankën Qëndrore EURpiane pas tre muajsh nga vendimi final.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 2 të Konventës, ndërsa konsideron si të panevojshme për shqyrtim pretendimet për shkele të Neneve 3 dhe 8 të Konventës [njëzëri].

Putinseva kundër Rusisë - 33498/04

10 maj 2012 [Seksioni i Parë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 2 (a)

Shkelje e të drejtës në jetë si pasojë e përdorimit të forcës përtej kornizave të forcës absolutisht të domosdoshme dhe dështimit të marrjes së masave për parandalimin e situatës / *ka shkelje*

Neni 2 (b)

Dështim i autoriteteve shtetërore për të kryer hetime efektive / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: *vrasje / përdorim i paarsyeshëm i forcës / dështim në parandalim / ushtri / arratisje / masa jo-adekuate / hetim efektiv*

Ankuesja: znj. Svetlana Putintseva, shtetase ruse e lindur në vitin 1964 dhe jeton në qytetin Beloyarskiy në rajonin Tyumen (Rusi)

Faktet e rastit

Gjatë kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak, djali i ankuses, Valeriy Putintsev, u largua nga njësia ushtarake pa leje në shkurt të vitit 2002. Ai u arrestua tri ditë më vonë dhe u vendos në një qeli disiplinore si dënim për mungesë pa leje. Gjatë ndalimit të tij z. Putintsev goditi rreshterin me gradë më të ulët L. në kokë kur ky i fundit po përpiquej ta kontrollonte atë. Pas incidentit, u urdhërua një ekzaminim mjekësor i rreshterit L. dhe z. Putintsev. Ndërsa shoqëronte z. Putintsev nga spitali ushtarak në njësinë e paraburgimit më 15 Shkurt 2002, rreshteri L., në një përpjekje për ta parandaluar z. Putintsev që të ikte, shtiu në të dhe e plagosi. Më 27 shkurt 2002, z. Putintsev vdiq nga gjakderdhja e shkaktuar nga plaga e marrë nga arma e zjarrit.

Në ditën e incidentit komandanti i garnizonit urdhëroi hapjen e hetimit penal për rastin, i cili ishte raportuar menjëherë në prokurorinë ushtarake. Në veçanti, hetuesi inspektoi skenën, dhe morri si dëshmi rrobat e z. Putintsev, armën dhe municionin e rreshterit, duke përfshirë dy fishekë të përdorur, të mbledhur nga një oficer dhe një fishek të përdorur në terrenin e spitalit, dhe organizoi një kërkim për plumbin me të cilin u qëllua z. Putintsev. Rreshteri L. u mor në pyetje brenda disa orësh nga incidenti. Një raport i hartuar nga psikologu i njësisë, i urdhëruar nga hetuesi për të mësuar në lidhje me arsyet prapa daljes së paautorizuar të z. Putintsev, dhe dosja e hetimit të brendshëm të garnizonit për daljen e tij te paautorizuar, treguan se z. Putintsev kishte deklaruar se ndihej i vetmuar dhe i dëshpëruar në ushtri dhe se jepte shenja se ishte ngacmuar nga eprorët e tij. Megjithatë, deklaratat e dëshmitarëve nuk e konfirmuan këtë të fundit. Pas vdekjes së z. Putintsev, ishte kryer një ekzaminim mjeko-ligjor (post mortum), ku si shkaktare e vdekjes u identifikua një plagë shpuese.

Në prill të vitit 2002, procedurat penale u mbyllën dhe hetuesi arriti në përfundimin se nuk kishte pasur sjellje kriminale nga ana e rreshterit L., pasi ai kishte ndjekur rregullat që rregullojnë përdorimin e armëve të zjarrit për të parandaluar ikjen e një të arrestuari.

Procedurat u rihapën dhe u mbyllën më pas në tri situata, pasi që janë nderrmarrë hetime shtesë, duke përfshirë vlerësimin e cilësisë së ekspertizes mjekësore të dhënë për Z. Putintsev në spital pas vrasjes, e cila u gjet të jetë teknikisht korrekte dhe me kohë. Tutje vendimi i prokurorit ushtarak të 7 majit 2003, zbuloi se përdorimi i armëve të zjarrit kundër djalit të ankueses kishte qenë i ligjshëm.

Për më shumë Gjykata Ushtrake e Komandës së tretë vuri në dukje se djali i ankueses kishte qenë i vetëdijshëm se ishte i arrestuar dhe kishte kuptuar pasojat e përpjekjes së tij për të ikur, duke përfshirë përdorimin e mundshëm të armëve të zjarrit, dhe se rreshter L., nuk kishte zgjidhje tjetër veçse të ndiqte rregullat mbi përdorimin e armëve të zjarrit të parashikuara nga Statuti i Shërbimit të Garnizonit dhe shërbimit të armëve. Kërkesa e ankueses për t'u dhënë statusin e viktimës ishte refuzuar. Vendimi i fundit i prokurorit për mbylljen e hetimeve penale u mbështet nga Gjykata Ushtrake e Komandës me vendimin e datës 3 në mars 2004.

Përmbledhje e pretendimeve

Duke u mbështetur në Nenin 2 të Konventës, ankuesja pretendon se djali i saj ishte vrarë si pasojë e përdorimit të panevojshëm të armëve të zjarrit nga një agjent i shtetit dhe se autoritetet nuk kishin arritur të ndërmarrin një hetim efektiv për vdekjen e djalit të saj. Ankuesja argumentoi se nuk ishte absolutisht e nevojshme që rreshteri L., të vriste djalin e saj, një person që nuk kishte paraqitur ndonjë rrezik dhe nuk kishte kryer ndonjë veprë penale dhe se hetimi për vrasjen nuk ishte kryer si duhej. Ajo vuri në dukje katër defekte në hetim: dështimi për të atribuar peshë të veçantë për faktin se vetëm një fishek i përdorur ishte gjetur në vendin e ngjarjes, ndërsa dy fishekë ishin prodhuar nga rreshteri L., vetë; se hetuesit nuk e kishin qartësuar çështjen e ndalimit të djalit të saj në njësinë disiplinore; se ata nuk e kishin identifikuar shkakun e lëndimeve në trupin e djalit të saj; dhe se ata nuk kishin urdhëruar një raport të ekspertëve për vërtetësinë e nënshkrimit të djalit të saj në një deklaratë me shkrim duke shpjeguar arsyet për pushimin e tij të paautorizuar. Ankuesja më tej pohoi se asaj nuk i ishte dhënë statusi i viktimës në procedurën penale, duke u mohuar kështu një mundësi efektive për të sfiduar sjelljen e hetuesit.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata përsëriti qëndrimin e përbashkët të palëve se vdekja e djalit të ankueses, rezultoi nga përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga rreshteri L. Si rezultat Gjykata së pari vlerëson përshtatshmërinë e hetimit për vdekjen e djalit të ankueses e pastaj vlerësimin e rrethanave në lidhje me përdorimin e forcës. Gjykata vëren se sa i përket aspektit substancial të Nenit 2 nënparagrafi (a) rezultatet e autoriteteve vendase nuk kishin përfshirë vlerësimin e kornizës ligjore që përcaktonte rrethanat për përdorimin e forcës kundër një ushtari që po ikte. Konstatimi nëse faktet zbuluan një shkelje të Nenit 2 ishte një pyetje e dallueshme nga vlerësimi nëse kishte ndonjë përgjegjësi penale nga ana e rreshterit L.. Gjykata konsideron se standardi i aplikuar nga autoritetet vendase ishte nëse përdorimi i forcës vdekjeprurëse ishte legjitim, në krahasim me atë se a ishte "absolutisht e domosdoshme", standard ky i aplikueshëm sipas Nenit 2 § 2 të Konventës. Tutje Gjykata vëren se sipas ligjit përkatës vendas, ishte e ligjshme për autoritetet përkatëse që të qëllonin ndonjë të arratisur, dhe se një kornizë e tillë ligjore

ishite krejtësisht e mangët dhe nuk përfshinte nivelin e mbrojtjes "me ligj" të së drejtës për jetën, pasi nuk kishte hapësirë për kërkesën e proporcionalitetit dhe nuk përmbante ndonjë mbrojtje tjetër për të parandaluar privimin arbitrar të jetës. Prandaj, Gjykata gjen se kishte një dështim të përgjithshëm nga shteti përgjegjës për të përmbushur detyrimin e vet sipas Nenit 2 të Konventës për të siguruar të drejtën për jetë duke vendosur një kornizë ligjore dhe administrative të përshtatshme për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga ana e forcave ushtarake kundër ushtarëve që iknin.

Përsa i përket përdorimit aktual të forcës dhe sjelljes së autoriteteve para incidentit, Gjykata vëren se djali i ankueses nuk ishte i armatosur dhe nuk paraqiste rrezik për ata që e shoqëronin atë apo palët e treta. Në këto rrethana, çdo lloj përdorimi i forcës potencialisht vdekjeprurës ishte i ndaluar bazuar në Neni 2 të Konventës, pavarësisht nga ndonjë rrezik i mundshëm. Për më tepër, ishte evidente se ka pasur mjete të tjera në dispozicion për të parandaluar ikjen e tij. Sipas Gjykatës, sjellja e tij ishte dukshëm e parashikueshme, pasi ai ishte gjetur lehtësisht në një incident të mëparshëm dhe zyrtarët e tij komandues ishin të vetëdijshëm se po përjetonte probleme psikologjike në përshtatjen me jetën në ushtri dhe për këtë përpiquej të arratisej. Megjithatë nuk kishte asnjë tregues se rreshteri L. që e kishte qëlluar kishte marrë udhëzime të qarta rreth sasisë së forcës që ishte e nevojshme në rrethana të tilla ose ishte pajisur me udhëzime për të minimizuar rrezikun e humbjes së jetës. Gjykata e konsideron shqetësuese faktin se i njëjti rreshter me të cilin djali i ankueses kishte pasur një grindje fizike më parë ishte ngarkuar me detyrën e shoqërimit të tij. Shoqërimi ishte organizuar në mënyrë të pakonsideruar dhe vendimi të komandantit për t'ia besuar rreshterit detyrën e shoqërimit të tij kishte nuk ishte bërë në përputhje me shkallën e duhur të kujdesit. Si pasojë Gjykata gjen se autoritetet nuk arritën të minimizojnë në masën më të madhe mundësinë e përdorimit të forcës vdekjeprurës dhe çdo rrezik për jetën e djalit të ankueses. Në të shumtën e rasteve, korniza ligjor përkatëse për përdorimin e forcës kishte qenë në thelb e mangët dhe djali i ankueses ishte vrarë në rrethana në të cilat përdorimi i armëve të zjarrit për të parandaluar ikjen e tij nuk ishte në papajtueshmëri me Nenin 2 të Konventës. Bazuar në të gjitha këto Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 2 (a) të Konventës.

Sa i përket aspektit procedural të Neni 2(b) Gjykata vëren se hetimi ishte i pavarur dhe u krye me një shpejtësi të mjaftueshme. Gjykata vuri në dukje se hetimet penale për vdekjen e z. Putintsev kishin qenë të kryera nga njerëz të pavarur nga personeli i garnizonit, si dhe prokuroria e ushtrisë e cila nuk ishte e lidhur me garnizonin apo njësinë ushtarake të viktimës. Hetimet ishin hapur menjëherë pas vrasjes dhe hetimet kryesore ishin marrë të njëjtën ditë ose pak kohë pas. Pas mbylljes dhe rihapjes së hetimit, hetuesit kishin ndjekur udhëzimet nga prokurori i rangut më të lartë dhe kishte kryer një numër të ekzaminimeve shtesë. Autoritetet hetuese nuk kishin dështuar të kërkonin dëshmi shtese. Për më shumë edhe pse ankueses nuk i ishte dhënë statusi i viktimës, Gjykata vuri në dukje se ajo ishte intervistuar disa herë dhe gjatë hetimeve ajo në mënyrë aktive ishte ankuar për shkeljet/defektet e pretenduara. Në këto rrethana, vendimi për të mos dhënë statusin e viktimës nuk e minimizoi efektivitetin e hetimit. Prandaj, Gjykata konstaton se autoritetet kishin ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar provat lidhur me incidentin dhe të përcaktojnë rrethanat në të cilën ajo kishte ndodhur. Hetimi ishte i pavarur dhe kishte qenë i kryer me shpejtësi të mjaftueshme. Si

pasojë, Gjykata gjen se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 2 (b) sa i përket detyrimit të autoriteti shtetëror për të kryer një hetim efektiv.

Bazuar në Nenin 41 të Konventës, Gjykata vendosi që Rusia t'i paguajë ankueses vlerën prej 45,000 EUR në lidhje me dëmin jo-material.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 2 të Konventës për sa i përket aspekteve substanciale, ndërsa nuk ka shkelje të Nenit 2 të Konventës bazuar në kërkesat procedurale [*njëzëri*].

Gorovenky dhe Bugara kundër Ukrainës - 36146/05; 42418/05

12 janar 2012 [Seksioni i Pestë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 2

Shkelje e të drejtës në jetë si pasojë e goditjes me armë nga një zyrtar policie në drejtim të dy personave, duke përdorur armën e tij zyrtare, që i ishte dhënë në kundërshtim me rregulloret e brendshme / *ka shkelje*

Neni 13

Dështim në përmbushjen e detyrimit të shtetit për zhdëmtim / *e panevojshme për shqyrtim ndaras*

Fjalët kyçe: *goditje me armë / vrasje / polic / organ shtetëror / mospërgjegjësi shtetërore / mospërmbushje e obligimeve / veprime të kundërligjshme*

Ankuesit: pesë shtetasit ukrainasë, z. Leonid Oleksandrovych Gorovenko (i ati i A. Gorovenko), znj. Nadiya Vitaliyivna Gorovenko (e ëma e A. Gorovenko), znj. Tetyana Oleksandrivna Bugara, z. Oleksandr Volodymyrovych Bugara dhe znjsh. Viktoriya Volodymyrivna Bugara (bashkëshortja dhe fëmijët e V. Bugara), parashtruan dy ankesa të ndara (numër 36146/05 dhe 42418/05) kundër shtetit të Ukrainës. Marrë parasysh sfondin e përbashkët faktik dhe ligjor, në pajtim me rregullin 42(1) të Rregullave të Gjykatës, kjo e fundit kishte vendosur që të bashkonte ankesat.

Faktet e rastit

Të afërmit e ankuesve ishin qëlluar nga D., një zyrtar policor i cili nuk ishte në detyrë. Ngjarja kishte ndodhur me 22 nëntor 1999, pak pas mesnatës. D., në atë kohë zëvendës/shëf i departmentit për hetime kriminale në zyrën policore të qarkut Pyatykhatky, ishte duke u kthyer nga një udhëtim privat me një veturë që vozitej nga i njohur i tij, z. V. Bugara. Ankuesi i tretë ishte, gjithashtu, në veturë. Pas një zënke me z. V. Bugara, D., i cili ishte i dehur, kishte shtënë dhe e kishte lënë atë të vranë, duke përdorur armën e tij policore, të cilën ai e bartte me vete gjatë gjithë kohës. Më pas, D. ka provuar të qëllojë edhe ankuesin e tretë, por duke mos pasur sukses. Ankuesi i tretë kishte mundur të ikte.

Pas ndodhisë së përshkruar më sipër, D. kishte bërë përpjekje që të ndalonte veturat që kalonin. Z. A. Gorovenko, që kishte rastisë të voziste në atë kohë, ishte ndalur dhe kishte biseduar me D., i cili kishte pretenduar se i është prishur makina dhe ka nevojë për ndihmë. Sidoqoftë, z. A. Gorovenko ishte bërë dyshues se diçka nuk kishte shkuar në rregull dhe kishte bërë përpjekje të largohej. D. kishte qëlluar z. A. Gorovenkon dhe ishte përpjekur që të qëllonte edhe R., që po udhëtonte bashkë me z. A. Gorovenko, dhe e cila kishte pësuar lëndime serioze. Brenda një kohë të shkurtër, D. ishte kapur nga kalimtarët dhe dërguar në stacion policor.

Jo shumë kohë pas incidentit, policia kishte nisur një hetim të brendshëm. Raporti i cili ishte nënshkruar me 23 nëntor 1999, kishte vënë në pah një numër “shkaqesh dhe

parakushtesh” të cilat kishin rrjedhë nga rregullativa e dobët e qarkut Pyatykhatky dhe zyrat policore rajonale të Dnipropetrovsk. Raporti theksonte, përveç tjerash, se eprorët e lartë kishin dështuar të vlerësonin në mënyrë të duhur karakterin e D., kur e kishin rekrutuar dhe më vonë edhe promovuar atë. Në veçanti, Raporti u referohej disa incidenteve që dëshmonin papërshtatshmërinë e D. për shërbim në departamentin policor të sipërtheksuar. Gjatë studimeve në kolegjin e policisë, D. ishte shkarkuar nga pozita e komandantit të seksionit për shkak të abuzimit me alkokool. Në vitin 1994, ai i kishte shkaktuar lëndime trupore një personi me inicialin Sh., dhe ishte sanksionuar në tri raste të ndryshme për shkelje disiplinore. Raporti theksonte tutje se eprorët policorë kishin dështuar të zbatonin dhe ruanin disiplinën ndaj vartësve të tyre.

Me 22 nëntor 1999, zyra e prokurorit lokal kishte paraqitur kallëzimin penal kundër D. Në proces të zhvillimit të rastit gjyqësor, ankuesit kishin ngritur padi civile kundër D.-së dhe njëkohësisht Zyrës Rajonale Policore të Dnipropetrovsk dhe kishin kërkuar dëmshpërblim për dëmin material dhe jo-material.

Me një aktgjykim të datës 14 nëntor 2000, Gjykata Rajonale e Dnipropetrovsk e kishte shpallur D. fajtor për vrasje të shumëfishta, përveç veprave të tjera, dhe e kishte dënuar me burgim të përjetshëm. Gjykata gjithashtu kishte urdhëruar dëmshpërblim monetar për të dy familjet e ankuesve, shumë kjo që do të paguhej nga D. Gjykata tutje kishte vendosur që padia e ankuesve kundër Zyrës Rajonale Policore të Dnipropetrovsk të shqyrtohej në procedurë të ndarë civile.

Në shkurt të vitit 2003, ankuesit kishin ngritur padi kundër Zyrës Rajonale Policore të Dnipropetrovsk dhe departamentit lokal të Thesarit Shtetëror të Ukrainës në Gjykatën e Qarkut të Dnipropetrovsk, duke kërkuar dëmshpërblim për dëm jo-material. Në mbështetje të pretendimeve të tyre, ata u ishin referuar gjetjeve të aktgjykimit, një vendimi të posaçëm të datës 14 nëntor 2000 dhe Raportit të 23 nëntorit 1999, që kishte rezultuar nga hetimi i brendshëm. Me 5 mars 2003, Gjykata kishte hedhur poshtë padinë e ankuesve. Përfundimisht më 10 korrik 2003 dhe 4 prill 2005, Gjykata Rajonale e Apelit për rajonin e Dnipropetrovsk dhe Gjykata Supreme e Ukrainës, respektivisht, kishin hedhur poshtë apelimet e bëra nga ankuesit.

Përmbledhje e pretendimeve

Si fillim, Qeveria e Ukrainës nuk ka paraqitur pikëpamjet e saj në lidhje me pranueshmërinë e ankesës. Gjykata vëren se ankesa nuk është qartazi e pabazuar brenda kuptimit të Nenit 35(3) të Konventës. Tutje, vëren se nuk është e paparanueshme mbi bazë të çfarëdo arsyeje tjetër. Kësisoj, ankesa është shpallur e pranueshme.

Ankuesit pretendojnë shkelje të Nenit 2 të Konventës, me arsyetimin se duke dështuar të mbikëyrë mbajtjen dhe përdorimin e armëve të zjarrit nga zyrtari policor D., shteti nuk ka përmbushur detyrimet pozitive që përcaktohen në këtë nen. Ankuesit u janë referuar incidenteve të shumta qoftë nga një e kaluar e largët apo e afërt kur zyrtari policor D. ka abuzuar me alkokool dhe është sjellë në mënyrë të dhunshme. Pavarësisht kësaj, ai është lejuar të mbajë armë ditën dhe natën. Dështimi i eprorëve të tij për të mbikëqyrur përputhshmërinë me rregullat për përdorim të armëve të zjarrit nga vartësitë e tyre janë pranuar shprehimisht në hetimin e brendshëm policor dhe në vendimet e gjykatës të datës 14 nëntor 2000. Përkundër kësaj, ankuesit kanë pretenduar

se këto përfundime janë injoruar nga gjykatat kombëtare në procedurat civile për dëmshpërblim, duke shkelur në këtë mënyrë Nenin 2 të Konventës.

Nga ana e saj, Qeveria ka mbajtur qëndrimin se shteti ka vepruar në përputhje me detyrimet procedurale të Nenit 2 të Konventës, duke kryer hetim efektiv dhe dënuar D. për veprimet e tij. Qeveria më tej thekson se autoritetet shtetërore nuk kanë qenë në dijeni të një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e familjarëve të ankuesve. Për më tepër, D. nuk ka qenë duke vepruar në kapacitetin e tij zyrtar.

Ankuesit, gjithashtu, kanë ngritur pretendime se shteti i paditur ka refuzuar të marrë përgjegjësinë për vdekjen e A. Gorovenko dhe V. Bugara të shkakuar nga përfaqësuesi i tyre (zyrtari policor D.) dhe, si rezultat, të zhdukej ata për dëmin e shkakuar, ashtu siç parashihet në Nenin 13 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata fillimisht thekson faktet vendimtare të rastit, duke rikujtuar se familjarët e ankuesve janë qëlluar me armë nga një zyrtar policor, D., i cili në kohën përkatëse nuk ka qenë në detyrë, se incidenti ka ndodhur gjatë një udhëtimi privat dhe që nuk ka përfshirë ndonjë operacion të planifikuar policor ose ndjekje të rastit. Në këtë mënyrë, veprimet private të D.-së të karakterit serioz penal, në parim, nuk angazhojnë përgjegjësinë e shtetit sa i përket anës përmbajtësore të Nenit 2 të Konventës vetëm për faktin se ai ka qëlluar të jetë përfaqësues i shtetit.

Megjithatë, Gjykata ka ripërsëritur se Neni 2 e detyron shtetin jo vetëm të përmbahet nga marrja e qëllimshme dhe e jashtëligjshme e jetës, por edhe që të ndërmarrë hapa të përshtatshëm për të garantuar jetën e të gjithë personave në juridiksionin e vet. Ky detyrim mund të zbatohet në situatat që lidhen me kërkesën për mbrojtje personale të një apo më shumë individëve të identifikuar që më parë si caqe të mundshme të sulmeve vdekjeprurëse dhe në rastet që ngrisin detyrimin për të ofruar mbrojtje të përgjithshme për shoqërinë. Në rastin e fundit, ky detyrim pozitiv përfshinë një gamë të gjerë sektorësh dhe, në parim, rrjedhë në kontekstin e çfarëdo aktiviteti, qoftë ai publik ose jo, në të cilin rast e drejta në jetë mund të vihet në pyetje.

Sidoqoftë, detyrimi pozitiv duhet interpretuar në një mënyrë që nuk krijon një barrë të papërballueshme për autoritetet, marrë parasysh në veçanti paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operationale që duhen bërë në kuptim të përparësive dhe burimeve. Në veçanti, zgjedhja e mjeteve për të siguruar zbatimin e detyrimeve pozitive sipas Nenit 2 në parim bie brenda hapësirës [marginës] së vlerësimit të shtetit. Gjykata ka rikujtuar se, në bazë të praktikës së saj gjyqësore, detyrimi i shtetit për të mbrojtur të drejtën në jetë duhet të përfshijë ndërmarrjen e masave të arsyeshme për të garantuar sigurinë e individëve dhe, në rastet e lëndimeve serioze ose vdekjes, pasjen e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe efektiv që siguron përdorimin e mjeteve të nevojshme ligjore për të përcaktuar faktet, për të mbajtur përgjegjës ata që janë fajtorë, dhe për të ofruar zhdëmtim për viktimat. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se, ndonëse fajësia e D. në vrasjen e dy personave nuk mund të mohohet, në një numër rastesh është pranuar nga autoritetet kombëtare se eprorët e zyrtarit policor D. kanë dështuar që të vlerësojnë në mënyrë të duhur personalitetin e tij dhe, pavarësisht incidenteve shqetësuese që kanë përfshirë D.-në në të kaluarën, e kanë lejuar atë të mbajë armën, e cila ka çuar te incidenti në fjalë. Për më tepër, ligji përkatës kombëtar shprehimisht

ndalon dhënien e armëve zyrtarëve policorë të cilët nuk posedojnë pajisjet e duhura për ruajtjen e tyre të sigurtë. Dhe siç është pranuar nga hetimi i brendshëm, D. nuk është kontrolluar asnjëherë nëse ai e ka ruajtur armën e tij në shtëpi. Në veçanti, mungesa e një vendi për ruajtje të sigurtë mund të jetë arsyeja që D. ka mbajtur armën me vete gjatë gjithë kohës, qoftë në ose jashtë detyrës. Sidoqoftë, Gjykata vëren se në procedurat civile për dëmshpërblim, gjykata vendore nuk ka marrë parasysh gjetjet e mësipërme, duke vlerësuar se nuk ka lidhje kauzale ndërmjet dështimit të zyrtarëve policorë për t'u sjellë në pajtim me ligjin dhe vlerësuar në mënyrë të drejtë rastin kur t'u lejohet vartësve të tyre bartja e armës, në një anë, dhe incidentit vdekjeprurës që përfshinë këtë vartës, në anën tjetër. Për autoritetet shtetërore, fakti që D. nuk ishte në detyrë zyrtare në momentin e shtënies me armë ishte e mjaftueshme për të përjashtuar çfarëdo përgjegjësie të mundshme të eprorëve të tij, pavarësisht përfundimeve qartë të kundërta në hetimin e brendshëm dhe materialet e lidhura me rastin penal.

Gjykata rithekson se shtetet kërkohet që të përcaktojnë standarde të larta profesionale brenda sistemeve të tyre të zbatimit të ligjit dhe të sigurojnë se personat të cilët shërbejnë në këto sisteme i plotësojnë kriteret e kërkuara. Në veçanti, kur shteti pajisë forcat policore me armë zjarri, jo vetëm që duhet ofruar trajnim teknik, por zgjedhja e zyrtarëve që u lejohet bartja e këtyre armëve duhet gjithashtu t'i nënshtrohet një shqyrtimi të posaçëm. Në rastin konkret, rrjedhë se zyrtarit policor, i cili kishte qëlluar me qëllim dy persona me armën e tij policore, i ishte dhënë arma në kundërshtim me rregulloret ekzistuese, pasi nuk ishte kontrolluar se ku ai e mbante armën kur nuk ishte në detyrë zyrtare; dhe se, gjithashtu, personaliteti i tij nuk ishte vlerësuar në mënyrë të drejtë marrë parasysh historinë e mëparshme të shkeljeve disiplinore. Në këto rrethana të veçanta, Gjykata vjen në përfundimin se, në rastin konkret, ka shkelje të detyrimeve të shtetit sipas Nenit 2 të Konventës.

Bazuar në Nenin 13 ankuesit pretendojnë se shteti ka dështuar të përmbush detyrimin e vet për zhdëmtim sipas Nenit 13 për faktin se nuk ka marrë përgjegjësinë për vdekjen e dy të afërmeve të tyre. Gjykata vlerëson se kjo ankesë ka të njëjtin sfond faktik sikurse çështjet e shqyrtuara në bazë të Nenit 2 të Konventës andaj nuk është e nevojshme për shqyrtim ndaras.

Sa i përket dëmshpërblimit, Gjykata vendos që, mbi baza të drejtshmërisë, t'u ofrojë individualisht ankuesit të parë, të tretë, të katërt dhe të pestë nga dymbëdhjetë mijë (12.000) EUR në lidhje me dëmin jo-material. Ndërkaq, sa u përket kostove dhe shpenzimeve, duke u mbështetur në dokumentet në posedim, Gjykata e ka vlerësuar të arsyeshme që t'u njohë shumat prej 150 EUR (ankuesit të parë) dhe 2,099 EUR (ankuesit të tretë) për të mbuluar kostot e procedurave para Gjykatës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata e shpallë ankesën të pranueshme në lidhje me Nenin 2 dhe 13 të Konventës dhe pjesën tjetër të ankesës të papranueshme, dhe gjen se ka shkelje të Nenit 2 të Konventës dhe konstaton si të panevojshme për shqyrtim ankesën sipas Nenit 13 të Konventës [njëzëri].

Andreas Manitaras dhe të tjerët kundër Turqisë - 54591/00

3 qershor 2008 [Seksioni i Katërt]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 2

Shkelje e te drejtës në jete si pasojë e vrasjes së pretenduar të Ioannis Manitaras / e pabazuar

Neni 3

Pretendim se vrasja dhe trajtimin pasues i trupit të viktimës dhe familjes së tij përbënin trajtim çnjerëzor ose degradues / e pabazuar

Neni 8, 13 dhe 14

Shkelje të së drejtës për respektimin e jetës së tyre familjare, mungesë e hetimeve të duhura për vdekjen e pretenduar dhe diskriminim për shkak të origjinës greko-qipriote / e pabazuar

Fjalët kyçe: vrasje e pretenduar / vdekje natyrore / hetim adekuat / degradim /trajtim çnjerëzor / e drejta në shtëpi dhe familje / diskriminim etnik / mjete efektive

Ankuesit: z. Andreas Manitaras, (ankuesi i parë); z. Elias Elia (ankuesi i dytë); z. Panayiotis Elia (ankuesi i tretë); Znj. Anna Manitaras (ankuesja e katërt); Zonja Evangelia Manitaras (ankuesja e pestë); z. John Manitaras (ankuesi i gjashtë), gjashtë shtetas qipriotë me origjinë greko-qipriote. Ankuesit paraqitën ankesën në emër të tyre dhe në emër të Ioannis Manitaras, një shtetas qipriot me origjinë greko-qipriote, i lindur në 1914 dhe kishte vdekur më 4 prill 1999. Ankuesi i parë, dytë, tretë, katërt dhe pestë janë fëmijët e Ioannis Manitaras, dhe ankuesi i gjashtë është nipi i tij.

Faktet e rastit

Paraardhësi i ankuesve, z. Ioannis Manitaras kishte lindur dhe rritur në fshatin Rizokarpaso në gadishullin Karpas, në rrethin e Famagusta, në Qipron veriore. Ai punoi atje si një fermer dhe kishte një shtëpi me disa toka. Pas ndërhyrjes turke të vitit 1974, Ioannis Manitaras mbeti në Rizokarpaso bashkë me një grup të vogël të banorëve greko-qipriotë të gadishullit Karpas që vazhdojnë të jetojnë atje nën pushtimin turk e të "enklavuar". Në shkurt 1998 ai dëshmoi për delegacionin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin e *Qipros kundër Turqisë*¹¹ në një seancë të mbajtur në hotelin Ledra në Nikosia. Më 4 prill 1999 Ioannis Manitaras u gjet i vdekur në shtëpinë e tij Rizokarpaso. Sipas raportit të një mjekut të përgjithshëm i autorizuar nga autoritetet lokale për të kryer autopsinë, Ioannis Manitaras kishte vdekur nga një infeksion miokardit. Rrjedhimisht, një deklaratë për shtyp u lëshua nga Ministria e Jashtme Çështje të Republikës Turke të Qipros Veriore ("TRNC") duke konfirmuar gjetjet e këtij raportit. Një oficer mjekësor nga Forcat Paqeruajtëse të OKB-se në Qipro

¹¹ *Qipro kundër Turqisë* [DhM] nr. 25781/94, GjEDNj 2001-IV

(UNFICYP) i cili ishte i pranishëm në ekzaminimi pas vdekjes, gjithashtu përgatiti një raport të shkurtër, pa i referuar shkakut të vdekjes.

Ankuesit pretendojnë se nuk ishin në gjendje të varrosnin të ndjerin në shtëpinë e tij për shkak të kufizimeve mbi lirinë e adhurimit religjioz dhe për shkak të vandalizmit të vazhdueshëm të varreve greko-qipriote. Kështu ata bënë aranzhime që i ndjeri të varrosej në pjesën jugore të Qipros. Ata pohojnë se trupi iu dorëzua atyre në një mënyrë veçanërisht shqetësuese dhe mosrespektuese dhe se Autoritetet turke treguan një mungesë të plotë respekti për familjen e viktimës. Në veçanti, ata deklarojnë se kur iu dorëzua atyre, trupi i të vdekurit u mbulua pjesërisht në një mbulesë të vjetër dhe nuk ishte në një arkivol të përkohshëm ose qese të trupit. Më tej, ankuesit të gjashtë, nipit të të ndjerit, i ishte refuzuar leja për të shoqëruar ankuesit e parë, të dytë dhe të tretë për në fshatin Rizokarpaso më 5 prill 1999 për një vizitë të shkurtër për të marrë rrobat e Ioannis Manitaras dhe gjëra të tjera e nevojshme për funeralin dhe varrimin.

Në anën tjetër, pas vdekjes së Ioannis Manitaras në Spitalin e Përgjithshëm në Nikosia u ndërmorrën disa ekzaminime. Fillimisht më 7 prill 1999, në spitalin e përgjithshëm në Nikosia u krye një ekzaminim i dytë pas vdekjes nga dy specialistë (një i emëruar nga familja e të ndjerit dhe një nga Qeveria e Republikës së Qipros) në prani të vëzhguesve të Kombeve të Bashkuara. Përfundimet e këtyre ekzaminimeve ishin se nuk kishte "asnjë provë të trombozës së arteries koronare, infarkt miokardi apo episode të rëndësishme ishemike të mëparshme" dhe se shkak i vdekjes ishte "trauma e rëndë në vertebrën e qafës së mitrës për shkak të zbatimit të forcës së tepruar". Me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Qipros, raportet e të dy ekzaminimeve post mortem u shqyrtuan nga një Patolog Shtetëror Ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Universitetin e Danimarkës Jugore. Ai u pajtua me konkluzionet e raportit të dytë post-mortem dhe kritikoi të parin se nuk i përmbushte standardet ndërkombëtare.

Më 20 maj 1999, dosja iu referua Prokurorit të Përgjithshëm të "TRNC", i cili rekomandoi hetimin tek një mjek. Mjeku mbrojtës shqyrtoi dosjen dhe arriti në përfundimin se i vdekuri kishte vdekur nga vdekja e natyrshme për shkak të infarktit të miokardit dhe se nuk kishte asnjë indikacion se ai kishte qenë viktimë e një akti dhune. Gjithashtu, para Gjykatës, Qeveria paraqiti një kërkesë për një raport nga një Patologu dhe Ligjërues o Lartë në Departamentin e Mjekësisë Ligjore të Dublin Trinity College. Me kërkesën e UNFICYP, ky i fundit shqyrtoi dokumente të ndryshme, raporte shkencore, video dhe fotografi në lidhje me vdekjen e Ioannis Manitaras dhe gjithashtu intervistoi të gjithë personat që mund të jepnin informata për rastin, duke përfshirë edhe anëtarët e familjes së të ndjerit. Patologu erdhi në përfundim se vdekja ishte shkaktuar në mënyrë të natyrshme nga një "sulm i mundshëm në zemer".

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit pretendojnë shkelje të Nenit 2 të Konventës, për vrasjen e Ioannis Manitaras, si dhe shkelje të Nenit 13 të Komventës për shkak të për mungesës së hetimit të duhur për vdekjen e tij. Ankuesit me tutje u ankuan se vrasja e Ioannis Manitaras dhe trajtimi pasues i trupit të tij dhe i familjes së tij përbënin trajtim degradues dhe / ose çnjerëzor në kundërshtim me Nenin 3 të Konventës si dhe shkelje të drejtës së tyre për respektimin e jetës së tyre familjare dhe të shtëpisë bazuar ne Nenin 8. Duke u bazuar

në Nenin 14 të Konventës, ankuesit u ankuan për shkeljen e të drejtave të tyre themelore për shkak të origjinës së tyre greko-qipriote.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata fillimisht deklaroi se elementet që përmban dosja nuk mund të mbështesin teorinë se Ioannis Manitaras ishte vrasë. Rrjedhimisht, ankesat lidhur me "vrasjen" e tij nuk mund të konsiderohen si të tilla. Duke u bazuar në rrethanat e rasti Gjykata vie në përfundim që z. Ioanis Manitras kishte vdekur nga shkaqet natyrore dhe se autoritetet kishin ndërmarrë veprimet e duhura për të trajtuar rastin në përputhje me Nenin 13. Gjykata po ashtu nuk është në gjendje të gjejë ndonjë element të shkeljes së Nenit 3 dhe 8 në lidhje me kushtet e jetesës së Ioannis Manitaras në rajonin e "enklavuar" të Karpas. Këto kushte të jetesës nuk janë sjellë në vëmendjen e Gjykatës në kuadër të aplikacionit të tanishëm, i cili u përqendrua në vdekjen e z. Manitaras dhe ngjarjet që pasojnë atë.

Sa i përket kushteve në të cilat trupi i Ioannis Manitaras iu dorëzua ankueseve - sidomos fakti se trupi ishte mbuluar me një mbulesë të vjetër dhe jo në një arkivol të përkohshëm - Gjykata i referohet rastit të *Akpınar dhe Altun kundër Turqisë*¹² ku kishte konstatuar se gjymtimi i trupit të të afërmeve të ankueseve përbën trajtim degradues. Megjithatë, Gjykata vëren se rasti i tanishëm dallohet qartë nga ai i *Akpınar dhe Altun*, meqëse nuk ka pretendime se trupi i zotit Manitaras pësoi ndonjë gjymtim. Mbulimi i trupit të vdekur nga një material i papërshtatshëm mund të kenë provokuar vuajtje psikologjike, por Gjykata është e mendimit se vuajtja dhe dhimbja të cilat ankuesit mund të kenë ndjerë nuk arritën nivelin minimal të ashpërsisë që do të binte brenda fushëveprimit të Nenit 3 të Konventës. E njëjta vlen edhe për refuzimin e lejimit të ankuesit të gjashtë për të shoqëruar familjarët e tij në Rizokarpaso për të marrë gjërat e nevojshme për funeralin dhe varrimin.

Për aq sa ankuesit përmendin Nenin 8 të Konventës, Gjykata i referohet çështjes së *Ploski kundër Polonisë*¹³ ku kishte gjetur se se refuzimi për të lejuar një të burgosur të merrte pjesë në funeralet e prindërve të tij përbënte një ndërhyrje joproporcionale me të drejtën e tij për respektimin e jetës së tij private dhe familjare. Megjithatë, në rastin aktual nuk është argumentuar se ankuesit ishin penguar në ndonjë mënyrë për të marrë pjesë në varrimin e Ioannis Manitaras. Pretendimet e tyre lidhur me vandalizmin e varreve të krishtera në rajonin e Karpas ose pamundësinë që greko-qipriotët të vizitojnë varret e të afërmeve të tyre nuk mbështeten me dëshmi faktike dhe në asnjë rast nuk është vërtetuar se këto rrethana do të kishin ndikim të drejtpërdrejtë mbi ankuesit. Duhet të theksohet se vizita e ankuesve në shtëpinë e Ioannis Manitaras u motivua ekskluzivisht nga qëllimi i marrjes së rrobave të të ndjerit dhe gjërave të tjera të nevojshme për varrimin. Nga kjo rrjedh se kjo ankesë është qartazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me Nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

Tutje ankuesit pretenduan se shkeljet e të drejtave të tyre themelore ishin të motivuara nga origjina e tyre greko-qipriote dhe se kjo përbënte diskriminim në kundërshtim me Nenin 14 të Konventës. Praktika gjyqësore e Gjykatës konstaton se diskriminimi

¹² *Akpınar dhe Altun kundër Turqisë*, nr. 56760/00, §§ 84-87, 27 Shkurt 2007

¹³ *Ploski kundër Polonisë* nr. 26761/95, §§ 32-39, 12 Nëntor 2002

nënkupton trajtimin ndryshe, pa ndonjë arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm, personave në situata relevante të ngjashme.¹⁴ Megjithatë, jo çdo ndryshim në trajtim do të përbëjë një shkelje të Nenit 14. Duhet të vërtetohet se personat e tjerë në një situatë analoge ose përkatësisht të ngjashme gëzojnë trajtim të ndryshëm dhe se ky dallim është diskriminues. Në rastin konkret, ankuesit nuk arritën të dëshmonin se ata ishin trajtuar ndryshe nga persona të tjerë - përkatësisht nga qipriotët me origjinë turke - të cilët ishin në një situatë të krahasueshme. Gjykata gjithashtu i referohet perfundimit të saj se të drejtat themelore të ankuesve sipas Neneve 2, 3 dhe 8 të Konventës nuk janë shkelur. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se ankesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë në pajtim me Nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ankesa është qartazi e pabazuar në të gjitha pikat e pretenduara dhe shpall kërkesën të papranueshme [*njëzëri*].

¹⁴ *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36042/97., § 48, GjEDNj 2002-IV

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 2

Dështim për mbrojtjen e jetës si pasojë e veprimeve ushtarake të përdorura dhe mungesë e hetimeve efektive /ka shkelje

Neni 13

Mungesë e mjeteve efektive për adresim të shkeljeve të pretenduara / ka shkelje

Fjalët kyçe: *ndërluftim / popullsi civile / kalim i sigurtë / bombardime / e drejta ndërkombëtare / mbrojtje e civilëve / mungesë hetimi /*

Ankuesja: znj. Zara Adamovna Isayeva, shtetase ruse, e lindur dhe me vendbanim në Çeçeni

Faktet e rastit

Në tetor të vitit 1999, forcat ushtarake të Federatës Ruse filluan operacion ushtarak në Çeçeni. Në dhjetor të vitit 1999 forcat rebele ishin bllokuar nga avancimi i forcave federale në Grozni ku edhe u bënë luftime shumë të rënda.

Sipas ankueses, gjatë operacionit, forcat Ruse iu kanë lënë forcave rebele të besojnë se ekziston kalim i sigurtë për ikje në mal. Po ashtu rebelët kanë paguar edhe të holla për informacion për dalje dhe për kalim të sigurtë. Natën vonë me 29 janar 2000 luftuesit e kanë lënë qytetin e rrethuar, duke lënë kështu luftuesit që ta lëshojnë qytetin. Mirëpo, posa e lanë qytetin, këta të fundit ishin zënë në fushë të minuar, ndërsa artileria dhe forcat ajrore i kishin bombarduar gjatë gjithë rrugës.

Më pastaj një numër i konsiderueshëm, deri në 4000, i luftëtarë Çeçen hynë në fshatin e Katyr-Yurt herët në mëngjes me 4 shkurt 2000. Sipas ankueses, ardhja e luftëtarëve ka qenë e papritur dhe fshatarët as nuk ka qenë në dijeni për luftimin që do të zhvillohej apo për ndonjë kalim të sigurtë. Ndërsa për më tepër fshati ka qenë i deklaruar ‘zonë e sigurtë’ prandaj ka pasë edhe shumë të ardhur në fshat nga zonat tjera të luftimeve në Çeçeni. Sipas ankueses bombardimi filloi herët në mëngjes me 4 shkurt 2000. Ankuesja dhe familja e saj u fshehën në bodrum të shtëpisë, po kur bombardimet pushuan diku nga ora 15:30, duke parë se të gjithë fshatarët po bëheshin gati për ta lëshuar fshatin edhe familja e ankuesit morën një minibus për të dalë nga fshati. Në rrugëtim e sipër, aeroplanët u riparaqitën dhe i bombarduan makinat nëpër rrugë. Si pasojë e gjuajtjes, djali i ankueses (23 vjeç) vdes. Gjatë gjuajtjes, tri mbesat e saj po ashtu vdiqën (15, 13, dhe 6 vjeçe), ndërsa nipi i saj iu plagos rëndë dhe mbeti në karrocë që nga ajo kohë, dhe tre personat tjerë në makinë po ashtu u plagosën. Ankuesja pohoi se armët kanë qenë shumë të rënda dhe se 150 persona u vranë e shumë të tjerë u zhvendosën, dhe se nuk ka pasë njoftim për zonë të sigurtë.

Sipas Qeverisë, luftëtarët Çeçen ishin të armatosur rëndë dhe pushtuan Katyr-Yurt. Shumë shtëpi i shëndrruan në barrikada ndërsa popullatën e mbanin si mburojë

njerëzore. Pas hyrjes së forcave federale, iu mundësua kalimi i sigurtë për popullatën që u lajmërua në administratën e fshatit, mirëpo luftëtarët e penguan largimin e fshatarëve.

Hetimi i ngjarjes u bë mirëpo pas një kohe u ndërpre në mungesë të *corpus delicti*.

Përmbledhje e pretendimeve

Qeveria kërkoi nga Gjykata që ta deklarojë kërkesën të papranueshme për shkak se ankuesja ka dështuar që të shfrytëzojë mjetet efektive juridike. Qeveria paraqiti fakte se autoritetet relevante kanë udhëhequr dhe vazhdojnë të udhëheqin hetime për rastet e vdekjes, lëndimeve dhe shkatërrimin e pasurisë në Çeçeni, në harmoni me ligjet e brendshme. Po ashtu Qeveria pohoi se gjykatat në Çeçeni në të vërtetë nuk funksionojnë nga viti 1996, mirëpo mjetet civile janë të mundshme për ata të cilët janë larguar nga Çeçenia. Sipas praktikës iu lejohet që të aplikojnë në Gjykatën Supreme apo në Gjykata në vendet e tyre të rezidente.

Lidhur me meritat e rastit, Qeveria pretendonte se sulmi ishte pasojë e legjitimuar sipas Nenit 2 § 2 (a), pasi përdorimi i forcës në rrethanat e tilla ka qenë proporcional dhe absolutisht i domosdoshëm. Qeveria po ashtu argumenton se popullata ka qenë e informuar se duhet ta lëshojë fshatin.

Sipas ankueses, mjeteve që iu referohet Qeveria janë iluzore, jo të mjaftueshme dhe jo efektive. Po ashtu ankuesja pohoi se operacioni anti-terrorist në Çeçeni, i udhëhequr nga agjentët e shtetit është bazuar në dispozitat e Ligjit për Shtypje të Terrorizmit, duke mos i përcaktuar limitet e të drejtave dhe nuk ka paraparë mjete efektive për viktimat. Po ashtu sipas ankueses, ka qenë praktikë e gjatë e dështimit të kërkesave për hetim nga abuzimet të bëra nga udhëheqja dhe anëtarët e policisë efektive, si gjatë kohës së luftës po edhe gjatë paqes. Sipas ankueses, Qeveria nuk ka arritë të paraqesë dëshmi se mjetet që ekzistojnë në teori janë të mundshme dhe mundësojnë realizim të arsyeshëm. Lidhur me meritat e rastit, ankuesja pretendon se ka cënim të Nenit 2 të Konventës, dhe se e drejta e saj për jetë dhe e drejta për jetë e djalit të saj është e cënuar nga veprimet ushtarake. Sipas saj, forcat Federale Ruse do të duhej të ishin të vetëdijshme për rrugën e kontrolluar nga forcat rebele, ndërsa për më shumë ka fakte që sugjerojnë se në mënyrë të qëllimshme është organizuar vendkalim për rebelët me qëllim të ardhjes së tyre në fshat, duke përfshirë vendin Katyr-Yurt ku edhe janë gjuajtur me armë. Asnjë korridor/kalim i sigurtë nuk ishte bërë për civilët, po popullata civile ishte mbajtur në bllokim të rrugëve. Po ashtu janë gjuajtur me artileri shumë të rëndë duke konkluduar se nuk i janë përmbajtur rregullave relevante e të drejtës humanitare ndërkombëtare që udhëheqin përdorimin e forcës gjatë operacioneve ushtarake të përfshirë edhe civilë gjatë konfliktit të armatosur. Ndërsa Qeveria ka dështuar të paraqesë dokumentet lidhur me hetimin.

Arsyetimi i Gjykatës

Në rastin në fjalë, Gjykata nuk mori asnjë vendim lidhur me shterrijen e mjeteve juridike vendase në fazën e pranueshmërisë, duke gjetur se kjo pyetje ishte shumë e lidhur ngushtë me meritat. E njëjta vërejtje paraprake që është ngritur nga ana e Qeverisë në fazën e shqyrtimit të pranueshmërisë së rastit, Gjykata është e detyruar të

vlerësojë argumentet e palëve në bazë të dispozitave të Konventës dhe praktikës përkatëse.

Lidhur me shterrjen e mjeteve juridike, Gjykata vëren se rregulli i shtjerrjes së mjetit efektiv juridik është i obligueshëm nëse është i mundshëm dhe i mjaftueshëm në sistemin juridik të vendit që mundëson dëmshpërblim për çënimet që pretendohen. Gjykata thekson se aplikimi i rregullës së shtjerrjes së mjetit efektiv juridik po ashtu jepet si mundësi sepse aplikohet në kontekst të makinerisë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që Shtetet Kontraktuese janë pajtuar, po që duhet të aplikohet me një dozë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar. Sipas Gjykatës, rregulli i shtjerrjes së mjetit efektiv juridik nuk është absolut apo i mundshëm që të aplikohet menjëherë, prandaj është esenciale që të shikohet për rrethanat e çdo rasti. Prandaj, Gjykata duhet të ketë parasysh jo vetëm ekzistencën e mjeteve formale juridike në sistemin juridik të Shteteve Kontraktuese po edhe kontekstin e përgjithshëm se si operojnë dhe rrethanat personale të aplikuesit. Për më shumë duhet të vlerësohet nëses në rrethanat e rastit, aplikuesi ka bërë çdo gjë, që ka qenë e pritur e arsyeshme për të shtjerrur mjetet juridike të vendit.

Lidhur me këtë çështje Gjykata pajtohet me ankuesen se kanë ekzistuar rrethana të veçanta të cilat kanë ndikuar në pamundësinë e kryerjes së obligimit për shtjerrjen e mjetit efektiv juridik, prandaj ankuesja nuk ka qenë e obliguar të ndjekë mjetet civile të cilat i janë sugjeruar nga Qeveria. Ndërsa lidhur me mjetet juridike në çështjet penale, Gjykata vëren se ankuesja nuk ka qenë e informuar për progresin në hetim dhe asnjë akuzë nuk është bërë kundër ndonjë individi.

Lidhur me dështimin për mbrojtjen e jetës, e drejtë e garantuar me Nenin 2 të Konventës, Gjykata konsideron se ky nen mbulon jo vetëm vrasjen e qëllimshme po edhe situatat në të cilat lejohet përdorimi i forcës që dërgojnë në pasojë të paqëllimshme. Mirëpo sipas Gjykatës përdorimi i forcës duhet të jetë vetëm ‘absolutisht i domosdoshëm’, si dhe autoritetet duhet të marrin masa që të sigurohet se çdo rrezik i jetës të minimizohet.

Sipas fakteve të paraqitura nga palët, Gjykata vëren se operacioni ushtarak në Katyr-Yurt nuk ka qenë spontan. Operacioni ka pasë për qëllim shuarjen e luftëtarëve dhe është planifikuar më herët, mirëpo nuk ka të dhëna se në fazën përgatitore është bërë përpjekje për evakuimin e civilëve, apo informim të mëhershëm. Po ashtu, Gjykata konsideron se përdorimi i armëve të tilla në zona të populluara, pa luftë dhe pa evakuim është e vështirë të pranohet në një shoqëri demokratike. Prandaj Gjykata gjen se është çenuar Neni 2 i Konventës sipas obligimit për të mbrojtur të drejtën për jetë të aplikueses, për djalin e saj dhe tri mbesave.

Lidhur me çështjen e hetimit, të garantuar me Nenin 2 të Konventës, Gjykata vëren se ky Nen kërkon që të ekzistojë një formë e hetimit zyrtar efektiv kur individët janë vrarë si rezultat i përdorimit të forcës nga ana e autoriteteve shtetërore. Po ashtu, konsideron se qëllim esencial është që hetimi të sigurojë realizim të ligjeve nacionale të cilat mbrojnë të drejtën për jetë. Për të qenë një hetim efektiv për vrasjen e supozuar të paligjshme nga ana e agjentëve shtetërorë përgjithësisht mund të konsiderohet si e nevojshme që personat përgjegjës për kryerjen e hetimeve të jenë të pavarur nga ata që janë të përfshirë në ngjarje. Kjo nënkupton jo vetëm mungesën e lidhjes hierarkike apo institucionale, por edhe një pavarësi praktike. Autoritetet duhet të jenë po ashtu

efektive në kuptimin që të jenë në gjendje të përcaktojnë se forca e përdorur është e justifikuar. Autoritetet do të duhej të siguronin të dhëna për incidentin, që përcaktojnë shkaqet e vdekjes si dhe përgjegjësinë e personit. Një shpejtësi dhe ekspeditim i arsyeshëm është i nënkuptuar në këtë kontekst. Po ashtu, duhet të ketë një element të mjaftueshëm të shqyrtimit publik të hetimit apo rezultateve të tij për të siguruar llogaridhënie si në teori edhe në praktikë. Shkalla e shqyrtimit publik të kërkuar mund të ndryshojë nga rasti në rast. Sidoqoftë, në të gjitha rastet, të afërmit e ardhshëm të viktimës duhet të përfshihen në procedurë në atë masë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e tij ose të saj legjitim.

Sipas fakteve të rastit, hetimi ishte hapur vetëm pas njoftimit të ankesës drejtuar Qeverisë së paditur në shtator të vitit 2000. Gjykata vërejtí disa të meta serioze në pjesën e dosjes së hetimit të paraqitur, siç është mungesa e informacionit të besueshëm për deklarin e "zonës së sigurtë". Asnjë person nuk ishte identifikuar në mesin e autoriteteve ushtarake ose civile si përgjegjës për deklarin e korridorit dhe për sigurinë e atyre që e përdorin atë. Nuk është dhënë sqarim për mungesën e koordinimit ndërmjet njoftimeve të një "daljeje/kalimi të sigurtë" dhe mungesës së dukshme të konsideratës që ushtria i ka dhënë në planifikimin dhe ekzekutimin e misionit të tyre. Për më shumë informacioni rreth vendimit me të cilin ishte mbyllur procedura dhe vendimet për dhënien e statusit të viktimës nuk u janë komunikuar drejtpërdrejt ankueses dhe viktimave të tjera, siç parashihet me legjislacionin përkatës vendas. Prandaj, Gjykata nuk ishte e bindur që ankuesja ishte informuar siç duhet për procedurat dhe mund të kishte kundërshtuar rezultatet e tij. Prandaj, autoritetet kishin dështuar për të kryer një hetim efektiv në rrethanat e operacionit ushtarak. Si pasojë, kishte shkelje të Nenit 2 të Konventës në këtë kontekst.

Lidhur me Nenin 13 të Konventës, Gjykata rithekson që ky nen garanton disponueshmërinë në nivel kombëtar të mjeteve juridike për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës në çfarëdo mënyre që ato mund të ndodhin për t'u siguruar në rendin juridik të brendshëm. Efekti i Nenit 13, pra, është të kërkojë sigurimin e mjeteve juridike të brendshme për t'u marrë me substancën e një "ankese të diskutueshme" sipas Konventës dhe për t'i dhënë satisfaksionin e duhur, edhe pse Shteteve Kontraktuese u jepet një diskrecion për mënyrën se si do t'i përmbushin detyrimeve të tyre që rrjedhin nga kjo dispozitë e Konventës.

Sa i përket fakteve, ankesa e ankueses ishte qartazi "e diskutueshme" për qëllimet e Nenit 13. Ajo duhet, pra, të ketë qenë në gjendje të përfitojë nga mjetet juridike efektive dhe praktike që mund të çojnë në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës dhe në dhënien e një dëmshpërblimi, për qëllimet e Nenit 13. Megjithatë, hetimi penal ishte i paefektshëm në atë që i mungonte objektiviteti dhe thelbësia, ashtu që edhe efektiviteti i çdo mjeti tjetër, përfshirë mjetet juridike civile, ishte minuar rrjedhimisht. Andaj, Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 13 të Konventës.

Në këto rrethana, bazuar në Nenin 41 të Konventës Gjykata i ndan ankueses shumat në vijim: 18,710.00 EUR në emër të dëmit material, 25,000.00 EUR në emër të dëmit jo material dhe 12,000.00 EUR për shpenzimet gjyqësore, duke zbritur shumën prej 1,074.00 EUR për ndihmë juridike të marrë nga Këshilli i Evropës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 2 si pasojë e dështimit të shtetit të paditur që të mbrojë të drejtën për jetë të ankuesit dështimin për marrjen e hetime efektive dhe gjithashtu se ka shkelje të Nenit 13 të Konventës [njëzëri].

Neni 3

Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese.

Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar - 14038/88

7 korrik 1989 [Dhoma e Madhe]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3

Shkelje e detyrimit për parandalim të torturës dhe trajtimit çnjerëzor në rast të lejimit të ekstradimit të një personi në Shtetet e Bashkuara, ku mund të dënohet me vdekje dhe të detyrohet të presë në “rreshtin e vdekjes” përpara ekzekutimit / *ka shkelje*

Neni 6 § 1 dhe 3

Shkelje e gjykimit të drejtë si pasojë e mungesës së ndihmës juridike falas; dhe mos trajtim i duhur i rastit / *nuk ngritet çështje e ndarë sa i përket Nenit 6 § 1; dhe nuk ka juridiksion për çështjen në bazë të Nenit 6 § 3*

Neni 13

Mungesë e mjeteve efektive juridike në Mbretërinë e Bashkuar / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: *ekstradim / dënim me vdekje / rreshti i vdekjes / kërkesa konkurruese / torturë / trajtim çnjerëzor / palë jokontraktuese*

Ankuesi: z. Jen Soering, shtetas gjerman, i lindur më 1 gusht 1966

Faktet e rastit

Ankuesi ishte zhvendosur në Shtetet e Bashkuara me prindërit e tij në moshën 11 vjeçare. Nga muaji prill i vitit 1986 mbahej në gjendje arresti në Mbretërinë e Bashkuar, në pritje të ekstradimit për në Shtetet e Bashkuara, ku do të gjykohej për vrasje në shtetin e Virxhinias. Ai dyshohej se më 30 mars 1989, në moshën 18 vjeçare, kishte vrarë prindërit e të dashurës së tij në Bedford County të shtetit të Virxhinias.

Në gusht të vitit 1986, Shtetet e Bashkuara kërkuan ekstradimin e z. Soering mbi bazën e Traktatit të Ekstradimit të vitit 1972 ndërmjet SHBA-ve dhe Mbretërisë së Bashkuar. Në tetor 1986, Ambasada Britanike u paraqiti një kërkesë Shteteve të Bashkuara, ku kërkonte sigurime se në rast se ankuesi ekstradohej dhe dënohej për krimet, ai nuk do të dënohej me vdekje ose dënimi me vdekje nuk do të zbatohet.

Në mars të vitit 1987, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, gjithashtu, i kërkoi Mbretërisë së Bashkuar ekstradimin e ankuesit për ta gjykuar në lidhje me vrasjet e pretenduara. Këtë e bëri mbi bazën e shtetësisë së ankuesit dhe mbështetur në Traktatin e Ekstradimit të vitit 1872 ndërmjet Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Në maj 1987, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar e njoftoi Republikën Federale të Gjermanisë se ka arritur në përfundimin se duhet të vazhdonte të shqyrtonte kërkesën e Shteteve të Bashkuara për ekstradimin e ankuesit dhe se kishte marrë sigurime nga Prokurori i Bedford County se nuk kishte për qëllim të kërkonte dënimin me vdekje.

Në qershor 1987, procedura e ekstradimit u zhvillua në Gjykatën e Magjistratëve në Boë Street. Në këtë rast, ankuesi i paraqiti gjykatës një raport psikiatrik që thonte se në kohën kur ishte kryer krimi ai vuante nga një çrregullim psikik, gjë e cila e shkarkonte

atë nga përgjegjësia. Përkundër kësaj, Gjykata e Magjistratëve gjeti se kishte prova të mjaftueshme për ta ekstraduar atë në Shtetet e Bashkuara dhe se ankuesi duhej të priste urdhërin e Sekretarit Britanik të Shtetit për ta ekstraduar atë. Një kërkesë e mëpastajme për rigjykim të çështjes ishte refuzuar. Pretendimet e ankuesit ishin se sigurimet e ofruara nga SHBA-të ishin aq të padobishme sa asnjë Sekretar Shteti i arsyeshëm nuk do t'i konsideronte si të kënaqshme ose të mjaftueshme sipas Nenit IV të Traktatit për Ekstradim.

Më 3 gusht 1998, Sekretari i Shtetit ka nënshkruar urdhërin që ankuesi t'i dorëzohej autoriteteve të Shteteve të Bashkuara. Megjithatë, si rezultat i ankesës së paraqitur në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe masave të përkohshme mbrojtëse, fillimisht të Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe më pas të Gjykatës, deri në datën e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, z. Soering nuk ishte transferuar në Shtetet e Bashkuara.

Në anën tjetër Ligji i aplikueshëm në shtetin e Virxhinias e njeh dënimin me vdekje, dhe personat të cilët marrin një dënim të tillë duhet të presin në të ashtuquajturin rreshti ose korridori i vdekjes. Koha mesatare që një i burgosur kalon përpara ekzekutimit është gjashtë deri në tetë vjet. Vonesat kryesisht rrjedhin si rezultat i kundërpadive të të dënuarve si në gjykatat shtetërore ashtu dhe në ato federale. Mjeti i përdorur i ekzekutimit është goditja me energji elektrike.

Përveç Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar kundër të cilës ishte paraqitur rasti, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, gjithashtu, ishte përfaqësuar. Pretendimi i Qeverisë Gjermane mbështetej në Nenin 48(b) të Konventës, që i jep të drejtën shtetit të mbrojë përpara Gjykatës shtetasin e tij, i cili pretendohet të jetë viktimë e shkeljes së Konventës.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi pretendon se vendimi i Sekretarit Britanik të Shtetit që të transferojë atë pranë autoriteteve të Shteteve të Bashkuara, po të zbatohet, do të përbënte shkelje të Nenit 3 të Konventës, që thekson se “askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtruese”. Andaj çështja e parë e shqyrtuar kishte të bënte me atë nëse ekstradimi nga një shtet palë i Konventës te një palë e tretë mund të krijojë përgjegjësinë e këtij shteti në bazë të Nenit 3, për shkak të keqtrajtimit që personi i ekstraduar mund të vuajë në shtetin ku ekstradohet.

Përveç pyetjes nëse kishte rrezik real që ankuesi të dënohej me dënim me vdekje në Virxhinia, çështja kyçe, që do të pasonte këtë dënim, kishte të bënte me fenomenin e korridorit të vdekjes. Për dallim nga ankuesi dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar nuk konsideronte se rreziku i dënimit me vdekje përmbante një shkallë të mjaftueshme të mundësisë për të vënë në lojë zbatimin e Nenit 3 të Konventës.

Ankuesi, gjithashtu, kishte ngritur pretendime në bazë të Nenit 6 të Konventës. Sipas tij, mungesa e ndihmës ligjore falas në Virxhinia për të financuar kundërpaditë para gjykatave federale, do t'ja pamundësonte përfaqësimin ligjor siç kërkohet në Nenin 6(3c).

Së fundmi, ankuesi kishte pretenduar shkelje të Nenit 13, pasi, sipas tij, nuk kishte mjete efektive juridike në lidhje me pretendimin e tij që kishte të bënte me Nenin 3 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata ka bërë të qartë në këtë rast se Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk rregullon sjelljet e shteteve të cilat nuk janë palë e Konventës dhe as nuk përmban detyrime për shtetet palë që t'ua imponojnë standardet e Konventës shteteve të tjera. Gjithashtu, Gjykata vëren se ekstradimi si mjet për të parandaluar shmangien nga drejtësia nuk mund të shpërfilllet dhe se Konventa nuk përmban një të drejtë që parandalon ekstradimin. Në anën tjetër, Gjykata thekson se ndalesa absolute e torturës dhe e dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtuese tregon se Neni 3 i Konventës paraqet një rëndësi prej vlerave më themelore të një shoqërie demokratike.

Në parim, Gjykata ka vlerësuar se institucionet e Konventës nuk shprehen në lidhje me ekzistencën e shkeljeve të mundshme të Konventës. Megjithatë, në rastin konkret të mbrojtjes së Nenit 3, Gjykata ka vlerësuar se ekstradimi i një personi të arrestuar nga një shtet palë mund të angazhojë përgjegjësinë e këtij shteti në bazë të Konventës, në rast se ka bazë thelbësore për të besuar se personi i ekstraduar do të ishte në rrezik që të ishte subjekt i torturës ose do të përballej me një rrezik të vërtetë për t'u trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe poshtuese në shtetin pritës. Kësisoj, vendimi i një shteti palë për të ekstraduar mund të ngrisë çështje që lidhen me Nenin 3 të Konventës.

Në vijim të këtij përcaktimi dhe pasi Gjykata gjeti se kishte arsye thelbësore për të besuar se nëse ankuesi do ekstradohej në Shtetet e Bashkuara, mund të dënohej me vdekje dhe, si pasojë e këtij dënimi, do të ekspozohej ndaj “fenomenit të rreshtit të vdekjes”, ajo pranoi se ky fenomen paraqiste burim të trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor dhe poshtues.

Tutje Gjykata sqaron se, në pajtim me praktikën e saj gjyqësore, trajtimi ose ndëshkimi duhet të jetë i një shkalle minimale të ashpërsisë për të hyrë kuadër të Nenit 3 të Konventës. Në mënyrë që një ndëshkim ose trajtim të jetë “çnjerëzor” ose “poshtues”, vuajtja ose poshtërimi në cilëndo rrethanë duhet të shkojë përtej ndëshkimit apo trajtimit të lidhur me një formë të ndëshkimit legjitim.

Gjykata shqryton më tej rrethanat e veçanta të rastit dhe fillimisht vëren se një i burgosur i dënuar duhet të kalojë vite të tëra jetese në ankth dhe tensioni në rritje për shkak të procedurave komplekse të pas-dënimit në Virxhinia. Së dyti, kushtet në regjimin e posaçëm të rreshtit ose korridorit të vdekjes gjithashtu janë faktor në çështjen e Nenit 3 të Konventës. Së treti, moshë e re e ankuesit në kohën e kryerjes së veprës dhe gjendja e tij mendore në atë kohë priren që të sjellin çështjen e trajtimit brenda përmbajtjes së Nenit 3. Së fundmi, ishte mundësia e ekstradimit të tij në Gjermani, që do të shmangte si rrezikun e mosndëshkimit të një kriminelit të arratisur ashtu dhe rrezikun e vuajtjes intensive në rrestin e pritjes për ekzekutim. Në përfundim, Gjykata përcaktoi se vendimi i Sekretarit të Shtetit për të ekstraduar ankuesin, po qe se do të zbatohej, do të përbënte shkelje të Nenit 3 të Konventës.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për shkelje të Nenit 6 të Konventës, për atë se në shtetin e Virxhinias mungonte ndihma juridike falas për të financuar apelimet e ndryshme në gjykatat federale, Gjykata gjen se faktet e rastit konkret nuk shpërfaqin

një rrezik të mohimit flagrant të së drejtës për gjykim të drejtë andaj nuk ngritet çështje e ndarë bazuar në Nenin 6 § 3 të konventës. Ndërsa lidhur me pretendimet bazuar në Nenin 6 § 1 dhe § 3 (d), Gjykata konstaton se nuk ka juridiksion.

Sa i përket pretendimit të ankuesit për shkelje të Nenit 13 të Konventës, në lidhje me atë se nuk kishte mjete efektive juridike në Mbretërinë e Bashkuar, Gjykata vie në përfundimin se kërkesat e këtij neni nuk ishin shkelur. Për të ardhur në këtë përfundim, Gjykata kishte shqyrtuar procedurat gjyqësore të ndjekura në Mbretërinë e Bashkuar.

Sa i përket dëmshpërblimit, Gjykata theksoi se gjetja në lidhje me Nenin 3 në vetvete paraqet dëmshpërblim të drejtë për qëllime të Nenit 50 të Konventës. Gjykata po ashtu i njohur ankuesit të drejtë për t'ju kompensuar të gjitha shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata e shpallë ankesën të pranueshme dhe gjen se vendimi për të ekstraduar ankuesin, në qoftë se do të ishte zbatuar, do të kishte shkelur Nenin 3 të Konventës; ndërsa lidhur me pretendimet bazuar në Nenet 6 dhe 13 të Konventës Gjykata gjen se nuk ka shkelje [*njëzëri*].

Selmouni kundër Francës - 25803/94

28 qershor 1999 [Dhoma e Madhe]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3

Trajtim çnjerëzor deri në shkallën e torturës gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim policor / *ka shkelje*

Neni 6 § 1

Pretendim për shkelje të së drejtës në proces të drejtë gjyqësor si pasojë e tejzgjatjes së procedurave / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: paraburgim / ushtrim i dhunës / lëndime fizike dhe psikike / torturë / tejzgjatje e procedurave / masa jo-efektive

Ankuesi: z. Ahmed Selmouni, me shtetësi të dyfishtë holandeze dhe marokiene

Faktet e rastit

Ankuesit iu caktua burgimi prej trembëdhjetë vjet pasi u dënua për vepra penale të trafikimit të drogës në Francë. Pasi u arrestua më 25 nëntor 1991, ankuesi u mbajt në paraburgim për tri ditë. Gjatë kësaj kohe, ai pretendon se ishte subjekt i keqtrajtimit serioz e të përsëritur që përfshinte dhunë të vazhdueshme fizike dhe seksuale, dhe fyerje të vazhdueshme në baza nacionale. Ankuesi u ankua vazhdimisht gjatë ekzaminimeve mjekësore se ai ishte duke iu nënshtruar keqtrajtimit. Një mjek i praktikës së përgjithshme mjekësore ekzaminioi ankuesin në së paku pesë raste të veçanta gjatë tre ditëve që ai ishte paraburgosur. Një raport mjekësor i përgatitur me kërkesë të ankuesit në përgjigje të pretendimeve të tij vuri në dukje të paktën 22 dëmtime të veçanta, duke konkluduar se vërehen dëmtime, shenja të traumës si dhe "lezione të një origjine traumatike [...] të shkaktuara në një kohë që korrespondon me periudhën e mbajtjes në polici". Oficerët e policisë të përmendur në deklaratat e ankuesit pretendonin se lëndimet ishin shkaktuar si pasojë e kacafytjes gjatë arrestimit. Megjithatë, një doktor i rishikoi shënimet mjekësore të ankuesit dhe në një raport të ndarë komentoj se edhe pse disa nga dëmtimet mund t'i atribuohen përleshjes gjatë arrestimit, dëmtimet e tjera janë shkaktuar pas arrestimit, duke mbështetur kështu versionin e ngjarjes së ankuesit.

Të gjitha vizitat mjekësore dhe intervistat u regjistruan dhe u dërguan tek Prokurori Publik në Bobigny më 2 dhjetor 1992 si pjesë e procedurave të depozituara. Në anën tjetër një aktgjykim të datës 7 dhjetor 1992, Divizioni i Trembëdhjetë i Gjykatës Penale në Bobigny dënoi ankuesin me pesëmbëdhjetë vjet burgim dhe përjashtim të përhershëm nga territori francez. Ndërsa në një procedurë civile nga autoritetet doganore, ankuesi u urdhërua të paguante një shumë totale prej njëzet e katër milionë franga franceze.

Një hetim i ri penal dhe civil i akuzave të pretenduara nga ankuesi u inicua në shkurt të vitit 1993. Një rishqyrtim mjekësor në qershor të vitit 1993 vuri në dukje se plagët e

mbetura po shëronin mirë, por nuk gjeti prova për sulme seksuale "kryesisht për shkak të kohës që kishte kaluar që nga veprat e pretenduara. Mjeku vuri në dukje se ankuesi nuk e përmendi sulmin seksual në atë kohë, sepse 'ndihej i turpëruar'. Ankuesi gjithashtu kishte probleme me syrin tij të majtë, por mjeku ekzaminues arriti në përfundimin se do të kërkohej ekzaminimi i mëtejshëm për të përcaktuar nëse kishte lidhje midis këtij dëmtimi dhe keqtrajtimit të dyshuar. Në një aktgjykim të datës 16 shtator 1993, Gjykata e Ankesave e Parisit i zvogëloi dënimin me burg në trembëdhjetë vjet dhe e miratoi pjesën tjetër të aktgjykimit. Më 27 qershor 1994 Gjykata e Kasacionit hodhi poshtë ankesën e ankuesit.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi pretendon se trajtimi i tij gjatë qëndrimit në paraburgim e kaloi pragun e ashpërsisë të kërkuar për t'u konsideruar torturë sipas Nenit 3 të Konventës, duke pretenduar se motivimi i punonjësve të policisë ishte të nxjerrin një rrëfim/dëshmi nga ai. Gjithashtu ankuesi pretendoi se procedurat në lidhje me ankesat kundër oficerëve të policisë nuk janë kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor siç kërkohet nga Neni 6 § 1 i Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Sipas pretendimeve preliminare të Qeverisë, ankesa e bazuar në Nenin 3 nuk mund të shqyrtohej nga Gjykata pasi që ankuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike vendasore. Fillimisht Komisioni e më pas edhe Gjykata gjeti se ankuesi kishte plotësuar kërkesat e Nenit 35 të Konventës. Gjykata vërejtë se duke pasur parasysh seriozitetin e pretendimeve të ankuesit dhe kohëzgjatjen e kohës që kishte kaluar që kur kishin ndodhur ngjarjet, autoritetet nuk kishin marrë të gjitha masat pozitive të kërkuara në rrethanat e rastit në mënyrë që të sjellin hetimin në një përfundim të shpejtë. Gjykata thekson se qëllimi i Nenit 35 është që Shtetet Kontraktuese ta kenë mundësinë e parandalimit ose vënies së të drejtës në rastet kur ka shkelje të pretenduara kundër tyre para se këto pretendime të dorëzohen në Institucionet e Konventës.¹⁵ Mjetet juridike që parashikohen në Nenin 35 të Konventës janë ato që lidhen me shkeljet e pretenduara dhe në të njëjtën kohë janë në dispozicion dhe të mjaftueshme. Sipas Gjykatës ekzistenca e këtyre mjeteve juridike duhet të jetë e mjaftueshme, të jetë e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Në rastin aktual Gjykata thekson se sapo ankuesi u lirua nga arrestimi i policisë më 29 nëntor 1991, gjykatësi hetues që u morr me procedimet kundër tij urdhëroi të hartohet një raport mjekësor dhe gjithashtu të kryhet një hetim paraprak nën autoritetin e prokurorit publik. Megjithatë, Gjykata vëren se në rrjedhën e atyre hetimeve asnjë deklaratë nuk është marrë nga ankuesi deri më shumë se një vit pas ngjarjeve në fjalë dhe se hapja e një hetimi gjyqësor nuk ishte kërkuar deri pasi që ankuesi paraqiti, më 1 shkurt 1993, një ankesë penale së bashku me një ankesë civile.

Gjykata vëren se rrethanat e rastit tregojnë se ka pasur një numër të vonesave të tjera të cilat duhet të merren parasysh. Pothuajse një vit ka kaluar midis ekzaminimit mjekësor

¹⁵ *Hentrich kundër Francës* i 22 shtatorit 1994, Seria A nr. 296-A, f. 18, § 33, dhe *Remli kundër Francës*, Aktgjykimi i 23 prillit 1996, Raportet 1996-II, f. 571, § 33

më 7 dhjetor 1991 dhe intervistimit të ankuesit nga Inspektorati Policor; pas kësaj, përsëri gati një vit kaloi mes hapjes së një hetimi gjyqësor; dhe dy vjet dhe mbi tetë muaj kaluan mes datës në të cilën janë identifikuar dhe datën në të cilën ishin të vendosur nën hetim policët e akuzuar. Gjykata më tutje vëren se, pesë vite pas ngjarjeve askush nuk ishte akuzuar për veprat pavarësisht nga faktit se oficerët e policisë të akuzuar nga ankuesi ishin identifikuar. Për më tepër, oficerët e policisë nuk u paraqitën përfundimisht para Gjykatës Penale deri gati pesë vjet pasi ata ishin identifikuar. Sipas mendimit të Gjykatës, çështja rrjedhimisht nuk është nëse ka pasur një hetim, pasi duket se ka pasur një të tillë, por çështja për trajtim është nëse hetimi ishte "efektiv". Duke pasur parasysh si më sipër, Gjykata konsideron, që autoritetet nuk kanë marrë masat pozitive të kërkuara në rrethanat e rastit për të siguruar që mjeti juridik i përmendur nga Qeveria ishte efektiv. Prandaj, duke pasur parasysh mungesën e shpjegimit bindës nga ana e Qeverisë në lidhje me "efektivitetin" dhe "përshtatshmërinë" e mjeteve juridike Gjykata konsideron se ankuesi nuk kishte në dispozicion një mjet juridik të mjaftueshme për të realizuar të drejtën e tij, me këtë edhe dëmshpërblimin në lidhje me shkeljet që ai pretendonte. Gjykata hedh poshtë pretendimin e Qeverisë se kërkesa e ankuesit duhet të hedhet poshtë për shkak të mos shtjerresës së mjeteve juridike vendore, dhe shpall kërkesën të pranueshme.

Ne lidhje me keqtrajtimin e ankuesti Gjykata vërejt se ankesat e tij për mënyrën e keqtrajtimit ishin të njehta dhe asnjëherë nuk ndryshuan. Gjithashtu, vërejt se certifikatat mjekësore dhe raportet e hartuara në pavarësi të plotë nga mjekët, vërtetuan ekzistencën e një numri të madh të goditjeve të shkaktuara ndaj ankuesit dhe intensitetin e tyre. Gjykata konsideron se kur një individ merret në polici në shëndet të mirë, por në kohën e lirimit, është evidente se ka pësuar lëndime, është detyrë e Shtetit të japë një shpjegim të besueshëm se si u shkaktuan lëndimet. Dështimi i shtetit për të bërë këtë paraqet shkelje të Nenit 3 të Konventës.¹⁶ Prandaj, autoritetet franceze kanë qenë të obliguara të japin një shpjegim të besueshëm se si u shkaktuan lëndimet e ankuesit. Njëkohësisht, Gjykata vërejt se nga raportet dhe dokumentet e rastit Qeveria asnjëherë nuk kundërshtoi faktet e pretenduara nga ankuesi në lidhje me ngjarjet. Gjykata thekson, si një argument plotësues, se ato fakte janë marrë si të vërtetuara nga Gjykata Penale dhe nga Gjykata e Apelit e Versajës - me përjashtim të pohimeve për përdhunimin seksual dhe humbjes së mprehtësisë pamore. Prandaj, Gjykata është e mendimit se, në lidhje me ankesat e paraqitura nga ankuesi, këto fakte mund të supozohen se kanë qenë të bazuara. Gjykata konsideron, megjithatë, se nuk është vërtetuar se ankuesi u abuzua seksualisht, pasi akuza ishte bërë shumë vonë për t'u provuar ose mohuar me dëshmi mjekësore.

Sa i përket peshës/gravitetit të dhunës së pretenduar, Gjykata merr parasysh vendimin e Komisionit, ku ishte konsideruar se nga goditjet e marra ankuesit i ishin shkaktuar lëndime dhe vuajtje akute fizike dhe mendore. Për më tepër trajtimi duket se i ishte shkaktuar atij qëllimisht dhe, me qëllim të marrjes së një rrëfimi ose informacioni. Sipas Komisionit, një trajtim i tillë, i shkaktuar nga një ose më shumë zyrtarë shtetërorë dhe për të cilat certifikatat mjekësore mbanin dëshmi, ishte i një natyre

¹⁶ *Tomasi kundër Francës*, 27 gusht 1992, Seria A nr. 241-A, fq. 40-41, §§ 108-11, dhe *Ribitsch kundër Austrisë*, Aktgjykimi i 4 dhjetorit 1995, Seria A nr. 336, f. 25-26, § 34

mizore dhe se ky trajtim mund të përshkruhet vetëm si torturë. Për këtë Gjykata duke marrë parasysh të gjitha sjelljet e policisë ndaj ankuesit konsideron se dhuna fizike dhe dhuna mendore, në tëresi e përdorur kundër ankuesit i shkaktoi atij dhimbje dhe vuajtje "të rënda" dhe ishte veçanërisht serioze dhe mizore. Një sjellje e tillë konsiderohet si akt torture për qëllimet e Nenit 3 të Konventës. Si pasojë Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 3 të Konventës.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit se procedurat në lidhje me ankesat e tij kundër oficerëve të policisë nuk ishin kryer brenda një kohe të arsyeshme siç kërkohet nga Neni 6 § 1 i Konventës Gjykata konsideron se periudha për shqyrtimin e kohëzgjatjes së procedurës e përcaktuar në Nenin 6 § 1 filloi të rrjedh në momentin kur ankuesi ka paraqitur shprehimisht ankesën dhe u intervistua nga një oficer i Inspektorati Kombëtar të Policisë, domethënë më 1 dhjetor 1992. Gjykata vëren se kjo formë e thjeshtë e ankesës penale është një mjet i ofruar nga ligji francez dhe se prokurori publik u informua për ankesën e ankuesit që më 2 dhjetor 1992, kur ishte hartuar procesverbali i intervistës dhe i ishte dorëzuar atij. Duke pasur parasysh natyrën dhe seriozitetin ekstrem të pretenduar Gjykata nuk konsideron se ajo duhet të marrë si pikënisje datën 1 shkurt 1993, data në të cilën ankuesi paraqiti padinë penale për t'u bashkuar me procedurat civile më pas. Gjykata konsideron se as kompleksiteti i rastit dhe sjellja e ankuesit nuk e arsyetojnë tej-zgjatjen e procedurave. Gjykata vëren se procedurat, në tëresi kanë zgjatur më shumë se gjashtë vjet e shtatë muaj. Duke pasur parasysh seriozitetin e fakteve të supozuara, kohëzgjatja e përgjithshme e procedurës, kishte tejkaluar "kohën e arsyeshme" të parashikuar nga Neni 6 § 1. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 3 dhe Nenit 6 §1, të Konventës [njëzëri].

Peers kundër Greqisë - 28524/95
19 prill 2001 [Seksioni i Dytë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3

Pretendim për trajtim çnjerëzor dhe degradues në ambientet e paraburgimit / *ka shkelje*

Neni 6 § 2

Pretendim për trajtim jo të duhur gjatë qëndrimit në paraburgim / *nuk ka shkelje*

Neni 8

Cënim i të drejtës në privatësi si pasojë e leximit të korrespondencës së tij / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: paraburgim / zonë e segreguar / trajtim çnjerëzor / qeli i ngushtë / kushte jo të mira / përdorues droge / korrespondencë

Ankuesi: z. Donald Peers, shtetas britanik

Faktet e rastit

Ankuesi, një ish i varur droge, u arrestuar në Aeroportin e Athinës, Greqi, për shkelje që kanë të bëjnë me narkotikë më 19 Gusht 1994, ku nga stacioni qendror i policisë, u transferua në burgun Koridallos më 24 gusht 1994. Së pari ai u mbajt në spitalin psikiatrik të burgut, ndërsa më pas në zonën e izoluar/ segreguese Delta që ishte e rezervuar për të varurit nga droga, dhe pastaj në krahun Alpha të burgut. Më 28 korrik 1995, ankuesi u shpall fajtor për vepër penale me narkotikë, dhe u dënua me 13 vite burg, dhe një gjobë prej 5,000,000 drahtas. Ankuesi apeloi këtë vendim dhe në nëntor të vitit 1997, gjykata uli dënimin në 9 vite, dhe urdhëroi largimin e tij nga Greqia. Më 2 qershor 1998, ankuesi aplikoi për lirim me kusht, dhe me 10 qershor 1998, i'u pranua kjo kërkesë.

Përgjatë kohës sa ankuesi ishte në burgun Koridallos ai deklaroi se në krahun Delta ndante një qeli shumë të vogël me një të burgosur tjetër, me një tualet të hapur që rrallëherë punonte, pa dritë natyrore të mjaftueshme, me vetëm një dritare të pluhurosur, dhe pa ajrosje. Edhe në krahun Alfa kushtet ishin shumë të vështira, ku ishte në një qeli aq të vogël sa që shumicën e kohës i duhej të qëndronte i shtrirë në shtrat, si dhe i mungonin të gjitha mjete higjienike të nevojshme dhe nuk kishte privatësi. Ai nuk kishte qasje në kurse ose aktivitete profesionale ose në bibliotekë.

Sa ishte në burgun e Koridallos, e vetmja gjë që ankuesit i ishte dhënë ndonjëherë ishin batanije. Atij nuk iu dhanë rroba, fleta, jastëkë, tualete (duke përfshirë sapun) ose letër higjienike. Ai duhej të blinte tualete dhe letër higjienike nga restoranti. Herë pas here ai nuk kishte para dhe duhej të kërkonte nga të burgosurit tjerë. Shërbimet sociale dhe disa organizata bamirëse gjithashtu e ndihmonin. Sidoqoftë, ka pasur raste kur ai u la pa letra higjienike, në veçanti kur duhej ta përdorte tualetin shpesh, për shkak të problemeve me stomakun e tij. Përkundër gjithë kësaj, ai arriti "të mbajë veten të pastër". Në këtë burg, kishte dhjetë dushe - të përshkruara nga ankuesi si tuba - në

bodrum për 250 deri 360 të burgosur të mbajtur në të njëjtin krah të burgut. Sipas përshtimeve të ankuesit kishte ujë të nxehtë për dy orë në ditë ose ndoshta pak më gjatë, nuk kishte perde dhe asnjë dritare. Ndërsa pas trazirave që kishin ndodhur, nuk kishte ujë të nxehtë.

Kushtet e vështira të të burgosurve, u konfirmuan edhe nga dëshmitarët, Spiros Athanassopoulos (administrator i burgut Koridallos), Vasiliki Fragathula (punëtore sociale në krahun Delta të burgut), Petros Papadimitriou (i burgosur), komisioni inspektues që e vizitoi burgun, dhe të gjeturat e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT), kur e vizitoi burgun me datë 29 nëntor 1994.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi u ankua se trajtimi i tij në burgun Koridallos ishte çnjerëzor dhe degradues, si dhe kushtet e burgut ishin gjithashtu përulëse dhe degraduese. Ankuesi deklaroi se ai kurrë nuk kishte kërkuar të vendosej në një zonë të izoluar/ segreguese të burgut, edhe pse Qeveria greke në fillim kishte deklaruar që ankuesi kishte bërë kërkesë të mbahej në zonën e izoluar/ segreguar. Ankuesi parashtron se atij nuk i ishin dhënë pajisjet bazike për mbijetesë në burg, si batanije, letër higjinike, detergjentë etj., kurse Qeveria Greke kishte mohuar që mbajtja e tij në burg përkonte me ndonjë mungesë respekti apo trajtimi çnjerëzor siç deklaronte ankuesi.

Po ashtu, ankuesi u ankua se, pavarësisht nga fakti që ai ishte i burgosur në paraburgim, ai i ishte nënshtruar të njëjtit regjim si të dënuarit. Ankuesi gjithashtu kishte deklaruar se autoritetet në burgun Koridallos kishin hapur letrat e dërguara në emër të tij shpeshherë pa praninë e tij. Qeveria Greke në anën tjetër deklaroi se letrat e dërguara për të burgosurit gjithmonë hapen në praninë e tyre. Ata gjithashtu pranuan se edhe letrat nga Komisioni ishin hapur. Me pak fjalë, ankuesi ankohej se i ishte trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe degraduese për shkak të kusheve shumë të këqija në burg duke pretenduar shkelje e Nenit 3), ishte trajtuar me të njëjtin regjim si të gjithë të burgosurit sa ishte në paraburgim që paraqet shkelje e Nenit 6 § 2, dhe se e drejta për privatësi i ishte cënuar kur iu kishin lexuar letrat/ korrespondenca duke shkelur kështu të drejtat e tij të mbrojtura nga Neni 8 i konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me shkeljen e Nenit 3 të Konventës, Gjykata rikujton që, sipas praktikës së saj gjyqësore, keqtrajtimi duhet të arrijë një nivel minimal të ashpërsisë nëse duhet të përfshihet në sferën e Nenit 3 të Konventës. Vlerësimi i këtij niveli minimal të ashpërsisë është relativ; varet nga të gjitha rrethanat e rastit, të tilla si kohëzgjatja e trajtimit, efektet e saj fizike dhe mendore dhe, në disa raste, gjinia, moshja dhe gjendja shëndetësore e viktimës.

Sa i përket çështjes në fjalë, Gjykata vëren në radhë të parë që, përkundër asaj që Qeveria argumenton, ankuesi nuk ishte vendosur në njësinë e segregacionit, e kërkesën e tij. Sipas dëshmisë së znj. Fragathula, kjo ishte një masë e vendosur nga administratori i burgut dhe kujdestari kryesor lidhur me gjendjen shëndetësore të ankuesit, më saktësisht për faktin se ai kishte vuajtur nga varësia e drogës. Sipas dëshmitarit të njëjtë, sapo kërkuesi u njoh me kushtet e paraburgimit në njësinë e

segregacionit, ai kërkoi një transferim. Më pas u ofrua mundësia për të shkuar në krahun e Delta, ku mhareshin të varurit nga droga. Edhe pse znj. Fragathula nuk pranonte shprehimisht se kishte droga në krahun e Delta, ajo deklaroi se "ky krah ishte problematik për dikë që donte të heqte dorë nga drogat". Gjykata konsideron se kjo nënkupton se ka pasur droga që qarkullojnë jashtëligjshëm në krahun e Deltës, një shkak për shqetësim serioz. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se ankuesi nuk mund të akuzohet për refuzimin për t'u zhvendosur nga njësia e segregacionit. Prandaj, Gjykata konsideron se ankuesi në asnjë mënyrë nuk pranoi të mbetej në njësinë e segregacionit të krahut të Delta.

Më pas Gjykata vlerësoi kushtet në burg siç janë madhësia e qelisë, numri i personave që ankuesi e ndante qelinë, kushtet higjienike, qasja në ujë dhe toalet, temperaturën e qelisë, të dhëna që u konfirmuan nga komisione të besueshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se në rastin në fjalë nuk ka dëshmi se ka pasur qëllim të poshtërimit të ankuesit nga ana e autoriteteve të burgut. Megjithatë, Gjykata mori në konsideratë veçanërisht se, për të paktën dy muaj, ankuesi duhej të kalonte një pjesë të konsiderueshme, 24 orë, i izoluar praktikisht në shtratin e tij të vogël në një qeli pa ventilim dhe pa dritare, ku ndonjëherë arrihej një temperaturë shumë e lartë dhe e padurueshme. Ankuesi gjithashtu i duhej ta përdorte tualetin në prani të një të burgosuri tjetër dhe të jetë i pranishëm, kur ai përdorej nga shokët e tij të qelisë. Gjykata është e mendimit se këto kushte të burgut ndikuan në zvogëlimin e dinjitetit njerëzor të ankuesit dhe i dhanë atij ndjenja të ankthit dhe inferioritetit, ashtu që e poshtëruan dhe degraduan atë duke shkelur rezistencën e tij fizike ose morale.

Duke marrë parasysh të gjitha faktet, dhe pas inspektimit të burgut, Gjykata konsideron se kushtet e burgut në zonën e segregacionit të krahut Delta ishin degraduese dhe poshtëruese për ankuesin, dhe se ankuesi nuk kishte kërkuar asnjëherë të vendosej në atë krah të burgut. Kështu që Gjykata këtu gjen shkelje të Nenit 3 të Konventës.

Lidhur me pretendimet për shkelje të Nenit 6 § 2 të Konventës, Gjykata rikujtoi se Konventa nuk përmban asnjë nen që parashikon trajtim të veçantë për të paraburgosurit në raport me të burgosurit e dënuar. Andaj Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të Nenit 6 § 2 të Konventës.

Lidhur me pretendimet për shkeljen e Nenit 8 të Konventës, Gjykata konsideron se nuk është vërtetuar se letrat e Komisionit drejtuar ankuesit janë hapur në mungesë të tij. Megjithatë, Qeveria pranon se këto letra janë hapur në prani të të burgosurit në fjalë. Prandaj, ka pasur ndërhyrje në të drejtën e ankuesit për respektimin e korrespondencës së tij sipas Nenit 8 të Konventës, ndërhyrje që sipas Gjykatës është e justifikueshme vetëm nëse plotësohen kushtet e paragrafit 2 të Nenit 8.

Në veçanti, nëse nuk është në kundërshtim me Nenin 8 § 2, ndërhyrja e tillë duhet të jetë "në përputhje me ligjin", të ndjekë një qëllim legjitim dhe të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike për të arritur këtë qëllim. Në këtë rast, ndërhyrja kishte bazë ligjore, domethënë Nenin 51 §§ 2 dhe 3 të Kodit të Burgjeve, dhe Gjykata është e bindur që ajo ka ndjekur qëllimin legjitim të "parandalimit të çrregullimit të rendit apo krimin". Sa i përket "domosdoshmërisë së ndërhyrjes", Gjykata nuk gjen arsye të domosdoshme për monitorimin e korrespondencës përkatëse, konfidencialiteti i të cilës është e rëndësishme për t'u respektuar. Megjithëse qeveria ka aluduar në përgjithësi për mundësinë e kontrabandimit të materialeve/drogave të ndaluara në burg përmes

korrespondencës me zarfe, Gjykata konsideron, se ky rrezik është aq i papërfillshëm sa nuk duhet të merret parasysh. Prandaj, ndërhyrja e ankuesit nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike në kuptim të Nenit 8 § 2 të Konventës dhe rrjedhimisht ka pasur shkelje të Nenit 8.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 3 dhe Nenit 8 të Konventës; ndërsa gjen se se nuk ka shkelje të Nenit 6 § 2 të Konventës [njëzëri].

Milić dhe Nikezić kundër Malit të Zi - 54999/10; 10609/11

28 prill 2015 [Seksioni i Dytë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3

Keqtrajtim dhe torturë nga rojet e burgut gjatë periudhës së paraburgimit/ *ka shkelje*.

Neni 13

Mungesa e një hetimi efektiv në lidhje me ankesën për torturën dhe keqtrajtimin e ushtruar */nuk ka nevojë të shqyrtohet*.

Fjalët kyçe: keqtrajtim / rezistencë / forcë e tepruar / roje burgu / hetim joefektiv / masë e domosdoshme / autoritet shtetëror

Ankuesit: z. Igor Milić (ankuesi i parë) dhe z. Dalibor Nikezić (ankuesi i dytë), shtetas malazezë

Faktet e rastit

Të ndaluar në Institucionin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, ankuesit pohojnë se më 27 tetor 2009 kur qelia e tyre duhej të kontrollohej për shkak të transferimit të ardhshëm në një njësi disiplinore të z. Milić, disa roje hynë në qeli, e kapën e prangosën, dhe e rrahën atë me shkopinj gome dhe me grushte. Ankuesi i parë parashtrroi se pas hyrjes në qelinë e tij, disa roje e kishin kapur dhe e kishin hedhur në dyshtemenë prej betoni në korridor jashtë qelië dhe e kishin rrahur duke përdorur shkopinj dhe grushtat e tyre. Përveç kësaj, dy rreshta të rojeve të pozicionuar përgjatë korridorit e kishin rrahur atë ndërsa ai ishte duke u larguar. Ankuesi i dytë pohoi se kishte protestuar kundër këtij abuzimi. Në përgjigje, katër roje kishin filluar të godisnin dhe e kishin rrahur me grushta dhe shkopinj. Pas kësaj ai ishte marrë në korridor jashtë qelisë, ku tetë roje të tjera kishin vazhduar ta rrihnin dhe rrahja kishte vazhduar pasi ai ishte kthyer në qeli. Ankuesi i parë më pas refuzoi të shihte një mjek, por ankuesi i dytë u ekzaminua nga një mjek i jashtëm i cili raportoi se kishte shenja në këmbën e tij të majtë dhe rreth syve të tij.

Qeveria parashtrroi një verzion tjetër të ngjarjeve, duke argumentuar se se rojet e burgut kishin qenë të detyruar të përdorin forcën kundër ankuesëve për shkak të rezistencës së tyre për të hyrë në qelinë e ankuesëve. Sipas Qeverisë ankuesi i dytë në veçanti ka sulmuar dhe plagosur një nga rojet. Nën atë ankuesëve, duke vënë re se djemtë e tyre u plagosën parashtruan ankesa kriminale, si pasojë dhe Prokurori i Shtetit kërkoi nga gjykatat vendase që të hetonin. Gjykatësi hetues pastaj kërkoi që rojet e burgut të përfshira në incident të identifikoheshin, që ankuesit të kenë një ekzaminim mjekësor, që një video-regjistrim të dorëzohet dhe gjithashtu të dëgjohen prova nga ankuesit, rojet e burgut dhe të paraburgosurit që ndanë qelinë me ankuesit. Mbi bazën e atyre gjetjeve Prokurori i Shtetit hodhi poshtë ankesat penale në shkurt dhe më pas në Tetor të vitit 2010. Ai arriti në përfundimin se rojet e burgut përdorën forcën, duke i goditur

ankuesit me shkopinj gome, për të kapërcyer rezistencën e tyre dhe për këtë arsye kishin vepruar brenda autoriteteve të tyre.

Ndërkohë në mars të vitit 2010, Zëvendës Avokati i Popullit, i kishte vizituar ankuesit në burg dhe bazuar në lëndimet e vërejtura, kërkoi nga administrata e burgut që të ndërmerren hetime për incidentin, duke dyshuar se kishte pasur përdorim të tepruar të forcës. Në një mendim të datës 29 mars 2010, Avokati i Popullit konstatoi se të drejtat e ankuesve ishin shkelur më 27 tetor 2009. Në raport thuhej se te burgosurit nuk kishin bërë rezistencë dhe se nuk kishte pasur asnjë justifikim për përdorimin e forcës së tepruar, sidomos jo në masën dhe në mënyrën e bërë. Në të njëjtën kohë Avokati i Popullit rekomandoi që autoritetet e burgut të ndërmarrin procedurat disiplinore kundër rojeve përgjegjëse dhe të i raportojnë Avokatit të Popullit brenda 20 ditëve për masat e marra. Më 1 prill 2010 janë ngritur procedura disiplinore kundër tre rojeve të burgut, I.M., I.B. dhe R.T ku si rezultat i të cilave ata u gjetën përgjegjës dhe ishin gjobitur me 20% të pagave të tyre për abuzimin pozitës ose tejkalimin e autoritetit të tyre pasi që ata kishin përdorur forcë të tepruar joproporcionale ndaj rezistencës së ofruar nga ankuesit më 27 tetor 2009. Familjet e ankuesve dhe Avokati i Popullit ishin të informuar për rezultatin e procedurave disiplinore dhe avokati i ankuesve mori pjesë në seancën para komisionit disiplinor. Ankuesit gjithashtu parashtuan kërkesë për kompensim në gjykatat civile. Si rezultat i këtyre procedurave në tetor 2014 Gjykata Supreme gjeti që përdorimi i forcës nga rojet nuk mund të justifikohet me rezistencën e ankuesve dhe se ato veprime kishin degraduar dinjitetin njerëzor në këtë rast dinjitetin e ankuesve dhe si rezultat kërkoi që t'u paguhen 1.500 EUR secilit ankues për dëmin jo-material.

Përmbledhje e pretendimeve

Duke u bazuar në Nenin 3 dhe Nenin 13 të Konventës ankuesit pretenduan se ishin keqtrajtuar nga rojet e burgut më 27 Tetor 2009 dhe se hetimet pasuese në ankesat e tyre kanë qenë joefektive. Qeveria nuk kundërshtoi që rojet e burgut kishin përdorur forcë të tepruar, e cila nuk ishte proporcionale me masat që duhej të ishin zbatuar. Megjithatë, ata pohonin se përdorimi i forcës ishte i justifikuar pasi qëllimi i saj ishte të tejkalonte rezistencën e ankuesve dhe prandaj nuk përbëjnë torturë ose trajtim çnjerëzor dhe degradues. Qeveria më tej parashtroi se ankuesve nuk u ishte mohuar kurrë ndihma mjekësore, dhe se vetë ankuesi i parë ka refuzuar ndihmë mjekësore. Andaj Qeveria pretendoi se nuk ka pasur shkelje në këtë drejtim.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet e Qeverisë se ankuesit kishin dështuar të shteronin mjetet juridike efektive të brendshme, në veçanti, procedurat civile që kishin iniciuar dhe nëpërmjet të cilave ata mund të merrnin kompensim për shkeljet e mundshme të të drejtave të tyre. Gjykata përseriti se qëllimi i Nenit 35 është t'u ofrojë Shteteve Kontraktuese mundësinë e parandalimit ose vendosjes së drejtësisë për shkeljet e pretenduara kundër tyre para se këto pretendime të dorëzohen në institucionet e Konventës. Duke u kthyer tek rasti në fjalë, Gjykata vëren se ankuesit parashtuan një kërkesë për kompensim dhe se procedurat u përfunduan në Tetor 2014. Ndërkohë që kërkesa për shterim të mjeteve juridike të brendshme normalisht përcaktohen duke iu

referuar datës në të cilën kërkesa është parashtruar në Gjykatë, porse faza e fundit e mjeteve të tilla mund të arrihet edhe pas paraqitjes së kërkesës, por para se Gjykata të përcaktojë çështjen e pranueshmërisë. Andaj duke supozuar se një kërkesë për kompensim në procedurat civile mund të konsiderohet mjet i brendshëm efektiv për ankesat nën aspektin thelbësor të Nenit 3 të Konventës, Gjykata vëren se ankuesit në rastin aktual kanë shteruar mjetet juridike të propozuara nga Qeveria. Prandaj, parashtrimi i Qeverisë në lidhje me mos shterrjen e mjeteve të mbrendhme juridike hidhet poshtë.

Tutje në shqyrtimin nëse ankuesit mund të pretendojnë të jenë viktimat të shkeljes së supozuar, Gjykata vëren se gjykatat vendase kanë vendosur pjesërisht në favor të ankuesëve, duke i dhënë atyre dëmshpërblim. Sidoqoftë, Gjykata vëren se edhe pse Gjykata Supreme i referohej veprimeve të kundërshtuara të rojeve si shkelje e dinjitetit njerëzor e trajtim degradues, ajo nuk pranoi shkeljen e të drejtave të ankuesëve në mënyrë të qartë si do të ishte e nevojshme në këtë lloj të rasteve. Andaj Gjykata është e mendimit se kompensimi prej 1,500 EUR i dhënë ankuesëve në lidhje me dëmin jomaterial, nuk mund të konsiderohet një zhdëmtim i duhur për shkeljet e pretenduara. Duke pasur parasysh këto, Gjykata konsideron se statusi i ankuesëve si "viktimat" brenda kuptimit të Nenit 34 të Konventës është i paprekur.

Në lidhje me shkeljen e pretenduara të Nenit 3, përkatësisht lidhur me keqtrajtimin dhe mungesën e hetimit të pretenduar nga ankuesit, Gjykata fillimisht thekson se personat në paraburgim janë në një pozitë të lëndueshme dhe se autoritetet janë nën një detyrë për të mbrojtur mirëqenien e tyre fizike. Përderisa pranon se përdorimi i forcës mund të jetë i nevojshëm me rastin e sigurimit të sigurisë së burgjeve, ruajtjes së rendit ose parandalimit të krimit, Gjykata thekson semforca e tillë mund të përdoret vetëm nëse është e domosdoshme dhe duhet të mos jetë e tepruar. Çdo rekurs për forcën fizike që nuk është bërë rreptësisht nga rrethanat e nevojshme të shkaktuara nga vetë sjellja e të paraburgosurit zvogëlon dinjitetin njerëzor dhe në parim është një shkelje e Nenit 3 të Konventës.¹⁷ Në rastin aktual, Gjykata vëren se organet e brendshme vërtetojnë se rojet e burgut kishin goditur ankuesit me një shkop gome, dhe se ankuesi i parë kishte refuzuar të ekzaminohej nga një mjek, ndërsa lëndimet e ankuesit të dytë u konfirmuan nga një mjek i jashtëm. Për më tepër, gjykatat vendase pranuan se përdorimi i forcës kishte qenë i tepruar, siç pranohet edhe nga Qeveria. Duke marrë parasysh veprimet specifike të përshkruara dhe të vendosur në procedurat e brendshme, si dhe lëndimet e vërejtura në raportet mjekësore, Gjykata konstaton se pragu i Nenit 3 është arritur dhe konsideron se ka pasur një shkelje substanciale të Nenit 3 të Konventës në lidhje me të dy ankuesit.

Sa i përket aspektit procedural të Nenit 3 Qeveria pretendon se ankuesit nuk kanë shtërur mjetet juridike të brendshme, përfshirë këtu edhe mos ngritjen e ankesës pranë Gjykatës Kushtetuese. Gjykata rikujton se aty ku keqtrajtimi i pretenduar është kryer nga Zyrtari shtetëror, Neni 3 kërkon që të kryhet një hetim zyrtar, andaj ankuesit nuk janë të detyruar personalisht të fillojnë një ndjekje plotësuese. Tek rasti në fjalë, Gjykata vëren se keqtrajtimi i supozuar ishte kryer nga rojet e burgut, domethënë nga zyrtarët shtetërorë. Ankuesit, nga ana e tyre, kishin sjellë ankesa penale në lidhje me

¹⁷ *Kopylov kundër Rusisë*, nr. 3933/04, § 157, 29 Dhjetor 2010

ngjarjet e ankimuar, dhe kështu i dhanë Shtetit një mundësi për të zhdëmtuar dëmin e bërë. Prandaj ata nuk ishin të detyruar të iniciojnë procedura te tjera. Përveç kësaj Gjykata konsideroi se, vendimet gjyqësore të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Lartë të datës 18 mars dhe 13 qershor 2011, dëshmojnë se ankuesit kanë shtetur mjetet juridike të mjaftueshme e për këtë ata nuk kishin asnjë detyrim për të parashtruar ankesë kushtetuese. Si pasojë, Gjykata konsideron se qendrimi i Qeverisë duhet të hidhet poshtë.

Lidhur me pretendimet e ankuesve për mungesën e një hetimi efektiv zyrtar të incidentit, Gjykata rikujtoi se praktiken gjyqësore në lidhje me rastet kur një individ bën një pohim të besueshëm se ai ka pësuar keqtrajtim në duart e policisë ose agentëve të Shtetit që shkelin Nenin 3, është detyra e autoriteteve kombëtare të ndërmarrin një hetim zyrtar efektiv.¹⁸ Hetimi duhet të jetë i plotë, i shpejtë dhe i pavarur.¹⁹ Në rastin aktual, Gjykata vëren se, nënat e ankuesëve kishin parashtruar ankesa penale në lidhje me ngjarjet e 29 tetorit 2009, si pasojë Prokurori i Shtetit kërkoi nga Gjykata e Shkallës së Parë të hetojnë ankesat. Menjëherë pas kësaj, Gjykata e Shkallës së Parë nga ana e saj, ndërmori një numër veprimesh: ajo kërkoi identifikimin e rojeve të burgut të përfshirë, ekzaminimi mjekësor të ankuesëve, dorëzimin e video-regjistrimit përkatës, dhe dëgjoi prova nga një numër individësh, duke përfshirë edhe ankuesit, rojet e burgut dhe të paraburgosurit që ndanë qelinë me ankuesit. Në bazë të gjetjeve të hetimit, prokurori i shtetit e hodhi poshtë ankesat penale, duke konkluduar se rojet e burgut kishin përdorur me të vërtetë forcë por e kishin bërë këtë në mënyrë që të tejkalojnë rezistencën e ankuesëve dhe kishin vepruar kështu brenda kompetencave të tyre. Sa i përket efektivitetit të hetimit penal, Gjykata kujton se Qeveria nuk e ka kundërshtuar pretendimin e ankuesve se Prokurori i Shtetit nuk ka marrë parasysh të gjitha dëshmitë relevante si video-regjistrimet e korridorit të burgut në kohën në fjalë. Për më tepër, shqyrtimi i rastit për herën e dytë nga Prokurori i Shtetit, më 19 tetor 2010, u bë vetëm pasi Avokati i Popullit kishte dhënë mendimin e tij për këtë çështje me 29 mars 2010, duke gjetur se kishte forcë të tepruar. Andaj Gjykata konsideron që vendimet e Prokurorit të Shtetit të që të ndërpres procedurat penale nuk janë bazuar në një vlerësimin adekuat të të gjitha elementeve relevante faktike duke marrë parasysh gjetjet e fakteve të përcaktuara nga Avokati i Popullit dhe në procedurat disiplinore. Duke pasur parasysh këto te gjetura, Gjykata konsideron se ka pasur shkelje të aspektit procedurale të Nenit 3 të Konventës në lidhje me të dy ankuesit.

Ankuesit gjithashtu u ankuan sipas Nenit 13 të Konventës se nuk kishte pasur hetime zyrtare efektive mbi ngjarjet e 27 tetorit 2009. Duke pasur parasysh konstatimin lidhur me pretendimet sipas Nenit 3 në këtë drejtim, Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohet pranueshmëria ose bazueshmërinë e të njëjtitave sipas Nenit 13.

Lidhur me dëmet e pretenduara, Gjykata u shpreh se Mali i Zi do t'u paguante aplikuesve 4,350 EUR për dëmet jo-materiale. Më tej Gjykata kërkoi q për shpenzimet ankuesve tu paguheshin vlerat 3.520 EUR për ankuesin e parë dhe 1.160 EUR për ankuesin e dytë.

¹⁸ *Labita kundër Italisë* [DhM], nr. 26772/95, § 131, KEDNJ 2000-IV

¹⁹ *Jasar kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 69908/01, §§ 56-57, 15 shkurt 2007

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen shkelje të aspektit substancial dhe përmbajtësore të Nenit 3 të Konventës, ndërsa konsideron të panevojshme të shqyrtoj pretendimet për shkelje të Nenin 13 të Konventës [njëzëri].

X dhe Y kundër Holandës - 8978/80

26 mars 1985 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3 si i vetëm dhe marrë së bashku me Nenin 14

Trajtim çnjerëzor dhe degradues i të miturës / e panevojshme për shqyrtim duke pasur parasysh gjetjet për sa i përket Nenin 8

Neni 8

Shkelje e të drejtës në jetë familjare nga pamundësia e prindit për të filluar ndjekje penale kundër autorit të dhunës seksuale ndaj një minorene të moshës mbi gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe të sëmurë mendore / ka shkelje

Neni 13

Mungesë e mjeteve efektive juridike / e panevojshme për shqyrtim duke pasur parasysh gjetjet për sa i përket Nenin 8

Neni 14 marrë së bashku me Nenin 8

Trajtim diskriminues nga legjislacioni për disa kategori/ e panevojshme për shqyrtim

Fjalët kyçe: abuzim seksual / paaftësi mendore / e mitur / mungesë zotësie / pamundësi e ushtrimit të padisë / e drejta në jetë private familjare / mbrojtje nga shteti

Ankuesit: z. X, në emër të tij dhe të së bijës së tij, Y. që të dy shtetas holandez, kanë kërkuar që identiteti i tyre të mos zbulohet

Faktet e rastit

Znj. Y e lindur më 13 dhjetor 1961, duke qenë se vuante nga një sëmundje mendore, nga viti 1970 ka jetuar në një shtëpi private për fëmijë me të meta. Gjatës natës së 14 dhe 15 dhjetori 1977, zonjusha Y ishte zgjuar nga z. B., dhëndëri i drejtorit të shtëpisë. Ai jetonte me gruan e tij në godinën e shtëpisë, ndonëse nuk ishte i punësuar aty. Z. B. e kishte detyruar atë që ta ndiqte për në dhomën e tij dhe e kishte abuzuar seksualisht. Më 16 dhjetor 1977, X., babai i zonjushës Y., paraqitet në stacion policor për të denoncuar rastin dhe nisur procedurat penale. z. X e kishte bërë këtë duke përdorur autoritetin prindëror për shkak se e bija, përveç se ishte e moshës 16 vjeçe, nuk kishte aftësinë mendore për të vepruar në emër të saj.

Më 29 maj 1978, zyra e prokurorit publik vendosë që të mos fillojë ndjekje penale ndaj B., nëse ai nuk do të kryente një veprë të ngjashme brenda dy viteve në vijim. Zyrtari përgjegjës i rastit e informon z. X në një takim më 27 shtator 1978.

Më 4 dhjetor 1978, z. X vendosë që të apelojë vendimin e prokurorit publik në Gjykatën e Apelit të Arnheimit mbi bazën e Kodit të Procedurës Penale; ai kishte kërkuar nga Gjykata që të urdhëronte fillimin e procedurave penale. Më 12 korrik 1979, Gjykata e Apelit në Arnhem e hedh poshtë ankesën e X kundër vendimit të prokurorit publik. Kjo me arsyetimin se Neni 248 i Kodit Penal, që ndalonte aktet e

tilla, nuk gjente zbatim përveç nëse këtë e kërkonte vetë viktimi. Në këtë rast, sipas Gjykatës së Apelit, ankesa e prindit nuk e zëvendësonte atë çka Y do të duhej ta kishte paraqitur në qoftë se do të kishte mundur, gjë të cilën ajo nuk e ka bërë. Policia, gjithashtu, e ka vlerësuar atë si të paaftë për ta bërë një të tillë. Dhe pasi në rastin konkret nuk kishte asnjë person ligjërisht të autorizuar që mund ta bënte këtë, mund të thuhet që në këtë pikë ekzistonte një zbrazëti në ligj.

Në bazë të Nenit 445 të Kodit të Procedure Penale të Holandës, nuk kishte mundësi apelimi për çështje ligji pranë Gjykatës Supreme (Hoge Raad) kundër këtij vendimi.

Përmbledhje e pretendimeve

Pretendimi i ankuesve ishte se pamundësia për të inicuar ndjekje penale kundër z. B është në kundërshtim me Nenin 8 të Konventës që garanton të drejtën e respektimit të jetës së tyre private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij të nen ky që ndër të tjera parasheh se ‘Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.’

Qeveria ka kundërshtuar këtë pretendim. Sipas ankuesve, për një vajzë të re si zonjusha Y, shkalla e kërkuar e mbrojtjes kundër keqëbërjes do të ishte ofruar vetëm përmes mjeteve të së drejtës penale. Nga ana tjetër, sipas pikëpamjes së Qeverisë, Konventa u ka lënë shteteve veç e veç që të vendosin për mjetet që do të përdoren dhe nuk e ndalon atë që të zgjedhë dispozitat e të drejtës civile.

Ankuesit, nga ana e tyre, kanë vlerësuar se mjetet e të drejtës civile janë të papërshtatshme për rastin konkret. Sipas Qeverisë, ndërkaq, ka qenë natyra e jashtëzakonshme e fakteve që ka shpalosur një boshllëk në ligj dhe se nuk mund të thuhet ka pas ndonjë dështim nga ana e legjislativit. Ankuesit, gjithashtu, kanë pretenduar se dallimi në trajtim i përcaktuar nga legjislativi ndërmjet kategorive të ndryshme të personave që kanë nevojë për kujdes të posaçëm kundër sulmeve seksuale, përbën shkelje të Nenit 14 të Konventës.

Më tej, sipas ankuesve, zonjusha Y është trajtuar nga z. B në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruese, në kundërshtim me Nenin 3 të Konventës. Ata kanë argumentuar se, për qëllime të kësaj dispozite, shteti ishte në rrethana të caktuara përgjegjës për veprimet e palëve të treta dhe se trauma kronike psikologjike që i ishte shkaktuar zonjushës Y ishte e një shkalle që hynte në kuadër të Nenit 3. Qeveria, nga ana e saj, në seancat dëgjimore, ka paraqitur qëndrimin se nuk është përgjegjëse për trajtimin që i është shkaktuar zonjushës Y.

Tutje, ankuesit pretendonin se nuk kanë pas mjete efektive juridike në Holandë të kërkuara nga Nenit 13 për ankesat e zonjushës Y.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata rikujton se ndonëse objekti i Nenit 8 të Konventës është në thelb mbrojtja e individit nga ndërhyrja arbitrare e autoriteteve publike, kjo thjesht nuk e detyron shtetin që vetëm të abstenojë nga kjo ndërhyrje. Përveç kësaj ndërmarrjeje në radhë të parë negative, mund të ketë edhe detyrime pozitive të pranishme në respektimin efektiv të jetës private ose familjare. Këto detyrime mund të përfshijnë miratimin e masave të

krijuara për të siguruar respektimin e jetës private, qoftë edhe në sferën e marrëdhënieve ndërmjet vetë individëve.

Gjykata vëren se zgjedhja e mjeteve të llogaritura për të siguruar pajtueshmëri me Nenin 8 në sferën e marrëdhënieve ndërmjet individëve, në parim, është çështje që bie brenda hapësirës së vlerësimit të shteteve kontraktuese të Konventës. Në këtë kuptim, ka mënyra të ndryshme të të siguruarit për respektimin e jetës private dhe karakteri i detyrimit të shtetit do të varej nga aspekti i posaçëm i jetës private që është në pyetje. Rregullimi përmes të drejtës penale nuk është patjetër përgjigjja e vetme.

Sidoqoftë, në rastin konkret, Gjykata gjen se mbrojtja e ofruar nga e drejta civile në rastin e keqbërjes së shkaktoar në rastin e zonjushës Y është e pamjaftueshme. Ky është një rast ku janë në pyetje vlerat themelore dhe aspektet thelbësore të jetës private. Frenimi efektiv është i patjetërsueshëm në këtë fushë dhe ky mund të arrihet vetëm përmes dispozitave penale; në të vërtetë, kjo çështje është normalisht e rregulluar me dispozita të kësaj natyre. Dhe në fakt kjo është një fushë ku Holanda në përgjithësi ka zgjedhur një sistem të mbrojtjes të mbështetur në të drejtën penale. Boshllëku i vetëm, për aq sa Komisioni dhe më pas Gjykata janë në dijeni, ka të bëjë me personat në të njëjtën situatë me atë të zonjushës Y. Sipas Gjykatës, asnjëra prej dispozitave relevante të Kodit Penal Holandez nuk i kanë ofruar zonjushës Y mbrojtje praktike dhe efektive. Kësisoj, Gjykata vjen në përfundimin se, marrë parasysh natyrën e keqbërjes në këtë rast, zonjusha Y ka qenë viktimë e shkeljes së Nenit 8 të Konventës. Andaj Gjykata gjen shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Ndryshe, sa i përket Nenit 14 marrë së bashku me Nenin 8, Gjykata ka vërejtur se nuk ka ekzistencë të pavarur; përbën një element të veçantë (mos-diskriminimi) të secilës prej të drejtave të mbrojtura nga Konventa. Dhe se shqyrtimi i rastit sipas Nenit 14 marrë së bashku me Nenin 8 nuk është përgjithësisht i kërkuar kur Gjykata gjen shkelje të një neni paraprakisht.

Sa i përket Nenit 3, Gjykata thekson se, pasi ka gjetur tashmë shkelje të Nenit 8, nuk konsideron që është e nevojshme që të shqyrtojë rastin edhe në bazë të kësaj dispozite, qoftë si të ndarë apo në ndërlidhje me Nenin 14.

Në lidhje me pretendimet e ankuesve për shkelje të Nenit 13, Gjykata, duke qenë se gjetja që nuk kishte mjete të duhura efektive juridike ishte një prej faktorëve të përcaktimit se ka shkelje të Nenit 8, nuk e pa të nevojshme që të shqyrtojë çështjen mbi bazën e Nenit 13.

Sa i përket dëmshpërblimit, Gjykata i akordoi zonjushës Y tre mijë (3000) florinta holandeze për dëm moral.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 8 në lidhje me zonjushën Y dhe nuk e sheh të nevojshme që të japë vendime të ndara në ankesat e tjera të saj dhe të z. X. [njëzëri].

Tali kundër Estonisë - 66393/10

13 maj 2014 [Seksioni i Parë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3

Trajtim degradues si pasojë e përdorimit të forcës së tepërt dhe masave restriktive gjatë qëndrimit në burg / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *i burgosur / rrezikshmëri / rezistencë / masa mbrojtëse / sprej / forcë e tepërt / autoritete / roje burgu / burgim i përjetshëm*

Ankuesi: z. Andrei Tali, shtetas Estonez

Faktet e rastit

Ankuesi ka lindur më 1977, në kohën e procedurave para Gjykatës Evropiane së të Drejtave të Njeriut vuante dënimin e përjetshëm në burg, për vrasjen e dy personave dhe tentim të therrjes së një personi tjetër. Po ashtu, ai kishte një varg akuzash për sulm ndaj oficerëve të burgut dhe të burgosurve të tjerë. Për më shumë një numër i madh i masave disiplinore janë shqiptuar ndaj tij, duke përfshirë mosbindjen ndaj urdhërave dhe kërcënimit e zyrtarëve të burgut. Prandaj, ankuesi është cilësuar si person i rrezikshëm.

Me 3 korrik 2009, ankuesi është urdhëruar nga roja e burgut me inicialet KA, që të transferohet në qeli atë mbrëmje ashtu që të vuajë dënimin disiplinor. Ankuesi kishte refuzuar urdhërin, në bazë të arsyetimit se priste vendimin e Ministrit të Drejtësisë lidhur e ankesën e tij. Roja KA e kërcënoi se nëse nuk i bindet urdhërit, do të dërgohet me forcë. Në orën 17:45 në po të njëjtën ditë, garda KA, erdhi sërish me dy roje të tjera në qelinë e ankuesit dhe e morrën me forcë, duke ushtruar shtypje mbi të me një mburojë plastike, përderisa kishin të veshura helmata dhe xhaketa, duke i shkaktuar vështirësi në frymëmarrje. Të njëjtit e kishin shtrirë ankuesin në dysheme, duke ia vendosur prangat dhe shqelmuar aq fort në brinjë, sa që ankuesi kishte ndërjet se si një bri i ishte thyer. Sipas rojeve të burgut, ankuesi u përpoq t'i godiste ata dhe ishte përleshur me KA, gjatë së cilës përleshje roja kishte pësuar lëndime të vogla. Ata mohuan se e kishin shqelmuar apo ngulfatur ankuesin dhe pohuan se ankuesi i kishte kërcënuar se do t'i vriste një nga një.

Me 4 korrik 2009, në ora 06:45, ankuesi u informua se duhet t'i bëhej një fotografim me rreze X, sepse sipas njërit nga rojet e burgut, një bri i tij është thyer, dhe se duhet të lidhej në shtrat. Në ora 8:30, gjashtë roje erdhën në qeli, dy hynë brenda dhe katër të tjerë qëndruan jashtë. Sipas ankuesit njëri nga rojet i shtrëngoi njëren dorë dhe duke i thënë se do t'ia heqin dyshekun nga qelia, si dhe papritur e spërkatën në fytyrë me sprej djegës, prandaj ankuesi vrapoi jashtë qelisë duke e mbuluar fytyrën me duar. Pastaj rojet e prangosën dhe e goditën në shpinë me shkop teleskopik. Sipas ankuesit, ai ishte alivanosur disa herë, sepse brinja e cila i ishte thyer i shkaktonte dhimbje jashtëzakonisht të mëdha. Pas prangosjes, ankuesi u lidh për shtrati me urdhër të njërit prej rojeve në detyrë me justikimin se përbënte rrezik dhe ishte agresiv. Sipas ankuesit,

ai po ngulfatej nga spreji djegës kur rojet e lidhën në shtrat, dhe nuk e lanë të pështynjë. Më në fund, iu lejua të pështyj dhe ia dhanë ujin që e kishte kërkuar.

Sipas certifikatave mjekësore, të 4 korrikut 2009, ankuesi ishte ekzaminuar nga asistentja medicinale në ora 08:50 dhe 12:20 pas lirimit të tij nga shtrati ku mbahej i lidhur. Në certifikatë shkruhej se ankuesi nuk ka shenja të lëndimeve të dukshme prandaj nuk kishte nevojë për asistencë me medikamente. Më 4 korrik iu bë edhe ekzaminimi me rreze X, i cili nuk zbuloi ndonjë ndryshim traumatik. Sipas certifikatës ekzistonin tri hematome, në shpinë, në dorë dhe në bri.

Më 7 korrik 2009, Departamenti i Burgut i Ministrisë së Drejtësisë filloi hetimet penale lidhur me pretendimet e ankuesit për abuzim të autoritetit nga rojet e burgut. Më 15 qershor 2010, hetuesi policor ndërpreu procedurat penale, duke konsideruar se përdorimi i forcës nga gardat e burgut ka qenë forcë e përdorur në mënyrë legjitime. Po ashtu, edhe Zyra e Prokurorit të Shtetit refuzoi kërkesën e ankuesit, pasi konsideroi se përdorimi i forcës, pajisjet e veçanta dhe mjetet për ndalim janë përdorur për shkak të sjelljes së ankuesit, apo thënë më mirë dështimit të tij që të pajtohet me urdhërat që i janë dhënë dhe për shkak të agresivitetit fizik dhe verbal drejtuar zyrtarëve të burgut. Po ashtu përdorimi i sprejit djegës arsyetohet sepse ankuesi konsiderohet se ka qenë pjesë e sulmit të paligjshëm, ndërsa vrapimi i tij jashtë qelisë mundë të kishte shkaktuar trazira tjera jashtë kontrollit të burgut, dhe ka pasë arsye të besohet se aplikuesi do të vazhdonte t'i sulmonte. Më 21 tetor Gjykata e Apelit, refuzoi ankesën e ankuesit kundër vendimit të Zyrës së Prokurorit të Shtetit.

Tutje më 6 gusht 2009 ankuesi paraqiti kërkesë për zhdëmtim material për trajtim çnjerëzor dhe degradues në gjykatën administrative. Kjo gjykatë gjeti se dështimi i ankuesit të bindet me rregullat e dhëna ndaj tij kanë shkaktuar padyshim kërcënim për sigurinë e përgjithshme të burgut, edhe pse prangosja nuk u arsyetua pasi që nuk ka pasë dëshmi se ankuesi ka qenë i pajisur me mjete të rrezikshme apo që ka pasë indicie se ai do të arratiset nga burgu. Megjithatë, ata përjashtuan kërkesën e ankuesit për kompensim, duke konsideruar se përdorimi i mjeteve për ndalim janë përdorur proporcionalisht me sjelljet e aplikuesit. Po ashtu, edhe Gjykata e Apelit e edhe ajo Supreme konsideruan se nuk ekziston ndonjë shkelje për shkak se ankuesi ka refuzuar të sillet sipas rregullave dhe nuk u gjet se ka pasur jo proporcionalitet në mes mjeteve të përdorura dhe sjelljeve të ankuesit.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi argumenton se ka qenë i keqtrajtuar nga zyrtarët e burgut në shkallë të torturës. Sipas tij, përdorimi i prangosjes, shkopit teleskopik, sprejit të djegës dhe shtratit shtrëngues nga ana e zyrtarëve të burgut si sanksion për shkaktimin e një incidenti, ka qenë i tëri jo proporcional. Ai po ashtu ka deklaruar se ka qenë i rrahur, i shqelmuar dhe si rezultat ai ka pësuar dhimbje intenzive. Sipas ankuesit, ai ka qenë i traumatizuar nga kjo përvojë dhe ka vuajtur nga ndjenja e pasigurisë dhe ndjenja e pashpresës, duke pretenduar kështu shkelje të Nenit 3 të konventës.

Sipas Qeverisë, ankuesi ka refuzuar t'i u bindet urdhërave në mënyrë që ta dorëzojë dyshekun, andaj edhe ka përdorë forcë fizike për rezistencë. Është konsideruar e papranueshme të lejohet një situatë ku i burgosuri nuk i bindet zyrtarit kur ai jep urdhër të ligjshëm. Qeveria po ashtu konsideron se personaliteti, sjellja paraprake dhe

rrezikshmëria e shprehur do të duhej të merreshin parasysish. Qeveria argumenton se ankuesi është i dënuar me burg të përjetshëm për vrasje brutale të dy personave dhe tentim vrasje të personit të tretë. Sipas tyre, ankuesi ka vazhduar të kryejë krime, ndaj zyrtarëve të burgut dhe të tjerëve. Prandaj sipas sjelljes së tij, ankuesi konsiderohet i burgosur i rrezikshmërisë së lartë.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata e ka potencuar në shumë raste se Neni 3 i Konventës ndërthet në vete një nga vlerat më themelore të shoqërisë demokratike. Konventa e ndalon absolutisht torturën, trajtimin çnjerëzor dhe degradues apo edhe dënimin pavarësisht nga rrethanat e sjelljes së viktimës. Keqtrajtimi duhet të ketë një nivel minimal të ashpërsisë ashtu që të jetë shkelje e Neni 3 të Konventës. Vlerësimi i këtij niveli minimal të ashpërsisë është relativ: varet nga të gjitha rrethanat e rastit, siç është koha e zgjatjes së trajtimit, efektet fizike dhe psikologjike, në disa raste edhe gjinia, mosha dhe shëndeti i viktimës. Sipas Gjykatës trajtimi konsiderohet si “çnjerëzor” nëse është aplikuar për orë të tëra dhe ka shkaktuar lëndim aktual trupor apo vuajtje intensive fizike apo mentale, kurse “degradues” nëse ka nxitur tek viktima ndjenjën e frikës, ankthin dhe kapacitetin inferior për zhvleftësim dhe nënshtrim.

Gjykata vëren se normalisht prangosja apo përdorimi i instrumenteve të shtrëngimit bie jashtë sferës së Neni 3 të Konventës, kur masat merren në lidhje me mbajtjen ligjore dhe nuk përfshihet përdorimi i forcës apo ekspozimit publik, që tejkalon atë çka konsiderohet e domosdoshme. Tutje Gjykata ka në konsideratë potencialin për dhunë që ekziston në institucionet penale apo faktin e mos-dëgjueshmërisë nga të burgosurit që mund të nxisin eskalimin e situatës. Sidoqoftë, forca e tillë mund të përdoret vetëm nëse është e pashmangshme dhe jo të teprohet. Po ashtu, Gjykata rithekson se pretendimet për keqtrajtim duhet të mbështeten në dëshmi. Ndërsa, barra e provave do duhej të mbetej në autoritetet që të sjellin sqarim të bindshëm.

Për më shumë, Gjykata është në dijeni se shtetet mund të kenë vështirësi në mbajtjen e rregullit dhe disiplinës në institucionet penitensiare, e sidomos në rastet e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë. Kjo është veçanërisht kështu në rastet e sjelljeve të jo të mira nga të burgosurit me rrezikshmëri të lartë; situatë në të cilën është e rëndësishme gjetja e një ekuilibri midis të drejtave të të burgosurve të ndryshëm ose midis të drejtave të të burgosurve dhe sigurisë së zyrtarëve të burgjeve. Në rastin konkret, karakteri dhe sjellja e mëparshme e ankuesit iu kishte dhënë arsye zyrtarëve të burgut për të qenë të vëmendshëm në lidhje me sigurinë e tyre dhe për marrjen e masave të menjëhershme kur ai shfaqte mosbindje, kërcënime dhe agresion ndaj tyre. Për më tepër, autoritetet vendase kishin vërtetuar se ankuesi kishte vepruar në mënyrë agresive dhe se për këtë arsye ishte justifikuar të merrte masa për të luftuar agresionin e tij.

Lidhur me ngjarjet e 3 korrikut, Gjykata e refuzoi kërkesën e ankuesit si të papranueshme mbi bazën se ishte qartazi e pabazuar në përputhje me Nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës. Kjo për shkak se zyrtarët e burgut mbështeteshin vetëm në përdorimin e një mburojeje, xhaketave dhe helmetave, që ishin masa të mbrojtjes pasive. Po ashtu, Gjykata vlerësoi faktin se ankuesi kishte rezistuar duke qenë agresiv, kurse teknika e zyrtarëve të burgut kishte të bënte më shumë me imobilizimin e

ankuesit se sa me rrahjen e tij. Andaj, qartazi përdorimi i forcës në këtë rast nuk shkelte Nenin 3 të Konventës.

Lidhur me ngjarjet e 4 korrikut, Gjykata vëren se zyrtarët e burgut janë mbështetur në teknikën e përdorimit të forcës dhe pajisjeve speciale, prandaj përpos prangosjes është përdorur spreji djegës dhe shkopi teleskopik. Edhe pas shqyrtimit të dëshmive, gjykata nuk ka mundur ta vërtetojë nëse shhkopi është përdorur ndaj ankuesit para apo pas prangosjes.

Sa i përket legjitimitetit të përdorimit të sprejit djegës, sipas shqetësimeve të shprehura nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT), ky lloj spreji është një substancë potencialisht e rrezikshme që nuk duhet të përdoret në hapësira të mbyllura. Nëse përjashtimisht duhet të përdoret në hapësira të hapura, duhet të ekzistojnë masa mbrojtëse të përcaktuara qartë. Spreji djegës nuk duhet të përdoret kurrë kundër një të burgosuri i cili tashmë ishte nën kontroll. Edhe pse spreji djegës nuk konsiderohet si armë kimike dhe përdorimi i saj është i autorizuar me qëllim të zbatimit të ligjit, ky sprej prodhon efekte të tilla si problemet e frymëmarrjes, vjellja, acarimi i traktit respirator, acarimi i kanalit të derdhjes dhe syve, spazma, dhimbje gjoksi, pezmatim i lëkurës dhe alergji. Në doza të forta mund të shkaktojë nekrozë të indeve në traktin respirator ose tretës, edemë pulmonare ose hemorragji të brendshme. Duke pasur parasysh ato efekte potencialisht serioze nga njëra anë dhe pajisjet alternative në dispozicion të rojeve të burgut nga ana tjetër, Gjykata konsideron se rrethanat nuk e kishin justifikuar përdorimin e saj në këtë rast.

Sa i përket lidhjes në shtrat, Gjykata vëren se periudha për të cilën ankuesi kishte qenë i lidhur (tre orë e dyzet minuta) ishte më i shkurtër se në rastin e *Julin kundër Estonisë*²⁰ (nëntë orë) ku kishte gjetur shkelje, dhe se situata e tij ishte vlerësuar çdo orë kur ishte kontrolluar nga stafi mjekësor. Po ashtu, gjykata është në dijeni të faktit se gjatë tërë kohës sa ka qenë ankuesi i lidhur, ka qenë agresiv. Megjithatë, Gjykata konsideron këta faktorë nuk e justifikojnë përdorimin e masës së tillë në rrethanat e rastit në fjalë. Masat si lidhja në shtrat nuk duhet të përdoren kurrë si mjet sanksionimi disiplinor, por përkundrazi duhet të përdoren vetëm për të shmangur vetëlëndim ose rrezik serioz për individët e tjerë ose për sigurinë e burgeve.

Në bazë të dëshmive të mbledhura, Gjykata nuk është e bindur se pas përfundimit të ballafaqimit me zyrtarët e policisë, ankuesi, i cili ishte i mbyllur në një qeli disiplinore në vetmi, kishte paraqitur kërcënim për veten ose për të tjerët. Për më tepër, periudha për të cilën ai kishte qenë i lidhur në shtrat nuk ishte aspak për t'u neglizhuar dhe imobilizimi i tij i gjatë duhet t'i kishte shkaktuar shqetësime fizike dhe stres. Duke marrë parasysh efektin kumulativ të këtyre masave, ankuesi i ishte nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe degradues, gjë që përbën shkelje të Nenit 3 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 3 të Konventës bazuar në keqtrajtim të ankuesit më 4 Korrik 2009 [njëzëri].

²⁰ *Julin kundër Estonisë*, nr. 16563/08, 40841/08, 8192/10 dhe 18656/10, §§ 84-90 dhe 94, 29 Maj 2012

Neni 4

Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar

1. Askush nuk do të mbahet në skllavëri ose në robëri.
2. Askush nuk do të shtrëngohet të kryejë një punë me dhunë ose të detyruar.
3. Për qëllim të këtij Neni, termi “punë e kryer me dhunë ose e detyruar”, nuk përfshin:
 - a) çdo lloj pune që i kërkohet të kryejë zakonisht një personi të ndaluar në kushtet e parashikuara nga Neni 5 i kësaj Konvente ose gjatë lirim të tij me kusht;
 - b) çdo lloj shërbimi i karakterit ushtarak ose, në rastin e kundërshtarëve të ndërgjegjes në vendet ku kundërshtimi i ndërgjegjes është i njohur me ligj, shërbimi që kryhet në vend të shërbimit ushtarak të detyrueshëm;
 - c) çdo lloj shërbimi që kërkohet në rast krizash ose fatkeqësish, që kërcënojnë jetën ose mirëqenien e komunitetit;
 - d) çdo lloj pune ose shërbimi që është pjesë e detyrimeve normale qytetare.

Zarb Adami kundër Maltës - 17209/02

20 qershor 2006 [Seksioni i Katërt]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 4 § 3 (d) në ndërlidhje me Nenin 14

Diskriminim në baza gjinore si pasojë e detyrimit për të shërbyer në juri të gjykimeve penale të zbatuar kryesisht ndaj personave të gjinisë mashkullore / *ka shkelje*

Neni 14 në ndërlidhje me Nenin 6

Shkelje e të drejtës në proces gjyqësor si rezultat i një norme diskriminuese / *e panevojshme për shqyrtim*

Fjalët kyçe: *anëtar jurie / detyrim qytetar / diskriminim gjinor / gjobitje për mungesë / obligim për meshkujt / diskriminim de fakto*

Ankuesi: z. Maurice Zarb Adami, shtetas i Maltës, që jeton në Attard të shtetit maltez

Faktet e rastit

Ankuesi, me profesion farmacist, nga viti 1971, është përfshirë në listën e anëtarëve të jurive për gjykime penale në Maltë dhe ka qenë në këtë listë deri së paku në vitin 2002. Ndërmjet vitit 1971 dhe 1997, ai ka shërbyer edhe si anëtar jurie por edhe si kryetar në tri raste të ndryshme të procedimeve penale. Në vitin 1997, ankuesi ishte ftuar që të shërbente sërish si anëtar jurie, por nuk ishte paraqitur dhe si rezultat i ishte shqiptuar një gjobë prej afërsisht 240 EUR.

Pasi ankuesi nuk kishte paguar shumën e gjobës, ai ishte ftuar të paraqitej në gjykatën penale. Në këtë rast, ai ka argumentuar se gjoba e caktuar ndaj tij ishte diskriminuese në kuptim të Nenit 45 të Kushtetutës së Maltës dhe Nenit 14 të Konventës, i lexuar në bashkëlidhje me Nenin 4(3)(d), pasi personat e tjerë në të njëjtin pozicion nuk ishin vënë para barrës dhe detyrave të shërbimit në juri gjyqësore dhe/ose praktika vendore i lironte personat e gjinisë femërore nga shërbimi në juri, por jo edhe meshkujt.

Rasti i tij i ishte referuar gjykatës civile, para të cilës ankuesi kishte ngritur pretendimin se sistemi maltez i penalizonte personat e gjinisë mashkullore dhe i favorizonte ato të gjinisë femërore; gjatë pesë viteve paraprake, vetëm 3.05 % e femrave kishin shërbyer si anëtare të jurisë për dallim nga 96.95 % që ishin meshkuj. Për më tepër, sipas tij, barra e shërbimit në juri nuk shpërndahej në mënyrë të barabartë. Kështu, në vitin 1997, lista e anëtarëve të jurisë përfaqësonte vetëm 3.4% të listës së votuesve. Më 5 shkurt 1999, gjykata vendore për çështje civile hodhi poshtë pretendimet e ankuesit. Ai e kishte apeluar këtë vendim, duke theksuar se shërbimi në juri paraqiste një barrë apo ngarkesë të veçantë, pasi anëtarët e jurive duhej të linin punën e tyre për të ndjekur rregullisht seancat dëgjimore. Gjithashtu, kjo detyrë paraqiste një ngarkesë morale për të gjykuar pafajësinë ose fajësinë e një personi. Apeli i tij ishte hedhur gjithashtu poshtë.

Në vitin 2003, si ligjërues në Universitetin e Maltës, ankuesi në mënyrë të pasuksesshme kishte kërkuar që të lirohej nga shërbimi në juri, në pajtim me Nenin

604(1) të Kodit Penal të Maltës. I ftuar që të shërbente sërish si anëtar jurie në një gjykim tjetër, në vitin 2004, ankuesi kishte kërkuar që të lirohej nga shërbimi në juri sipas Nenit 607 të Kodit Penal. Kërkesa e tij ishte refuzuar. Më 18 prill 2005, ankuesi sërish kishte kërkuar lirim nga shërbimi në juri, duke u mbështetur në Nenin 604(1) të Kodit Penal, që parasheh lirimin për ligjëruesit e rregullt në Universitet. Më 25 prill 2005, kërkesa e tij ishte pranuar.

Përmbledhje e pretendimeve

Para Gjykatës, Qeveria e Maltës ka deklaruar se Neni 14, i vlerësuar në ndërlidhje me Nenin 4 § 3 (d), nuk ishte i zbatueshëm ndaj fakteve të rastit konkret. Sipas Qeverisë, shërbimi në juri ishte pa dyshim “detyrim qytetar normal” i mbështetur në solidaritet shoqëror, që u ishte caktuar qytetarëve me qëllim për të siguruar demokratizimin e procesit të administrimit të drejtësisë penale. Sipas Qeveriës, kjo nuk ishte kontestuar nga ankuesi. Si pasojë, shërbimi si anëtar jurie nuk mund të paraqesë “punë të kryer me forcë ose të detyruar” në kuptimin e Nenit 4 § 2 të Konventës. Aplikimi i kësaj dispozite është përjashtuar nga paragrafi 3(d) i këtij neni.

Qeveria më tej ka theksuar se ankuesi, që ishte ftuar të shërbente si anëtar jurie vetëm tri herë brenda shtatëmbëdhjetë vitesh, është ankuar vetëm rreth procedurave që kanë çuar në krijimin e listave se kush do të ishte i pranueshëm të shërbente si anëtarë jurie, dhe jo rreth procesit të mëpastajmë të zgjedhjes së personave që përfundimisht do të shërbenin si anëtarë jurie. Sidoqoftë, sipas Qeverisë, përcaktimi i listave nuk ka rezultuar në “punë të detyruar”, pasi asnjë lloj shërbimi nuk është nënkuptuar nga fakti i thjeshtë që emri i një personi është paraqitur në listë. Në fakt, ishte e mundur që kërkesa për përjashtim të lejohej, personi do të mund të sfidohej ose refuzohej ose do të mund të ndodhte që emri i tij ose i saj asnjëherë nuk do të zgjidhej. Si rezultat, sipas Qeverisë, faktet që karakterizojnë rastin e ankuesit bien jashtë kuadrit të Nenit 4 të Konventës, ndërsa Neni 14 nuk ishte i zbatueshëm.

Nga ana e tij, ankuesi ka theksuar se Gjykata Kushtetuese e ka pranuar në mënyrë të qartë se shërbimi në juri paraqet një “detyrim normal qytetar”. Ky mendim është konfirmuar edhe nga parimet e përcaktuara nga Gjykata në rastin *Karlheinz Schmidt kundë Gjermanisë*²¹ dhe *Van der Musselle kundër Belgjikës*.²² Në atgjykimin e fundit, Gjykata ka theksuar se koncepti i “detyrimit normal qytetar” i referohet “të gjithë punës ose shërbimit që kërkohet nga një person nën kërcënimin e ndonjë dënimi dhe për të cilën punë apo shërbim ky person nuk është ofruar vullnetarisht”.

Ankuesi ka nënvizuar faktin se atij nuk i është ofruar vullnetarisht që të shërbejë si anëtar jurie. Ka qenë në të vërtetë e kundërta, ky shërbim i është kërkuar atij nën kërcënim të gjobës, që do të mund të konvertohej në burgim. Ankuesi, gjithashtu, u është referuar disa vendimeve të Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara në lidhje me shërbimin në juri dhe diskriminimin në përzgjedhjen e anëtarëve të jurisë. Sipas pikëpamjes së ankuesit, pasi shërbimi në juri është mbuluar nga paragrafi 3(d) i Nenit 4 të Konventës, përfundimi i vetëm logjik ishte se faktet e rastit të tij ishin brenda kuadrit të Nenit 4. Si rezultat, Neni 14 — një dispozitë që nuk kërkon shkelje të një dispozite

²¹ *Karlheinz Schmidt kundër Gjermanisë*, 18 korrik 1994, Seria A nr. 291-B

²² *Van der Musselle kundër Belgjikës*, 23 nëntor 1983, Seria A nr. 70

përmbajtësore të Konventës, por vetëm një ndërlidhje me të — ishte gjithashtu i zbatueshëm në rastin e tij. Në këtë drejtim, ankuesi ka pretenduar se ka qenë viktimë e diskriminimit mbi bazë gjinore, pasi përbindja e personave të gjinisë femërore që kërkohej të shërbenin në juri ishte e papërfillshme, dhe se ai ishte detyruar që të përballej me ndjekje penale në lidhje me një detyrim civil diskriminues. Pra, ai është mbështetur në Nenin 14 të Konventës në ndërlidhje me Nenin 4(3) dhe Nenin 6 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata ka vlerësuar si fillim se shërbimi i detyrueshëm në juri siç ai ekziston në Maltë është një prej “detyrimeve normale qytetare” të parashikuar në Nenin 4 § 3(d) të Konventës. Më tej, Gjykata ka vërejtur se ankuesi nuk është ofruar vullnetarisht për shërbim si anëtar jurie dhe se mosparaqitja e tij në juri ka çuar në shqiptimin e një gjobe, e cila mund të konvertohet në burgim. Marrë parasysh lidhjen e ngushtë me detyrimin për të shërbyer, detyrimi për të paguar gjobën gjithashtu bie brenda Nenit 4 § 3(d). Për rrjedhojë, faktet e rastit hyjnë brenda kuadrit të Nenit 4 dhe kësisoji Neni 14 është gjithashtu i zbatueshëm.

Gjykata ka vënë re se ankuesi e ka pranuar që dallimi në trajtim për të cilin është ankuar nuk është varur nga gjuha e ligjit të Maltës në fuqi në kohën relevante, i cili nuk ka bërë dallime ndërmjet gjinive, pra si meshkujt ashtu edhe femrat janë njëlloj të kualifikuar dhe të pranueshëm të shërbejnë. Diskriminimi në fjalë ishte i mbështetur në atë që ankuesi e ka përshkruar si praktikë të mirë-krijuar, e karakterizuar nga një numër faktorësh, si mënyra në të cilën lista e anëtarëve të jurisë është hartuar dhe kriteret për lirin e dikujt për shërbim në juri. Si rezultat, vetëm një numër i papërfillshëm i femrave ishin ftuar të shërbenin si anëtare të jurive.

Gjykata ka ripërsëritur se statistikat në vetvete nuk ishin të mjaftueshme për të shpërfaqur një praktikë që mund të klasifikohet si diskriminuese. Në të njëjtën kohë, Gjykata ka vlerësuar se diskriminimi i mundshëm në kundërshtim me Konventën mund të vie jo vetëm nga masat legjislative, por edhe nga një situatë *de facto*. Gjykata kanë vërejtur se në vitin 1997—vit kur ankuesi ishin ftuar të shërbenin si anëtar jurie dhe nuk ishte paraqitur në takimin e gjykatës—numri i meshkujve (7,503) që ishin regjistruar në listën e anëtarëve të jurisë ishin tri herë më i madh se numri i femrave (2,494). Në vitin paraprak, dallimi ishte edhe më i theksuar, ku vetëm 147 femra ishin përfshirë në listat e anëtarëve të jurive, për dallim prej 4,298 meshkujve. Për më tepër, Gjykata kishte vërejtur se në vitin 1996, pesë femra dhe 175 meshkuj kishin shërbyer si anëtarë jurie. Gjykata ka vlerësuar se këto të dhëna tregojnë se detyrimi qytetar për shërbim në juri është zbatuar kryesisht ndaj meshkujve. Për pasojë, ka pas dallim në trajtim ndërmjet dy grupeve—meshkujve dhe femrave—të cilët, në lidhje me shërbimin në juri, ishin në situatë të ngjashme.

Gjykata ka rikujtuar se nëse një politikë ose masë e përgjithshme ka efekte paragjyquese jopërpjestimore ndaj një grupi të personave, mundësia që kjo të cilësohet diskriminuese nuk mund të përjashtohet qoftë edhe nëse në mënyrë të veçantë nuk ka pas si qëllim ose nuk është drejtuar ndaj atij grupi. Përfundimisht, Gjykata ka vlerësuar se Qeveria nuk ka arritur të dëshmojë se dallimi në trajtim ka ndjekë një qëllim legjitim dhe se ka pas një marrëdhënie të arsyeshme të përpjestueshmërisë (proporcionalitetit)

ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që është synuar të realizohet. Në këtë mënyrë, Gjykata ka gjetur shkelje të Nenit 14, i lexuar në ndërlidhje me Nenin 4 § 3(d) të Konventës.

Ky përfundim e ka liruar Gjykatën nga vlerësimi i çështjes tjetër, nëse ankuesi është diskriminuar në raport me meshkujt tjerë, të cilët edhe pse të kualifikuar për shërbim në juri, nuk ishin ftuar asnjëherë të shërbenin si anëtarë jurie.

Sa i përket pretendimit për shkelje të Nenit 14 në ndërlidhje me Nenin 6 Gjykata ka vlerësuar se ankuesi nuk ka pretenduar që procedurat e ndjekura ndaj tij kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta ose se ndonjëra prej të drejtave të garantuara me Nenin 6 është shkelur. Në cilindo rast, Gjykata ka vërejtur se procedurat penale kanë qenë pasojë e thjeshtë e ekzistencës së një detyrimi qytetar diskriminues. Duke qenë se ajo ka gjetë tashmë shkelje të Nenit 14 në ndërlidhje me Nenin 4 § 3(d) Gjykata nuk e ka vlerësuar të nevojshme që të shqyrtojë çështjen nëse ka pas edhe shkelje të Nenit 14 në ndërlidhje me Nenin 6.

Gjykata ka urdhëruar shtetin maltez që t'i paguajë ankuesit shumën në vlerë prej 7,752 EUR për kostot dhe shpenzimet. Sa i përket dëmit, ankuesi ka theksuar se shërbimi i tij si anëtar jurie i ka kushtuar atij me mungesë në punë për disa ditë. Megjithatë, pasi humbja financiare ka qenë e vështirë të kuantifikohet, ai nuk ka paraqitur ndonjë pretendim në këtë aspekt.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 14 në ndërlidhje me me Nenin 4 § 3(d) të Konventës [*me shumicë prej gjashtë me një*]; ndërsa nuk e vlerëson të nevojshme që të shqyrtojë nëse ka pas shkelje edhe të Nenit 14 në ndërlidhje me Nenin 6 të Konventës [*njëzëri*].

Meier kundër Zvicrës - 10109/14

9 shkurt 2016 [Seksioni i Tretë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 4 § 2

Pretendim i shkeljes së të drejtës për të mos kryer punë të detyrueshme në burg përtej moshës së pensionit /*nuk ka shkelje*

Neni 14

Pretendim për diskriminim si pasojë e detyrimit për punë pas pensionimit /*hedhet poshtë*

Fjalët kyçe: punë e detyrur / vuajtje dënimi / pensionim / kompensim / diskriminim

Ankuesi: z. Beat Meier, shtetas zviceran, i lindur në vitin 1946 dhe aktualisht është i ndaluar në Regensdorf

Faktet e rastit

Me një aktgjykim të datës 4 korrik 2003, Gjykata e Apelit e Kantonit të Zürich dënoi ankuesin me katër vjet e katër muaj burgim për disa vepra seksuale me të mitur. Në mars të vitit 2010, Gjykata e Apelit pezulloi ekzekutimin e paraburgimit, duke e zëvendësuar atë me paraburgim parandalues (*Verëahrung*). Më 6 dhjetor 2011, ankuesi kërkoi përjashtimin nga puna e detyruar gjatë mbajtjes së dënimit, por kërkesa e tij u mohua. Autoriteti kompetent i burgjeve i shqiptoi një rregjim më të rreptë burgu për shkak të refuzimit për të punuar, vendim ky që u revokua më vonë pas një ankese nga ankuesi.

Më 15 shkurt 2003 ankuesi apeloi në Gjykatën Federale, duke argumentuar se kishte pasur një aplikim jo korrekt të Kodit Penal dhe shkelje të dinjitetit njerëzor dhe lirisë individuale të mbrojtur me Kushtetutën Federale. Gjykata Federale e hodhi poshtë ankesën e tij duke konsideruar se puna e detyruar për të burgosurit nuk ishte në vetvete shkelje e të drejtave të njeriut me kusht që puna e ofruar të ishte e përshtatur me aftësitë, stërvitjen dhe interesat e çdo të burgosuri. Sipas pikëpamjes së Gjykatës Federale, kërkesa për punë kontribuon në ekzekutimin e dënimeve dhe nxit sjelljen e duhur shoqërore dhe aftësinë për të shmangur recedivizmin. Puna është dizajnuar ashtu që t'i mbajë të zënë të burgosurit, për t'i dhënë strukturë jetës së përditshme dhe për të ruajtur rendin në institucion.

Përmbledhje e pretendimeve

Duke u bazuar në Nenin 4 § 2 të Konventës ankuesi pretendon se kishte shkelje të së drejtës së tij për të mos kryer punë të detyruar, duke theksuar se ai ishte në moshën e pensionit. Po ashtu, ankuesi shtoi se ai kishte kontribuar në skemën e sigurimeve pensionale, përderisa ishte në burgun Pöschëies. Nëse atij i kërkohet të punonte edhe pas arritjes së moshës së pensionit, nuk kishte garanci se një ditë do të ishte në gjendje të korre përfitimet e atij sigurimi. Tutje ankuesi shtoi se detyrimi për të kontribuar në

skemën e sigurimeve pensionale do të binte në konflikt me kërkesën për të vazhduar punën përtej moshës së pensionit.

Duke u bazuar në Nenin 14, ai gjithashtu u ankua për diskriminim kundër tij si i burgosur i cili kishte arritur moshën e daljes në pension në krahasim me një person në liri që nuk duhej të punonte më.

Arsyetimi i Gjykatës

Ky ishte rasti i parë në të cilin Gjykata duhej të merrej me çështjen e punës së detyrueshme në burg përtej moshës së pensionit. Gjykata duhej të vlerësonte nëse ky detyrim kishte përfshirë ndonjë "punë të detyruar" në kundërshtim me Nenin 4 § 2 të Konventës. Gjykata vuri në dukje se ankuesit, i ishte kërkuar të punonte sipas Nenit 81 të Kodit Penal. Sipas të njejtit legjislacion, nëse ankuesi do të kishte refuzuar të kryente punën që i ishte caktuar, ai do të kishte kryer një vepër penale dhe do të duhej të përballonte pasojat. Duke përdorur përkufizimin e punës së detyruar, të përcaktuar në Konventën nr. 29 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), si bazë për interpretimin e Nenit 4 § 2 të Konventës, nuk mund të ketë dyshim se ankuesi kishte kryer punën "nën kërcënimin e një dënimi dhe për të cilin [ai nuk e kishte ofruar veten vullnetarisht]".

Gjykata u shpreh se pyetja nëse Neni 4 § 3 (a) i Konventës zbatohet në këtë situatë duhet të vlerësohet në dritën e *qëllimit*, *natyrës* dhe *shkallës* së punës së detyrueshme dhe *mënyrës* në të cilën duhet të kryhet.

Sa i përket *qëllimit* të punës së detyrueshme, Gjykata pranoi argumentin e Qeverisë se obligimi i të burgosurve për të vazhduar punën edhe përtej moshës së pensionit ishte pjesë e përpjekjes për të zvogëluar efektet e dëmshme të burgosjes. Puna e përshtatshme, e arsyeshme mund të ndihmojë në strukturimin e jetës së përditshme të të burgosurve dhe t'i mbajë ato aktive, të cilat ishin objektiva të rëndësishme për mirëqenien e një të burgosuri afatgjatë.

Sa i përket *natyrës* së punës së kryer nga të burgosurit që kishin arritur moshën e daljes në pension, vëzhgimet e nxjerra nga Këshilli Federal në tetor të vitit 2012 në përgjigje të raportit të Komitetit për Parandalimin e Torturës në vizitën e tyre në Zvicër në tetor të vitit 2013 treguan se puna e detyrueshme nuk zbatohet për të gjithë të burgosurit në të njëjtën masë dhe se duhej të përshtatej, në varësi të rrethanave, aftësive të të burgosurit, përshtatshmërisë për punë dhe gjendjes shëndetësore.

Gjykata gjithashtu vërejti se *shkalla* e detyrimit për punë ishte përshtatur gjithashtu me rrethanat e ankuesit dhe situatën personale, për shkak se ai punonte vetëm tre orë në ditë, domethënë 18 orë e 20 minuta në javë.

Sa i përket *mënyrës* në të cilën Ankuesi duhej të kryente punën e tij, Gjykata theksoi se ai ishte i vendosur, së bashku me të burgosurit e tjerë që kishin arritur moshën e pensionimit, në një krah të posaçëm të burgut. Së fundi, duhet të theksohet se ankuesi ishte paguar për punën e tij.

Në lidhje me praktikën në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Gjykata vuri në dukje se ajo që doli nga një studim krahasues që mbulonte 28 vende, të burgosurve nuk u kërkohej të punonin pas moshës së daljes në pension në 16 shtete anëtare. Në 12 vendet e tjera anëtare të anketuara çështja nuk ishte e rregulluar në mënyrë eksplicite në ligjin

vendas, por këto vende lejuan përjashtime nga puna e detyrueshme në burgje, në varësi të kapaciteteve dhe moshës së të burgosurve.

Gjykata arriti në përfundimin se në mungesë të një konsensusi të mjaftueshëm midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në lidhje me çështjen e punës së detyrueshme në burg përtej moshës së pensionit, duhet të theksohet, së pari, se autoritetet zvicerane gëzuan një hapësirë të konsiderueshme të vlerësimit, dhe së dyti, se nuk mund të ketë ndalim absolut të një pune të tillë, të nxjerrë nga Neni 4 i Konventës. Puna e detyruar e kryer nga Ankuesi gjatë kohës së ndalimit të tij, mund të konsiderohet si "punë e kërkuar për t'u bërë gjatë rrjedhës normale të paraburgimit", për qëllimin e Nenit 4 të Konventës. Rrjedhimisht, ajo nuk përbënte "punë të detyruar ose të detyrueshme" brenda kuptimit të këtij Neni. Duke vënë në dukje se ankuesi kishte sfiduar thjesht parimin aktual të punës së detyrueshme për të burgosurit të cilët kishin arritur moshën e daljes në pension dhe nuk ishin ankuar për mënyrën në të cilën puna të caktuar nga autoritetet zvicerane duhej të kryheshin, Gjykata gjeti se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 4 të Konventës.

Në lidhje me pretendimet për shkelje të Nenit 14 të Konventës, Gjykata vuri në dukje se ankuesi nuk kishte pretenduar para Gjykatës Federale se ai kishte pësuar trajtim diskriminues. Prandaj, kjo ankesë duhej të hidhej poshtë për mos shterje të mjeteve të brendshme juridike.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se nuk ka shkelje për sa i përket Nenit 4 të Konventës, ndërsa hedh poshtë pretendimet për shkelje të Nenit 14 [njëzëri].

C.N. kundër Mbreterisë së Bashkuar - 4239/08

13 shkurt 2013 [Seksioni i Tretë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 4

Shkelje e detyrimeve pozitive nga ana e Qeverisë për të vendosur ligje penale që ndëshkojnë punën dhe servitutin e detyruar/ *ka shkelje*.

Neni 8

Shkelje të drejtës për respektimin e jetës së private dhe familjare për shkak të trajtimit që i ishte nënshtruar ndërmjet viteve 2002 dhe 2006/ *nuk ngritet si çështje e veçantë*

Neni 13

Mungesë e mjeteve efektive për të adresuar mos cilësimin të veprës penale specifike të robërisë së brendshme ose të punës së detyruar si e kundërligjshme/ *nuk ngritet si çështje e veçantë*

Fjalët kyçe: trafikim / servitut / punë e detyrueshme / imigrant / kërcënim / ndalje e pagave / kufizim i lëvizjes

Ankuesja: C.N., shtetase e Ugandës

Faktet e Rastit

Ankuesja kishte udhëtuar për në Mretërinë e Bashkuar për të shpëtuar nga dhuna seksuale dhe fizike. Të afërmit S. dhe A. e ndihmuan atë të arrinte në Mretërinë e Bashkuar, por me të mbërritur, S., ia mori pasaportën dhe dokumentet e udhëtimit. Fillimisht, ankuesja ka jetuar për disa muaj në shtëpi të ndryshme që i përkasin S. në Londër. Ajo pretendoi se gjatë kësaj kohe S. vazhdimisht e paralajmëroi atë se ajo nuk duhet të flasë me njerëzit dhe se ajo lehtë mund të arrestohet ose përndryshe do të dëmtohet në Londër. Në janar të vitit 2003, S. e njoftoi ankuesen me një burrë të quajtur M. i cili drejtonte një biznes që ofronte shërbime kujdestarie dhe sigurimit. Ankuesja ndoqi një kurs trajnimi të shkurtër për kujdestarët dhe më pas bëri disa ndërrime gjatë natës si kujdestare dhe si roje sigurie në disa vende. Ankuesja pohoi se në çdo rast pagesa ishte bërë nga klienti direkt tek burri M., i cili transferoi një pjesë të parave në llogarinë bankare të S.-së, duke besuar se ajo do t'ia kalonte asaj. Megjithatë, ajo pretendonte se ajo nuk kishte marrë ndonjë pagesë për punën që ajo bënte. Ankuesja filloi të punonte për një çift të moshuar, z. dhe znj. K duke punuar ditë e natë dhe duke marrë vetëm një pasdite të lire në muaj. Në ditën e saj të lirë ajo zakonisht shoqërohej nga M. I cili e dergonte në shtëpinë e S. për pasdite. Ankuesja pranoi që pas disa vitesh i lejohej të merrte transport publik, por tha se ajo ishte paralajmëruar se nuk ishte e sigurt dhe se ajo nuk duhet të fliste me askënd. Gjatë gjithë kohës sa punonte pagat e saj i janë paguar S., i cili i mbajti ato duke ia dhënë ankueses vetëm një shumë të vogël parash.

Pas tre vite e gjysmë, në gusht të vitit 2006, ankuesja u rrëzua gjatë një vizite në një bankë. Ajo u dërgua në një spital dhe u diagnostifikua me HIV-pozitiv. Ajo po vuante gjithashtu nga psikoza, duke përfshirë halucinacione auditive. Më pas u strehua nga autoritetet lokale, ku edhe aplikoi për azil, por u refuzua. Avokati i saj kërkoi nga policia që të hetonte situatën e saj. Një njësi policore e specializuar për trafikimin e qenieve njerëzore e hetoi rastin dhe arriti në përfundimin se nuk kishte prova për trafikim.

Më 5 dhjetor 2008, avokati i ankueses i kishte shkruar policisë për t'u kërkuar atyre që të marrin në konsideratë ndjekjet penale për vepra të tjera, duke përfshirë vepëren penale *jus cogens* të skllavërisë ose të punës së detyruar. Më 18 dhjetor 2008, ankuesja i'u nënshtrua një vlerësimi nga Projekti POPPY, projekt i financuar nga qeveria që ofron strehim dhe mbështetje për viktimat e trafikimit. Projekti POPPY, arriti në përfundimin se "ajo i ishte" nënshtruar pesë nga gjashtë treguesve të punës së detyruar "(siç është identifikuar nga ILO). Në veçanti, lëvizja e saj kishte qenë e kufizuar në vendin e punës, pagat e saj i ishin ndalur për të paguar një borxh për të cilin ajo nuk e dinte, paga e saj ishte ndalur për katër vjet, pasaporta e saj ishte ruajtur dhe ajo ishte nën kërcënimin e denoncimit të autoriteteve.

Në 5 janar 2009, policia filloi të kryejë hetime të mëtejshme, duke marrë fillimisht një deklaratë nga agjenti i cili e rregullonte punën e ankueses me z. dhe znj. K (me sa duket, njeriu i identifikuar më parë si M.). Ky i fundit deklaroi se i ishte njoftuar me ankuesen nga një person që besonte se ishte i afërmi i saj dhe se ankuesja kishte marrëveshje me të afërmin e saj se pagat e saj do t'i paguheshin atij. Agjenti gjithashtu deklaroi se kishte frikë nga i afërmi i ankueses, i cili ishte një njeri i pasur dhe i fuqishëm i lidhur mirë me qeverinë e Ugandës. Policia nuk ishte në gjendje të kontaktojë me z. dhe znj. K. Më 25 shkurt 2009, policia informoi avokatin e ankueses se dëshmitë nuk kanë treguar egzistimin e vepëres penale të trafikimit. Ata vunë në dukje se "në këtë fazë nuk ka prova që do të mbështesin shfrytëzimin e çfarëdo lloji". Sipas pohimit të mëvonshëm të Avokatit të ankuese, në një takim në mes të oficerëve të policisë me ankuesen dhe përfaqësuesin e saj, një oficer policie tregoi se ishte pikëpamja e përkohshme e Policisë Metropolitane, e dhënë shprehimisht pa autorizim formal, që nuk kishte shkelje të ligjit penal që zbatohet për faktet e rastit. Avokati më tej pohoi se policia kërkoi falje për mënyrën e jo të duhur në të cilën rasti ishte trajtuar më parë dhe konfirmoi se dëshmitë e ankueses do të shqyrtoheshin prapë.

Tutje ankuesja u vlerësua nga një psikolog klinik i specializuar në dhunën kundër grave, ku sipas raportit të përgatitur ankuesja ishte duke vuajtur në një masë të ashpër nga një formë komplekse e çrregullimeve kronike të stresit post traumatik (PTSD), në lidhje me një çrregullim të madh depresiv dhe ajo paraqiste një rrezik të moderuar të vetëvrasjes. Në veçanti, raporti vuri në dukje se ankuesja paraqiste përvojë jetesore që përputheshin me një viktimë të trafikimit dhe të punës së detyruar, në kontekstin e një historie të sulmeve seksuale. Më 11 gusht 2009, policia informoi avokatin e ankueses se ky rast i veçantë nuk i plotëson kërkesat e trafikimit të qenieve njerëzore sipas legjislacionit të Mbretërisë së Bashkuar dhe se legjislacioni nuk ekziston në lidhje me pretendimet e vetme dhe specifike të robërisë shtëpiake ku trafikimi nuk është një faktor.

Në atë kohë (2007 -2009) nuk kishte ligj në Britani të Madhe, që posaçërisht kriminalizonte punën e detyruar apo servitutit. Kjo ka ndryshuar që nga viti 2009, me miratimin e Nenit 71 të Ligjit mbi Miratimin dhe Drejtësinë. Neni 71 i Ligjit mbi Miratimin dhe Drejtësinë 2009, përcakton se skllavëria, puna e detyrueshme është e dënueshme me burgim gjer në katërmbëdhjetë vjet. Neni 71 hyri në fuqi më 6 prill 2010, por nuk kishte efekt retroaktiv.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesja pretendoi se gjatë kohës sa ajo ishte keqtrajtuar, Qeveria kishte dështuar të përmbushte detyrimet e detyrimet e veta pozitive sipas Nenit 4 të Konventës për të miratuar ligje penale që ndëshkonin punën dhe servitutit e detyruar, dhe nuk arriti të miratoj ligje pozitive të tilla deri në vitin 2009. Tutje ankuesja argumentoi se edhe pasi që kishte bërë një pohim të besueshëm për keqtrajtim në kundërshtim me Nenin 4 të Konventës në vitin 2006, çdo hetim mbi ankesat e saj ishte joefektive pasi nuk ishte i drejtuar për të përcaktuar nëse ajo kishte qenë viktimë e trajtimit në kundërshtim me Nenin 4 dhe prandaj nuk rezultuan në ndjekje penale. Përfundimisht, ankuesja parashtrroi se, në paraqitjen e Nenit 71 të Ligjit mbi Miratimin dhe Drejtësinë, i cili krijoi vepra specifike të skllavërisë, robërisë dhe punës së detyruar ose të detyruar, Qeveria kishte pranuar se kishte një "zbrazëti në ligj" e që duhet plotësuar.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata konsideron se Neni 4 i Konventës përfshin obligimin procedural nga ana e shteteve anëtare për të hetuar "aty ku ekziston një dyshim i besueshëm se të drejtat e një individi sipas atij Neni janë shkelur". Autoritetet britanike hapën një hetim në këtë rast, por ky hetim ishte i drejtuar ndaj veprës penale të trafikimit dhe jo ndaj punës së detyruar ose robërisë, sepse legjislacioni i Mbretërisë së Bashkuar në fuqi në atë kohë vetëm në mënyrë specifike ndalonte trafikimin. Ankuesja argumenton se kjo e bëri hetimin të papërshtatshëm. Gjykata rikujton se në rastin *Rantsev*, në kontekstin e trafikimit, konstatoi se në mënyrë që një detyrim për të hetuar të kishte lindur, rrethanat duhet të kishin shkaktuar një "dyshim të besueshëm" se ankuesi/ja ishte trafikuar. Gjithashtu, konsideron se për një detyrim që ka lindur në rastin në fjalë, duhet të bindet se ankesat e ankueses ndaj autoriteteve vendase kanë shkaktuar një dyshim të besueshëm se ajo ishte mbajtur në robëri shtëpiake.

Në mbështetje të pretendimeve të saj ankuesja kishte argumentuar se në *Siliadin kundër Francës*²³, Gjykata definoi skllavërinë si një "formë veçanërisht serioze të mohimit të lirisë", e cila përfshinte "përveç detyrimit për të kryer shërbime të caktuara për të tjerët... detyrimin për të jetuar në pronën e një personi tjetër dhe pamundësinë për të ndryshuar gjendjen e tij". Ankuesja parashtrroi se ishte e detyruar që të jetonte me Z. dhe Znj. K., të cilët kërkonin kujdes të vështirë dhe kishin nevojë që ajo të ishte "në thirrje" njëzet e katër orë në ditë. Ajo e bëri këtë nën shtrengim nga S. dhe M. dhe ajo nuk mori asnjë shpërblim të dukshëm. Orari i punës dhe kushtet e tij si dhe marrja e dokumenteve të udhëtimit të saj, ishin të tilla që ta bënë atë të paaftë për të ndryshuar situatën e saj. Duhet të theksohet se në *Siliadin* Gjykata përcaktoi punën e detyruar ose

²³ *Siliadin kundër Francës*, nr. 73316/01, § 123, GjEDNj 2005-VII

të detyrueshme e cila përfshinte "të gjithë punën ose shërbimet që kërkohen nga çdo person nën kërcënimin e ndonjë ndëshkimi dhe për të cilin personi në fjalë nuk i ka ofruar vetë vullnetarisht". Vetë Gjykata vuri në dukje se termi solli në mend idenë e "kufizimit fizik apo mendor". Në *Siliadin* Gjykata gjeti këtë element të pranishëm kur ankuesja ishte një vajzë adoleshente, pranishme në një vend të huaj në mënyrë të paligjshme dhe që jetonte në frikën e arrestimit nga policia. Ankuesja ka parashtruar që dispozitat përkatëse të brendshme nuk kanë përfshirë, në kohën përkatëse, veprën penale të punës së detyruar ose servitutit. Në të vërtetë, policia i konfirmoi ankueses me shkrim se nuk kishte ndonjë dispozite ligjore që përkufizonte situatën e saj. Si rezultat, pavarësisht dëshmimeve të forta të trajtimit që bien në kuadër të Nenit 4 të Konventës, nuk ka mundur të bëhet hetim efektiv në trajtimin e saj dhe asnjë person nuk është arrestuar ose ndjekur penalisht në lidhje me të. Masa kryesore që qeveria britanike mund të inicone për rastin në fjalë ishin: shkelje të përgjithshme si rrëmbimi, mashtrimi ose sulmi psikologjik, asnjë nga të cilat nuk përmbushën detyrimin pozitiv sipas Nenit 4 të Konventës. Ankuesja përfundimisht ka parashtruar që vendimi i Gjykatës në *Siliadin* ka bërë të qartë se ajo që kërkohet ishte legjislacioni që në mënyrë specifike kriminalizon sjelljet që përfshihen në objektin e Nenit 4 të Konventës.

Gjykata nuk konsideron që ankesat e ankueses lidhur me trajtimin e saj nga S. dhe M. ishin në thelb të padukshme. Në të vërtetë, ajo vë në dukje se rrethanat që ajo përshkroi ishin shumë të ngjashme me faktet e rastit *Siliadin*, vetëm dallimet e dukshme ishin se ankuesja ishte më e vjetër se ankuesja në *Siliadin* dhe se ishte agjenti - dhe jo "punëdhënësit" e saj - të cilët ajo pretendonte se ishin përgjegjës për trajtimin në kundërshtim me Nenin 4 të Konventës. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron që ankesat e ankueses kanë shkaktuar dyshim të besueshëm se ajo ishte mbajtur në kushte të servitutit të brendshëm, i cili më pas i vendosi autoritetet vendase një detyrim për të hetuar ato ankesa. Gjykata vëren se është e qartë se autoritetet vendase kanë hetuar ankesat e ankueses. Megjithatë, ankuesja pohon se hetimi ishte i mangët, sepse mungesa e një legjislacioni të posaçëm që kriminalizonte shërbimin shtëpiak nënkuptonte që nuk ishte predisponuar për të përcaktuar nëse ajo kishte qenë viktimë e trajtimit në kundërshtim me Nenin 4 të Konventës.

Është i pakontestueshëm fakti se në kohën kur ankuesja pretendonte se ajo i ishte nënshtruar një trajtimi që binte në kundërshtim me Nenin 4 të Konventës, sjellja e tillë nuk ishte e kriminalizuar në mënyrë specifike sipas ligjit të brendshëm. Kishte, megjithatë, një numër veprash penale që kriminalizonin disa aspekte të skllavërisë, robërisë dhe punës së detyruar. Në veçanti, Qeveria i drejtoi vëmendjen Gjykatës ndaj veprave penale të trafikimit, burgosjes së rreme, rrëmbimeve, dëmtimeve të rënda trupore, sulmit, shantazhit dhe ngacmimit. Duke pasur parasysh të gjeturat e Gjykatës në *Siliadin*, nuk mund të konstatohet se dispozitat legjislative në fuqi në Mbretërinë e Bashkuar në kohën përkatëse ishin të pamjaftueshme për të ofruar mbrojtje praktike dhe efektive kundër trajtimit që përfshihej në objektin e Nenit 4 të Konventës.²⁴ Në vend që t'u mundësonte autoriteteve të hetojnë dhe penalizojnë një trajtim të tillë, autoritetet u kufizuan në hetimin dhe penalizimin e veprave penale të cilat shpesh - por jo domosdoshmërisht - shoqërojnë shkeljet e skllavërisë, robërisë dhe punës së detyruar

²⁴ *MC kundër Bullgarisë*, nr. 39272/98, § 179, KEDNJ 2003-XII

ose të detyruar. Viktimat e një trajtimi të tillë, të cilët gjithashtu nuk ishin viktima të një prej këtyre veprave penale, kanë mbetur pa ndonjë zgjidhje. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se ligji penal në fuqi në kohën e ngjarjeve nuk siguroi mbrojtje praktike dhe efektive kundër trajtimit që përfshihej në objektin e Nenit 4 të Konventës.

Megjithatë, Qeveria ka parashtuar se arsyeja që asnjë veprim nuk është ndërmarrë pas hetimit të ankesave të ankueses ishte jo mungesa e legjislacionit përkatës, por mungesa e provave për të mbështetur faktet e pretenduara nga ankuesja. Prandaj, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse mungesa e një legjislacioni të posaçëm që kriminalizon shërbimin shtëpiak i pengoi autoritetet vendore të hetojnë në mënyrë të duhur pretendimet e ankueses, ose nëse ankesat e saj janë hetuar siç duhet, por nuk është gjetur prova për t'i mbështetur ato. Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Gjykata përsërit se nuk është detyrë e saj të zëvendësojë autoritetet vendase në vlerësimin e fakteve të rastit. Gjykata rikujton se hetimi mbi ankesat e ankuesit filloi nga ekipi i Policisë Metropolitane i Trafikimit të Qenieve Njerëzore, një njësi policore e specializuar në hetimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore. Me pas, hetimi lidhur me ankesat është kryer nga një njësi e specializuar e trafikimit dhe ndërsa hetuesit herë pas here i referohen skllavërisë, punës së detyruar dhe servitutit të brendshëm është e qartë se në çdo kohë fokusi i tyre ishte në veprën e mishëruar në seksionin 4 të ligjit të vitit 2004. Servituti i brendshëm është një vepër e veçantë, e dallueshme nga trafikimi dhe shfrytëzimi, që përfshin një dinamikë komplekse, që përfshin format e forta dhe më delikate të shtrëngimit, për të detyruar pajtueshmërinë. Një hetim i plotë për ankesat për një sjellje të tillë kërkon, pra, një kuptim të shumë mënyrave delikate që një individ mund të bjerë nën kontrollin e një tjetri. Në rastin në fjalë, Gjykata konsideron se për shkak të mungesës së një veprë të posaçme të servitutit të brendshëm, autoritetet vendase nuk ishin në gjendje të japin peshë të duhur këtyre faktorëve. Në veçanti, Gjykata është e shqetësuar nga fakti se gjatë hetimit të pretendimeve të ankueses, duket se nuk është bërë asnjë përpjekje për të intervistuar S. pavarësisht nga rëndësia e veprës që ai pretendohet se kishte kryer. Për Gjykatën, mungesat në legjislacionin vendas në atë kohë mund të shpjegojnë këtë mosveprim, së bashku me faktin se asnjë peshë e dukshme nuk i atribuohet pretendimeve të ankueses se pasaporta e saj ishte marrë nga S., nuk i kishte mbajtur pagat e saj për të siç ishte rënë dakord dhe se ajo ishte kërcënuar në mënyrë eksplicite dhe implicite ndaj denoncimit të autoriteteve të imigracionit, edhe pse këta faktorë ishin ndër ato të identifikuar nga ILO si tregues të punës së detyruar. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se hetimi mbi pretendimet e ankueses për servitutin e brendshëm ishte i paefektshëm për shkak të mungesës së legjislacionit specifik që e penalizon trajtimin e tillë. Si rezultat Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Nenit 4 të Konventës.

Gjykata konsideron se pretendimet për shkelje të nenit 8 dhe 13 janë të pranueshme, sidocoftë duke pasur parasysh gjetjet në raport në nenin 4 konsideron që nuk ngritet ndonjë çështje e ndarë për sa i përket neneve në fjalë.

Bazuar në Nenin 41 të Konventës Gjykata tutje përcakton se Shteti i paditur duhet të paguajë brenda tre muajve nga data në të cilën aktgjykimi bëhet i formës së prerë shumat prej 8,000 EUR plus çdo taksë që mund të jetë e ngarkueshme, në lidhje me dëmin jomaterial; si dhe shumën 20,000 EUR plus çdo taksë që mund të jetë e ngarkueshme për ankuesen, në lidhje me shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata dhe gjen se ka shkelje te Nenit 4 të Konventës dhe se se asnjë çështje e veçantë nuk ngritet çështje e veçantë në lidhje me Neni 8 dhe Neni 13 i Konventës.

Chitos kundër Greqisë - 51637/12

4 qershor 2015 [Seksioni i Parë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 4 (2)

Shkeljee të drejtës për ndalimin e punës së detyruar, si rezultat i detyrimit të vënë ndaj një oficeri ushtarak që të paguajë një shumë të hollash në këmbim të dorëheqjes përpara përfundimit të periudhës së shërbimit ushtarak / *ka shkelje*

Neni 4 (2) në kombinim me Nenin 14

Pretendim për diskriminim në raport me ushtarët në gradat dhe divizionet tjera / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: *shërbim ushtarak / profesion mjekësor / studime / obligim për punë / kompensim për mospunë / interes / zbritje e shumë*

Ankuesi: z. Georgios Chitos, shtetas grek, i lindur në vitin 1968 dhe që jeton në Selanik

Faktet e rastit

Në vitin 1986, ankuesi ishte pranuar në Akademinë Ushtarake (seksioni mjekësor). Ai kishte marrë pagë për këtë dhe gjithashtu kishte të drejtë në përfitime sociale. Për një periudhë prej gjashtë vitesh, ai kishte vijuar studimet akademike falas në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetin e Selanikut. Me të diplomuar në vitin 1993, ai ishte promovuar në detyrën e togerit të dytë në trupën mjekësore të ushtrisë. Sipas ligjit, ai kërkohet të shërbente për forcat e armatosura për një periudhë që korrespondonte me dyfishin e kohëgjatësisë së studimeve të tij, që i binte të ishte 12 vite (në të vërtetë, ligji që ishte në fuqi në kohën e regjistrimit në studime, por që ishte ndryshuar më vonë, parashihte trefishin e kohës sa zgjasnin studimet).

Në vitin 1996, ishte organizuar një provim konkurrues për praninë të specialistëve mjekësorë. Oficerët e trupës mjekësore, përfshirë ankuesin, ishte ftuar të aplikonin për të marrë kualifikime të specializuara. Pas përfundimit të trajnimit të specializuar, që kishte zgjatuar afërsisht pesë vite, ankuesi ishte zotuar në pajtim me ligjin në fuqi që të shërbente në ushtri edhe për pesë vite të tjera. Ai kishte bërë një deklaratë nën betim për këtë qëllim, ashtu siç e kërkonte ligji.

Ankuesi kishte shërbyer në forcat e armatosura deri më 22 janar 2006, kur paraqiti dorëheqjen në moshën 37 vjeçare si mjek anestezolog në gradën ushtarake të kolonelit. Në shtator 2006, ai ishte informuar nga Stafit i Shtabit të Përgjithshëm se duhej të shërbente edhe nëntë vite e katër muaj dhe dymbëdhjetë ditë ose ndryshe i duhej paguar shtetit një taksë që kalkulohej mbi bazën e periudhës së mbetur të shërbimit. Më 26 maj 2007, Departamenti i financave i Stafit të Shtabit të Përgjithshëm kishte vlerësuar se kjo shumë kapë vlerën prej 106,960 EUR. Vendimi këshillonte se ankuesi mund të ankohet në Gjykatën e Auditorëve për rishikim gjyqësor, ndonëse kjo ankesë nuk do të kishte efekt pezullues për sa i përket procedurës së pagesës.

Ankuesi kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Auditorëve, e cila e kishte pezulluar zbatimin e këtij vendimi. Përkundër këtij vendimi të Gjykatës së Auditorëve, Zyra Tatimore e Selanikut e kishte urdhëruar ankuesin që të paguante shumën prej 106,960 EUR, plus 2,139.20 EUR taksa për dokumenta dhe 427.84 EUR për fondin për sigurinë bujqësore. Më 10 maj 2010, autoritetet tatimore të Ministrisë së Financave e kishin njoftuar ankuesin se pasi shuma e kërkuar nuk ishte paguar deri në fund të vitit paraprak, një normë interesi prej 13,143.24 EUR do të zbatohet për pagesë të vonuar. Ai ishte informuar gjithashtu se, nëse do të paguante shumën e kërkuar deri më 31 maj 2010, atij do t'i reduktohet norma e interesit në vlerën prej 80 për qind. Më 26 maj 2010, ankuesi kishte depozituar shumën në vlerë prej 112,155.69 EUR pranë Zyrës Tatimore të Selanikut.

Në një vendim të 12 dhjetorit 2013, Gjykata e Auditorëve kishte vendosur se trajnimi i specializuar prej pesë vitesh i ankuesi duhej llogaritur si pjesë e periudhës së gjithmbarshme që përfshinë shërbimin e detyruar dhe si rezultat kishte ulur shumën e kërkuar për pagesë në 49,978.33 EUR. Pas këtij vendimi, shteti ia kishte rikthyer shumën tjetër, në vlerën prej 59,749.61 EUR.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi pretendon shkelje të Nenit 4 § 2, duke argumentuar se kërkesa e përcaktuar nga ligji i aplikueshëm që të mbetet në forcat e armatosura për çfarë ai e ka konsideruar një periudhë shumë të gjatë ose për t'i paguar shtetit si kompensim një shumë tepër të lartë, paraqet punë të kryer me dhunë ose të detyruar. Kjo pasi në këtë mënyrë vendoset një barrë jopërpjestimore dhe kufizim i panevojshëm i lirisë së tij të punësimit. Ankuesi gjithashtu, është ankuar mbi bazën e Nenit 4 § 2, të lexuar bashkërisht me Nenin 14, pasi sipas tij, vetëm oficerët mjekësorë të trupave tokësore kërkohej të specializoheshin, në këtë mënyrë duke u zotuar të shërbenin në forcat e armatosura edhe për pesë vite të tjera.

Qeveria, nga ana e saj, kishte deklaruar se rasti për të cilin ishte paraqitur ankesa nuk përbën punë të detyruar në kuptimin e Nenit 4 § 2 të Konventës. Sipas përfaqësuesve të Qeverisë, pas ndjekjes dhe përfundimit të studimeve në Akademinë Ushtarake nga ana e ankuesit, emërimin në pozitën e togerit të dytë dhe vijimin e trajnimit të specializuar, ai në mënyrë të lirë dhe vullnetare kishte zgjedhur të shërbente në forcat e armatosura për një periudhë prej dymbëdhjetë vitesh, plus pesë vite të tjera. Sipas Qeverisë, ankuesi ka qenë në dijeni për këtë detyrim, i përcaktuar shprehimisht me ligj. Qeveria tutje ka paraqitur se pretendimi i ankuesit se atij i është dashur që të pajiset me një kualifikim të specializuar është i pathemeltë. Sipas përfaqësuesve të Qeverisë, një detyrim i tillë nuk ka ekzistuar, dhe kjo ka qenë çështje e rëndësishme vetëm për karrierën e ankuesit.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata si fillim ka theksuar se ankuesi nuk mund të pretendojë në mënyrë legjitime se nuk ka qenë në dijeni se për studimet falas dhe pagën e benefitet e tjera sociale që ai i ka gëzuar si pjesë e forcave të armatosura, ai ka ndërmarrë që të shërbejë për një numër të caktuar vitesh pas diplomimit. Gjykata ka vërejtur se shuma që duhej paguar nga ankuesi është llogaritur në bazë të Ligjit Nr. 3257/2004.

Gjykata ka vlerësuar se detyrimi për oficerët ushtarakë që të shërbejnë për një periudhë të caktuar pas përfundimit të trajnimit është pjesë e qenësishme e misionit të tyre dhe se kohëgjatësia e kësaj periudhe është çështje që lë hapësirë për vlerësim ana e shteteve për të siguruar kthimin e investimit të shtetit të bërë në trajnimin e oficerëve ushtarakë dhe të oficerëve mjekësor ushtarakë.

Gjykata më pas ka rikujtuar se ankuesi ka studiuar mjekësinë dhe, gjithashtu, ka arritur kualifikim të specializuar si anesteziolog përmes të qenurit pjesë e ushtrisë, dhe se ai ka pasur mundësinë që të ushtrojë profesionin në praktikën private pas orëve të tij të punës. Për më tepër, gjatë studimeve të tyre dhe trajnimit të specializuar, oficerët ushtarakë mjekësorë gëzojnë privilegje që nuk janë të mundshme për studentët civilë të mjekësisë, përfshirë sigurinë në punë dhe punën me pagesë.

Përkundrejt kësaj më sipër, Gjykata vlerësoi se procedura e blerjes së viteve të mbetura të shërbimit në ushtri ka dështuar të krijojë një ekuilibër të drejtë ndërmjet mbrojtjes së të drejtës individuale të ankuesit dhe interesave të komunitetit në përgjithësi. Shuma prej 49,978.33 EUR që i ishte kërkuar ankuesit ta paguante përfundimisht nuk ishte e paarsyeshme—duke qenë që paraqiste më pak se dy të tretën e shumës së përgjithshme që ankuesi kishte marrë gjatë periudhës në diskutim. Sidocoftë, ai ishte urdhëruar të paguante 109,527 EUR pavarësisht pezullimit nga ana e gjykatës të vendimit për ekzekutim dhe pavarësisht se procedura para Gjykatës së Auditorëve thuajse nuk kishte filluar, me rrezikun që kjo shumë mund të rritej tutje si pasojë e normës së interesit për pagesë të vonuar si rezultat i kohës që kërkohet nga Gjykata e Auditorëve për të marrë vendimin. Për më tepër, Gjykata ka vërejtur se vendimi i 26 majit 2007 nuk e kishte përmendur mundësinë se ankuesi do të mund të paguante shumën e detyrimit në këste. Duke e detyruar ankuesin që menjëherë të paguante shumën prej 109,527 EUR, të rritur më pastaj në 112,155.69 EUR, autoritetet tatimore kanë vendosur një barrë jopërpjestimore ndaj ankuesit, në shkelje të Nenit 4 § 2.

Sa i përket pretendimit të ankuesit për shkelje të Nenit 4 § 2 në kombinim me Nenin 14 (Gjykata ka vërejtur se detyrimi për shërbim për pesë vite shtesë në rastin e ndjekjes së trajnimit të specializuar ka vlejtur për oficerët mjekësorë në të tri degët e forcave të armatosura (dhe jo vetëm ndaj atyre tokësore), dhe se ligji ka parashikuar që ata persona që duan të ndjekin një kualifikim të specializuar mund ta bëjnë këtë vetëm nëpërmes ushtrisë. Si rezultat, Gjykata e ka shpallur këtë pjesë të ankesës të papranueshme si qartazi të pabazuar.

Gjykata ka urdhëruar Greqinë t'i paguajë ankuesit 5,000 EUR në lidhje me dëmin jo-material dhe 5,000 EUR për kostot dhe shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 4 § 2, të Konventës. Gjykata, ndërkaq, e shpallë të papranueshëm pretendimin për shkelje të Nenit 4 § 2 në kombinim me Nenin 14 [njëzëri].

Graziani-Weiss kundër Austrisë - 31950/06

18 janar 2012 [Seksioni i Dytë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 4

Obligim për të bërë punë të detyruar si pasojë e caktimit si kujdestarë i një personi me sëmundje mendore / *nuk ka shkelje*

Neni 14

Diskriminim në bazë të profesionit në raport me profesionet tjera ligjore / *nuk ka shkelje*.

Fjalët kyçe: *kujdestari / obligim ligjorë / avokat / noterë / profesione ligjore / caktim i detyrueshëm / punë e detyrueshme / pa kompensim*

Ankuesi: z. Wolfgang Graziani-Weiss, shtetas austriak i lindur më 1963 dhe jeton në Linz (Austri) me profesion avokat

Faktet e rastit

Në korrik të vitit 2005, ankuesi u informua se Gjykata e Qarkut në Linz planifikonte ta emërojë atë si kujdestar ligjor për një person të sëmurë mendërisht, K. dhe i kërkoi atij të komentonte mbi propozimin. Me vendim të Gjykatës së Rrethit të Linz të datës 15 shtator 2005 ankuesi u caktua kujdestar ligjor pasi që sipas gjykatës, as asociacioni e kujdestarëve e as ndonjë familjarë i njohur nuk mund të merrte përsipër kujdestarinë e K.. Ankuesi kundërshtoi emërimin në bazë të asaj që ky emërim do të shqetësonte jetën e tij familjare me gruan dhe dy fëmijët e tij dhe se, duke pasur parasysh përfshirje e tij në udhëheqjen e një korit të kishës, ai nuk kishte kohë për të marrë përsipër një detyrë të tillë. Ai më tej argumentoi se ai nuk ishte i trajnuar për t'u marrë me persona që kanë sëmundje mendore dhe se ai do të duhej të paguante për një sigurim të veçantë/shtesë që K. nuk kishte para për të paguar. Gjykata e Rrethit në anën tjetër gjeti se arsyet e parashtruara nga ankuesi nuk ishin të mjaftueshme për të justifikuar refuzimin e tij; duke shtuar se fëmijët dhe udhëheqja e korit të kishës, nuk përbënin një arsye të vlefshme se pse ai duhet të shpallet i papërshtatshëm për detyrën. Kjo Gjykatë gjithashtu konsideroi se detyra e avokatëve për të vepruar si kujdestarë ligjorë nuk përbënte punë të detyruar, pasi që ndihmat ndaj anëtarëve më të dobët të shoqërisë ishte detyrë qytetare dhe për praktikimin e avokatëve, dhënia e ndihmës në çështjet ligjore ishte pjesë e detyrave kryesore të tyre profesionale dhe ishte e krahasueshme me një obligim normal qytetar në kuptim të Nenit 4 § 2 të Konventës. Duke gjetur arsyet për refuzimin e tij të pamjaftueshme, gjykatat vendore caktuan ankuesin si mbrojtës ligjor i K. në shtator 2005 ku ndër tjera ai duhej të merrej me çështje të tilla si menaxhimin e të ardhurave të K. dhe përfaqësimin e tij para gjykatave dhe autoriteteve të tjera.

Ankuesi, parashtrroi kundërshtime duke argumentuar se ishte diskriminuese që të detyroheshin avokatët dhe noterët për të vepruar si kujdestarë ndërsa jo njerëz të tjerë

që kanë studiuar drejtesinë - si gjykatësit dhe zyrtarët publik - që kanë të njëjtën njohuri ligjore, por nuk janë nën ndonjë detyrim të tillë. Kjo ankesë u hodh poshtë, dhe më 15 dhjetor 2005, Gjykata Rajonale e Linzit mbështeti vendimin e Gjykatës së Rrethit Linz, duke konsideruar se kishte të paktën një gjykim që përfshinte K në pritje dhe se çdo detyrë tjetër që kërkuesi do të duhej të kryente në rastin konkret ishte e kufizuar dhe nuk vendoste një barrë të tepruar mbi të. Ankuesi parashtrroi ankesë të jashtëzakonshme në gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje të Nenit 14 në lidhje me Nenin 4 të Konventës, pasi që vetëm avokatët dhe noterët dhe bashkëpunëtorët e tyre, por asnjë person tjetër që kishte studiuar ligjin nuk ishte vendosur në listën e kujdestarëve të mundshëm. Ai gjithashtu u ankua se avokatët në parim kanë të drejtën e shpërblimit për shërbimet e tyre, por kjo aplikohet vetëm për atë sa kjo nuk do të rrezikonte përmbushjen e nevojave bazë të personit të vendosur nën kujdestari. Me një vendim të datës 7 mars 2006, Gjykata Supreme refuzoi të trajtojë çështjen, duke gjetur se nuk ngriste një çështje të rëndësishme të ligjit, dhe përfundimisht ankesa e tij u hodh poshtë në mars të vitit 2006.

Përmbledhje e pretendimeve

Duke u mbështetur në Nenin 4 të Konventës, ankuesi pretendon se ishte i detyruar të vepronte si kujdestar ligjor dhe ky emerim rezultoi në punë të detyrueshme. Ankuesi gjithashtu pohoi, mbështetur në Nenin 14, se emërimi vetëm i avokatëve të praktikës ose noterëve publikë si kujdestarë ligjore, por jo kategoritë e tjera të personave me edukim ligjor, ishte diskriminues. Qeveria kundërshtoi keto argumente, duke theksuar se ankesa në trajtim të ndryshëm pa arsytetime faktike dhe të arsyeshme nuk çoi në shkelje të Konventës. Për më tepër, Konventa i jep Shteteve një hapësirë të caktuar vlerësimi për të përcaktuar se cilat situata justifikonin trajtimin e ndryshëm. Qeveria pranoi se avokatët e praktikës dhe noterët publikë u emëruan si kujdestarë më shpesh sesa personat e tjerë të trajnuar ligjorisht. Është parashikuar gjithashtu me ligj që grupe profesionale të tilla duhet të emërohen si kujdestarë nëse çështjet që menaxhohen nga kujdestari kryesisht kërkojnë njohuri ligjore. Preferenca e dhënë ndaj këtyre grupeve profesionale nuk ishte arbitrare dhe kështu nuk ishte diskriminuese, por bazohet në faktin se këto grupe profesionale ishin veçanërisht të përshtatshme për të përfaqësuar persona para zyrave, gjykatave dhe autoriteteve të tjera publike. Gjithsesi, Qeveria parashtrroi se avokatët dhe noterët publikë ishin të trajnuar dhe me përvojë të veçantë në trajtimin e gjykatave dhe autoriteteve. Grupet profesionale të juristëve dhe noterëve publikë gjithashtu gëzonin privilegje dhe të drejta të veçanta në lidhje me përfaqësimin e personave para gjykatave dhe autoriteteve: një person duhet të përfaqësohet nga avokatët para gjykatave të qarkut nëse vlera e kërkesave në mosmarrëveshje tejkalon një shumë të caktuar (në atë kohë e fakteve, pragu ishte 4,000 EUR (EUR)), dhe përfaqësimi nga avokati ishte gjithashtu i detyrueshëm para gjykatave më të larta. Profesionistë të tjerë të trajnuar ligjorisht nuk gëzonin privilegje të tilla. Për më tepër, avokatët e praktikuar dhe noterët publikë ishin subjekt i ligjit disiplinor. Qeveria gjithashtu theksoi se rregulli 86 § 2 i Rregullores së Punës së Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Dytë përcaktonte se duhet të ketë një ndryshim të arsyeshëm midis personave të emëruar si kujdestarë sa i përket avokatëve dhe noterëve publikë. Për më tepër, sipas Nenit 189 § 2 të Kodit Civil, avokati praktikues apo noteri i cili do të

emërohej si kujdestar mund të refuzojë emërimin nëse ai ose ajo nuk mund të pritej me arsye që të vepronte në atë cilësi.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata vuri në dukje se ankuesi duhej të kishte qenë i vetëdijshëm se ai mund të ishte i detyruar të veprojë si kujdestar kur vendosi të bëhej avokat dhe kjo përbente një element të pëlqimit paraprak. Në të vërtetë, përfaqësimi i dikujt para gjykatave dhe autoriteteve dhe menaxhimi i pronës së tyre nuk ishte veprimtari jashtë spektrit të aktiviteteve të një avokati dhe se këto aktivitete ishin normale për një avokat. Lidhur me pretendimeve të ankuesit se veprimtaria e tij në cilësi të kujdestarit të K-së paraqiste një barrë të tepruar ndaj tij, Gjykata vëren se numri i rasteve në të cilat ai duhej të vepronte si kujdestari i K.-së nuk ishin as shumë domethënëse e as nuk kërkonin kohë të shtuar e as nuk ishin veprimtari komplekse. Për më tepër, tanimë ishte e pranueshme që, në rrethana të caktuara, ku personat në fjalë nuk kishin mjaftueshëm të holla/mjete, kujdestarët nuk kanë marrë fare shpërblim. Në këtë kontekst gjykata rikujtoi se avokatët dhe noterët publikë kishin privilegj ndaj profesionistëve të tjerë në atë se kishin të drejtën për të përfaqësuar palët në lloje të caktuara të procedurave gjyqësore. Andaj Gjykata arriti në përfundimin se shërbimet që i ishin kërkuar ankuesit, nuk përbënin punë të detyruar ose të detyrueshme. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 4 të Konventës.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit se kishte shkelje të Nenit 14 në kombinim me Nenin 4, Gjykata përsëriti se diskriminimi nënkuptonte trajtimin e njerëzve në mënyrë të ndryshme në situata të ngjashme pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Gjykata ritheksoi se praktika e emërimit të avokatëve dhe noterëve publikë si kujdestarë, por jo edhe kategorive të tjera që kishin edukim ligjor, nuk arrinë shkallën e një diference në trajtim. Megjithatë, ka pasur një diferencë të ndjeshme midis grupeve profesionale të avokatëve dhe kategorive të tjera të personave që kishin studiuar drejtësinë ose kishin trajnim ligjor por nuk ishin duke punuar si avokatë. Për më shumë Gjykata vëren se avokatët kanë të drejta dhe detyra të cilat janë të qeverisura nga ligje dhe rregulla specifike siç është dhënia e provimit dhe marrja e sigurimit kundër dëmeve para se të praktikonin. Ata gjithashtu u nënshtrohen kriterve disiplinore dhe mbi të gjitha kishin të drejtë përfaqësohen që të përfaqësojnë palët para gjykatave ku përfaqësimi është normalisht i detyrueshëm, për dallim nga kategoritë tjera ligjore që nuk kanë këtë të drejtë. Si përfundim Gjykata vëre se kufizimi i detyrës për të vepruar si kujdestar ligjor për noterët publikë dhe avokatët nuk ishte diskriminues pasi q ishin jo në një situatë të ngjashme me personat e tjerë me aftësim ligjor. Prandaj Gjykata gjen se nuk ka shkelje të Nenit 14 në lidhje me Nenin 4.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se se nuk ka shkelje të Nenit 4 të Konventës; dhe gjithashtu gjen se nuk ka asnjë shkelje të Nenit 14 i marrë së bashku me Nenin 4 të Konventës [njëzëri].

C.N. dhe V. kundër Francës - 67724/9

11 tetor 2012 [Seksioni i Pestë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3

Pretendim për trajtim çnjerëzor dhe degradues si pasojë e keqtrajtimit / e papranueshme për kërkuesen e dytë

Neni 4 § 2

Pretendim për mbajtje në robëri dhe detyrim për kryerjen e punëve të detyrueshme / ka shkelje vetëm për ankuesen e parë

Neni 13

Mungesë e mjeteve efektive / e panevojshme për shqyrtim

Fjalët kyçe: mbajtje në robëri / punë e detyrueshme / imigrantë / kërcënim / trajtim çnjerëzor / frikë nga deportimi

Ankueset: C.N. (ankuesja e parë) dhe V. (ankuesja e dytë), shtetase franceze

Faktet e rastit

Ankueset, dy motrat të cilët kanë lindur në vitin 1978 dhe 1984 në Burundi, u larguan nga Burundi pas luftës civile të vitit 1993, gjatë së cilës prindërit e tyre u vranë. Ato arritën në Francë në vitin 1994 dhe 1995, me ndërmjetësimin e xhaxhait dhe gruas së tij (z. dhe znj. M.), shtetas të Burundit që jetonin në Francë. Këtyre të fundit iu është besuar kujdestaria e ankuesve dhe motrave të tyre më të reja në një takim familjar në Burundi. Z. dhe znj. M. jetonin në një shtëpi në Ville d'Avray me shtatë fëmijët e tyre, një prej të cilëve ishte me aftësi të kufizuara.

Ankueset u vendosën në bodrumin e shtëpisë dhe pretendonin se ishin detyruar të kryenin të gjitha punët e shtëpisë, pa ndonjë shpërblim ose pa ndonjë ditë pushimi. Ankuesja e parë pretendoi se i ishte kërkuar gjithashtu që të kujdeset për djalin me aftësi të kufizuara të z. dhe znj. M., duke përfshirë edhe gjatë natës. Ankueset pohonin se ato jetonin në kushte jo të higjienike (pa banjë, tualete të improvizuara), nuk iu ishte lejuar të ndanin ushqimet familjare dhe iu ishin nënshtruar ngacmimeve të përditshme fizike dhe verbale.

Më 19 dhjetor 1995, departamenti i veprimt shoqëror për Departamentin e Hauts de Seine paraqiti një raport mbi fëmijët në rrezik për prokurorin publik të Nantesit, por pas një hetimi nga ekipi policor i mbrojtjes së fëmijëve, u vendos që të mos ndërmerret ndonjë veprim tjetër.

Ankuesja e dytë ishte nxënëse në shkollën fillore "Ville d'Avray" nga viti 1995, pastaj në departamentin e mësimt të përgjithshëm dhe profesional (Segpa) të një shkolle të mesme të Versajës nga viti 1997. Përkundër vështirësive në integrimin dhe mësimin e gjuhës frënge, ajo pati rezultate të mira shkollore. Kur kthehej nga shkolla, ajo bënte detyrat e shtëpisë, pastaj ndihmonte motrën e saj me punët e shtëpisë. Ankueset

pohonin se ato ishin ngacmuar fizikisht dhe gojarisht në baza ditore nga znj. M, duke i kërcënuar rregullisht se do t'i kthente në Burundi. Po ashtu, znj. M kishte ndaluar së paguari tarifën mujore të transportit të shkollës për ankuesen e dytë. Disa herë z. M, pa dijeninë e së shoqes kishte paguar për transportin e V, gjë që kishte nevrikosur znj. M. Më 4 janar 1999 asociacioni "Enfance et Partage" tërhoqi vëmendjen e zyrës së prokurorit publik Nanterre për situatën e ankueseve; andaj të nesërmen, ankueset u larguan nga shtëpia e z. dhe znj. M. dhe u morën nën kujdesin e shoqatës.

Imuniteti diplomatik që gëzonte zoti M., për shkak se kishte qenë ministër i qeverisë së Burundit dhe punonjës i UNESCO-s, u hoq, ashtu siç u hoq edhe imuniteti i gruas së tij. Gjatë hetimeve paraprake ankuesja e dytë tha se ajo nuk kishte guxuar të jepte deklaratë në polici në vitin 1995 për shkak të frikës nga hakmarrja. Në kontekstin e hetimit gjyqësor që u hap më pas, ankueset konfirmuan se gjendja e tyre ishte përkeqësuar gradualisht që nga viti 1995, një pikë kur "gjërat nuk ishin (ende) duke shkuar shumë keq" me znj. M. Një raport mjekësor-psikologjik për aplikueset gjeti, ndër të tjera, se ndikimi psikologjik i akteve ndaj të cilave ishin nënshtruar, karakterizohet nga vuajtja mentale dhe, në rastin e ankuses së parë nga një përvojë e frikës dhe ndjenjës së braktisjes, pasi kërcënimi për t'u kthyer në Burundi ishte sinonim me mendimin e saj për kërcënimin me vdekje dhe braktisje të motrave të saj më të reja. Me një aktgjykim të 17 shtatorit 2007, Gjykata Penale Nanterre, gjeti z. dhe znj. M. fajtorë për të gjitha akuzat e ngritura kundër tyre (për të dy bashkëshortët, nënshtrimi i individëve në kushte pune dhe jetese të papërputhshme me dinjitetin njerëzor duke përfituar nga cenueshmëria ose gjendja e varësisë, dhe për znj. M. sulm i rëndë). Megjithatë, pas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Versajë, më 29 qershor 2009, u konfirmua vetëm dënimi i znj. M. për sulm të qëllimshëm dhe të rëndë kundër ankuses së dytë. Znj. M. u urdhërua të paguajë një gjobë penale prej 1.500 EUR dhe t'i paguajë ankuses shumë prej një EUR si kompensim për dëmin jo-material, në përputhje me kërkesën e saj. Prokurori publik nuk ka apeluar pikat/çështjet e ligjit kundër atij aktgjykimi. Ankesat në pikat e ligjit të parashtruara nga ankuesit dhe nga znj. M. u hodhën poshtë më 23 qershor 2010 nga Divizioni Penal i Gjykatës së Kasacionit.

Përmbledhje e pretendimeve

Duke u bazuar në Nenin 3 ankuesja e dytë pretendonte se ajo i ishte nënshtruar keqtrajtimit. Ankueset gjithashtu parashtruan se ishin mbajtur në robëri dhe ishin detyruar të kryenin punë të detyrueshme, duke pretenduar kështu shkelje të Nenit 4 të Konventës. Së fundmi, duke u mbështetur në Nenin 13, ato pohonin gjithashtu se nuk ishte kryer asnjë hetim efektiv në përgjigje të pretendimeve të tyre.

Arsyetimi i Gjykatës

Për sa i përket Nenit 3 të Konventës, meqë znj. M. ishte dënuar me aktgjykim final nga gjykatat e vendit për aktakuzën për sulm të rëndë dhe ankuesja e dytë kishte marrë kompensim që korrespondonte me shumë e kërkuar nga ajo, ankuesja nuk mund të pretendonte më si "viktimë" në kuptim të Nenit 34 të Konventës. Si rrjedhojë, Gjykata e hodhi poshtë këtë ankesë si qartazi të pabazuar.

Lidhur me pretendimet e ankueseve për shkelje të Nenit 4 të Konventës, Gjykata përsëriti se ky nen ruan një nga vlerat themelore të shoqërive demokratike. Paragrafi i parë i këtij neni nuk ka parashikuar përjashtime dhe asnjë përjashtim nuk është i lejueshëm, madje as në rast lufte apo të ndonjë emergjence tjetër publike që kërcënon jetën e kombit në kuptimin e Nenit 15 § 2 të Konventës. Gjykata më tej përsëriti se "puna e detyruar" në kuptim të Nenit 4 § 2 nënkuptonte punën e kryer "nën kërcënimin e ndëshkimit" dhe të kryer kundër vullnetit të personit në fjalë. Ishte e nevojshme të dallonim "punën e detyruar" nga puna e arsyeshme që mund të kërkohej në lidhje me ndihmën e ndërsjellë familjare ose bashkëjetesën, duke marrë parasysh, ndër të tjera, natyrën dhe sasinë e punës në fjalë. Në këtë rast, Gjykata vëren se ankuesja e pars me të vërtetë ishte detyruar të punonte jo-vullnetarisht. Përveç kësaj, ajo kishte qenë e detyruar të kryente aq shumë punë, që pa ndihmën e saj, z. dhe znj. M., do të kishin qenë të detyruar të punësonin një punonjës profesional me pagesë. Gjykata nuk arriti një përfundim të tillë në lidhje me ankuesen e dytë e cila nuk ofroi dëshmi se ajo kishte kontribuar disproporcionalisht në mirëmbajtjen dhe pastrimin e shtëpisë së z. dhe znj. M.

Sa i përket "kërcënimit për ndëshkim", Gjykata vuri në dukje se znj. M. kërcënoi rregullisht t'i dërgonte ankueset përsëri në Burundi, një vend që për ankuesen e parë ishte sinonim me vdekjen dhe braktisjen e motrave të saj më të reja. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se ajo i ishte nënshtruar "punës së detyruar" në kuptim të Nenit 4 § 2, ndryshe nga ankuesja e dytë për të cilën, Gjykata vlerësoi se puna e kryer nuk përfshihej në objektin e Nenit 4 § 2. Për më tepër, nuk ishte vërtetuar se keqtrajtimi i përjetuar nga ankuesja e dytë ishte i lidhur drejtpërdrejt me shfrytëzimin e supozuar; as nuk hynë brenda fushëveprimit të Nenit 4.

Gjykata më pas e konsideroi ekzistencën e "robërisë" në kuptim të Nenit 4 § 1, fillimisht duke theksuar se robëria ishte punë e detyruar e "rënduar", bazuar në faktin se ishte e pamundur për individin në fjalë që të ndryshonte situatën e tij. Në rastin konkret, karakteristika thelbësore që veçonte robërinë nga puna e detyruar ishte *ndjenja e viktimave që gjendja e tyre nuk mund të ndryshohej dhe se nuk kishte asnjë mundësi për ndryshim*, në veçanti besimi i ankuseses së parë se ajo nuk mund të shpëtojë nga kujdestaria e z. dhe znj. M., pa gjetur veten në një situatë të paligjshme dhe rezonimit të saj se pa ndonjë trajnim profesional, ajo nuk do të ishte në gjendje të gjejë punë jashtë asaj shtëpie. Pasi që kjo situatë ka zgjatur për katër vjet, Gjykata konsideroi se ankuesja e parë ishte mbajtur në gjendje të robërisë nga z. dhe znj. M. Ky nuk ishte rasti për ankuesen e dytë e cila, duke marrë parasysh se ajo kishte shkuar në shkollë, ajo është zhvilluar në një atmosferë tjetër dhe më pak të izoluar. Po ashtu, ajo kishte pasur kohë për të bërë detyrat e shtëpisë pas shkollës.

Në fund, Gjykata shqyrtoi çështjen e detyrimeve pozitive të Francës sipas Nenit 4 të Konventës. Gjykata fillimisht rikujton praktikën e vet gjyqësore përkatësisht në rastin *Siliadin*,²⁵ ku kishte trajtuar një situatë të ngjashme, dhe thekson se nga njëra anë, dispozitat përkatëse penale dhe interpretimi i tyre nuk i kishin ofruar viktimës mbrojtje praktike dhe efektive dhe, nga ana tjetër, ankesa në Gjykatën e Kasacionit kishte të bënte vetëm me aspektin civil të çështjes, meqë prokurori publik nuk kishte apeluar

²⁵ *Siliadin kundër Francës*, nr. 73316/01, GjedNj 2005-VII

çështjet ligjore në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit më 29 qershor 2009. Prandaj, Gjykata konstaton se ka shkelte të Nenit 4 në lidhje me ankuesen e parë sa i përket obligimit pozitiv të shtetit për të krijuar një kornizë adekuate legjislative dhe administrative për të luftuar efektivisht robërinë dhe punën e detyruar. Sa i përket detyrimit të shtetit për të hetuar situatat e shfrytëzimit të mundshëm, Gjykata gjeti se nuk kishte arsye për të vënë në pikëpyetje përfundimet e hetimit të kryer nga ekipi për mbrojtjen e fëmijëve në vitin 1995. Gjykata theksoi gjithashtu se ankueset kishin pranuar se situata nuk ishte përkeqësuar ende në atë kohë. Si pasojë, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 4 lidhur me detyrimin e shtetit për të kryer një hetim efektiv në rastet e robërisë dhe të punës së detyruar. Duke pasur parasysh këtë përfundim, nuk e ka konsideruar të nevojshme të shqyrtojë veçmas ankesën e ankuesve sipas Nenit 13 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 4 të Konventës në lidhje me ankuesën e dytë, ndërsa për ankuesen e parë ka shkelje në aspektin substancial por jo edhe atë procedural, ndërsa shpalli si të panevojshme për shqyrtim pretendimet për Nenin 13 lidhur [njëzëri].

Neni 5

E drejta për liri dhe siguri

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:
 - a) kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;
 - b) kur arrestohet ose burgoset ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;
 - c) kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;
 - d) kur një i mitur ndalohet ligjërisht, për qëllim edukimi të mbikëqyrur, ose për ndalimin e tij të ligjshëm, me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor;
 - e) kur individët ndalohen ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;
 - f) kur një person arrestohet ose ndalohet ligjërisht, me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose për një person kundër të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;
2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.
3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij Neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet nga garanci për t'u paraqitur para gjykatës.
4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.
5. Çdo person, që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij Neni, ka të drejtën e zbatueshme të dëmshpërblimit.

Schwabe dhe M.G. kundër Gjermanisë - 8080/08; 8577/08

1 dhjetor 2011 [Seksioni i Pestë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5(1)

Cënim i lirisë personale, si rezultat i paraburgimit me qëllimin të parandalimit të pjesëmarrjes në protestat / *ka shkelje*

Neni 11

Privim nga liria e tubimit paqesor si pasojë e mbajtjes në paraburgim gjatë gjithë kohë së mbajtjes së protestës / *ka shkelje*

Neni 10

Cënim i lirisë së shprehjes si pasojë e mbajtjes në paraburgim dhe pamundësismit të pjesëmarrjes në protestë / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: *protesta / G8 / parulla / demonstrues / parandalim / paraburgim / ndalim i tubimit / mospjesëmarrje në protesta / nxitje e protestave*

Ankuesit: z. Sven Schwabe dhe M.G., shtetasë gjerman, të lindur në vitin 1985 dhe që jetojnë në Bad Bevensen dhe Berlin, respektivisht. Ankuesit parashtuan ankesa të ndara të cilat Gjykata kishte vendosur që t'i bashkonte pasi kishin të bënë me të njëjtën çështje.

Faktet e rastit

Në qershor të vitit 2007, ankuesit udhëtuan për në Rostok me qëllimin që të merrnin pjesë në protestat kundër samitit të grupit të tetë shteteve, të njohur si G8. Samiti i G8-tës ishte planifikuar në mbahej në datat 6 deri më 8 qershor 2007 në Heiligendamm, në periferi të Rostokut në Gjermani. Policia kishte vlerësuar se kishte një kërcënim për sulme terroriste gjatë samitit, sidomos nga grupet islamiste. Për më tepër, marrë parasysh përvojat e samiteve të tilla të mëparshme, ata vlerësuan se kishte gjithashtu rreziqe për dëmtim të pronës nga ekstremistët e majtë. Sipas policisë, këta të fundit kishin planifikuar që të protestojnë kundër samitit, ta bllokojnë dhe sabotojnë atë.

Sipas vlerësimeve të policisë, pritej të kishte rreth 25 mijë protestues në protestën e 2 qershorit 2007, prej të cilëve rreth dy mijë e pesëqind të gatshëm për të përdorur dhunë, si dhe rreth 15 mijë protestues të pranishëm gjatë samitit, një mijë e pesëqind prej të cilëve do të ishin të gatshëm të përdornin dhunë. Siç edhe ishte pritur trazira serioze kishin shpërthyer në qendër të qytetit Rostok më 2 qershor 2018, ku rreth 400 policë ishin lënduar.

Në qershor të vitit 2007, ankuesit udhëtuan për në Rostok me qëllim pjesëmarrjeje në protestat kundër samitit të G8-tës. Në mbrëmjen e 3 qershorit, ata ishin ndaluar nga policia për verifikim të identitetit në një parking automjetesh përpara burgut në afërsi të Rostokut. Sipas policisë, njëri prej ankuesve kishte rezistuar fizikisht kundër

verifikimit të identitetit. Policia kishte gjetur në automjetet parulla me mbishkrimin “liri për të gjithë të burgosurit” dhe “lironi të gjithë tash”. Ankuesit ishin arrestuar.

Në mëngjesin e hershëm të datës 4 qershor 2007, Gjykata e Qarkut të Rostokut kishte urdhëruar paraburgimin e ankuesve deri më së voni në mesditën e datës 9 qershor 2007. Në arsyetimin e saj, Gjykata kishte gjetur se paraburgimi i ankuesve ishte i ligjshëm, pasi ishte bërë me qëllimin të parandalimit të kryerjes së veprës penale. Pasi në veturë u ishin gjetur parulla që bënin thirrje për lirim të të gjithë të burgosurve, ishte supozuar që ata do të kryenin, ndihmonin ose bashkëpunonin në kryerjen e një veprë penale. Të njëjtën ditë, Gjykata Rajonale e Rostokut kishte hedhur poshtë ankesën e ankuesve. Kjo gjykatë erdhi në përfundimin se nga parullat dilte se ankuesit kishin për qëllim t’i nxisnin të tjerët që të lironin të burgosurit, diçka që përbënte shkelje ligjore.

Ankesat e mëpastajme të ankuesve—që argumentonin se slloganet e tyre u drejtoheshin policëve, duke i nxitur ata që t’u jepnin fund arrestimeve të panumërta dhe burgosjes së protestuesve, dhe nuk ishin menduar si thirrje e të tjerëve për të liru të burgosurit me forcë—ishin hedhur poshtë edhe nga Gjykata e Apelit të Rostokut më 7 qershor 2007. Gjykata e Apelit kishte deklaruar se, edhe pse slloganet mund të kuptoheshin në mënyra të ndryshme, policia ishte e autorizuar, në dritën e gjendjes së sigurisë në Rostok përpara samitit të G8-tës, që të parandalonte deklaratimet e mjegullta që mund të paraqisnin rrezik për sigurinë publike.

Derisa ndodheshin në paraburgim, ankuesit gjithashtu kishin paraqitur ankesat e tyre në Gjykatën Federale Kushtetuese dhe kishin kërkuar si masë mbrojtëse të përkohshme lirim të menjëhershëm. Më 8 qershor, ata ishin njoftuar se Gjykata Kushtetuese nuk do të merrte vendim ndaj kërkesës për masë të përkohshme. Më 9 qershor, në mesditë, ata u liruuan., Gjykata Kushtetuese kishte refuzuar shqyrtimin e ankesës së tyre kushtetuese më 6 gusht 2007. Ndërsa procedurat penale, që kishin nisur kundër ankuesve për pengim të zyrtarëve publikë në ushtrimin e detyrave të tyre, ishin ndërprerë më vonë.

Përmbledhje e pretendimeve

Qeveria në kundërshtimet preliminare kishte paraqitur pikëpamjen se ankuesit nuk kishin shterur mjetet e brendshme juridike, pasi ata nuk kishin ndërmarrë veprime për dëmshpërblim për paraburgimin e pretenduar si të kundërligjshëm në gjykatat gjermane përpara se të sillnin rastin në Gjykatë. Ndryshe, Qeveria ishte pajtuar që ankuesit kishin përdorur të gjitha mjetet ekzistuese në lidhje me paraburgimin e tyre. Ankuesit, nga ana e tyre, kishin kontestuar këtë pikëpamje, duke pohuar se ata janë ankuar në lidhje me atë se mbajtja në paraburgim ka shkelur të drejtat e tyre themelore. Procedurat për zhdëmtim në gjykatat civile nuk do të kishin mundësinë e një veprimi më të gjerë dhe nuk do të shërbenin si mjet efektiv për të sjellë një vendim të shpejtë në lidhje me ligjshmërinë e paraburgimit dhe lirim të tyre nëse mbajtja në paraburgim do të vlerësohej si e kundërligjshme. Për më tepër, fillimi i një rasti të ri për dëmshpërblim pasi vendimi për paraburgim nga gjykatat e Rostokut ishte konsideruar i ligjshëm nuk do të kishte perspektivë suksesi.

Për sa u përket meritave të rastit, ankuesit kanë pretenduar se mbajtja e tyre në paraburgim ndërmjet datës 3 dhe 9 qershor 2007, ka çënuar të drejtën e tyre sipas Nenit

5 § 1 të Konventës. Sipas tyre, ky veprim nuk është justifikuar sipas asnjërës prej bazave të listuara në nën-paragrafët e kësaj dispozite. Më konkretisht, ankuesit kanë argumentuar se ata nuk ishin paraburgosur në ndërlidhje me procedura penale, siç kërkohet nga nën-paragrafi (c) i Nenit 5 § 1 dhe siç është interpretuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës. Sipas tyre, kjo është dëshmuar edhe nga fakti se paraburgimi i tyre nuk është mbështetur në seksionin 112 të Kodit të Procedurës Penale, por përkundrazi në seksionet 55 dhe 56 të Aktit për Rendin dhe Sigurinë Publike, që rregullojnë paraburgimin për qëllime parandalimi pa ndonjë lidhje me procedurat penale. Përveç tjerash, ankuesit kanë pretenduar se paraburgimi i tyre ka qenë arbitrar, për atë se nuk ka qenë i nevojshëm për të arritur qëllimin e synuar. Policia thjesht do të mund të urdhëronte ankuesit që të mos hynin në zonën ku ishin zhvilluar protestat kundër samitit të G8-tës ose, si alternativë, do të mund t'ua konfiskonin parullat. Qeveria, nga ana e saj, ka paraqitur pikëpamjen se paraburgimi i ankuesve është bërë në pajtim me Nenin 5 § 1 të Konventës. Sipas Qeverisë, ky veprim është justifikuar mbi bazën e alternativës së dytë të nën-paragrafit (c) të Nenit 5 § 1, pasi paraburgimi në mënyrë të arsyeshme ishte vlerësuar i nevojshëm për të parandaluar ankuesit nga kryerja e një vepre penale. Përveç tjerash, Qeveria gjithashtu ka argumentuar se paraburgimi ka qenë i ligjshëm dhe në pajtim me procedurën e përcaktuar nga ligji. Sipas pikëpamjes së Qeverisë, paraburgimi i ankuesve gjithashtu ka qenë i përpjestueshëm dhe jo-arbitrar.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata së pari ka vlerësuar çështjen pranueshmërisë, respektivisht pretendimet e palëve në lidhje me shterimin ose jo të mjeteve të brendshme juridike. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se ankuesit janë ankuar në lidhje me paraburgimin e tyre për qëllime parandalimi gjatë samitit të G8-tës dhe se ata më parë kanë kontestuar ligjshmërinë e urdhërit për paraburgim para të gjitha gjykatave vendore kompetente. Duke ju referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës, në këtë mënyrë ata kanë shterur mjetet e brendshme juridike për qëllime të ankesës së tyre në lidhje me Nenin 5 § 1. Si rezultat, kundërshtimi i Qeverisë për mos-shterje duhet hedhur poshtë. Më tej, Gjykata vlerëson se nuk ka arsye të tjera për të cilat rasti do të mund të shpallej i papranueshëm, dhe kësaj Gjykata e shpallë rastin të pranueshëm.

Më tej, Gjykata ka rikujtuar se Neni 5 § 1, nën-paragrafët (a) deri te (f), përmbajnë një listë shteruese të bazave të lejueshme për privimin e lirisë, dhe se asnjë privim i lirisë nuk do të ishte i ligjshëm nëse nuk bie brenda njërës prej këtyre kategorive.

Së pari, Gjykata ka shqyrtuar çështjen nëse paraburgimi ka qenë i justifikuar në bazë të Nenit 5§1(c) si masë e arsyeshme për të parandaluar ata nga kryerja e një vepre penale. Gjykata ka vërejtur se gjykatat gjermane kanë dalluar mes vete sa i përket veprës specifike që ata do të kryenin. Derisa Gjykata e Qarkut dhe ajo Rajonale kanë vlerësuar se ata kanë pas si qëllim të nxisin të tjerët për të liruar të burgosurit me forcë për çfarë arsye edhe janë arrestuar, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se qëllimi i tyre ka qenë që të udhëtojnë në Rostok dhe të nxisin masën në protesta, duke shpalosur parullat.

Sipas Gjykatës, ankuesit janë mbajtur në ndalim për një kohë të konsiderueshme, prej pesë ditë e gjysmë. Për më tepër, mbishkrimet në parulla do të mund të kuptoheshin në mënyra të ndryshme, siç e ka pranuar edhe Gjykata e Apelit. Ka qenë e

pakontestueshme që ankuesit nuk kanë qenë në posedim të ndonjë instrumenti që do të mund t'u shërbente atyre për të liruar të burgosurit në mënyrë të dhunshme. Andaj, Gjykata nuk mundi të bindej se vazhdimi i mbajtjes së tyre në paraburgim do të mund të konsiderohej në mënyrë të arsyeshme si masë e nevojshme për të parandaluar ata nga kryerja e një vepre penale mjaftueshëm konkrete dhe specifike. Për më tepër, nuk është bindur se paraburgimi i tyre në radhë të parë ka qenë i nevojshëm, pasi që do të ishte e mjaftueshme që t'u konfiskoheshin parullat me qëllimin për t'i parandaluar ata nga nxitja e të tjerëve për të liruar të burgosurit.

Gjykata ka marrë në shqyrtim argumentin e Qeverisë se, pa mundësinë e ndalimit ose paraburgimit të individëve për qëllime parandalimi, shteti nuk mund të zbatojë detyrimet e veta për mbrojtjen e qytetarëve nga veprat e pashmangshme penale. Në rastin konkret, sidoqoftë, madje duke marrë për bazë edhe situatën e përgjithshme para dhe gjatë samitit të G8-tës, nuk është dëshmuar mjaftueshëm se lirimi i të burgosurve ka qenë i afërt ose i menjëhershëm. Si rezultat, kryerja e kësaj vepre nuk justifikon ndërhyrjen në të drejtën e lirisë, veçanërisht kur ka qenë e mundur të merreshin masa më pak të ashpëra. Kësisoj, Gjykata ka gjetur shkelje të Nenit 5 § 1 të Konventës.

Sa i përket ankesave në lidhje me Nenin 10 dhe 11, ato kryeshit kishin të bënin me të drejtën për liri të tubimit. Për këtë arsye, Gjykata ka vendosur që të shqyrtojë këtë pjesë të ankesës vetëm mbi bazën e Nenit 11 (liria e tubimit dhe e organizimit). Në lidhje me këtë pretendim, nuk është kontestuar nga palët se mbajtja në ndalim e ankuesve ka ndërhyrë në të drejtën e tyre të lirisë së tubimit paqësor, pasi ata janë parandaluar nga pjesëmarrja në protestat kundër samitit të G8-tës. Gjykata ka gjetur që qëllimi i autoriteteve për të paraburgosur ankuesit, me qëllimin për të parandaluar ata nga kryerja e një krimi, si i tillë ka qenë legjitim. Megjithatë, siç ka theksuar Gjykata në lidhje me Nenin 5, nuk është konstatuar se ankuesit kishin si qëllim që, përmes shpalosjes së parullave, në mënyrë të qëllimshme të nxisnin protestuesit e tjerë që të përdornin forcën për lirimin e të burgosurve. Për më tepër, Gjykata gjeti se, duke marrë pjesë në protestat kundër samitit të G8-tës, ankuesit kishin si qëllim të merrnin pjesë në një debat për çështje të interesit publik, më konkretisht në lidhje me efektet e globalizimit në jetët e njerëzve. Për më tepër, Gjykata nuk ishte e bindur se nuk mund të gjendeshin masa më pak të ashpëra për të arritur qëllimet në mënyrë të përpjestueshme, siç do të ishte konfiskimi i parullave. Për këto arsye, Gjykata konstaton se ka pas shkelje të Nenit 11 të Konventës.

Gjykata ka urdhëruar shtetin gjerman që t'i paguajë secilit ankues individualisht shumën në vlerë prej 3,000 EUR për dëme jo-materiale, si dhe 4,233.35 EUR ankuesit të parë dhe 4,453.15 EUR ankuesit të dytë për kostot dhe shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 5(1) dhe Nenit 11 të Konventës [njëzëri].

McKay kundër Mbreterisë së Bashkuar - 543/03

3 tetor 2006 [Seksioni i Tretë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5 § 3

Shkelje e të drejtës në liri si pamundësi e paraqitjes para një gjyqtari që kishte kompetencë ligjore të aprovonte lirim nga paraburgimmi / nuk ka shkelje.

Fjalët kyçe: të drejtat e njeriut / të drejtat civile dhe politike / e drejta për gjykim të drejtë / e drejta për liri dhe sigurinë e personit

Ankuesi: z. Mark McKay, shtetas Britanik

Faktet e rastit

Më 6 janar 2001, në ora 10:00, ankuesi i u arrestua me dyshimin për kryerjen e një grabitje të një stacioni të benzinës në Bangor, Qarku Down. Më 7 janar 2001, ai pranoi se ishte përgjegjës për grabitjen, për të cilën u akuzua më pas ditën e nesërme. Më 8 janar 2001, në orën 10:00, ankuesi bëri paraqitjen e tij të parë në gjykatën e magistraturës, ku ai i udhëzoi avokatët e tij që të bënin një kërkesë për lirim me kusht. Oficeri i policisë i dha dëshmi gjykatës duke deklaruar se vjedhja nuk ishte e lidhur me terrorizmin dhe se, sipas kushteve të duhura, ndaj tij nuk duhet të kishte asnjë kundërshtim për lirim me kusht. Gjyqtari rezident e refuzoi kërkesën, duke treguar se vepra penale ishte një vepër e caktuar dhe se në bazë të legjislacionit në fuqi ai nuk kishte fuqinë për të urdhëruar lirim. Më 8 janar 2001, ankuesi aplikoi në Gjykatën e Lartë për lirim me kusht. Ku kjo e fundit ndëgjoi kërkesën e tij më Më 9 janar 2001 dhe aprovoi atë.

Më 12 prill 2001, pranë Gjykatës së Kurorës ankuesi u deklarua fajtor në për një vepër të vjedhjes dhe u dënua me dy vjet burgim në një institucion të korektues të kryesve të veprave penale të rinj, pasuar me një vit i sprovues. Ankuesi bëri një kërkesë për shqyrtim gjyqësor që kërkonte një deklaratë të papajtueshmërisë së legjislacionit me Nenet 5 dhe 14 të Konventës. Më 3 maj 2002, Gjykata e Lartë hodhi poshtë kërkesën e ankuesit. Gjykatësi hodhi poshtë gjithashtu argumentet sipas Nenet 14 që akuzat se pjesëtarët e forcave të sigurisë u trajtuan më mirë në lidhje me lirim me kusht se të akuzuarit e tjerë dhe refuzuan lejen për t'u ankuar. Më 16 maj 2002, Gjykata e Divizionit refuzoi lejen për të apeluar në Dhomën e Lordëve edhe pse e vërtetuar si pikë të ligjit me rëndësi të përgjithshme publike nëse legjislacioni ishte në përputhje me Konventën dhe nëse Neni 5 kërkoi që gjykata para së cilës të sillt një i akuzuar në pajtim me Nenin 5 § 3, ka fuqinë ta vendosë për lirim me kusht. Më 4 dhjetor 2002, e drejta për apelim u refuzua nga Dhoma e Lordëve.

Ligji dhe praktika përkatëse vendase që rregullon çështjen në fjalë bazohet në Nenin 67 (2) të Aktit të Terrorizmit 2000 (i cili hyri në fuqi më 19 shkurt 2001 është në thelb i njëjtë me Nenin 3 (2) të Aktit 1996 të Irlandës së Veriut (Dispozitat Emergjente) në fuqi në kohën e paraqitjes së ankuesit) i cili ndër tjera parasheh se:

"Duke iu nënshtuar nënseksioneve (6) dhe (7) një person për të cilin zbatohet ky seksion nuk do të lirohet me kusht, përveç:

(a) nga një gjyqtar i Gjykatës së Lartë ose i Gjykatës së Apelit, ose

(b) nga gjyqtari i gjykatës së gjykimit për shtyrjen e gjykimit të një personi të akuzuar për vepër penale të caktuar."

Juridiksioni i vetëm i Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Apelit dhe Gjyqtarit të Gjyqit për dhënien e lirimit me kusht në rast të veprave penale të planifikuara daton nga viti 1973 dhe bazohet në dispozitat origjinale të Ligjit të Irlandës së Veriut (Dispozitat Emergjente) 1973. Arsyetimi rrjedh nga Raporti Diplock ("Raporti i Komisionit për të shqyrtuar procedurat ligjore për të trajtuar veprimtaritë terroriste në Irlandën e Veriut" (1972 Cmst 5185), i cili konkludoi se magjistratët rezidentë që dëgjuan kërkesat për dorëzanimë ishin veçanërisht të ndjeshëm ndaj kërcënimeve. Akti i vitit 2000 parasheh pozitën që do të shqyrtohet çdo vit nga Parlamenti dhe deri më tani është ripërtirë për 12 muaj të tjerë. Në raportin e vitit 2002 të Rishikuesit të Pavarur, Lordi Carlile i Berrië Q.C. rekomandoi kthimin e kërkesave për dorëzani në gjykatën e magjistraturës. Ai rekomandoi që pushteti t'i jepej një numri të vogël të magjistratëve të trajnuar posaçërisht. Megjithatë, në raportin e tij të vitit 2004, ai vuri në dukje një rrezik të vazhdueshëm nga krimi i sofistikuar terrorist dhe shumë vepra të rënda penale me një lidhje të fortë terroriste, me krimin e bashkuar me një lidhje paraushtarake në rritje dhe me nivele të konsiderueshme të frikësimit. Gjatë marrjes në konsideratë për dhënien apo jo të magjistratëve rezidentë për t'u marrë me kërkesat për dorëzanimë, ai nuk e përsëriti rekomandimin e tij të mëparshëm, duke vërejtur se vlerësimi i sigurisë ishte se do të kishte një kërcënim të madh të frikësimit dhe dhunës ndaj tyre dhe atyre afër tyre. Ai megjithatë pajtohet që seancat e lirimit me kusht duhet të jenë në dispozicion gjatë fundjavave dhe ky ndryshim është sjellë menjëherë në fuqi.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi u ankua për faktin se personat e akuzuar për vepra penale të planifikuara nuk mund të aplikojnë për dorëzani përpara gjykatës së magjistraturës. Atyre u kërkohet të bëjnë një kërkesë në Gjykatën e Lartë dhe mund të jetë deri në katër ditë më vonë para se të dëgjohej kërkesa, gjë që sipas tij është në kundërshtim me Nenin 5 të Konventës pasi ndan kompetencën për dhënien e lirimit me kusht nga gjykata, para së cilës një i akuzuar është sjellë në pajtim me Nenin 5 § 3 dhe e lë të akuzuarin të kërkojë me kusht diku tjetër nga propozimi i tij.

Qeveria parashtrroi se qëllimi i Nenit 5 § 3 ishte të siguronte një mbrojtje kundër paraburgimit arbitrar duke ofruar një shqyrtim të pavarur për arsyet e ndalimit të një të akuzuari dhe për të siguruar lirimin nëse vazhdimi i paraburgimit nuk ishte i justifikuar. Zyrtari gjyqësor në fjalë duhej të ishte i pavarur me fuqinë për të urdhëruar lirimin. Megjithatë, sipas Qeverisë asgjë në tekstin e Nenit 5 ose në jurisprudencën e Gjykatës nuk kërkon që gjykata para së cilës duhet të sillet një person i arrestuar duhet të jetë e njëjta gjykatë që ka fuqinë të vendos mbi dorëzanimin dhe lirimin e kusht. Sipas Qeverisë personi i ndaluar duhet të sillet menjëherë përpara një gjykate ose zyrtari të autorizuar për të ushtruar pushtetin gjyqësor; ai duhet gjithashtu të ketë mundësinë për të aplikuar për librim me kusht. Vetëm e para kërkohet të jetë automatike; e dyta - çështja e lirimit me kusht, bëhet relevante vetëm kur arrestimi dhe paraburgimi të

konsiderohen të ligjshme dhe nuk përbënin domosdoshmërisht pjesë të rishikimit automatik të meritave.

Qeveria parashtroi se Neni 5 § 3 u respektua në rastin e ankuesit. Gjyqtari kujdestar/magjistrati ishte në gjendje të rishikonte bazën ligjore në të cilën kërkuesi ishte i ndaluar dhe duhej të bindte se arrestimi dhe paraburgimi ishin të ligjshëm dhe si rrjedhojë nuk ishin arbitrare; nëse ai nuk do të ishte aq i kënaqur, ai do të ishte i detyruar të urdhëronte lirimin e ankuesit. Kështu, parashtuesi i kërkesës mori një shqyrtim të shpejtë nga një gjyqtar i bazës ligjore të arrestimit dhe vazhdimin të paraburgimit të tij. Ai gjithashtu kishte të drejtë dhe mori një shqyrtim të shpejtë nga një gjyqtar i Gjykatës së Lartë për të drejtën e tij për lirimin me kusht. Duke iu referuar kufijve të vlerësimit, përfaqësuesit e Qeverisë konkluduan se legjislacioni përfaqësonte një ekuilibër të drejtë midis të drejtave individuale dhe kërkesave të mbrojtjes së shoqërisë kundër një rreziku të vazhdueshëm nga krimi terrorist dhe një shkallë të lartë kërcënimi dhe ishte plotësisht në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Konventës në promovimin e sundimit të ligjit.

Ankuesi në anën tjetër pohoi se regjimi i veprave penale të planifikuara mbulonte shumë raste, të tilla si rasti i tij, ku nuk kishte as dyshim të bazuar për lidhje me terrorizmin dhe rrjedhimisht arsyetimi i Qeverisë nuk kishte bazë në fakt apo në politikë. Mbështetja në kërcënimet e mundshme të gjyqtarëve/magjistratëve në rastet terroriste nuk mund të justifikonte logjikisht heqjen e juridiksionit të tyre për të vendosur lidhur me çështjet e lirit me kusht. Ankuesi argumentoi se gjyqtari para të cilit shfaqet një i akuzuar duhej të ushtronte një autoritet gjyqësor, jo thjesht juridiksionin për të vendosur lidhur me ligjshmërinë e paraburgimit, por gjithashtu nëse paraburgimi është i justifikuar objektivisht në bazë të meritave. Tutje sipas tij praktika gjyqësore e Gjykatës tregoi se rishikimi duhej të ishte mjaft i gjerë për të përfshirë rrethanat e ndryshme që ishin në favor të dhe kundër ndalimit. Edhe nëse hetimi mbi ligjshmërinë formale i parapriu logjikisht një hetim mbi përshtatshmërinë e lirit me kusht, ishte jo duhur interpretimi i jurisprudencës duke lejuar heqjen e juridiksionit për të konsideruar lirimin me kusht. Sipas ankuesit detyrimi i pakushtëzuar që një person i ndaluar të shfaqet përpara një zyrtari të tillë bie mbi shtetin dhe duhej të ndodhte menjëherë dhe automatikisht.

Prandaj, ankuesi parashtroi se në rastin e tij kishte shkelje të Nenit 5 § 3 që gjyqtari/magjistrati nuk kishte fuqi të merrte parasysh lirimin me kusht dhe se atij i kërkohej, me propozimin e tij, të bënte një kërkesë për dorëzani. Një kërkesë e tillë mund të ndikojë veçanërisht tek personat më të brishtë, siç janë të dobëtit apo të sëmurët mendorë, ata që i nënshtrohen keqtrajtimit në paraburgim ose që nuk janë në gjendje të flasin gjuhën e gjykatës.

Arsyetimi i Gjykatës

Duke pasur parasysh ankesat e ankuesit dhe parashtimet e palëve, Gjykata gjen se linden pyetje serioze të fakteve dhe të ligjit, përcaktimi i të cilave duhet të varet nga shqyrtimi i bazueshmërisë. Ankesa nuk mund të konsiderohet si e pabazuar në kuptim të Nenit 35 § 3 të Konventës meqëse asnjë arsye tjetër për shpalljen e saj të papranueshme nuk është përcaktuar.

Gjykata vëren se ankuesi u arrestua më 6 janar 2001 në orën 10:00, me dyshimin për kryerjen e një vjedhje të një stacioni të benzinës, ndërsa u akuzua në orën 12.37 të mëngjesit, ditën pasuese. Më 8 janar 2001, në orën 10:00, ankuesi bëri paraqitjen e tij të parë në gjykatën e magjistraturës, e cila e ktheu në paraburgim. Për Gjykatën nuk është çështje diskutabile se magjistrati kishte kompetencën për të shqyrtuar ligjshmërinë e arrestimit dhe paraburgimit dhe nëse kishte baza të arsyeshme për dyshim dhe për më tepër që ai kishte fuqinë të urdhëronte lirimin nëse këto kërkesa nuk ishin respektuar. Kjo vetëm siguroi garanci të kënaqshme kundër keqpërdorimit të pushtetit nga ana e autoriteteve dhe siguroi përputhjen me pjesën e parë të Nenit 5 § 3 si të menjëhershme, automatike dhe duke u zhvilluar para një zyrtari gjyqësor të autorizuar në mënyrë të rregullt.

Çështja e lirimit në pritje të gjykimit ishte një çështje e veçantë e cila logjikisht u bë e rëndësishme vetëm pas themelimit të ekzistencës së një baze të ligjshme dhe një baze të konventës për paraburgim. Në rastin e ankuesit, çështja u trajtua rreth njëzet e katër orë më vonë, më 9 janar 2001, nga Gjykata e Lartë e cila urdhëroi lirimin e tij. Asnjë element i abuzimit ose arbitraritetit të mundshëm nuk vjen nga fakti se ishte një gjykatës tjetër apo gjykatës që e bëri këtë, as nga fakti që shqyrtimi ishte i varur nga kërkesa e tij. Avokati i ankuesit paraqiti një kërkesë të tillë pa ndonjë pengesë ose vështirësi; nuk është e dukshme dhe as nuk duhet të vendoset në këtë rast, se sistemi në veprim do të parandalonte të dobëtit ose të pambrojturit që ta shfrytëzonin këtë mundësi.

Ndonëse është e vërtetë se policia nuk kishte asnjë kundërshtim për lirimin me kusht dhe se nëse magjistrati kishte pasur të drejtën të liroj me kusht, ankuesi do të lirohej një ditë më parë, megjithatë Gjykata konsideron se procedura në këtë rast është kryer me shpejtesinë e duhur, që çoi në lirimin e tij tri ditë pas arrestimit të tij. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të Nenit 5 § 3 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se nuk ka shkelje të Nenit 5 të Konventës [*gjashtëmbëdhjetë vota pro/një kundër*]

Baranowski kundër Polonisë - 28358/95

28 mars 2000 [Seksioni i Parë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5 §§ 1 dhe 4

Shkelje e të drejtës në liri si pasojë e vazhdimit të paraburgimit në mënyrë të jashtëligjshme pa vendim të gjykatës / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *paraburgim / vazhdim i paraburgimit / pa vendim / jo ligjorë / mos-efikasitet*

Ankuesi: z. Janusz Baranowski, shtetas polak i lindur në vitin 1943 dhe që jetonte në Lodz (Poloni).

Faktet e rastit

Ankuesi ishte themelues dhe president i pronës së parë polake në pronësi private, kompania e sigurimeve 'Westa' (e deklaruar insolvente në vitin 1993). Ai ishte gjithashtu një politikan i mirënjohur dhe, në fillim të viteve 1990, ishte senator (anëtar i Dhomës së Sipërme të Parlamentit Polak). Më 2 qershor 1993, Prokurori Rajonal i Lodzit e akuzoi aplikuesin për mashtrim dhe e futi në paraburgim. Më 30 dhjetor 1993, Gjykata Rajonale e Lodzit, me kërkesë të prokurorit, e zgjati paraburgimin e ankuesit deri më 31 janar 1994. Më 7 janar 1994, ankuesi paraqiti ankesë kundër këtij vendimi. Në procedurat pasuese, gjykata e apelit vendosi që 'ishte e pakuptimtë' të shqyrtojë ankesën dhe vendosi që ajo të konsiderohej si një kërkesë për lirim. Ai e dërgoi ankesën në Gjykatën Rajonale të Lodzit. Megjithatë, Gjykata Rajonale nuk e shqyrtoi ankesën në fjalë as si një kërkesë për lirim, ose nën ndonjë arsye tjetër.

Më 11 janar 1994, Prokurori Rajonal Lodz paraqiti një aktakuzë në Gjykatën Rajonale të Lodzit. Më 1 shkurt 1994, ankuesi paraqiti një petition formal ndaj Prokurorit të Qarkut, duke e informuar atë se urdhri për paraburgimin e tij kishte skaduar më 31 janar 1994 dhe andaj paraburgimi i tij i vazhdueshëm ishte bërë i paligjshëm. Në fazën e mëvonshme të procedurës, ankuesi u informua nga autoritetet që paraburgimi i tij vazhdoi nën të njejtën aktakuzë dhe se, sipas praktikës së brendshme, ndalimi i tij ishte ende i ligjshëm, sepse pas ngritjes së aktakuzës në gjykatë, nuk kishte nevojë të nxirrej një vendim i veçantë për zgjatjen e paraburgimit.

Më 7 shkurt dhe 28 mars 1994, ankuesi paraqiti dy kërkesa për lirim në Gjykatën Rajonale Lodz, duke argumentuar, në veçanti, se ai duhet të lirohet për arsye shëndetësore. Gjykata konsideroi se duhen prova nga ekspertë mjekësore. Për të marrë këto prova, ajo shtyu shqyrtimin e kërkesave në pesë raste. Përfundimisht, këto dy kërkesa u shqyrtuan bashkërisht: më 24 maj 1994 në shkallën e parë dhe më 5 korrik 1994 në apel. Më 22 tetor 1996 ankuesi u lirua nën mbikëqyrjen e policisë. Procedurat penale kundër tij ende janë në pritje në gjykatën e shkallës së parë.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi u ankua se paraburgimi i tij, në masën që ishte kryer nën aktakuzë dhe pas skadimit të urdhrit të paraburgimit të 30 dhjetorit 1993, nuk ishte 'i ligjshëm' brenda kuptimit të Nenit 5 § 1 të Konventës. Ai gjithashtu u ankua se gjykatat polake nuk kishin shqyrtuar 'shpejtë' ligjshmërinë e paraburgimit të tij sipas aktakuzës dhe prandaj kishin shkelur Nenin 5 § 4 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me Nenin 5 § 1 të Konventës, Gjykata fillimisht i referohet jurisprudencës së saj mbi standardin e "ligjshmërisë" të përcaktuar nga Konventa, duke theksuar, në veçanti, se është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë sipas legjislacionit të brendshëm duhet të *përcaktohen qartë dhe vetë ligji duhet të jetë i parashikueshëm* në zbatimin e tij.²⁶

Sa i përket rastit të ankuesit, Gjykata vërejti se ndërmjet 31 janarit dhe 24 majit 1994 nuk kishte pasur vendim gjyqësor që autorizonte ndalimin e tij dhe se ai ishte mbajtur në paraburgim vetëm në bazë të faktit se një aktakuzë ishte dorëzuar në gjykatën përkatëse. Më tutje Gjykata vërejti se praktika e mbajtjes së një personi në paraburgim sipas aktakuzës nuk ishte bazuar në ndonjë dispozitë specifike legjislative ose jurisprudencë por rrjedh nga fakti që legjislacioni penal polak në atë kohë kishte mungesë të rregullave të qarta të përcaktimit të gjendjes së një të paraburgosuri në procedurat gjyqësore pas skadimit të një urdhri të paraburgimit të bërë në fazën e hetimit.

Gjykata konsideroi se legjislacioni përkatës, për shkak të kësaj gjendjeje ligjore, nuk e plotësonte provën e "parashikueshmërisë" së një "ligji" për qëllimet e Nenit 5 § 1 të Konventës. Ajo gjithashtu konsideroi se praktika e zhvilluar në përgjigje të zbrazëtirave ligjore, ku një person arrestohej për kohë të pakufizuar dhe të paparashikueshme dhe pa e bazuar ndalimin e tij/saj në dispozitë ligjore konkrete ose ndonjë vendim gjyqësor, ishte në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike.

Gjykata më tej vuri në dukje se, për qëllimet e Nenit 5 § 1 të Konventës, paraburgimi i cili zgjati disa muaj dhe që nuk ishte urdhëruar nga një gjykatë ose nga një gjyqtar ose ndonjë person tjetër "i autorizuar... për të ushtruar pushtetin gjyqësor" nuk mund të konsiderohej të jetë 'e ligjshme'. Gjykata e konsideroi se kjo kërkesë, megjithëse nuk është e përcaktuar shprehimisht në paragrafin 1 të Nenit 5, mund të nxjerret nga Neni 5 duke e lexuar si tërësi. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të Nenit 5 § 1.

Lidhur me Nenin 5 § 4 të Konventës, sa i përket procedurave të cilat ishin vendosur në lëvizje nga kërkesat e ankuesit për lirim më 7 shkurt 1994 dhe 28 mars 1994, Gjykata konsideroi se kohëzgjatja e tyre (përafërsisht 5 muaj në lidhje me kërkesën e parë dhe pak më shumë se 3 muaj në lidhje me të dytën) nuk ishte në papajtueshmëri me nocionin e "shpejtësisë" të përcaktuar në Nenin 5 § 4. Gjykata hodhi poshtë argumentin e Qeverisë se nevoja për të marrë dëshmi mjekësore shpjegoi gjatësinë e përgjithshme

²⁶ *Steel dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i 23 Shtator 1998, Raportet 1998-VII, p. 2735, § 54

të procedurave, duke pasur parasysh se ka pasur intervale shumë të gjata në mes të vendimeve të gjykatës vendase për të marrë dëshmi.

Duke iu referuar ankesës së ankuesit, të datës 7 janar 1994, të cilën e kishte parashtruar kundër urdhrorit të paraburgimit të 30 dhjetorit 1993, Gjykata vuri në dukje se kjo ankesë nuk ishte shqyrtuar. Megjithatë, konsideroi se meqë të gjitha çështjet që kishin të bënin me ligjshmërinë e ndalimit të tij, në fakt, ishin përcaktuar me vendimin e Gjykatës së Apelit më 5 korrik 1994, ky vendim mund të shihej si përgjigje drejtuar argumenteve të bëra nga aplikuesi në atë ankesë.

Rrjedhimisht, Gjykata gjeti se përcaktimi i zgjatjes së paraburgimit të ankuesit deri më 31 janar 1994 zgjati nga 7 janari deri më 5 korrik 1994 (afro 6 muaj) dhe se një vonesë kaq e gjatë kishte rezultuar që ankesa të mos ketë efekt juridik ose praktik. Gjykata, në përputhje me rrethanat, arriti në përfundimin se kishte pasur gjithashtu një shkelje të Nenit 5 § 4.

Bazuar në Nenin 41 të Konventës, Gjykata nuk e ka gjetur të përshtatshme për të bërë ndonjë shpërblim për dëmin material në këtë rast pasi që konsideroi se nuk kishte lidhje kauzale midis shkeljes së vendosur dhe humbjes së supozuar financiare. Pasi konsideroi dëmin jo-material, Gjykata vendosi dëmshpërblim në vlerë 30.000 zlotys (PLN). Për shpenzimet gjyqësore, gjykata caktoi shumën prej 10,000 PLN.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 5 §§ 1 dhe 4 të Konventës. [*njësëri*].

Velinov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë - 16880/08

19 shtator 2013 [Seksioni i Parë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5

Privim joligjor nga liria si pasojë e konvertimit të kundërvajtjes së papaguar në dënim me burgim gabimisht në mungesë të një sistemi automatik / *ka shkelje*

Neni 6

Tejzgjatje e pararsyeshme e procedurave të kompensimit që tejkalojnë kohën e arsyeshme / *ka shkelje*

Neni 13 në lidhje me Nenin 6

Shkelje si rezultat i mungesës së mjetit efektit efektiv në lidhje me zgjatjen e procedurave / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: kundërvajtje / gjobë / vonesë / konvertim / dënim me burgim / mungesë sistemi / kompensim / mjet efektiv

Ankuesi: z. Pančo Velinov, shtetas maqedon, i lindur në vitin 1952

Faktet e rastit

Në qershor të vitit 2000, Ministria e Punëve të Brendshme kishte nisur procedurat e kundërvajtjes ndaj ankuesit për vozitje të një autobusi që nuk ishte në gjendje të rregullt. Ankuesi ishte vozitës i kompanisë B.E. Procedurat gjithashtu përfshinin kompaninë dhe një zyrtar përgjegjës të kompanisë.

Më 22 shtator 2000, Gjykata e shkallës së parë në Shtip e dënoi ankuesin për kundërvajtje dhe e kishte urdhëruar atë që të paguante gjobë në vlerën prej dy mijë denarëve maqedonas (shumë e barasvlershme me 33 EUR). Ankuesi ishte urdhëruar që të paguante gjobën brenda pesëmbëdhjetë ditëve pasi vendimi të kishte marrë formën e prerë. Vendimi i gjykatës saktësonte gjithashtu llogarinë bankare ku duhej bërë pagesa e gjobës. Gjykata po ashtu i ishte referuar Aktit të Kundërvajtjes të vitit 1997, ku thuhej se nëse ankuesi nuk e paguan gjobën brenda kohës së përcaktuar, gjykata do të zbatojë vendimin duke e konvertuar gjobën në dënim me burgim mbi bazën e një dite burg për çdo një mijë (1000) denarë.

Vendimi i gjykatës kishte marrë formën e prerë më 27 shtator 2001. Më 14 nëntor 2001, gjykata e kishte urdhëruar ankuesin që të paguante gjobën dhe të paraqitej në gjykatë më 26 nëntor 2001 për të sjellë dëshminë e pagesës. Siç është përcaktuar në proces të procedurave të dëmshpërblimit të nisura nga ankuesi, letra ku ai njoftohej për urdhërin e gjykatës i ishte dërguar djalit të tij.

Më 7 shkurt 2002, një gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë me përgjegjësi për zbatimin e sanksioneve, e kishte konvertuar gjobën në dënim me burgim prej dy ditësh. Vendimi theksonte se ankuesi nuk e kishte paguar gjobën, qoftë brenda afatit të përcaktuar ose pasi gjykata e kishte urdhëruar dhe paralajmëruar atë. Vendimi i gjykatës për burgim i

ishte dorëzuar ankuesit personalisht më 12 shkurt 2002. Ai ishte njoftuar më tej se do të vuante burgun duke filluar nga data 15 mars 2002 në burgun e Shtipit. Burgu gjithashtu ishte njoftuar me datën e fillimit të vuajtjes së burgimit. Më 13 shkurt 2002, ankuesi kishte paguar gjobën. Ai kishte shënuar numrin e rastit për të cilin ishte bërë pagesa. Kopja nuk i ishte dorëzuar gjykatës.

Më 28 tetor 2002, ankuesi ishte arrestuar në shtëpinë e tij. Ai nuk ishte informuar për arsyet e arrestimit. Në bazë të ankuesit, ai ishte njoftuar për arsyet vetëm pasditen e 29 tetorit 2002. Më 29 tetor dhe pasi kishte dorëzuar një kopje të pagesës, ankuesi ishte liruar nga burgu. Urdhëri për lirim nga Burgu i Shtipit theksonte se ai ishte liruar më 29 tetor 2002 mbi bazën e një njoftimi të marrë nga gjykata se gjoba ishte paguar.

Ankuesi më pas e kishte kontaktuar Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim për të gjetur një zgjidhje jashtëgjyqësore dhe pagesë dëmi jo-material në vlerën prej 310,000 denarëve (ose 5,060 EUR) për siç ka pretenduar ankuesi privimin e tij të paligjshëm nga liria. Ministria kishte refuzuar kërkesën, duke theksuar se ai nuk kishte paraqitur dëshmi se ishte dënuar ose burgosur në mënyrë të gabuar. Më 17 janar 2013, kishte ngritur padi civile kundër shtetit, duke kërkuar shumën e njëjtë të të hollave për dëmin jo-material që kishte pësuar si rezultat i privimit të paligjshëm të lirisë të pretenduar nga ana e tij. Gjykata kishte vendosur se asnjë lloj përgjegjësie nuk mund t'i mvishej organeve të shtetit, që sipas gjykatës kanë vepruar në pajtim me ligjin.

Ankuesi e kishte apeluar këtë vendim, duke argumentuar, përveç tjerash, se pasi ka paguar gjobën, ai ka shlyer detyrimin e tij dhe se ka qenë përgjegjësi e shtetit që të krijojë një sistem të regjistrimit të pagesave. Urdhëri për burgim, që i ishte dorëzuar më 12 shkurt 2002, nuk ka përmbajtur ndonjë udhëzim që i ka kërkuar atij të dorëzojë dëshmi të pagesës. Ai më tej ka kontestuar gjetjen e gjykatës së shkallës së parë se urdhëri i gjykatës i datës 14 nëntor 2001 i është dorëzuar djalit të tij. Në këtë drejtim, ai ka theksuar se nuk është bërë ekzaminimi i ekspertit për të verifikuar nënshkrimin në letrën e dorëzimit-pranimi. Më 10 shtator 2007, Gjykata e Apelit në Shtip kishte hedhur poshtë ankesën, duke mos gjetur arsye për të lëvizur nga faktet e përcaktuara dhe arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë. Ajo kishte vendosur se ankuesi ishte përgjegjës për ngjarjet e lidhura me burgimin e tij, pasi ai as nuk e kishte paguar gjobën brenda afatit të përcaktuar dhe as nuk e kishte njoftuar gjykatën për pagesën, pasi e kishte bërë atë. Vendimi i ishte dorëzuar ankuesit më 21 shtator 2007.

Qeveria nuk ka paraqitur ndonjë kundërshti në lidhje me pranueshmërinë e ankesës në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata gjithashtu nuk kishte gjetur ndonjë arsye që rasti ishte qartazi i pabazuar ose i paparanueshëm mbi bazën e ndonjë arsyeje tjetër. Prandaj, e ka shpallur këtë rast të pranueshëm.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi ka ripërsëritur se ai është burgosur në kundërshtim me Nenin 5 § 1 të Konventës. Në këtë drejtim, ai ka argumentuar se shteti do të duhej të kishte një sistem efikas të regjistrimit dhe përcjelljes së pagesave të gjobave gjyqësore. Ai nuk ka qenë i detyruar që t'i ofrojë gjykatës një kopje të dëshmisë së pagesës. Ai tutje ka mohuar që letra paralajmëruese e 14 nëntorit 2001 i është dorëzuar në mënyrë të duhur. Nuk ka dëshmi se ajo i është dorëzuar djalit të tij.

Qeveria, nga ana e saj, ka argumentuar se ankuesi është burgosur në mënyrë të ligjshme, si rezultat i mospërbushjes së një urdhëri gjyqësor. Sipas Qeverisë, ai nuk ka paguar gjobën brenda afatit të përcaktuar dhe as brenda afatit shtesë, që ka urdhëruar gjykata në letrën e 14 nëntorit 2001. Për më tepër, ankuesi nuk e ka njoftuar gjykatën se ai e ka paguar gjobën, pavarësisht kërkesës shprehimore në këtë drejtim. Qeveria ka sqaruar se gjobat gjyqësore i paguhen dhe regjistrohen nga Ministria e Financave. Deklaratat në lidhje me pagesat e pranuar nga Ministria e Financave nuk u transferohen gjykatave. Për të përcjellë pagesat, personat e dënuar që kanë paguar gjobën, kërkohet që vetë t'i ofrojnë gjykatës kopjen e dëshmisë së pagesës. Në cilindo rast, sipas Qeverisë, ankuesi ishte burgosur në bazën e urdhërit për burgim të 7 shkurtit 2002, në bazë të të cilit gjoba i ishte konvertuar në dënim me burg, dhe se është e parëndësishme që ai e ka paguar gjobën pas atij vendimi. Në këto rrethana, Qeveria e ka mohuar se burgosja e ankuesit ka qenë në kundërshtim me pjesën relevante të Nenit 5 § 1(b) të Konventës.

Ankuesi gjithashtu ishte ankuar se zgjatja e procedurave të dëmshpërblimit (kompensimit) ka qenë në kundërshtim me kërkesën për “kohë të arsyeshme” sipas Nenit 6 të Konventës. Qeveria nuk ka ngritur ndonjë kundërshtim rreth pranueshmërisë së ankesës mbi bazën e Nenit 6. Po ashtu, Qeveria ka pranuar se procedurat janë zgjatuar padrejtësisht, marrë parasysh faktin se kanë kaluar më tepër se katër (4) vite nga paraqitja e rastit prej ankuesit deri te veprimi i parë i ndërmarrë nga gjykata e shkallës së parë.

Ankuesi është ankuar edhe sa i përket mungesës së mjeteve efektive, ku ai do të mund të ngriste çështjen e zgjatjes së tepërt të procedurave për dëmshpërblim. Prandaj, ai ka pretenduar shkelje të Nenit 13. Qeveria nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim rreth pranueshmërisë së ankesës në lidhje me Nenin 13. Sa i përket meritave të pretendimeve në lidhje me këtë Nen, Qeveria ka argumentuar se zgjidhja sa i përket kohëzgjatjes, siç saktësohet në Aktin e vitit 2006, do të mund të ishte efektive në rastin e tij, pavarësisht që nuk është konsideruar e tillë në kohën relevante.²⁷ Në këtë aspekt, ankuesi ka deklaruar se mjeti në veprim në kohën relevante nuk ka qenë efektiv, ashtu siç është konfirmuar në praktikën e Gjykatës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata ka shqyrtuar dy çështje kryesore në lidhje me pretendimin për shkelje të Nenit 5 në rastin konkret: *së pari*, nëse fakti që gjoba është paguar pasi ajo ishte konvertuar në dënim me burg e ka bërë burgimin e mëpastajmë të ankuesit të jashtëligjshëm dhe, *së dyti*, nëse dështimi i ankuesit për të njoftuar gjykatën se ai ka paguar gjobën e justifikon burgimin e tij.

Në lidhje me çështjen e parë, për dallim nga rasti i pagesës së pjesëshme të gjobës, nuk ekzistonin rregulla në legjislacionin vendor në lidhje me pagesën e plotë të gjobës, pra kur ajo është paguar pasi gjoba është konvertuar në dënim me burg. Sipas legjislacionit në lidhje me pagesën e pjesërishtme, pjesa e papaguar e gjobës do të konvertohej në burgim, por dënimi do të përfundonte nëse gjoba do të paguhej. Sipas Gjykatës, nuk ka arsye se pse i njëjti rregull nuk do të mund të aplikohet edhe në rastin e ankuesit, siç

²⁷ *Parizov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 14258/03, 7 shkurt 2008

është e dukshme nga urdhëri për lirim, ku thuhej se ai ishte liruar mbi bazën e dëshmisë së pagesës. Në këto rrethana, baza për burgimin e ankuesit sipas Nenit 5 § 1 të Konventës kishte pushuar së ekzistuari sapo ai e kishte zbatuar urdhërin e pagesës.

Ndërkaq, sa i përket çështjes së dytë, ankuesi nuk e kishte njoftuar gjykatën në lidhje me pagesën e bërë. Marrë parasysh këtë, gjykata e shkallës së parë në Shtip kishte ardhë në përfundimin se asnjë përgjegjësi nuk mund t'i mvishej shtetit për arrestimin dhe burgosjen e tij të mëpastajme. Sidoqoftë, nuk ekzistonte asnjë dispozitë ligjore që i kërkonte ankuesit ta njoftonte gjykatën në lidhje me pagesën. Për më tepër, ai ishte arrestuar dhe burgosur pas më shumë se tetë muajve nga data kur ishte lëshuar urdhëri i burgimit dhe koha kur e kishte paguar gjobën, por Ministria e Financave nuk e kishte njoftuar gjykatën në lidhje me pagesën e bërë. Gjykata thekson se dështimi i ankuesit për ta njoftuar gjykatën në lidhje me kryerjen e pagesës nuk e liron shtetin nga përgjegjësia për të krijuar një sistem efikas të regjistrimit të pagesave të gjobave. Procesi i vendimmarrjes në çështje kur liria e një personi është në pyetje do të duhej të merrte në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit. Rëndësia e të drejtës së ankuesit në liri kërkon që shteti të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të shmangë kufizimin e padrejtë të lirisë. Si rezultat i kësaj më sipër, Gjykata gjen se burgosja e ankuesit ka qenë në kundërshtim me Nenin 5 § 1 (b).

Sa i përketet Nenit 6, Gjykata ka vërejtur se procedurat e dëmshpërblimit kanë zgjatur prej 17 janarit 2003 deri më 21 shtator 2007, kur aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i është dorëzuar ankuesit. Procedurat kësajsoji kanë zgjatur rreth katër vite e tetë muaj në të dy nivelet e juridiksionit. Gjykata ka rikujtuar në këtë drejtim se arsyeshmëria e zgjatjes së procedurave duhet vlerësuar në kontekst të rastit dhe duke pas parasysh kriteret në vijim: kompleksiteti i rastit, sjellja e ankuesit dhe e autoriteteve relevante, dhe çfarë rëndësie ka për ankuesin zgjidhja e mosmarrëveshjes. Në rastin konkret, Gjykata ka vlerësuar se rasti nuk ka kërkuar shqyrtim të çështjeve komplekse. Gjithashtu, gjen as vonesat nuk janë shkaktuar nga ankuesi. Përfundimisht, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e procedurave për dëmshpërblim ka qenë e tepërt dhe nuk plotëson kërkesën e Nenit 6(1) për kohë të arsyeshme.

Në lidhje me Nenin 13, Gjykata nuk gjen arsye që të lëvizë nga praktika gjyqësore e mëparshme, ku kishte gjetur shkelje të Nenit 13 në lidhje me Nenin 6, si rezultat i mungesës së mjetit efektiv në lidhje me zgjatjen e procedurave për dëmshpërblim.

Gjykata ka urdhëruar shtetin maqedon që t'i paguajë ankuesit shumën në vlerë prej 1,500 EUR për dëmin jo-material dhe 1,260 EUR për kostot dhe shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 5, Nenit 6 dhe Nenit 13 në ndërlidhje me Nenin 6 të Konventës [njëzëri].

Quinn kundër Francës - 18580/91

22 Mars 1995 [Gjykata]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5 § 1

Pretendimi për shkelje të drejtës në liri si pasojë e vazhdimit të ndalimit dhe burgosja e tij pasuese me qëllim ekstradimit përkundër vendimit ekzistues për lirim, dhe kohëzgjatjes së paraburgimit / *ka shkelje*

Neni 5 § 3

Pretendimet se mbajtja e tejkzgjatur ne paraburgim kishte shkelur te drejten e tij qe te sillet shpejtë para një gjyqtari / *nuk ka shkelje*

Neni 18

Pretendim se është abuzuar me procedurën e ekstradimit duke e përdorur atë për një qëllim tjetër nga ai për të cilin ajo ishte menduar / *nuk ka nevojë të shqyrtohet.*

Fjalët kyçe: *arrestim / ndalim / paraburgim / procedurë ekstradimi / vazhdim paraburgimi / tejkzgjatje*

Ankuesi: Z. Thomas Quinn, i lindur në Nju Jork në vitin 1937, me shtetesi amerikane dhe jetonte në Paris.

Faktet e rastit

Ankuesi u arrestua më 1 gusht 1988 në posedim të dy Pasaportave greke të rreme dhe u akuzua në të njëjtën ditë me vepra penale sipas legjislacionit për lëshimin e letrave me vlerë dhe falsifikimit të dokumenteve administrative. Më 29 nëntor gjyqtari hetues i shtoi akuzave fillestare rrethanën rënduese të mashtrimit të publikut për një skemë kursimi. Në ditën e arrestimit, ankuesi ishte dëguar në burgu Santé në Paris. Në tri raste, 30 nëntor 1988, 23 mars dhe 20 korrik 1989, gjykatësi hetues zgjati ndalimin me katër muaj bazuar në mendimin se ndalimi ishte e vetmja mënyrë për të siguruar prezencën për gjykimin e një të akuzuari, i cili ishte një shtetas i huaj, i cili ishte arrestuar në posedim të pasaportave të rreme dhe i cili kishte disa banesa jashtë Francës dhe një numër të madh të bashkëpunëtorëve. Ankuesi parashtoi një ankesë në Divizionin e Aktakuzës së Gjykatës së Apelit në Parisit kundër urdhrin të 20 korrikut 1989 që zgjati paraburgimin e tij. Pas mbajtjes së seancës dëgjimore më 2 gusht 1989, Divizioni i Aktakuzës vendosi se ai duhet të lirohet menjëherë pasi që ai [nuk] u ndalua në baza të tjera. Ky vendim ishte menjëherë i ekzekutueshëm dhe nuk ishte paraqitur asnjë ankesë kundër tij. Megjithatë, ankuesi nuk u lirua. Lirimi i tij ishte subjekt i vendimit për të njoftuar prokurorin publik i cili ishte përgjegjës për ekzekutimin dhe përfundimin e formaliteteve përkatëse.

Më pas, Ankuesi u paraqit para Gjykatës Penale të Parisit, derisa ishte në paraburgim lidhur me kërkesën për ekstradim (e cila është elaboruar më poshtë). Me 10 korrik 1991 ai u gjet fajtor për mashtrim në dëm të nëntëdhjetë e tre personave dhe për

organizimin e një fushatë mashtrimi në lidhje me transaksione që përfshijnë letrat me vlerë të huaja në Francë. Ai u dënua me katër vjet burg dhe u gjobit me 300,000 franga franceze (FRF). Gjykata urdhëroi ndalimin e tij. Ankuesi apeloi në Gjykatën e Apelit në Paris kundër këtij ndalimi. Në një aktgjykim të 23 prillit 1992 gjykata gjeti se ankesa në lidhje me rrethanat rënduese për një skemë kursimi nuk është bërë dhe me këtë e zvogëlon dënimin për katër vjet burgim, një viti i të cilit u pezullua. Gjykata urdhëroi që ankuesi të qëndronte në paraburgim. Ankuesi, i cili ishte në paraburgim nga 1 gushti 1988 deri më 4 gusht 1989 qendroi - një total prej rreth një viti dhe dhjetë muaj e me pas u ekstradua në Zvicër më 24 shtator 1992.

Lidhur me procedurat e ekstradimit - Më 4 gusht 1989, një gjykatës hetues i Gjenevës dërgoi me faks në zyrën e prokurorit publik të Parisit, një kërkesë për arrestimin e përkohshëm të ankuesit me qëllim të ekstradimit të tij. E njëjta kërkesë u transmetua nëpërmjet Organizatës Nderkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol) më 5 gusht dhe përmes kanaleve diplomatike më 16 gusht. Prokurori publik i Parisit urdhëroi arrestimin e përkohshëm të tij. Ankuesi, i cili ishte ende në burgun Santé, u morr në pyetje nga prokurori rreth orës 8 të mëngjesit e më pas vendoset në paraburgim me qëllim të ekstradimit. Gjatë rrjedhës së procedurave të ekstradimit të ngritura kundër tij, ankuesi aplikoi tri herë për lirimin e tij, duke u mbështetur në çdo rast në Nenin 5 të Konventës, duke u ankuar për rrethanat në të cilat ai ishte arrestuar. Në tre vendimet e tij, dhënë më 23 gusht 1989, 2 nëntor 1989 dhe 19 dhjetor 1990, Divizioni i Aktakuzës i hodhi poshtë tre kërkesat, duke gjetur se ndalimi ishte urdhëruar në përputhje me dispozitat e Konventës Evropiane për Ekstradimin. Në ndalimin e tij justifikohet refuzimi për lirimin e ankuesit për shkak të rrezikut të arratisjes së tij dhe mungesa e garancive për të siguruar praninë e tij në lidhje me procedura të tjera. Përkundër tri anesave të tjera më 14 mars 1990 Divizioni i Aktakuzës së Gjykatës së Apelit në Paris vendosi në favor të ekstradimit të ankuesit. Më 24 korrik 1990 Gjykata e Kasacionit e hodhi poshtë si të papranueshme ankesën e tij mbi pikat e ligjit kundër mendimit të Divizionit të Aktakuzës. Më 24 janar 1991 Kryeministri i aprovoi kërkesën autoriteteve Zvicerane për ekstradimin e ankuesit. Më pas ankuesi aplikoi në Conseil d'Etat për anulimin e ekzekutimit të vendimit për ekstradim dhe për shqyrtimin e urdhrit, por kërkesa e tij u hodh poshtë më 31 janar 1992. Ankuesi i cili ishte në paraburgim me qëllim ekstradimi, nga 4 gushti 1989 deri më 10 korrik 1991 - një periudhë prej një viti, njëmbëdhjetë muaj dhe gjashtë ditë - iu dorëzua autoriteteve zvicerane më 24 shtator 1992.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi parashtroi argumente lidhur me paligjshmërinë dhe kohëzgjatjen e paraburgimit të tij. Ankuesi pohoi se ai ishte mbajtur arbitrarisht në paraburgim më 4 gusht 1989, në mënyrë që ti ipej kohë Zyrës së prokurorit publik të Parisit për të inicimin e proceduarve të ekstradimit duke penguar kështu zbatimin e vendimit që urdhëron lirimin e menjëhershëm të ankuesit. Duke u bazuar në Nenin 5 §§ 1 dhe 3, të vetëm dhe marrë së bashku me Nenin 18 të Konventës ankuesi pretendonte një abuzim me procedurat e ekstradimit për qëllime që lidhen me hetimin në Francë dhe u ankua për paligjshmërinë e paraburgimit të tij në lidhje me këtë procedurë si dhe kohëzgjatjen e paraburgimit të tij. Ankuesi pohoi se ai duhet të ishte liruar "menjëherë" në zbatim të

vendimit të dhënë prandaj u mbajt në mënyrë arbitrare në paraburgim, në mënyrë që ai të mund të rikthehej në burg me kërkesën e autoriteteve zvicerane. Kjo ishte gjithashtu pikëpamja e Komisionit.

Qeveria shpjegoi se kishte patur në mënyrë të pashmangshme disa vonesa në lirimin e ankuesit për shkak të formaliteteve, të cilat morën një kohë më të gjatë për të përfunduar për shkak të pushimeve gjyqësore. Ankuesi gjithashtu kontestoi ligjshmërinë e paraburgimit të tij në pritje të ekstradimit, duke pasur parasysh jo vetëm rrethanat e arrestimit të tij në mbrëmjen e 4 gushtit të vitit 1989, por edhe në kohëzgjatjen e privimit të tij nga liria. Qeveria e kundërshtoi atë duke u arsyetuar se shteti Francez ka obligim bazuar në Konventën mbi Ekstradimin si shtet Palë dhe në rastin në flajë kishte pasur detyrimin për të ekstraduar. Ata pohuan se paraburgimi ishte në pritje të ekstradimit, dhe kishte ishte e vetmja mënyrë për të siguruar që do të ishte e mundur që ankuesi ti dorëzohej shtetit kërkues, dhe se urdhëri në rastin në fjalë ishte konform me rregullat që qeverisin ekstradimin. Qëllimi i vetëm i atij ndalimi ishte dorëzimi i ankuesit tek autoritetet gjyqësore të shtetit kërkues.

Ankuesi u ankua gjithashtu për kohëzgjatjen totale të paraburgimit të tij, e cila sipas tij kishte shkelur Nenin 5 §§ 1 dhe 3 të Konventës, dhe të drejtën e tij për tu sjell para një gjyqtari apo zyrtari ligjor në afat të arsyeshëm kohor. Ankuesi gjithashtu akuzoi autoritetet franceze se kishin abuzuar me procedurën e ekstradimit duke e përdorur atë për një qëllim tjetër nga ai për të cilin ajo ishte menduar. Objektivi kryesor i tyre ishte të pengonte lirimin e tij dhe që përbënte shkelje të Nenit 18 të Konventës

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet e ankuesit për shkeljen e Nenit 5 § 1 Gjykata rithekson se përjashtimet nga e drejta e lirisë e siguruar nga ky nen duhet të jenë në përputhje me qëllimin të sigurojë që askush nuk është privuar arbitrarisht nga e drejta e lirisë së tij ose të saj. Gjykata pranon se ka pasur vonesa në ekzekutimin e vendimit për urdhërimi e lirimit të paraburgosuri, që në rrethana të caktuara është e kuptueshme. Megjithatë, Gjykata vëren se në rastin konkret ankuesi mbeti në paraburgim për njëmbëdhjetë orë pas vendimit të Divizionit të Aktakuzës që parasheh që ai të lirohet "menjëherë". Rrjedhimisht, konstaton se ka pasur shkelje të Nenit 5 § 1 në këtë aspekt.

Në lidhje me zgjatjen e paraburgimit të ankuesit Gjykata konsideron se paraburgimi me qëllim ekstradimin ishte në parim i justifikuar sipas nënparagrafit (f) të Nenit 5 § 1. Kjo dispozitë kërkon në radhë të parë që paraburgimi të jetë "i ligjshëm", i cili përfshin kushtet e pajtueshmërisë me një procedurë të përcaktuara me ligj. Konventa këtu i referohet në tëresi ligjit nacional, por gjithashtu kërkon që çdo heqje lirie të jetë në përputhje me qëllimin e Nenit 5 përkatësisht për të mbrojtur individët nga arbitrariteti. Gjykatat kombëtare, të cilat janë në një pozitë më të mirë se Institucionet e Konventës për të përcaktuar nëse arsyeshmeria e paraburgimit ka qenë e ligjshme ka konstatuar se paraburgimi i kontestuar ishte i ligjshëm në fillim dhe në lidhje me qëllimin e saj. Megjithatë, Gjykata vëren se paraburgimi i ankuesit për qëllime të ekstradimit ishte jashtëzakonisht i gjatë. Ai u arrestua në lidhje me procedurat e ekstradimit nga 4 gusht 1989 deri më 10 korrik 1991, pothuajse dy vite. Pas kësaj ai shërbeu dënimin e shqiptuar nga Gjykata e Apelit në Paris deri më 24 shtator 1992, në cilën datë ai u dorëzua tek autoritetet zvicerane sipas urdhërit të 24 janarit 1991. Paraburgimi me

qëllim ekstradimin vazhdoi deri më 10 korrik 1991, edhe pas miratimit të urdhrimit për ekstradim. Dorëzimi i ankuesit te autoritetet zvicerane u shty, në përputhje me Nenin 19 para. 1 të Konventës Evropiane për Ekstradim, për shkak të procedimeve në lidhje me krimet e kryera në të njëjtën kohë në Francë. Nuk është roli i Gjykatës për të përcaktuar se çfarë masash duhet të kishin marrë autoritetet kombëtare këto rrethana për të siguruar që paraburgimi në pritje të ekstradimit, por Gjykata vëren se ky paraburgim kishte tejkaluar një kohë të arsyeshme deri më 24 janar 1991. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Nenit 5 § 1 të Konventës edhe në këtë pikë. Ndërsa lidhur me pretendimet për shkelje të Nenit 5 § 3, Gjykata konsideron se nuk ka pasur vonesa të konsiderueshme apo neglizhencë nga ana e autoriteteve andaj nuk ka shkelje në këtë pikë.

Në lidhje me pretendimet se ka shkelje të Nenit 18 Gjykata vëren se kjo dispozitë siguron mbrojtje specifike dhe mund të ishte i thirrur në vetvete pa u referuar në lidhje me Nenet e tjera të Konventës. Pasi që gjykata tashmë ka gjetur se nuk ka prova për të vërtetuar pretendimi e një abuzimi të procedurës, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të shqyrtojë të njëjtat fakte nga pikëpamja e Nenit 18.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Nenit 5 § 1 të Konventës, dhe se nuk ka pasur shkelje të Nenit 5 § 3 të Konventës; Ndërsa konstaton se nuk është e nevojshme të shqyrtohet çështja nga pikëpamja të Nenit 18 të Konventës; [*njësori*].

Smirnova kundër Rusisë - 46133/99; 48183/99

24 korrik 2003 [Seksioni i Tretë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni Neni 5 §§ 1 dhe 3

Shkelje e mbi të drejtën për liri dhe siguri si pasojë e mbajtjes në paraburgim të përsëritur të pabazë / *ka shkelje*

Neni 6 §1

Shkelje e të drejtës për një gjykim të drejtë si pasojë e tejzgjatjes së procedurave / *ka shkelje*

Neni 8

Shkelje e të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare për ankuesen e parë, si pasojë e mbajtjes së pasaportës / *ka shkelje për ankuesen e parë*

Fjalët kyçe: *paraburgim / vazhdim i paraburgimit / rrezikshmëri / ndalim i pasaportës / tej-zgjatje e procedurave / ndërhyrje në jetë*

Ankueset: znj. Yelena Pavlovna Smirnova (*ankuesja e parë*) dhe znj. Irina Pavlovna Smirnova (*ankuesja e dytë*), motra binjake të lindura në vitin 1967, shtetase ruse

Faktet e rastit

Më 5 shkurt 1993, ka filluar ndjekja penale ndaj ankuesve me dyshimin se kishin mashtruar një bankë të Moskës, duke marrë një hua me pretendime të rreme, përkatësisht, lënë nën hipotekë një banesë që nuk e kishin në pronësi. Gjatë hetimeve penale, ato janë arrestuar katër herë.

Fillimisht, Gjykata e Rrethit të Tverskoy ka arrestuar vetëm ankuesen e parë kurse nuk ka vazhduar hetimet ndaj ankuses së dytë. Me 21 mars 1997, e njejta gjykatë ka gjetur që hetimet ndaj ankuses së dytë nuk do të duhej të ndalohen, andaj me vetë-mocion ka ri-filluar hetimet ndaj saj dhe bashkuar ato me rastin ndaj ankuses së parë.

Përgjatë procedurës penale, ankuesja e parë ishte liruar me 9 dhjetor 1997 nga Gjykata e Rrethit të Lyublinsky-it, por ishte arrestuar sërish pas ekzaminimit të dytë të rastit të saj me 31 mars 1997 nga Gjykata e Rrethit të Tverskoy. Me 30 mars 1999, Ankuesja e parë ishte arrestuar për herë të parë, dhe mbeti në paraburgim deri me 29 prill 1999 kur ishte liruar nga Gjykata e Rrethit të Lyublinsky-it. Me 9 shtator 1999, ajo u arrestua sërish dhe u dërgua në mbajtje.

Me 2 dhe 7 tetor 1999, ankuset u liruan nga paraburgimi, për shkak se koha e mbajtjes kishte skaduar. Megjithatë, ato u paraburgosën sërish me 10 nëntor 1999 deri sa të kryhet gjykimi, për shkak të gravitetit të akuzave dhe karakterit të “ankuesve”. Ankuesja e dytë kishte paraqitur rastin e saj edhe në Gjykatën Kushtetuese, e cila vendosi se Neni 256 i Kodit të Procedurës Penale ishte jo-kushtetues për shkak se i ka veshur gjykatat penale me një funksion që në esencë është i prokurorisë, ai i ndjekjes penale, në momentin kur ka nisur procedurën penale kundër ankuses së dytë. Pas këtij

vendimi, aktvendimet e marra nga gjykatat respektive u anuluan sa i përket asaj dhe rasti u dërgu për hetime të mëtutjeshme. Ankuesja e dytë u lirua, por motra e saj mbeti në paraburgim. Me 25 prill 2000, ankuesja e parë u lirua nga paraburgimi për shkak së koha e paraburgimit kishte skaduar. Pas lirimit të të dyja ankuesve, seancat dëgjimore për rastin e tyre dështuan një pas një, pasi ato nuk u paraqitën në gjykatë. Si rezultat, me 28 gusht 2000, Gjykata e Rrethit të Tverskoy urdhëroi arrestin e tyre, i cili u realizua me 12 mars 2001. Ato u mbajtën në paraburgim deri kur është dhënë aktgjykimi i shkallës së parë.

Me 9 janar 2002 ankueset u dënuan për mashtrime në shkallë të gjerë dhe u dënuan respektivisht me tetë vjet burgim për ankuesen e parë dhe gjashtë vjet burgim për ankuesen e dytë, si dhe me konfiskimin e pronës së tyre. Më 9 prill 2002, Gjykata e Rrethit të Moskës anuloi aktgjykimin e shkallës së parë dhe i liroi ato nga dënimi i dhënë, pasi që afati për vërtetimin e përgjegjësisë së tyre penale kishte skaduar.

Faktet rreth pasaportës: Pasaporta e ankueses së parë ("pasaporta e brendshme") ishte marrë nga ajo kur u arrestua më 26 gusht 1995 dhe u ndal deri më 6 tetor 1999. Në dhjetor 1997 dhe prill 1998, Shërbimi i Sigurimeve Shoqërore të Moskës dhe një firmë ligjore kishin refuzuar ta punësonin, sepse ajo nuk kishte pasaportë. Tutje në dhjetor 1997, një klinikë e Moskës e kishte njoftuar atë se kujdesi mjekësor i lirë mund të sigurohej vetëm nëse ajo paraqiste një certifikatë sigurimi dhe pasaportë të saj. Për të njëjtën arsye, në prill 1998 kompania telefonike e Moskës kishte refuzuar të instalonte linjën telefonike në shtëpinë e saj. Më 2 qershor 1998, Zyra e Noterëve të Qytetit të Moskës e kishte njoftuar atë se ajo kishte nevojë të provonte identitetin e saj, për shembull me "pasaportë", nëse dëshironte të merrte veprime noteriale. Më 10 dhjetor 1998, asaj i është refuzuar regjistrimi i martesës së saj. Më 19 mars 1999 ajo ishte ndaluar nga një patrullë policore për një kontrollë të identitetit. Pasi që nuk kishte mundur të paraqiste pasaportën, ajo ishte dërguar në një stacion policie dhe kishte paguar gjobë administrative.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankueset kanë parashtruar se nuk ka pasur arsye të mira për të justifikuar paraburgimin e përsëritur të tyre duke pretenduar shkeljen e Nenit 5 §§1 dhe 3 të Konventës. E para, nuk ka pasur rrezik që kanë mundur të arratisen, për shkak se vendqëndrimin e vetëm e kanë pasur në Moskë, ku kanë pranuar korrespondencën nga autoritetet ruse dhe organizatat ndërkombëtare. Kanë qenë qytetare të devotshme dhe kanë pasur reputacion të mirë si avokate. Ankuesja e parë ka lënguar nga një sëmundje serioze-Schonlein Henoch. E dyta, nuk ka pasur rrezik që ankueset kanë mundur të ndikojnë në dhënien e drejtësisëm sepse s'kanë shkatërrur dokumente apo dëshmi, apo bërë presion në viktimat. E treta, paraburgimi nuk ka qenë i nevojshëm për parandalimin e krimeve të tjera sepse nuk kanë pasur të kaluar kriminale. E katërta, nuk ka pasur dyshim të bazuar se lirimi i ankuesve do të prishte rendin publik. Po ashtu, ankueset pretendojnë se paraburgimi është reprezalje/hakmarrje nga Shteti për ankesat e tyre tek organizatat ndërkombëtare për kushtet e jetesës në qendrën e paraburgimit.

Qeveria ruse ka theksuar se ankesa bie pjesërisht jashtë juridiksionit kohor *ratione temporis* të Gjykatës, për shkak se i përket, paraburgimit të filluar para 5 majit 1998 - datë kur ka hyrë në fuqi Konventa për Rusinë. Qeveria më tej ka pohuar se autoritetet

duhej t'i ndalonin ankueset, sepse ato ikën nga drejtësia dhe shkelën kushtet e dorëzimit në atë që ata nuk i njoftojnë autoritetet hetimore për lëvizjet e tyre dhe u paraqitën për gjykim. Ky veprim ishte justifikuar kryesisht nga rreziku që ankuesit të arratiseshin, për shembull, jashtë vendit. Përveç kësaj, me vendimin e saj të datës 9 prill 2002, Gjykata e Rrethit të Moskës shkarkoi ankuesit nga kryerja e dënimit, dhe ky vendim ishte në vetvete satisfaksion i drejtë për kohën e kaluar në burg.

Lidhur me shkeljen e Nenit 6 § 1 të Konventës, ankueset pretendojnë se procedura penale ndaj tyre ka zgjatur pa arsye. Së pari, sipas tyre, as faktet e as aspektet ligjore të rastit të tyre nuk kanë qenë komplekse. Së dyti, ato kanë dhënë më të mirën e tyre për të përshpejtuar procedurat, duke parashtruar më shumë se 100 kërkesa për zgjidhjen më të shpejtë të rastit të tyre. Përkundër këtij zelli, sipas tyre, shteti ka vepruar në mënyrë neglizhente, duke lënë rastin statik për nëntë vite, fillimisht duke zarritur hetimet, e më pas shtyrë seancat për të dëgjuar meritat e rastit.

Qeveria pretendon se procedurat duhej të shtyhen derisa ankuesit po fshiheshin. Gjykata duhej ta kalonte kohën e saj në vendimin për të mbajtur ankuesit në vend që të merrte parasysh meritat e akuzës. Në të shumtën, ankuesja e parë ishte në listën e të arratisurve të kërkuar për 2 vjet, 2 muaj dhe 6 ditë; ndërsa motra saj - për 2 vjet, 9 muaj dhe 15 ditë. Po ashtu, kur në mars 2001, Gjykata e Rrethit Tverskoy mori rastin për gjykim, nuk mund të vazhdonte sepse ankuesja e parë disa herë kërkoi kohë shtesë për të studiuar dosjen e çështjeve. Avokati i saj nuk është paraqitur në seanca dëgjimore dhe se ajo e ka mbytur gjykatën me ankesat dhe mocionet e saj të shumta, shpesh të pabazuara. Qeveria arriti në përfundimin se kohëzgjatja e procedurave u shkaktua kryesisht nga mungesa e vullnetit të ankuesve për t'u nënshtruar drejtësisë.

Lidhur me shkeljen e Nenit 8 të Konventës, ankuesja e parë parashtroi se një qytetar rus që nuk mban pasaportën e tij është dëmtuar në të drejtat e tij në një shkallë që përbën një ndërhyrje në jetën e tij private. Ligji rus kërkon që personi që dëshiron të gjejë punë, të marrë kujdes mjekësor falas, të marrë postën, të martohet, të votojë, të përdorë shërbime noteriale, të instalojë një linjë telefonike, të kursejë para duke blerë valutë të huaj ose të udhëtojë me tren ose aeroplan duhet të jetë në gjendje të paraqes pasaportën. Për më tepër, mos-pasja e pasaportës është në vetvete një kundërvajtje administrative. Sipas ankuses, marrja e pasaportës nuk i ka shërbyer interesave kombëtare, e as nuk ka paraqitur kërcënim të rendit publik, nuk i kashërbyer mbrojtjes së shëndetit apo moralit të personave të tjerë e as nuk ka qenë e nevojshme për një shoqëri demokratike. Për më tepër nuk ka qenë në përputhje me ligjin rus, sipas të cilit që pasaporta merret vetëm pas dënimit përfundimtar. Përgjithësisht, gjatë paraburgimit pasaporta mundet të merret sipas legjislacionit sekondar, dhe në ato raste duhet të kthehet sa më parë tek qytetari.

Qeveria ruse, ka parashtruar se Gjykata e Rrethit të Tverskoy ka mbajtur pasaportën e ankuses për shkak se nuk ka mundur të dallojë motrat binjake, dhe se disa herë, ato kanë shfrytëzuar pamjen e tyre fizike në këtë drejtim. Po ashtu, pohon se pasaporta i është bërë e qasshme ankuses për disa qëllime kryesore, por ankuesja nuk ka shkuar asnjëherë ta marrë atë.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata rithekson se Neni 5 §1 (c) i Konventës duhet të lexohet në lidhshmëri me Nenin 5 §3. Personi i akuzuar për një vepër penale duhet të lirohet gjithmonë në pritje të gjykimit përveç nëse shteti mund të tregojë se ka arsye "të përshtatshme dhe të mjaftueshme" për të justifikuar ndalimin e vazhdueshëm. Praktika gjyqësore e Konventës ka zhvilluar katër arsye themelore të pranueshme për refuzimin e lirit me kusht: "rreziku që i akuzuari të mos dalë në gjyq (arratisja); rreziku që i akuzuari, nëse lirohet, do të ndërmarë veprime për të penguar administrimin e drejtësisë ose të kryejë vepra të mëtutjeshme ose të shkaktojë prishjen e rendit publik." Rreziku i arratisjes nuk mund të bazohet vetëm në ashpërsinë e dënimit potencial, por duhet të vlerësohet në raport me faktorë të tjerë, siç është karakteri i personit të përfshirë, morali, asetet, lidhjet me shtetin përmdjekës dhe kontaktet ndërkombëtare. Periudha e paraburgimit nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte. Argumentet "pro" dhe "kontra" lirit nuk duhet të jenë të "përgjithshme" dhe "abstrakte".

Në rastin konkret, Gjykata shqyrton jo vetëm nëse periudha e përgjithshme e paraburgimit ishte e arsyeshme, por edhe nëse ripërsëritshmëria e saj ishte në përputhje me Nenin 5 të Konventës. Arsyet e dhëna nga autoritetet vendase ishin jashtëzakonisht të dendura dhe nuk kanë arritur të përshkruanin hollësisht situatën e motrave. Andaj Gjykata vën në pah jo vetëm në ashpërsinë e dënimit dhe por edhe karakterin e ankuesve pa detaje të tjera, psh. çfarë ishte karakteri i tyre?. Andaj, sipas Gjykatës paraburgimi i përsëritur gjatë një hetimi penal - në bazë të arsyeve të pamjaftueshme - ka përbërë shkelje të Nenit 5 §§ 1 dhe 3.

Lidhur me pretendimet për shkelje të Nenit 6, Gjykata ka ritheksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të veçanta të rastit, duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, në veçanti kompleksitetin e çështjes, sjelljen e ankuesit dhe sjelljen e autoriteteve kompetente. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se periudha e procedurës që mund ta merrte parasysh, pra, që bie në *ratione temporis* të saj, është 3 vite, 4 muaj dhe 19 ditë në lidhje me ankuesen e parë (totali: 9 vite, 2 muaj, 4 ditë) dhe 2 vjet, 5 muaj dhe 27 ditë në lidhje me ankuesen e dytë (totali: 7 vite, 6 muaj, 23 ditë). Gjykata konsideroi se akuzat nuk ishin veçanërisht komplekse dhe se hetimi nuk duhet të kishte marrë vite. Sa i përket sjelljes së ankuesve, Gjykata nuk ishte e bindur për vullnetin e tyre bashkëpunues, sidomos për shkak të parashtrimit të shumë mocioneve, edhe pse disa ishin të bazuara mirë.

Sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata gjen se ka pasur periudha të konsiderueshme të pasivitetit nga ana e tyre, pa ndonjë arsye bindëse. Hetimi fillestar zgjati tri vite. Shqyrtimi i parë i çështjes u zhvillua gati një vit pas përfundimit të hetimit. Ekzaminimi i dytë i çështjes u zhvillua dy vjet pas asaj të parës. Gjyqi përfundimtar u zhvillua pothuajse tre vjet pas ekzaminimit të dytë. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nga njëra anë, e korrigjoi situatën në lidhje me akuzën e paligjshme kundër ankueses së dytë, por nga ana tjetër, shkaktoi një vonesë tjetër në procedurë. Për më tepër, duke dhënë vendime periodike mbi lirim ose arrestimin, autoritetet ngritën në to një ndjenjë të pasigurisë dhe mosbesimit ndaj drejtësisë duke i nxitur në këtë mënyrë të ikin. Andaj, kjo stërgjatje e procedurës përbën shkelje të Nenit 6 §1 të Konventës.

Lidhur me Nenin 8 të Konventës, Gjykata ka vendosur disa herë se jeta private është një nocion i gjerë që nuk mund të përkufizohet në mënyrë të shtershme. Sidoqoftë, është theksuar se ajo mbron integritetin moral dhe fizik të individit. Ndërhyrja e vetme në këtë të drejtë nga shteti lejohet në “përputhje me ligjin” dhe kur “është e nevojshme për një shoqëri demokratike”. Në rastin në fjalë Gjykata vuri në dukje se ndërhyrja në jetën private të ankueses së parë ishte e veçantë në atë që pretendohet se nuk rrjedh nga një akt i menjëhershëm, por nga një numër shqetësimesh të përditshme të marra në tërësinë e tyre, të cilat kishin zgjatur deri në tetor 1999. Në lidhje me këtë, ndërhyrja ka rënë brenda juridiksionit kohor të gjykatës. Gjykata konstatoi se në jetën e përditshme qytetarët rusë shpesh kishin obligim të dëshmonin identitetin e tyre, madje edhe kur kryenin detyra të caktuara të zakonshme. Për më tepër, pasaporta ishte e nevojshme për nevojat më thelbësore si gjetja e punësimit dhe marrja e kujdesit mjekësor. Prandaj kishte pasur një ndërhyrje të vazhdueshme në jetën private të ankueses.

Tutje Gjykata vëren se legjislacioni rus parashikonte që pasaporta duhej të kthehej kur një individ ishte liruar nga paraburgimi. Qeveria kishte dështuar të provonte se moskthimi i pasaportës pas lirimimit të ankueses kishte pasur ndonjë bazë në ligj. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se kishte pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Po ashtu, gjykata ka vendosur që shteti rus t’i paguajë ankueses së parë, dëmshpërblim jo-material prej 3,500 EUR, kurse ankueses së dytë, I.S., 2,000 EUR. Në rastin në fjalë, është e arsyeshme të supozohet se ankueset kanë pësuar ankth dhe zhgënjim, të përkeqësuar nga paraburgimi i përsëritur dhe kohëzgjatja e paarsyeshme e procedurës. Për më tepër, Y.S. pësoi zhgënjim për moszbatimin e plotë të jetës së përditshme për shkak të konfiskimit të pasaportës së saj. Gjithashtu, shteti rus duhet t’u paguajë bashkarisht të dyja ankuesve 1,000 EUR në emër të shpenzimeve të procedurës. Gjykata ka refuzuar kërkesën e ankuesve për dëmshpërblim material për shkak se ato kanë dështuar që të provojnë se dëmi material iu është shkaktuar pikërisht nga kohëzgjatja e paraburgimit dhe gjykimit.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata se ka pasur shkelje të Nenit 5 §§1 dhe 3 të Koventës, për të dyja ankueset, shkelje të Nenit 6 §1 të Koventës për të dyja ankueset, dhe shkelje e Nenit 8 të Koventës, mbi të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare për ankuesen e parë, Y.S. [njëzëri].

Neni 6

E drejta për një proces të rregullt

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.
3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
 - a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
 - b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
 - c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
 - d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
 - e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Bellet kundër Francës - 23805/94

4 dhjetor 1995 [Seksioni i Tretë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6 §1

Shkelje e të drejtës për qasje në gjykatë si pasojë e refuzimit të ankesës bazuar në faktin se çështja ishte trajtuar në instanca tjera/ ka shkelje

Fjalët kyçe: transfuzion gjau / infektim / virusi HIV / obligim i shtetit / neglizhencë / kompensim / qasje në gjykatë / mjete ligjore

Ankuesi: z. Daniel Bellet, një shtetas francez i lindur në 1944

Faktet e rastit

Ankuesi ishte zyrtar i qeverisjes lokale të Qytetit të Parisit dhe ishte në pushim mjekësor të zgjatur. Si një i sëmurë nga hemofilia A, simptomat e së cilës iu shfaqën së pari në vitin 1948, ai shpesh ka kryer transfuzione gjaku. Sidomos në mes të viteve 1983 dhe 1984, në ankuesi janë kryer një numër i madh i transfuzioneve të gjakut. Më 26 tetor 1983 ai u diagnostikua se ishte i infektuar me virusin e mungesës së imunitetit të njeriut (HIV).

Më 19 maj 1990, ankuesi parashtroi në Gjykatën Administrative të Parisit një kërkesë për dëmshpërblim nga shteti për shkak të infeksionit të tij. Në aktgjykimin e datës 8 prill 1992, gjykata e hodhi poshtë kërkesën e tij me arsyetimin se ai ishte diagnostifikuar HIV-pozitiv jashtë periudhës së përgjegjësisë së shtetit për mosveprim nga neglizhenca, i cili filloi më 12 mars 1985, kur autoritetet ministrore ishin plotësisht të informuar se produktet e gjakut të përgatitura nga grupet e donatorëve në Paris ishin të rrezikshme.

Paralelisht, në dhjetor të vitit 1991, ankuesi bëri një kërkesë urgjente tek kryetari i Gjykatës së Parisit për një urdhër të përkohshëm që Fondacioni Kombëtar i Transfuzionit të Gjakut ("FNTS"), duhet t'i paguajnë atij shumën prej 3.000.000 franga franceze (FRF) në lidhje me dëmet e pësuar. Ekspertiza e porositur nga gjykata në prill të vitit 1992 arriti në përfundimin se infeksioni i ankuesit ishte i mundshëm nga produktet e gjakut të furnizuara nga FNTS. Më 19 maj 1992, mbrojtësi i ankuesit, pa e informuar gjykatën për kërkesën e parashtruar pranë Fondit të Kompensimit, solli një kërkesë të dytë kundër FNTS në shumën prej 3.000.000 FRF.

Në aktgjykimin e 14 shtatorit 1992, gjykata urdhëroi FNTS-në të paguante kompensimin e ankuesit në shumën prej 1,500,000 FRF dhe vendosi që aktgjykimi të jetë i ekzekutueshëm menjëherë. Me 9 prill 1992, përderisa padia e tij civile ishte duke u përgatitur për gjykim dhe pa vepruar përmes avokatit të tij, ankuesi kishte paraqitur një kërkesë në Fondin e Kompensimit për Pacientët dhe Hemofilikët e Transfuzionit, që ishin themeluar me Aktin e 31 Dhjetorit 1991. Më 21 maj, Fondi i ofroi atij si kompensim në shumën prej 993,750 FRF, që do të pagueshme në tre këste gjatë një periudhe prej dy vjetësh.

Me 16 tetor 1992, FNTS, e cila kishte mësuar për kompensimin e paguar nga Fondi, kishte aplikuar për pezullim të ekzekutimit të vendimit. Për shkak se ankuesi kishte pranuar këtë kompensim, Gjykata e Apelit në Paris refuzoi vendimin e gjykatës për rritjen e kompensimit dhe vendosi që padia e ankuesi, që shuma të rritet në 3,000,000 FRF të ishte e papranueshme. Ky vendim u konfirmua edhe nga Gjykata e Kasacionit me 26 janar 1994.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi argumentoi se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Paris të datës 12 mars 1993, në të cilën gjykata vendosi që padia e tij ishte e papranueshme, sikurse u konfirmua nga Gjykata e Kasacionit më 26 janar 1994, ai aktgjykim kishte privuar atë nga e drejta e tij për qasje në gjykatë e drejtë kjo e garantuar nga Neni 6 § 1 i Konventës. Megjithëse kishte pranuar ofertën nga Fondi pasi kishte nevojë urgjente për para, në prag të vdekjes e cila ishte e pashmangshme, ankuesi kishte menduar se ai kishte të drejtë të padisë palën përgjegjëse për infeksionin e tij. Ai nuk kishte asnjë arsye të dyshonte për rezultatin e veprimit të tij gjyqësor, duke pasur parasysh në veçanti kushtet e Nenit 47 (IX) të Aktit të 31 dhjetorit 1991, që parasheh se “pranimi i një oferte nga Fondi nuk kishte efekt në vazhdimin e veprimeve gjyqësore”. Për më tepër, aplikuesi thekson se kishte nënshkruar formën standarde të pranimit të fondit, ku thuhet se personi informon Fondin nëse nis procedurë gjyqësore, pas pranimit të dëmshpërblimit.

Para Gjykatës Qeveria franceze ka ngritur argumente disi të ndryshme nga ato të parashtruara para Komisionit, pasi ai kishte vendosur se pranimi i ofertës nuk pengonte nisjen e procedurës gjyqësore. Qeveria argumentoi se ankuesi kishte pasur qasje të lirë në gjykatë. Pavarësisht nga procedurat penale në të cilat ankuesi mund të kishte qenë palë civile, tre lloje të veprimeve për dëmshpërblim kishin qenë në dispozicion të tij: Së pari, kërkesa në të drejtën administrative, në këtë rast, Gjykata Administrative kishte shqyrtuar çështjen dhe ka hudhur poshtë kërkesën me një vendim të arsyeshëm; Së dyti, një padi e zakonshme civile për kompensim të dëmit: rasti i ankuesit ishte shpallur i papranueshëm për shkak të mungesës së ndonjë interesi që i mundësonte atij të ngrinte procedurën, vendim i afirmuar nga Gjykata e Kasacionit; një vendim i tillë, i marrë, sipas Qeverisë, pasi gjykata kishte konsideruar meritat e çështjes si në fakt dhe në ligj, nuk e kishte privuar kërkuesin nga e drejta e tij për zgjidhje efektive. Së fundi, ankesa e veçantë në Gjykatën e Apelit të Parisit, e paraparë në Aktin e vitit 1991: pasi që nuk kërkohej as nga dy përfaqësuesit e zakonshëm ligjorë, kjo procedurë ishte e shpejtë dhe e lirë.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata rithekson se e drejta e qasjes në gjykata, e siguruar në Nenin 6 të Konventës nuk është absolute, por mund të jetë subjekt i kufizimeve. Kjo e drejtë bën thirrje për rregullim nga shteti, rregullim i cili mund të ndryshojë në kohë dhe në vend sipas nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve. Duke vendosur një rregull të tillë, shtetet kontraktuese gëzojnë një margjinë të caktuar vlerësimi, por vendimi përfundimtar për respektimin e kërkesave të Konventës i takon Gjykatës. Kufizimi nuk mund të zvogëlojë qasjen e individit në atë të drejtë në atë mënyrë që vetë thelbi i së

drejtës të dëmtohet. Duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet.

Lidhur me rastin konkret Gjykata pranoi se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar ankesën e veçantë në Gjykatën e Apelit të Parisit të paraparë në Nenin 47 (VIII) të Aktit të 31 dhjetorit 1991 ashtu siç e ka cekur Qeveria. Megjithatë, edhe pse pas pranimit të ofertës nga Fondi i Kompensimit, Gjykata e Apelit ka lejuar disa ankesa të këtij lloji, ato raste nuk mund të merren parasysh për shkak se janë shumë të reja dhe kontraverze. Gjykata theksoi se krijimi i një skeme të veçantë nga shteti francez për kompensimin e hemofilikëve dhe pacientëve të transfuzionit të infektuar me AIDS shfaq një frymë të shquar solidariteti. Por, nuk duhet që Gjykata të vlerësojë sistemin francez të kompensimit si të tillë.

Gjykata duhet të kufizohet sa më shumë që të jetë e mundur për të shqyrtuar çështjet specifike para saj. Në këtë drejtim, detyrë e Gjykatës është të vendosë nëse shpallja e padisë së ankuesit si e “papranueshme” nga Gjykata e Apelit në Paris, përbën shkelje ose jo të së drejtës për qasje në gjykata. Sipas gjykatës, sistemi nuk ishte mjaft i qartë ose nuk kishte mjaftueshëm masa mbrojtëse për të parandaluar keqkuptimin lidhur me procedurat për përdorimin e mjeteve juridike në dispozicion dhe kufizimet që rrjedhin nga përdorimi i njëkohshëm i tyre. Andaj, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit, sidomos, qëllimin e ligjvënësit për të kompensuar të gjitha viktimat e këtyre transfuzioneve të gjakut, e cila reflektohet në historikun e procedimit në parlament të këtij ligji; Gjykata konstaton se ankuesit nuk i’u ishte ofruar një e drejtë praktike dhe efektive për qasje në gjykata në procedurat para Gjykatës së Apelit të Parisit. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës [8 vota për dhe një kundër].

Shtojcë e akgykimit janë: mendimi mospajtues i gjykatësit z. Pettiti, mendimi pajtues i gjykatësit, z. Walsh, dhe mendimi pajtues i gjykatësve, z. PekkaNen and z. Jambrek.

Gjykatësi Pettit ka votuar kundër kërkesës së ankuesit dhe nuk është pajtuar me rezonimin e gjykatës, për shkak se sipas tij, ligji për kompensimin e viktimave të transfuzioneve të gjakut ishte i qartë dhe efektet e tij ishin proporcionale. Sigurishtse çfarëdo skeme të kompensimi mund t’i jepet një lexim humanitar, por Konventa nuk e lejon gjykatën të vendosë vetëm mbi bazën e përshtypjeve subjektive të aplikuesit, pavarësisht rrethanave tragjike të viktimës.

Gjykatësi Walsh pajtohet me të gjitha aspektet e akgykimit.

Gjykatësi PekkaNen dhe Jambrek, pajtohen me përfundimin e gjykatës por deri tek ky rezultat kanë ardhur përmes një rezonimi tjetër. Sipas tyre, sistemi francez i ndërmarrjes së veprimeve gjyqesore është pamjaftueshëm i qartë për parandalimin e keqkuptimit të përdorimit të mjeteve juridike për marrjen e kompensimit për dëmin specifik të shkakuar. Megjithatë tek i njejtë përfundim kanë arritur, kryesisht për shkak të mendimeve të ndryshme të gjykatave supreme franceze, dhe jo për shkak të qëllimeve të ligjvënësit siç shpaloset në procedurat parlamentare të ligjit konkret. Duke

marrë parasysh ndryshimin e mendimeve në mes të gjykatave më të larta franceze dhe ekzistencën e procedurës së veçantë për trajtimin e fatkeqësisë, në të cilën ankuesi ishte viktimë, këta gjyqtarë arritën në përfundimin se ankuesi kishte arsye adekuate për të supozuar se ai duhet të përdorte procedurën e krijuar posaçërisht për t'iu përshtatur situatës së tij.

Moroko kundër Russisë - 20937/07

1 dhjetor 2008 [Seksioni i Parë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6 § 1 dhe Neni 1 i Protokolit Nr. 1

Shkelje e të drejtës në gjykatë dhe të drejtës në pronë si pasojë e mos ekzekutimit të aktgjykimit në të mirë të ankuesit / *nuk ka shkelje*

Neni 13

Mungesë e mjeteve efektive të brendshme për adresimin e moszbatimit të aktgjykimit / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *procedura gjyqësore / vendim lirues / kompensim / ekzekutim / vonesa / mjete efektive*

Ankuesi: Zt. Andrey Vladimirovich Moroko, i lindur në vitin 1979 dhe jeton në Krasnoyarsk

Faktet e rastit

Në vitin 2001-02 ankuesi ai u paraqit për gjykim për një vepër drogë për të cilën dhe u lirua. Ai e paditi Shtetin për kompensim për ndjekjen penale të pabazuar dhe paraburgimin. Rasti u trajtua nga Gjykat e Qarkut Leninskiy të Krasnoyarsk, e cila me aktgjykimet e 5 dhjetorit 2003 dhe 21 shtator 2006, urdhëroi Ministrinë e Financave të kompensojë dëmin jomaterial dhe atë monetar të ankuesit. Aktgjykimet u bënë të detyrueshme më 2 shkurt 2004 dhe 16 nëntor 2006, por nuk u zbatuan menjëherë. Aktgjykimi i 5 dhjetorit 2003 ishte zbatuar më 21 tetor 2005, kur Ministria e krediton borxhin e aktgjykimit në llogarinë bankare të ankuesit. Aktgjykimi i 21 shtatorit 2006 i cili ishte i ekzekutueshëm më 16 nëntor 2006 nuk ishte zbatuar menjëherë. Urdhri i përbarimit u dërgua nga gjykata në shërbimin përbarimor dy muaj dhe shtatë ditë pas vendimit përfundimtar. Në të njëjtën datë, shërbimi përbarimor e ktheu shkresën në gjykatë pasi nuk kishte kompetencë për të zbatuar këtë aktgjykim sipas dispozitave përkatëse të Kodit Buxhetor. Më 27 mars 2007, ankuesi i dërgoi dokumentet përkatëse Thesarit Federal, dhe më 15 gusht 2007, borxhi i aktgjykimit u kreditua në llogarinë bankare të ankuesit.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi u ankua se moszbatimi i gjatë i aktgjykimeve shkeli Nenin 6§1 të Konventës dhe Nenin 1 të Protokollit Nr. 1.

Qeveria argumentoi se ankuesi kishte dështuar të shteronte mjetet juridike vendore në shkelje të Nenit 35 § 1 të Konventës. Ai kishte pasur në dispozicion tre mjete juridike, por nuk kishte përdorur asnjë prej tyre. Mjeti i parë kishte qenë një ankesë gjyqësore lidhur me neglizhencën e Ministrisë sipas Kapitullit 25 të Kodit të Procedurës Civile. Mjeti i dytë ishte një kërkesë për të përmirësuar borxhin e gjykimit sipas Nenit 208 të Kodit të Procedurës Civile. Mjeti i tretë ishte një kërkesë për dëm jo-material sipas

Kreut 59 § 4 të Kodit Civil. Në përputhje me këtë kapitull, mund të jepet dëm jo-material për moszbatimin e aktgjykimeve vendore nëse në procedurat gjyqësore vërtetohet fakti i vuajtjes morale, fajit të debitorit dhe lidhjes shkakësore midis veprimeve të tij dhe pasojave negative për ankuesin. Sipas mendimit të Qeverisë, ky mjet ka provuar efektivitetin e saj në praktikë.

Në lidhje me këtë ankuesi u përgjigj se nuk kishte mjete vendore për tu shtejerruar. Mjeti i parë i përmendur nga Qeveria do të kishte rishikuar vetëm detyrimin origjinal të pagesës që përmbahet në aktgjykimin e parë. Sa i përket mjetit të dytë të cituar nga Qeveria, thjesht ekzistenca e dispozitës që lejon të përmirësojë çmimet gjyqësore nuk ishte e mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e Neneve 6 dhe 13. Mjeti i tretë nuk kishte ekzistuar realisht, sepse Kodi Civil deklaroi se dëmi jo-material mund të jepej vetëm në rastet e parashikuara nga ligji (Neni 1099). Ligji, megjithatë, nuk parashikonte në mënyrë specifike kompensimin e dëmit jo-material në rast të zbatimit me vonesë të aktgjykimit.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata fillimisht vëren se mjetet juridike efektive dhe të disponueshme janë ato që janë të arritshme, të afta për të siguruar dëmshpërblim në lidhje me ankesat e ankuesit dhe ofrojnë perspektiva të arsyeshme për sukses. Tre mjetet juridike të sugjeruara nga Qeveria nuk kanë këtë cilësi. Një ankesë kundër neglizhencës së Ministrisë do të jepte një gjykim deklarues që do të përsëriste atë që në çdo rast ishte e dukshme nga vendimi origjinal: Shteti duhet të nderonte borxhin e saj. Ky aktgjykim i ri nuk do të sillte ankuesin më afër qëllimit të tij të dëshiruar, domethënë pagesën aktuale të vendimit gjyqësor ose, nëse është e përshtatshme, kompensimin për pagesat e vonuara.²⁸ Sa i përket mundësisë së përmirësimit të borxhit të gjykimin, Gjykata kishte vërejtur në raste të caktuara të përmendura nga Qeveria se përmirësimi i shpërblimeve gjyqësore ishte kompensuar në mënyrë efektive për ankuesit për humbje inflacioniste. Gjykata u shpreh lidhur me ato raste se pagesa pa vonesa të panevojshme të një kompensimi të tillë së bashku me njohjen e shkeljeve nga ana e autoriteteve, i kishte hequr ankuesve statusin e tyre të viktimës. Megjithatë, këto vendime nuk përcaktojnë asnjë parim të përgjithshëm se kompensimi i thjeshtë për humbjet e inflacionit është i mjaftueshëm për të siguruar korrigjimin e kërkuar nga Konventa për zbatimin e vonuar të aktgjykimit. Në të gjitha rastet e lartpërmendura, Gjykata arriti konkluzionet e saj në rrethanat specifike ku pretendimet e ankuesve për kompensim ishin të kufizuara në humbjet monetare që rezultojnë nga inflacioni ose pozicioni i ankuesve në procedurat e brendshme u konsiderua si një heqje e nënkuptuar për të kërkuar kompensim për mjete të mëtejshme ose dëm jo-financiar. Gjykata pajtohet në parim me ankuesin se thjesht përmirësimi i shpërblimeve gjyqësore në pajtim me Nenin 208 të Kodit të Procedurës Civile nuk mjafton për të përmbushur kërkesat e Konventës për efektivitetin pasi që do të kompensonte vetëm humbjet e mundshme të inflacionit dhe jo më tej dëmet, qoftë financiare ose jomateriale. Ky mjet përmirësimi, megjithatë i arritshëm dhe efektiv në

²⁸ *Jasiūnienė kundër Lituaniës* (vendim), nr. 41510/98, 24 Tetor 2000, *Plotnikovy kundër Rusisë*, nr. 44883 / 02, § 16, 24 shkurt 2005

ligj dhe në praktikë, nuk është i aftë në përgjithësi të sigurojë një korrigjim adekuat dhe të plotë për moszbatimin ose zbatimin me vonesë të aktgjykimeve vendore.

Sa i përket mundësisë për të kërkuar dëmshpërblim për dëmin jomaterial sipas kapitullit 59 të Kodit Civil, Gjykata vëren, siç theksohet nga ankuesi, se ligji rus nuk parashikon në mënyrë specifike kompensimin e dëmit jo-material që rrjedh nga zbatimi me vonesë i aktgjykimeve vendore. Duke pranuar mendimin e Qeverisë se mundësia e një kompensimi të tillë nuk është përjashtuar në parim sipas dispozitave ekzistuese të përgjithshme të Kodit Civil, Gjykata nuk është e bindur se kjo mundësi është mjaft e sigurt në praktikë, në mënyrë që t'i ofrojë ankuesit mundësi të arsyeshme suksesi siç kërkohet nga Konventa. Me përjashtim të një numri të kufizuar të rasteve të renditura në seksionet 1070 dhe 1100, kompensimi i dëmit jomonetar i nënshtrohet krijimit të fajit të autoriteteve. Gjykata vëren se kjo gjendje vështirë se mund të jetë e kënaqur në mënyrë sistematike në rastet e mos zbatimit, duke pasur parasysh kompleksitetin e procedurave të përbarimit dhe rrethanat e mundshme objektive që parandalojnë zbatimin, siç është mungesa e fondeve në llogarinë e debitorit. Dyshimet në lidhje me efektivitetin e këtij mjeti janë vërtetuar nga dështimi i Qeverisë për të demonstruar para Gjykatës ekzistencën e një jurisprudence të mjaftueshme dhe të qëndrueshme, që provon se ky mjet është efektiv si në teori ashtu edhe në praktikë. Gjykimi vendas i cituar nga Qeveria si dhënia e dëmit jo-material në bazë të dispozitave ekzistuese nuk lejon që Gjykata të largohet nga përfundimi i saj.²⁹ Prandaj, Gjykata refuzon argumentin e Qeverisë për mos shterimin e mjeteve juridike vendase.

Tutje për sa i përket afatit të parashtrimit të ankesës, Gjykata vëren se kur nuk ka mjet efektiv juridik, periudha gjashtë mujore shkon nga data e mosveprimit të ankuesit ose nga data kur ankuesi mësoi për mosveprimin.³⁰ Në raport me mos-ekzekutimin, ky rregull do të thotë që gjashtë muaj të mbarojnë nga data e ekzekutimit. Në rasin në fjalë aktvendimi i 5 dhjetorit 2003 u zbatua më 21 tetor 2005, që është më shumë se gjashtë muaj para datës së ankesës. Nga njëra anë, ankuesi pohon se ai ka mësuar për transferimin e fondeve në llogarinë e tij vetëm në vitin 2007. Por nga ana tjetër, ai mund të pritet me arsye që të ketë mësuar për transferin në vitin 2005, sepse ky veprim ishte i shënuar në deklaratën e tij bankare. Nga kjo del se kjo pjesë e ankesës është futur jashtë afatit dhe duhet të hidhet poshtë në përputhje me Nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

Sa i përket gjykimit të 21 shtatorit 2006, Qeveria argumentoi se ankesa ishte qartazi e pabazuar. Zbatimi kishte zgjatur një kohë të shkurtër. Ankuesi kishte dërguar shkresën e përbarimit në autoritetin e gabuar. Ai kishte vepruar në keqbesim, sepse në vend që të dërgonte shkresën në autoritetin e duhur, ai kishte aplikuar në Gjykatë. Ankuesi nuk bëri asnjë vërejtje për këtë pikë. Gjykata i referohet gjetjeve të saj të shumta të shkëlqeve për shkak të zbatimit të gjërë të vendimeve gjyqësore vendase në Rusi dhe vë në dukje se kjo pjesë e kërkesës nuk është qartazi e pabazuar në kuptim të Nenit 35 § 3 të Konventës, prandaj duhet të deklarohet e pranueshme.

²⁹ *Wasserman kundër Rusisë* (nr. 2), nr. 21071/05, 10 Prill 2008

³⁰ *Hilton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 12015/86, Vendimi i Komisionit të 6 korrik 1988, DR 57, fq. 108

Lidhur me meritat e rastit, Gjykata vëren se zbatimi i aktgjykimit të 21 shtatorit 2006 zgjati nga 16 nëntori 2006 deri më 15 gusht 2007, pra nëntë muaj. Qeveria parashtroi se kjo periudhë ishte e arsyeshme dhe se të gjitha autoritetet e përfshira në ekzekutimin e këtij aktgjykimi kishin shfaqur kujdesin e duhur, duke shmangur vonesat e panevojshme. Ankuesi pretendoi të kundërtën. Për të vendosur nëse vonesa ishte e arsyeshme, Gjykata shqyrtoi se sa komplekse ishin procedurat e ekzekutimit, si u sollën ankuesi dhe autoritetet, dhe cila ishte natyra e shpërblimit. Njëkëtë aspekt Gjykata vëren se nga njëra anë, gjykimi ishte i lehtë për t'u zbatuar, sepse kërkonte vetëm transferimin e shumës së parave dhe ishte shteti, jo ankuesi, i cili duhej të merrte iniciativën e zbatimit të tij.³¹ Nga ana tjetër, koha e përgjithshme e marrë nga autoritetet për të zbatuar aktgjykimin nuk duket *prima facie* e paarsyeshme dhe është në çdo rast më pak se koha e gjetur të jetë e tepruar në rastet e tjera të ngjashme në lidhje me Rusinë, ku Gjykata gjeti shkelje të Konventës për shkak të mosekzekutimit ose përbarimit të vonuar. Gjykata më tej vëren se autoritetet kishin vepruar me kujdesin e duhur. Urdhri për përbarim u dërgua nga gjykata kompetente në shërbimin përbarimor dy muaj dhe shtatë ditë pasi që aktgjykimi të ishte bërë i formës së prerë. Në të njëjtën datë, shërbimi përbarimor e ktheu shkresën në gjykatë pasi nuk kishte kompetencë për të zbatuar këtë aktgjykim sipas dispozitave përkatëse të Kodit Buxhetor. Dy muaj më vonë, ankuesi i dërgoi dokumentet përkatëse Thesarit Federal dhe aktgjykimi u zbatuar pesë muaj pas asaj date. Duke vënë në dukje se Ministria e Financave nuk ka respektuar afatin tre mujor të përcaktuar nga Kodi i Buxhetit për ekzekutimin e aktgjykimit, Gjykata nuk konsideron se kalimi i kohës që ka ndodhur ka shkelur kërkesën e arsyeshme kohore të sanksionuar në Konventë. Duke pasur parasysh sa më sipër, dhe duke pasur parasysh faktin se vendimi nuk lidhej me burimin kryesor të të ardhurave të ankuesit, por përbënte vetëm një sasi të kufizuar dëmshpërblimi për një gabim në të të kaluarën, Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të Nenit 6 të Konventës dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

Ne lidhje me ankesën e ankuesit në bazë të Nenit 13 të Konventës se nuk kishte mjete juridike të brendshme kundër moszbatimit Gjykata rikujton që Neni 13 është interpretuar në mënyrë të vazhdueshme nga Gjykata, duke kërkuar që një mjet juridik në ligjin vendas të zbatohet vetëm në lidhje me ankesat që mund të konsiderohen si "të diskutueshme" në lidhje me Konventën.³² Duke iu referuar vendimit të vet mbi pranueshmërinë e mësipërme, Gjykata konsideron se kërkesa e ankuesit sipas këtyre neneve ishte e diskutueshme. Duke marrë parasysh kundërshtimin paraprak të Qeverisë, Gjykata gjen se ankuesi nuk kishte asnjë mjet juridik për ta shteruar, pasi asnjë nga mjetet që u përmenden nga Qeveria nuk ishte në përputhje me kërkesat e Konventës për efektivitetin. Duke pasur parasysh mangësitë e ndryshme të mjeteve të brendshme të identifikuar më lart, Gjykata vie në konkludim se ankuesi ishte i privuar nga një mjet efektiv në lidhje me kërkesën e tij të diskutueshme për kompensim për përbarimin e vonuar të vendimit të brendshëm në favor të tij. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Nenit 13 të Konventës.

³¹ *Metaxas kundër Greqisë*, nr. 8415/02, § 19, 27 maj 2004

³² *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 27 prillit 1988, Seria A nr. 131, f. 23-24, § 54

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se nuk ka shkelje të Nenit 6 të Konventës dhe Nenit 1 të Protokollit nr. 1; gjithashtu gjen se ka shkelje të Nenit 13 të Konventës [*njëzëri*].

Salduz kundër Turqisë - 36391/02
27 nëntor 2008 [Dhoma e Madhe]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6 § 3 në kombinim me Nenin 6 § 1

Përdorimi si dëshmi i një rrëfimi të bërë në polici nga një i mitur të cilit i është mohuar qasja për avokat mbrojtës, përbën shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë / *ka shkelje*

Neni 6 § 1

Mos-komunikimi (ankuesit) i opinionit me shkrim të Kryeprokurorit Publik pranë Gjykatës së Kasacionit paraqet shkelje të të drejtës në gjykatë / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *arrestim / deklaratë / polici / [mos]prani e avokatit / nën shtrëngim / gjykim i drejtë / mos komunikim / mitur*

Ankuesi: z. Jusuf Salduz, shtetas turk

Aspektet procedurale:

Ankuesi është ankuar në veçanti se të drejtat e tij të mbrojtjes i janë çenuar për faktin që opinionit me shkrim i Kryeprokurorit Publik pranë Gjykatës së Kasacionit nuk i është komunikuar atij dhe se atij i është mohuar e drejta në mbrojtje ligjore gjatë kohës sa ka qenë në mbajtje policore. Në këto aspekte, ai është mbështetur në Nenin 6 § 1 dhe 6 §3 (c) të Konventës.

Ankesa i ishte caktuar Seksionit të Dytë të Gjykatës. Në mars të vitit 2006, një dhomë e këtij seksioni e kishte shpallur rastin pjesërisht të pranueshëm. Në një vendim të 26 prillit 2007, dhoma e Gjykatës kishte vendosur njëzëri se ka shkelje të Neni 6 § 1 në lidhje me mos-komunikimin e opinionit me shkrim të Kryeprokurorit Publik dhe tuje kishte vendosur me pesë vota kundër dyve se nuk kishte shkelje të Neni 6 § 3 (c) në pikën që ka të bëjë me mungesën e ndihmës ligjore të ankuesit gjatë kohës sa ndodhej në mbajtje policore. Më 20 gusht 2007, ankuesi kishte kërkuar që rasti t'i referohej Dhomës së Madhe (Neni 43 i Konventës).

Më 24 shtator 2007, një panel i Dhomës së Madhe mori vendim që të pranonte kërkesën e ankuesit për shqyrtim të rastit nga Dhoma e Madhe. Më pas, ankuesi dhe Qeveria kishin dorëzuar pikëpamjet e tyre me shkrim sa i përket meritave të rastit.

Faktet e rastit

Më 29 maj 2001, rreth orës 22.15, ankuesi ishte marrë në mbajtje nga zyrtarë policorë të Degës së Kundër-terrorizmit të Drejtoratit të Sigurisë së Izmirit nën dyshimin e pjesëmarrjes në një protestë të jashtëligjshme në mbështetje të një organizate që nga shteti konsiderohet si ilegale, pra Partisë Popullore Kurde (PPK). Ankuesi ishte akuzuar gjithashtu se kishte varur një pankartë (parullë) të jashtëligjshme në një urë në datën 26 prill 2001. Rreth orës 00:30 të mëngjesit të datës 30 maj 2001, ankuesi ishte dërguar në një spital, ku ishte kontrolluar nga një doktor. Raporti mjekësor theksonte se nuk kishte shenja të keqtrajtimit në trupin e tij. Më pas, rreth orës 1 të mëngjesit,

ankuesi ishte marrë në pyetje në Degën e Kundër-terrorizmit pa praninë e një avokati. Sipas një formulari që shpjegonte të drejtat e të arrestuarit, të cilin ankuesi e kishte nënshkruar, atij i ishin ritheksuar akuzat ndaj tij dhe e drejta e tij për t'u mbrojtur në heshtje. Në deklaratën e tij, ankuesi kishte pranuar përfshirjen e tij në degën rinore të Partisë Popullore për Demokraci (*Halkin Demokrasi Partisi - HADEP*). Ai e kishte pranuar gjithashtu se kishte marrë pjesë në protestën e 29 majit 2001 në mbështetje të liderit të burgosur të PPK-së. Ai kishte theksuar tutje se pjesëmarrës ishin rreth gjashtëdhjetë veta dhe që grupi kishte brohoritur slogane në mbështetje të Oçalanit dhe PPK-së. Po ashtu, ai kishte pranuar se kishte shkruar "Jetë të gjatë lideri Apo" në një pankartë që ishte varur në urë më datën 26 prill 2001. Policia kishte marrë modele të shkrimit me dorë dhe i kishte dërguar në laboratorin policor për ekzaminim.

Më 1 qershor 2001, Laboratori i Policisë Kriminale të Izmirit kishte lëshuar një raport ku krahasonte dorëshkrimin e ankuesit me shkrimin në pankartë. Përfundimi ishte se ndonëse disa karakteristika të dorëshkrimit të ankuesit kishin ngjashmëri me dorëshkrimin në pankartë, megjithatë nuk mund të përcaktohej nëse shkrimi në pankartë ishte në të vërtetë shkrimi i tij. Të njëjtë ditë, ankuesi ishte sjellë sërish para prokurorit publik dhe më pas gjykatësit hetues. Para prokurorit publik, kishte sqaruar se nuk ishte anëtar i ndonjë partie politike, porse kishte marrë pjesë në disa aktivitete të HADEP-it. Ai kishte mohuar me këtë rast prodhimin e pankartës së paligjshme ose se kishte marrë pjesë në protestën e 29 majit 2001. Ai kishte theksuar se ishte në fqinjësi duke vizituar një mik në momentin kur ishte arrestuar. Ankuesi po ashtu kishte bërë një deklaratë edhe para gjykatësit hetues, ku ishte tërhequr nga deklarata e bërë në polici, me pretendimin se i ishte marrë nën detyrim. Në këtë rast, kishte theksuar se ishte rrahur dhe fyer derisa po merrej në pyetje në polici. Pas marrjes në pyetje, ankuesi kishte vazhduar të mbahej në ndalim, marrë parasysh natyrën e veprës për të cilën akuzohej. Vetëm atëherë ankuesi ishte lejuar që të kishte qasje te një avokat.

Më 11 korrik 2001, Prokurori Publik kishte dorëzuar një aktakuzë në Gjykatën Shtetërore të Sigurisë në Izmir, ku e akuzonte ankuesin dhe tetë të tjerë për ndihmë dhe mbështetje PPK-së, që ishte vepër penale sipas Neni 169 të Kodit Penal dhe seksionit 5 të Aktit për Parandalim të Terrorizmit. Më 16 korrik 2001, Gjykata Shtetërore e Sigurisë kishte organizuar një dëgjim paraprak dhe marrë vendim që të vazhdonte burgimin me kusht të ankuesit. Në gusht 2001, kjo gjykatë kishte mbajtur seancën e parë në prani të ankuesit dhe avokatit të tij. Në dëshminë e tij, ankuesi kishte mohuar të gjitha akuzat kundër tij. Ai po ashtu kishte hedhur poshtë deklaratën e policisë, duke theksuar se e kishte dhënë atë nën detyrim. Ai kishte sqaruar se gjatë kohës sa ishte në paraburgim, zyrtarët policorë e kishin urdhëruar që të kopjonte fjalët e pankartës. Me këtë rast po ashtu kishte deklaruar se i ka vëzhguar ngjarjet e asaj dite, porse vetë nuk ka marrë pjesë në protestë. Gjithashtu, kishte mohuar vënien apo krijimin e pankartës.

Më 5 dhjetor 2001, Gjykata Shtetërore e Sigurisë në Izmir kishte nxjerrë aktgjykimin me të cilin lironte pesë nga të akuzuarit dhe shpallte fajtorë ankuesin dhe tre persona të tjerë.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi ka pretenduar se të drejtat e tij të mbrojtjes i janë cënuar, pasi atij i është mohuar e drejta për avokat gjatë mbajtjes në ndalim policor. Në këtë pikë, ai është

mbështetur në Nenin 6 § 3 (c) të Konventës, duke theksuar se ndihma e një avokati në këtë rrethanë ishte një e drejtë themelore. Ai kishte theksuar se e gjitha dëshmia që ishte përdorur kundër tij ishte marrë gjatë fazës së hetimeve paraprake, fazë gjatë të cilës i ishte mohuar asistenca e një avokati. Në këtë drejtim, ankuesi po ashtu kishte deklaruar se, edhe pse gjykata vendase e kishte shpallur atë fajtor, nuk kishte dëshmi që provonte se ai ishte fajtor. Ai ka theksuar tutje se dëshmia e tij nga policia i është marrë nën kërcënim, duke shtuar tutje se në kohën relevante ka qenë i mitur dhe se nuk ka pas dosje të mëparshme kriminale.

Qeveria, nga ana e saj, i ka kërkuar Dhomës së Madhe të Gjykatës që të mbështesë gjetjen e dhomës se nuk ka pas shkelje të Nenit 6 § 3 (c) të Konventës. Qeveria ka theksuar se legjislacioni kishte ndryshuar në vitin 2005, se kufizimi i ankuesit për të drejtën në avokat nuk ka çënuar të drejtën e tij për gjykim të drejtë sipas Nenit 6 të Konventës. Duke ju referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës, Qeveria ka shprehur pikëpamjen se në vlerësimin e asaj nëse gjykimi ka qenë i drejtë, duhet marrë në shqyrtim tërësinë e procedurës. Kësisoj, sipas Qeverisë, pasi ankuesi është përfaqësuar nga një avokat në procedurën përpara Gjykatës Shtetërore të Sigurisë në Izmir dhe Gjykatës së Kasacionit më pas, si pasojë e drejta e tij për gjykim të drejtë nuk është çënuar.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata së pari thekson se, edhe pse qëllimi parësor i Nenit 6, për sa ka të bëjë me procedimet penale, është që të sigurojë gjykimin e drejtë nga një “tribunal” kompetent për të përcaktuar “akuzat penale”, kjo nuk do të thotë se ky nen nuk gjen zbatim në procedurat para-gjyqësore. Në këtë mënyrë, Neni 6, sidomos paragrafi 3, mund të jetë i rëndësishëm para se një rast të dërgohet në gjykim nëse dhe për aq sa drejtësia e gjykitimit ka mundësi të kompromentohet nga dështimi fillestar për të respektuar dispozitat e këtij neni. Gjykata tutje ka ritheksuar se, ndonëse jo absolute, e drejta e secilit të akuzuar për vepër penale, për t’u mbrojtur në mënyrë efektive nga një avokat, nëse është nevoja të përcaktuar zyrtarisht, është njëra prej veçorive themelore të gjykitimit të drejtë. Sidoqoftë, Neni 6 § 3 (c) nuk saktëson mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte; pra, ua lejon shteteve palë zgjedhjen e mënyrave për të siguruar se kjo gjen zbatim në sistemet e tyre juridike. Detyra e Gjykatës në këtë drejtim është vetëm që të vlerësojë nëse metoda që kanë zgjedhur shtetet është në pajtim me kërkesat e gjykitimit të drejtë. Sidoqoftë, Gjykata thekson se në mënyrë që e drejta për gjykim të drejtë të jetë mjaftueshëm “praktike dhe efektive”, Neni 6 § 1 kërkon që, si rregull, qasja në avokat të mundësohet që nga marrja e parë në pyetje e të dyshuarit nga policia, përveç nëse dëshmohej e kundërta në dritën e rrethanave të veçanta të secilit rast se ka arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë.

Në rastin konkret, ankuesit i’u ishte mohuar e drejta për qasje në avokat mbrojtës gjatë mbajtjes dhe marrjes në pyetje në polici. Si pasojë, ai nuk ka pas qasje në avokat kur ka bërë deklaratat e tij në polici, në prokurori publike dhe para gjykatësit hetues. Asnjë justifikim tjetër nuk është dhënë për mohimin e qasjes së ankuesit në avokat, përveç faktit se kjo parashihej dispozitat relevante ligjore, pra kur një person akuzohej për vepra që ishin brenda juridiksionit të Gjykatës Shtetërore të Sigurisë. Kjo në vetvete

nuk plotëson kërkesat e Nenit 6. Gjykata tutje vëren se ankuesi kishte qasje në avokat vetëm pas burgimit me kusht.

Në rastin konkret, ankuesi ishte ndikuar pashmangshëm nga kufizimet e qasjes së tij në avokat, pasi deklarata e tij në polici ishte përdorur për dënimin e tij. As ndihma e mëvonshme e ofruar nga avokati dhe as natyra kundërshtuese e procedurave të mëpastajme nuk kishin ofruar kurë për defektet që kishin ndodhur gjatë mbajtjes në polici. Gjykata më tej ka rikujtuar se as germa dhe as fryma e Nenit 6 nuk e parandalon një person të heqë dorë me vullnetin e tij të lirë nga garancionet e gjykimit të drejtë. Sidoqoftë, në mënyrë që Konventa të mbetet efektive, heqja dorë nga pjesëmarrja në gjykim duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë dhe duke ndjekur standardet minimale në pajtueshmëri më rëndësinë e saj. Kësisoj, në rastin konkret, nuk është e mundur mbështetja në deklarinimin në formën se ankuesit i është rikujtuar ose ritheksuar e drejta për të mos u deklaruar.

Në fund, Gjykata vëren se një element specifik i rastit konkret ishte mosha e ankuesit. Duke pas parasysh një numër të konsiderueshëm të materialeve të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në lidhje me ndihmën ligjore për të miturit në ndalim/mbajtje policore, Gjykata nënvizon rëndësinë fundamentale të ofrimit të qasjes në avokat kur personi në paraburgim është i mitur. Për këto arsye, Gjykata vjen në përfundimin se ka pas shkelje të Nenit 6 § 3 (c) të Konventës në kombinim me Nenin 6 § 1.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se opinioni me shkrim i Kryeprokuroorit Publik të dorëzuar pranë Gjykatës së Kasacionit nuk i është komunikuar atij, duke u mbështetur në Nenin 6 § 1 të Konventës, Dhoma e Gjykatës, më 26 prill 2007, kishte gjetur shkelje të së drejtës së tij për kundërshtim gjatë procedurave. Në këtë drejtim, Dhoma e Madhe e Gjykatës pajtohet me këtë arsyetim dhe gjen se ka pas shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

Në fund dhe në lidhje me dëmshpërblimin, Gjykata ka ripërsëritur qëndrimin e mbajtur në raste të tjera të mëparshme se forma më e mirë për zhdëmtim për shkelje të Nenit 6 § 1 është të siguroarit e ankuesit se nuk vendoset në pozitën e njëjtë siç është bërë në rastin e tanishëm, duke shpërfillur këtë dispozitë të Konventës. Gjykata gjen se ky parim vlen edhe në rastin konkret. Prandaj, vlerëson se forma më e mirë e zhdëmtimit do të ishte rigjykimi i ankuesit në pajtim me kërkesat e Nenit 6 § 1 të Konventës, po qe se ai e kërkon këtë. Sa i përket pjesës së mbetur të dëmit jo-material, gjykuar në bazë të drejtshmërisë, Gjykata e urdhëron shtetin që t'i akordojë ankuesit një shumë në vlerën 2,000 EUR. Gjykata, gjithashtu, i ka njohur ankuesit të drejtën për mbulim të kostove dhe shpenzimeve në vlerën prej 1,000 EUR.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 6 § 3(c) në kombinim me Nenin 6 § 1 të Konventës, si dhe shkelje të Nenit 6 § 1 [*njësëri*].

Philis kundër Greqisë - 12750/87; 13780/88; 14003/88

27 gusht 1991 [Gjykata]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6

Shkelje e të drejtës në një gjykim të drejtë para një gjykate të pavarur dhe të paanshme brenda një koha e arsyeshme / *ka shkelje*

Neni 13

Mungesë e mjeteve efektive të përdorshme para një "autoriteti" kombëtar për të adresuar shkeljen e të drejtës për qasje në gjykatë / *e panevojshme për shqyrtim ndaras*

Neni 14

Trajtim ndryshe pasi si pasojë e veprimit retroaktiv të legjislacionit/ *e panevojshme për shqyrtim ndaras*

Fjalët kyçe: *inxhinier / punë e kontraktuar / shërbim / [mos]kompensim / qasje në gjykatë / përfaqësim / pamundësi qasjeje / mjet efektiv / diskriminim*

Ankuesi: z. Nicolaos Philis, shtetas grek

Faktet e rastit

Ankuesi ka punuar si inxhinier konsulent që nga viti 1970. Pas një mosmarrëveshje në lidhje me shumën e tarifave që i detyrohen atij për një numër të projekteve që ai kishte projektuar, u ngritën tri mosmarrëveshje mes atij dhe atyre që kishin porositur punën, dy korporata publike dhe një individ privat.

Mosmarrëveshja e parë - Fillimisht ankuesi filloi procedurat në lidhje me mosmarrëveshjen me Organizatën Autonome për Strehimin e Punës (Autonomos Organismos Ergatikis Katoikias - "A.O.E.K") një trup nën autoritetin e Ministrisë së Punës. Nga 1971 deri në 1975, dhe më pas nga viti 1976 deri më 1978, A.O.E.K., kishte lidhur me ankuesin një sëri kontratash për projektimin e instalimeve elektromekanike dhe mbikëqyrjen e punës përkatëse. Në mars të vitit 1978 A.O.E.K., mohoi këto kontratat dhe refuzoi t'i paguajë atij shpërblimin e dakorduar.

Mosmarrëveshja e dytë - Më pas, ankuesi filloi procedurat në lidhje me mosmarrëveshjen me Spitalin e Fëmijëve Penteli (Paidiko Nosokomeio Pentelis-"P.N.P."). Më 30 tetor 1981 Fondacioni Patriotik për Mirëqenie dhe Ndihmë Sociale (Patriotiko Idryma Koinonikis Pronoias kai Antilipseos - P.I.K.P.A.), një organ publik nën autoritetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenia sociale kishte autoruar ankuesin të hartonte një projekt për zgjerimin e sistemit të ngrohjes në një nga spitalet e saj, spitalin e fëmijëve Penteli. Më 23 shkurt 1983 ky spital, i cili në ndërkohë ishte bërë a organi publik, i kërkoi ankuesit të ndryshonte planet e tij. Projekti, i cili u paraqit brenda afateve të përcaktuara, u miratua më 13 prill 1983. Ankuesi konsideroi se ulja e tarifave të tij të kryera nga P.N.P. ishte arbitrare dhe ai kërkoi nga ta që të rishqyrtojë metodën e llogaritjes, por pa sukses. Më 24 shkurt 1984 ai zbatoi kërkesën përkatëse te

Departamenti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Pasi që nuk e mori vendim të kënaqshëm, ankuesi inicioi procedurë kundër P.I.K.P.A. dhe P.N.P. në Gjykatën e Apelit të Athinës më 1 Gusht 1984 sipas Nenit 61 të "Aktit Hyrës" (Eisagogikos Nomos) në Kodin e Procedurës Civile.

Mosmarrëveshja e tretë - Në nëntor të vitit 1980 ankuesi u kontraktua për kryerjen e disa punëve publike, me kompaninë A.S. Kjo kontratë kishte të bente me hartimin e planeve për instalimin e sistemit të kanalizimit në qytetin e Amfilohisë. Me një letër të 30 qershorit 1981, ankuesi kërkoi ndihmën e Odës Teknike Greke (Techniko Epimelitirio Ellados -"T.E.E), sepse A.S. kishte refuzuar planet dhe nuk kishte paguar shpërblimin e rënë dakord. Në shtator të vitit 1981 T.E.E. iu përgjigj atij se dëshironte të shlyente mosmarrëveshjen jashtë gjykatës. Pasi që negociatat ishin të pasuksesshme, ankuesi më 20 janar 1982 i kërkoi T.E.E-së të inicone procedimet ligjore. Më 30 mars 1983 ai përsëriti kërkesën e tij dhe i kërkoi T.E.E. të rivlerësoj shumat e pretenduara. Më 23 janar 1984 ai u ankua për vendimin dhe për keq llogaritjen e taksave. T.E.E. solli një veprim në gjykatën e shkallës së parë të Athinës më 16 Dhjetor 1985. Më 26 prill 1986 veprimi u lejua pjesërisht; dhe ankuesi nuk ka ndërhyrë në këto procedura. T.E.E. sfidoi aktgjykimin në Gjykatën e Athinës. Më 11 qershor 1987, gjykatë urdhëroi A.S. për të paguar T.E.E. 13,9336 drahma plus interes; megjithatë, gjykata refuzoi parashtrësën në lidhje me rivlerësimin e kërkesës sepse T.E.E. nuk e kishte specifikuar shumën e pretenduar (aktgjykimi 7439/1987). Më 10 korrik 1987, ankuesi parashroi një ankesë lidhur me T.E.E. sepse kjo e fundit dështoi të përfshinte në ankesë informacionin mbi bazën e të cilit koeficienti për rivlerësimin e lartpërmendur mund të llogaritet. Ai gjithashtu kërkoi që ajo të fillojë procedurat e ekzekutimit në lidhje me aktgjykimi i 11 qershorit 1987.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi pohoi rastet e tij të inicuar para gjykatave vendore nuk ishin trajtuar në përputhje me kriteret e kërkuara nga Konventa përkatësisht nuk kishte pasur një gjykim të drejtë para një gjykate të pavarur dhe të paanshme brenda një koha e arsyeshme. Ankuesi gjithashtu u ankua për shkelje të së drejtës së tij për qasje në Gjykate, me arsyetimin se T.E.E. kishte qenë caktuar ex officio për vepruar ne emër të tij për të rimarrë shpërblimin e duhur në lidhje me një numër projektesh që ai kishte projektuar. Ankuesi kërkoi që përmbajtja e ankesës se tij të zgjerohej dhe Gjykata të shqyrtojë pretendimet e tij për shkeljen e Neneve 6, 8, 13, 14 dhe 17 të Konventës dhe Nenit 1 i Protokollit Nr. 1.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata shpalli të pranueshme ankesat lidhur me të drejtën e qasjes në gjykatë dhe kohëzgjatjen e procedurave, përkatësisht pretendimeve për shkelje të Nenit 6 si i vetëm dhe në lidhje me Nenin 13 (Neni. 13), ndërsa shpalli ankesat e tjera të papranueshme. Duke pasur parasysh të gjitha provat e ofruara, Gjykata konsideron se mundet gjithashtu të shqyrtojnë ankesën bazuar në Nenin 14 sepse lidhet me të njëjtat fakte si ankesat sipas Neneve 6 dhe 13.

Ankuesi pretendoi shkelje të Nenit 6 § 1 në dy aspekte. Në radhë të parë ai pohoi se atij iu ishte refuzuar qasja në një gjykatë për të kërkuar shpërblimin e pagueshëm në lidhje

me një numër projektesh të cilat ai kishte projektuar. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit e Athinës duke vendosur mbi mosmarrëveshjen e tij me Spitalin e Fëmijëve Penteli, nuk kishte dhënë, sipas tij, vendimin e saj "brenda një kohe të arsyeshme". Ankuesi u ankua se Gjykata e Apelit e Athinës mori më shumë se tre vjet për të dhënë vendimin në rastin e tij, e cila në çdo rast ishte e kufizuar duke hedhur poshtë veprimin e tij për shkak se ai nuk kishte kapacitet për të sjellë veprime.

Në shqyrtimin e vet Gjykata rikujton se në aktgjykimet e saj në rastin *Golder dhe Ashingdane*³³ kishte konstatuar se Neni 6 § 1 i siguron secilit të drejtën për të sjellë ndonjë kërkesë në lidhje me çshtjet civile para një gjykate. Kjo e drejtë e qasjes, megjithatë, nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve pasi që e drejta nga natyra e saj kërkon rregullim nga shteti. Megjithatë kufizimet e aplikuara nuk duhet të kufizojnë ose reduktojnë qasjen individit në një mënyrë të tillë ose deri në një masë të tillë sa të cënohet vetë thelbi i së drejtës. Për sa i përket rasti konkret Gjykata pohoi që nuk është në fushëveprim të vet të vlerësojë meritat e sistemit grek për pagesat e tarifave të inxhinierëve si të tillë, prandaj ajo do të kufizohet, sa të jetë e mundur, në shqyrtimin e çështjeve të ngritura nga rasti specifik. Për ta bërë këtë, megjithatë, ajo duhet të shqyrtojë dispozitat në fjalë në shkallën që të kuptojë se cila ishte pengesa për të drejtën në qasje në gjykatë. Lidhur me këtë Qeveria pretendoi se, pavarësisht nga efekti i sistemi i përshkruar më lart, ankuesi mund të kishte siguruar të drejtat e tij në person nëpërmjet mjeteve të shumta në dispozicion të tij në procedura civile greke. Ai mund të kishte ndërrhyrë "në mënyrë autonome" në procedurën e inicuar nga T.E.E., një mundësi që ofrohej nga legjislacioni përkatës. Për më shumë ai mund të kishte paraqitur një kundërshtim të palës së tretë ndaj aktgjykimit; ai mund të kishte sjellë një veprim për dëmet kundër T.E.E., e cila i kishte shkaktuar dëm atij, dhe për fund më në fund, ai mund të kishte sjellë një veprimi zëvendësues sipas Nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile.

Por ky arsytim i Qeverise nuk e bindi Gjykatën pasi që ishte e qartë se ankuesi nuk ishte në gjendje të iniciojë procedurat, drejtpërdrejt dhe në mënyrë të pavarur, për të kërkuar pagesën të tarifave që i ishin borxh dhe me këtë vetë thelbi i "së drejtës së tij në një gjykatë" ishte i dëmtuar, dhe kjo nuk duhet të korrigjohet nga ndonjë mjet juridik që është në dispozicion sipas ligjit grek. Prandaj, Gjykata konstatoi se në këtë pikë ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1.

Ankuesi pohoi më tej se nuk kishte asnjë mjet ligjor efektiv në dispozicion të tij para një "autoriteti" kombëtar për t'u ankuar për shkeljen e e drejta e tij për qasje në gjykatë. Duke pasur parasysh vendimin e vet në lidhje me Nenin 6 Gjykata, është e mendimit se nuk ka nevojë të shqyrtojë rastin sipas Nenit 13 pasi kërkesat e tij janë më pak strikte, dhe në rastin në fjalë janë absorbuar nga kërkesat e ngritura bazuar në Nenin 6.³⁴

Bazuar në nenin 14 të Konventës, ankuesi pretendon të jetë viktimë e një diskriminimi të dyfishtë bazuar në radhë të parë në dispozitat e Ligjit nr. 1346/1983 të cilat kishin efekt retroaktiv në mënyrë specifike ndaj tij. Si dëshmi për këtë ai përmendi referencën e shprehur për emrin e tij në procesverbalin e debateve parlamentare para votimit të këtij

³³ *Golder*, vendim i datës 21 Janar 1975, *Ashingdane*, vendim i 28 majit 1985 (Seria A nr. 18, f. 18, par. 36, dhe nr. 93, f. 24-25, par. 57

³⁴ *Håkansson dhe Sturesson* i 21 shkurtit 1990, Seria A nr. 171-A, f. 21, para. 69

akti. Së dyti, profesioni i inxhinierit ishte profesioni i vetëm që nuk gëzon përfitimin e qasjes së drejtpërdrejtë në gjykatat për të mbrojtur të drejtat e tyre civile. Në vendimin e 7 dhjetorit 1988 mbi pranueshmërinë e ankësës, Komisioni kishte hedhur poshtë ankesën e parë për shkak se ajo kishte të bënte me një periudhë para datës 20 nëntor 1985, datë kjo kur pranimi i të drejtës së peticionit individual hyri në fuqi. Prandaj, Gjykata nuk mund ta trajtoj këtë kërkesë. Sa i përket ankesës së dytë, Gjykata tashmë ka vërejtur se kufizimi i të drejtës së ankuesit për qasje në një gjykatë ka shkelur Nenin 6 të Konventës. Duke qenë kështu, Gjykata konsideron se nuk ka ndonjë përfitim nëse trajtohet çështja nëse ai përveç kësaj ka pësuar diskriminim në krahasim me persona të tjerë të cilët janë subjekt i kufizimeve më të vogla në të njëjtën të drejtë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Neni 6 § 1, për sa i përket qasjes në gjykatë, ndërsa shpall të panevojshme për shqyrtim pjesën tjetër të pretendimit nën këtë nen; Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet rasti qoftë sipas Nenit 13 ose Nenit 14 në lidhje me Nenin 6 [*me tetë vota pro dhe një kundër / njëzëri / njëzëri*].

Agrokompleks kundër Ukrainës - 23465/03

6 tetor 2011 [Seksioni i pestë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6 §1

Shkelje e të drejtës për qasje në gjykatë si pasojë e mungesës së paanshmërisë së gjykatave dhe tejzgjatjes së procedurave/ *ka shkelje*

Nenin 1 i Protokollit nr. 1.

Shkelje e të drejtës në pronë si pasojë e fitimit të humbur dhe mungesës së kompensimit /*ka shkelje*

Fjalët kyçe: *naftë / obligim kontraktual / ndërmarrje publike / shkelje e kontratës / kompensim / ndërhyrje e ekzekutivit / paanshmëri / qasje në gjykata*

Ankuesi: Kompania Agrokompleks JSC (“*kompania ankuese*”)

Faktet e rastit

Ankuesi është një kompani private e regjistruar në Ukrainë. Në kohën e ngjarjeve ajo kreu veprimtari tregtare me kompanitë ruse, duke përfshirë, në veçanti, këmbimin e disa lëndëve ushqimore të para nga Ukraina për naftën e papërpunuar ruse dhe shitjen e mëtejshme të produkteve të naftës.

Në fillim të viteve 1990, ankuesi furnizoi me 375,000 ton naftë bruto rafinerinë e naftës (me shumicë shtetërore) më të madhe në Ukrainë, e cila u riemërua më vonë Lysychansk Nafto Org Syntez (“LyNOS”), për rafinimin. Në vitin 1993, rafineria dorëzoi vetëm një pjesë të vogël të produkteve të naftës për ankuesin. Në mars 1993 dhe nëntor 1994, Gjykata e Lartë e Arbitrazhit (“HAC”), pas kërkesave të paraqitura nga ankuesi, konfirmoi detyrimet kontraktuale të rafinerisë dhe e urdhëroi atë të dorëzonte produktet e dakorduara të naftës. Në 1995, Departamenti i Shtetit për Rafinimin e naftës, gazit dhe industritë naftës, ka gjetur që pretendimet e ankuesit janë të bazuara mirë dhe i ka shënuar një letër Parlamentit, se arsyeya kryesore për dështimin e rafinerisë për të përmbushur detyrimet e veta kishte qenë dispozita për produktet e lira të naftës nga autoritetet rajonale në disa nga industritë vendase në vitin 1993, pas një mungese akute të karburantit. Në korrik të vitit 1996, HAC kompensoi ankuesin për moszbatimin e gjatë të gjykimeve në favor të saj.

Në të njëjtin muaj, ankuesi ngriti procedurë të falimentit ndaj LyNOS, duke iu referuar moszbatimit të aktgjykimeve në favor të vet. Në një vendim të datës 2 korrik 1998, HAC gjykoi borxhin e LyNOS ndaj ankuesit në vlerën prej 216,150,544 ukrainas hryvnias (UAH). Pasi që asnjëra nga palët nuk e kundërshtuan vendimin para panelit shqyrtues nën dispozitat përkatëse, ky vendim u bë e plotfuqishëm.

Megjithatë, më vonë në korrik 1998, Qeveria krijoi një grup punues me përfaqësues të autoriteteve të ndryshme të nivelit të lartë, për të përcaktuar arsyet për borxhet e LyNOS ndaj kreditorëve të vet dhe për të studiuar pasojat e zgjidhjes së kërkesave të tyre. Në raportin e gushtit 1998, grupi punues deklaroi nevojën për të verifikuar

shumën e borxheve. Zëvendëskryeministri kështu udhëzoi ministritë e caktuara dhe agjencitë shtetërore që të ndërmarrin auditim për këtë qëllim. Në raportin e prillit të vitit 2000, Departamenti i Auditimit Rajonal të Luganskut arriti në përfundimin se gjetjet e HAC në vendimin e 2 korrikut 1998 në lidhje me borxhin e papaguar ishte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, dhe se në fakt borxhi i LyNOS ishte i barabartë me UAH 36,401,894.

LyNOS është mbështetur në atë përfundim si një rrethanë e zbuluar rishtazi dhe aplikoi në panelin shqyrtues të HAC për shqyrtimin, në veçanti, të vendimit të 2 korrikut 1998. Ndërsa në shtator të vitit 2000, HAC konstatoi se raporti i Departamentit të Auditimit Rajonal nuk përmbante informacione të reja dhe mbështeti vendimin që përcakton shumën përfundimtare të borxhit. Më pas, drejtori i gjykatës i udhëzoi zëvendësit e tij për të shqyrtuar këtë gjetje. Në qershor të vitit 2001, HAC e reduktoi borxhin në 97,406,920 UAH dhe, pas ankesës nga ankuesi, Gjykata Ekonomike e Apelit të Donetskut, në tetor të vitit 2001, reduktoi më tej totalin e borxheve të papaguara në UAH 90,983,077.

Ankesat e kompanisë ankuese kundër këtij vendimi dhe kundër një zgjidhje miqësore midis LyNOS dhe kreditorëve të saj, sipas të cilave pretendimet e kreditorëve do të zgjidheshin duke i shkëmbyer ato për pasurinë e debitorit, nuk ishin të suksesshme. Në një vendim përfundimtar në nëntor të vitit 2004, Gjykata Supreme hodhi poshtë kërkesën e ankuesit për lejimin e apelimit në kasacion.

Në një numër rastesh gjatë procedurës, LyNOS u ankua tek disa autoritete shtetërore lidhur me vendimet e gjykatave dhe aktorët e ndryshëm të shtetit intervenuan në procedurat për emrin e LyNOS. Në veçanti, në shtator të vitit 1998, Zëvendëskryeministri i parë i kërkoi kryetarit të HAC të merrte në konsideratë gjetjet e grupit punues për nevojën e rivlerësimit të borxhit të LyNOS, "duke pasur parasysh rëndësinë e tij për ekonominë dhe sigurinë e shtetit." Në dhjetor 2000, Presidenti i Ukrainës dërgoi një letër nga LyNOS tek presidenti i HAC, në të cilën LyNOS shprehu keqardhje "pretendimet e ekzagjeruara" të ankuesit në procedurat e falimentimit. Presidenti i HAC iu përgjigj disa prej atyre kërkesave me raporte për statusin e procedurës dhe me shpjegimet e masave të marra.

Përmbledhje e pretendimeve

Kompania aplikuese ankohet duke u bazuar në Nenin 6 § 1 të Konventës, se procedurat gjyqësore për rikuperimin e borxhit, të iniciuara nga vetë ajo kundër kompanisë LyNOS ishin të padrejta. Ankuesi pohon, në veçanti, se gjykatat që u morrën me çështjen ishin nën një presion të fortë nga autoritetet ekzekutive dhe kështu nuk mund të konsideroheshin të paanshme dhe të pavarura. Kompania më tej ankohet se gjykatat kanë prishur vendimet e tyre të plogfuqishme në shkelje të parimit të sigurisë juridike. Kompania aplikuese gjithashtu i referohet disa parregullsive të pretenduara në dosjen e çështjes lidhur me procedurat e falimentimit dhe shkatërrimit të dosjeve të lëndës gjatë procedurave gjyqësore në mes të viteve 1993 dhe 1994.

Kompania aplikuese më tej ankohet, duke u mbështetur në Nenet 6 § 1 dhe 13 të Konventës dhe Nenin 2 të Protokollit nr. 7, se i është mohuar qasja në gjykatë me faktin se më 26 dhjetor 2002, Gjykata Supreme e refuzoi ankesën në kasacion, si panel i pesë gjyqtarëve. Kompania i referohet kërkesës së legjislacionit procedural të

zbatueshëm që të ketë pëlqimin e të paktën pesë gjyqtarëve për fillimin e procedurave dhe dështimin e tij për të specifikuar numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve në panel.

Kompania aplikuese, duke u mbështetur në Nenit 6 § 1 dhe 13 të Konventës, ankohet që kompania LyNOS nuk zbatoi aktgjykimet e Gjykatës së Lartë të Arbitrazhit të 5 marsit 1993 dhe 19 nëntorit 1994. Po ashtu, ankohet sipas Nenit 6 § 1 të Konventës, se kohëzgjatja e procedurës nuk ishte në përputhje me kërkesat e "kohës së arsyeshme".

Kompania ankuese gjithashtu ankohet sipas Nenit 1 të Protokollit nr. 1 që Kompania LyNOS, si dhe autoritetet e ndryshme vendore dhe jo gjyqësore, kanë ndërhyer në të drejtën për gëzim paqësor të pronës. Në veçanti, kompania pohon se nuk i ka kthyer 375,000 ton naftë me të cilën ka furnizuar paraardhësin ligjor të kompanisë LyNOS për rafinimin e naftës në vitet 1992 dhe 1993, dhe as nuk ka marrë kompensim adekuat për të.

Në anën tjetër, qeveria ukrainase pretendon se kërkesa ishte jo-kompatibile *ratione temporis* për sa i përket ngjarjeve në fjalë, për shkak se kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Konventës në Ukrainë, gjegjësisht para 11 shtatorit 1997. Po ashtu, qeveria ka sfiduar aplikimin e Nenit 6 § 1, në kuptimin që në atë kohë, procedurat e falimentimit, janë ngritur nga kompania aplikuese kundër LyNOS, sa ishin ende në zhvillim e sipër dhe se të drejtat dhe detyrimet civile të kompanisë ende nuk ishin përcaktuar. Qeveria gjithashtu parashtroi se kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit gjashtëmuor, për shkak se periudha gjashtë mujore për qëllimet e Nenit 35 § 1 të Konventës kishte filluar me 26 dhjetor 2000 - data kur Paneli Shqyrtues i HAC-it kishte anuluar vendimin e HAC-it më herët për refuzimin e aplikacionit LyNOS për rishikimin e vendimit të 2 korrik 1998 duke përcaktuar shumën e borxhit të saj për kompaninë kërkuese në bazë të rrethanave të zbuluara dhe kishte dorëzuar kërkesën për ekzaminim të ri.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me pranueshmërinë e rastit, për sa i përket juridiksionit *ratione temporis*, Gjykata ritheksoi se është kompetente për të shqyrtuar faktet e një kërkesë lidhur me Ukrainën vetëm për aq sa ato kanë ndodhur pas datës 11 shtator 1997, data e hyrjes në fuqi e Konventës për Ukrainën. Rasti aktual ka të bëjë me faktet që ndodhin para dhe pas kësaj date, por Gjykata konsideron se ankesat e kompanisë ankuese janë brenda juridiksionit kohor të saj vetëm pas periudhës së lartcekur. Megjithatë, Gjykata mund dhe do të ketë parasysh ngjarjet para ratifikimit, për aq sa mund të konsiderohet se kanë krijuar një situatë që shtrihet përtej kësaj date ose mund të jetë e rëndësishme për të kuptuar faktet që ndodhin pas kësaj date.

Lidhur me aplikimin e Nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata konsideron se kjo ankesë ngre pyetje të fakteve dhe të ligjit të cilat janë mjaft komplekse që nuk mund të zgjidhen në fazën e pranueshmërisë së rastit andaj këtë argumentim ia bashkëngjet meritave të rastit.

Sa i përket afatit gjashtëmuor, Gjykata tha se për shkak të rrethanave specifike të rastit aktual, kompania aplikuese nuk mund të qortohet për llogaritjen e afatit gjashtëmuor për ankimin në gjykatë për shuarjen e paligjshme të vendimit përfundimtar të HAC të datës 2 korrik 1998, nga data e vendimit të Gjykatës Supreme për rastin e 26 dhjetorit 2002. Meqenëse kërkesa është paraqitur në Gjykatën e Strasburgut brenda gjashtë

muajve, më 23 qershor 2003, Gjykata gjithashtu e hedh poshtë kundërshtimin e Qeverisë dhe shpall rastin si të pranueshëm.

Për sa i përket meritave të rastit, përkatësisht lidhur me pretendimet për shkeljen e Nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata vërejtë se, siç u konfirmua me prova dokumentare, autoritetet e ndryshme ukrainase kishin ndërhyrë në procedurat gjyqësore në një numër rastesh. Këto ndërhyrje kishin ndodhur në mënyrë të hapur dhe të vazhdueshme dhe shpesh ishin kërkuar shprehimisht nga kundërshtari i Agrokompleksit LyNOS. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata tashmë kishte dënuar përpjekjet e autoriteteve jo gjyqësore për të ndërhyrë në procedurat gjyqësore, duke i konsideruar ato të papajtueshme me nocionin e një "gjykate të pavarur dhe të paanshme" brenda kuptimit të Nenit 6 § 1.

Duke pasur parasysh faktin se procedurat kishin të bënin me falimentimin e asaj që ishte, në atë kohë, rafineria më e madhe e naftës në vend dhe në të cilën shteti ishte aksionari kryesor, ishte e natyrshme që procedurat kishin tërhequr vëmendjen e ngushtë të autoriteteve shtetërore. Megjithatë, ishte e papranueshme që autoritetet nuk u kufizuan në monitorimin pasiv të proceseve gjyqësore, por se ata kishin ndërhyrë në mënyrë të hapur. Gjykata theksoi se fushëveprimi i detyrimit të shtetit për të siguruar një gjykim nga një "tribunal i pavarur dhe i paanshëm" nuk ishte i kufizuar në gjyqësor, por gjithashtu nënkuptonte detyrime ndaj ndonjë autoriteti tjetër shtetëror për të respektuar dhe zbatuar vendimet dhe vendimet e gjykatave.

Pavarësia gjyqësore kërkon më tutje që gjyqtarët individualë të jenë të lirë nga ndikimi i panevojshëm, duke përfshirë edhe ato brenda gjyqësorit. Fakti që kryetari i HAC-ut kishte dhënë udhëzime të drejtpërdrejta deputetëve të tij për të rishikuar vendimin e gjykatës me të cilin kishte refuzuar kërkesën e LyNOS për rishikimin e shumës së borxhit të saj ishte në kundërshtim me parimin e pavarësisë së brendshme gjyqësore. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1 lidhur me mungesën e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatave.

Gjykata më tej përsëriti se siguria ligjore, e cila është një nga aspektet më themelore të sundimit të ligjit, kërkon që kur gjykatat më në fund të vendosin një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje. Në rastin e Agrokompleks, vendimi i korrikut 1998 kishte qenë një përcaktim gjyqësor përfundimtar i shumës së borxheve të papaguara që i detyrohej LyNOS. Megjithatë, faktet e rastit treguan se autoritetet shtetërore jo gjyqësore kishin vënë në dyshim këtë vendim, e kishin rishikuar atë siç e kishin parë të arsyeshme dhe kishin kritikuar gjetjet e saj si të paligjshme. Për më tepër, rishikimi jo gjyqësor i borxhit më pas ishte referuar si një rrethanë e sapo zbuluar, në bazë të të cilave gjykatat rishikuan, në dëm të Agrokompleks, shumën e borxheve që ajo i detyrohej nga LyNOS.

Rihapja e çështjes ligjore përfundimtare të shumës së borxheve ishte bazuar thjesht në mosmarrëveshjet e autoriteteve shtetërore me të, gjë që përbënte një shkelje flagrante të parimit të sigurisë juridike. Kështu, kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1 në këtë drejtim. Sa i përket kohëzgjatjes së procedurës, Gjykata ka vërejtur se periudha që duhet marrë në konsideratë në vendimin e saj, pra nga hyrja në fuqi e Konventës në lidhje me Ukrainën (shtator 1997) deri tek vendimi përfundimtar i Gjykatës Supreme për të mbështetur zgjidhjen miqësore lidhur me borxhet e LyNOS, zgjati për mbi shtatë vjet. Përderisa çështja ishte faktikisht dhe ligjrisht komplekse, vonesa më e madhe ka

ndodhur nga përpjekjet e autoriteteve për të rishikuar shumën e borxhit, pavarësisht vendimit gjyqësor përfundimtar në lidhje me këtë. Nga ana tjetër, asnjë vonesë në procedurë nuk i atribuohet ankuesit. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur gjithashtu një shkelje të Nenit 6 § 1 lidhur me kohëzgjatjen e procedurës.

Lidhur me shkeljen e Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, duke qenë se borxhet e LyNOS-it ndaj Agrokompleks ishin konfirmuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, këto borxhe kishin përbërë pasurinë e Agrokompleksit në kuptim të Nenit 1 të Protokollit nr. 1. Reduktimi i tij i mëpasshëm, si rezultat i rihapjes së rastit, një ndërhyrje në të drejtën e saj për gëzimin paqësor të atyre pasurive. Sikurse Gjykata gjeti sipas Nenit 6 § 1, shfuqizimi i vendimit të HAC në korrik 1998 ishte në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike. Ajo kishte frustruar mbështetjen e ankuesit në një vendim gjyqësor të detyrueshëm dhe e kishte privuar atë nga një mundësi për të marrë paratë që kishte pritur me ligj që të merrte. Prandaj, rishikimi i shumës së borxhit kishte vendosur një barrë të tepruar në kompaninë ankuese dhe ishte e papërputhshme me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Duke marrë parasysh gjetjet e Gjykatës se gjykatat vendase në rastin e kompanisë ankuese kishin mungesë të pavarësisë dhe paanësisë, ajo vlerësoi se nuk kishte pasur baraspeshë të drejtë midis kërkesave të interesit publik dhe nevojës për të mbrojtur të drejtën e kompanisë për gëzimin paqësor të pronës së tij. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr. 1.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës; gjithashtu gjen shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës [*njëzëri*].

Masson dhe Van Zon kundër Holandës - 15346/89; 15379/89

28 shtator 1995 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6 § 1

Pretendim për shkelje të së drejtës në gjykatë si pasojë e mos kompensimit për gjykimin lirues / *neni nuk është i aplikueshëm / nuk ka shkelje*

Neni 13

Mungesë e mjeteve efektive për adresimin e shkeljes së pretenduar / *e panevojshme për shqyrtim*

Fjalët kyçe: *ndjekje penale / gjykim dënues / burgim / anulim i aktgjykimit / lirim / kompensim / mjete efektive*

Ankuesit: z. Adrianus Johannes Marie Masson (*ankuesi i parë*) dhe z. Jacobus van Zon (*ankuesi i dytë*), shtetas holandez, parashtruan dy ankesa të ndara

Faktet e rastit

Ankuesi i parë ishte menaxher investimesh në fondin e pensioneve të shërbimit civil ABP, derisa ankuesi i dytë ishte biznesmen në fushën e zhvillimit të paluajtshmërive. Në vitin 1983, ishin ngritur dyshime se që të dy kishin bashkëpunuar për t'u pasuruar në mënyrë të jashtëligjshme në dëm të fondit pensional ABP.

Të dy ankuesit ishin shpallur fajtorë nga Gjykata Rajonale e Maastrichtit për vepra që lidheshin me korrupsion dhe falsifikim dhe ishin dënuar me nga një (1) vit burgim. Ankuesi i parë ishte mbajtur në burgim me kusht nga maji i vitit 1984 deri në shkurt të vitit 1985, ndërsa ankuesi i dytë nga maji 1984 deri në janar 1985. Në qershor të vitit 1988, Gjykata e Apelit kishte vendosur se disa prej akuzave kundër ankuesit të parë ishin të papranueshme dhe përfundimisht e kishte liruar atë. Ankuesi i dytë ishte shpallur i pafajshëm në të gjitha pikat.

Të dy ankuesit kishin kërkuar kompensim në bazë të Kodit të Procedurës Penale për dëme materiale dhe jo-materiale të shkaktuara nga burgimi i tyre me kusht, si dhe pagesën e të gjitha shpenzimeve ligjore dhe të tjera. Më 9 dhjetor 1988, Gjykata e Apelit kishte refuzuar kërkesat për kompensim. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës së Apelit, u kishte lejuar ankuesve vetëm një pjesë të shpenzimeve që ata i kishin deklaruar dhe kërkuar.

Rasti i ishte referuar Gjykatës nga ana e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, që ekzistonte në atë kohë, më 9 shtator 1994.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit kanë argumentuar para Gjykatës se ndërmjet tyre dhe shtetit holandez ka ekzistuar një “mosmarrëveshje” mbi një “të drejtë” të njohur sipas ligjit holandez. E drejta që ata kanë pretenduar—që, sipas pikëpamjes së tyre, ka rrjedhë nga prezumimi i pafajësisë i mishëruar në Nenin 6 § 2 —ishte e drejta e një ish të dyshuari për t'u

kompensuar për shpenzimet e tij ose të saj të domosdoshme ligjore dhe për të marrë dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar në proces të pricidimeve penale që kanë përfunduar me pafajësinë e plotë.

Në këtë drejtim, ata kishin bërë përpjekje për të dalluar rastin e tyre nga rastet e mëhershme të *Lutz kundër Gjermanisë*, *Englert kundër Gjermanisë* dhe *Nölkenbockhoff kundër Gjermanisë*,³⁵ të cilat nuk kishin përfunduar në pafajësinë e tyre të plotë, por ishin ndërprerë për arsye të tjera.

Qeveria, nga ana e saj, ka kontestuar zbatimin e Nenit 6 të Konventës. Sipas Qeverisë, së pari, nuk ka “mosmarrëveshje”. Shteti nuk ka marrë ndonjë qëndrim rreth asaj nëse ankuesit duhet të kompensohen. Gjithashtu, shteti nuk ka qenë palë e atyre procedurave. Prokuroria është dëgjuar, jo si palë, por si një këshilltar i gjykatës. Së dyti, sipas argumentit të Qeverisë, ekziston një dallim i qartë ndërmjet pretendimit për kompensim për përgjegjësi në shkaktim të dëmit prej kërkesës për kompensim mbi baza të drejtshmërisë. Vetëm kur kufizimet e lirisë vijnë si rezultat i një shkeljeje ligjore rrjedhë detyrimi për kompensim. Në rastin konkret, dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale parashihnin mundësinë e kompensimit diskrecional që mund të jepej mbi baza të drejtshmërisë. Për atë që nuk kishte asnjë detyrim për kompensim në rastin konkret, sipas Qeverisë, ishte e qartë nga fjalëformimi i dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, ku thuhej se gjykata “mund të” akordonte kompensim dhe këtë mund ta bënte vetëm “nëse ishte e mendimit se kishte arsye në drejtshmeri...”

Arsyetimi i Gjykatës

Së pari, Gjykata ka theksuar se kompetenca në lidhje me rastin tashmë ishte përcaktuar në vendimin e Komisionit në lidhje me pranueshmërinë. Si rezultat, Gjykata nuk ka kompetencë të shqyrtojë pretendimet e ngritura në lidhje me Nenin 6 § 2, të cilën dispozitë Komisioni e kishte shpallur të papranueshme në këtë rast.

Sa i përket Nenit 6 § 1, në mënyrë që aspekti “civil” i saj të aplikohet, Gjykata vëren se duhet të ekzistojë një mosmarrëveshje në lidhje me një të drejtë, e cila e pakta në bazë të argumentueshme mund të thuhet se është e njohur në të drejtën vendore. Mosmarrëveshja duhet të jetë reale dhe serioze; ajo mund të jetë e lidhur jo vetëm me ekzistimin e një të drejte, por edhe në lidhje me përmbajtjen ose përmasat e asaj të drejtë dhe me mënyrën e ushtrimit të asaj. Rezultati i procedurave duhet të jetë drejtpërdrejt vendimtar për të drejtën në fjalë; lidhjet e parëndësishme ose pasojat periferike nuk janë të mjaftueshme për të vënë Nenin 6 § 1 në zbatim.

Në dritë të statusit të Konventës në rendin ligjor të Holandës, Gjykata vë në pah se Konventa nuk i ka njohur një personi të akuzuar për vepër penale, por më vonë të shpallur të pafajshëm, një të drejtë qoftë për kompensim të kostove të procedurave gjyqësore, pavarësisht sa të nevojshme këto kosto të kenë qenë, ose një të drejtë për dëmshpërblim për kufizime të ligjshme të lirisë. Një e drejtë e tillë nuk mund të nxirret qoftë nga Neni 6 § 2 i Konventës apo ndonjë dispozitë tjetër e Konventës ose Protokollove të saj shtesë.

³⁵ Aktgjykime të 25 gushtit 1987, Seria A nr. 123-A, 123-B dhe 123-C

Nga ky diskutim dhe analizë rrjedhë se çështja nëse një e drejtë e tillë mund të thuhet se ekziston apo jo duhet të vlerësohet ekskluzivisht mbi bazën e të drejtës së brendshme. Marrë parasysh këtë, Gjykatës i është dashur të shqyrtojë fjalëformimin e dispozitave përkatëse ligjore dhe mënyrën në të cilën këto dispozita janë interpretuar nga gjykatat vendore të shtetit holandez. Dhe nëse procedurat e kundërshtuara përfshinin ose jo një mosmarrëveshje për qëllime të Nenit 6 § 1, pretendimet e ngritura nga ankuesit nuk përbënin në ndonjë mënyrë një “të drejtë” që mund të thuhet se njihet nga e drejta holandeze. Duke qenë kështu, Gjykata vie në përfundim se Neni 6 § 1 nuk ka qenë i zbatueshëm ndaj procedurave të kundërshtuara prej ankuesve dhe për pasojë nuk ka pas shkelje të kësaj dispozite ndaj cilitdo prej dy ankuesve.

Ndërkaq sa i përket pretendimit për shkelje të Nenit 13, ankuesi kishte deklaruar përpara Komisionit për të Drejtat e Njeriut se ai nuk kishte mjete (zgjdhje) efikase në të drejtën e brendshme kundër vendimeve të ankimuar. Megjithatë, pretendimi për shkelje të Nenit 13 nuk ishte referuar fare përpara Gjykatës, e cila nuk ka parë arsye, qoftë në ligj ose në fakte, që ta adresojë këtë çështje me nismën e saj.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se Neni 6 § 1 nuk është i aplikueshëm (*gjashhtë vota me një*) dhe se nuk ka shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në raport me asnjërin prej ankuesve [*njëzëri*], ndërsa pretendimi në bazë të nenit 13 është i panevojshëm për shqyrtim.

Neni 7

Nuk ka dënim pa ligj

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.
2. Ky Nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.

Dallas kundër Mbretërisë së Bashkuar - 38395/12

11 shkurt 2016 [Seksioni i Parë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6 §§ 1 dhe 3 (a)

Dështim në informimin e qartë për pasojat ligjore të veprimit të mospërfilljes së gjykatës / nuk ngritet çështje ndaras

Neni 7

Kerkuesi pretendon se ishte shpallur fajtor për vepër penale për shkak të një veprimi që nuk përbënte vepër penale në kohën kur ishte kryer dhe për mos saktësim të veprës / nuk ka shkelje.

Fjalët kyçe: juri porote / detyrim / administrim i drejtësisë / udhëzime / [mos]hulumtim / internet / paragjykim / mospërfillje / saktësim i sanksionit

Ankuesja: znj. Theodora Dallas, shtetase greke

Faktet e rastit

Në Korrik 2011, ankuesja u ftua të merrte pjesë në shërbimin e jurisë porote në Gjykatën e Kurorës. Para fillimit të gjykimit anëtarëve të jurisë i'u shfaqë një video në lidhje me shërbimin e tyre dhe iu dhanë udhëzime verbale nga oficeri i jurisë së gjykatës. Sipas ushzimeve jurisë nuk u lejohej të hulumtonin rastet që do gjykonin në internet ose të hulumtonin të pandehurit ose ndonjë individ të përfshirë në gjykim dhe se se veprimi i kundërt me kërkesat e gjykatës do të dënohej me gjobë ose me burgim.

Ankuesja u zgjodh për të shërbyer në një juri në gjykimin e një të pandehuri të akuzuar për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore me qëllim. Ankuesja së bashku me anëtarët tjerë bëri betimin ose pohimin se ajo do të vepronte me besnikëri në lidhje me të pandehurin dhe do të jepte një vendim të vërtetë sipas provave që do i degjonte gjate gjykimit. Gjykimi u mbajt më 5 dhe 6 korrik 2011.

Më 5 korrik gjyqtari i gjyqit lejoi një kërkesë për ndjekje penale për të paraqitur dëshmi për karakterin e lig të të pandehurit. Si pasoj gjatë dëshmive u dhanë edhe detaje për një dënim të mëparshëm, por nuk u zbulua se i pandehuri ishte akuzuar gjithashtu për përdhunim në lidhje me të njëjtën vepër, por ishte liruar.

Më 6 korrik 2011 juria u tërhoq për të shqyrtuar vendimin e tyre, për tu arritur vendim deri më 11 korrik. Pas rifillimit të seancës, një prej anëtarëve të jurisë në këtë rast e njoftoi gjykatën që një anëtarë i jurisë, duke iu referuar ankueses kishte hulumtuar në internet dhe kishte zbuluar dënimin e mëparshëm që, i cili kishte përfshirë edhe përdhunimin. Më 8 korrik 2011, pas dëgjimit nga anëtari i jurisë në gjykatë, gjykatësi thirri kryetarin e jurisë, i cili konfirmoi se kishte pasur një referencë në çështjen për të cilën juristi kishte referuar. Gjykatësi më pas e foti ankuesen në gjykatë. Ai e informoi atë rrjedhën e bisedave, dhe se ajo nuk do të duhet të thotë asgjë në atë fazë. Gjykatësi i ofroi mundësinë ankueses për të folur me një avokat për të marrë këshilla për çështjen e shpërfilljes së gjykatës, si pasoj ajo pranoi.

Pas diskutimit me ankuesen, avokati njoftoi gjykatën mbi pozitën e ankueses, duke shpjeguar se sjellja e saj në lidhje me hulumtimin online nuk ishte e qëllimshme. Prandaj ajo pohoi se do të përdorte këtë argument në mbrojtje ndaj pretendimit për shpërfillje të gjykatës. Gjykatësi i shpjegoi asaj se çështja do t'i referohej Prokurorit të Përgjithshëm dhe se do të bëhej një hetim policor. Gjykatësi më pas e shkarkoi jurinë dhe gjykimi u ndërpre. Policia mori deklaratat nga njëmbëdhjetë anëtarët e tjerë të jurisë në gjykim. Deklaratat treguan se gjatë diskutimeve të jurisë, ankuesja deklaroi se kishte kryer kërkime në Internet dhe se hulumtimi i saj kishte treguar se dënimi i mëparshëm përfshinte gjithashtu një pohim për përdhunim. Shumica e anëtarëve të jurisë kishin reaguar ndaj kësaj duke bërë të qartë se ankuesja kishte futur fakte të paarsyeshme dhe të palejueshme në diskutimin e tyre, në kundërshtim me udhëzimet që u ishin dhënë.

Në kuadër të procedurave gjyqësore vendore që u zhvilluan, më 2 dhjetor 2011, Prokurori i Përgjithshëm bëri një kërkesë pranë Gjykatës së Divizionit për iniciimin e procedurave ndaj ankuesës për veprën "shpërfillje e gjykatës për shkak të kryerjes së hulumtimit në internet në rastin që ajo ishte duke vepruar si anëtare e jurisë në Gjykatën e Kurorës dhe më pas në zbulimin informacioneve që ajo kishte marrë tek anëtarët e tjerë të jurisë. Në lidhje me këtë ankuesja tha se nuk i kujtohes se gjyqtari kishte udhëzuar anëtarët e jurisë që të mos bënin hulumtime në Internet. Ajo shpjegoi se kishte parë një artikull në gazete lidhur me të pandehurin në internet në mbrëmjen e 5 korrikut 2011. Kur u pyet se çfarë po bënte në internet, ajo u përgjigj se duke qenë se ajo ishte greke, ajo kishte dashur të dinte përkthimin e saktë të akuzës me të cilën përballej i pandehuri. Prandaj kishte kërkuar për "dëm të rëndë trupor". Më pas, ajo dëshironte të shihte sa të shpeshta ishin incidentet e tilla ishin në Luton, kështu që shtoi "Luton" në termat e kërkimit. Artikulli në lidhje me dënimin e mëparshëm të të pandehurit ishte shfaqur në listën e rezultateve. Ajo pranoi se kishte informuar anëtarët e tjerë të jurisë për informacionin që ajo kishte gjetur. Ajo tha se ajo nuk ishte në dijeni se ajo kishte humbur ndonjë element të udhëzimeve të gjyqtarit dhe se ajo kishte pasur "absolutisht asnjë qëllim" të shkonte kundër udhëzimeve apo udhëzimeve të gjykatës.

Konkludimet e Gjykatës Vendore në lidhje me pretendimet e ankueses ishin se nuk ka asnjë dyshim se i ankuesja e dinte mirë, se ndalohej përdorimi i internetit pasi që ajo sikur dhe anëtarët e tjerë të jurisë, në terma të qarta, ishin të njoftuar se ata nuk duhet të kërkojnë informacion në lidhje me rastin nga interneti; së dyti, se ankuesja vlerësoi se kjo ishte një urdhër; dhe, së treti, se ankuesja qëllimisht nuk iu bind urdhrit. Duke vepruar kështu, para se ajo të bënte ndonjë zbulim për anëtarët e tjerë, ajo nuk rrezikoi vetëm paragjykimet për administrimin e duhur të drejtësisë, por ajo e paracaktoi gjykimin ndaj saj. Si rezultat, juria u shkarkua me të drejtë dhe u urdhërua një gjykim i ri. Dëmi i administrimit të drejtësisë është i qartë.

Gjykatësi më tutje konstatoi se përbuzja ishte vërtetuar në standardin penal. Në dënimin e saj, gjykata shpjegoi se keqpërdorimi i Internetit nga një anëtarë i jurisë ishte gjithmonë "një parregullsi shumë serioze" dhe se një dënim efektiv i kujdestarisë ishte pothuajse i pashmangshëm për të siguruar që integriteti i procesit gjyqësor nga juria të ishte i qëndrueshëm. U shqiptua dënim me burgim për gjashtë muaj. Gjykatësi vuri në dukje se në bazë të rregullave për lirimin e parakohshëm, ankuesja do të shërbente tre muaj burgim.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesja pretendoi shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) si pasojë e dështimit për të definuar qartë veprën për të cilën ajo akuzohej deri sa u dha gjykimi si dhe u ankua në dështimin për t'u informuar menjëherë për natyrën dhe shkakun e perjashtimit nga juria. Gjithashtu ankuesja u ankua bazuar në Nenin 7 se ajo ishte u shpall fajtores për një veprë penale për shkak të një akti që nuk përbënte veprë penale në kohën kur është kryer. Ankuesja theksoi se qasja dhe saktësia e mjaftueshme e ligjit penal ishte një parim kyç i Nenit 7. Edhe pse ky nen nuk e ka penguar sqarimin apo përshtatjen e ligjit ekzistues, megjithatë kërkohet që interpretimi i ligjit të jetë në përputhje me parimin e arsyeshmëri të sigurisë juridike. Ajo argumentoi se Urdhri 52 përjashtonte shprehimisht juridiksionin e Gjykatës së Divizionit në rastet kur shkelja është në procedurë penale. Ajo konsideroi se parashtrimet e Qeverisë adresojnë në mënyrë adekuate dallimin midis qëllimit specifik dhe qëllimit themelor, por më tepër "qëllim specifik" i fshehur me mosbindjen e qëllimshme të një gjykate por kjo e fundit nuk shpjegoi se si një ndryshim i tillë në ligj ishte në përputhje me nenin 7 të Konventës. Ankuesja më tej e konsideroi se gjykata shkeli të drejtën e saj pasi që sipas Nenit 7, urdhri duhej të ishte ligjshëm, dhe i qartë. Në veçanti, natyra e shkeljes duhet të ishte përcaktuar me saktësi. Sa i përket përdorimit të internetit, ka pasur nevojë për një përkufizim të qartë të asaj që është lejuar. Ajo më tej argumentoi se në një rast penal paralajmërimi ishte i domosdoshëm, sepse nuk ishte e qartë se cilat situata konsiderohet shkelje e që mund të rezultojnë në një ndëshkim penal. Ankuesja konkludoi se ndërhyrja në të drejtat e saj nuk ishte në përputhje me ligjin..

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykatë vëren fillimisht se pretendimet e ankueses për shkelje të Nenit 6 § 1(3) dhe Nenit 7 të Konventës si pasojë e procedurave ligjore të ngritura ndaj saj janë në esencë çështje të ngjashme andaj, konsideron të mjaftueshme të shqyrtohen vetëm pretendimet në raport me Nenin 7 të Konventës.

Sipas Gjykatës, Neni 7 duhet të interpretohet dhe zbatohet në atë mënyrë që të ofrojë mbrojtje efektive kundër ndjekjes, bindjes dhe dënimit arbitrar. Në mesin e garancive të saj, ajo përcakton parimin se ligji penal nuk duhet të interpretohet gjerësisht në dëm të një të akuzuarit. Gjykata rikujton se veprat penale duhet të përcaktohen qartë me ligj. Neni 7 përcakton kërkesat cilësore të ligjit, veçanërisht ato të qasjes dhe parashikueshmërisë. Këto kërkesa konsiderohet se janë plotësuar atëherë kur individit mund të dijë nga formulimi i dispozitës përkatëse - nëse është e nevojshme me ndihmën e interpretimit të gjykatave dhe pas marrjes këshillave të përshtatshme ligjore - cilat veprime dhe lëshime do ta bëjnë atë penalisht të dënueshëm.³⁶ Zhvillimi progresiv i së drejtës penale nëpërmjet legjislacionit gjyqësor është një pjesë e qëndrueshme dhe e domosdoshme e traditës ligjore në Mbretërinë e Bashkuar. Neni 7 i Konventës nuk mund të lexohet si akt i cili e bën të jashtëligjshme sqarimin gradual të rregullave të përgjegjësisë penale që është bërë përmes interpretimit gjyqësor nga rasti

³⁶ S.W. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 22 nëntor 1995, dhe C.R. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 22 nëntor 1995

në rast, me kusht që zhvillimi rezultues të jetë në përputhje me thelbin e veprës dhe mund të parashikohet në mënyrë të arsyeshme.

Është kryesisht detyrë e autoriteteve kombëtare, sidomos gjykatat vendore, që të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit vendas. Andaj nuk është detyrë e Gjykatës të zëvendësoj gjykatat vendore për sa i perket vlerësimin të fakteve dhe klasifikimin e tyre ligjor, me kusht që ato të jenë bazuar në një vlerësim të arsyeshëm të provave. Roli i Gjykatës është i kufizuara në konstatimin e asaj nëse nëse efektet e një interpretimi të tillë janë në përputhje me Konventën.³⁷

Qeveria pranoi që Neni 7 § 1 ishte i zbatueshëm në rastie e tanishëm pasi që përbuzja e gjykatës ishte veprë penale në natyrë dhe Gjykata e Divizionit arriti në përfundimin se ankuesja ishte fajtores për një veprë penale për qëllimet e atij neni. Duke e gjetur ankuesen fajtores për shpërfillje të gjykatës Gjykata e Divizionit kishte zbatuar ligjin në mënyrë të mirëfilltë. Ankuesja, duke u ankuar se Gjykata kishte formuluar një test të ri të përgjegjësisë, kishte keqkuptuar dhe keqinterpretuar gjykimin e gjykatës vendore. Në veçanti, sipas Qeverisë gjykata kishte aplikuar elementin mendor të mirëformuar të nevojshëm, domethënë një qëllim për të penguar ose paragjykuar administrimin e duhur të drejtësisë. Ajo thjesht e riformuloi ligjin me faktet specifike të rasti i ankueses.

Ankuesja kundërshtoi qasjen dhe parashikueshmërinë e ligjit. Testi i kërkuar sipas saj është që të jenë të pranishme dy elemente: Së pari, duhej të ishte një akt që krijoi një "rrezik të vërtetë" të paragjykimin ndaj administrimit të drejtësisë; dhe së dyti, duhej të kishte një qëllim për të krijuar atë. Është e vërtetë që, në përmbledhjen e testit të aplikuar ndaj verefikomit të qëllimit, Gjykata e Divizionit e harroi fjalën "reale" nga përshkrimi i tij i rrezikut. Prandaj, nuk është e diskutueshme se Gjykata e Divizionit në rastin e saj aplikoi një prag më të ulët se sa kërkesa e kërkuar.

Në vlerësimin e vet Gjykata vëren se sa i përket çështjes së qëllimit, Gjykata e Divizionit vendosi që, në rrethanat e rasti të ankueses, nëse vërtetohet se ajo me dashje nuk iu bind udhëzimeve të gjykatësit që ndalonte marrjen e informacionit të jashtëm lidhur me gjykimin, atëherë do të vërtetohej ekzistimi i qëllimit për të penguar ose paragjykuar administrimi i duhur i drejtësisë. Gjykata konsideron se duhet të jetë mjaft evidente për çdo anëtarë të jurisë që duke futur në mënyrë të qëllimshme dëshmi të paarsyeshme në dhomën e jurisë në kundërshtim me një urdhër të gjyqtarit gjykues, një gjë e tillë ndodh me synimin e kryerjes së një veprim që pak a shumë mban një rrezik real për të qenë paragjykuar ndaj administrimit të drejtësisë. Në vendosjen se qëllimi specifik mund të rrjedh nga parashikueshmëria e pasojave të veprimeve të caktuara, Gjykata e Divizionit nuk ishte duke zëvendësuar testin e synimit specifik me një test të "shkeljes së një urdhri" ose me një provë më themelore të qëllimit. Përkundrazi, ajo ishte duke gjetur provën specifike të synimit për t'u plotësuar në rrethanat e rasti të ankueses. Sipas Gjykatës kjo qasje ndaj provës së qëllimit specifik kishte precedent të qartë. Gjykata e Divizionit nuk ishte e parashikueshme, duke pasur parasysh jurisprudencën ekzistuese për këtë pyetje. Kështu, duke deklaruar se qëllimi mund të demonstronhet nga parashikueshmëria e pasojave, gjykata vendore nuk ka tejkalluar kufijtë e asaj që mund të konsiderohet si një sqarim i pranueshëm i ligjit.

³⁷ *Rohlena kundër Republikës Çeke* [DhM], nr. 59552/08, § 51, KEDNJ 2015

Ankuesja gjithashtu kritikoi qartësinë e drejtimit/ instruksioneve të gjyqtarit. Gjykata nuk mund ta pranojë pohimin se informacionet në fillim të gjykimit ishin të paqarta, veçanërisht marrë në kontekstin e informatave të tjera të ofruara nga nga zyrtari i jurisë, njoftimet e postuara rreth ndërtesës së gjykatës dhe betimin e saj. Anëtarëve të jurisë u tha qartë, dy herë, se ata nuk ishin të lejuar të "hulumtonin në internet", të mos "përpiqeshin të bëjnë ndonjë hulumtim vetanak" dhe se, sapo të largoheshin nga gjykata, ata nuk duhej të merreshin me rastin në asnjë mënyrë. Fakti që nuk ka paralajmërim penal të qartë nuk ndikon në qartësinë e udhëzimit të dhënë nga gjyqtari. Një paralajmërim i tillë nuk kërkohet sipas ligjit vendor dhe nëse ankuesja dëshironte të dijë detaje të mëtejshme të sanksioneve të zbatueshme në një shkelje të udhëzimit, ajo përsëri mund të kërkonte sqarime nga gjyqtari. Së fundi, sa i përket argumentit të ankueses lidhur me ndryshimin midis një udhëzimi dhe një urdhri, Gjykata konsideron se një argumente i tilla është i papërshtatshëm për arsyet e dhëna nga Gjykata e Divizionit dhe Gjykatës. Konsideratat e mësipërme janë të mjaftueshme për t'iu mundësuar Gjykatës të konstatojë se prova për shpërfillje të gjykatës të aplikuar në rastet si rasti në fjalë janë të mjaftueshme dhe të parashikueshme. Funkzioni ligjvënës i gjykatave që mbahen brenda kufijve të arsyeshëm: aktgjykimi i dhënë në rastin e saj mund të konsiderohet, më së shumti, si një hap në sqarimin gradual të rregullave të përgjegjësisë penale për shpërfillje të gjykatës përmes interpretimit gjyqësor. Çdo zhvillim i ligjit ishte në përputhje me thelbin e veprës dhe mund të parashikohej në mënyrë të arsyeshme. Rrjedhimisht, Gjykata gjen nuk ka pasur shkelje të Nenit 7 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se nuk pasur shkelje të Nenit 7 të Konventës. Ankesa sipas Nenit 6 § 1 janë qartazi absorbohet brenda Nenit 7 andaj nuk ngritet si çështje e ndarë [njëzëri].

Ruban kundër Ukrainës - 8927/11

11 korrik 2016

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 7

Shkelje e të drejtës për dënim më të favorshëm në bazë të legjislacionit të ri, si pasojë e shtyerjes së kohës së dënimit / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: *bazë ligjore / dënim / legjislacion / ndryshim / dënim me vdekje / i përjetshëm / hendek ligjorë / kohë e vendimit*

Ankuesi: z. Vladimir Nikolayevich Ruban, shtetas ukrainas i lindur në vitin 1972

Faktet e rastit

Ankuesi, në kohën e parashtrimit të kërkesës, gjendet në vuajtje të një dënimi të përjetshëm për vrasje të rëndë dhe banditizëm. Në korrik të vitit 2009, Ankuesi u dënua në shkallën e parë për vrasje të rëndë dhe banditizëm. Veprat penale ishin kryer në vitin 1996 dhe, në atë kohë, Kodi Penal i vitit 1960 parashikonte dënimin me 15 vjet burgim ose dënimin me vdekje për veprën penale të vrasjes së rëndë. Megjithatë, më 29 dhjetor 1999 Gjykata Kushtetuese e kishte shpallur dënimin me vdekje të jetë jokushtetues, i cili vendim hyri në fuqi menjëherë; dhe, tre muaj më vonë, më 29 mars 2000, Parlamenti kishte ndryshuar Kodin Penal në mënyrë që të zëvendësojë dënimin me vdekje me burgim të përjetshëm për veprën penale të vrasjes së rëndë. Ankuesi u dënua me burgim të përjetshëm. Në një ankesë në Gjykatën Supreme në korrik 2010, ankuesi pretendoi se ai duhet të kishte përfitur nga dënimi më i butë që ishte zbatuar për një vepër penale të vrasjes së rëndë gjatë periudhës tre mujore ndërmjet vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe amendamentit të Kodit Penal, përkatësisht 15 vjet burgim. Megjithatë, Gjykata Supreme mbështeti vendimin e korrikut 2009, duke vënë në dukje se ankuesi ishte dënuar si duhet.

Përmbledhje e pretendimeve

Duke u bazuar në Nenin 7 §§ 1 dhe 2 të Konventës (nuk ka dënim pa ligj), a nkuesi pretendoi se nëse ai do të ishte dënuar gjatë hendekut tre mujor ndërmjet kohës kur ishte shfuqizuar dënimi me vdekje dhe burgimi i përjetshëm nuk ishte futur ende në Kodin Penal, gjykatat nuk do të kishin zgjidhje tjetër përveçse ta dënonin atë me një dënim maksimal prej 15 vjetësh, pasi asnjë alternativë tjetër nuk ishte në dispozicion në Kodin Penal.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata kujtoi parimin, siç garantohet me Nenin 7, se legjislacioni penal nuk mund të interpretohet gjerësisht në dëm të të akuzuarit. Veçanërisht, kur ka pasur dallime në mes të ligjit penal në fuqi në kohën e kryerjes së një vepre penale dhe ligjeve të

mëvonshme penale të nxjerra para se të merrej një vendim i formës së prerë, gjykatat duhet të zbatojnë ligjin dispozitat e ligjit që janë më të favorshme për të pandehurin.³⁸

Në rastin e ankuesit, ai ishte shpallur fajtor për krime të kryera në vitin 1996, por më së voni u dënua për ato krime në vitin 2010 me vendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme. Gjykata theksoi rëndësinë e marrjes në konsideratë të qëllimit të ligjvënësit dhe, në veçanti, nëse ai ishte të humanizonte ligjin penal dhe të jepte efekt retrospektiv në një ligj më të butë. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, krijimi i hendekut tre mujor - midis heqjes së dënimit me vdekje dhe zëvendësimit të tij me burgim të përjetshëm - nuk kishte qenë i qëllimshëm. Në çdo rast, në rastin e ankuesit, Parlamenti kishte zëvendësuar dënimin me vdekje me një dënim të përjetshëm dhe gjykatat në fakt kishin aplikuar formën më të butë të dënimit.

Gjykata vuri në dukje se nuk kishte asnjë mosmarrëveshje midis palëve lidhur me parimin e prapaveprueshmërisë/retroaktivitetit së zbatimit më të butë të ligjit penal, por papajtueshmëria qëndronte në interpretimin e verzionit të Kodit Penal që kishte ekzistuar gjatë tre muajve, përkatësisht midis 29 dhjetorit 1999 dhe 29 mars 2000. Sipas mendimit të Gjykatës, kishte një hendek tre mujor midis heqjes së dënimit me vdekje dhe zëvendësimit të tij me burgim të përjetshëm, por krijimi i atij boshllëku nuk kishte qenë i qëllimshëm. Gjykata theksoi rëndësinë e marrjes në konsideratë qëllimin e ligjvënësit për ta humanizuar ligjin penal dhe t'i jepte efekt retrospektiv ligjit më të butë, mirëpo nuk ka mundur të zbulojë ndonjë qëllim të legjislaturës në veçanti, dhe të shtetit në përgjithësi, për ta zbutur ligjin në masën e kërkuar nga Ankuesi. Po ashtu, Gjykata ka ripërsëritur se burgimi i përjetshëm është dënim më i butë se dënimi me vdekje.

Gjykata arriti në përfundimin se në kohën kur ankuesi kishte kryer krimin e tij në vitin 1996, ajo vepër penale ishte sanksionuar me dënimin me vdekje. Parlamenti e kishte zëvendësuar atë dënim me një dënim të përjetshëm, të cilin e konsideroi proporcionale dhe gjykatat në fakt kishin aplikuar formën më të butë të dënimit në rastin e zotit ankuesi. Prandaj, Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të Nenit 7 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se nuk ka shkelje të Nenit 7 të Konventës [*me 6 vota për dhe 1 kundër*].

Gjyqtari Hajiyev, i cili ka votuar kundër, ka deponuar mendimin mos pajtues. Sipas tij, ishte një parashtrim i arsyeshëm i ankuesit që në mungesë të dënimit me vdekje gjatë periudhës kalimtare dhe para futjes së dënimit me burgim të përjetshëm, gjykatat kombëtare duhet të aplikojnë në rastin e tij dënimin e vetëm që ekzistonte sipas dispozitës përkatëse, e cila ishte pesëmbëdhjetë vjet burg. Pozita e ankuesit bazohet në një parim të përgjithshëm të së drejtës penale, sipas të cilit ligji i përkohshëm që parashikon një ndëshkim më të butë zbatohet pa kushte. Ky parim i qartë është shkelur në rastin në fjalë dhe për këtë arsye, gjyqtari ka vendosur të mos pajtohet me shumicën.

³⁸ *Scoppola kundër Italisë* (nr. 2) [GC], nr. 10249/03, § 109, 17 Shtator 2009

C.R. kundër Mbretërisë së Bashkuar - 20190/92
22 nëntor 1995 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 7

Pretendim se dënimi për një krim, i cili në kohën relevante nuk përbënte vepër penale, paraqet shkelje të të drejtës /*nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: *dhunim / bashkëshort / imunitet / divorc / legjislacion / retroaktivitet / vepër penale*

Ankuesi: z. C.R., shtetas britanik.

Faktet e rastit

Më 24 shtator të vitit 1994, në interes të administrimit të duhur të drejtësisë dhe mbështetur në rregullat e Gjykatës, Kryetari i Gjykatës vendosi që të konstituonte një Dhomë të vetme gjyqësore për të shqyrtuar këtë rast dhe rastin tjetër, *S.W. kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Megjithatë, në vijim do të përshkruhen vetëm rrethanat, pretendimet dhe arsyetimi në lidhje me rastin aktual, C.R. kundër Mbretërisë së Bashkuar.

Ankuesi, është i lindur në vitin 1952 dhe jeton në Leicester. Ai është martuar me gruan e tij në vitin 1984 dhe kanë një djal, i lindur në vitin 1985. Në nëntor të vitit 1987, çifti ishte ndarë për një periudhë dy-javore përpara se të bashkoheshin sërish. Në vitin 1989, për shkak të problemeve martesore, gruaja e tij e kishte lënë shtëpinë ku jetonin bashkërisht dhe ishte kthyer bashkë me djalin të jetonte te prindërit e saj. Ndërkohë ajo ishte konsultuar me avokatë rreth problemeve të saj martesore dhe i kishte lënë një letër ankuesit ku e njoftonte se ajo po planifikonte të aplikonte për shkurorëzim. Sidoqoftë, asnjë veprim ligjor nuk ishte ndërmarrë para se të ndodhte incidenti, i cili ka rezultuar në fillimin e procedurave penale.

Më 23 tetor 1989, ankuesi kishte folur në telefon me gruan e tij, ku gjithashtu ka shprehur qëllimin e tij për të shikuar mundësinë e shkurorëzimit. Njëzetedy ditë pasi ajo e kishte lëshuar shtëpinë, ankuesi ishte paraqitur në shtëpinë e prindërve të gruas në kohën që ata nuk ishin në shtëpi dhe e kishte sulmuar atë, në përpjekje për dhunim. Ankuesi ishte akuzuar më pas edhe dënuar për tentim dhunimi dhe sulm që kishin për pasojë lëndime trupore. Ankuesi ishte thirrur në imunitet si bashkëshort i viktimës në mbrojtjen e paraqitur përpara gjykatave angleze. Ndonëse ligji në kohën kur ishte kryer vepra i njihte imunitetin një bashkëshorti për dhunim të gruas së tij, ky rregull ishte subjekt i një numri përjashtimesh në rritje, përfshirë kur palët ishin pajtuar të ndaheshin. Përveç kësaj, ky rregull ishte vënë në dyshim nga një numër rastesh gjyqësore dhe një raport i komisionit kombëtar të së drejtës.

Gjykata vendore e Apelit ka hedhur poshtë argumentin e ankuesit, duke krijuar precedent të ri, kështu duke përmbysur rregullin se një bashkëshort është imun nga ndjekja për dhunim të gruas së tij. Dhoma e Lordëve (tash Gjykata Supreme) ishte pajtuar njëzëri me vendimin e Gjykatës së Apelit.

Ankuesi pastaj e kishte sjellë rastin para Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, duke pohuar se ai ishte dënuar për një krim, i cili në kohën relevante nuk përbënte vepër penale, në shkelje të Nenit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Komisioni e kishte shpallur ankesën të pranueshme më 14 janar 1994 dhe kishte shprehur opinionin se nuk kishte shkelje të Nenit 7(1) të Konventës (me katërmbëdhjetë vota kundër tri).

Përmbledhje e pretendimeve

Pretendimi i ankuesit ishte se shpallja fajtor e tij dhe dënimi për tentim dhunimi të gruas së tij ishte dënim retrospektiv (prapaveprues) në shkelje të Nenit 7 të Konventës. Qeveria, por as edhe Komisioni, nuk ishin pajtuar me këtë pretendim. Qeveria ka argumentuar se dënimi i ankuesit për tentim dhunimi të gruas së tij ka qenë në pajtueshmëri me Nenin 7 të Konventës. Sipas Qeverisë, e drejta angleze nuk e njihnte imunitetin absolut të një bashkëshorti që kishte marrëdhënie seksuale me gruan e tij pa pëlqimin e saj. Tutje, sipas Qeverisë, kishte rast gjyqësore që tregonin se një bashkëshort mund të shpallej fajtor për dhunim të gruas së tij.

Qeveria ka mbajtur qëndrimin se në rastin konkret faktet e rastit dëshmojnë se gruaja e ankuesit e ka tërhequr (revokuar) pëlqimin e saj në marrëveshje të ndërsjellë me ankuesin. Qoftë edhe nëse vendimet e gjykatave janë mbështetur më tepër në faktin se një grua kishte mundësinë që në mënyrë të njëanshme të tërhiqte pëlqimin e saj, ky ka qenë interpretim i arsyeshëm i të drejtës ekzistuese marrë parasysh rrethanat e ndryshuara shoqërore dhe këto vendime kanë qartësuar elementët ekzistues të veprës penale.

Ndërkaq, pretendimi qendror i ankuesit ka qenë se dënimi i tij për një vepër, e cila në kohën përkatëse nuk është konsideruar vepër penale sipas të drejtës së Mbretërisë së Bashkuar. Rregulli i përgjithshëm se një bashkëshort nuk mund të kryente veprën e dhunimit kundër gruas së tij ishte pranuar në mënyrë universale deri në vitin 1990. Ndonëse ekzistonin përjashtime ndaj këtij rregulli të zhvilluar, sipas ankuesit, këto ishin në mënyrë strikte të kufizuara në rrethanat kur, për shembull, ekzistonte një urdhër gjyqësor ose ekzistonte një marrëveshje formale për ndarje. Faktet e rastit, sipas ankuesit, nuk flasin për ekzistimin e ndonjë marrëveshjeje të ndërsjellë ndërmjet atij dhe gruas së tij.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata, së pari, ka vërejtur se Neni 7 mishëron parimin më të përgjithshëm se vetëm ligji mund të përcaktojë një krim dhe përshkruajë sanksionet; me fjalë të tjera, një krim duhet qartazi të definohet në ligj.

Gjykata, megjithatë, ka pranuar rolin e interpretimit gjyqësor në definimin dhe përshtatjen e ligjit ndaj rrethanave të ndryshueshme. Në këtë mënyrë, Gjykata ka gjetur se Neni 7 nuk mund të lexohet si ndalesë ndaj qartësisimit gradual të rregullave rreth përgjegjësisë penale përmes interpretimit juridik, me kushtin që zhvillimi i ligjit është i parashikueshëm. Në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se, “duke marrë parasysh njohjen e statusit të barazisë së grave me burratë në martesë dhe jashtë saj, si dhe të autonomisë së tyre rreth trupave të tyre, përshtatja e përbërësve të veprës penale të

dhunimit ishte në mënyrë të arsyeshme e parashikueshme, dhe me këshillë të përshtatshme ligjore, për ankuesin”.

Përfundimisht, Gjykata ka ardhur në përfundimin se ankuesi nuk është dënuar për sjellje e cila nuk ka përbërë vepër penale në kohën e kryerjes. Në fund, Gjykata ka shtuar se braktisja e imunitetit martesor për dhunim ishte në pajtueshmëri “jo vetëm me konceptin qytetërues të martesës, por edhe me, dhe mbi të gjitha, objektivat themelore të Konventës, thelbi më kryesor i së cilës është respekti për dinjitetin njerëzor dhe lirinë njerëzore”. Si rezultat gjykata konstaton se nuk ka shkelje të Nenit 7 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosë se nuk ka shkelje të Nenit 7 § 1, të Konventës [njëzëri].

Varvara kundër Italisë - 17475/09
29 tetor 2013 [Seksioni i Dytë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 7 § 1

Vendosja e dënimit në formën e urdhrit të konfiskimit pa një gjykim dënues pavarësisht ndërprerjes së procedurave penale si pasojë e ndryshimit të legjislationit / *ka shkelje*

Neni 1 i Protokollit nr. 1.

Ndërhyrja me të drejtën për gëzimin paqësor të pronës së ishte në kundërshtim me kërkesat e ligjshmërisë /*ka shkelje*.

Fjalët kyçe: *plan ndërtimor / leje ndërtimi / peisazh / zonë e mbrojtur / leje e veçantë / ndërrim legjislationi / dënim / [mos] parashikim në ligj / konfiskim pabazë / kompensim / pasuri*

Ankuesi: Vincenzo Varvara, shtetas italian, i lindur në vitin 1943 dhe jeton në Gravina di Puglia

Faktet e rastit

Ankuesi paraqiti një plan zhvillimi në komunën e Cassano delle Murge me qëllim të ndërtimit të banesave pranë pyllit Mercadante. Më 31 tetor 1984, komuna miratoi planin, si rezultat më 1 mars 1985, ankuesi lidhi një marrëveshje zhvillimi me komunën dhe mori lejet e për ndertimin e komplekseve banesore.

Më 6 shkurt 1986 një vendim ministror i 1 gushtit 1985 u botua në Gazetën Zyrtare. Sipas të cilit tokës rreth pyllit Mercadante do t'i jepej statusi i peizazhit të mbrojtur dhe si i tillë do t'i nënshtrohej dispozitave të Ligjit nr. 1497/1939, i cili vendosi autorizim të detyrueshëm paraprak ministror për lëshimin e lejeve të ndërtimit. Komuna e Cassano delle Murge sfidoi Dekretin Ministerial para Gjykatës Administrative të Pulias dhe, me një vendim të datës 10 mars 1993 pjesërisht miratoi ankesën. Në bazë të atij vendimi toka e mbuluar nga plani i ankuesit nuk ishte më subjekt i kufizimeve të peizazhit. Për më tepër, në të njëjtën kohë, dy ligje kishin hyrë në fuqi, Ligjit nr 431/1985 i kishte dhënë rajoneve kompetenca ekskluzive legjislative në fushën e mbrojtjes së peizazhit, dhe Ligji Rajonal 30/1990 sipas të cilit toka ngjitur me pyjet futej në kategorinë e tokave nënshtrohen kufizimeve të peizazhit dhe që kërkojnë autorizim nga Rajoni, me përjashtim të rasteve kur plani i zhvillimit ishte miratuar para 6 qershorit 1990. Nën efektin e kombinuar të këtyre ligjeve, planet për t'u miratuar pas kësaj date duhej të merrnin një opinion të favorshëm nga komiteti përkatës rajonal.

Në vitin 1993, ankuesi i paraqiti komunës së Cassano delle Murge një variant të planit të miratuar në vitin 1984. Dosja e lëndës tregon se variant i ri ishte i nevojshëm sepse plani origjinal kishte përfshirë aksidentalisht një zonë që përmbante një ujësjellës. Prandaj, ishte e nevojshme të zvogëlohej madhësia e projektit për 3,917 metra katrorë. Për më tepër, pronarët e parcelave fqinje kishin vendosur të mos vazhdonin me

projektin, prandaj duhej të modifikohet, veçanërisht aty ku ishin planifikuar ndërtimet. Ky variant i planit u miratua nga komuna e Cassano delle Murge më 30 maj 1994. Më 19 gusht 1994, ankuesi lidhi një marrëveshje zhvillimi me komunën, dhe si rezultat mori edhe lejet e ndërtimit. Më 21 maj 2007 komuna lëshoi një certifikatë për efektin që të gjitha ndërtesat e ndërtuara nga ankuesi para 30 shtatorit 2004 ishin në pajtim me legjislacionin e peizazhit.

Në vazhdimësi u inicuan procedurat penale ndaj ankuesit për zhvillim dhe ndërtim pa leje. Në një aktgjykim të 1 qershorit 1998, Gjykata e Rrethit Acquaviva delle Fonti vuri në dukje se aplikanti kishte ndërtuar shtatëmbëdhjetë blloqe banimi në përputhje me variantin e miratuar në vitin 1994 dhe lejet e ndërtimit të lëshuara nga komuna. Megjithatë, gjykata konsideroi se ky variant nuk ishte thjesht një modifikim i projektit të vitit 1984, por një plan i ri zhvillimi i cili duhej të ishte në përputhje me dispozitat që kishin hyrë në fuqi. Duke qenë se dispozitat në fjalë kërkonin një mendim të favorshëm nga komiteti rajonal përgjegjës për planifikimin e qytetit dhe se ankuesi nuk kishte aplikuar për një mendim të tillë, lejet e ndërtimit të lëshuara nga komuna duhej të konsideroheshin si jo valide. Duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese, gjykata vendosi një denim me burg nëntë muaj dhe një gjobë për ankuesin dhe urdhëroi konfiskimin, në dobi të komunës, të tokës dhe ndërtesave të mbuluara nga plani zhvillimor i kontestuar.

Ankuesi parashitri ankesë ndaj ndaj këtij vendimi, pranë Gjykata së Apelit e Barit, e cila me një aktgjykim të datës 22 janar 2001, lejoi ankesën e ankuesit dhe e liroi atë në bazë të meritave Gjykata konsideroi se kishte vetëm një plan zhvillimi, i cili ishte autorizuar në vitin 1984, domethënë shumë kohë përpara hyrjes në fuqi të dekretit ministror të vitit 1985 dhe Ligjit nr. 431/1985. Ajo konstatoi se në vitin 1994 ankuesi kishte paraqitur një ndryshim të thjeshtë në planin e miratuar tashmë. Prandaj, toka e ankuesit nuk ishte mbuluar nga masa e mbrojtjes së peizazhit dhe nuk kishte pasur zhvillim të paligjshëm të tokës. Ky vendim u apelua nga Prokurori publik dhe avokati shtetëror apeluan. Si rezultat në një aktgjykim të dhënë më 17 maj 2002, Gjykata e Kasacionit prishi vendimin e kundërshtuar dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim. Gjykata e Apelit të Bari, me një aktgjykim të ri të datës 5 maj 2003, dënoi ankusin për zhvillimin e paligjshëm të tokës me arsyetimin se varianti i planit zhvillimor përbënte një plan të ri dhe të veçantë.

Procedurat vazhduan sërish, duke u kthyer mbrapa nga Gjykata e Kasacionit te Gjykata e Apelit në Bari, edhe për një herë tjetër, deri sa më 23 marsit 2006, Gjykata e Apelit Bari ndërpreu procedurën për shkak se veprat penale ishin ndaluar që nga fundi i vitit 2002. Vendim i cili u apelua sërish. Përfundimisht me një aktgjykim të 11 qershorit 2008, të depozituar në regjistër më 1 tetor 2008, Gjykata e Kasacionit hodhi poshtë ankesën e ankuesit.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi pretendon shkelje të Nenit 7 të Konventës duke u mbështetur në argumentin se një dënim penal i ishte shqiptuar ndaj tij edhe pse ai nuk ishte dënuar për ndonjë veprë penale. Ai vuri në dukje se sipas ligjit Italian, ndjekjet penale nuk mund të sillen nëse vepra penale në fjalë nuk ishte e ndaluar. Në rastin në fjalë, sipas vepra ishte ndaluar që nga gushti i vitit 2001, megjithatë, procedurat penale ndaj kishin vazhduar deri në vitin

2008 për qëllimin e vetëm të vendosjes së një gjobe. Andaj ankuesi pretendoi shkelje të Nenit 7 të konventës si rezulta ti konfiskimit të pronës së tij, duke u bazuar në atë se kjo gjobë ishte dhënë pa pasur bazë në një vendim gjyqësor.

Për më tepër, ankuesi përsëriti se plani i zhvillimit të tokës ishte autorizuar nga komuna e Cassano delle Murge, se ai kishte ndërtuar banesën në përputhje me lejet e ndërtimit të lëshuara atij dhe se ai ishte siguruar se plani i tij ishte në përputhje me dispozitat e aplikueshme. Sipas tij, sjellja e autoriteteve para së gjithash duke autorizuar dhe madje duke inkurajuar projektin e ndërtimit dhe pastaj duke ndryshuar rrethësisht qëndrimin e tyre pas lejit të përfundimit të punës ishte shumë e diskutueshme. Së fundi, ankuesi vuri në dukje se fakti që fqinjët e tij kishin vendosur të mos vazhdonin me planin e zhvillimit ishte e parëndësishme nëse vetë plani ishte në harmoni me ligjin kombëtar.

Ndërsa, Qeveria e Italisë para së gjithash vuri në dukje se pas gjetjes së shkeljes në aktgjykimin *Sud Fondi*,³⁹ Gjykata Kushtetuese⁴⁰ kishte vendosur që ligji kombëtar duhet të interpretohet në përputhje me Konventën dhe se sipas parimeve të përcaktuara në aktgjykimin *Sud Fondi* "konfiskimi nuk mund të zbatohet automatikisht pas zhvillimit të paligjshëm të tokës, pa marrë parasysh përgjegjësinë për faktet ". Për më tepër, ligji nr. 102, datë 3 gusht 2009, kishte paraqitur një procedurë për heqjen e masave të konfiskimit dhe përcaktimin e kushteve për kompensimin e personave që kanë pësuar konfiskim të papajtueshëm me Konventën.

Qeveria pastaj vërejti se sipas ligjit Italian gjykatat ende e konsideronin konfiskimin e kontestuar si një sanksion administrativ. Për këtë arsye, vendosja e këtij sanksioni në rastin në fjalë ishte në përputhje me Nenin 7 të Konventës. Ndryshe nga *Sud Fondi*, në rastin konkret paditësi nuk ishte liruar në bazë të meritave, por kishte përfituar nga një vendim për të mos ndjekur penalisht, sepse vepra ishte bërë e ndaluar. Qeveria parashtrroi se parashtruesi i kërkesës mund të kishte hequr dorë nga zbatimi i afatit kohor dhe kërkoi nga gjykata të vendoste rastin sipas kushteve të Nenit 129 & 2 të K.Pr.Penale. Në të gjitha rastet, duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës së Kasacionit (aktgjykimi 5857, datë 16 shkurt 2011), Qeveria theksoi se rasti i çështjes nuk ishte ndaluar para fillimit të procedurës penale, e cila vuri në dukje ligjshmërinë e sanksionit të vendosur. Sipas Qeverisë, ankuesi ishte në dijeni të ekzistencës së kufizimeve të pezazhit andja Neni 7 i Konventës nuk ishte shkelur, sepse dispozitat e aplikueshme ishin të arritshme dhe të parashikueshme dhe si pasojë edhe dënimi ishte prandaj një pasojë e parashikueshme.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet e ankuesit Gjykatat arrijnë se në rastin *Sud Fondi* kishte gjetur se përmbarimi i një urdhri të konfiskimit pa ndonjë bazë ligjore, pavarësisht nga lirimi i shoqërive ankuese, është arbitrare, dhe në kundërshtim me Nenin 7 të Konventës. Në rastin në fjalë, procedurat kundër ankuesit ishin ndërprerë me arsyetimin se ndjekja penale e veprës penale të zhvillimit të paligjshëm të tokës ishin ndaluar; megjithatë, atij i ishte shqiptuar dënim penal, përkatësisht ishte realizuar konfiskimin i strukturave dhe tokave të prekura nga planin zhvillimor i paligjshëm.

³⁹ *Sud Fondi srl dhe të tjerët kundër Italisë*, nr. 75909/01, 20 janar 2009

⁴⁰ Aktgjykimi nr. 239, 2009

Gjykata duhet të marrë në konsideratë nëse shqiptimi i një dënimi të tillë është në përputhje me Nenin 7 të Konventës.

Së pari, Gjykata vëren se sipas kushteve të zbatueshme dispozita që parasheh se “ konfiskimi i ndërtesave të paligjshme është i autorizuar kur gjykatat penale kanë nxjerrë një vendim "final" që përcakton natyrën e paligjshme të zhvillimit në fjalë. Kjo dispozitë megjithatë nuk e specifikon se "vendimi përfundimtar" duhet të jetë dënim. Gjykatat vendore e interpretuan këtë dispozitë në atë atë formë që u lejonte atyre të vendosnin sanksionin pa një dënim *per se* dhe e konsideronin atë si një sanksion administrativ. Gjykata vëren së në lidhje me këtë vlen një parimi i të drejtës së brendshme sipas të cilit i pandehuri nuk mund të ndëshkohet pa një dënim. Në veçanti, asnjë dënim nuk mund të vendoset kur vepra penale është e ndaluar nga ligji. Për më tepër, interpretimi i aplikueshëm i dispozitave nga gjykatat kombëtare ishte e dëmshme për të pandehurin.

Së dyti, Gjykata dështon të shohë se si ndëshkimi i një të pandehuri të cilit gjykimi nuk i ka rezultuar në një dënim mund të jetë në përputhje me Nenin 7 të Konventës, dispozitë e cila përcakton qartë parimin e ligjshmërisë në ligjin penal. Duke pasur parasysh se askush nuk mund të shpallet fajtor për një vepër penale që nuk është e parashikuar me ligj dhe që askush nuk mund të pësojë një gjobë që nuk është e parashikuar me ligj, pasoja e parë është qartazi ndalimi i gjykatave vendore nga interpretimi i ligjit në mënyrë të gjerë e që është e dëmshme për të paditurit, përndryshe ai ose ajo mund të dënohet për sjellje që nuk është përcaktuara në ligj si kundërvajtje. Një pasojë tjetër e rëndësisë madhore rrjedh nga parimi i ligjshmërisë në të drejtën penale, përkatësisht ndalimi i dënimit ndaj një personi ku vepra është kryer nga një tjetër. Gjykata e ka shqyrtuar më parë këtë çështje nga këndvështrimi i Neni 6 § 2 i Konventës. Përkatësisht në rastin e *A.P., M.P. dhe T.P. kundër Zvicrës*,⁴¹ ishin një numër i trashëgimtarëve të dënuar për një vepër penale të kryer nga i ndjeri. Gjykata konsideroi se sanksioni penal i vendosur ndaj trashëgimtarëve për mashtrim tatimor i atribuohet të vdekurit dhe se përgjegjësia penale e te vdekurit nuk mund të bartet ndaj trashëgimtarëve. Duke pasur parasysh lidhjen ndërmjet Neneve 6 § 2 dhe 7 § 1 të Konventës,⁴² Gjykata konsideron se rregulli i cituar më lartë është gjithashtu i vlefshëm nga këndi i Neni 7 të Konventës, i cili kërkon që askush nuk mund të konsiderohet fajtor për një vepër penale të kryer nga një tjetër. Ndërsa është e vërtetë se dikush duhet të jetë në gjendje në çdo kohë të konstatojë çfarë është e lejuar dhe çfarë është e ndaluar nëpërmjet ligjeve të qarta dhe të hollësishme, as nuk mund të përfytyrohet një sistem me të cilin mund të jetë një ndëshkim i imponuar një personi i cili është provuar i pafajshëm ose, në çdo rast, në respektimi i të cilëve asnjë përgjegjësi penale nuk është vërtetuar me gjetjen e fajit. Në rastin në fjalë, dënimi penal i cili ishte shqiptuar ankuesit, përkundër faktit se vepra penale ishte ndaluar dhe përgjegjësia e tij penale nuk ishte themeluar në një vendim për fajin e tij, është i papajtueshëm me parimin se vetëm ligji mund të përcaktojë një krim dhe të përshkruajë një gjobë, të cilën Gjykata ka qartësuar së fundmi dhe që është një pjesë përbërëse e parimit të ligjshmërisë të përcaktuar në Nenin 7 të Konventës. Rrjedhimisht, ndëshkimi në fjalë ndaj ankuesit

⁴¹ *A.P., M.P. dhe T.P. kundër Zvicrës*, 29 Gusht 1997, *Reporter e Aktgjykimeve dhe Vendimeve* 1997-V

⁴² *Guzzardi kundër Italisë*, 6 nëntor 1980, § 100, Seria A nr. 39

nuk ishte i përcaktuar me ligj dhe për qëllimet e Nenit 7 të Konventës është arbitrar. Prandaj, Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Nenit 7 të Konventës.

Ankuesi u ankua për paligjshmërinë dhe natyën joproporcionale të konfiskimit të pronës së tij, duke pretenduar kështu shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr. 1. Në lidhje me këtë Gjykata rikujtoi se në rastin e cituar më lartë *Sud Fondi*, konfiskimi i tokës kontestuese dhe ndërtesave në pronësi të kompanisë ankuese përbënin një ndërhyrje në gëzimin e të drejtës për respektim të pasurisë.

Gjykata përsërit që Neni 1 i Protokollit 1 mbi të gjitha kërkon që çdo ndërhyrje nga një autoritet publik në gëzimin e pronës duhet të jetë në përputhje me ligjin. Nga kjo rrjedh se nevoja për të konstatuar nëse është arritur ekuilibri në mes të një të drejte dhe kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesat e mbrojtjes së individit si e drejte themelore⁴³ bëhen të rëndësishme vetëm sapo të vërtetohet se ndërhyrja e kundërshtuar e plotëson kërkesën e ligjshmërisë dhe nuk ishte arbitrar. Gjykata tashmë ka theksuar se vepra penale në lidhje me të cilën konfiskimi u vendos ndaj ankuesit nuk ishte parashikuar me ligj brenda kuptimit të Nenit 7 të Konventës dhe ishte arbitrar. Prandaj, Gjykata gjen se ndërhyrja me të drejtën e ankuesit për gëzimin paqësor të pronës së tij ishte në kundërshtim me kërkesat e ligjshmërisë dhe ishte arbitrar, dhe se si rezultat ka shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr. 1.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 7 të Konventës; dhe se si rezultat gjithashtu shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës [*njëzëri*].

⁴³ *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, 23 shtator 1982, § 69, Seria A nr. 52, dhe *Ish - Mbreti i Greqisë dhe të tjerët kundër Greqisë* [DhM], nr. 25701/94, § 89, KEDNJ 2000-XII

Kokkinakis kundër Greqisë - 14307/88

23 maj 1993 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 7

Pretendim se dënimi për një vepër e cila nuk ishte qartazi e përcaktuar në ligj përbënte shkelje të së drejtës / *nuk ka shkelje*

Neni 9

Shkelje e të drejtës për manifestim të lirisë fetare si pasojë e arrestimit me rastin e tentimit të bindjes së fqinjit për konvertim / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *liri fetare / konvertim / e drejtë / proselitizmit / predikim / vepër penale / krishterë / jehovaj / ndalim me ligj*

Ankuesi: z. Minos Kokkinakis, shtetësi greke

Faktet e rastit

Ankuesi, biznesmen i dalë në pension, ka lindur më 1919 në një familje të besimit ortodoks. I shndërruar në dëshmitar të Jehovait, në moshën 16 vjeqare, ai ka qenë i arrestuar më se gjashtëdhjetë herë për proselitizëm. Përveç kësaj ai ka qenë i internuar dhe burgosur disa herë.

Më 2 mars 1986, ai dhe gruaja e tij shkuan në shtëpinë e znj. Kyriakaki, e krishterë ortodokse, në Sitia (Kretë), ku patën me të një bisedë gjatë së cilës z. Kokkinakis u përpoq ta konvertojë atë, sidomos duke i lexuar disa pasazhe të librave si dhe duke i ofruar asaj shumë libra të tjerë. Bashkëshorti i znj. Kyriakaki lajmëroi policinë, e cila e arrestoi dhe i vendosi në gjendje arresti bashkëshortët Kokkinakis. Të dy u akuzuan për akte proselitizmi, të ndaluara nga Neni 4 i Ligjit 1363 të vitit 1938, i cili ishte miratuar gjatë diktaturës Metaxas (1936-1940). Më 20 mars 1986, Gjykata Penale e Lasithit i dënoi me katër muaj heqje lirie secilin, të konvertueshëm në 400 dhrahmi për ditë heqje lirie, dhe një gjobë prej 10000 dhrahmish. Më 17 mars 1987, Gjykata e Apelit të Kretës, e mbledhur me kërkesë të të dënuarve, e konsideroi të pafajshme znj. Kokkinakis por konfirmoi fajësinë e bashkëshortit të saj, të cilit gjykata ia reduktoi dënimin me heqje lirie në tre muaj dhe e konvertoi në një sanksion pasuror prej 400 dhrahmish për heqje lirie. Ankuesi iu drejtua Kasacionit, por kërkesa iu hodh poshtë në prill 1988.

Simbol i ruajtjes dhe kulturës greke gjatë afro katër shekujsh të pushtimit osman, Kisha ortodokse lindore e Krishterimit ka marrë pjesë aktivisht në luftërat e popullit grek për emancipimin e tij, deri në një shkallë të atillë sa ekziston një farë identifikimi i helenizmit në ortodoksinë. Kushtetutat e njëpasnjëshme greke i atribuuan Kishës në fjalë një karakter “dominues”. Duke përfaqësuar shumicën dërrmuese të popullsisë, ajo mishëron sipas saj, sipas ligjit dhe sipas faktit, besimin e vetë shtetit duke marrë përsipër nga ana tjetër edhe një numër të mirë të funksioneve të karakterit administrativ apo edukativ. Kushtetutat e viteve 1844, 1864, 1911 dhe 1952 e ndalonin “proselitizmin

dhe çdo lloj ndërhyrjeje tjetër kundër fesë dominuese”. Ndërsa Kushtetuta e vitit 1975 e ndalon oselitizmin, këtë herë në mënyrë të përgjithhme: ai ka të bëjë me “çdo fe të njohur”, do të thotë dogmat e të cilës nuk janë të pranuar nga kishat e krishtera dhe që nuk u imponon atyre që nuk besojnë asnjë besim sekret.

Përmbledhje e pretendimeve

Në kërkesën e tij të 22 gushtit 1988 drejtuar Komisionit, ankuesi pretendoi se dënimi i tij për proselitizëm mohonte të drejtat e garantuara nga Nenet 7, 9 dhe 10 të Konventës. Ai gjithashtu iu referua Neneve 5 § 1 dhe 6 §§ 1 dhe 2 të Konventës.

Më 7 dhjetor 1990, Komisioni e pranoi kërkesën me përjashtim të pretendimeve që kishin të bënin me Nenet 5 dhe 6. Në raportin e tij të 3 dhjetorit 1991, ai hartoi mendimin sipas të cilit nuk ka pasur shkelje të Nenit 7, që ka pasur shkelje të Nenit 9, dhe se nuk shtrohej asnjë çështje e veçantë nën këndvështrimin e Nenit 10.

Në lidhje me Nenin 9 të Konventës, ankuesi pohoi se ligji grek ishte në kundërshtim me të drejtën e secilit për të manifestuar fenë e tij në përgjithësi në bazë të asaj që deklarata e besimit në kundërshtim me besimin ortodoks grek mund të shkaktonte ndjekje penale. Përveç kësaj, e njëjta e drejtë për të manifestuar një besim fetar duhet të ekzistojë në çdo shoqëri tolerante demokratike. Qeveria greke u përgjigj në bazë të asaj që, megjithëse nuk u pretendua se ligjet greke që ndalonin prozelitizmin ishin në kundërshtim me Nenin 9 të Konventës, ligjet synonin të mbronin besimin mbizotërues grek dhe prandaj ishin të domosdoshëm.

Në lidhje me Nenin 7 të Konventës, ankuesi ka pohuar se dispozitat e ligjit grek në lidhje me veprën penale të proselitizmit ishin shumë të paqarta për të krijuar një veprë penale të definuar siç duhet. Veçanërisht formulimi që përcaktonte aktin e veprës penale, duke filluar me fjalën 'veçmas', krijoi një listë të paplotë dhe të padefinuar të veprimeve të mundshme që shkaktojnë veprën penale. Për më tepër, dispozita, në përdorimin e fjalëve "përpjekje" dhe "indirekte", krijoi një veprë penale ku nuk kishte aktivitet në përputhje me definicionin *actus reus* (megjithatë të paqartë). Qeveria greke u përgjigj duke parashtruar se ligji ishte i qartë në lidhje me elementet themelore të veprës penale. Domethënë, vepra kërkoi që një individ me një besim fetar të ndërmarrë hapa për të minuar, në mënyrë të papranueshme, ato të një tjetri. Prania e një liste joshteruese të metodave të mundshme me të cilat kjo mund të ndodhte nuk krijoi pasiguri.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me Nenin 9 të Konventës, Gjykata vëren se liria e mendimit, ndërgjegjes dhe e fesë përfaqëson një prej themeleve të një “shoqërie demokratike” sipas kuptimit të Konventës. Ajo renditet ndërmjet elementeve thelbësore të identitetit të besimtarëve dhe konceptit të tyre për jetën, por është gjithashtu edhe një gjë e çmuar për ateistët, anostikët, skeptikët apo indiferentët. Në veçanti liria e fesë nënkupton atë të “manifestimit të fesë” jo vetëm në mënyrë kolektive por edhe “individualisht” dhe “në mënyrë private”; ajo nënkupton në vetvete kryesisht të drejtën për të provuar të bindësh fqinj, për shembull me anë të një “mësimi”. Karakteri themelor i të drejtave të garantuar nga ana e Nenit 9 del në pah gjithashtu nga mënyra e formulimit të klauzolës që lidhet me kufizimin e tyre: në ndryshim nga paragrafi i dytë i Neneve 8, 10 dhe 11 që

përfshin tërësinë e të drejtave të përmendura në paragrafët e tyre të para, paragrafi i dytë i Nenit 9 ka të bëjë veçse me “lirinë për të shfaqur fenë ose bindjet e tij”.

Lidhur me rastin në fjalë gjykata shqyrton ndarasi nëse kishte ndërhyrje, nëse kjo ndërhyrje ishte e ligshme, legjitime dhe e nevojshme. Lidhur me pyetjen se a kishte ndërhyrje nga ana e shtetit, dënimin e shpallur nga ana e Gjykatës Penale të Lassthit, i ulur më pas nga ana e Gjykatës së Apelit të Kretës, Gjykata e analizoi si një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së z. Kokkinakis të “lirisë së shfaqjes së besimit ose bindjeve të tij”. Si pasojë çështja relevante është nëse kjo ndërhyrje ishte e ligshme. Gjykata konstatoi se gjuha e ligjeve nuk paraqet saktësi absolute. Për shkak të nevojës për të shmangur ngurtësi të tepruar dhe për t’iu përshtatur ndryshimeve të rrethanave, shumë prej tyre përdorin formula pak a shumë të përgjithshme interpretimi, dhe zbatimi i të cilave varet nga ana e praktikës. Në rastin në fjalë, Neni 4 i Ligjit nr. 1363 të vitit 1938 ishte plotësuar nga një jurisprudencë e qëndrueshme e juridiksioneve greke, jurisprudencë që ishte botuar gjithandej.

Sa i përket legjitimitetit duke marrë parasysh rrethanat e çështjes dhe kushtet aktuale të vendimeve të gjykatave përkatëse, Gjykata konsideron se masa e kundërshtuar ishte në ndjekje të një qëllimi legjitim sipas Nenit 9 § 2 të Konventës, përkatësisht mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, ashtu siç kishte arsyetuar qeveria. Tutje, Gjykata ka konsideruar vazhdimisht se një margjinë e caktuar vlerësimi duhet t’i lihet Shteteve Kontraktuese në vlerësimin e ekzistencës dhe shtrirjes së domosdoshmërisë së një ndërhyrjeje, por kjo kufizim është subjekt i mbikëqyrjes evropiane, duke përfshirë edhe legjislacionin dhe vendimet që e zbatojnë atë, madje edhe ato të dhëna nga një gjykatë e pavarur. Detyra e Gjykatës është të përcaktojë nëse masat e marra në nivel kombëtar janë justifikuar në parim dhe proporcionalisht.

Sipas Gjykatës, është e domosdoshme të bëhet dallimi ndërmjet dëshmisë së krishterë dhe proselitizmit abuziv. I pari korrespondon evangjelizimit të vërtetë; i dyti përfaqëson shtrembërimin ose deformimin e tij dhe nuk përputhet me respektimin e duhur ndaj lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe fesë të tjetrit. Kriteret e pranuar në fushën e proselitizmit nga ana e legjislatorit grek do të mund të konsideroheshin si të pranueshme deri në masën që ato do të kishin për synim të ndalonin vetëm proselitizmin abuziv, përkufizimi i të cilit në parim nuk shtrihet në çështje në rastin në fjalë.

Gjykata vuri në dukje, nga ana tjetër, se juridiksioni grek kanë vendosur për përgjegjësinë e ankuesit për arsye që kufizoheshin vetëm në ripërsëritjen e termave të Nenit 4, të ligjit nr. 1363 të vitit 1938 pa saktësuar në mënyrë të mjaftueshme se në lidhje me çfarë i dënuari kishte bërë përpjekje për ta bindur fqinjin e tij me mjete abuzive. Asnjë prej fakteve që ato kanë ndërlidhur nuk lejoi ankuesin të justifikohet me një nevojë sociale imperative. Andaj si përfundim, Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Nenit 9.

Në lidhje me Nenin 7 të Konventës, gjykata theksoi se ky nen nuk kufizohet në ndalimin prapaveprues të së drejtës penale në dëm të të akuzuarit. Ai shpall gjithashtu, në mënyrë më të përgjithshme, parimin e ligjshmërisë që thotë se vetëm ligji mund të përcaktojë një krim dhe të përshkruajë një dënim (*nullum crimen, nulla poena sine lege*) dhe parimin se ligji penal nuk duhet të interpretohet gjerësisht në dëm të një të akuzuarit, për shembull me analogji. Prej kësaj rezultojnë që një shkelje duhet të jetë e

përcaktuar në mënyrë të qartë nga ligji. Ky kusht është i kënaqur kur individi mund të dijë nga formulimi i dispozitës përkatëse dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimit të gjykatave, sanksionin për të cilin veprimet dhe mosveprimet do ta bëjnë përgjegjës.

Në rastin në fjalë, ankuesi mund të dinte, duke u nisur nga gjuha e Nenit 4 të ligjit 1363 të vitit 1938, se mund të ishte përgjegjës penalisht për një veprim të tillë. Duke u bazuar në këtë Gjykata vie në përfundim që nuk ka shkelje të Nenit 7 të Konventës.

Duke pasur parasysh vendimin e saj në lidhje me Nen 9, Gjykata nuk vlerësoi së ishte e nevojshme që të shqyrtonte ankesat e formuluarat për shelje të Nenit 10 dhe 14 të kombinuar me Nenin 9 të Konventës.

Bazuar në Nenin 41 të Konventës, Gjykata caktoi se shteti i paditur duhet të paguajë ankuesin, brenda tre muajve, 400,000 dhrahmi në lidhje me dëmin jomaterial dhe 2,789,500 dhrahmi në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen shkelje të Nenit 9, ndërsa nuk gjen shkelje të Nenit 7 të Konventës; Gjykata gjithashtu vendosi se nuk është e nevojshme të shqyrtohet rasti sipas Nenit 10 ose sipas Nenit 14 të marrë së bashku me Nenin 9; [me 6 vota për dhe 3 kundër / me 8 vota për dhe 1 kundër / njëzëri].

Puhk kundër Estonisë - 55103/00

10 shkurt 2004 [Seksioni i Katërt]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 7

Pretendim për shkelje të Nenit 7 si rezultat i aplikimit prapaveprues (retroaktiv) të ligjit penal / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: kompani / tatime / falsifikim / mospërmbajtje e llogarisë / ndryshim legjislacioni / prapaveprim / ndëshkim penal

Ankuesit: z. Rain Puhk, shtetas estonez

Faktet e rastit

Ankuesi ka lindur në vitin 1970 dhe jeton në Tartu, qytet në Estoni. Në kohën relevante, kur kanë ndodhur ngjarjet që kanë çuar në këtë rast, ankuesi ishte pronar dhe menaxher i kompanisë *AS Maarja*.

Më 10 gusht 1995, policia e Tartu-s kishte nisur procedurat penale kundër ankuesit me akuza për vepra tatimore sipas Nenit 148-1 dhe 148-7 të Kodit Penal. Në proces të hetimeve paraprake, ankuesi ishte akuzuar tutje edhe me veprën e mosmbajtjes së duhur të llogaritarisë sipas Nenit 148-4 të Kodit Penal, si dhe për falsifikim të dokumenteve.

Më 6 tetor 1997, prokurori i Tartus kishte miratuar aktpadinë, dhe rasti i ishte dërguar Gjykatës së Qytetit Tartu. Me një vendim të 17 shkurtit 1999, Gjykata e Qytetit Tartu e kishte shpallur fajtor ankuesin për veprat sipas Nenit 148-1&7 dhe dënuar me katër vite burgim. Po ashtu, e kishte shpallur atë fajtor për veprën sipas Nenit 148-4 të Kodit dhe dënuar me katër muaj burgim. Pasi kjo e fundit ishte bashkuar me veprat e para, Gjykata i kishte caktuar ankuesit dënimin me 4 vite burgim, i cili ishte pezulluar për tri vite.

Gjykata kishte gjetur se aplikimi i Nenit 148-1&7 i Kodit Penal, që ishte në fuqi prej 13 janarit 1995, justifikohet në këtë rast mbi bazën e dështimi i ankuesit për të paguar taksat e kërkuara ishte i qëllimshëm dhe u vazhdueshëm dhe se aktiviteti i tij penal kishte vazhduar deri në tetor të vitit 1995.

Sa i përket mosmbajtjes së duhur të llogaritarisë sipas Nenit 148-4 të Kodit Penal, që ishte në fuqi nga 20 korriku 1993, Gjykata kishte vërejtur se kompania e ankuesit kishte funksionuar nga 5 maji 1993 (kur ligji nuk ishte në fuqi), por megjithatë funksionimi i saj kishte zgjatur deri më 1 tetor 1993, pasi ligji tashmë kishte hyrë në fuqi. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pas regjistrim të veprimtarisë ekonomike dhe ka qenë e pamundur që të përcaktohet rezultati i kompanisë, të hyrat, humbjet, borxhet, apo pasuritë e kompanisë. Sipas kësaj gjykate, ankuesi gjithashtu nuk kishte ndjekur rregullat dhe procedurat për llogarimbajtje, si dhe sigurim dhe ruajtje të dokumenteve relevante, ashtu siç kërkohej me dekretin e Qeverisë të 6 korrikut 1990 në lidhje me organizimin e llogarimbajtjes së kompanive.

Ankuesi e kishte apeluar vendimin e gjykatës së qytetit. Më 3 maj 1999, Gjykata e Apelit kishte vendosur që të lë në fuqi vendimin e gjykatës së qytetit. Kjo gjykatë kishte gjetur se veprimet për të cilat ankuesi ishte ngarkuar sipas Kodit Penal përbënin vepra penale në vazhdimësi.

Edhe Gjykata Supreme e kishte hedhur poshtë ankesën e ankuesit, duke theksuar se, sipas parimeve të së drejtës penale estoneze, ligji që duhej aplikuar ndaj një vepre penale ishte ligji që kishte hyrë në fuqi para përfundimit të aktivitetit kriminal.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi ka ngritur pretendimin në këtë rast se ai nuk mund të mbahet përgjegjës sipas Nenit 148-4 të Kodit Penal për periudhën para hyrjes së tij në fuqi. Aplikimi nga ana e gjykatave i konceptit të veprës penale në vazhdim u ka lejuar atyre shmangien nga ndalimi i aplikimit retroaktiv të ligjit penal i cili ka hyrë në fuqi më 20 korrik 1993, në shkelje të Nenit 7 të Konventës.

Tutje, ankuesi ka argumentuar se para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të tjera ligjore më 13 janar 1995, një dënim penal mund të shqiptohej vetëm nëse ai më parë ka qenë subjekt i procedurave administrative për veprën e njëjtë. Sidoqoftë, ai nuk ka pasur një dënim të tillë administrativ më parë. Sërish, aplikimi i konceptit të veprës penale të vazhdueshme nuk e mbivlen (tejkalon) ndalesën e aplikimit retroaktiv të ligjit penal.

Qeveria, nga ana e saj, ka argumentuar se Neni 7 i Konventës nuk është çenuar. Ndonëse kompania e ankuesit nuk posedonte ndonjë llogarimbajtje që prej 5 majit 1993, kjo gjendje ka vazhduar edhe pas hyrjes në fuqi të Nenit 148-4 të Kodit Penal më 20 korrik 1993. Për më tepër, sipas Qeverisë, ankuesi kishte detyrim që të mbante në mënyr të duhur dhënat e llogarisë edhe para asaj, sipas një dekreti të Qeverisë të datës 6 korrik 1990.

Tutje, Qeveria ka mbajtur qëndrimin se, përkundër ngjashmërive të pretenduara, rasti aktual është i ndryshëm prej rastit të mëhershëm *Veeber*,⁴⁴ pasi në rastin konkret, shumica e veprimeve të ankuesit binin brenda periudhës pas 20 korrikut 1993, nga e cila datë e tutje rreziku i ndëshkimit penale ishte qartazi i parashikueshëm për ankuesin.

Qeveria, po ashtu, i është referuar jurisprudencës së Gjykatës Supreme të vendit në lidhje me aplikimin dhe interpretimin e ligjit dhe njohjen e konceptit të krimit të vazhdueshëm ose të veprës penale në vazhdim.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata ka rikujtuar se garancioni i mishëruar në Nenin 7, që është një element thelbësor i sundimit të ligjit, zë një vend të rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të Konventës, siç nënvizohet nga fakti se asnjë përjashtim nuk lejohet sipas Nenit 15 në kohë lufte ose emergjence tjetër publike. Duhet konceptuar dhe aplikuar ashtu siç rrjedhë nga objekti dhe qëllimi, në një mënyrë që ofron mbrojtje efektive kundër ndjekjes, gjykimit dhe dënimit arbitrar.

Në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës, Neni 7 nuk kufizohet vetëm në ndalimin e aplikimit retroaktiv të së drejtës penale në dëm të të akuzuarit; ai mishëron, më

⁴⁴ *Veeber kundër Estonisë* (no. 2) nr. 45771/99, GjEDNj 2003-I

përgjithësisht, parimin se vetëm ligji e definon një krim dhe e përshkruan një sanksion (*nullum crime nulla poena sine lege*) dhe parimin se e drejta penale nuk duhet interpretuar gjerësisht në dëm të të akuzuarit. Nga këto parime del se një veprë penale duhet të definohet qartë në ligj. Kjo kërkesë plotësohet kur individi e din fjalëformimin e dispozitës relevante dhe, nëse ka nevojë, me ndihmën e interpretimit të gjykatës, se çfarë veprime dhe mosveprime e bëjnë atë penalisht përgjegjës.

Në rastin konkret, Gjykata ka vërejtur se ankuesi ishte dënua në bazë të Nenit 148-4 të Kodit Penal si rezultat i dështimit për të organizuar në mënyrë adekuate llogarimbajtjen në kompaninë e tij gjatë periudhës së veprimtarisë prej 5 majit 1993 deri më 1 tetor 1993.

Gjykata vëren se sipas dekretit të Qeverisë të 6 korrikut 1990, ankuesi kërkohej që të mbante llogarinë e kompanisë së tij në mënyrë të duhur gjatë gjithë periudhës së funksionimit. Sidoqoftë, përgjegjësia penale për shkelje të rregullave përkatëse ishte përcaktuar vetëm më 20 korrik 1993, kur Nenin 148-4 i Kodit Penal hyri në fuqi.

Duke aplikuar ligjin penal ndaj sjelljes së ankuesit para datës së hyrjes së fuqi të ligjit, gjykatat vendore kishin gjetur se veprimi ishte pjesë e një veprë penale të vazhdueshme, e cila kishte zgjatur edhe gjatë periudhës pas hyrjes në fuqi të dispozitës relevante të ligjit.

Ndonëse Gjykata e ka konsideruar të saktë se sjellja e ankuesit shtrihej kryesisht gjatë periudhës pas 20 korrikut 1993, zgjatja e periudhës ndaj të cilës është aplikuar në mënyrë retroaktive nuk është vendimtare për të shqyrtuar nëse garancionet e Nenit 7 të Konventës janë respektuar ose jo.

Në fund, Gjykata vëren se jurisprudenca e gjykatave vendore të cilës i është referuar Qeveria në argumentet e saj lidhet me vitet 1997-1998, derisa ankesa e ankuesit ka të bëjë me një situatë të para 20 korrikut 1993. Në mungesë të një ligji për përgjegjësinë penale si pasojë e mosorganizimit të duhur të llogarimbajtjes në kompani, ankuesi nuk do të mund të parashikonte rrezikun e ndëshkimit penal për sjelljen e tij gjatë asaj periudhe. Në këto rrethana, Gjykata ka gjetur se gjykatat vendore të Estonisë kanë aplikuar në mënyrë retroaktive ligjin e vitit 1993 ndaj sjelljes e cila më parë nuk është cilësuar veprë penale. Për pasojë, ka pas shkelje të Nenit 7(1) të Konventës. Njësoj, Gjykata ka gjetur se autoritetet estoneze kanë aplikuar në mënyrë retroaktive ligjin e vitin 1995 për sjellje ose veprime të cilat më parë nuk përbënin veprë penale.

Sa i përket dëmshpërblimit, Gjykata urdhëroi shtetin që t'i paguajë ankuesit 3,000 EUR si dëmshpërblim për dëmin jo-material dhe 1,508 EUR për kostot dhe shpenzimet gjyqësore para Gjykatës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen shkelje të Nenit 7 të Konventës mbi bazën e aplikimit retroaktiv (prapaveprues) të ligjit penal [*njëzëri*].

Neni 8

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korespondencës së tij.
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Berrehab kundër Holandës - 10730/84

28 maj 1988 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3

Trajtim çnjerëzor dhe degradues si pasojë e dëbimit / *nuk ka shkelje*

Neni 8

Shkelje e të drejtës në jetë private dhe familjare si pasojë e dëbimit nga shteti / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *jetë familjare / martesë / divorc / dëbim / shtetësi / lejeqëndrim / jasht-martese*

Ankuesit: z. Abdellah Berrehab (ankuesi i parë), shtetas Maroken, dhe vajza e tij, znj. Rebecca Berrehab (ankuesja e dytë) shtetase Holandeze

Faktet e rastit

Ankuesi i parë, një qytetar maroken i lindur në Marok në vitin 1952, ishte banor i përhershëm në Amsterdam, në kohën kur ai aplikoi në Komision. Atij iu dha leja për të qëndruar në Holandë për 'qëllimin e vetëm' të jetesës me gruan e tij holandeze, znj. Kosher, me të cilën u martua në vitin 1978. Rebecca, vajza e tyre, lindi në vitin 1979 dhe çifti më pas u shkurorëzua. Kur Rebecca u lind, babai dhe zonja Koster ranë dakord të siguroheshin që fëmija kishte kontakte të shpeshta dhe të rregullta me babain e saj (vizita katër herë në javë).

Në dhjetor të vitit 1979, kërkesa për rinovimin e lejes së qëndrimit të ankuesit u refuzua. Gjithashtu kërkesa për shqyrtimin e vendimit u refuzua nga Ministri i Drejtësisë. Ankesa e tij u hodh poshtë nga Divizioni Gjyqësor i Shtetit Raad van në vitin 1983 në bazë të asaj se s.11 (5) i Aktit për të Huaj i vitit 1965 parashikonte refuzimin për të ripërtërirë një leje qëndrimi për arsye të interesit publik dhe kjo ishte e justifikuar se ankuesi i parë nuk i plotësonte kushtet e lejes së tij. Raad van State vlerësoi se përmbushja e detyrimeve të tij ndaj vajzës së tij nuk i shërbeu asnjë interesi jetësor kombëtar dhe se këto detyrime ekzistonin pavarësisht nga vendbanimi i tij dhe se katër takime në javë nuk ishin të mjaftueshme për të krijuar jetë familjare brenda kuptimit të Nenit 8. Si pasojë ankuesi u dëbua më pas për në Marok.

Ankuesit iu dha më vonë një vizë një mujore për Holandën dhe pas kthimit ai u rimartua me znj. Kosher dhe iu dha leja për të qëndruar në Holandë "me qëllim që të jetonte me gruan e tij holandeze dhe të punonte gjatë asaj kohe".

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit argumentojnë se Neni 8 nuk supozon vetëm bashkëjetesën e përhershme dhe se vizita dhe mirëmbajtja ishin faktorë që duhet të merren parasysh. Ankuesit po ashtu argumentuan se vendimi për të dëbuar nuk ka ndjekur asnjë nga qëllimet legjitime të renditura në Nenin 8 § 2 dhe nuk ka promovuar "mirëqenien ekonomike të vendit",

sepse e kanë penguar ankuesin që të kontribuojë në shpenzimet e mbajtjen dhe edukimin e vajzës së tij.

Kërkesat e hyrjes në Holandë janë të përcaktuara në Aktin për të Huaj të vitit 1965 dhe "Qarkoren për të huajt". Sidoqoftë është politikë holandeze që të lejojë konsiderata humanitare të domosdoshme për të justifikuar një leje qëndrimi të pavarur, kjo politikë përdoret rrallë. Gjykata Evropiane vuri në dukje se Gjykata Holandeze e Kasacionit favorizon një interpretim të gjerë të 'jetës familjare', ndërkohë që Divizioni Gjyqësor i Raad van State ka një pikëpamje më të ngushtë. Vendimi në këtë rast është në përputhje me rastet e mëparshme para Raad van State, por në një vendim të fundit (atëhere) duket se Raad van State do të miratojë të njëjtin qëndrim si Gjykata e Kasacionit ku është konstatuar se bashkëjetesa nuk është *conditio sine qua non* e 'jetës familjare për qëllimet e Nenit 8 të Konventës.

Qeveria holandeze argumentoi se asgjë nuk e pengoi ankuesin të ketë qasje në vajzën e tij, pasi ai mund të udhëtonte nga Maroku në një vizë të përkohshme. Dëbimi i aplikant të parë ishte i domosdoshëm për rendin publik, ndoqi një qëllim legjitim dhe ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike.

Arsyetimi i Gjykatës

Sa i përket Nenit 8 të Konventës, Gjykata konstatoi se bashkëjetesa nuk është një *conditio sine qua non* për jetën familjare midis prindërve dhe fëmijëve. Një martesë konsiderohet si jetë. Kjo rrjedh nga koncepti i jetës familjare në të cilën bazohet Neni 8 që një fëmijë i lindur i një bashkimi të tillë është *ipso jure* pjesë e asaj marrëdhënieje; prandaj, që nga momenti i lindjes së fëmijës dhe nga vetë fakti i tij, midis tij dhe prindërve të tij ekziston një lidhje që i përket "jetës familjare", edhe nëse prindërit nuk jetojnë së bashku. Gjykata gjeti se lidhjet e jetës familjare nuk ishin thyer në këtë rast dhe iu referuan takimeve të shpeshta dhe të rregullta që ankuesi kishte me vajzën e tij para dëbimit të tij.

Gjykata pranon se vendimi për të refuzuar rinovimin e lejes së qëndrimit të ankuesit ishte në përputhje me politikën holandeze të kontrollit të imigracionit. Në përcaktimin nëse një përfundim ishte "i domosdoshëm në një shoqëri demokratike", Gjykata aplikon hapësirën e vlerësimit që i lihet shteteve kontraktuese.

Gjykata pohoi se "qëllimi legjitim i ndjekur duhet të peshohet kundër seriozitetit të përfundimit të së drejtës së ankuesve për respektimin e jetës së tyre familjare". Në këtë rast, ankuesi tashmë jetonte në Holandë dhe kishte lidhje të vërteta familjare. Refuzimi për dhënien e një leje qëndrimi të pavarur, së bashku me dëbimin, kërcënoi të shpëput këto lidhje. Si pasojë, efekti i përfundimeve në këtë rast ishte më serioz duke pasur parasysh moshën e re të vajzës së tij. Gjykata konstatoi se mjetet e përdorura në këtë rast ishin joproportionale me qëllimin legjitim të ndjekur. Anaj Gjykata vie në përfundim se ka shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Sa i përket Nenit 3 të Konventës, sipas mendimit të Komisionit, faktet e rastit nuk treguan se ndonjëri nga ankuesit pësoi vuajtje të nivelit që korrespondonte me konceptet e trajtimit "çnjerëzor" ose "degradues". Gjykata ndan këtë pikëpamje dhe konstaton se nuk ka pasur shkelje të Nenit 3.

Po ashtu, Gjykata i caktoi Holandës obligimin që t'ua paguajë ankuesve dëmshpërblimin material në vlerë prej 20,000 Gulden holandez.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjeti shkelje të Nenit 8, dhe në anën tjetër konstatoi nuk kishte shkelje të Nenit 3 *[me gjashtë vota për dhe një kundër / njëzëri]*.

Sipas mendimit mospajtues të gjyqtarit Thór Vilhjálmsson, i cili votoi kundër, të drejtat e z.Berrehab nuk i tejkalojnë interesat e të paditurit/Holandës sipas Nenit 8 (2), duke pasur parasysh faktin se ankuesit nuk jetonin në të njëjtën shtëpi dhe se prindërit e fëmijës nuk ishin të martuar në kohën e dëbimit. Fakti që autoritetet nuk i konsideronin të drejtat e fëmijës nuk përbën në vetvete një shkelje të Nenit 8 dhe gjykata duhet të vlerësojë në mënyrë të pavarur të drejtat dhe interesat konkurruese. Gjendja e fëmijës ishte shumë e pasigurt dhe ajo nuk kishte zë në këtë çështje dhe 'jeta familjare' ekzistonte vetëm në bazë të marrëveshjes mes babait dhe nënës së saj. Andaj sipas tij, nuk kishte shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Iglesias Gil dhe A.U.I. Kundër Spanjës - 56673/00

29 korrik 2009 [Seksioni i Katërt]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 8

Dështim i autoriteteve për të marrë masat e duhura për të siguruar kthimin e fëmijës tek nëna në përputhje me rregullat e rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve / *ka shkelje*.

Fjalët kyçe: *divorc / kujdestari / rrëmbim i fëmijës / largim nga shteti / procedurë civile / ndjekje penale / detyrim pozitiv*

Ankuesit: znj. María Iglesias Gil (*ankuesja e parë*), ka lindur në vitin 1961 dhe jeton në Vigo, dhe djali i saj A.U.I. (*ankuesi i dytë*), i lindur në vitin 1995.

Faktet e rastit

Më 8 shtator 1989, ankuesja u martua me A.U.A, ndersa më 3 qershor 1994 çifti u divorcua. Djali i tyre A.U.I. u lind më 7 dhjetor 1995 dhe A.U.A. pranoi atësinë. Në një vendim të datës 20 dhjetor 1996, Gjykata Familjare në Vigo i dha kujdestarinë nënës, përkatësisht ankuses së parë si dhe i lejoi babait të ketë qasje tek femija, përkatësisht ankuesi i dytë. Më 1 shkurt 1997 A.U.A. rrëmbeu djalin e tij gjatë një vizite dhe u largua nga Spanja me të. Pas kalimit nëpër Francë dhe Belgjikë, ai udhëtoi me fëmijën për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ankuesja paraqiti një ankesë penale pranë gjykatësit hetues në Vigo duke pretenduar rrëmbimin e fëmijës. Më 4 shkurt 1997 gjyqtari hetues dha urdhër për një kërkim mbarëkombëtar për A.U.A. dhe për kthimin e menjëhershëm të fëmijës tek nëna. Më pas, ankuesja gjithashtu paraqiti ankesa penale kundër anëtarëve të ndryshëm të familjes së A.U.A., e cila, siç tha ajo, kishte ndihmuar në rrëmbimin e djalit të saj. Gjithashtu ajo i kërkoi gjyqtarit hetues që të monitoronte thirrjet në telefonin celular të A.U.A. si dhe të intervistoheshin anëtarët e familjes së tij. Në një vendim të 19 shkurtit 1997, gjykatësi hetues hodhi poshtë të dy kërkesat, për shkak se nuk kishte dëshmi se numri i telefonit celular i cili ishte dhënë ishte i AUA dhe pasi që ankuesja nuk kishte dhënë saktë detajet e pyetjeve që ajo dëshironte t'u bëheshin të afërmve të ish burrit të saj.

Ankuesja gjithashtu kërkoi nga gjykatësi hetues që një kërkim të kryhet në zyrën e regjistruar të një kompanie që i përkiste A.U.A. që ishte përgjegjës për administrimin e pronës së tij në mungesë të tij, dhe për ekzaminimin e një automjeti që ai kishte përdorur për të lënë Spanjën. Gjykatësi përsëri refuzoi. Ankuesja kërkoi gjyqtarit të lëshonte një kërkesë ndërkombëtare dhe një urdhër arresti kundër A.U.A., por me urdhër të 29 majit 1997, gjyqtari refuzoi. Me një vendim të 5 qershorit 1997, gjyqtari hetues nr. 5 refuzoi kërkesat e ankuses për të gjitha hetimet që ajo kishte propozuar. Në urdhrin e 25 majit 1998, gjykatësi hetues gjithashtu shqyrtoi nëse një person mund të ndiqej penalisht për rrëmbimin e të miturit për të cilin kishte përgjegjësi të përbashkët prindërore. Gjykatësi gjeti se kjo nuk ishte e mundur sipas jurisprudencës, pasi të vetmet vepra që mund të kryheshin në rrethana të tilla ishin përbuzje penale dhe zhvatje. Në një urdhër të mëvonshëm të datës 1 korrik 1998, gjykatësi hetues përsëriti

se asnjë kërkim ndërkombëtar dhe urdhër arrest nuk mund të lëshohen për veprën penale të dyshuar për përbuzje penale.

Ankuesja parashtrroi një ankesë të veçantë *amparo* sipas Neneve 24 (e drejta për dëgjim të drejtë), 15 (e drejta për jetë dhe integritet mendore dhe fizike) dhe 17 (e drejta për liri dhe siguri) të Kushtetutës dhe bazur në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve i vitit 1989. Në një vendim të 2 qershorit 1999, Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë ankimin e saj si të pabazuar, duke pretenduar se ajo nuk kishte deklaruar pse nuk ishte dakord me vendimet e arsyetuara të gjykatave më të ulëta. Ankuesja paraqiti edhe një ankesë *amparo* në Gjykatën Kushtetuese, në të cilën pretendonte shkelje të Nenit 17 (e drejta për liri dhe siguri), të marra së bashku me Nenet 18 (të drejtat për jetën private dhe privatësinë familjare), 24 (një seancë të drejtë) dhe 39 (mbrojtja sociale, ekonomike dhe ligjore e familjes dhe fëmijëve) të Kushtetutës. Ajo u mbështet gjithashtu në Nenet 5 dhe 8 të Konventës. Në ankesën e saj, ajo u ankua në mënyrë të veçantë ndaj refuzimit sistematik të gjyqtarit hetues për të lëshuar një urdhër ndërkombëtar të kërkimit për fëmijën e saj, një refuzim i cili, sipas ankueses, ishte në kundërshtim me detyrën pozitive për të mbrojtur fëmijët dhe familjet. Ajo gjithashtu pohoi një shkelje të Nenit 11 § 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989, e cila kërkon nga shtetet të marrin masa për të luftuar transferimin e paligjshëm dhe mosdhënien e fëmijëve jashtë vendit. Në parashtrësën e saj, duke refuzuar të ndërmernte hapa hetues, gjyqtari hetues kishte shkelur drejtpërdrejt të drejtën e saj dhe të djalit të saj në jetën private dhe familjare, si dhe të drejtën e saj për mbrojtje gjyqësore, të garantuar me Nenin 24 të Kushtetutës dhe Nenin 6 të Konventës. Në një vendim të 17 qershorit 1999, Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë ankesën *amparo* si të pabazë, duke konsideruar se ankuesja e parë kishte kufizuar veten në kontestimin e vendimeve të gjykatave penale të cilat me vendime të arsyetuara dhe të bazuara kishin vendosur të bënin një urdhër të përkohshëm të shkarkimit në lidhje me ankesën e saj penale për rrëmbimin e fëmijës. Në një aktgjykim të 12 shkurtit 1999, Gjykata Familjare Vigo tërhoqi përgjegjësinë prindërore nga A.U.A. dhe i dha kërkueses së parë përgjegjësinë e plotë prindërore.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesja, duke vepruar në emër të vet dhe si përfaqësues ligjor i fëmijës së saj, pretendonte se autoritetet spanjolle kishin dështuar të merrnin masa efektive për të siguruar ekzekutimin e shpejtë të urdhrave të gjykatës që ishin bërë si dhe të njëjtat kishin dështuar të ndihmonin në sigurimin e kthimit të djalit të saj. Ajo parashtrroi se shteti i paditur nuk kishte përmbushur detyrimet e parapara me Konventë e as dispozitat e tjera të së drejtës vendore dhe ndërkombëtare. Në veçanti, ajo tha se autoritetet vendase kishin shkelur Nenin 8 të Konventës. Përsa i përket dispozitave të së drejtës ndërkombëtare, ankuesja i referohej Nenit 11 § 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës të 20 nëntorit 1989, i cili detyronte shtetet kontraktuese që të marrin masa të duhura për të luftuar levizjen e paligjshme të fëmijëve jashtë vendit, dhe Konventën e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve të 25 tetorit 1980. As prokurori publik, as gjykatat e brendshme nuk e kishin zbatuar këtë dispozitë, edhe pse ishte direkt i zbatueshëm në ligjin vendas. Në lidhje me këtë, ajo vuri në dukje se, në përputhje me Nenet 10 § 2 dhe 96 § 1 të Kushtetutës, traktatet ndërkombëtare që

ishin ratifikuar nga Spanja ishin pjesë e rendit juridik të brendshëm. Duke mos marrë masat e nevojshme sipas ligjit vendor dhe ndërkombëtar, autoritetet kombëtare ishin në kundërshtim me detyrimet e tyre pozitive sipas Nenit 8 të Konventës. Ankuesja theksoi se ajo kishte ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për të bindur autoritetet gjyqësore spanjolle që të ndërmarrin veprimet për të siguruar kthimin e djalit të saj. Për fat të keq, të gjitha kërkesat e saj ishin hedhur poshtë nga gjykatat që merreshin me çështjen. As gjykatësi hetues, as Provinciali Audiencia, as Gjykata Kushtetuese nuk ishin pajtuar me kërkesat e saj. Përpjekjet e saj kishin qenë të gjitha kot.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata vëren, së pari, se është e zakonshme që marrëdhënia midis ankueses dhe djalit të saj bie në sferën e jetës familjare sipas Nenit 8 të Konventës. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të përcaktojë nëse ka pasur shkelje të së drejtës së ankueses dhe të birit të saj për të respektuar jetën e tyre familjare. Gjykata përsërit se megjithëse objekti thelbësor i Nenit 8 është mbrojtja e individit kundër veprimeve arbitrare nga autoritetet publike, shteti ka gjithashtu detyrime pozitive të natyrshme të sigurojë një "respekt" efektiv për jetën familjare. Në të dy kontekstet theks i veçantë vihet mbi nevojën për vendosjen e një baraspeshe të drejtë midis interesave konkurruese të individit dhe të bashkësisë në tërësi; dhe se shteti gëzon një hapërisë të caktuar vlerësimi.⁴⁵

Sa i përket detyrimit të shtetit për të marrë masa pozitive, Gjykata ka përsëritur se Neni 8 përfshin të drejtën e prindërve në qasjen në masat të caktuara që do t'u mundësojnë atyre të ribashkohen me fëmijët e tyre dhe një detyrim ndaj autoriteteve kombëtare për të marrë masa për të lehtësuar ribashkimin nuk është absolut, dhe se natyra dhe shtrirja e masave të tilla do të varen nga rrethanat e secilit rast, por mirëkuptimi dhe bashkëpunimi i të gjithë të interesuarve janë gjithmonë një përbërës i rëndësishëm. Ndërkohë që sipas Gjykatës, autoritetet kombëtare duhet të bëjnë maksimumin për të lehtësuar një bashkëpunim të tillë, çdo detyrim për të aplikuar shtrëngimin në këtë fushë duhet të jetë i kufizuar, pasi që interesat, si dhe të drejtat dhe liritë e të gjithë të interesuarve duhet të merren parasysh dhe veçanërisht interesat më të mira të fëmijës sipas Nenit 8 të Konventës. Aty ku kontaktet me prindin mund të duket se i kërcënojnë ato interesa ose ndërhyjnë në ato të drejta, autoritetet kombëtare duhet të bëjnë një ekuilibër të drejtë mes tyre.

Së fundmi, Gjykata përsërit se Konventa duhet të zbatohet në përputhje me rregullat e së drejtës ndërkombëtare, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.⁴⁷ Duke pasur parasysh në mënyrë specifike detyrimet pozitive që Neni 8 i Konventës i imponon Shteteve Kontraktuese lidhur me ribashkimin e prindërve me fëmijët e tyre, ato duhet të interpretohen në dritën e Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve të 25 Tetorit 1980.

⁴⁵ *Keegan kundër Irlandës*, gjykimi i 26 majit 1994, Seria A nr. 290, fq.19, § 49

⁴⁶ *Ignaccolo-Zenide kundër Rumanisë*, nr. 31679/96, § 94, ECHR 2000-I, dhe *Nuuti Nen kundër Finlandës*, nr 32842/96, § 127, KEDNJ 2000-VIII

⁴⁷ *Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë* [DhM], nr. 34044/96, 35532/97 dhe 44801/98, § 90, KEDNJ 2001-II, dhe *Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], nr. 35763/97, § 55, KEDNJ 2001-XI

Çështja vendimtare në këtë rast, pra, është nëse autoritetet kombëtare kanë marrë të gjitha masat që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme prej tyre, për të lehtësuar ekzekutimin e urdhrave të gjykatave të vendit që i japin ankueses së parë përgjegjësinë dhe kujdestarinë prindërore për fëmijën.⁴⁸ Sa i përket pozitës sipas ligjit të brendshëm, Gjykata vëren se gjykatat kombëtare janë thirrur të marrin vendime, kryesisht të natyrës civile. Prandaj, është e padiskutueshme që sipas ligjit të brendshëm, gjykatat para të cilave u morën masat morën masa të ndryshme që ishin në përputhje me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, Gjykata vëren se çështja kryesore në rastin konkret është transferimi jashtë shtetit. Prandaj, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse, në dritën e detyrimeve të tyre ndërkombëtare që dalin në veçanti sipas Konventës së Hagës, autoritetet vendase bënë përpjekje adekuate dhe efektive për të siguruar përputhjen me të drejtën e ankueses për kthimin e fëmijës së saj dhe të drejtën e fëmijës për t'u bashkuar me nënën e saj. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se, sipas Nenit 96 § 1 të Kushtetutës, traktatet ndërkombëtare që janë ratifikuar në mënyrë të vlefshme janë pjesë e rendit juridik të brendshëm. Spanja ka qenë një Palë Kontraktuese në Konventën e Hagës që nga 16 qershori 1987, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendi ku fëmija u dërgua nga babai i tij, ka ratifikuar konventën gjithashtu. Për më tepër, në bazë të Ligjit Institucional nr. 1/1996 të datës 15 janar 1996 mbi mbrojtjen ligjore të të miturve, autoritetet kombëtare janë të detyruara të garantojnë respektimin e të drejtave të të miturve në përputhje me traktatet ndërkombëtare që janë ratifikuar nga Spanja. Gjykata vëren se nga 4 shkurti 1997, domethënë vetëm disa ditë pasi djali ishte marrë nga babai i tij, gjykatësi hetues urdhëroi një kërkim mbarëkombëtar dhe kthimin e menjëhershëm të fëmijës. Për më tepër, sipas parashtrësive të bëra nga Qeveria në seancë, si rezultat i pyetjeve fillestare, u zbulua shumë shpejt se babai dhe fëmija ishin në Shtetet e Bashkuara. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se sipas Nenit 3 të Konventës së Hagës, heqja ose mbajtja e fëmijës duhet të konsiderohet e gabuar kur ajo është në shkallë të të drejtave të kujdestarisë që i atribuohen një personi sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ishte banor i zakonshëm menjëherë para largimit ose mbajtjes. Për këtë qëllim, Neni 11 i Konventës së Hagës kërkon që autoritetet gjyqësore ose administrative të Shteteve Kontraktuese të veprojnë me shpejtësi në procedurat për kthimin e fëmijëve. Gjykata vëren se këto masa mund të merren nga autoritetet përkatëse vendase me iniciativën e tyre. Për më tepër, Neni 158 i Kodit Civil të ndryshuar me Ligjin Institucional nr. 1/1996 të datës 15 janar 1996 mbi mbrojtjen ligjore të të miturve u jep gjykatave të drejtën për të marrë me vete, ndër të tjera, të gjitha masat e duhura për ta larguar fëmijën nga rreziku dhe për ta parandaluar atë. Pasi autoritetet gjyqësore spanjolle kishin vërtetuar që fëmija ishte larguar nga shteti në mënyrë të paligjshme Gjykata konsideron se autoritetet kombëtare përkatëse duhet të kishin marrë masat e duhura siç janë përcaktuar në dispozitat përkatëse të Konventës së Hagës për të siguruar kthimin e tij te nëna. Autoritetet nuk morën ndonjë nga masat e parashikuara në Konventën e Hagës për të lehtësuar zbatimin e urdhrave të gjykatës në favor të ankuesit të parë dhe fëmijës së saj. Duke pasur parasysh këto gjetje, Gjykata konsideron se aspekti penal i procedurës nuk ka më ndonjë ndikim të rëndësishëm në rastin. Në lidhje me këtë, ajo vëren se disa

⁴⁸ *HokkaNen kundër Finlandës*, vendimi i 23 shtatorit 1994, Seria A nr. 299-A, fq. 22, § 58

kërkesa të ankueses për masa të ndryshme hetimore që duhen marrë në lidhje me ish bashkëshortin e saj dhe anëtarët e familjes së tij, u refuzuan në vendimet që ishin të arsyetuara dhe jo arbitrare. Duke qenë kështu, dhe në kundërshtim me atë që është pretenduar nga ankuesja, gjykatat e brendshme penale nuk mund të akuzohen se kanë qenë krejtësisht joaktive. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se më 4 shkurt 1997 gjyqtari hetues urdhëroi një kërkim mbarëkombëtar për A.U.A. dhe kthimin e menjëhershëm të fëmijës.

Në lidhje me refuzimit të gjykatave vendase për të lëshuar një kërkesë ndërkombëtare dhe urdhër arresti kundër A.U.A, Gjykata vëren se arsyeja e dhënë nga gjykatat vendase për refuzimin e lëshimit të urdhëresës ishte se akti i largimit të A.U.A, me fëmijën, mund të klasifikohet si përbuzje penale, një vepër penale që mbante një dënim me burg prej gjashtë muajsh dhe një viti dhe nuk mund të formonte bazën për lëshimin e një urdhër arresti ndërkombëtar. Gjatë marrjes së këtij vendimi, gjykatat vendase shqyrtuan elemente të ndryshme faktike dhe ligjore të cilat i konsideronin të rëndësishme për pyetjen. Gjykata përsërit se kryesisht u takon autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, të interpretojnë dhe zbatojnë të drejtën e brendshme, megjithatë, në rastin në fjalë, Gjykata konsideron se problemi ka të bëjë jo vetëm me interpretimin e dispozitave përkatëse ligjore në fuqi të gjykatave vendase - në fakt, nuk kishte asgjë për të treguar se interpretimi i tyre ishte i paarsyeshëm - por, mbi të gjitha, pamjaftueshmëria e legjislacionit përkatës. Në këtë pikë, Gjykata vëren se legjislativi spanjoll e gjeti të nevojshme përforcimin e dispozitave të hartuara për të luftuar rrëmbimin e fëmijëve, veçanërisht në lidhje me ligjin penal. Në lidhje me këtë, ajo vëren se dispozitat e Kodit Penal që rregullojnë këtë fushë janë ndryshuar me Ligjin Institucional nr. 9/2002 të datës 10 dhjetor 2002, i cili shtoi ndëshkimet që mund të shqiptohen kur personi fajtor për marrjen ose refuzimin e kthimit të të miturit ishte një nga prindërit dhe kujdesi i të miturit i ishte dhënë ligjërisht prindit tjetër ose një personi tjetër ose institucioni në interesin e fëmijës.

Gjykata konkludon se autoritetet spanjolle nuk arritën të bënin përpjekje adekuate dhe efektive për të zbatuar të drejtën e ankueses për kthimin e fëmijës së saj dhe të drejtën e fëmijës për tu ribashkuar me nënën dhe në këtë mënyrë shkelin të drejtën e tyre për respektimin e jetës së tyre familjare, siç garantohet me Nenin 8 të Konventës.

Gjykata vendos që shteti i paditur t'i paguajë ankueses brenda tre muajve nga data në të cilën aktgjykimi bëhet i formës së prerë shumë monetare në lidhje me dëmin jomonetar; në lidhje me shpenzimet dhe shpenzimetn si dhe çdo tatim që mund të paguhet mbi shumë e lartpërmendura;

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës [njëzëri].

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 8

Dështim i autoriteteve finlandeze për të mbrojtur të drejtat e fëmijës për respektim të jetës private pas postimit të një reklame me karakter seksual rreth tij në një web-faqe për takime në internet / *ka shkelje*

Neni 13

Mungesë e mjeteve juridike efektive për të adresuar shkeljen / *e panevojshme për shqyrtim*

Fjalët kyçe: portal / shpallje / pa autorizim / i mitur / përmbajtje jo e duhur / keqpërdorim / anonim / ruajtje identiteti / pedofili

Ankuësi: K.U., është shtetas finlandez, i lindur në vitin 1986

Faktet e rastit

Rasti ka të bëjë me publikimin e reklamës së një natyre seksuale në lidhje me një fëmijë në një portal *vendtakimi* në internet. Reklama, e postuar pa dijeninë e tij, përfshinte emrin e tij, vitin e lindjes, përshkrimin e detajuar të karakteristikave të tij fizike, një foto dhe numrin e telefonit (vetëm një shifër ishte gabim nga numri i saktë). Reklama thoshte se ai po kërkonte marrëdhënie intime me një djal të moshës së tij ose më të vjetër. Fëmija mësoi për ekzistencën e reklamës kur një person e kontaktoi atë me anë të postës elektronike, duke ofruar takim dhe “për të parë se çka dëshiron”. Ankuesi ishte 12 vjeçar në atë kohë.

Babai i ankuesit i kishte kërkuar policisë që të identifikonte personin që kishte postuar reklamën në mënyrë që të ndërmernte veprime ligjore kundër tij. Ofruesi i shërbimit të internetit kishte refuzuar, duke e konsideruar veten të detyruar nga konfidencialiteti i telekomunikimeve, siç definohej sipas ligjit finlandez të kohës.

Sipas legjisllacionit finlandez në fuqi në atë kohë, policia dhe gjykatat nuk mund t'i kërkonin ofruesit të shërbimit të internetit identifikimin e personit që kishte postuar reklamën.

Në një vendim të 19 janarit 2001, Gjykata e Qarkut të Helsinkit po ashtu kishte refuzuar kërkesën e policisë në bazë të Aktit për Hetime Penale që të detyronte ofruesin e shërbimit të internetit që të shpaloste identitetin e personit që kishte postuar reklamën. Gjykata gjeti se nuk kishte dispozitë ligjore shprehimore në këtë rast, që do ta detyronte ofruesin e shërbimit të internetit që të shpërfillte fshehtësinë profesionale dhe shpaloste një informacion të tillë.

Më vonë, Gjykata e Apelit e kishte lënë në fuqi këtë vendim, derisa Gjykata Supreme kishte refuzuar shqyrtimin e apelit.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi argumentoi pranë se i ishte shkelur e drejta e tij për respektimin e jetës së tij private (Neni 8 i Konventës) dhe shteti nuk i kishte dhënë atij një mjet efektiv juridik (siç kërkohet në Nenin 13 të Konventës) për të zbuluar identitetin e personit që kishte postuar në internet reklamën rreth tij.

Në parashtresën e tij, ankuesi ka paraqitur argumentin se legjislacioni finlandez i kohës ka mbrojtur kriminelin, derisa viktimat nuk ka pas mjete në posedim për t' mbrojtur kundër shkeljes së privatësisë. Sipas Kodit Penal, vepra përkatëse ishte e dënueshme, por Qeveria nuk kishte ndërmarrë masa për t' u siguruar se Kodi dhe Akti i Mbrojtjes së Privatësisë dhe Sigurisë së të Dhënave në Telekomunikime ishte në pajtueshmëri me njëri-tjetrin.

Ankuesi kishte argumentuar se mundësia e rastësishme për të kërkuar zhdëmtim civil, veçanërisht nga një palë e tretë, nuk ishte e mjaftueshme për të mbrojtur të drejtat e tij. Ai ka nënvizuar se nuk kishte mundësitë ose mjetet e nevojshme juridike për të identifikuar personin që kishte vendosur reklamën në internet. Derisa kompensimi në disa raste mund të jetë mjet efektiv, kjo do të varej nga ajo nëse ishte paguar nga personi që ka cënuar të drejtat e viktimës, që nuk ka qenë rasti në ankesën e tij. Në pikëpamjen e ankuesit, Qeveria nuk i kishte ofruar asnjë justifikim për dështimin për t' i ofruar atij mbrojtje në kohën përkatëse. Ai vlerësoi se kishte shkelje të Neneve 8 dhe 13.

Qeveria, nga ana e saj, ka deklaruar se në rastin konkret ndërhyrja në jetën private të ankuesit është bërë nga një individ tjetër. Akti për të cilin është paraqitur rasti është trajtuar nga e drejta vendore si akt i shpifjes që si i tillë do të ishte i ndëshkueshëm, dhe që ka efekt parandalues ose siguries. Një hetim kishte filluar për të identifikuar personin që ka postuar reklamën në internet, por ka qenë i pasuksesshëm për shkak të legjislacionit në fuqi, që ka pas për synim të mbrojtë lirinë e shprehjes dhe të drejtën për shprehje anonime. Legjislacioni ka mbrojtur publikuesin e mesazhit anonim në internet aq gjerësisht sa mbrojtja po ashtu mbulonte mesazhet që potencialisht do të mund të ndërhyjnë në privatësinë e një personi tjetër. Megjithatë, sipas Qeverisë, kishte rrugë të tjera të disponueshme për zhdëmtim, për shembull Akti për të Dhënat Personale, që ofronte mbrojtje nga shpifja dhe në bazë të këtij Akti, operatori i serverit, mbi bazë të dispozitave të Aktit për përgjegjësinë penale dhe përgjegjësinë në dëme, ishte i detyruar të siguronte se të dhënat e ndjeshme të regjistruara nga operatori procesoheshin me pëlqimin e subjektit të atyre të dhënave.

Në këtë rast, kishte edhe ndërhyrje të një pale të tretë, që ishte Fondacioni i Helsinkut për të Drejtat e Njeriut. Në deklaratën e paraqitur para Gjykatës, Fondacioni kishte deklaruar se rasti konkret ngritë çështjen e balancimit të mbrojtjes së privatësisë, nderit dhe reputacionit, në një anë, me ushtrimin e lirisë së shprehjes, në anën tjetër. Fondacioni mbajti qëndrimin se rasti konkret i ofronte Gjykatës mundësinë për të definuar detyrimet pozitive të shtetit në këtë sferë dhe kësajsoji të promovonte standardet e përbashkëta në përdorimin e internetit në mesin e të gjitha shteteve anëtare.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata gjeti shkelje të Nenit 8, duke pasur parasysh se asnjë mjet juridik nuk ekzistonte sipas ligjit finlandez për të zbuluar identitetin e personit që e kishte postuar reklamën rreth ankuesit në faqen e internetit për *vendtakime*.

Gjykata deklaroi se “si interesi publik, ashtu edhe mbrojtja e interesave të viktimave të krimeve të kryera kundër mirëqenies së tyre fizike apo psikologjike kërkojnë disponueshmërinë e një mjeti juridik që mundëson identifikimin e të pandehurit aktual dhe sjelljen para drejtësisë”. Mungesa e një sanksioni penal që mund të zbatohet në rastin aktual ishte problem serioz, arsyetoi Gjykata, sepse “vepra ishte penale, përfshinte një të mitur dhe e bëri atë cak për afrimet nga pedofilët”.

Neni 8 i Konventës jo vetëm që mbron nga ndërhyrja e Qeverisë, por gjithashtu imponon detyrime pozitive për të siguruar respekt për jetën private të qytetarëve. Gjykata theksoi se fëmijët dhe individët e tjerë duhet të kenë të drejtën e mbrojtjes nga shteti, në formë të parandalimit efektiv, nga llojet e tilla të rënda të ndërhyrjes në aspektet e thelbësore të jetës së tyre private.

Gjykata e hodhi poshtë argumentin e Qeverisë se mbrojtja e mjaftueshme për privatësi është siguruar përmes ekzistencës së veprës penale të shpifjes (bërja e komenteve të pavërteta që synojnë dëmtimin e reputacionit), sepse “ekzistenca e një vepre penale ka efekte të kufizuara parandaluese nëse nuk ka mjete për të identifikuar shkelësin aktual dhe për ta sjellë para drejtësisë”. Gjykata, po ashtu, e hodhi poshtë argumentin e Qeverisë se parashtruesi kishte mjet juridik pasi ai mund të kompensohej (dëmshpërblehej) për dëmet nga ofruesi i shërbimit të internetit, duke thënë se ishte “i pamjaftueshëm në rrethanat e këtij rasti”.

Në fund, Gjykata deklaroi se megjithëse liria e shprehjes dhe privatësia e komunikimeve janë konsiderata të rëndësishme dhe përdoruesit e kësaj teknologjie duhet ta garantojnë respektimin e privatësisë dhe lirisë së shprehjes së tyre, “garancia e tillë nuk mund të jetë absolute dhe duhet të rezultojë... në parandalimin e prishjes së rendit ose krimit ose në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”.

Marrë parasysh gjetjen e shkeljes së Nenit 8, Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme që të shqyrtonte ankesën në bazë të Nenit 13 të Konventës.

Mbi bazën e Nenit 41, Gjykata ka urdhëruar pagesën e një shume prej 3,000 EUR në lidhje me dëmin jo-material.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosë se ka shkelje të Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pasi ka gjetur shkelje të këtij Neni, Gjykata nuk e ka parë të nevojshme që të shqyrtojë shkeljen edhe të Nenit 13 të Konventës [*njëzëri*].

Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar - 10454/83

7 korrik 1989 [Gjykata]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 8

Shkelje e të drejtës në jetë familjare si pasojë e refuzimit të qasjes në dosjen e tij të plotë të fëmijërisë nga koha kur ai ishte në kujdestari të shtetit / *ka shkelje*

Neni 10

Shkelje e të drejtës për të ditur si pasojë e mos lejimit të qasjes në dokumente / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: *i mitur / kujdestari / informata / qasje / aprovim / pjesërishëm / konfidenciale / liri për të ditur / detyrim pozitiv*

Ankuesi: z. Graham Gaskin, shtetas britanik

Faktet e rastit

Ankuesi pas vdekjes së nënës së tij, u morr nën kujdestari nga Këshilli Bashkiak i Liverpoolit në vitin 1960, ku qëndroi deri në vitin 1974. Gjithashtu në vitin 1974 ai u paraqit para një gjykate për të mitur dhe u deklarua fajtor për një numër shkeljesh. Gjykata vazhdoi urdhërin e kujdestarisë; Ankuesi mbeti nën kujdesin e Këshillit Bashkiak të Liverpoolit ('LCC') deri në vitin 1977. Ankuesi pretendonte se ai ishte keqtrajtuar sa ishte nën kujdestari dhe kishte dashur të kuptonte detajet se ku ishte mbajtur, nga kush dhe në çfarë kushtesh ashtu për të qenë në gjendje të kapërcejë problemet e tij dhe të mësojë për të kaluarën e tij.

Pas një procesi gjyqësor të mbyllur, LCC vendosi në vitin 1983 që informacioni në dosjen e ankuesit të vihej në dispozicion të tij, me pëlqimin e kontribuesve në dosje. Nga 46 kontribues, 19 dhanë pëlqimin e tyre dhe 65 nga gjithsej 352 dokumente iu dhanë ankuesit.

Kontribuesit që refuzuan thanë, ndër të tjera, se interesat e palëve të treta mund të ishin dëmtuar; se kontributi do të kishte qenë i pavlefshëm nëse merrej jashtë kontekstit; se besimi profesional ishte i përfshirë; se nuk ishte praktikë të zbuloheshin raportet tek klientët; ka kaluar një periudhë shumë e gjatë për një raport që ende duhet të jetë në kujtesën e kontribuesit; dhe se do të ishte e dëmshme për interesat e ankuesit.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi pretendoi se refuzimi i qasjes në dosjen e tij të plotë të mbajtur nga LCC ishte në shkelje të së drejtës së tij për respektimin e jetës së tij private dhe familjare sipas Nenit 8 dhe e drejtës së tij për të marrë informacion sipas Nenit 10 të Konventës. Ankuesi gjithashtu u thirr në Nenet 3 dhe 13 të Konventës dhe Nenin 2 të Protokollit 1 të Konventës.

Komisioni e deklaroi të pranueshme ankesën e ankuesit lidhur me refuzimin e vazhdueshëm të qasjes në dosjen e tij të çështjes por deklaroi pjesën e mbetur të

kërkesës si të papranueshme. Komisioni konsideroi se kishte pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës për shkak të refuzimit për qasje në dosje të ankuesi. Komisioni po ashtu arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 10.

Në anën tjetër, Mbretëria e Bashkuar argumentoi se dosja, duke qenë informacion i hartuar për dhe nga autoritetet lokale, nuk përbënte pjesë të jetës private të ankuesit dhe për këtë arsye nuk binte në fushëveprimin e Nenit 8. Qeveria vlerësoi se nëse zbatohet Neni 8, ishte e diskutueshme nëse kishte pasur ndonjë ndërhyrje relevante me të drejtën e ankuesi për respektimin e jetës private ose nëse kishte ndonjë dështim në përmbushjen e obligimeve pozitive të qenësishme në Nenin 8, duke pohuar se ekzistenca e këtyre detyrimeve pozitive përbënte një diferencë të gjerë e vlerësimit për shtetin.

Mbretëria e Bashkuar gjithashtu pohoi se refuzimi i qasjes kishte një interes të gjerë publik: nëse konfidencialiteti i kontribuesve nuk ishte respektuar, bashkëpunimi i tyre do të kishte humbur dhe rrjedha e informacionit do të zvogëlohej seriozisht; kjo do të kishte një efekt serioz në funksionimin e shërbimit të kujdesit për fëmijët. Në lidhje me këtë, Qeveria argumentoi se baraspesha e arritur mes interesave të individit që kërkonte qasje në të dhënat dhe interesat e atyre që kishin dhënë informacion në konfidencë dhe interesin më të gjerë publik për ruajtjen e të dhënave të plota dhe të sinqerta, ishte në përputhje me obligimet e shtetit sipas Nenit 8.

Mbretëria e Bashkuar gjithashtu argumentoi se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 10, pasi nuk i dha ankuesit të drejtën për të marrë, kundër vullnetit të një autoriteti vendor, një dosje të mbajtur nga ai autoritet.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me Nenin 8 të Konventës, Gjykata vëren se dosja përmbante informacione në lidhje me aspektet shumë personale të fëmijërisë, zhvillimit dhe historisë së ankuesit dhe kështu mund të përbënte burimin e tij kryesor të informacionit në lidhje me vitet e tij të kaluara dhe formuese. Rrjedhimisht, dosja kishte të bënte me 'jetën private dhe familjare' të ankuesit dhe çështja e qasjes së tij në të binte në kuadër të Nenit 8 të Konventës. Megjithatë, objekti thelbësor i Nenit 8 ishte mbrojtja e individit kundër ndërhyrjes arbitrare nga autoritetet publike, përveç kësaj Mbretëria e Bashkuar mund të kishte detyrime pozitive të natyrshme në një "respekt" efektiv për jetën familjare.

Duke i refuzuar ankuesit qasjen e plotë në dosjen e çështjes së tij, Britania e Madhe nuk mund të thuhet se ka 'ndërhyrë' në jetën e tij private ose familjare; Gjykata vëren se thelbi i ankesës së ankuesit nuk ishte se shteti kishte vepruar, por se nuk kishte vepruar. Prandaj, në pyetje janë detyrimet pozitive që rrjedhin nga Neni 8. Në përcaktimin nëse ka ekzistuar një detyrim pozitiv apo jo, duhet pasur parasysh baraspeshën e drejtë që duhej të arrihej ndërmjet interesit të përgjithshëm të shoqërisë dhe interesave të individit. Për të arritur këtë baraspeshë, qëllimet e përmendura në Nenin 8 § 2 mund të kishin qenë relevante, edhe pse kjo dispozitë referohej vetëm për "ndërhyrje", domethënë detyrime negative.

Tutje Gjykata thekson, se konfidencialiteti i përmbajtjes së dosjes kontribuoi në funksionimin efektiv të sistemit të kujdesit të fëmijëve dhe në atë masë i shërbeu një qëllimi legjitim, duke mbrojtur jo vetëm të drejtat e kontribuesve, por edhe të fëmijëve në nevojë për kujdes. Personat në situatën e ankuesit kishin një interes vital,

të mbrojtur nga Konventa, përkatësisht e drejta për marrjen e informacionit të nevojshëm për të njohur dhe kuptuar fëmijërinë e tyre dhe zhvillimin e hershëm. Megjithatë Gjykata ka parasysh se konfidencialiteti i të dhënave publike ishte i rëndësishëm për marrjen e informacionit objektiv dhe të besueshëm dhe se konfidencialiteti i tillë mund të kishte qenë i nevojshëm edhe për mbrojtjen e personave të tretë.

Një sistem që ka mundësuar qasje në regjistrat, në varësi nga pëlqimi i kontribuesit, në parim mund të konsiderohet në përputhje me Nenin 8, duke marrë parasysh hapësirën e vlerësimit të shtetit. Megjithatë, Gjykata thekson se në një sistem të tillë, interesat e individit që kërkonin qasje në regjistrat duhej të siguroheshin kur një kontribues nuk ishte i disponueshëm ose refuzoi në mënyrë të parregullt pëlqimin. Proporcionaliteti do të arrihej vetëm nëse sistemi parashikon që një autoritet i pavarur mund të vendoste nëse do të jepej qasja në raste të tilla; mirëpo asnjë procedurë e tillë nuk ishte në dispozicion. Në rastin në fjalë procedurat e ndjekura nuk arritën të siguronin respektin për jetën private dhe familjare të ankuesit siç kërkohet nga Neni 8. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se kishte pasur një shkelje të Nenit 8.

Lidhur me Nenin 10 të Konventës, Gjykata vlerësoi se e drejta e lirisë për të marrë informacion në thelb i ndalon një qeverie që t'i kufizojë ndonjë personi marrjen e informacionit që të tjerët do të dëshironin ose mund të kishin qenë të gatshëm t'i jepnin atij. Ky nen nuk mishëron ndonjë detyrim ndaj shtetit për të dhënë, kundër vullnetit të vet, informacionin e mbajtur nga autoriteti lokal. Prandaj, nuk kishte pasur ndërhyrje në të drejtën e ankuesit për të marrë informacione të mbrojtura nga Neni 10.

Për shkak se ankuesi mund të ketë vuajtur shqetësime emocionale me rastin e shkeljeve, Gjykata që Mbretëria e Bashkuar duhet t'i paguajë ankuesit, për dëmin jomaterial 5,000 funta dhe, për shpenzimet gjyqësore £ 11,000 funta.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se kishte shkelje të Nenit 8, dhe në anën tjetër konstaton se nuk kishte shkelje të Nenit 10 [njëmbëdhjetë vota për dhe gjashtë kundër /njëzëri].

Gjykatësit Ryssdal, Kremona, Gölcüklü, Matscher dhe Sir Vincent Evans, të cilët votuan kundër, deponuan mendimin mospajtuas - Sipas tyre Neni 8 ishte i zbatueshëm, por nuk kishte pasur shkelje. Sipas tyre, procedura që u pasua nga Mbretëria e Bashkuar për të përcaktuar se cilat pjesë të dosjes së ankuesit mund t'i vihen në dispozicion të tij përfaqësonin një bilanc të drejtë interesash kundrejt rrethanave.

Po ashtu, gjykatësi Walsh deponoi mendimin mospajues, sipas të cilit Neni 8 nuk ishte i zbatueshëm pasi informacioni i kërkuar ishte për qëllim të avancimit të veprimeve ligjore; nuk është kërkuar në mbrojtje apo për të çuar më tej të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Gjithashtu, Neni 10 ishte i zbatueshëm; e drejta për të marrë informacionin e kërkuar ka bie në kuadër të Nenit 10 § 1. Informacioni u kufizua për të mbrojtur konfidencialitetin; kjo është brenda kualifikimit të lejuar nga Neni 10 § 2; më tej, kufizimi mund të ishte justifikuar si i domosdoshëm në një shoqëri demokratike për parandalimin e zbulimit të informacionit të marrë në besim në lidhje me një zonë të ndjeshme të mirëqenies sociale. Prandaj nuk kishte shkelje të ndonjë neni të Konventës.

Krasniqi kundër Austrisë - 41697/12

25 korrik 2017 [Seksioni i Katërt]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 8

Dëbimi nga Austria në Kosovë kishte shkelur të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: azil / imigracion / vendbanim / vepra penale / dëbim / ndalim kthimi / lidhje familjare / fëmijë / ndërhyrje

Ankuesi: Agron Krasniqi, i cili ka lindur në vitin 1974 dhe jeton në Kosovë

Faktet e rastit

Ankuesi hyri në Austri për herë të parë më 14 janar 1994 kur ishte 19 vjeç. Në nëntor të vitit 1994, ankuesi u arrestua duke punuar ilegalisht dhe më 16 nëntor 1994, Autoriteti Administrativ i Rrethit Dornbirn lëshoi një vendim me të cilin ankuesit i ndalohej lejeqëndrimi në Austri për një periudhë pesë vjeqare.

Më 5 janar 1995, ankuesi paraqiti një kërkesë azili, e cila më 27 janar 1995 u hodh poshtë nga Zyra Federale e Azilit si e pabazë. Ankesa e tij kundër këtij vendimi u hodh poshtë dhe ai vullnetarisht u kthye në Kosovë në shtator të vitit 1997.

Më tutje, më 1 korrik 1998, ankuesi u kthye në Austri dhe paraqiti një kërkesë të re azili më 8 korrik 1998, këtë herë së bashku me bashkëshorten dhe vajzën e tyre. Kërkesa për azil u hodh poshtë nga Zyra Federale e Azilit më 12 gusht 1998, por ankuesit dhe familjes së tij iu dha mbrojtje plotësuese. Ata morën një leje qëndrimi të përkohshme, e cila u zgjat disa herë. Leja e përkohshme e qëndrimit të ankuesit, e cila ishte bazuar në të drejtën e tij për mbrojtje plotësuese, skadoi në dhjetor 2009, pasi ai nuk kishte aplikuar për rinovimin e saj. Ndërmjet viteve 2003 dhe 2012, Krasniqi u dënua në nëntë raste të ndara për krime të ndryshme, duke përfshirë dëmtim trupor, vjedhje, kërcënimin e rënduar, dhe vepra të ndryshme të ndaluara me ligjin kundër drogës.

Në vitin 2007, si rezultat i dosjes së tij kriminale Autoriteti Administrativ i Distriktit Dornbirn lëshoi një ndalim ndaj ankuesit, që e ndalonte kthimin e tij në Austri për dhjetë vjet. Megjithatë, ndalimi mbeti pa efekt për aq kohë sa ai kishte mbrojtje plotësuese. Mbrojtja e tij subsidiare u tërhoq në vitin 2010, kështu që autoritetet e azilit konstatuan se gjendja e sigurisë në Kosovë ishte përmirësuar ndjeshëm, dhe dëbimi i tij u shpall i pranueshëm. Më pas gjykatat e azilit e konfirmoi këtë vendim; duke konkluduar në thelb se interesi publik për të dëbuar ankuesin dhe në për qëllim të parandalimit të veprimeve kriminale ka tejkaluar interesin e tij personal për ruajtjen e jetës së tij private lidhjet familjare në Austri.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi ka specifikuar se ai nuk është ankuar lidhur me lëshimin e ndalimit që ndalon kthimin e tij në Austri, por se ankesa e tij ndaj Gjykatës kishte të bënte vetëm me tërheqjen e statusit të mbrojtjes së tij plotësuese dhe dëbimin e tij të mëvonshëm në

Kosovë, që sipas tij kishte shkelur të drejtën e tij për respektimin e jetës së tij private dhe familjare, siç përcaktohet në Nenin 8 të Konventës.

Qeveria pranoi se dëbimi i ankuesit kishte përbërë një ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës së tij private dhe familjare. Megjithatë, sipas tyre kjo ndërhyrje ishte bazuar në ligj dhe kishte ndjekur një qëllim legjitim. Qeveria pohoi se kishte qenë gjithashtu proporcionale me qëllimet e ndjekura, pasi qëndrimi i gjatë i ankuesit në Austri ishte dëmtuar ndjeshëm nga fakti se ai ishte dënuar në mënyrë të përsëritur për vepra penale. Në kohën e vendimit përfundimtar vendas për dëbimin e tij, ai kishte, ndër të tjera, denime për trafik droge, vjedhje dhe gjashtë krime të tjera të dhunshme. Edhe pasi urdhri i tij për dëbim ishte bërë i formës së prerë nga gjykimi i Gjykatës Kushtetuese, ai ishte dënuar për një krim të dhunshëm. Ankuesi kishte kryer të gjitha veprat e tij penale si i rritur, gjë që shtoi ashpërsinë e tyre në vendimin përfundimtarë.

Për më tepër, edhe pasi vendimi për të dëbuar kërkuesin ishte bërë përfundimtar, ai ishte dënuar për krime të mëtejshme të dhunshme. Burgimi i ti për disa muaj nuk e kishte penguar atë të kryente vepra penale të mëtejshme, as nuk e kishte lëshuar atë me një ndalim që ndalonte kthimin e tij në vitin 2007 ose duke tërhequr statusin e tij të mbrojtjes shtesë në vitin 2011. Duhet të ketë qenë e qartë për atë në atë pikë se statusi i vendbanimit të tij ishte jashtëzakonisht i pasigurt⁴⁹ dhe se dënimet e mëtejshme penale mund të rezultonin në përfundimin e qëndrimit të tij në Austri në çdo kohë dhe kështu ndarjen nga familja e tij. Duke pasur parasysh se ai ishte dënuar për dy vepra të tjera, ndërsa procedurat për tërheqjen e statusit të mbrojtjes së tij shtesë ishin ende në zhvillim e sipër, ishte e qartë për autoritetet se ankuesi ishte krejtësisht indiferent ndaj vlerave sociale të mbrojtura nga dispozitat e ligjit penal austriak. Parashikimet e tyre përfundimisht u konfirmua nga kryerja e veprës së kërcënimit të rënduar pasi urdhri i dëbimit ishte bërë i formës së prerë.

Në lidhje me jetën familjare të ankuesit në Austri, Qeveria argumentoi se do të kishte qenë e mundur për të që të vazhdonte jetën në Kosovë.⁵⁰ Vetë ankuesi kishte deklaruar gjatë procesit të dëbimit që familja e tij nuk kishte asgjë për tu frikësuar në vendin e tij dhe ndoshta do të bashkohej me të atje. Megjithëse familja e tij kishte vendosur përfundimisht të qëndronte në Austri, ata mund ta vizitonin atë në Kosovë, e cila mund të arrihej lehtë nga Austria me makinë, avion ose tren. Për më tepër, ata mund të qëndronin në kontakt nëpërmjet telefonit dhe internetit. Qeveria shtoi se ankuesi kishte kaluar një periudhë të përgjithshme prej gjashtëmbëdhjetë muaj burg gjatë qëndrimit të tij në Austri. Prandaj, si rezultat i veprimeve të tij, ai nuk kishte qenë në gjendje të mbante një jetë familjare me të afërmit e tij gjatë asaj periudhe. Për më shumë Qeveria argumentoi se ankuesi kishte mbajtur lidhje sociale, gjuhësore dhe kulturore me vendin e tij të origjinës dhe gjithashtu kishte deklaruar gjatë procesit të dëbimit se kishte ende të afërm në Kosovë dhe se babai i tij kishte në pronësi një tokë dhe tre dyqane atje. Për më tepër, ankuesi kishte hyrë në Austri si i rritur dhe kishte kaluar një pjesë të madhe të jetës së tij në vendin e tij.

Në dritën e natyrës serioze dhe të përsëritshme të veprave penale të ankuesit, Qeveria parashittoi se ndalimi i kthimit të tij në Austri për dhjetë vjet - i cili erdhi përsëri në fuqi

⁴⁹ *AH Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 6222/10, & 41, 20 dhjetor 2011

⁵⁰ *Palanci kundër Zvicrës*, nr. 2607/08, & 61, 25 mars 2014

si pasojë e tërheqjes së statusit të mbrojtjes së tij subsidiare dhe dëbimi i tij - mund të konsiderohet si proporcional. Për më tepër, vendimi i kontestuar do të ndikonte në fakt vetëm për më pak se katër vjet, pasi që ai u bërë ligjërishit i detyrueshëm në nëntor të vitit 2007, jo në kohën kur ai ishte larguar nga vendi në vitin 2013 dhe prandaj ka skaduar në nëntor 2017. Pas kësaj, ankuesi mund të kthehej në Austri në qoftë se ai i plotësonte kërkesat përkatëse të hyrjes.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata fillimisht riafirmon se një shtet ka të drejtë, si një çështje e së drejtës ndërkombëtare dhe në përputhje me detyrimet e saj të traktatit, të kontrollojë hyrjen e të huajve në territorin e saj dhe vendbanimin e tyre atje.⁵¹ Konventa nuk garanton të drejtën e një të huaji për të hyrë ose banuar në një vend të caktuar dhe, në zbatim të detyrës së tyre për ruajtjen e rendit publik, shtetet kontraktuese kanë fuqinë për të dëbuar një të huaj të dënuar për vepra penale.

Megjithatë, një ndërhyrje në jetën private ose familjare të një personi do të jetë në kundërshtim me Nenin 8 i Konventës, përveç nëse mund të justifikohet sipas paragrafit 2 të atij Neni si "në përputhje me ligjin", duke ndjekur një ose më shumë qëllime legjitime të listuara në të dhe duke qenë "e nevojshme në një shoqëri demokratike" me qëllim të arritjes së qëllimit apo synimeve në fjalë. Kriteret përkatëse që duhet të zbatohen, në përcaktimin nëse një ndërhyrje është e nevojshme në një shoqëri demokratike, u përcaktuan në një seri rastesh si *Uner kundër Hollandës*, *Maslov kundër Austrisë*, *Balogun kundër Mbretërisë së Bashkuar*, dhe *Samsonnikov kundër Estonisë*.⁵² Ku Gjykata kishte listuar disa kriteret si "natyra dhe serioziteti i veprës penale të kryer nga ankuesi; kohëzgjatja e qëndrimit të ankuesit në vendin nga i cili do të dëbohet; koha e kaluar që kur vepra penale është kryer dhe sjellja e anuesit gjatë asaj periudhe; kombësia e personave të ndryshëm të interesuar; gjendja familjare e ankuesit, siç është kohëzgjatja e martesës dhe faktorë të tjerë që shprehin efektivitetin e jetës familjare të një çifti; nëse bashkëshorti e dinte për veprën në kohën kur ai ose ajo hyri në një marrëdhënie familjare; nëse ka fëmijë të martesës, dhe nëse po, moshën e tyre; seriozitetin e vështirësive që bashkëshorti ka të ngjarë të hasë në vendin në të cilin kërkuesi duhet të dëbohet; interesat dhe mirëqenien më të mirë të fëmijëve, në veçanti seriozitetin e vështirësive që mund të hasen në çdo vend të vendit në të cilin kërkuesi duhet të dëbohet; dhe - qëndrueshmërinë e lidhjeve sociale, kulturore dhe familjare me vendin pritës dhe me vendin e destinacionit."

Tutje Gjykata rikujton atëgjykimin e vet në *Jeunesse kundër Hollandës*,⁵³ që kishte të bënte me dëbimin e planifikuar të një emigranti afatgjatë dhe me lidhje të forta familjare në vendin pritës. Gjykata përsëriti se në rastet ku përfshihen fëmijët ekziston një konsensus i gjerë, duke përfshirë edhe të drejtën ndërkombëtare, në mbështetje të idesë se në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët, interesat e tyre më të mirë janë me rëndësi të madhe... Përderisa përfshirja e fëmijëve nuk mund të jetë faktor i

⁵¹ Abdulaziz, *Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 28 maj 1985, § 67, Seria A nr. 94

⁵² *Uner kundër Hollandës* [DhM], nr. 46410/99, §§ 54-55 dhe 57-58, KEDNJ 2006-XII; *Maslov kundër Austrisë* [DhM], nr. 1638/03, & 72-73, KEDNJ 2008; *Balogun kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 60286/09, § 46, 10 prill 2012; dhe *Samsonnikov kundër Estonisë*, nr. 52178/10, & 86, 3 korrik 2012.

⁵³ *Jeunesse kundër Hollandës* [DhM] nr. 12738/10, § 109, 3 tetor 2014

vetëm vendimtarë, sidocoftë duhet ti jepet një peshë e konsiderueshme. Prandaj, organet kombëtare vendim-marrëse duhet, në parim, të referohen dhe të vlerësojnë provat në lidhje me praktikitetin, fizibilitetin dhe proporcionalitetin e çdo largimi të një prindi jo-kombëtar me qëllim që të ofrojë mbrojtje efektive dhe peshë të mjaftueshme për interesat më të mirë të fëmijët e prekur drejtpërdrejt prej tij.

Duke qenë kështu, Gjykata nuk e harron faktin që, në kontekstin e largimit të një prindi jo-kombëtar si pasojë e një dënimi penal, vendimi në radhë të parë ka të bëjë me moszbatuesin e ligjit. Për më tepër, siç ka treguar praktika e gjykatës, në raste të tilla natyra dhe serioziteti i veprës së kryer ose historia e ofendimit mund të tejkalojnë kriteret e tjera që duhet të merren parasysh. Së fundmi, Gjykata përsërit se autoritetet kombëtare gëzojnë një hapësirë të caktuar vlerësimi kur vlerësojnë nëse një ndërhyrje në një të drejtë të mbrojtur nga Neni 8 ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur. Porse Gjykata është e autorizuar të japë vendimin përfundimtar nëse një masë dëbimi është e pajtueshme me Nenin 8. Duke konsideruar natyrën e rastit, në veçanti natyrën e përsëritur, pjesërisht të dhunshme dhe në këtë mënyrë serioze të veprave penale të ankuesit dhe kërcënimit që rezulton ndaj rendit dhe sigurisë publike. Gjykata vën në pah faktin që ankuesi kishte ardhur në Austri si i rritur dhe ende ka lidhjet gjuhësore me vendin e tij të origjinës, mundësinë e familjes së tij të qëndrojnë në kontakt me të dhe fakti se ai është në gjendje të kërkojë leje për t'u kthyer në Austri më pak se pesë vjet pas dëbimit të tij. Si pasojë Gjykata konkludon se autoritetet nuk kanë tejkaluar hapësirën e vlerësimit që u është dhënë atyre në çështjet e imigracionit duke dëbuar ankuesin. Si pasojë nuk ka pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se nuk ka pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Kroon dhe të tjerët kundër Holandës - 18535/91

27 tetor 1994 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 8

Shkelje e te drejtës në jetë familjare si pasojë e mohimit të regjistrimit të atësisë / *ka shkelje*

Neni 14 kombinim me Nenin 8

Diskriminim në bazë të gjinisë si pasojë e pamundësisë të mohimit të atësisë / *nuk ka çështje të ndarë*

Fjalët kyçe: *fëmijë / jashtëmartesor / jetë familjare / atësi / mohim /lidhje biologjike / pamundësi regjistrimi*

Ankuesit: znj. Catharina Kroon (*ankuesja e parë*) shtetase holandeze e lindur në vitin 1954, z. Ali Zerrouk (*ankuesi i dytë*) i cili kishte shtetësinë marokene në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet që janë subjekt i ankesës dhe z. Samir M'Halle-Driss (*Ankuesi i tretë*), shtetësi të dyfishtë: holandeze dhe marokene

Faktet e rastit

Ankuesja e parë dhe ankuesi i dytë ndonëse ata nuk jetonin bashkërisht në atë kohë, ata kishin një marrëdhënie stabile nga e cila, në vitin 1987, kishte lindur fëmija i tyre - ankuesi i tretë në këtë rast. Të tre ankuesit jetojnë në Amsterdam.

Në vitin 1979, ankuesja e parë ishte martuar me ankuesin e dytë i cili në atë kohë ishte shtetas maroken. Martesa e tyre ishte prishur kah fundi i vitit 1980. Prej asaj kohe, ankuesja kishte jetuar e ndarë nga bashkëshorti i saj dhe e kishte humbur kontaktin me të. Siç del nga dëshmitë zyrtare, ai ishte larguar nga Amsterdam në janar të vitit 1986 dhe venddodhja e tij ka mbetur e panjohur që nga ajo kohë. Fëmija i tyre kishte lindur më 18 tetor 1987. Ai ishte regjistruar në regjistrin e lindjeve si djali i ankueses së parë dhe z. M'Halle-Driss.

Ankuesja e parë kishte nisur procedurat e shkurorëzimit në Gjykatën Rajonale të Amsterdimit një muaj pasi kishte lindur i biri. Shkurorëzimi kishte marrë formën përfundimtare kur vendimi i Gjykatës Rajonale ishte regjistruar në regjistrin e martesave më 4 korrik 1988.

Më 13 tetor 1988, mbështetur në Kodin Civil të Holandës, ankuesja e parë dhe ankuesi i dytë i kishin kërkuar zyrës së regjistrimit të lindjeve, vdekjeve dhe martesave të Amsterdimit që të lejonte ankuesen të bënte një deklaratë ku thuhej se z. M'Halle-Driss nuk ishte babai i Samirit dhe kështu të bënte të mundur njohjen e atësisë së ankuesit të dytë. Zyra kishte refuzuar kërkesën në tetor 1988. Ndonëse kishte shprehur simpati, regjistruesi kishte vërejtur se Samiri ka lindur në kohën kur ankuesja ishte ende e martuar me z. M'Halle-Driss, dhe derisa ky i fundit të mos niste procedurat për mohim të atësisë, njohja nga një njeri tjetër ishte e pamundur sipas ligjit që ishte në fuqi në Holandë.

Më 9 janar 1989, ankuesit aplikuan në Gjykatën Rajonale të Amsterdemit, ku kërkonin një urdhër gjyqësor me të cilin i kërkohej regjistruarit që të shtonte në regjistrin e lindjeve deklaratën e ankueses së parë se z. M'Halle-Driss nuk ishte babai i Samirit dhe ku njihej se ankuesi i dytë ishte babai i tij. Gjykata Rajonale kishte refuzuar kërkesën në qershor të vitit 1989. Gjykata kishte deklaruar se, pavarësisht dëshirës së justifikuar të ankuesve për t'ua njohur zyrtarisht realitetin biologjik, kërkesa e tyre duhej refuzuar, pasi sipas ligjit që ishte në fuqi, Samiri ishte fëmiju legjitim i z. M'Halle-Driss. Ankuesit e kanë apeluar këtë vendim pranë Gjykatës së Apelit të Amsterdemit. Gjykata e Apelit, gjithashtu, ka refuzuar apelin më 8 nëntor 1989. Sipas kësaj Gjykate, Neni 8 i Konventës ishte i aplikueshëm, por nuk ishte shkelur. Apeli nuk mund të miratohej, pasi gjykatat nuk kishin lirinë të lejonin kërkesën e ankuesve, pasi një gjë e tillë do të kërkonte miratimin e një ligji të ri në Holandë, përfshirë procedurat administrative. Prandaj, një gjë e tillë, sipas Gjykatës, do të kalonte kufijtë e pushtetit gjyqësor.

Ankuesit e kishin ankimuar edhe këtë vendim pranë Gjykatës Supreme. Në vijim të mendimit këshillëdhënës të Avokatit të Përgjithshëm, edhe Gjykata Supreme e kishte hedhur poshtë ankesën. Gjykata Supreme ishte pajtuar me Gjykatën e Apelit se, edhe po të kishte shkelje, zgjidhja e këtij problemi shkonte përtej kufijve të pushtetit gjyqësor.

Ankuesit kishin edhe tre fëmijë të tjerë pas lindjes së Samirit: një vajzë, Nadia, në vitin 1989, dhe dy binjakë, Jamal dhe Jamila, më 1992. Ata megjithatë nuk bashkëjetonin. Por, ata janë deklaruar, sidoqoftë, se ankuesi i dytë kontribuon në kujdesin dhe rritjen e fëmijëve të tyre.

Përmbledhje e pretendimeve

Në parashtresën e tyre, ankuesit kanë deklaruar se, sipas ligjit në fuqi në Holandë, nuk kanë qenë në gjendje të fitojnë njohjen e atësisë së Samirit nga ankuesi i dytë, babai i tij biologjik dhe derisa një burr i martuar mund të mohonte atësinë e një fëmiju, kjo mundësi nuk ishte e hapur për gratë e martuara. Ata e kanë mbështetur ankesën e tyre në Nenin 8 të Konventës, qoftë të marrë në mënyrë individuale apo në ndërlidhje ose kombinim me Nenin 14 të Konventës. Ata kanë argumentuar tutje se, duke mos pranuar këto kërkesa, Gjykata Supreme u ka mohuar atyre një mjet efektiv brenda kuptimit të Nenit 13.

Më 31 gusht 1992, Komisioni e shpalli ankesën e pranueshme në lidhje me ankesat që lidheshin me Nenin 8 dhe 14 të Konventës dhe të papranueshme në lidhje me pjesën tjetër, duke përfshirë Nenin 13.

Qeveria, nga ana e saj, ka deklaruar se në rastin konkret Neni 8 nuk ishte i zbatueshëm ose se Neni 8, paragrafi 1, nuk ishte çenuar, ose se kufizimi i të drejtave të referuara në Nenin 8 § 1 ishte i justifikueshëm në pajtim me Nenin 8 § 2 dhe se Neni 14, në kombinim me Nenin 8, nuk ishte shkelur. Qeveria kishte argumentuar se marrëdhënia ndërmjet ankuesit të dytë, në një anë, dhe ankueses së parë dhe ankuesit të tretë, në anën tjetër, nuk përbënte “jetë familjare”. Pasi fëmija kishte lindur nga një marrëdhënie jashtëmartesore, sipas Qeverisë, nuk kishte lidhje *ipso jure* ndërmjet tij dhe ankuesit të dytë. Për më tepër, Qeveria kishte argumentuar se ankuesja e parë dhe ankuesi i dytë kishin zgjedhur të mos martoheshin dhe si rezultat i kësaj zgjedhjeje, ky i fundit nuk

bashkëjetonte me ankuesen e parë dhe fëmiun. Qeveria, po ashtu, kishte pretenduar se zankuesi i dytë nuk kishte kontribuar në kujdesin dhe rritjen e Samirit në ndonjë mënyrë dhe se nuk kishte asgjë për të dëshmuar se ai kishte përmbushur rolin e “babait social” të tij.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata ka ritheksuar se objekti thelbësor i Nenit 8 është të mbrojë individin nga veprimi arbitrar i autoriteteve publike. Si shtesë e kësaj, mund të ketë edhe detyrime pozitive që rrjedhin nga “respektimi” efektiv i jetës familjare. Kufijtë ndërmjet detyrimeve pozitive dhe negative të shtetit sipas kësaj dispozitë nuk japin vetvetiu definicion të saktë. Parimet e aplikueshme janë megjithatë të ngjashme. Në të dyja kontekstet, duhet synuar një baraspeshë e drejtë ndërmjet interesave të individit dhe atyre të komunitetit si të tërë; dhe në të dyja rastet shteti gëzon një hapësirë vlerësimi.

Sipas parimeve të përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, kur ekzistenca e një lidhje familjare me një fëmijë është përcaktuar, shteti duhet të veprojë në një mënyrë që llogaritet se do të mundësojë atë lidhje të zhvillohet dhe garancionet ligjore të ofrohen, në mënyrë që të bëjnë të mundur integrimin e fëmiut në familje nga momenti i lindjes ose sa më parë që është praktikisht e mundur më pastaj.

Në rastin konkret, Gjykata ka rikujtuar se ndërmjet ankuesve është krijuar një marrëdhënie që e kualifikon atë si “jetë familjare”. Kësisoj, ekziston një detyrim për autoritetet kompetente që të lejojnë formimin komplet të lidhjeve familjare ligjore ndërmjet ankuesit të dytë dhe djalit të tij Samirit sa më shpejtë që është e mundur. Në pikëpamjen e Gjykatës, “respekti” për “jetën familjare” kërkon që realiteti social dhe biologjik të mbivlejnë mbi supozimin ligjor që, në rastin konkret, mbizotëron si ndaj faktit të mirëqenë ashtu dhe dëshirave të atyre që janë të përfshirë, duke bërë që askush të mos përfitojë. Në këtë mënyrë, Gjykata vjen në përfundimin se, edhe duke pas parasysh margjinën e vlerësimit që i takon shtetit, Holanda ka dështuar t’u sigurojë ankuesve “respektin” për jetën e tyre familjare për të cilën ata kanë të drejtë sipas Konventës. Pra, ka shkelje të Nenit 8.

Sa i përket pretendimit për shkelje të Nenit 14 në ndërlidhje me Nenin 8, Gjykata deklaroi se kjo ankesë është në thelb e njëjtë sikurse ajo mbi bazën e Nenit 8, prandaj nuk ka çështje të ndarë që rrjedhë nga ky nen, në kombinim me Nenin 14 të Konventës. Sa i përket dëmshpërblimit, Gjykata ka vlerësuar se pamundësia e njohjes ligjore të lidhjeve të tyre familjare u ka shkaktuar ankuesve frustrim. Megjithatë, ky frustrim është shpërblyer mjaftueshëm me gjetjen e një shkeljeje të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 8 të Konventës [*shtatë vota për / dy kundër*]; gjen se nuk ka çështje tjetër të ndarë që mund të ngritet mbi bazë të Nenit 14, në kombinim me Nenin 8 [*njëzëri*].

Neni 9

Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.
2. Liria e shfaqjes së fesë së tij ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve.

Hasan and Eylem Zengin kundër Turqisë - 1448/04

9 tetor 2007 [Seksioni i dytë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 9

Shkelje e të drejtës për liri fetare si pasojë e formës së edukimit fetar të detyruar / *nuk ngritet çështje ndaras*

Neni 2 i Protokollit Nr. 1

Mungesë e objektivitetit në programet e edukimit fetarë të ofruara në shkolla / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *liri fetare / edukim fetar / zgjedhje / prindër / objektivitet / edukim i njëanshëm / detyrim*

Ankuesit: Hasan Zengin dhe vajza e tij Eylem Zengin, janë shtetas turq që kanë lindur në 1960 dhe 1988, dhe jetojnë në Stamboll

Faktet e rastit

Ankuesi dhe familja e tij janë pasues të Alevizmit, një degë e Islamit e cila ka rrënjë të thella në shoqërinë dhe historinë turke dhe përfaqëson një nga besimet më të përhapura në Turqi (pas degës Hanefiite të Islamit, e cila është një nga katër shkollat e Sunit islam). Alevizmi ishte i ndikuar nga disa besime para-islame dhe nga dy Sufitë të mëdhenj të shekujve XII dhe XIV. Praktikantët e saj fetare ndryshojnë nga ato të shkollave sunitë në aspekte të caktuara siç janë lutja, agjërimi dhe pelegrinazhi. Në veçanti, sipas ankuesit, Alevizi nuk falet pesë herë në ditë si në ritin sunit, por shprehin përkushtimin e tyre nëpërmjet këngëve dhe vallëzimeve fetare (semah); ata nuk marrin pjesë në xhami, por takohen rregullisht në cemevi (takim në dhoma adhurimi); dhe, nuk e konsiderojnë pelegrinazhin në Mekë si një detyrim fetar.

Në kohën kur është paraqitur kjo kërkesë, vajza e ankuesit ishte duke ndjekur klasën e shtatë të shkollës shtetërore në Avcılar, Stamboll. Si nxënës në një shkollë shtetërore, ajo ishte e detyruar të ndiqte mësimet në kulturën dhe etikën fetare. Sipas Nenit 24 të Kushtetutës së Turqisë dhe Nenit 12 të Ligjit Themelor nr. 1739 mbi edukimin kombëtar, kulturën fetare dhe etikën, kjo ishte lëndë e detyrueshme në shkollat fillore dhe të mesme turke.

Në vitin 2001, ankuesi paraqiti kërkesë në Drejtorinë e Arsimit Kombëtar dhe para gjykatave administrative që vajza e tij të përjashtohet nga mësimet për kulturën dhe etikën fetare. Duke vënë në dukje se familja e tij ishte pasuese e alevizmit, ai pretendoi se, sipas traktateve ndërkombëtare si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, prindërit kishin të drejtë të zgjedhin llojin e edukimit që fëmijët e tyre do të merrnin. Ai gjithashtu pohoi se kursi në fjalë ishte i papajtueshëm me parimin e sekularizmit dhe nuk ishte asnjanshëm, pasi ai ishte në thelb i bazuar në mësimin e islamit sunit.

Të gjitha kërkesat e tij u hodhën poshtë, së fundi, në apel para Gjykatës së Lartë Administrative me vendimin e 5 gushtit 2003, me arsyetimin se kursi në kulturën dhe etikën fetare ishte në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin turk.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit pohonin në mënyrë të veçantë se mënyra në të cilën u mësua kultura dhe etika fetare në Turqi shkeli të drejtën e ankueses për lirinë e fesë dhe të drejtën e prindërve të saj për të siguruar arsimimin e saj në përputhje me bindjet e tyre fetare të garantuara sipas Nenit 2 të Protokollit Nr. 1 të Konventës (e drejta për arsim) dhe Nenit 9 të Konventës (liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë). Ankuesit në mënyrë të dukshme pretendonin se programi i kursit kishte mungesë objektiviteti, sepse nuk përfshiheshin informata të hollësishme për fetë e tjera dhe u mësuan nga një perspektivë fetare që vlerësoi interpretimin sunnit të besimit dhe traditës islame.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me Nenin 2 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, së pari, Gjykata vendosi nëse përmbajtja e lëndës u mësua në mënyrë *objektive, kritike dhe pluraliste*. Për këtë qëllim, Gjykata shqyrtoi udhëzimet e Ministrisë së Arsimit për mësimet në kulturën dhe etikën fetare dhe tekstet shkollore të paraqitura nga ankuesit. Gjykata konstatoi se planprogrami për mësimdhënie në shkollat fillore dhe ciklin e parë të shkollës së mesme dhe tekstet përkatëse u dhanë prioritet më të madh njohjes së Islamit sesa asaj të feve dhe filozofive të tjera. Në veçanti, planprogrami përfshinte studimin e profetit Muhamed dhe Kuranit. Nxënësit duhej të mësonin disa sure nga Kurani përmendësh dhe të studionin me mbështetjen e ilustrimeve, lutjeve të përditshme. Ata gjithashtu duhej të bënin teste me shkrim. Tekstet nuk dhanë vetëm një pasqyrë të përgjithshme të feve, por ofruan udhëzime specifike në parimet kryesore të besimit musliman, duke përfshirë ritet e tij kulturore, siç është profesioni i besimit, pesë lutjet e përditshme, Ramazani, pelegrinazhi, konceptet e engjëjve dhe krijesa të padukshme dhe besim në botën tjetër.

Nga ana tjetër, nxënësit nuk morën mësim mbi specifikat konfesionale ose rituale të besimit Alevi, edhe pse pasuesit e tij përfaqësonin një pjesë të madhe të popullsisë turke. Informacioni rreth Alevizmit u mësua në klasën e 9-të. Gjykata, ashtu si ankuesit, konsideroi se fakti që jeta dhe filozofia e dy Sufive të mëdhenj, të cilët kishin pasur një ndikim të madh në lëvizje, u mësua me një vonesë të tillë, ishte e pamjaftueshme për të kompensuar mangësitë e mësimit gjatë shkollës fillore dhe të mesme. Prandaj, Gjykata gjeti se mësimet e kulturës fetare dhe etikës në Turqi nuk mund të konsideroheshin të përmbushnin kriteret e objektivitetit dhe pluralizmit të nevojshëm për arsimin në një shoqëri demokratike dhe për nxitësit që të zhvillonin një mendje kritike ndaj fesë. Në rastin e ankuesve, mësimet nuk i respektonin bindjet fetare dhe filozofike të babait të ankueses.

Së dyti, Gjykata shqyrtoi nëse ekzistonin *mjete të përshtatshme* në sistemin arsimor turk për të siguruar respektimin e bindjeve të prindërve. Pas një vendimi të Këshillit të Lartë për Arsimin të Korrikut 1990, ishte e mundur që fëmijët "me kombësi turke që i përkisnin fesë së krishterë apo judaike" të përjashtoheshin nga mësimet e kulturës fetare dhe etikës. Ky vendim domosdoshmërisht sugjeroi se mësimet mund të krijonin

konflikt për fëmijët e krishterë ose hebrenj mes mësimit fetar të dhënë nga shkolla dhe bindjeve fetare ose filozofike të prindërve të tyre. Sikurse edhe Komisioni Evropian i Këshillit të Evropës kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), Gjykata konsideroi se kjo situatë ishte e hapur për kritika: nëse lënda kishte për qëllim të kishte lidhje me kulturat e ndryshme fetare, nuk kishte arsye për ta bërë atë të detyrueshme vetëm për fëmijët muslimanë. Fakti që prindërit ishin të detyruar të informonin autoritetet shkollore për bindjet e tyre fetare ose filozofike ishte një mënyrë e papërshtatshme për të siguruar respektin për lirinë e bindjes. Për më tepër, në mungesë të ndonjë teksti të qartë, autoritetet e shkollës gjithmonë kishin mundësinë të refuzonin kërkesat për përjashtim, si në rastin e ankueses.

Rrjedhimisht, Gjykata konsideroi se procedura e përjashtimit nuk përdorte metoda të përshtatshme dhe nuk siguroi mbrojtje të mjaftueshme për ata prindër që mund të konsideronin në mënyrë të ligjshme se lënda që mësohej ka të ngjarë të ngrejë një konflikt vlerash në fëmijët e tyre. Kjo ndodhte sidomos kur nuk ishte parashikuar asnjë zgjedhje për fëmijët e prindërve që kishin bindje fetare ose filozofike ndryshe nga ajo e Islamit suni dhe ku procedura e përjashtimit përfshinte barrën e rëndë të zbulimit të bindjeve të tyre fetare ose filozofike. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të Nenit 2 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.

Lidhur me Nenin 9 të Konventës, duke pasur parasys se tanimë kishte gjetur shkelje të Nenit 2 të Protokollit 1 të Konventës lidhur me të drejtat e edukimit fetar, Gjykata konsideroi se asnjë çështje e veçantë nuk u ngrit në bazë të Nenit 9 të konventës.

Po ashtu, Gjykata vendosi që Turqia duhet t'i paguajë bashkërisht ankuesve, brenda tre muajve nga data në të cilën aktgjykimi bëhet i formës së prerë sipas Nenit 44 § 2 të Konventës, 3,726,80 EUR në lidhje me shpenzimet gjyqësore, ku më pak se 850 EUR dedikohen për ndihmë juridike.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 2 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, dhe pohoi se asnjë çështje e veçantë nuk u ngrit në bazë të Nenit 9 të Konventës [njëzëri].

Buscarini dhe të tjerët kundër San Marinus - 24645/94

18 shkurt 1999 [Dhoma e Madhe]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 9

Shkelje e së drejtës së lirisë së fesë si pasojë e detyrimi i anëtarëve të zgjedhur në Parlamentit që të betoheshin në Bibël si kusht për emërimin e tyre në detyrë përbën / ka shkelje

Fjalët kyçe: betim / parlament / zgjedhje / detyrim / ungjill / liri e fesë / jo-fetarë / laicitet / traditë

Ankuesit: z. Christoforo Buscarini, z. Emilio Della Balda dhe z. Dario Manzaroli, tre shtetasë të San Marinus:

Faktet e rastit

Ankuesit ishin zgjedhur në Këshillin e Madh të Përgjithshëm (emri zyrtar për Parlamentin e Republikës së San Marinus) në zgjedhjet e mbajtura më 30 maj 1993. Menjëherë pas zgjedhjeve, ata kishin kërkuar nga krerët e qeverisë në San Marino, që të japin betimin në bazë të Nenit 55 të Aktit të Zgjedhjeve, duke mos iu referuar asnjë teksti religjioz. Akti në fjalë i referohej një dekreti të 27 qershorit 1909, që përshkruante tekstin e betimit të cilin duhet ta lexonin anëtarët e Parlamentit të Republikës. Ky tekst kishte këtë përmbajtje: “Unë... betohem në Ungjijtë e Shenjtë që do të jem gjithmonë besnik dhe do të ndjek Kushtetutën e Republikës...”

Në mbështetje të kërkesës së tyre, ankuesit kishin përdorur Nenin 4 të Deklaratës së të Drejtave të San Marinus të vitit 1974, që garantonte lirinë e fesë, dhe Nenin 9 të Konventës.

Në mbledhjen e Parlamentit të datës 18 qershor 1993, ankuesit dhanë betimin në formë të shkruar, në formën e fjalëve të përcaktuara në dekretin e 27 qershorit 1909, me të vetmin dallim përjashtimin e fjalëve Ungjijtë e Shenjtë, që ata i kishin shmangur. Në të njëjtën kohë, ankuesi i parë kishte tërhequr vëmendjen te detyrimet e ndërmarra nga Republika e San Marinus kur ajo ishte bërë palë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Më 12 korrik 1993, Sekretariati i Parlamentit, pas kërkesës së krerëve të qeverisë, kishte lëshuar një opinion në lidhje me formën e betimit të dhënë nga ankuesit, ku kishte konstatuar së betimi i tyre ishte i pavlefshme. Çështja i ishte referuar Parlamentit.

Në mbledhjen e 26 korrikut 1993, Parlamenti miratoi një rezolutë të propozuar nga krerët e qeverisë, e cila i urdhëronte ankuesit që të jepnin sërish betimin, këtë herë në Ungjijtë e Shenjtë, nën rreziku për humbjes së ulëseve të tyre parlamentare. Ankuesit i ishin bindur urdhërit dhe kishin dhënë betimin me tekstin që përmbante Ungjijtë e Shenjtë, ndonëse me ankesën se u ishte cënuar drejta për lirinë e fesë dhe të ndërgjegjes.

Më pas, ankuesit dorëzuan ankesën e tyre pranë Komisionit më 17 nëntor 1995. Duke u mbështetur në Nenin 9, ata u ankuan për shkelje të së drejtës së tyre në liri të fesë dhe të ndërgjegjes. Komisioni e shpalli ankesën të pranueshme më 7 prill 1997. Në raportin e tij të 2 dhjetorit 1997, Komisioni njëzëri kishte ardhur në përfundimin se ka shkelje të Nenit 9. Qeveria kishte ngritur tri kundërshtime paraprake dhe i kishte kërkuar Gjykatës që të shpallte ankesën të papranueshme ose, si alternativë, ta hidhte poshtë si të pabazuar. Ankuesit, nga ana tyre, i kishin kërkuar Gjykatës që të hidhte poshtë kundërshtitë e Qeverisë në lidhje me pranueshmërinë dhe të gjente se ka shkelje të Nenit 9 të Konventës.

Përmbledhje e pretendimeve

Në parashtrësën e saj, Qeveria kishte argumentuar se ankesa paraqiste abuzim të procesit, se ishte dorëzuar jashtë afatit kohor dhe mjetet e brendshme juridike nuk ishin shteruar. Pra, Qeveria pretendonte se ankuesit e kishin paraqitur rastin në mënyrë jo të duhur për qëllime politike, siç do të mund të vërehej nga deklaratat e tyre rreth qëllimit për të paraqitur rastin para Komisionit. Gjykata, njësoj si Komisioni, e kishte hedhur poshtë këtë pretendim, duke deklaruar se pohimi i ankuesve për të sjellë çështjen në vëmendjen e Gjykatës paraqet një veprim i cili nuk përbën abuzim të së drejtës për ankesë individuale. Gjykata, po ashtu, kishte vlerësuar se ankesa është paraqitur brenda afatit të përcaktuar kohor dhe se Qeveria nuk kishte dëshmuar se mjetet e brendshme juridike janë efektive.

Sa u përket meritave të rastit, ankuesit kishin argumentuar se detyrimi i imponuar ndaj tyre nga Parlamenti i Republikës dëshmonte se në San Marino në kohën përkatëse ushtrimi i një të drejte themelore politike, siç ishte detyra e parlamentarit, ishte e kushtëzuar me të praktikuarit publik të një feje të caktuar, në shkelje të Nenit 9 të Konventës.

Qeveria e kishte kundërshtuar, duke argumentuar se, teksti i betimit nuk ishte fetar, por më tepër kishte rëndësi historike dhe shoqërore dhe ishte i mbështetur në traditë. Republika e San Marinos pranohej që ishte themeluar nga një njeri i fesë, por ishte shtet sekular në të cilin liria e fesë shprehimisht garantohej në ligj (Neni 4 i Deklaratës së të Drejtave të vitit 1974). Qeveria kishte nënvizuar rëndësinë që në një vend demokratik ka dhënia e betimit të përfaqësuesve të popullit, e cila do të duhej të ishte një zotim ndaj lojalitetit të vlerave të Republikës. Sipas Qeverisë, historia dhe traditat e San Marinos ishin të lidhura me krishterimin, pasi shteti ishte themeluar nga një shenjtor.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata ka ritheksuar si fillim parimet relevante të praktikës së saj gjyqësore, ku kishte konstatuar se sikurse edhe përcaktohet në Nenin 9 të Konventës, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë është një nga themelet e një "shoqërie demokratike" brenda kuptimit të Konventës. Përderisa kjo liri është, në dimensionin e saj fetar, një nga elementët më jetikë që përbëjnë identitetin e besimtarëve dhe konceptin e tyre të jetës, është gjithashtu një pasuri e çmuar për ateistët, agnostikët, skeptikët dhe të

paidentifikuarit.⁵⁴ Gjykata tutje vëren se argumentet e Qeverisë ishin përqendruar në rëndësinë që kishte dhënia e betimit nga përfaqësuesitë e zgjedhur të popullit në karakterin e veçantë të San Marinos, historinë dhe traditat kombëtare të së cilës ishin të lidhura me krishterimin pasi republika ishte themeluar nga një i shenjtë; dhe deklarimi se rëndësia fetare e betimit tashmë ishte zëvendësuar nga “nevoja për të ruajtur rendin publik, në formën e kohezionit shoqëror dhe besimin e qytetarëve në institucionet e tyre tradicionale”.

Duke i trajtuar këto pika, Gjykata ka vërejtur se, pavarësisht nëse qëllimet e Qeverisë janë legjitime apo jo—një çështje për të cilën Gjykata nuk e ka parë të nevojshme të vendosë—nuk kishte dyshim se, në përgjithësi, ligji i San Marinos garantonte lirinë e ndërjegjes dhe të fesë. Në rastin aktual, sidoqoftë, kërkesa që ankuesit të jepnin betimit mbi Ungjijtë e Shenjtë ishte e barazvlershme me kërkesën që dy përfaqësuesë të zgjedhur të popullit të betoheshin për besnikëri ndaj një feje të caktuar. Një kërkesë e tillë nuk ishte e përputhshme me Nenin 9 të Konventës.

Gjykata është pajtuar me deklaratën e Komisionit të bërë në raportin e tij se do të ishte kundëthënëse që të kushtëzoje ushtrimin e mandatit që do të kishte qëllim të përfaqësonte pikëpamje të ndryshme të shoqëriës në Parlament me një deklaratë paraprake të zotimit ndaj një sërë besimesh të caktuara. Kufizimi ndaj të cilit janë ankuar parashtruesitë e ankesës nuk mund të shihet si “i domosdoshëm në një shoqëri demokratike”.

Ndërkaq, në lidhje me argumentin e Qeverisë se ankesa kishte pushuar së pasuri ndonjë qëllim, pasi tashmë ishte miratuar një ligj i ri, Gjykata ka vlerësuar se betimi në rastin konkret është dhënë para miratimit të këtij legjislacioni. Për të gjitha arsytet si më sipër, Gjykata ka gjetur shkelje të Nenit 9 të Konventës.

Sa i përket dëmshpërblimit, Gjykata ka vlerësuar se në rrethanat e rastit, gjetja e shkeljes së Nenit 9 të Konventës përbën satisfaksion mjaftueshëm të drejtë. Ndërkaq, në lidhje me kostot dhe shpenzimet, ankuesit nuk kanë saktësuar shumën e pretenduar dhe si pasojë Gjykata i ka hedhur poshtë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 9 të Konventës [njëzëri].

⁵⁴ *Kokkinakis kundër Greqisë*, aktgjykimi i datës 25 maj 1993, Seria A nr. 260-A, p. 17, § 31

Bayatyan kundër Armenisë - 23459/03

7 korrik 2011 [Dhoma e Madhe]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 9

Pretendim për shkelje të së drejtës për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë si pasojë e dënimit për refuzim për të shërbyer në ushtri / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *shërbim ushtarak / detyrim / kundërshtim i ndërgjegjshëm / bindje fetare / refuzim / ndjekje / dënim / dëshmitar i Jehovahit*

Ankuesi: z. Vahan Bayatyan, shtetas i armenisë

Faktet e rastit

Ankuesi ishte Dëshmitari i Jehovahit, dhe prej vitit 1997 mori pjesë në shërbesa të ndryshme fetare të Dëshmitarëve të Jehovahit dhe u pagëzua më 18 shtator 1999 në moshën 16 vjeç. Në janar të vitit 2000 ankuesi u regjistrua si person përgjegjës për shërbimin ushtarak me Komisariatin Ushtarak të Qarkut Erebusi. Në Prill 2001, ankuesi i dërgoi letra identike Prokurorit të Përgjithshëm të Armenisë, Komisionerit Ushtarak të Armenisë dhe në Komisionin e të Drejtave të Njeriut të Asamblesë Kombëtare, ku njoftoi këto të fundit për shkollimin e tij fetar bazuar në bindjet e tij dhe me vetëdije nuk pranoi të kryej shërbimin ushtarak. Në të njëjtën kohë i informoi organet e njejta se ishte i gatshëm të kryej shërbimin civil alternativ në vend të shërbimit ushtarak.

Në maj 2001 ankuesi pranoi një thirrje për t'u paraqitur për shërbimin ushtarak. Më tutje, në maj 2001, një oficer i Komisarariatit Ushtarak Erebusi telefonoi shtëpinë e ankuesit dhe e pyeti nënën e tij nëse ai ishte i vetëdijshëm se ai ishte thirrur të paraqitej në Komisariat për të filluar shërbimin ushtarak të nesërmen. Në të njëjtën mbrëmje, ankuesi përkohësisht u largua nga shtëpia e tij nga frika se do të merrej me forcë në ushtri.

Zyrtarët e Komisarariatit gjat muajit Maj 2001, përsëri telefonuan nënën e ankuesit, duke kërkuar të dinë vendndodhjen e tij. Ata kërcënuan se do ta çonin në ushtri me forcë nëse nuk do të vinte vullnetarisht. Më 17 maj 2001, herët në mëngjes, zyrtarët erdhën në shtëpinë e ankuesit. Prindërit e tij ishin në gjumë dhe nuk e hapën derën. Në të njëjtën datë, nëna e ankuesit shkoi në Komisariatin ku ajo deklaroi se ankuesi ishte larguar nga shtëpia dhe nuk e dinte kur do të kthehej. Ankuesi pohoi se Komisariatin nuk bëri përpjekje të mëtejshme për të kontaktuar familjen e tij.

Më 29 maj 2001, Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore dhe Shtetërore i dërgoi një përgjigje letrës së ankuesit të 1 prillit 2001, duke deklaruar se në përputhje me legjislacionin e Republikës së Armenisë, çdo qytetar... është i detyruar të shërbejë në ushtrinë Armene. Meqë asnjë ligj nuk është miratuar ende në Armeni për shërbimin alternativ, ankuesi duhet t'i nënshtrohet ligjit aktual dhe të shërbejë në ushtrinë Armene. Në fillim të qershorit 2001, ankuesi u kthye në shtëpi, ku jetoi deri në arrestimin e tij në shtator të vitit 2002. Më 26 qershor 2001, komisarit ushtarak i

Erebunit njoftoi Prokurorin e Rrethit se ankuesi nuk kishte raportuar për shërbimin ushtarak më 15 maj 2001 dhe ishte qëllimisht duke shmangur shërbimin në ushtri. Më 1 gusht 2001 hetuesi filloi procedurën penale sipas Nenit 75 të Kodit Penal, ndaj të ciles procedure ankuesi ngriti ankesë pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Ai nuk mori përgjigje për këtë ankesë. Më 1 tetor 2001, hetuesi lëshoi pesë vendime në lidhje me ankuesin: (1) të paraqiste një padi kundër projektvendimit kundër ankuesit sipas Nenit 75 të Kodit Penal; (2) të aplikojë në gjykatë për autorizim për paraburgimin e ankuesit; (3) të deklarojë ankuesin si të arratisur dhe të krijojë një kërkim për të; (4) të aplikojë në gjykatë për autorizim për të monitoruar korrespondencën e ankuesit; dhe (5) të pezullohet procedura derisa të jetë gjetur ankuesi. Por as ankuesi e as familja e tij nuk ishin njoftuar për këto vendime, pavarësisht nga fakti se që nga mesi i qershorit 2001 ai kishte jetuar në shtëpinë e familjes dhe se ai kishte takuar hetuesin disa herë në korrik dhe gusht 2001. Më 4 shtator 2002, dy policë shkuan në shtëpinë e ankuesit për ti njoftuar prindërit e tij se ai ishte në listën e të kërkuarve. Më 5 shtator 2002, policët e shoqëruan ankuesin në një stacion lokal të policisë, ku ata hartuan një dokument të dorëzimit vullnetar të ankuesit, i cili deklaroi se pasi dinte se ishte në listën e kërkuarve, vendosi të paraqitet në stacionin policor. Në të njëjtën datë, ankuesi ishte vendosur në objektin e paraburgimit Nubarashen.

Përmbledhje e pretendimeve

Sa i përket aplikimit të Nenit 9 të Konventës, ankuesi pretendoi se, institucionet vendore kishin refuzuar të zbatojnë doktrinën e "instrumentit të gjallë", pë Konventen Evropiane, duke e kristalizuar kështu interpretimin e bërë nga Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut në atë që Neni 4 § 3 (b) kufizoi zbatueshmërinë e Nenit 9 ndaj 'kundërshtarëve të ndërgjegjshëm' pa arsytet apo shpjegim. Megjithatë, Neni 4 § 3 (b) nuk mund të përdoret për të mohuar të drejtën për kundërshtim të ndërgjegjshëm sipas Nenit 9, sidomos në rastin e Armenisë. Gjithashtu, duke u bazuar në parimet e *travaux-ve*, ankuesi pretendonte se Neni 4 § 3 (b) nuk ishte menduar kurrë të lexohej në lidhje me Nenin 9. Qëllimi i tij i vetëm ishte të kufizonte të drejtën e garantuar me Nenin 4 § 2 dhe as nuk njihej dhe as nuk u përjashtua e drejta për kundërshtim të ndërgjegjshëm, në këtë rast për shërbim në ushtri. Neni 4 § 3 (b) nuk zbatohet në dispozitat e tjera të Konventës dhe nuk kishte arsye për të që të zbatohet edhe për Nenin 9. Sipas ankuesit, kushtet e sotme mbështetën njohjen e të drejtës për kundërshtim të ndërgjegjshëm për shërbim në ushtri sipas Nenit 9, duke marrë parasysh njohjen graduale të kësaj të drejte në pothuajse të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Ky konsensus u pasqyrua edhe në pozitën e organeve të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian. Për më tepër, njohja e të drejtës për kundërshtim të ndërgjegjshëm ishte bërë një nga parakushtet për shtetet e reja anëtare që dëshironin të bashkohen me Këshillin e Evropës. Ankuesi në fund pretendoi se çështja shkonte përtej rastit të tij, pasi kishte pasoja serioze që preknin qindra të rinj në një situatë të ngjashme në Këshillin e Evropës dhe mijëra të tjerë në mbarë botën.

Sa i përket pajtueshmërisë së veprimeve të autoriteteve Armene me Nenin 9, ankuesi pohoi se dënimi i tij ishte një ndërhyrje në të drejtën e tij për të manifestuar besimet e tij fetare. Kjo ndërhyrje nuk ishte përcaktuar me ligj sepse autoritetet armene, duke e dënuar atë, kishin vepruar në kundërshtim me angazhimin ligjërish të detyrueshëm që

kishin ndërmarrë kur hynë në Këshillin e Evropës, përkatësisht për të falur të gjithë kundërshtuesit e ndërgjegjshëm të dënuar me burg. Ky detyrim ndërkombëtar ishte bërë pjesë përbërëse e sistemit ligjor vendas të Armenisë dhe prej atëherë të gjithë kundërshtuesit e ndërgjegjshëm që refuzuan të kryenin shërbimin ushtarak mund të arsyetonin se do të liroheshin nga ky detyrim dhe më pas do t'i jepej mundësia e kryerjes së shërbimit alternativ civil. Si rezultat, ligji i brendshëm nuk ishte mjaft i saktë, pasi nuk ishte i harmonizuar me angazhimet ligjore të Armenisë. Ankuesi më tej pohoi se ndërhyrja nuk ishte e përcaktuar me ligj edhe pse Armenia, pasi u bë palë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) në 1993, nuk kishte arritur të ishte besnikë ndaj Nenit 18 të saj dhe jurisprudencës pasuese të UNHRC siç kërkohet me standardet që parshihen në kuadër të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë. Ankuesi më tej argumentoi se ndërhyrja nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Së pari, fakti që ai - një kundërshtues i ndërgjegjshëm i cili ishte zotuar të jetonte në mënyrë paqësore me fqinjët e tij dhe që kishte një dosje penale të paster - ishte burgosur dhe trajtuar si një kriminel i rrezikshëm, duke u mbyllur në një qeli pa asnjë shtrat dhe me gjashtë të tjerë të arrestuar për krime të ndryshme dhe i ishte nënshtruar ofendimeve dhe abuzimeve verbale nga rojet. Së dyti, ai u ankua se i ishte nënshtruar dënimit dhe trajtimit tërësisht joproporcional, duke pasur parasysh se ai thjesht po ushtronte të drejtën e tij themelore për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Së treti, se burgimi i tij nuk ishte i nevojshëm edhe për shkak se autoritetet armene kishin falur individë të tjerë në një situatë të ngjashme. Së fundmi, mbrojtja ushtarake e vendit nuk do të ishte e çorganizuar dhe dobësuar nëse personat si ai nuk do të ndëshkoheshin. Në veçanti, Armenia kishte 125.000 rekrutë aktivë në vitin 2007 dhe 551.000 të mundshëm, ndërsa vetëm 41 Dëshmitarë të Jehovait u burgosën. Për më tepër, që nga viti 2002 vetëm tre individë që u përkisnin feve të tjera kishin vendosur të bëheshin kundërshtarë të ndërgjegjshëm. Këto numra nuk mund të kenë një ndikim negativ në kapacitetin ushtarak të Armenisë. Qeveria kundërshtoi keto pretendime. Pranë Gjykatës qëndrime të përbashkëta në cilësi të palëve të treta paraqitën Amnesty International, Conscience and Peace Tax International, Friends World Committee for Consultation (Quakers), International Commission of Jurists, and War Resisters' International. Keto organizata ndërhyrëse ofruan një pasqyrë të përgjithshme të njohjes graduale të së drejtës për kundërshtim me ndërgjegje në nivel ndërkombëtar dhe rajonal. Në nivel ndërkombëtar, ata u përqendruan në veçanti në zhvillimet në jurisprudencën e UNHRC dhe interpretimin e saj të dispozitave homologe të KNDCP-së. Ata u referuan më tej zhvillimeve përpara organeve të tjera të Kombeve të Bashkuara, siç është Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Grupi i Punës për Paraburgimin Arbitrar. Në nivel rajonal, organizatat ndërhyrëse i referoheshin në veçanti zhvillimeve para organeve të Këshillit të Evropës, veçanërisht rekomandimeve të tyre duke kërkuar njohje dhe mbrojtje më të madhe të së drejtës për kundërshtim të ndërgjegjes.

Gjithashtu edhe Asociacioni Evropian e Dëshmitarëve Kristian të Jehovait (European Association of Jehovah's Christian Witnesses) në cilesinë e organizates ndërhyrëse i bëri thirrje Dhomës së Madhe të zbatojë doktrinën e "instrumentit të gjallë" dhe të sjellë të drejtën në përputhje me kushtet e sotme. Kjo organizate argumentoi se imperativi i mbrojtjes së shteteve anëtare nuk ishte më i zbatueshëm në nivelin që

mbizotëronte në kohën e vendimeve më të hershme mbi këtë çështje dhe nevoja për të bërë aranzhime për shërbimin kombëtar mund të plotësoheshin nga shtetet anëtare pa i anashkaluar të drejtat e garantuara me Nenin 9.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata vëren se ankuesi ishte dënuar për refuzimin e tij për të kryer shërbimin ushtarak të detyruar për shkak se ishte kundër bindjeve të tij fetare si Dëshmitare e Jehovahit. Ankuesi kërkoi nga Gjykata që të shqyrtojë praktikën gjyqësore të Konventës në lidhje me çështjen e kundërshtimit të ndërgjegjshëm dhe zbatueshmërisë së Nenit 9 për këtë çështje, duke u mbështetur në doktrinën e "instrumentit të gjallë".

Gjykata përsërit se Konventa është një instrument i gjallë i cili duhet të interpretohet në dritën e kushteve të sotme. Është e ligjshme kur vendoset nëse një masë e caktuar është e pranueshme sipas një prej dispozitave të saj të merren parasysh standardet që mbizotërojnë midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

Gjykata nuk e mohon që shumica e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës kanë miratuar ligje që parashikojnë forma të ndryshme të shërbimit alternativ për kundërshtarët e ndërgjegjës. Në të njëjtën kohë, Gjykata nuk mund të anashkalojë dispozitat e Nenit 4 § 3 (b) të Konventës. Gjykata është e mendimit se pasi që ky nen ka lënë në mënyrë të qartë zgjedhjen e njohjes së kundërshtuesve të ndërgjegjshëm për secilën Palë Kontraktuese, fakti që shumica e Palëve Kontraktuese e kanë njohur këtë të drejtë nuk mund të mbështeten në mbajtjen përgjegjëse të një Pale Kontraktuese e cila nuk e ka bërë këtë në kundërshtim me detyrimet e Konventës. Rrjedhimisht, sa i përket kësaj çështjeje të veçantë, ky faktor nuk mund të shërbejë si një qëllim i dobishëm për interpretimin evolutiv të Konventës. Në rrethana të tilla, Gjykata konkludon se Neni 9, i lexuar në bazë të Nenit 4 § 3 (b), nuk garanton të drejtën e refuzimit të shërbimit ushtarak për arsye të ndërgjegjes.

Gjykata vëren se në kohën materiale nuk u njoh në Armeni e drejta për kundërshtim me ndërgjegje. Nga ana tjetër, Armenia u angazhua zyrtarisht për të njohur të drejtën ligjore ndërkombëtare dhe - në ndërkohë - t'i falte të gjithë kundërshtuesit e dënuar të ndërgjegjshëm, duke i lejuar ata të kthehen në vend të tyre pasi kishte hyrë në fuqi ligji për të kryer shërbimin civil alternativ. Gjykata nuk dyshon se kundërshtimi i ankuesit për shërbimin ushtarak të detyruar bazohet në bindjet e tij të vërteta fetare dhe pranon që vetë fakti që Armenia, me deklaratën e saj, u angazhua zyrtarisht ndërkombëtarisht, duhet t'i ketë dhënë një pritje të ligjshme ankuesit që ti lejohet të kryejë shërbim alternativ pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri, në vend që të kryejë dënimin me burg. Gjykata më tej vëren faktin se një ligj për shërbimin alternativ tashmë është miratuar në Armeni, duke njohur kështu të drejtën për kundërshtim të ndërgjegjshëm. Megjithatë, Gjykata konsideron se përmbajtja e këtij ligji dhe mënyra e zbatimit të tij në praktikë bien përtej fushëveprimit të kësaj kërkesë. Sidoqoftë, Gjykata është e mendimit se dënimi i ankuesit për kundërshtim të ndërgjegjshëm ishte në konflikt të drejtpërdrejtë me politikën zyrtare të reformës dhe ndryshimet legjislative që po zbatoheshin në Armeni. Andaj Gjykata konsideron se dënimi i ankuesit përbën një ndërhyrje që nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike në kuptim të nenit 9 të Konventës. Prandaj, ka pasur një shkelje të kësaj dispozite.

Gjykata, bazuar në Nenin 41 të Konventës, i caktoi ankuesit 10,000 EUR për dëmet jo-materiale, dhe 10,000 EUR për shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 9 të konventës [*gjashtëmbëdhjetë vota për / një kundër*].

Hasan dhe Chaush kundër Bullgarisë - 30985/96

26 tetor 2000 [Gjykata]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6

Mungesë e qasjes në gjykatë për të adresuar shkeljen e të drejtave të tyre / *nuk ka shkelje*

Neni 9

Shkelje e lirive fetare si pasojë e ndërhyrjes së autoriteteve shtetërore në organizimin e komunitetit fetarë / *ka shkelje*

Neni 11

Shkelje e të drejtës në asociim si pasojë e ndërhyrjes në organizimin e brendshëm nga ana e shtetit / *nuk ngritet çështje ndaras*

Neni 13

Mjetet ekzistuese ligjore nuk përbënin mjete efektive / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *liri fetare / bashkësi fetare / regjistrim i udhëheqjes / vullnet i bashkësisë / organizim i brendshëm / ndërhyrje / mos-regjistrim / mjet efektiv*

Ankuesit: *z. Fikri Sali Hasan (ankuesi i parë), z. Ismail Ahmed Chaush (ankuesi i dytë)*

Faktet e rastit

Ankuesi i parë ishte shefi i myftiut të muslimanëve bullgarë që nga 1992 deri në parashtrimin e ankesës, ndërsa ankuesi i dytë ishte më parë mësues në Institutin Islamik në Sofje. Në parashtrirat e tij në Gjykatë, ankuesi i dytë deklaroi se që nga shkurti i vitit 1995 kishte punuar gjithashtu me kohë të pjesshme si sekretar i Zyrës së Krye-Muftiut, udhëheqjes kombëtare të organizatës fetare muslimane dhe redaktorit të Musulmanit, që ishte gazetën e organizatës. Qeveria i kundërshtoi këto pohime.

Në vitin 1992, konferenca kombëtare e besimtarëve muslimanë në Bullgari miratoi akte të reja të emërtimit dhe zgjodhi një udhëheqje të re me z. Fikri Sali Hasan si Krye-Mufti, përkatësisht ankuesin e parë. Aktet nënligjore dhe udhëheqja e re u regjistruan më 1 tetor 1992 në përputhje me dispozitat e Aktit të Emërtimeve. Në kundërshtim me aktet nënligjore të vitit 1992 dhe jo në emër të përfaqësuesve legjitim, në nëntor të vitit 1994 z. Nedim Gendjevi organizoi një konferencë e cila miratoi një akt nënligjor dhe zgjodhi një tjetër udhëheqës. Në janar të vitit 1995, për të zgjidhur mosmarrëveshjen, udhëheqja legjitime e besimtarëve muslimanë në Bullgari thirri një konferencë kombëtare të planifikuar për 6 mars 1995. Me një vendim të pamotivuar nga 22 shkurti 1995, dy javë para konferencës, zëvendëskryeministri në përgjegjësi i emërtimeve, z. Svetoslav Shivarov, regjistroi aktet nënligjore dhe udhëheqjen e zgjedhur në konferencën e nëntorit 1994. Përpjekjet e ankuesit për mbrojtje kundër vendimit të

paligjshëm dhe akteve të mëvonshme të udhëheqjes së regjistruar rishtazi nuk u shqyrtuan në thelb nga autoritetet kompetente.

Më 6 mars 1995 udhëheqja e ligjshme e besimtarëve myslimanë në Bullgari organizoi një konferencë kombëtare ku ishin të pranishëm delegatët e të gjitha kapitujve myslimanë vendas. Përfundimisht, delegatët rizgjodhën ankuesin e parë si Krye-Mufti. Përkundër legjitimitetit të konferencës dhe të vendimeve të saj, Këshilli i Ministrave refuzoi të regjistrojë udhëheqjen e zgjedhur më 6 mars 1995 deri në nëntor 1997, kur u mbajt një konferencë e re kombëtare dhe u zgjodh një udhëheqje e re. Këshilli i Ministrave refuzoi të regjistrojë udhëheqjen pa marrë parasysh faktin se Gjykata e Lartë Administrative e kishte aprovuar dy herë apelin e ankuesit kundër refuzimit të Këshillit të Ministrave për të regjistruar aktet nënligjore dhe udhëheqjen.

Përmbledhje e pretendimeve

Lidhur me Nenin 9 të Konventës, ankuesit pohuan se autoritetet shtetërore kishin ndërhyrë dy herë me jetën organizative të komunitetit musliman. Së pari, në shkurt 1995, ata kishin zëvendësuar udhëheqjen legjitime të komunitetit të udhëhequr nga ankuesi parë dhe më pas, në vitet në vijim, kishin refuzuar njohjen e udhëheqjes së rizgjedhur të ankuesit të parë. Ankuesit më tutje pohuan se ndërhyrja e Shtetit në çështjet e brendshme të bashkësisë fetare nuk ishte bazuar në rregulla të qarta ligjore. Ata më tej pohuan se dekreti R-12 ishte në kundërshtim me ligjin përkatës, pasi sanksiononte një udhëheqje e cila nuk ishte zgjedhur në përputhje me statutin dhe aktet nënligjore të bashkësisë muslimane. Po ashtu, ankuesit pretendonin se ndërhyrja në të drejtat e tyre sipas Nenit 9 të Konventës nuk kishte asnjë qëllim legjitim.

Në anën tjetër, sipas mendimit të Qeverisë, aktet e kontestuara të Drejtorisë së Emërtimeve Fetare nuk mund të konsideroheshin si ndërhyrje në organizimin e brendshëm të komunitetit, pasi ato kishin qenë të një natyre thjesht deklarative dhe nuk përbënin asgjë më shumë se një regjistrim administrativ. Qeveria pretendoi se i gjithë aplikacioni nuk ka bazë por mbështetet në interesa personale për avancim të karrierës dhe duke e prezentuar çështjen në mënyrë të rreme si shkelje e të drejtave të njeriut.

Lidhur me Nenin 11 të Konventës, ankuesit u ankuan se ndërhyrja e Shtetit në organizimin e brendshëm të bashkësisë fetare myslimane shkeli këtë të drejtë të tyre. Ndërsa, Qeveria mohoi që bashkësia muslimane ishte "shoqatë " dhe pohoi se në asnjë rast nuk kishte pasur ndonjë ndërhyrje të Shtetit me të drejtën e mbrojtur nga ky nen.

Lidhur me Nenin 13 të Konventës, ankuesit parashtuan, ndër të tjera, se procedura para Gjykatës Supreme, e cila përfundoi me një aktgjykim të 27 korrikut 1995, nuk ishte një mjet efektiv juridik. Megjithëse Gjykata Supreme mund të kishte dhënë lehtësim të duhur duke shfuqizuar Dekretin R-12, kjo gjykatë kishte zgjedhur të mos merret me argumentet e ankuesve në bazë të meritave. Kjo ishte pasojë e asaj që ankuesit e përshkruan si "doktrina e diskrecionit të plotë". Në parashtrësën e ankuesve, Gjykata e Lartë Bullgare vazhdimisht kishte respektuar qëndrimin se në shumë fusha ekzekutivi gëzonte liri të plotë dhe nuk ishte subjekt i shqyrtimit gjyqësor. Në anën tjetër, Qeveria u përgjigj se ankuesit nuk kishin filluar asnjë procedurë në cilësinë e tyre si individë. Në këto rrethana ata nuk mund të pohonin në mënyrë abstrakte se ligji nuk garantonte mjete efektive juridike. Sipas pikëpamjes së Qeverisë, ankuesit mund të kishin kërkuar ngritjen e procedurës penale sipas Neneve 164 dhe 165 të Kodit Penal,

të cilat kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes dhe pengojnë manifestimin e lirë të fesë me anë të forcës ose detyrimit.

Po ashtu, lidhur me me Nenin 6 të Konventës, ankuesit u ankuan se ata nuk kishin pasur qasje në gjykatë për kërkimin e disa të drejtave civile, si psh e drejta në pagë. Qeveria kundërshtoi këtë argument dhe parashtrroi se fatkeqësitë në karrierën e ankuesve nuk ishin pasojë e vendimeve të refuzuara.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me pretendimet për shkelje e nenit Nenin 9 të Konventës si pasojë e ndërhyrjes nga ana e Shteti Gjykata fillimisht vlerëson se a kishte ndërhyrje dhe sa ishte ajo ndërhyrje e arsyetuar. Gjykata konsideron se faktet që tregojnë dështimin e autoriteteve për të mbetur neutrale në ushtrimin e kompetencave të tyre në këtë fushë duhet të çojnë në përfundimin se shteti ka ndërhyrë në lirinë e besimtarëve për të manifestuar fenë e tyre në kuptim të Nenit 9 të Konventës. Gjykata kujton se në raste shumë të jashtëzakonshme, e drejta për lirinë e fesë, e garantuar sipas Konventës përjashton çdo liri veprimi nga ana e Shtetit për të përcaktuar nëse besimet fetare ose mjetet e përdorura për të shprehur besime të tilla janë legjitime. Në këtë dejtim, Gjykata gjeti se Dekreti R-12 dhe vendimi i Drejtorisë së Emërtimeve Fetare të 23 shkurtit 1995 dhe refuzimi i mëvonshëm i Këshillit të Ministrave për të njohur ekzistencën e organizatës të udhëhequr nga ankuesi ishin më shumë se akte të regjistrimit rutinë ose korrigjim i parregullsive të kaluara. Efekti i tyre kishte favorizuar një fraksion të bashkësisë muslimane, duke i dhënë statusin e udhëheqjes së vetme zyrtare, me përjashtimin e plotë të udhëheqjes deri tani të njohur. Aktet e autoriteteve, në ligj dhe në praktikë, privuan udhëheqjen e përjashtuar nga çdo mundësi që të vazhdonin të përfaqësonin të paktën një pjesë të bashkësisë muslimane dhe të menaxhonin punët e saj sipas vullnetit të asaj pjese të komunitetit. Andaj, sipas Gjykatës një ndërhyrje e tillë përbën një shkelje të Nenit 9 të Konventës, përveç nëse është e paraparë me ligj dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike në funksion të qëllimit legjitim.

Si pasojë Gjykata vazhdon të shqyrtojë nëse një ndërhyrje e tillë është e arsyestuar, ku fillimisht përsërit praktikën e saj të përcaktuar sipas së cilës shprehjet "të përcaktuara me ligj" dhe "në përputhje me ligjin" në Nenet 8 deri 11 të Konventës jo vetëm që kërkojnë që masa e kundërshtuar të ketë bazë në të drejtën vendase, por gjithashtu i referohen cilësisë së ligjit në fjalë. Ligji duhet të jetë në mënyrë adekuate i qartë dhe i parashikueshëm, dmth., të formulohet me saktësi të mjaftueshme për të mundësuar që individit të rregullojë sjelljen e tij.

Gjykata vëren se në rastin në fjalë, ligji përkatës nuk parasheh ndonjë kriter thelbësor në bazë të të cilit Këshilli i Ministrave dhe Drejtoria e Emërtimeve Fetare regjistrojnë konfesionet fetare dhe ndryshimet e udhëheqjes së tyre në një situatë të ndarjeve të brendshme dhe pretendimeve kontradiktore për legjitimitet. Për më tepër, nuk ekzistojnë masa mbrojtëse procedurale, siç janë procedimet kundërshtuese para një organi të pavarur, kundër ushtrimit arbitrar të lirisë së gjykimit të lënë ekzekutivit. Për më tepër, Dekreti R-12 dhe vendimi i Drejtorisë nuk u janë bërë të ditura asnjëherë atyre që preken drejtpërdrejt nga to. Këto akte nuk ishin të arsyetuara dhe nuk ishin të qarta për aq sa nuk përmendnin as ankuesin e parë, megjithëse ata kishin për qëllim dhe me të vërtetë ta largonin atë nga pozita e tij si Krye-Mufti. Gjykata tashmë ka gjetur se

këto akte dhe refuzimi i mëvonshëm i Këshillit të Ministrave për të njohur udhëheqjen e ankusit kishte efektin e favorizimit arbitrarisht të një fraksioni të bashkësisë fetare të ndarë. Vlen të përmendet në këtë kontekst që zëvendësimi i udhëheqjes së komunitetit në vitin 1995, si dhe në vitet 1992 dhe 1997, ndodhi pak pas një ndryshimi të qeverisë. Gjykata, pra, konstaton se ndërhyrja në organizimin e brendshëm të bashkësisë muslimane dhe liria e besimit të ankuesve nuk ishte "e përcaktuar me ligj" në atë që ishte arbitrare dhe bazohej në dispozita ligjore që lejonin diskrecion të papenguar të ekzekutivit dhe nuk i plotësoi standardet e kërkuara të qartësisë dhe parashikueshmërisë. Si rezultat Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 9 të Konventës.

Lidhur me Nenin 11 të Konventës, Gjykata konsideroi se asnjë çështje e veçantë nuk ngritet nën këtë nen, dhe se tashmë ka trajtuar ankesën lidhur me ndërhyrjen e Shtetit në organizimin e brendshëm të bashkësisë fetare muslimane sipas Nenit 9 të Konventës.

Lidhur me Nenin 13 të Konventës, pra, pretendimit për mungesë të mjetit efektiv juridik, Gjykata vuri në dukje se Gjykata e Lartë Bullgare kishte refuzuar të shqyrtojë thelbin e ankesës së ankuesit, duke pasur parasysh se Qeveria gëzonte plotësisht lirinë për të regjistruar ose jo aktet nënligjore dhe udhëheqjen e komunitetit fetar. Ankesa në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të shkurtit 1995 nuk ishte, pra, një mjet juridik efektiv. Qeveria nuk kishte pranuar të zbatonte dy aktgjykime të tjera të Gjykatës Supreme. Asnjë mjet tjetër nuk kishte ekzistuar. Prandaj, ka pasur shkelje të Nenit 13 të Konventës.

Për sa i përket Nenit 6 të Konventës, Gjykata vëren se ankuesit nuk kanë mbështetur përmbajtjen e pretendimeve të tyre në bazë ligjore. Për më tepër, ankuesit nuk kanë treguar se ekzistojnë pengesa që i pengojnë ata të marrin të drejta civile para gjykatave në lidhje me të drejtën e tyre të pretenduar për pagë. Andaj Gjykata konsideron se nuk ka shkelje të Nenit 6 të Konventës.

Në fund, Gjykata ka vërejtur se ankuesit nuk i kanë përsëritur pretendimet e tyre lidhur me shkeljen e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, andaj, ka vendosur të mos shqyrtojë këtë pretendim.

Po ashtu, Gjykata vendosi që Bullgaria t'i paguajë ankuesit të parë dëmshpërblim jo-material në vlerë prej BGN 10,000, dhe kundër se gjetja e shkeljeve në fjalë mjafton si satisfaksion për ankuesin e dytë. Gjithadhtu, Gjykata i caktoi Bullgarisë pagesën ndaj ankuesve prej BGN 10,000 në emër të shpërblyerëve gjyqësorë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 9 dhe Nenit 13 të Konventës; ndërsa gjen se nuk kishte shkelje të Nenit 6 të Konventës dhe se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet nën Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës; se asnjë çështje nuk ngritet nën Nenin 11 të Konventës, [njëzëri].

Në mendimin e pjesshëm mospajtuës të gjyqtarëve Tulkens dhe Casadevall, bashkuar nga Judget Bonello, Strážnická, Greve dhe Maruste, theksohet se në rastin aktual nuk ka dyshim se të dy ishin viktimat të shkeljeve të pretenduara dhe se ishte e padiskutuueshme që ankuesi i dytë, "vazhdoi të punojë përballë vështirësive të mëdha" për gati tre vjet andaj ai gjithashtu pësoi shqetësim dhe dëm të qëndrueshëm jo-material, gjë që i garanton një shpërblyer sipas Nenit 41 të Konventës.

Leela Förderkreis E.V. dhe të tjerët kundër Gjermanisë - 58911/00

6 nëntor 2008 [Seksioni i Pestë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6 § 1

Shkelje e të drejtës në gjykatë si pasojë e tej-zgjatjes së procedurave përtej kohës së arsyeshme / *ka shkelje*

Neni 9

Ndërhyrjes në jetën fetare dhe lirinë e manifestimit të fesë si pasojë e etiketimit me emra dëmtues nga ana e shtetit / *nuk ka shkelje*

Neni 14 në kombinim me Nenet 9 dhe 10

Pretendim për diskriminim në raport me komunitetet tjera fetare si pasojë e defamacionit dhe kampanjës negative ndaj tyre / *nuk ngritet çështje ndaras*

Fjalët kyçe: *asociacione / liri fetare / defamacion / etiketim / ndëryrje e shtetit / interes publik / tej-zgjatje e procedurave / diskriminim*

Ankuesit: pesë asociacione të regjistruara sipas ligjit gjerman, Leela Förderkreis e.V., Wies Rajneesh Zentrum für spirituelle Therapie und Meditation e.V., Osho Uta Lotus Commune e.V., Dharmadeep Verein für ganzheitliches Leben e.V. dhe Osho Meditations Center Berlin e.V.

Faktet e rastit

Asociacionet të cilat janë ankuar në këtë rast janë asociacione ose bashkime fetare ose meditative që i takojnë lëvizjes Mosho, më herët e njohur si Shree Rajneesh ose lëvizja Bhagwan.

Lëvizja është themeluar nga misticisti Rajneesh Chandra Mohan, që nga ndjekësitë e tij është quajtur fillimisht Bhagwan dhe më vonë Osho. Sipas statuteve të tyre, asociacionet promovojnë mësimet e Osho-s, dhe theksojnë se qëllimi i zhvillimit shpirtëror është ndriçimi ose sqarimi. Asociacionet kanë qendrat e tyre të meditimit, organizojnë seminare, festojnë ngjarjet fetare dhe gjithashtu zbatojnë projekte të përbashkëta pune. Ato po ashtu mbrojnë të drejtat fetare të anëtarëve të tyre kundër diskriminimit.

Asociacionet ankuese i takojnë grupit të komuniteteve fetare më parë të panjohura, të cilat u shfaqën në Gjermani gjatë viteve 1960-të. Ato janë përshkruar si “sekte”, “sekte të reja”, “fe të reja”, “psiko-sekte”, “psiko-grupe” dhe përshkrime të ngjashme. Këto grupe u bënë shpejt temë debati publik për shkak që veprimet e tyre ndikohen në masë të madhe nga pikëpamjet fetare dhe filozofike dhe gjithashtu për mënyrën se si i trajtojnë anëtarët e tyre. Shqetësimi kryesor ka qenë rreziku i mundshëm që këto grupe do të mund t’u shkaktonin adoleshentëve në zhvillimin e tyre personal dhe marrëdhëniet shoqërore, të cilat do të mund të çonin jo vetëm në lënien e shkollës ose trajnimit profesional, ndryshimet rrënjësore të personalitetit, format e ndryshme të

varësisë, mungesën e nismave dhe vështirësitë në komunikim, por edhe t'u shkaktonin dëme materiale dhe dëmtime psikologjike.

Në një përgjigje të Qeverisë Federale të 27 prillit 1979 për anëtarët e Parlamentit Gjerman, lëvizja të cilës i takonin asociacionet ankuese llogaritej në mesin e komuniteteve të ashtuquajtura fetare dhe filozofike. Qeveria Federale theksonte se këto grupe etiketoheshin në terma të përgjithshëm si “sekte te reja”, “grupe fetare destruktive” ose “kulte destruktive”. Vetë Qeveria u referohej si “sekte të reja pseudo-religjioze dhe psik-grupe” dhe shkurt në përgjithësi si “sekte”.

Më 1 tetor 1984, asociacionet ankuese kishin filluar procedurat gjyqësore para Gjykatës Administrative të Këlnit. Ata i kërkonin Qeverisë që të pushonte së lëshuari deklarata me etiketimet e mësipërme kur i referohej lëvizjes fetare dhe asociacioneve që i përkisnin asaj, duke theksuar se të tilla deklarata ishin inkriminuese. Ato pretendonin në thelb se u ishte cënuar liria e tyre për të praktikuar një fe ose besim filozofik. Si rezultat me një vendim të janarit 1986, Gjykata Administrative ja ndaloi Qeverisë që t'i referohej lëvizjes Rajneesh në deklaratat zyrtare si “sekt i ri” ose “psiko-sekt”, dhe nga përdorimi i mbiemrave “destruktiv” dhe “pseudo-religjioz”.

Më 28 prill 1986, Qeveria kishte apeluar vendimin para Gjykatës Administrative të Apelit për landin North Rhine-Westphalia. Në një vendim të datës 22 maj 1990, Gjykata Administrative e Apelit kishte prishur vendimin paraprak të Gjykatës Administrative të Këlnit dhe hedhur poshtë pretendimin e ankuesve në tërësi. Gjykata Administrative e Apelit kishte deklaruar se e drejta për liri të fesë nuk ishte absolute dhe ishte subjekt i kufizimeve nga dispozitat e tjera të Kushtetutës, kufizime dhe ndërhyrje që i lejoheshin Qeverisë kur kishte arsye të rëndësishme të interesit publik kërkonin mbrojtjen e të drejtave themelore që ishin në konflikt me lirinë e fesë, siç ishte rasti me të drejtë në jetë dhe pacënueshmëri të personit apo me të drejtat e familjes. Kësisoj, sipas Gjykatës Administrative të Apelit, pikëpamjet e shprehura nga Qeveria ishin të pranueshme dhe respektonin parimin e proporcionalitetit.

Më 13 mars 1991, Gjykata Federale Administrative (*Bundesverwaltungsgericht*) kishte hedhur poshtë apelin e asociacioneve, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo gjykatë vlerësoi se rasti nuk kishte rëndësi thelbësore dhe nuk ngriste ndonjë çështje të re, pasi çështjet e ngritura nga asociacionet tashmë ishin trajtuar në praktikën e saj gjyqësore dhe atë të Gjykatës Kushtetuese Federale (*Bundesverfassungsgericht*). E drejta kushtetuese e Qeverisë për të informuar publikun dhe për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe shëndetin e qytetarëve e justifikonte ndërhyrjen në lirinë e fesë ose të besimit. E drejta për të informuar publikun përfshinte të drejtën për të paralajmëruar publikun dhe për të vlerësuar sjelljen e të tjerëve si të rrezikshme.

Më 3 maj 1991, asociacionet kishin paraqitur ankesë pranë Gjykatës Federale Kushtetuese kundër vendimeve të sipërpërmendura gjyqësore. Më 23 prill 1992, në përgjigje të një letre të ankuesve, Gjykata Kushtetuese i njoftonte se nuk ishte në gjendje të tregonte se kur do të mund të merrej vendimi. Më 1993, Gjykata i njoftonte palët se rasti u kishte komunikuar Qeverisë Federale dhe landit North-Rhine-Westphalia. Si rezultat i kësaj, Qeveria Federale kishte dorëzuar pikëpamjet e saj, të cilat u ishin përcjellë asociacioneve ankuese më 4 nëntor 1993. Më 21 shtator 1994, asociacionet, gjithashtu, kishin dorëzuar pikëpamjet e tyre si kundërpërgjigje.

Asociacionet i kishin adresuar një sërë letrash Gjykatës, ku kërkonin të dinin për fazën e procedurës së vendimmarrjes, përkatësisht më 8 mars 1993, 6 gusht 1995, 8 korrik 1998 dhe 2 shkurt 2000.

Më 26 qershor 2002, Gjykata Federale Kushtetuese kishte vendosur të prishte pjesërisht vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Vendimi ishte prishur për pjesën ku hidhej poshtë pretendimi i asociacioneve në lidhje me përdorimin e shprehjeve “destruktive”, “pseudo-religjioze”, “manipulues të anëtarëve të tyre” dhe ja referoi këtë pjesë të ankesës Gjykatës Administrative të Apelit për një vendim të ri. Megjithatë, edhe Gjykata Kushtetuese kishte gjetur se Qeveria ishte e autorizuar që të karakterizonte lëvizjen e asociacioneve ankuese si “sekt”, “fe të re”, “sekt të ri” dhe “psiko-sekt” dhe se, gjithashtu, Qeveria ishte e lejuar t’i ofronte publikut informacion të përshtatshëm në lidhje me këtë. Sipas Gjykatës Kushtetuese, liria e fesë ose e besimit, e garantuar me Kushtetutë, nuk e parandalonte shtetin që të përfshihej në diskutim publik rreth qëllimeve dhe aktiviteteve të grupeve fetare. Kufizimet e lirisë së fesë gjendeshin në të drejtat dhe liritë e tjera themelore të garantuara në Kushtetutë, siç ishte rasti me mbrojtjen e dinjitetit, të drejtë në jetë dhe integritet fizik, si dhe mbrojtjen e martesës dhe të familjes.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit kanë pretenduar në veçanti se kohëzgjatja e procedurave para gjykatave vendore ka qenë e skajshme dhe se autoritetet gjermane kanë ndërhyrë në të drejtën e tyre për të shprehur besimin fetar. Sipas ankuesve, tejzgjatja e procedurave para Gjykatës Kushtetuese ishte rezultat i një deficiti strukturor. Sa i përket kompleksitetit të rastit, asociacionet e pranojnë se rasti ishte kompleks, por megjithatë jo përjashtimisht kompleks.

Qeveria, nga ana e saj, ka deklaruar se kohëzgjatja e procedurave para Gjykatës Administrative të Këlnit ka qenë e arsyeshme dhe se çfarëdo vonese që mund të jetë shkaktuar gjatë procedurave para kësaj gjykate, ka qenë në radhë të parë përgjegjësi e asociacioneve, të cilat, përveç tjerash, kanë kërkuar dy herë shtyerjen e seancave dëgjimore dhe kanë dorëzuar deklarata dhe argumente shtesë dhe të zgjeruara.

Ndonëse Qeveria ka pranuar kohëzgjatja e procedurave para Gjykatës Federale Kushtetuese ka qenë e konsiderueshme, megjithatë Qeveria vlerësonte se ajo justifikohet nga rrethanat e këtij rasti të veçantë. Sipas Qeverisë, çështja që ishte subjekt shqyrtimi duhej parë si veçanërisht komplekse, pasi çështja nëse Qeveria kishte të drejtë të bënte paralajmërime ishte subjekt i një numri ankesash të paraqitura gjatë asaj kohe. Gjykata Kushtetuese i kishte bashkuar këto raste dhe, pas vendimeve udhëheqëse të marra nga Dhoma e plotë—përfshirë vendimin në rastin aktual—ankesat e mbetura ishin trajtuar me vendime të paneleve prej tre (3) gjyqtarësh. Tutje, Qeveria kishte vënë theksin te sfondi unik politik i ribashkimit të Gjermanisë, që kishte ndodhur vetëm një vit e gjysëm para se kjo ankesë të dorëzohej në Gjykatë.

Arsyetimi i Gjykatës

Sa i përket zgjatjes së procedurave, Gjykata rithekson se arsyeshmëria e tyre duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe në lidhje me kriteret në vijim: kompleksitetin e rastit, sjelljen e ankuesve dhe të autoriteteve relevante, si dhe atë se

çfarë ka qenë në pyetje për ankuesit. Gjykata ka vërejtur se palët janë pajtuar që çështja aktuale kishte të bënte me çështje kushtetuese të një kompleksiteti ligjor të caktuar. Gjykata e mbështetë këtë vlerësim.

Sa i përket sjelljes së asociacioneve, Gjykata vëren se asociacionet nuk e kanë kontestuar faktin që kanë shkaktuar një vonesë të caktuar në procedurat para Gjykatës Administrative të Apelit. Ndërkaq, sa u përket procedurave para Gjykatës Federale Kushtetuese, Gjykata vë re se Qeveria nuk e ka kontestuar deklarinimin e ankuesve se ata nuk kanë dorëzuar argumentet e tyre menjëherë pas atyre të Qeverisë pasi Gjykata Kushtetuese i kishte informuar ata se rasti do të merrte disa vite për t'u trajtuar. Për më tepër, nuk ka tregues se dorëzimi i deklaratës së ankuesve në Gjykatës Kushtetuese është bërë pas një afati të tejzgjatur, marrë parasysh kompleksitetin e çështjes në shytim. Si rezultat, Gjykata vlerëson se sjellja e ankuesve nuk i ka kontribuar zgjatjes së procedurave para Gjykatës Kushtetuese.

Sa i përket sjelljes së gjykatave vendore, Gjykata vëren se procedurat kishin zgjatur rreth një vit e katër muaj në gjykatën e shkallës së parë, katër vite e një muaj në Gjykatën Administrative të Apelit dhe më pak se një vit në Gjykatën Federale të Apelit. Marrë parasysh edhe kontributin e asociacioneve ankuese në zgjatjen e procedurave para Gjykatës së Apelit dhe kompleksitetin e çështjes, Gjykata e vlerëson këtë zgjatje të pranueshme.

Sa përket procedurave para Gjykatës Federale Kushtetuese, që kanë zgjatur rreth njëmbëdhjetë (11) vite e tre (3) muaj, Gjykata vlerëson se ajo shpesh ka mbajtur qëndrimin se Neni 6 § 1 u imponon shteteve palë detyrimin për të organizuar sistemet e tyre gjyqësore në atë mënyrë që gjykatat mund të plotësojnë kërkesat, përfshirë detyrimin për të dëgjuar rastet brenda një kohe të arsyeshme. Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e procedurave në rastin konkret nuk mund të shpjegohet me rrethanat e jashtëzakonshme të ribashkimit të Gjermanisë dhe as të justifikohet me bashkimin apo grupin e një numri rastesh për çështje të ngjashme. Tutje, Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e procedurave prej më tepër se njëmbëdhjetë vitesh e tejkalon për shumë edhe margjinën e përcaktuar në rastet e saja të mëhershme (përfshirë në kontekstin unik të ribashkimit të Gjermanisë). Si rezultat, del se kohëzgjatja e këyre procedurave ka qenë e tepruar dhe nuk plotësonë kërkesën për "kohë të arsyeshme". Kësisoj, ka shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

Nërkaq, sa u përket pretendimeve për shkelje të Nenit 9, Gjykata ka ritheksuar si fillim parimet relevante të praktikës së saj gjyqësore në lidhje me shtrirjen e të drejtës për lirinë e fesë.⁵⁵ Por, pavarësisht shtrirjes së kësaj të drejte dhe lirisë, përveç të tjerash, për të manifestuar fenë, vetëm dhe në mënyrë private, ose në komunitet me të tjerët, në publik dhe brenda qarqeve të atyre me të cilët e ndanë fenë, Neni 9 nuk e mbron çdo akt të motivuar ose inspiuar nga një fe ose besim. Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë përmban pikëpamje që kanë një nivel të caktuar serioziteti, koherence dhe rëndësie.

Në rastin konkret, pasi ka analizuar faktet e rastit, Gjykata ka vlerësuar se shprehjet e përdorura nga ana e Qeverisë për lëvizjen e asociacioneve kanë pas pasoja negative, ndonëse ajo në asnjë rrethanë nuk ka ndaluar aktivitetet e tyre ose të anëtarëve të tyre.

⁵⁵ *Kokkinakis kundër Greqisë*, aktgjykimi i datës 25 maj 1993, Seria A nr. 260-A.

Pa e definuar shtrirjen e saktë dhe karakterin e këtyre pasojave, Gjykata vazhdon mbi supozimin se deklaratat e Qeverisë kanë përbërë ndërhyrje në të drejtën e ankuesve për të manifestuar fenë ose besimin.

Gjykata pastaj ka vijuar për të vlerësuar nëse kjo ndërhyrje ka qenë e paraparë me ligj, dhe ka arritur në përfundimin se ndërhyrja ka qenë e përcaktuar me ligj. Tutje, Gjykata i është përgjigjur pozitivisht pyetjes nëse ndërhyrja ka ndjekë qëllime legjitime, e që në këtë rast ka qenë mbrojtja e sigurisë publike dhe rendit publik, si dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Në vijim, ka qenë shqyrtimi i çështjes nëse ndërhyrja ka qenë e “domosdoshme në një shoqëri demokratike”. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se deklaratat e Qeverisë, siç ato janë përkufizuar nga Gjykata Federale Kushtetuese, e pakta në kohën kur janë bërë, nuk përmbajnë ndonjë tejkalim të kufijve të asaj se çfarë një shtet demokratik mund ta shoh si interes publik.

Në dritën e vlerësimeve si më sipër dhe duke pas parasysh margjinën e vlerësimit që u lihet autoriteteve shtetërore, detyrë e të cilave në një shoqëri demokratike që po ashtu të shqyrtojnë, brenda kufijve të juridiksionit të tyre, interesat e shoqërisë si të tërë, Gjykata gjen se ndërhyrja në fjalë ka qenë e justifikuar në parim dhe ka qenë proporcionale për sa i përket qëllimit të synuar. Në këtë mënyrë, nuk ka pas shkelje të Nenit 9 të Konventës.

Sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata ka gjetur se nuk ka çështje të ndarë sipas Nenit 14 në ndërlidhje me Nenet 9 dhe 10 të Konventës. Gjykata vëren se këto ankesa kanë të bëjnë me faktet e njëjta sikurse në lidhje me Nenin 9. Dhe marrë parasysh gjetjen në lidhje me Nenin 9, Gjykata vlerëson se këto fakte nuk ngrisin çështje të ndarë sipas dispozitës së Nenit 14 në kombinim me Nenet 9 dhe 10.

Sa u përket kostove dhe shpenzimeve, Gjykata e urdhëron shtetin që t’u paguaj tre asociacioneve të para 4,000 EUR për kostot dhe shpenzimet. Ndërkaq, në lidhje me dëmin jo-material, Gjykata ka vënë re se, derisa ankuesit kanë kërkuar dëmshpërblim për shkeljen e pretenduar të lirisë së fesë (për të cilën nuk është gjetur shkelje), ata nuk kanë kërkuar ndonjë dëmshpërblim për shkak të kohëzgjatjes së tepruar të procedurave. Prandaj, Gjykata nuk përcakton ndonjë dëmshpërblim të caktuar.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës se nuk ka shkelje të Nenit 9, dhe se nuk ka çështje të ndarë sipas Nenit 14 në kombinim me Nenet 9 dhe 10 [*njëzëri/pesë vota për, kundër dy / njëzëri*].

Pavlidēs dhe Georgakis kundër Turqisë - 9130/09; 9143/09

20 dhe 23 janar 2009 [Seksioni i Katërt]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3

Trajtim çnjerëzor, poshtërues dhe degradues si pasojë e ndalimit të mbajtjes së meshës dhe detyrimit për largim nga kisha / *e pabazuar*

Neni 5

Shkelje e të drejtës në lëvizje të lirë si pasojë e ndalimit dhe mbajtjes në oborrin e kishës për disa orë nga persona të armatosur / *e pabazuar*

Neni 9

Ndërhyrje në të drejtën e manifestimit të fesë si pasojë e refuzimit të vazhdueshëm i forcave turke për të lejuar çdo sherbimin në Manastirin e Shën Barnaba, dhe ndërprerjen e meshës / *e pabazuar*

Fjalët kyçe: *zonë e mbrojtur / kufizime / konflikt / shmangie e konfliktit / praktikim i fesë / leje speciale / keqkuptim / ndërprerje e meshës / ndalim*

Ankuesit: z. Nicos Pavlidēs dhe z. Spyridon Georgakis, qytetarë Qipriot

Faktet e rastit

Ankuesit janë anëtarë të Kishës së Qipros, e cila konsiderohet se është themeluar nga Shën Barnaba gjatë shekullit të parë. Vendi tradicional i varrimit të Shën Barnabës ndodhet në një kodër në zonën pranë Famagustës, tani e pushtuar nga forcat turke dhe që administrohet nga "TRNC" ("Republika Turke e Qipros Veriore") që nga viti 1974. Manastiri i Shën Barnabës dhe një ndërtesë e vogël e kishes janë të vendosura në atë vend. Ato përdoren tani për të strehuar një muze ikonë dhe vizitohen nga turistët në kohë të caktuara.

Pas heqjes së pjesshme të kufizimeve të udhëtimit në vitin 2003, përpjekjet u bënë nga Abbot-i i Manastirit të Shën Barnabës për të rifilluar ritet fetare në vend, duke u zhvilluar negociatat përmes Kombeve të Bashkuara. Kërkesa për meshat mujore në manastirin dhe kishën u refuzua; autoritetet "TRNC" fillimisht ranë dakord që mesha mund të festohej në kishë çdo tre muaj në kohë të paracaktuar dhe të autorizuar paraprakisht. Pas kësaj marrëveshjeje, gjatë vitit 2008, në kisha ritet fetare u festuan në masë të madhe.

Më 25 qershor 2008, UNIFCYP mori një përgjigje me shkrim nga autoritetet "TRNC" duke deklaruar se mesha e shenjtë e fundit periodike ishte kryer më 8 maj 2008, dhe se shërbimi i ardhshëm mund të organizohej për javën e parë të muajit gusht. Me letrën e datës 26 qershor 2008, zyrtari kryesor i çështjeve civile të Kombeve të Bashkuara e informoi Abatin se kërkesa për kryerjen e një meshe më 5 korrik 2008 në manastir ishte refuzuar; ai deklaroi se megjithatë leja u dha për një meshë që do të festohej më 2 gusht 2008 në kishë. Nuk ka dëshmi se kjo letër ose përmbajtja e saj iu ishte

komunikuar autoriteteve "TRNC". Më 2 gusht 2008, një grup prej rreth 70 personash, duke përfshirë edhe ankuesit, udhëtuan në kishë. Mesha filloi në orën 07:00.

Sipas qeverisë, kujdestari i manastirit, i cili nuk ishte në dijeni për ndonjë rregullim për një shërbim, i informoi autoritetet për ardhjen e kongregacionit grek qipriot. Policia ka kontaktuar me Drejtorin e Antikave, i cili deklaroi se asnjë leje nuk ishte dhënë për një shërbim në atë datë. Policët "TRNC" arritën në kishë dhe kërkuan të shihnin lejen për mbajtjen e meshës. Një anëtar i kongregacionit u dërgua për të marrë letrën e UNFICYP që ishte lënë në Nikosia. Në orën 08.30, policia i largoi njerëzit nga kisha. Ankuesit deklaruan se policia bëri kërcënime për arrestimin dhe ndalimin e të gjithë atyre që nuk pajtohen. Ata deklaruan se njerëzit dilnin nga kisha në një oborr ku pikat e hyrjes u ruajtën nga skuadra e policisë më shumë oficerë. Oficerët e policisë kërkuan emrat e të pranishmëve; që të dy ankuesit por edhe të tjerët që refuzuan të jepnin emrat e tyre dhe u kërcënuan për tu arrestuar. Ata përfundimisht u pajtuan dhe u larguan për të parandaluar përshkallëzimin e situatës.

Në ndërkohë, ankuesi i dytë telefonoi Presidentin e Republikës së Qipros, e ky i fundit kontaktoi z. Talat, udhëheqës i "TRNC"; Z. Talat siguroi Presidentin se nëse do të kishte një leje të vlefshme, shërbimi do të lejohej. Përfundimisht, pas një deri në një orë e gjysmë, ankuesit dhe njerëzit e tjerë u lejuan të largohen nga oborri. Ata u mblodhën rreth 50 metra larg kishës në një fushë. Oficerët e policisë nuk pranuan të lejonin që masa të vazhdonte meshën në fushë dhe kërkoi që të gjithë të largohen. Qeveria e paditur deklaroi se policia nuk e mbajti kongregacionin në oborr kundër vullnetit të tyre dhe as nuk i detyruan për tu shpërndarë. Në paraqitjen e tyre, kongregacioni zgjodhi të qëndronte në afërsisë së kishës, duke pritur kthimin e personit të dërguar për të gjetur leje për shërbimin.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit u ankuan sipas Nenit 3 se ndërprerja e meshës ishte një akt veçanërisht fyes i sakrilegjii në një vend me rëndësi supreme fetare për ortodoksët qipriotë. Sipas tyre, ky ishte një akt i poshtërimit të rëndë që zbulonte trajtim çnjerëzor dhe degradues. Ankuesit u ankuan edhe bazuar në Nenin 5 se ata ishin mbajtur në oborr nga burrat e armatosur e që përbënte një privim arbitrar dhe të pajustificuar të lirisë, të cilat nuk binin në ndonjë bazë të ligjshme të parburgimit.

Ankuesit pretenduan shkelje të Nenit 9 të Konventës për shkak të refuzimit të vazhdueshëm të forcave turke për të lejuar çdo meshë në Manastirin e Shën Barnabës; kufizimet e pajustificuara në kryerjen e meshave në manastirin dhe kishën; dhe ndërprerjen dhe ndalimin e meshave të kryera më 2 Gusht 2008 pavarësisht miratimit të mëparshëm që është dhënë. Kufizimet nuk kishin bazë në ligj dhe nuk plotësonin një nevojë sociale të ngutshme. Forcat e policisë nuk ishin mbështetur në ndonjë ligj për veprimet e tyre, të cilat gjithashtu nuk kishin një qëllim legjitim dhe nuk ishin të nevojshme. Ankuesit pretendonin se këto kufizime drejtpërsëdrejti preknin të drejtën e ankueseve për të manifestuar fenë e tyre në kishë dhe në varrin e dedikuar për themeluesin e kishës së tyre.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata fillimisht rikujton se Neni 5 § 1 nuk ka të bëjë me kufizime të thjeshta mbi lirinë e levizjes, të cilat mbuloheh nga Neni 2 i Protokollit nr. 4. Me qëllim të percaktimit nese dikush është "privuar nga e drejta e lirisë së tij" në kuptim të Nenit 5 § 1, pika e fillimit duhet të jetë gjendja e tij konkrete dhe duhet të merret parasysh një tërësi kriteresh si lloji, kohëzgjatja, efektet dhe mënyra e zbatimit të masës në fjalë. Dallimi ndërmjet privimit dhe kufizimit të lirisë ndërlihet me shkallën ose intensitetin e ndalimit, dhe jo natyrën ose substancën.⁵⁶

Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se, siç vuri në dukje Qeveria e paditur, vetë ankuesit nuk bëne asnjë ankesë ndaj asnjë autoriteti zyrtar dhe nuk paraqitën ankesën që ata ngritënpara Gjykatës, për privimin e paligjshëm dhe të pajustificuar të lirisë, para gjykatat e brendshme në zonën "TRNC". Sipas deklaramit të ankuesve, çështja nuk u ngrit për shkak të frikës se do të rrezikonte aranzhimet e ardhshme për shërbime në kishë. Nëse ky shqetësim ishte një bazë e vlefshme e përjashtimit apo jo nga kërkesa për të shterur mjetet e brendshme në dispozicion sipas Nenit 35 § 1 të Konventës, Gjykata vëren se nuk ka pasur ekzaminim të fakteve, me vlerësimin e dëshmive të dëshmitarit. Prandaj është ballafaquar me dy verzione të ngjarjeve të cilat nuk janë provuar dhe të paprovuara në nivel vendor.

Në këto rrethana, duke peshuar të dyja llogaritë, Gjykata vëren se pohimi i ankuesve se ata mbaheshin në oborrin e kishës kundër vullnetit të tyre është në kundërshtim me pohimin e Qeverisë se qëllimi i pranuar i ankueseve ishte të qëndronin pranë kishës në mënyrë që ata mund të rifillojnë shërbimin e meshës në kohën e duhur. Në të vërtetë ankuesit nuk deklarojnë se ka pasur ndonjë vend tjetër që ata në fakt dëshironin të shkonin. Pas një ore e gjysmë, grupi u transferua në një vend tjetër ku ata vendosën të mbanin një shërbim në ajër të hapur. Gjykata nuk dyshon se prania e oficerëve të policisë, ishte një tipar frikësues. Sidoqoftë, nuk është e qartë se ndonjë masë e detyrimit të drejtpërdrejtë ose forcë është zbatuar nga cilido oficer policie ndaj ndonjërit prej ankueseve që i pengonte ata të kthehen në shtëpi ose të shkonin në ndonjë vend tjetër të veçantë. Gjithashtu, mund të vërehet se zona nuk ishte e hapur për publikun pa leje dhe se qasja ishte rregulluar. Situata mund të interpretohet si një ku ankuesit dhe kongregantët e tjerë u lejuan të presin në zona të caktuara, nën mbikëqyrje, deri në kthimin e anëtarit të tyre me autorizimin e supozuar me shkrim.

Në dritën e këtyre konsideratave, mungesa e provave të masave shtrënguese dhe periudha relativisht e shkurtër gjatë së cilës ankuesit pritën në oborr, Gjykata nuk është e bindur se ata kanë treguar se janë privuar nga liria sipas kuptimit të Neni 5§ 1 të Konventës. Rrjedhimisht, kjo pjesë e kërkesës duhet të refuzohet si e pabazuar në kuptim të Nenit 35 § 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Ankuesit pretenduan shkelje të Nenit 9 të Konventës bazuar në faktin se shërbimi fetar i kryer në kishën në manastirin e Shën Barnabës ishte ndërprerë nga policia, e njëjta do të nodhte sikur të kishin tentuar ta rifillonin shërbimin në një fushë të afërt, si dhe për kufizimet në qasjen në vendet fetare në "TRNC" në përgjithësi. Qeveria parashtrroi, se

⁵⁶ *Medvedyev dhe të tjerët kundër Francës* [DhM], nr. 3394/03, §§ 73, KEDNJ 2010, mutatis mutandis, *Austin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], nr. 3961 / 09, 40713 / 09 dhe 41008/09, §§ 52-60, GjEDNj 2012

ankuesit nuk kishin sjellë ankesat e tyre para gjykatave vendore dhe kështu nuk kishin shtuar mjetet e brendshme juridike. Sa i përket përmbajtjes, ata pohuan se ndërsa veprimet e ankuesve ishin frymëzuar nga besimet e tyre fetare, pamundësia e ankuesve për të ndjekur shërbimin në atë ditë për shkak të mungesës së aranzhimeve të nevojshme formale nuk bie në fushëveprim të Nenit 9 të Konventës. Veprimet e autoriteteve në manastir synuan të siguronin pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit të Antikiteteve që instaluan një regjim të mbrojtjes dhe ruajtjes së monumenteve kulturore dhe historike dhe nuk kishin për qëllim kufizimin e manifestimeve të lirisë së fesë. Qeveriaparashtrroi se masat e zbatuara nga autoritetet ishin të autorizuar me ligj, ishin proporcionale dhe të justifikuar. Çështja e vetme ishte kërkesa për para-autorizim për atë shërbim të veçantë në mjediset e mbrojtura si një monument historik; përveç atij incidenti të bazuar në keq-komunikim ndërmjet bashkëbiseduesve të ndryshëm, marrëveshja për lehtësimin e shërbimeve në vend kishte punuar në një mënyrë të arsyeshme dhe bashkëpunuese.

Ankuesit deklaruan se Qeveria e paditur nuk kishte specifikuar se çfarë arsye veprimi mund të merrnin në lidhje me ankesat e tyre. Ata argumentuan se shqetësimi i meshës ishte qartë një kufizim në ushtrimin e besimeve të tyre fetare dhe se kufizimet në qasjen në vendet ortodokse ishin në vetvete një kufizim për të drejtat e tyre. Gjykata në anën tjetër e sheh të panevojshme të vendosë mbi kundërshtimin e Qeverisë për mospërdorimin e mjeteve juridike të brendshme për arsyet e paraqitura më poshtë.

Sa i përket domosdoshmërisë së përdorimit të masave në rastin aktual dhe në veçanti proporcionalitetit të ndërhyrjes së policisë në përfundimin e shërbimit brenda dhe jashtë kishës, Gjykata vëren se, megjithëse është e vërtetë se ankuesit ishin atje duke besuar se ata kishin autorizim, duket nga pikëpamja e autoriteteve që kanë për detyrë ruajtjen e vendit, se tubimi ishte i paplanifikuar, i paautorizuar dhe i paligjshëm. Duke pasur parasysh kërkesat e ligjit vendas dhe rëndësinë e vendit, veprimet e autoriteteve në ndërhyrjen në atë që ata konsiderohen si një ndërhyrje e paligjshme nuk duket as arbitrare apo të tepruara. Gjykata vëren se sistemi i autorizimit paraprak funksiononte pa probleme dhe nuk mund të thuhet se ka qenë tepër e vështirë në praktikë. Poashtu Gjykata vëren se ky nuk ishte i vetmi vend ku ankuesit mund të takoheshin për të adhuruar ose se ishte ndonjëherë famulli e tyre lokale ku ata kishin adhuruar gjithmonë në baza të rregullta ose të vazhdueshme. Për më tepër, duke pasur parasysh në veçanti situatën në vazhdim në Qipro dhe dëshirën për të shmangur tensione dhe pika të mprehta midis të dy palëve, Gjykata gjen se fakti që shërbimi, i cili nuk ishte autorizuar në përputhje me marrëveshjet në fuqi, në këtë rast nuk mund të konsiderohet se ndikon në mënyrë joproporcionale me lirinë e kërkuar për të manifestuar fenë e tyre. Në përfundim, Gjykata konstaton se kjo pjesë e kërkesës duhet të refuzohet si e pabazuar në mënyrë të qartë në pajtim me Nenin 35 § 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Tutje ankuesit pretenduan se ndërprerja e shërbimit më 2 gusht 2008 ka shkelur Nenin 3 të Konventës, duke argumentuar se ky veprim përbente trajtim çnjëzësor dhe degradues. Duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme dhe rrethanat specifike të situatës, Gjykata nuk gjen ndonjë ndonjë trajtim të tillë që do të mund të binte brenda fushëveprimit të kësaj dispozite. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se këto ankesa janë qartazi të pabazuara dhe të refuzohen sipas Nenit 35 & 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se pretendimet për shkelje të Neneve 3, 5 dhe 9 janë qartazi të pabazuara andaj duhet të shpallen të papranueshme [*njëzëri*].

Neni 10

Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky Nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive.
2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 10 § 1

Pretendim për shkelje të lirisë së shprehjes si pasojë e kërkimit dhe konfiskimit të materialeve gazetareske dhe detyrimi për të zbuluar burimin gaetaresk / *ka shkelje*.

Neni 8

Kërkimi në banesë përbënte ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën për respektimin e shtëpisë dhe të jetës private / *e panevojshme për shqyrtim*.

Fjalët kyçe: gazetar / burim gazetaresk / mbrojtje / detyrim / liri e shprehjes / hetime / publikim i informatave / kërkim në shtëpi / baraspeshë e drejtë / interes publik

Ankuesja: znj. Ilze Nagla, shtetase letoneze e lindur në vitin 1971 dhe jeton në Riga (Letoni).

Faktet e Rastit

Gjatë periudhës të zhvillimit të ngjarjeve si më poshtë ankuesja po punonte pranë transmetuesit televiziv kombëtar Latvijas Televīzija (LTV), ku prodhonte dhe organizonte programin hetimor javor "De Facto". Në shkurt 2010 ajo u kontaktua nga një burim anonim i cili e informoi atë se kishte të meta serioze të sigurisë në një bazë të dhënash të mbajtur nga Shërbimi i të Ardhurave të Shtetit (VID). Ajo informoi VID për një shkelje të mundshme të sigurisë dhe pastaj publikisht njoftoi rrjedhjen e të dhënave gjatë një transmetimi të emisionit "De Facto." Një javë më vonë, burimi i saj, duke u identifikuar si "Neo", filloi të përdorë Tëitter-in për të publikuar informacion në lidhje me pagat e zyrtarëve shtetërorë në institucione të ndryshme publike dhe vazhdoi ta bëjë këtë deri në mes të prillit 2010. VID filloi procedurat penale dhe në shkurt 2010, policia hetuese intervistoi ankuesen si dëshmitare. Ajo nuk pranoi të zbulonte identitetin e burimit të saj. Në maj 2010 autoritetet hetuese kanë konstatuar se personi me inicialet I.P. ishte lidhur me bazën e të dhënave dhe kishte bërë disa thirrje në numrin e telefonit të ankueses. I.P. u arrestua në lidhje me procedurën penale. Në të njëjtën ditë u kontrolluan shtëpitë e ankueses, nga ku u morren një laptop, një hard disk i jashtëm, një kartë kujtese dhe katër disqe flash pasi një hetim kërkimi u hartua nga hetuesi dhe u autorizua nga një prokuror publik. Urdhri i citonte dëshminë e komunikimit ndërmjet ankueses dhe një individ që policia dyshonte se ishte 'Neo', dhe sugjeroi që ankuesja të ketë informacion në lidhje me rrjedhjet e të dhënave ose përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e informacionit të marrë nëpërmjet këtyre rrjedhjeve. Urdhri gjithashtu vuri në dukje mundësinë që dëshmitë e tilla mund të jenë në rrezik shkatërrimi ose fshehje për të mbështetur zbatimin e një procedure të veçantë, urgjente të kërkimit me të cilën mandati mund të miratohet në mënyrë retrospektive nga gjyqtari hetues. Ky miratim u dha në ditën pas kërkimit të shtëpisë së ankueses,

dhe më pas u mbështet nga kryetari i gjykatës së shkallës së parë pasi që ankuesja paraqiti një ankesë.

Në shtator të vitit 2010, Avokati i Popullit dha një mendim jo të detyrueshëm në të cilin ai arriti në përfundimin se veprimet e autoriteteve hetuese i kishin shkelur të drejtën në lirinë e shprehjes dhe të drejtën e ankueses për të mos zbuluar burimet e saj të informacionit gazetaresk, siç është përcaktuar Kushtetutën kombëtare dhe traktatet ndërkombëtare.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesja u ankuu se ajo ishte detyruar të zbulonte informacione që kishin mundësuar identifikimin e një burimi gazetaresk, duke shkelur kështu të drejtën e saj për të marrë dhe dhënë informacionin siç garantohet me Nenin 10 të Konventës. Në parashtresën e saj, ajo pretendoi se ndërhyrja në lirinë e saj të shprehjes nuk ishte e përcaktuar me ligj, nuk kishte një qëllim legjitim dhe nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Më tej, ankuesja kërkoi nga Gjykata që të sqarojë detyrat e shtetit sipas kësaj dispozite në këto rrethana.

Së pari, Qeveria ngriti një vërejtje paraprake se ankuesja nuk i kishte dorëzuar Gjykatës ndonjë kopje të ankesave të saj të parashtruara pranë autoriteteve vendore dhe kështu nuk kishte arritur të demonstronte se çështjet e parashtruara para Gjykatës ishin ngritur të paktën në thelb në nivel kombëtar. Ata konsideruan se ajo kishte dështuar të parashtronte kërkesën në përputhje me Nenin 34 të Konventës dhe nuk e kishte paraqitur kërkesën e saj siç duhet, në përputhje me kërkesat e Rregullës 47 të Rregullores së Gjykatës. Së dyti, Qeveria ngriti një vërejtje paraprake lidhur me shterjen e mjeteve juridike vendase, duke u mbështetur në vendimin e Gjykatës në *Grišankova dhe Grišankovs kundër Letonisë*,⁵⁷ bazuar në të cilin ankuesja duhet të kishte paraqitur një ankesë në Gjykatën Kushtetuese në qoftë se ajo konsideroi se procedura sipas Nenit 180 të Ligjit të Procedurës Penale si të aplikuara për të nuk ofronin garanci të mjaftueshme procedurale, ose se dështimi për të siguruar mbrojtje shtesë statutores në lidhje me gazetaret lidhur me privilegjet e mos-zbulimit (Nenet 121 dhe 122 të Ligjit të Procedurës Penale) kishin ndërhyrë me të drejtat e saj njerëzore. Ajo duhet të ketë ngritur çështjen e përputhjes së këtyre dispozitave ligjore me Kushtetutën Letoneze dhe vetë Konventën. Ankuesja kundërshtoi këto pretendime.

Në lidhje me pohimet e qeverisë Gjykata përsërit se tashmë në disa raste ka hedhur poshtë një kundërshtim të ngjashëm paraprak nga ana e Qeverisë së Letonisë dhe për këtë nuk sheh asnjë arsye që në rastin në fjalë të veprojnë ndryshe andaj e shpall rastin si të pranueshëm.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me aplikimin e Nenit 10 Gjykatat deklaroi se pajisjet për ruajtjen e të dhënave të cilat ishin të konfiskuara gjatë kontrollit të shtëpisë së ankueses shërbenin jo vetëm për të ruajtur informacion dhe jo vetëm për identifikimin e burimit të informacionit të saj në lidhje me rastin në fjale, por ato përmbanin edhe burimet të tjera të informacioneve të punës së saj si gazetaresk. Prandaj, Gjykata nuk pranoi argumentin e

⁵⁷ *Grišankova dhe Grišankovs kundër Letonisë*, nr. 36117/02, GjEDNj-2003 II

Qeverisë se kërkimi nuk ka të bëjë me burime të gazetarisë dhe si rezultat Gjykata deklaroi se kërkimi në shtëpinë e ankueses dhe informacioni i marrë bie në sfondin e mbrojtjes sipas Nenit 10 të Konventës. Për më tepër, Gjykata konsideroi se kishte pasur një ndërhyrje në lirinë e ankueses për të marrë dhe për të dhënë informacion. Kjo ndërhyrje ishte "e përcaktuar me ligj" dhe ndoqi një qëllim legjitim për parandalimin e çrregullimit ose krimit dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve sipas autoriteteve vendore.

Në lidhje me këtë Gjykata deklaroi se arsyet e dhëna nga autoritetet vendase për kontrollin nuk ishin "relevante" dhe "të mjaftueshme", as nuk përbënin një "nevojë të ngutshme sociale". Sipas Gjykatës tema për të cilën raportoi ankuesja dhe për të cilën ajo kishte hulumtuar përbën një kontribut të dyfishtë në debatin publik. Ajo e informoi publikun për pagat e paguara në sektorin publik në kontekstin e një klime të krizës ekonomike dhe kursimit, si dhe ekspozoi të metat e sigurisë në bazën e të dhënave të të Ardhurave të Shërbimit të Shtetit. Gjykata theksoi se e drejta e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e tyre nuk mund të konsiderohet një privilegj, i varur nga ligjshmëria ose paligjshmëria e tyre, por më tepër si një pjesë e brendshme e së drejtës për informacion që duhet trajtuar me kujdes maksimal. Në të vërtetë, kur autoritetet hetuese, thuajse tre muaj pas transmetimit dhe pasi ankuesja kishte pranuar të dëshmonte, vendosi që një kërkim në shtëpinë e saj ishte i domosdoshëm, ata proceduan nën procedurën *urgjente* pa asnjë autorizim gjyqësor duke analizuar siç duhet marrëdhënien e proporcionalitetit ndërmjet interesit publik e hetimit, në njërën anë, dhe mbrojtjes së lirisë së gazetarit në anën tjetër. Duke marrë parasysh se nuk kishte asnjë informacion që lidhte ankuesen me personin e ashtuquajtur 'Neo' në ndonjë mënyrë tjetër përveçse në kapacitetin e saj si gazetare, çdo kërkim që përfshin konfiskimin e pajisjeve të ruajtjes së të dhënave që i përkasin një gazetari ngrit çështjen e lirisë së shprehjes së gazetarit, duke përfshirë burimin mbrojtjen dhe qasjen në informatat që përmban ai/ajo duhet të mbrohen mjaftueshëm dhe në mënyrë adekuate kundër abuzimit.

Edhe pse gjykatësi hetues shqyrtoi ligjshmërinë dhe arsyet për kërkimin në shtëpinë e e ankueses pasi publikimit të informacioneve në rastin në fjalë kishte ndodhur, duke u bazuar në legjislacionin e brendshëm, gjyqtari nuk arriti të vërtetojë se interesat e hetimit në sigurimin e provave ishin të mjaftueshme për të anashkaluar interesin e publikut në mbrojtjen e lirisë së shprehjes së gazetarit, duke përfshirë mbrojtjen e burimit dhe mbrojtjen nga dorëzimi i materialit hulumtues. Arsyet si më lartë janë të mjaftueshme për Gjykatësn që të vie në përfundim se nuk ishin dhënë arsye relevante dhe të mjaftueshme për ndërhyrjen e pretenduar. Andaj Gjykata gjen se ka pasur shkejlë të Nenit 10 të Konventës.

Ankuesja u ankua gjithashtu se kërkimi në banesën e saj përbënte ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën e saj për respektimin e shtëpisë dhe të jetës private, të mbrojtur me Nenin 8 të Konventës. Ajo vuri në dukje se laptopi i saj, i cili ishte konfiskuar, përmbante informacione private të cilat ajo nuk i konsideronte të nevojshme për qëllimet e hetimit, andaj ajo kundërshtoi, fushëveprimin e gjerë të urdhrin për kërkim. Gjykata vëren se ankuesja nuk ka përmendur, edhe në mënyrë përmbledhëse, llojin e informacionit të ruajtur në laptopin e saj personal ose në pajisjet e tjera të ruajtjes së të dhënave dhe masën e ndërhyrjes së supozuar në jetën private të

saj. Sa i përket të drejtës së ankueses për respektimin e shtëpisë së saj, Gjykata tashmë ka shqyrtuar rrethanat faktike që rrethojnë atë kërkim sipas Nenit 10 të Konventës, andaj nuk e konsideron të nevojshme të shqyrtojë pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e kësaj ankese veças sipas Nenit 8 të Konventës në rrethanat e rastit aktual.⁵⁸

Lidhur me dëmet e pretenduara Gjykata përcakoi se Letonia do t'i paguante ankuesit 10,000 EUR në lidhje me dëme jomateriale dhe 10,000 EUR në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 10, dhe vendos se nuk ka nevojë të shqyrtohen pretendimet nën Nenin 8 të Konventës [njëzëri].

⁵⁸ *Telegraaf Media Nederland, Landelijke Media BV dhe të tjerët kundër Holandës*, nr. 39315/06, § 120, 22 Nëntor 2012

Tillack kundër Belgjikës - 20477/05

27 shkurt 2008 [Seksioni i Dytë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 10

Shkelje e lirisë së shprehjes me rastin e bastisjes së shtëpisë dhe vendit të punës së ankuesit / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: burim gazetaresk / liri e shprehjes / bastisje / konfiskim / zbulim i burimit / ryshfet / interes publik

Ankuesi: z. Hans Martin Tillack, shtetas gjerman i lindur në vitin 1961 dhe jeton në Berlin

Faktet e rastit

Ankuesi është gazetar i revistës gjermane Stern dhe është caktuar në Bruksel, nga gushti 1999 deri në korrik 2004, për të raportuar mbi politikat e Bashkimit Evropian dhe aktivitetet e institucioneve evropiane. Në shkurt dhe mars të vitit 2002, ankuesi botoi dy artikuj në Stern bazuar në informacionin nga dokumentet konfidenciale të Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF). Artikulli i parë raportoi akuzat e një nëpunësi civil Evropian lidhur me parregullsitë në institucionet evropiane, ndërsa i dyti kishte të bënte me hetimet e brendshme që OLAF kishte kryer në këto akuza.

Duke dyshuar që ankuesi ka marrë ryshfet nga një nëpunës civil duke paguar 8,000 EUR në këmbim të informacionit konfidencial në lidhje me hetimet në progres në institucionet evropiane, OLAF hapi një hetim për të identifikuar informatorin. Në shkurt 2004, pasi hetimi nuk arriti të zbulojë zyrtarin në origjinën e rrjedhjeve, OLAF paraqiti një ankesë kundër ankuesit tek autoritetet gjyqësore belge,. Këto të fundit hapën një hetim kundër një personi ose personave të panjohur për shkelje të besimit profesional dhe ryshfetit që përfshinte një nëpunës civil.

Më 19 mars 2004 u bastisën shtëpitë dhe vendi i punës së ankuesit; pothuajse të gjitha dokumentet dhe mjetet e punës së ankuesit u konfiskuan dhe u vunë nën vulë (16 arka letrash, dy kuti skedash, dy kompjutera, katër telefona celularë dhe një kabinet metalik). Ankuesi kërkoi që gjërat e tij të ktheheshin, por pa sukses. Ndërkohë, ankuesi kishte parashtruar një ankesë pranë Avokatit të Popullit Evropian. Në maj të vitit 2005, Avokati i Popullit dërgoi një raport të posaçëm në Parlamentin Evropian, në të cilin konkludoi se dyshimi i ryshfetit nga ana e ankuesit ishte bazuar në thashetheme të përhapura nga një gazetar tjetër dhe jo nga deputetët e Parlamentit Evropian, siç kishte sugjeruar OLAF. Avokati i Popullit përfundoi në rekomandimin e tij se OLAF duhet të pranojë se kishte bërë deklaratatë të pasakta dhe mashtruese në parashtrësit e veta pranë Avokatit të Popullit.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi u ankua në veçanti se bastisjet dhe konfiskimet në shtëpinë e tij dhe në vendin e tij të punës përbënin shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes duke u

mbështetur në Nenin 10 të Konventës. Ankuesi sfidoi si ligjshmërinë ashtu edhe legjitimitetin e bastisjeve. Duke u bazuar në praktikën gjyqësore siç kishte qenë në kohën e bastisjeve, ai argumentoi së pari se edhe pse Akti i Mbrojtjes së Gazetarëve të 7 Prillit 2005 ishte miratuar pas kryerjes së kontrolleve, ajo ishte e zbatueshme me analogji në rastin prezent. Sipas tij, ky ligj kishte përcaktuar parimet e ripohuara në shumë raste nga Gjykata, të cilat tashmë ishin zbatuar në sistemin ligjor belg. Ankuesi më tej argumentoi se bastisjet ishin të paligjshme pasi që nuk ishin kryer në ndjekje të ndonjë qëllimi të përmendur në paragrafin 2 të Nenit 10, por vetëm për të zbuluar burimin e ankuesit, domethënë emrin i zyrtarit të OLAF i cili kishte shkelur sekretin profesional, ose dëshmi për ryshfet të mundshëm. Sa i përket asaj nëse ndërhyrja ishte e nevojshme, ankuesi vuri në dukje se asnjë akuzë nuk ishte ngritur kundër tij, dhe se bastisjet ishin kryer lidhur me persona të panjohur. Në parashtresën e tij, fakti që artikujt e botuar përmbanin informata konfidenciale dëshmuon më së shumti se një zyrtar i OLAF kishte zbuluar informacione konfidenciale. Po ashtu, ai shtoi se raporti i OLAF ishte formuluar në terma hipotetik dhe bazuar ekskluzivisht në thashetheme. Duke iu referuar dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe konkluzioneve të Gjykatës në aktgjykimin e saj *Ernst dhe të tjerët kundër Belgjikës*,⁵⁹ Qeveria parashtroi se ishte e kotë për ankuesin të kontestonte bazën ligjore për ndërhyrje. Sa i përket pretendimit të ankuesit se shkelja e sekretit profesional nga një nëpunës civil Evropian nuk përbënte shkelje sipas ligjit belg, Qeveria theksoi se Neni 458 i Kodit Penal ka imponuar një detyrë të fshehtë profesionale për "të gjithë... personat që, për shkak të statusit ose profesionit të tyre, janë kujdestarë të sekreteve që u janë besuar atyre". Qeveria më tej pohoi se legjitimiteti i ndërhyrjes ishte vendosur; masat e kontestuara kishin për qëllim parandalimin e zbulimit të informacionit të marrë në besim dhe parandalimin e çrregullimeve dhe krimit. Meqë bastisjet dhe konfiskimet ishin kryer në kontekstin e hetimit të kryer nga autoritetet gjyqësore, nuk mund të diskutohej se ata kanë ndjekur qëllim legjitim. Në lidhje me atë nëse ndërhyrja ishte e nevojshme, Qeveria tërhoqi vëmendjen e Gjykatës në një faktor themelor, përkatësisht sjelljen e ankuesit. Në rastin në fjalë, qëllimi i bastisjeve dhe konfiskimeve kishte qenë jo vetëm që të zbulonte identitetin e personit që kishte shkelur detyrën e sekretit profesional, por edhe për të gjetur dëshmi se ankuesi kishte ofruar dhe pranuar ryshfet si kryerës kryesor. Në fund Qeveria konsideroi se kishte marrë parasysh edhe parimin e proporcionalitetit gjatë marrjes së këtyre masave.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata përsëriti rëndësinë e lirisë së shtypit në një shoqëri demokratike dhe për mbrojtjen e burimeve gazetareske. Megjithatë kjo e drejtë nuk duhet të tejkalohet kufijtë e caktuar, veçanërisht në lidhje me reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve dhe nevojën për të parandaluar zbulimin e informacionit konfidencial, si dhe për të dhënë - në një mënyrë në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e saj - informacion dhe ide për të gjitha çështjet me interes publik.

Në mendimin e Gjykatës, bastisjet në këtë rast kishin shkaktuar ndërhyrje në të drejtën e ankuesit për lirinë e tij të shprehjes, dhe se ndërhyrja e tillë është parashikuar në Kodin

⁵⁹ *Ernst dhe të tjerët kundër Belgjikës*, nr. 33400/96, 15 korrik 2003

e Procedurës Penale të Belgjikës dhe ka ndjekur qëllimin legjitim për parandalimin e çrregullimeve dhe krimit, si dhe parandalimin e zbulimit të informacionit të marrë në besim dhe mbrojtjen e reputacionit të të tjerëve. Sa i përket ndërhyrjes se a ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike", për Gjykatën ishte e qartë se, në kohën kur u kryen bastisjet, qëllimi i tyre ishte identifikimi i burimit të informacionit të raportuar nga ankuesi në artikujt e tij. Pasi që hetimi i brendshëm i OLAF-it nuk arriti të prodhonte rezultatin e dëshiruar dhe dyshimi i ryshfetit nga ana e ankuesit u bazua në thashetheme të thjeshtë, nuk kishte pasur interes publik për të arsyetuar këto masa. Prandaj Gjykata konsideron se masat në fjalë kishin çenuar mbrojtjen e burimeve gazetareske.

Gjykata thekson se drejta e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e tyre nuk mund të konsiderohej si një privilegj i thjeshtë për t'u dhënë apo marrë në varësi të ligjshmërisë apo paligjshmërisë së burimeve të tyre, por ishte pjesë e së drejtës për informacion, që duhej të trajtohej me kujdes. Për më shumë, në rastin e ankuesit, ku ai kishte qenë i dyshuar për shkak të thashethemeve të paqarta dhe të pakorrigjueshme, siç u konfirmua më pas nga fakti se ai nuk ishte akuzuar. Shuma e pasurisë së konfiskuar gjithashtu duhej marrë në konsideratë. Duke qenë kështu, edhe pse arsyet e dhëna nga gjykatat belge ishin "relevante", ato nuk mund të konsideroheshin "të mjaftueshme" për të justifikuar bastisjet e kontestuara. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të Nenit 10 dhe deklaroi pjesën e mbetur të kërkesës si të papranueshme. Sipas Nenit 41 të Konventës, Gjykata caktoi 10,000 EUR në lidhje me dëmin jomaterial dhe 30,000 EUR për shpenzimet gjyësore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 10 të Konventës [*njëzëri*].

Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar - 17488/90

27 mars 1996 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 10

Urdhëri për zbulimin e identitetit të burimit të gazetarit së bashku me detyrimin për të paguar gjobë përbënin shkelje të së drejtës së shprehjes / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *burim gazetaresk / detyrim / zbulim identiteti / gjobë / informata konfidenciale / liri e shprehjes / interes publik*

Ankuesi: William Goodwin, shtetas anglez dhe me banim në Londër

Faktet e rastit

Ankuesi më 1989 filloi të punonte si gazetar në “The Engineer.” Vitin që filli punën, një burim i mëhershëm i gazetarit i kishte ofruar informata përmes telefonit për kompaninë Tetra Ltd., e cila po aplikonte për një kredi prej 5 milionë funtash për shkak të humbjeve të papritura në fitim prej 1.2 milionë funtash. Kompania pretendonte që informatat e botuara rrjedhnin nga një draft-dokument konfidencial që ishte zhdukur nga zyra e zyrtarit për financa të kompanisë.

Gazetari nuk kishte paguar për informatën e marrë dhe nuk kishte arsye të besonte që ajo informatë vinte nga dokumente të vjedhura ose konfidenciale, andaj edhe përgatiti një artikull për publikim. Kompania parashtrroi në gjykatë kërkesë për masë të përkohshme në mënyrë që të ndalonte gazetarin të publikonte ndonjë material që rridhte nga dokumenti në fjalë.

Gjykatat vendore, në disa instanca, vendosën në favor të kompanisë dhe urdhëruan gazetarin që të zbulonte burimin. Sipas gjykatës vendore, zbulimi i burimit ishte më rëndësi për të ndaluar dëmin që do të pësonte kompania nëse lajmi do të vazhdonte të shpërndahej. Gazetari refuzoi të zbatonte aktgjykimet e të gjitha instancave gjyqësore vendore që e urdhëronin atë të zbulonte burimin e informacionit. Si pasojë, ai u dënua me gjobë prej 5,000 funtash për mospërfillje të gjykatës.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi iu drejtua Gjykatës nën pretendimin se zbulimi i identitetit të burimeve të gazetarëve është në kundërshtim me të drejtën e lirisë së shprehjes të garantuar me Nenin 10 të Konventës. Pretendimi i ankuesit ishte se urdhëri që i kërkonte atij zbulimin e identitetit të burimit të tij dhe gjoba e shqiptuar si rezultat i refuzimit për të bërë atë paraqiste shkelje të Nenit 10 të Konventës.

Qeveria nuk u pajtua me këtë pretendim, derisa Komisioni nuk gjeti arsye për të arritur një përfundim në lidhje me këtë pikë. Gjykata, nga ana e saj, nuk kishte vënë në diskutim faktin se masat e përdorura përbënin ndërhyrje me të drejtën e ankuesit sipas Nenit 10 § 1 të Konventës. Si rezultat, ishte e nevojshme që të shqyrtohej nëse ndërhyrja justifikohej sipas paragrafit 2 të Nenit 10.

Ankuesi dhe Komisioni ishin të mendimit se Neni 10 i Konventës kërkonte që çfarëdo detyrimi i përcaktuar ndaj një gazetari për të zbuluar burimin e tij duhej të kufizohej në rrethana të jashtëzakonshme, kur interesat vitale të publikut ose individit janë në pyetje. Ky test nuk ishte plotësuar në rastin aktual. Nga ana e saj, Qeveria pretendonte se urdhëri për zbulim ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike për mbrojtjen e të drejtave të kompanisë Tetra.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjatë shqyrtimit të rastit, Gjykata fillimisht gjeti se nuk ishte i diskutueshëm fakti që masat e ndërmarra kundër ankuesit përbënin ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes siç garantohet me Nenin 10 të Konventës. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe ishte bërë për arsye legjitime, meqë synonte mbrojtjen e të drejtave të kompanisë Tetra Ltd. Gjykatës i mbetej të vlerësonte nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Sipas Gjykatës, mbrojtja e burimeve të gazetarëve përbën një ndër kriteret themelore për lirinë e shtypit dhe pa këtë mbrojtje burimet mund të hezitojnë të ndihmojnë gazetarët që të informojnë publikun për çështje me interes publik. Më tej, Gjykata vlerësoi se pa mbrojtje të burimeve, roli mbikëqyrës i shtypit mund të nënvlerësohet dhe po ashtu mund të ndikohet negativisht mundësia e shtypit që të ofrojë informata të besueshme dhe të sakta.

Për arsyet si më sipër, kufizimet në mbrojtjen e burimeve të gazetarëve kërkojnë mbikëqyrje shumë të kujdesshme. Në rastin konkret, të gjitha gazetat dhe gazetarët ishin njoftuar për urdhërin për zbulimin e burimit të gazetarit dhe masa e përkohshme ishte efektive për ndalimin e përhapjes së informacioneve konfidenciale të kompanisë përmes mediave. Rrjedhimisht, klientët dhe bashkëpunëtorët e kompanisë nuk do të informoheshin përmes shtypit dhe interesi vital i kompanisë ishte neutralizuar përmes masës së përkohshme. Urdhëri për zbulimin e burimit shërbeu thjesht për të përforcuar masën e përkohshme dhe nuk ishte i arsyetuar mjaftueshëm siç kërkohet me paragrafin e dytë të Nenit 10 të Konventës.

Gjykatat vendore theksuan se qëllimi legjitim i ndjekur me urdhërin për zbulimin e burimeve ishte zbulimi dhe largimi nga puna i punëtorit ose bashkëpunëtorit të pabesë, i cili ende ka mundur të ketë qasje në informatat e kompanisë. Gjykata e pranoi këtë argument si relevant, mirëpo nuk mundi të pranojë se interesi për mbrojtjen e kompanisë përmes veprimeve kundër burimit të gazetarit tejkalonte interesin vital të publikut në mbrojtjen e burimit të gazetarit. Sipas Gjykatës, qëllimi i ndjekur me urdhërin për zbulimin e burimeve dhe mjeteve të përdorura për të arritur atë qëllim nuk ishte proporcional. Për këto arsye, Gjykata vendosi që urdhëri për zbulimin e identitetit të burimit të gazetarit nuk ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike dhe së bashku me detyrimin për të paguar gjobë përbënin shkelje të së drejtës së tij për t'u shprehur, ashtu siç garantohet me Nenin 10 të Konventës.

Ndërsa sa i përket pretendimeve për dëme Gjykata vendosë se gjetja e shkeljes paraqet satisfaksion të drejtë për dëmin jo-material.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosë se ka shkelje të Nenit 10 të Konventës [*njëmbëdhjetë vota kundër shtatë*]; [*njëzëri*].

Butkevich kundër Ruisë - 5865/07

13 shkurt 2018 [Seksioni i Tretë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5 § 1

Shkelja e të drejtës në liri dhe siguri si pasojë e arrestimit të paligjshëm dhe vonesë prej gjashtë orësh në lirimin e ankuesit / *ka shkelje*

Neni 6 § 1

Procedurat e kundërvajtjes administrative nuk ishin të paanshme dhe u mungonin garancitë substanciale dhe procedurale / *ka shkelje*

Neni 10

Shkelje e lirisë së shprehjes si pasojë e pengimit të mbulimit të një ngjarjeje për shkak të ndalimit nga policia / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *protestë / gazetar / ndalim / paraburgim / jo-ligjshëm / tejzgjatje e paraburgimit / liri e shprehjes / mbulim i ngjarjes / mungesë prokurori*

Ankuesi: z. Maksim Butkevich, një shtetas ukrainas i lindur në vitin 1977 dhe jeton në Kiev

Faktet e rastit

Ankuesi, me profesion gazetar, u arrestua gjatë një proteste "kundër globalizimit" në mëngjesin e 16 korrikut 2006 në Shën Petersburg. Sipas tij, ai u arrestua edhe pse ai nuk kishte marrë pjesë në protestë dhe kishte respektuar urdhërin policor për të fikur kamerën e tij.

Ai ishte marrë me forcë në një stacion policor, ku u hartua një raport i kundërvajtjes. I akuzuar me kundërvajtje administrative të mosrespektimit të urdhërit të ligjshëm të policisë (sipas Nenit 19.3 të Kodit të Kundërvajtjeve Administrative), ai ishte sjellë para gjyqtarit në të njëjtën mbrëmje. Gjykatësi dëgjoi deklaratat nga ankuesi, i cili u vetëdeklarua jo fajtor. Gjykatësi gjithashtu i dha kërkesën e mbrojtjes dhe shqyrtoi një dëshmitar. Asnjë dëshmitar i anës së kundërt nuk u dëgjua e as nuk kishte prokuror në këtë rast.

Ankuesi u dënua me tre ditë heqje lirie, dënimin për të cilin gjykata u mbështet kryesisht në raportin e kundërvajtjes administrative dhe në raportet paraprake të hartuara nga policët që e kishin arrestuar atë. Pas një seance dëgjimore mbi çështjen e tij më 18 korrik 2006, dënimi i tij u konfirmua, por u reduktua në dy ditë, me efekt të menjëhershëm. Palët kontestojnë kohën e lirimit të tij. Qeveria parashtroi se ai ka vuajtur dënimin e tij të ndryshuar në ankesë dhe është liruar në orën 10:00, ndërsa ankuesi pohon se ai u lirua vetëm në orën 16:00, kur urdhri i gjykatës kishte arritur në objektin e paraburgimit.

Përmbledhje e pretendimeve

Duke u bazuar në Nenin 5 § 1 (e drejta për liri dhe siguri), ankuesi pretendoi se arrestimi i tij ishte i paligjshëm dhe se kishte pasur një vonesë prej gjashtë orësh në lirim e tij më 18 korrik 2006. Më tej duke u mbështetur në Nenin 6 § 1 për një gjykim të drejtë nga një gjykatë e paanshme), ai pretendonte se procedurat e kundërvajtjes administrative nuk ishin të paanshme dhe u mungonin garancitë procedurale. Së fundmi, ai u ankua në bazë të Nenit 10 (liria e shprehjes) se ai ishte arrestuar, ndaluar dhe dënuar pavarësisht nga fakti që ai i kishte thënë në mënyrë të përsëritur policisë se ai ishte gazetar. Ai pretendoi se kjo e kishte shkelur lirinë e tij për të mbuluar një ngjarje të madhe të organizuar nga Qeveria, duke përfshirë protestat lidhur me të.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me Nenin 5 § 1 të Konventës, Gjykata vuri në dukje se sipas ligjit rus arrestimi administrativ duhej të justifikohej nga "rrethanat e jashtëzakonshme" dhe/ose nga domosdoshmëria "për shqyrtimin e menjëhershëm dhe të duhur të çështjes administrative dhe për të siguruar zbatimin e çdo ndëshkimi që do të vendoset". Megjithatë, as autoritetet vendase, as qeveria ruse nuk kishin dhënë asnjë justifikim për arrestimin e ankuesit. Andaj arrestimi i ankuesit nuk ishte në përputhje me ligjin rus dhe nuk ishte e ligjshme në kuptim të Nenit 5 § 1.

Për më tepër, qeveria nuk kishte dhënë një raport të hollësishëm mbi paraburgimin administrativ të ankuesit dhe kohën e lirit të tij. Prandaj, Gjykata konsideroi se ai kishte mbetur në paraburgim deri në ora 16:00, më 18 korrik 2006, ashtu siç ishte paraqitur nga ankuesi. Megjithatë, sipas Nenit 5 të Konventës, paraburgimi i tij nuk ishte më i justifikueshëm pas orës 10:00 në atë ditë, koha në të cilën dënimi i tij konsiderohej të jetë shërbyer plotësisht. Nuk kishte asnjë justifikim për këtë vonesë gjashtë-orëshe në lirim e tij, pasi nuk kishte asgjë që të sugjeronte se kishte pasur vështirësi veçantë për të siguruar lirim e tij të menjëhershëm, siç kërkohet nga gjykata e apelit. Prandaj, Gjykata konstaton se kishte pasur shkelje të Nenit 5 § 1 të Konventës.

Lidhur me Nenin 6 § 1 të Konventës, Gjykata vuri në dukje se kishte gjetur tashmë një shkelje të kërkesës së paanshmërisë objektive sipas Nenit 6 § 1 në rastin *Karelin kundër Rusisë*,⁶⁰ shkak të mungesës së prokurorit në seancat gjyqësore në të cilat janë përcaktuar akuzat administrative. Gjykata nuk shihte arsye për t'u larguar nga ky vendim për të vendosur në rastin e ankuesit ku elementet faktike dhe ligjore ishin të ngjashme. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me ankesën për mungesën e paanshmërisë në procedurën administrative.

Duke marrë parasysh ankesën për mungesën e garancive procedurale, Gjykata shqyrtoi argumentin kryesor të ankuesit lidhur me përdorimin e raporteve paraprake të prodhuara nga dy oficerët arrestues për ta dënuar atë dhe mungesën e një mundësie për t'i vënë në pyetje ato. Gjykata vazhdoi me konstatimin se nuk kishte pasur ndonjë arsye të mirë/bindëse për mungesën e këtyre oficerëve të policisë nga gjykimi, kur dëshmia e tyre e kundërt kishte qenë vendimtare në marrjen e vendimit. Në veçanti, oficerët ishin

⁶⁰ *Karelin kundër Rusisë*, nr. 926/08, §§ 69-84, 20 Shtator 2016

në fillimin e procedurës, i përkisnin autoritetit që fillonte çështjen dhe kishin qenë dëshmitarë okularë për pjesëmarrjen e supozuar të ankuesit në një ngjarje publike të paligjshme, si dhe refuzimin e tij për të përmbushur një urdhër policie. Prandaj, dënimi i tij ishte bazuar në atë që quhej provë e patestuar. Pyetja e një dëshmitari në gjykimin e ankuesit nuk kishte qenë e mjaftueshme për të balancuar një të metë të tillë. Duke iu referuar rasteve të mëparshme të ngjashme në lidhje me procedurat administrative, Gjykata përsëriti se ishte e domosdoshme që gjykatat ruse të shfrytëzonin çdo mundësi të arsyeshme për të verifikuar deklaratat inkriminuese nga punonjësit e policisë të cilët kishin paraqitur provat kryesore negative të cilat ishin atëherë themeli për dënimin e të pandehurit. Prandaj, kishte pasur shkelje të mëtejshme të Nenit 6 § 1 në lidhje me të drejtën e Butkevich për një seancë të drejtë.

Lidhur me pretendimet për shkelje të Nenit 10 të Konventës, Gjykata vëren se arrestimi, ndjekja penale dhe dënimi me paraburgim administrativ kishte përbërë një "ndërrhyrje" me lirinë e tij si gazetar për të mbledhur informata për një ngjarje publike dhe për të publikuar fotografi. Gjykata nuk ishte e bindur se arsyet e dhëna nga autoritetet kombëtare për një ndërrhyrje të tillë ishin të mjaftueshme për të justifikuar dënimin e tij me dy ditë burgim. Vendimet e gjykatës vendase nuk e kishin vlerësuar argumentin e ankuesit se ai ishte duke vepruar si gazetar. As nuk kishte pasur ndonjë shqyrtim nëse demonstrata kishte qenë paqësore apo jo. Për më tepër, vendimet e gjykatës nuk kishin balancuar ndërrhyrjen në lirinë e shprehjes së ankuesit kundrejt një qëllimi legjitim, siç është parandalimi i trazirave, nëse ai kishte marrë pjesë si protestues në një veprim të paligjshëm, siç pohonin autoritetet dhe qeveria. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të Nenit 10 të Konventës.

Pra, Gjykata gjeti në veçanti se as gjykatat vendase, as Qeveria Ruse nuk kishin justifikuar arrestimin e ankuesit ose vonesën prej gjashtë orësh në lirinë e tij më 18 korrik 2006. Për më tepër, procedurat në të cilat ai ishte dënuar ishin në kundërshtim me kërkesën për paanshmëri objektive për shkak të mungesës së palës akuzuese në seancën gjyqësore në rastin e tij. Këto procedura ishin gjithashtu të padrejta për shkak se punonjësit e policisë të cilët e kishin arrestuar atë dhe kishin paraqitur raportet paraprake mbi të cilat ishte bazuar dënimi i tij nuk u morën në pyetje gjatë asaj seance. Së fundi, Gjykata gjeti se vendimet ruse nuk kishin balancuar të drejtën e ankuesit për lirinë e shprehjes kundrejt një qëllimi legjitim, siç është parandalimi i trazirave, duke injoruar argumentin e tij se ai ishte duke vepruar si gazetar dhe duke mos shqyrtuar në mënyrë adekuate nëse demonstrata kishte qenë paqësore ose jo. Andaj kishte pasur shkelje të Nenit 10 të Konventës.

Po ashtu, Gjykata vendosi se Rusia do t'i paguante ankuesit 7,000 EUR në lidhje me dëmin jo-material dhe 2,000 EUR për shpenzimet gjyqësore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 5 § 1 të Konventës, dy shkelje të Nenit 6 § dhe gjithashtu shkelje të Nenit 10 të Konventës [njëzëri].

Antović dhe Mirković kundër Malit te Zi - 70838/13

28 nëntor 2017 [Seksioni i Dytë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 8

Shkelje të drejtës për respektimin e jetës së private si pasojë e instalimit të paligjshëm dhe përdorimit të pajisjeve të mbikëqyrjes me video në auditoriumet e universitetit / *ka shkelje*.

Fjalët kyçe: *hapësirë publike / universitet / auditorium / video-mbikëqyrje / privatësi / cënim / hapësirë private / pa pëlqim*

Ankuesit: znj. Nevenka Antović dhe z. Jovan Mirković, shtetas malazes

Faktet e rastit

Ankuesit janë shtetas malazezë që jetojnë në Podgoricë, dhe punojnë si profesorë të Matematikës në universitet. Në shkurt 2011, dekani i Shkollës së Matematikës njoftoi se ai kishte vendosur të instalonte kamerat e vëzhgimit në disa zona, duke përfshirë auditoriumet ku mbahet mësimi. Një vendim i lëshuar më vonë në të njëjtin muaj specifikonte se vendosja e kamerave ishet ndërmarrë si mase për të mbrojtur njerëzit dhe pronën dhe për të monitoruar mësimdhënien. Ankuesit parashtruan një ankesë në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në mars 2011, duke thënë se mbikëqyrja me video-kamera dhe mbledhja konsekuente e të dhënave mbi ta ishte duke u zhvilluar pa pëlqimin e tyre. Ata deklaruan se nuk dinin asnjë arsye për t'u frikësuar për sigurinë e askujt dhe se ka pasur mënyra të tjera për të mbrojtur njerëzit dhe pronën. Ata gjithashtu kërkuan që kamerat të hiqen. Dy inspektorë nga Agjencia fillimisht e mbështetën Shkollën, por pas një kundërshtimi nga ankuesit Këshilli i Agjencisë vendosi që masa nuk ishte në përputhje me Ligjin e Malit te Zi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këshilli i Agjencisë konsideroi se nuk kishte asnjë arsye të mirë për video-mbikëqyrjen si dhe nuk kishte asnjë rrezik për njerëzit ose pronën dhe se mbikëqyrja e mësimdhënies nuk ishte justifikim për një masë të tillë në Ligjin e Malit te Zi për mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë Këshilli i Agjencisë urdhëroi që kamerat të hiqen, gjë që ishte bërë nga fundi i janarit 2012.

Në janar 2012, ankuesit kërkuan kompensim në gjykatë, duke përmendur Nenin 8 të Konventes (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe bazuar në të drejtën e brendshme. Megjithatë, gjykatat refuzuan kërkesën e tyre. Ata konsideronin se çështja e jetës private nuk ishte në diskutim pasi që auditoriumet ku mbanin mësim ankuesit ishin zona publike. Të dhënat e mbledhura nga vëzhgimi me video gjithashtu nuk ishte edhe të dhëna personale. Gjykata gjithashtu konsideroi se monitorimi i veprimeve të një individ në një vend publik me përdorimin e pajisjeve fotografike të cilat mbledhnin vetëm të dhënat vizuale të regjistruara menjëherë nuk kanë shkaktuar ndërhyrje me jetën private të atij individ, që mund të lindë njëherë kur ndonjë filmim i një material i tillë u bë publikisht i disponueshëm. Gjykata arriti në përfundimin se instalimi dhe përdorimi i video survejimit dhe mbledhja e të dhënave në këtë mënyrë

nuk e shkeli të drejtën e ankuesve për privatësi (pravo na privatnost) prandaj nuk u shkaktoi atyre ndonjë stres psikik. Gjatë procedurës së degjimit të dëshmitarëve u kuptua se në hapësirat e universitetit kishte pasur raste të vjedhjes dhe dëmtimeve të brendshme. Këto ngjarje kishin çuar në punësimin e një agjencie private të sigurisë. Sipas dëshmitarit, policia kishte sugjeruar instalimin e pajisjeve të video-mbikëqyrjes në apësirat e shkollës.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit u ankuan sipas Nenit 8 të Konventës se instalimi i paligjshëm dhe përdorimi i pajisjeve të video-mbikëqyrjes në auditorët e universitetit ku mbajtën mesimin kishin shkelur të drejtën e tyre për të respektuar jetën e tyre private. Ata argumentuan, në veçanti, se ndërhyrja në të drejtën e tyre për respekt për jetën e tyre private nuk kishte qenë në pajtueshmëri me ndonjë ligj dhe prandaj ishte në kundërshtim me Nenin 8 § 2 të Konventës. Gjithashtu ankuesit deklaruan se ndërmarrja e një mase të tillë-mbikëqyrje me kamerë - nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Për më tepër, sipas ankuesit Gjykata e Shkallës së Parë nuk ishte mbështetur në asnjë dispozitë ligjore në vendimin kundër tyre dhe nuk arriti të vlerësojë argumentet e tyre. Më 17 korrik 2013, Gjykata e Lartë në Podgoricë e miratoi aktgjykimin e shkallës së parë, duke mbështetur arsyet e saj në thelb. Gjykata e Lartë në veçanti, deklaroi që ankuesit nuk kishin vërtetuar se e drejta e tyre në privatësi ishte shkelur dhe gjeti se gjykata e shkallës së parë kishte qenë në mënyrë të mjaftueshme në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës me Evropiane.

Qeveria kundërshtoi pretendimet duke theksuar se jo të gjitha aktivitetet profesionale dhe biznesore bien brenda hapësirës së jetës private. Sipas Qeverisë Universiteti është një institucion publik dhe mësimi është një aktivitet me interes publik. Zona që ishte nën mbikëqyrje ishte një hapësirë pune dhe përbën hapësirën jashtë fushëveprimit të autonomisë personale, ndryshe nga zyrat e profesorëve, ku një sasi e caktuar e autonomisë personale mund të ekzistonte. Qeveria gjithashtu pohoi se ankuesit kishin dështuar të përdornin të gjitha mjetet juridike efektive vendase, veçanërisht kishin dështuar të sillnin një apel kushtetues.

Ankuesit kontestuan parashtrimet e Qeverisë. Në veçanti, ata pohonin se një ankesë kushtetuese nuk praqiste një mjet efektive korrigjimi në kohën përkatëse.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata filloi duke refuzuar argumentin e Qeverisë për pranueshmërinë e rastit, sipas të cilit jeta private e të dy profesorëve nuk kishte qenë në diskutim pasi zona nën mbikëqyrje ishte publike, konkretisht ishte hapësirë publike e punës. Gjykata vuri në dukje se më parë kishte gjetur se "jeta private" mund të përfshinte edhe jetën profesionale dhe konsideroi se pikërisht kjo kishte të bente në rastin e ankuesve. Prandaj, Neni 8 ishte i zbatueshëm dhe rasti ishte i pranueshëm.

Gjykata pastaj vazhdoi të theksonte se ajo kishte konstatuar në gjykimet e mëparshme se nocioni i jetës private mund të përfshijë edhe aktivitete profesionale që zhvillohen në një kontekst publik dhe ka vërejtur se amfiteatrit universitar ishte vend i punës së profesorëve, ku ata jo vetëm që mësonin, por ndërveprojnë me studentët, zhvillojnë marrëdhënie dhe kontribuojnë në ndërtimin e identitetit të tyre social.

Gjykata kishte gjetur më parë se mbikëqyrja e fshehtë me video-kamera në punë është ndërhyrje në jetën private të një punonjësi dhe Gjykata nuk ka asnjë arsye për t'u larguar nga ky qëndrim përse i përket së fshehtë në një vend pune siq është rasti në fjalë. Si pasojë, jeta private e ankuesve ishte cënuar dhe mbikëqyrja e aktiviteteve të tyre nga kamera ishte një ndërhyrje në të drejtat e tyre. Për më tepër, gjykatat vendase nuk e kishin shqyrtuar ligjshmërinë e masës, sepse nuk kishte gjetur në radhë të parë se ishte çështje e privatësisë. Megjithatë, të dhënat nga Agjencia e Mbrojtjes tregojnë se Agjencioni e kishte konsideruar mbikëqyrjen me kamera si një ndërhyrje dhe kishte gjetur se kjo ndërhyrje nuk kishte qenë në përputhje me ligjin. Për shembull, legjislacioni i brendshëm kishte deklaruar se video-kamerat mund të përdoren për të monitoruar zonat e qasjes në lokalet zyrtare, megjithatë, në këtë rast ato ishin vendosur në amfiteatre. Ligji i brendshëm kishte parashikuar gjithashtu që mbikëqyrja mund të kryhej nëse qëllimi i masës, kishte të bënte me parandalimin e rrezikut për pronën ose njerëzit, dhe kjo mbrojtje nuk mund të arrihej në një mënyrë tjetër. Të dhënat nga Agjencia e Mbrojtjes nuk kishin treguar se ka ndonjë rrezik të tillë, ndërsa një arsye tjetër e përmendur për masën e ndërmarrë në lidhje me mbikëqyrjen e mësimdhënies, nuk parashihej fare në ligj si një justifikim për ndërmarrjen e një mase të tillë. Prandaj, Gjykata gjeti se vide- mbikëqyrja edhe pse i lajmëruar nuk ishte në përputhje me ligjin dhe se ka pasur shkelje të Nenit 8.

Gjykata gjithashtu caktoi se Mali i Zi do t'i paguante 1,000 EUR për secili ankues në lidhje me dëmin jomaterial dhe 1,669.50 EUR në lidhje me shpenzimet dhe shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se ka shkelje të Nenit 8 të Konventës [*katër për/tre kundër*]

Gjyqtarët Vučinić dhe Lemmens shprehën një mendim të përbashkët. Gjyqtarët Spano, Bianku dhe Kjølbros shprehën një opinion të përbashkët kundërthënës. Këto opinione i bashkëngjiten aktgjykimit.

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 8

Në kontekst të një postimi në Instagram që e akuzon ankuesin si përdhunues përbën shkeletë së drejtës së privatësisë përkundër faktin që bie ndesh me lirinë e shprehjes / *ka shkelje*

Neni 10

Arritje e baraspeshës së drejtë me rastin kufizimit të lirisë së shprehjes sipas Nenit 10 në të mirë të mbrojtjes së jetës private / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: rrjete sociale / figurë publike / privatësi / postim / publik / qasje publike / cënim i privatësisë / akuza / reputacion

Ankuesi: z. Egill Einarsson, shtetas i Islandës, i lindur në vitin 1980

Faktet e rastit

Ankuesika qenë person i njohur në shtetin e tij, Islandën, kur për vite të tëra ka publikuar artikuj, blogje dhe libra, si dhe është paraqitur në filma, në televizion dhe në medime të tjera, duke përdorur pseudonime të ndryshme.

Ankuesi ka shprehur pikëpamjet e tij edhe sa u përket femrave dhe lirisë së tyre seksuale. Në vitet 2011 dhe 2012, dy femra kanë raportuar në polici se ankuesika kryer vepra penale të karakterit seksual kundër tyre. Policia ka hetuar dhe përfundimisht hedhur poshtë pretendimet. Ankuesi, nga ana e tij, ka paraqitur ankesë në polici, duke ngritur pretendimin se akuzat ndaj tij kanë qenë false. Kjo ankesë, po ashtu, është hedhur poshtë nga policia. Në nëntor të vitit 2012, një revistë në Islandë botoi një intervistë me ankuesin. Fotografia e tij ishte publikuar në faqenë e parë dhe, në intervistë, ankuesi diskutonte për akuzat për dhunim të ngritura ndaj tij. Ai me këtë rast deklaroi disa herë se akuzat kanë qenë false.

Në ditën e njëjtë me atë të botimit të intervistës, personi X ka publikuar një version të modifikuar të fotografisë së botuar të ankuesit, duke e fyer atë dhe quajtur “bastard përdhunues” në llogarinë e tij në Instagram. X kishte rreth 100 individë që e ndiqnin atë në Instagram dhe kishte besuar se vetëm ndjekësit e tij kishin qasje në gjërat që postonte. Sidoqoftë, fotografite e X-it ishin të qasshme edhe për përdoruesitë e tjerë të Instagramit në domenin publik. Ditën tjetër, një revistë kishte publikuar një artikull *online* rreth postimit të X-it, duke ripublikuar fotografinë e modifikuar për një audiencë më të gjerë.

Ankuesi kishte filluar procedurat gjyqësore kundër personit X para Gjykatës së Qarkut. Gjykata kishte vendosur kundër tij, dhe kishte përcaktuar se deklaratat e X-it ishin brenda kufijve të lirisë së shprehjes. Fotografia e modifikuar dhe fjalët e paraqitura nga X ishin konsideruar të paraqisnin një gjykim të lirë më tepër sesa një deklaratë fakti.

Ankuesi kishte apeluar vendimin e Gjykatës së Qarkut pranë Gjykatës Supreme. Gjykata Supreme kishte lënë në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët. Gjykimi kishte analizuar historinë e ankuesit publikimit të pikëpamjeve të tij kundërthënëse, duke përfshirë qëndrimet e tij ndaj femrave. Gjykata Supreme ka gjetur se kur ankuesi ka dhënë intervistën dhe ka bërë komente provokative rreth femrave që e kanë akuzuar atë për vepra seksuale, ai ka nisur një debat publik dhe, për më tepër, “e ka ditur se komentet e tij të forta do të rezultojnë në reagime të forta nga ata që fuqishëm nuk pëlqejnë pikëpamjet e tij”.

Përmbledhje e pretendimeve

Pretendimi kryesor i ankuesit ishte se vendimi i Gjykatës Supreme të Islandës përbënte shkelje të së drejtës së tij për jetë private, ashtu siç garantohej në Nenin 8 të Konventës. Më saktësisht, ankuesi ka theksuar se kur X-i ka publikuar fotografinë e tij të modifikuar, me mbishkrimin “...bastard përdhunues”, ai e ka akuzuar atë për dhunim të një personi specifik, ndonëse X-i e ka ditur se rasti kundër tij është hedhur poshtë nga prokurori. Sipas mendimit të ankuesit, kjo ka qenë një deklaratë fakti rreth tij si dhunues, që do të mund të provohej.

Ankuesi tutje ka deklaruar se X-i e ka publikuar fotografinë dhe deklaratën në gjuhën angleze dhe e ka bërë atë të qasshme për mbi 100 milionë përdorues të Instagramit. Si rrjedhojë, fotografia është botuar edhe në mediat islandeze. Fotografia ka krijuar përshtypjen se personi në fotografi (ankuesi) është dhunues. Më tej, ankuesi ka theksuar se përfundimi i Gjykatës Supreme nënkupton se ankuesi do të mund të quhej dhunues pa qenë i akuzuar dhe dënuar për një krim të tillë dhe pa pasur mundësinë që të mbrojë veten. Sipas tij, kjo paraqet shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Sa i përket qëndrimin të Qeverisë, ajo, në radhë të parë, ka theksuar se faktet e këtij rasti janë të ndryshme nga rastet e tjera që përfshinin mediat të cilat kanë publikuar informacione për individë dhe si rrjedhojë parimet e përdorura nga Gjykata në ato raste nuk mund të aplikohen në mënyrën e njëjtë në rastin konkret. Për shembull, kriteri i metodës së marrjes së informacionit nuk aplikohet në këtë rast. Sipas Qeverisë, informacioni është shpërndarë nga një individ, që shprehë gjykimin e tij të lirë personal rreth ankuesit dhe nuk ka qenë i synuar për publikun e gjerë.

Sipas pikëpamjes së Qeverisë, gjykatat vendore kanë aplikuar standarde që janë në përputhshmëri me parimet e mishëruara në Nenin 8 të Konventës, ashtu siç ato parimet janë interpretuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës. Sipas Qeverisë, gjykatat vendore, gjithashtu, gëzojnë një hapësirë vlerësimi; dhe se gjykatat vendore gëzojnë një margjinë më të gjerë vlerësimi në lidhje me detyrimet pozitive të palëve private, ku mendimet brenda një shoqërie demokratike mund të ndryshojnë në masë të madhe. Qeveria, po ashtu, ka vënë re se gjykatat vendore kanë analizuar materialin në tërësi dhe kanë ardhur në përfundimin se deklarata ka qenë gjykim i lirë dhe jo përcaktim faktik.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjatë shqyrtimit të rastit, Gjykatës i është kërkuar që të baraspeshojë të drejtën për respektim të jetës private me të drejtën për lirinë e shprehjes. Në këtë kuptim, Gjykata ka vërejtur se faktorë të rëndësishëm në vlerësimin e kësaj baraspeshë mund të jenë

“kontributi ndaj një debati të interesit të përgjithshëm; sa i njohur është personi konkret dhe cila është tema e raportit; sjellja e mëhershme e tij ose saj; metoda e marrjes së informacionit dhe saktësia e tij; përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit; dhe ashpërsia e sanksioneve të zbatuara”. Si shtesë e kësaj, me qëllim vlerësimi të justifikimit për një deklaratë të kundërshtuar, duhet bërë dallim ndërmjet deklaratave të faktit dhe gjykimeve vlerësuese.

Lidhur me pyetjen sa i njohur është ankuesi, Gjykata është pajtuar me gjetjet e gjykatave islandeze se kufijtë e kritikës së pranueshme në këtë rast duhet të jenë më të gjerë sesa në rastin kur një individ nuk është i njohur. Përkundër kësaj, Gjykata ka theksuar se edhe personat e njohur publikisht kanë pritje legjitime për respektim të jetës së tyre private. Gjykata, po ashtu, është pajtuar me gjykatat vendore se, në dritë të faktit se ankuesi ishte person i mirënjohur dhe deklaratat e kundërshtuar ishte pjesë e një debati të përgjithshëm në lidhje me akuzat për një vepër serioze penale, kjo ishte një çështje e interesit të përgjithshëm.

Përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit të kundërshtuar - a ishte publikimi një deklaratë fakti apo gjykim vlerësues?

Gjykata nuk është pajtuar me gjykatat vendore sa i përket përmbajtjes, formës dhe pasojave të publikimit. Ajo e ka konsideruar shprehjen “përdhunues” si diçka “objektive dhe faktike sipas natyrës”. Gjykata ka gjetur se konteksti faktik në të cilin është bërë deklaratat e kundërshtuar dhe deklarimi se ankuesi ishte një “përdhunues” pas ndërprerjes së procedurave penale kundër tij, nuk është marrë parasysh në mënyrë të duhur. Qoftë edhe si gjykim vlerësues, ka nevojë për bazë të mjaftueshme faktike për të mbështetur një deklaratë të tillë dhe, në këtë rast, nuk ka pas një bazë të tillë pas ndërprerjes së procedurave penale.

Gjykata ka deklaruar se:

“thënë shkurt, Neni 8 i Konventës duhet interpretuar në atë mënyrë që individët, qoftë edhe individët e diskutueshëm publik që kanë nxitur debat të nxehtë për shkak të sjelljes së tyre dhe komenteve publike, nuk duhet të tolerojnë të qenurit publikisht të akuzuar për vepra të dhunshme kriminale në mungesë të mbështetjes së këtyre deklaratave në fakte. Prandaj, Gjykata gjen se deklaratat ka qenë e një natyre serioze dhe e aftë për të dëmtuar reputacionin e ankuesit. Ajo ka arritur atë nivel serioziteti sa për të krijuar paragjykim në lidhje me gëzimin e të drejtës për respektim të jetës private të ankuesit sipas Neni 8.”

Përfundimisht, Gjykata ka gjetur se gjykatat islandeze nuk kanë krijuar një baraspeshë të drejtë ndërmjet të drejtës së ankuesipër respektim të jetës private dhe të drejtës së X-it për lirinë e shprehjes. Kësisoj, ka shkelje të së drejtës së privatësisë së ankuesit.

Në lidhje me dëmshpërblimin: sa i përket dëmit jo-material, Gjykata vlerëson se gjetja e shkeljes së të drejtës së ankuesit paraqet satisfaksion mjaftueshëm të drejtë të çfarëdo dëmi jo-material që ankuesi mund të ketë pësuar.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Neni 8 të Konventës, dhe se kjo nuk e shkel Nenin 10, gjithahshtu vendosë se gjetja e shkeljes paraqet satisfaksion të drejtë për dëmin jo-material [*pesë vota kundër dy / njëzëri*].

Neni 11

Liria e tubimit dhe e organizimit

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.
2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirisë së të tjerëve. Ky Nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

Partia Komuniste e Bashkuar e Turqisë dhe të Tjerët kundër Turqisë - 19392/92

30 janar 1998 [Gjykata]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 11

Pretendim se masa e detyrimit të shpërbërjes së Partisë Komuniste të Bashkuar e Turqisë ("TBKP") dhe ndalimi për liderët e saj të mbanin zyra të ngjashme në ndonjë parti tjetër politike kishin shkelur të drejtën e tyre për lirinë e asociimit / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: liri e asociimit / parti politike / shpërbërje / anti-kushtetuse / qëllim / terrorizëm / kurd / bashkim / fushëveprim / mision

Ankuesit: Partia Komuniste e Bashkuar e Turqisë (TBKP) (*ankuesi i parë*), z. Nihat Sargin (*ankuesi i dytë*) dhe z. Nabi Yagci (*ankuesi i tretë*)

Faktet e rastit

Partia politike e Bashkuar e Turqisë - ankuesi i parë - u themelua nga 36 persona më 4 qershor 1990. Programi dhe kushtetuta e TBKP-së u paraqitën në zyrën e Këshillit Kryesor Shtetëror në Gjykatën e Kasacionit për vlerësimin e pajtueshmërisë së partisë në bazë të Kushtetutës së Republikës së Turqisë dhe Ligjit nr. 2820 për rregullimin e partive politike të vendit. Kryetari dhe Sekretari i Pergjithshëm i TBKP ishin respektivisht zt. Nihat Sargin dhe zt. Nabi Yagci, përkatësisht ankuesi i dytë dhe i tretë, të cilët janë shtetas të Republikës së Turqisë dhe jetonin në Stamboll. Më 14 qershor 1990, Prokurori i Përgjithshëm i Shtetit në Gjykatën e Kasacionit ngriti procedurë para Gjykatës Kushtetuese për ndërprerjen e egzistimit të TBKP. Në bazë të Neneve 6, 10, 14 dhe ish Nenit 68 të Kushtetutës dhe Nenit 78 dhe 81 të Ligjit nr. 2820, Avokati kryesor i shtetit paditi TBKP-në për përpjekje për të vendosur ngritjen e një klase shoqërore mbi të tjerët, bazuar në Nenin 96 (3) të Ligjit nr. 2820.

Avokati kryesor i shtetit ka fajësuar TBKP-në se ka kryer aktivitete që mund të minojnë integritetin territorial të Republikës së Turqisë dhe në bazë të Nenit 96 (2) të Ligjit nr. 2820 Avokatët thanë se TKBP deklaroi veten të jetë pasardhës i Partisë Turke të Punëtorëve që u shpërbë nga Gjykata më parë. Si dëshmi e kërkesës së tij para Gjykatës, Avokati kryesor i shtetit paraqiti faktet që ishin marrë nga programi i TKBP. Më 16 korrik 1990, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë dha një urdhër për shpërbërjen e Partisë Komuniste të Bashkuar të Turqisë. Njëkohësisht, në pajtim me Nenin 69 të Kushtetutës dhe Nenin 95 (1) të Ligjit nr. 2820, ankuesit dhe menaxherët e tjerë të TKBP, i'u ndalua të mbajnë zyra të ngjashme në ndonjë organ tjetër politik.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi i dytë dhe tretë parashtuan ankesë në Gjykata me pretendimin se vendimi i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me shpërbërjen e TKBP nuk është domosdoshmërisht në pajtim me demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Ankuesit e ngritën çështjen para Komisionit që Gjykata Kushtetuese e Turqisë, në mënyrë individuale, shkeli Nenin 6 § 2, 9, 10 dhe 11 të Konventës dhe së bashku me Gjykatën Kushtetuese shkelën Nenin 14

dhe 18 të Konventës. Përveç kësaj, ankuesit ngriten çështjen se Gjykata Kushtetuese shkeli Nenet 1 dhe 3 të Protokollit nr. 1.

Më 6 dhjetor 1994, Gjykata njoftoi se përveç pretendimeve për nën Nenin 6 § 2 të Konventës, pjesa e tjetër e ankesës është e pranueshme. Më 3 shtator 1996, Komisioni deklaroi se nuk është e nevojshme të trajtohet çështja në bazë të Neneve 9 dhe 10 dhe të trajtohen veqmas Nenet 14 dhe 18 të Konventës dhe Nenet 1 dhe 3 të Protokollit 1.

Përfundimisht ankuesit pretenduan pranë Gjykatës se faktet mbi të cilat rasti ishte i bazuar përbënin shkelje të Nenit 11 dhe Neneve 1 dhe 3 të Protokollit 1.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me zbatueshmërinë e Nenit 11 Gjykata konsideron se formulimi i Nenit 11 jep një tregues fillestar nëse partitë politike mund të mbështeten në këtë dispozitë. Ajo thekson se megjithëse Neni 11 i referohet "lirisë së asociimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën për të formuar... sindikatat...", bashkimi "duke përfshirë" tregon qartë se sindikatat janë vetëm një shembull ndër të tjera në formën në të cilën liria e asociimit mund të ushtrohet si e drejtë. Prandaj Gjykata nuk pajtohet me konkludimin e Qeverisë se, duke iu referuar sindikatave - për arsye që lidhen kryesisht me çështjet që ishin aktuale në atë kohë - hartuesit e Konventës synonin të përjashtonin partitë politike nga sfera e Nenit 11. Sidoqoftë, edhe më bindës se formulimi i Nenit 11, sipas mendimit të Gjykatës, është fakti se partitë politike janë një formë thelbësore e shoqërisë për funksionimin e duhur të demokracisë. Duke pasur parasysh rëndësinë e demokracisë në sistemin e Konventës, nuk mund të ketë dyshime se partitë politike hyjnë në kuadër të Nenit 11 të Konventës.

Sa i përket pretendimit të Qeverisë se TBKP kishte vënë në dyshim rendin kushtetues të Turqisë dhe konkluzionet që duhej të nxirrnin nga ky fakt, duhet të thuhet në fillim se në këtë fazë Gjykata nuk duhet të vendosë nëse ky pretendim është i vërtetë apo mund të mbështetet vetëm në bazë të kushtetutës dhe programit të partisë në fjalë. Në lidhje me vërejtjet e saj lidhur me domosdoshmërinë e ndërhyrjes së kundërshtuar, Gjykata, vëren se një asociacion, duke përfshirë një parti politike, nuk përjashtohet nga mbrojtja e ofruar nga Konventa thjesht sepse aktivitetet e saj konsiderohen nga autoritetet kombëtare se janë duke minuar strukturat kushtetuese të Shtetit dhe duke bërë thirrje për imponimin e kufizimeve. Gjykata në parim është e hapur për autoritetet kombëtare që të ndërmarrin veprime të tilla që ato i konsiderojnë të nevojshme për të respektuar sundimin e ligjit ose për të zbatuar të drejtat kushtetuese, por qeverite duhet ta bëjnë këtë në një mënyrë që është në përputhje me detyrimet e tyre sipas Konventës dhe që i nënshtrohen rishikimit nga institucionet e Konventës.⁶¹

Qeveria gjithashtu parashtroi, se Neni 11 garantonte lirinë për të formuar një asociacion, dhe se ajo nuk e pengonte fromimin e një asociacioni të ri për shkak të shpëbërjes së mëhershme. Gjykata përsërit se Konventa synon të garantojë të drejtat që nuk janë teorike apo iluzore, por praktike dhe efektive⁶². E drejta e garantuar me Nenin 11 do të ishte kryesisht teorike dhe iluzore nëse kufizohej në themelimin e një asociacioni, pasi autoritetet kombëtare mund të shpërndanin menjëherë shoqatën pa

⁶¹ *Open Door dhe Dublin Well Woman kundër Irlandës*, 29 tetor 1992, Seria A, nr. 246-A, fq. 29, § 69

⁶² *Artiko kundër Italisë*, i 13 majit 1980, Seria A 37, fq. 16, § 33

qenë në përputhje me Konventën. Rrjedhimisht, mbrojtja e ofruar nga Neni 11 zgjat gjatë gjithë jetëgjatësisë së asociacionit dhe se shpërndarja e një shoqërie nga autoritetet e një vendi duhet të përmbushë kërkesat e paragrafit 2 të kësaj dispozite. Tutje, Qeveria parashtroi se shpërbërja e TBKP nuk përbënte një ndërhyrje në të drejtën e ankuesit të dytë dhe tretë për lirinë e asociimit. Ashtu si Komisioni, edhe Gjykata konkludon se ka pasur një ndërhyrje në këtë të drejtë në lidhje me të tre ankuesit, duke pasur parasysh rolin e tyre si themelues dhe udhëheqës të partisë dhe ndalimit i cili i pengoi ata të kryejnë përgjegjësi të ngjashme në çdo grupim tjetër politik.

Në lidhje me atë nese ndërhyrja ishte e justifikuar Gjykata konsideroi se një ndërhyrje e tillë do të përbënte një shkelje të Nenit 11 përveç nëse u përcaktua me ligj, ndoqi një ose më shumë synime legjitime sipas paragrafit 2 dhe ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike për arritjen e këtyre qëllimeve. Në rastin në fjalë, ndërhyrja ishte e përcaktuar me ligj, pasi masat e urdhëruara nga Gjykata Kushtetuese ishin bazuar në Nenet 2, 3 § 1, 6, 10 § 1 dhe 14 § 1 dhe ish Neni 68 të Kushtetutës dhe Nenet 78, 81 dhe 96 (3) të Ligjit nr. 2820 për rregullimin e partive politike.

Sa i përket qëllimit, Qeveria pohoi se ndërhyrja ka ndjekur një sërë qëllimeve legjitime: sigurimin e sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe integritetit territorial dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Qeveria tutje sygjeron se nëse Gjykata, siç kishte bërë në gjykimin e *Hadjianastasiou kundër Greqisë*⁶³ do të prantonte se një rast i izoluar i spiunazhit mund të dëmtonte sigurinë kombëtare, kishte më shumë arsye për të arritur një konkluzion të ngjashëm edhe në rastin në fjalë.

Komisioni ka dalluar midis arsyeve të ndryshme të mbështetura nga Gjykata Kushtetuese për shpërbërjen e TBKP-së. Për aq sa shpërbërja bazohej në një dallim të tërhequr në programin e TBKP midis turqve dhe kurdëve, sipas mendimit të Komisionit, mund të thuhet se është urdhëruar me qëllim të mbrojtjes së integritetit territorial dhe kështu "sigurisë kombëtare". Nuk ishte se TBKP ishte një organizatë terroriste ose një sponsorizim i terrorizmit, por mund të konsiderohej hapur se duke ndjekur krijimin e një kombi të veçantë kurd dhe rrjedhimisht një rishpërndarje të territorit të shtetit turk. Ashtu si Komisioni, Gjykata konsideron se shpërbërja e TBKP-së ka ndjekur të paktën një nga "qëllimet legjitime" të përcaktuara në Nenin 11, atë të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, e cila është e domosdoshme në një shoqëri demokratike.

Gjykata përsërit se, pavarësisht nga roli i saj autonom dhe sfera e veçantë e zbatimit, Neni 11 duhet të shqyrtohet edhe në bazë të Nenit 10. Mbrojtja e opinionëve dhe liria për t'i shprehur ato është një nga objektivat e lirive të asociimit.⁶⁴ Sipas Gjykatës shumë herë nuk mund të ketë demokraci pa pluralizëm. Për këtë arsye, liria e shprehjes, e përcaktuar në Nenin 10, është e zbatueshme, në përputhje me paragrafin 2, jo vetëm për informacionin ose idetë që pranohen në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si joformale ose si çështje indiference, por gjithashtu edhe për ato që ofendojnë, shokojnë apo shqetësojnë. Fakti që aktivitetet e tyre janë pjesë e një ushtrimi kolektiv të lirisë së

⁶³ *Hadjianastasiou kundër Greqisë*, 16 dhjetor 1992 (Seria A nr. 252)

⁶⁴ *Young, James dhe Webster kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 13 gusht 1981, Serie A 44, fq. 23, § 57; *Vogt kundër Gjermanisë*, 26 Shtator 1995, Serie A, nr. 332, fq. 30, § 64

shprehjes në vetvete u japin të drejtë partive politike të kërkojnë mbrojtjen e Neneve 10 dhe 11 të Konventës.

Në sferën politike përgjegjësia nënkupton që shteti është nën detyrimin, ndër të tjera, të mbajë, në përputhje me Nenin 3 të Protokollit nr. 1, zgjedhje të lira në intervale të arsyeshme me votim të fshehtë nën kushte të cilat do të sigurojnë shprehjen e lirë të opinionit të popullit në zgjedhjen e legjislaturës. Një shprehje e tillë është e pakonceptueshme pa pjesëmarrjen e një shumice të partive politike që përfaqësojnë hije të ndryshme të opinionit që gjenden brenda popullsisë së një vendi. Duke transmetuar këtë spektër mendimi, jo vetëm brenda institucioneve politike, por gjithashtu - me ndihmën e mediave - në të gjitha nivelet e jetës shoqërore, partitë politike bëjnë një kontribut të pazëvendësueshëm në debatin politik.⁶⁵ Gjykata në shumë raste ka deklaruar, për shembull, se liria e shprehjes përbën një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike dhe një nga kushtet bazë për përparimin e saj dhe për çdo individ, ndërsa në aktgjykimin *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt*⁶⁶, Gjykata vuri në dukje rëndësinë parësore të Nenit 3 të Protokollit nr.1 i cili mishëron një parim karakteristik të një demokracie politike efektive. Si rrjedhojë, përjashtimet e përcaktuara në Nenin 11, ku janë të përfshira partitë politike, duhet të interpretohen në mënyrë strikte; vetëm arsyet bindëse dhe bindëse mund të justifikojnë kufizimet për lirinë e shoqërimit të këtyre partive. Gjykata duhet të bindet se autoritetet kombëtare kanë aplikuar standarde të cilat janë në përputhje me parimet e mishëruara në Nenin 11 dhe, për më tepër, që i kanë bazuar vendimet e tyre në një vlerësim të pranueshëm të fakteve relevante.

Gjykata vëren se TBKP u shpërbë madje edhe para se të ishte në gjendje të fillonte aktivitetet e veta dhe se shpërbërja u urdhërua vetëm në bazë të kushtetutës dhe programit të TBKP, të cilat megjithatë - siç vërehet nga Vendimi i Gjykatës Kushtetuese - nuk përmban asgjë për të sugjeruar që ata nuk pasqyrojnë objektivat e vërteta të partisë dhe synimet e vërteta të liderëve të saj. Ashtu si autoritetet kombëtare, Gjykata do t'i marrë këto dokumente si bazë për vlerësimin nëse ndërhyrja në fjalë ishte e nevojshme. Duhet të theksohet më tej se, në mbështetje të kërkesës së tij për një urdhër shfuqizimi, Këshilltari kryesor i Shtetit në Gjykatën e Kasacionit bëri katër parashtrësia. Dy prej tyre u refuzuan nga Gjykata Kushtetuese: pretendimi që TBKP kishte për qëllim të pohonte se proletariati ishte superior ndaj klasave të tjera shoqërore dhe argumentin se ishte në kundërshtim me Nenin 96 (2) të Ligjit nr. 2820 për të pretenduar të jetë pasardhës i një partie politike që më parë ishte shpërbërë - Partia Turke e Punëtorëve. Prandaj Gjykata mund të kufizojë shqyrtimin e saj në dy bazat e tjera, të cilat u mbështetën nga Gjykata Kushtetuese. Në të parën prej tyre u pretendua se TBKP kishte përfshirë fjalën "komunist" në emër të saj, në kundërshtim me Nenin 96 (3) të Ligjit nr. 2820. Gjykata Kushtetuese në veçanti ka theksuar se kjo dispozitë e ka ndaluar formimin e partive politike në një fushë krejtësisht formale dhe se i thjeshtë fakti i përdorimit të një emri të ndaluar në atë pjesë ishte i mjaftueshëm për të nxitur

⁶⁵ *Lingens kundër Austrisë*, 8 korrik 1986, Seria A nr. 103, f. 26, § 42, *Castells kundër Spanjës*, i 23 prill 1992, Seria A nr. 236, fq.23, § 43

⁶⁶ *Mathieu-Mohin and Clerfayt kundër Belgikës*, 2 March 1987, Seria A nr. 113

zbatimin e tij dhe rrjedhimisht të sjellë shpërbërjen e çdo partie politike që, sikurse TBKP, e kishte shkelur atë dispozitë.

Gjykata konsideron se zgjedhja e emrit të një partie politike nuk mundet, në parim të invokoj një masë aq drastike sa shpërbërja, në mungesë të rrethanave të tjera relevante dhe të mjaftueshme. Në lidhje me këtë, duhet të theksohet, së pari, se më 12 prill 1991 dispozitat e Kodit Penal që kriminalizonin kryerjen e veprimtarive politike të frymëzuara, në veçanti, nga ideologjia komuniste u shfuqizuan me Ligjin nr. 3713 për parandalimin e terrorizmit. Gjykata gjithashtu i kushton shumë rëndësi gjetjes së Gjykatës Kushtetuese që TBKP nuk kërkoi, pavarësisht nga emri i saj, të vendoste dominimin e një klase shoqërore mbi të tjerët dhe që, përkundrazi, i plotësonte kërkesat e demokracisë, duke përfshirë pluralizmin politik, votimin universal dhe lirinë për të marrë pjesë në politikë. Prandaj, në mungesë të ndonjë dëshmie konkrete për të treguar se në zgjedhjen e vetë emrit "komuniste", TBKP kishte zgjedhur një politikë që përbënte një kërcënim real për shoqërinë turke ose shtetin turk. Andaj Gjykata nuk mund të pranojë që paraqitja e bazuar në emrin e partisë, në vetvete, sjellin shpërbërjen e partisë.

Parashtresa e dytë e pranuar nga Gjykata Kushtetuese ishte se TBKP u përpoq të nxiste separatizmin dhe ndarjen e kombit turk. Duke nxjerrë një dallim në kushtetutën dhe programin e vet midis kombeve kurde dhe turke, TBKP kishte zbuluar synimin e vet për të punuar në krijimin e minoriteteve të cilat - me përjashtim të atyre që përmenden në Traktatin e Lozanës dhe në traktatin me Bullgarinë - përbën një kërcënim për integritetin territorial të Shtetit. Pikërisht për këtë arsye vetëvendosja dhe autonomia rajonale ishin të ndaluara nga Kushtetuta. Gjykata vëren se megjithëse TBKP-ja i referohet popullit kurd si "qytetarëve" dhe "kombit" dhe "shtetasve" kurdë, dhe nuk i përshkruan ata si "pakicë" dhe as nuk bën ndonjë kërkesë - përveçse njohjen e ekzistencës së tyre - për ta që të gëzojnë trajtim ose të drejta të posaçme, akoma më pak të drejta për t'u ndarë nga pjesa tjetër e popullsisë turke. Në të kundërtën, programi thotë: "TBKP do të përpiqet për një zgjidhje paqësore, demokratike dhe të drejtë të problemit kurd, në mënyrë që popujt kurdë dhe turq të mund të jetojnë së bashku me vullnetin e tyre të lirë brenda kufijve të Republikës Turke, baza e të drejtave të barabarta dhe me qëllim të ristrukturimit demokratik të bazuar në interesat e tyre të përbashkëta.

Tutje Gjykata konsideron se një nga karakteristikat kryesore të demokracisë është mundësia që ajo ofron për zgjidhjen e problemeve të një vendi nëpërmjet dialogut, pa u mbështetur në dhunë. Demokracia lulëzon me lirinë e shprehjes. Nga ky këndvështrim, nuk mund të ketë justifikime për pengimin e një grupi politik vetëm për shkak se kërkon të debatojë në publik situatën e një pjese të popullsisë së shtetit dhe të marrë pjesë në jetën politike të vendit në mënyrë që të gjejë, sipas rregullave demokratike, zgjidhje të aftë për të kënaqur të gjithë të interesuarit. Gjykuar sipas programit tyre, ky ishte në të vërtetë objektivi i TBKP në këtë fushë. Sipas Gjykatës kjo e dallon rastin në fjalë nga ato të referuara nga Qeveria. Pa dyshim, nuk mund të përjashtohet që programi politik i partisë mund të fshehë objektivat dhe qëllimet e ndryshme nga ato që ajo shpall. Për të verifikuar nëse nuk ka, përmbajtja e programit duhet të krahasohet me veprimet e partisë dhe pozicionet që mbron. Në rastin konkret, programi i TBKP-së vështirë se mund të ishte hedhur poshtë nga ndonjë veprim praktik që duhej, pasi që u

shpërnda menjëherë pasi u formua dhe rrjedhimisht nuk kishte as kohë për të ndërmarrë ndonjë veprim. Kështu u penalizua për sjellje që lidhej vetëm me ushtrimin e lirisë së shprehjes.

Gjykata është gjithashtu e përgatitur të marrë parasysh sfondin e çështjeve para saj, veçanërisht vështirësitë që lidhen me luftën kundër terrorizmit. Megjithatë, në rastin në fjalë, nuk gjen asnjë provë që do të dërgonte në përfundimin, në mungesë të ndonjë aktiviteti nga ana e TBKP, se partia mbante çdo përgjegjësi për problemet që terrorizmi paraqet në Turqi. Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, një masë aq drastike sikurse shpërbërja e menjëhershme dhe e përhershme e TBKP, e urdhëruar para se aktivitetet e asaj partie të kishin filluar dhe shoqëruar me një ndalim që i ndalonte liderët e saj për të përmbushur çdo përgjegjësi tjetër politike, është joproporcionale me qëllimin e ndjekur dhe rrjedhimisht të panevojshme në një shoqëri demokratike. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se masa shkel Nenin 11 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen shkelje të Nenit 11 të Konventës dhe se nuk ka nevojë të shqyrtohen pretendimet lidhur me Nenet 9, 10, 14, 18 të Konventës. Gjykata gjithashtu konsideron se nuk ka nevojë të shqyrtohen pretendimet për shkelje të Nenit 1 dhe 3 të Protokollit 1 [njëzëri].

Partia Socialiste dhe të tjerët kundër Turqisë - 20/1997/804/1007

25 maj 1998 [Dhoma e Madhe]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 11

Shpërbërja e një partie politike dhe ndalesa për liderët politikë që të ushtrojnë funksione të ngjashme në parti të tjera politike paraqet shkelje të lirisë së tubimit / *ka shkelje*

Nenet 6(1), 9, 10, 14 dhe 18 si dhe Nenet 1 dhe 3 të Protokollit Nr. 1

Gjykata e ka parë të panevojshme që të përcaktojë, pasi ka gjetur shkelje të Nenit 11, nëse ka shkelje edhe të dispozitave të tjera të pretenduara, siç janë Nenet 6(1), 9, 10, 14 dhe 18 të Konventës, si dhe / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: *liria e tubimit / partitë politike / parimet themelore kushtetuese / sistemi demokratik / e drejta për vetëvendosje*

Ankuesit: Partia Socialiste (*ankuesi i parë*), z. Ilhan Kirit (*ankuesi i dytë*), z. Dogu Perinçek (*ankuesi i tretë*)

Faktet e rastit

Ankuesi i parë në këtë rast është një parti politike e themeluar më 1 shkurt të vitit 1998. Kjo parti është shpërbërë me vendim të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë në tetor të vitit 1992. Ankuesit e dytë dhe të tretë kanë mbajtur postet e kryesuesit dhe të ish-kryesuesit të partisë, respektivisht. Që të dytë jetojnë në Stamboll.

Më 8 dhjetor 1992, Gjykata Kushtetuese kishte hedhur poshtë një ankesë fillestare të paraqitur nga Prokurori Kryesor Shtetëror në Gjykatën e Kasacionit, me kërkesën për shpërbërje të Partisë Socialiste. Partia Socialiste kishte fituar të drejtën që të marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme të 20 tetorit 1991 dhe kishte mbajtur një seri takimesh për t'ia shpjeguar programin e vet elektoratit.

Më 14 nëntor 1991, Prokurori Kryesor Shtetëror kishte sjellë sërish rast, këtë herë në Gjykatën Kushtetuese, me kërkesën për shpërbërje të Partisë Socialiste. Në deklarinimet e tij, në të cilat ishte mbështetur në një numër deklaratash dhe publikimesh të bëra nga kryesuesi i partisë, Prokurori kishte akuzuar Partinë Socialiste për zhvillimin e aktiviteteve që dëmtojnë integritetin e shtetit të Turqisë.

Në aktgjykimin e 10 korrikut 1992, Gjykata Kushtetuese e Turqisë kishte shpallur shpërbërjen e partisë. Urdhëri i kësaj gjykate *ipso jure* përfshinte edhe konfiskimin dhe transferin e pasurisë së Partisë Socialiste në thesarin shtetëror dhe ndalesëm për liderët politikë të partisë që të ushtrojnë ndonjë funksion të ngjashëm në të ardhmen.

Çështja paraprakisht ishte shqyrtuar nga Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, që funksiononte në atë kohë. Në raportin e tij, Komisioni kishte shprehur pikëpamjen se kishte shkelje të Nenit 11, nuk kishte shkelje të Nenit 6(1) dhe nuk kishte çështje të ndara të ngritura në bazë të Neneve 9 dhe 10, si dhe ishte e panevojshme që të

shqyrtoheshin ankesat sipas Neneve 14 dhe 18 të Konventës dhe Neneve 1 dhe 3 të Protokollit Nr. 1.

Përmbledhje e pretendimeve

Në argumentet e paraqitura nga Qeveria, Gjykatës i kërkohej të gjente dhe shpallte se nuk ka shkelje të Neneve 6, 9, 10, 11, 14 ose 18 të Konventës dhe Neneve 1 ose 3 të Protokollit Nr. 1. Ankuesit, nga ana e tyre, kërkonin dhe pretendonin se të gjitha këto dispozita të Konventës dhe Protokollit Nr. 1 ishin shkelur në rastin e tyre.

Ankuesit mbanin qëndrimin se fakti që Partia Socialiste ishte shpërbërë dhe liderët e saj ishin ndaluar që të ushtronin funksione të ngjashme në ndonjë parti tjetër politike përbënte shkelje të së drejtës së tyre në lirinë e tubimit, siç garantohet në Nenin 11 të Konventës. Ankuesit ishin të mendimit se nuk kishte dyshim që partitë politike binin brenda fushëveprimtarisë së Nenit 11 të Konventës.

Qeveria ka kontestuar këtë pretendim, duke deklaruar se Neni 11 nuk zbatohet ndaj partive politike. Sipas Qeverisë, kur në programin ose kushtetutën e saj një parti politike e sulmon rendin kushtetues të shtetit, Gjykata duhet ta shpallë të pazbatueshme Konventën *ratione materiae*.

Në deponimin me shkrim, Qeveria ka deklaruar se është e qartë që, përmes aktiviteteve të saj, Partia Socialiste ka dashur që të thyejë parimet themelore kushtetuese të Turqisë. Partia Socialiste ka konsideruar se qytetarët me origjinë kurde kanë statusin e “kombit” dhe “popullit” dhe të drejtën për “të themeluar një shtet të veçantë”.

Tutje, sipas Qeverisë, shtetet palë të Konventës në asnjë rast nuk kanë synuar që të dëmtojnë institucionet e tyre kushtetuese, në veçanti parimet që ato i vlerësojnë të paraqesin kushte thelbësore të ekzistencës së tyre. Për këtë arsye, sipas Qeverisë, në këtë rast, Konventa nuk është e zbatueshme, pasi nuk është në pyetja liria e tubimit, por e drejta për vetëvendosje, e cila nuk rregullohet dhe nuk bie brenda kufijve rregullativ të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjatë shqyrtimit të rastit, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se partitë politike janë një formë e tubimit ose organizimit që është thelbësore për funksionimin e duhur të demokracisë dhe marrë parasysh rëndësinë e demokracisë në sistemin e Konventës, nuk ka dyshim se partitë politike bien brenda fushëveprimtarisë së Nenit 11 të Konventës.

Gjykata ka vënë re, në anën tjetër, se një bashkim, duke përfshirë një parti politike, nuk përjashtohet nga mbrojtja që i jepet me Konventë për faktin e thjeshtë sepse aktivitetet e saj shihet nga autoritetet kombëtare si diçka që çënojnë strukturat kushtetuese të shtetit dhe bëjnë thirrje për vendosjen e kufizimeve.

Gjykata vlerëson se shpërbërja e Partisë Socialiste ka ndjekur së paku një prej qëllimeve legjitime, të përcaktuara në Nenin 11: mbrojtjen e “sigurisë kombëtare”.

Në pikëpamjen e Gjykatës, megjithatë, fakti se një program politik konsiderohet i papërputhshëm me parimet ekzistuese dhe strukturat e shtetit turk nuk e bën atë të papërputhshëm me rregullat e demokracisë. Është thelbësore për demokracinë që të lejojë propozimin dhe debatimin e programeve politike diverse, madje edhe të atyre që

vënë në pyetje mënyrën se si aktualisht shteti është i organizuar, me kushtin që nuk e dëmtojmë vetë demokracinë.

Në përfundim, shpërbërja e Partisë Socialiste nuk ka qenë proporcionale me qëllimin e synuar dhe si pasojë e panevojshme në një shoqëri demokratike. Nga kjo rrjedhë se ka pas shkelje të Nenit 11 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosë se ka shkelje të Nenit 11 të Konventës; tutje, Gjykata vendosë se është e panevojshme që të përcaktojë nëse ka shkelje edhe të dispozitave të Neneve 6(1), 9, 10, 14 dhe 18 të Konventës dhe Neneve 1 dhe 3 të Protokollit Nr. 1 [njëzëri].

***Partia Kombëtare Baske - Organizata Rajonale e Iparralde kundër Francës -
71251/01***

7 shtator 2007 [Seksioni i Parë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 10 në lidhje me Nenin 11

Vështirësitë e shkaktuara nga mos financimi i organizatës kishin rezultuar në shkelje të lirisë së shprehjes dhe lirisë së asociimit / *nuk ka shkelje*

Neni 3 i Protokollit nr. 1

Shkelje e të drejtës për zgjedhje të lira / *e panevojshme për shqyrtim*

Fjalët kyçe: *parti politike / degë e partisë / financim / shoqatë financuese / fonde publike / liri e asociimit*

Ankuesi: Dega franceze e Partisë Kombëtare Baske të Spanjës, një shoqatë e cila ka zyrën e saj të regjistruar në Bayonne (Francë).

Faktet e rastit

Partia ankuese, sipas statutit të saj, është një degë rajonale e EAJ-PNB (Euzko Alderdi Jeltzalea - Partido Nacionalista Vasco, një parti politike sipas ligjit spanjoll, qëllimi i të cilit është të mbrojë dhe promovojë nacionalizmin bask). Statuti thekson se partia do të miratojë "ideologjinë kombëtare të EAJ-PNB" dhe "parimet tradicionale dhe *modus operandi* të EAJ-PNB".

Për t'u lejuar të marrin fonde, dhe në veçanti kontributet nga EAJ-PNB, ankuesi formoi një shoqatë financimi në përputhje me Ligjin e vitit 1988 për transparencën financiare në jetën politike. Në shtator 1998, ankuesi bëri një kërkesë për aprovim të shoqatës, e cila u refuzua nga Komisioni Kombëtar për Llogaritë e Fushatave Zgjedhore dhe Financimin Politik (CCFP) për arsye se Ligji i vitit 1988 ndalonte financimin e një partie politike nga një person juridik i huaj. CCFP gjithashtu hodhi poshtë një kërkesë të mëvonshme nga ankuesi për të rishikuar vendimin e saj. Partia pastaj aplikoi në *Conseil d'Etat*, e cila hodhi poshtë kërkesën e saj me një aktgjykim të 8 dhjetorit 2000. Pra, miratimi i kësaj asociacioni ishte thelbësore për funksionimin e partisë, megjithatë u refuzua nga Franca, me arsyetimin se pjesa më e madhe e burimeve të partisë aplikuese ka ardhur nga subvencionet e partisë spanjolle.

Përmbledhje e pretendimeve

Partia ankuese pretendon se kërkesa e saj për aprovimin e shoqatës së financimit të cilën e krijoi, u refuzua me arsyetimin se pjesa më e madhe e financimit mori formën e subvencioneve nga Partia Kombëtare Baske e Spanjës. Po ashtu, ankuesi u ankua për vështirësitë financiare dhe aftësinë e për të vazhduar aktivitetin e politik, veçanërisht në fushën zgjedhore dhe u mbështet në Nenin 10 (lirinë e shprehjes), Nenin 11 (lirinë e tubimit dhe shoqërimit) dhe Nenin 3 të Protokollit nr. 1 (e drejta për zgjedhje të lira).

Qeveria parashtroi se pasoja e vetme e vendimit të CCFP-së në rastin e ankuesit kishte qenë që ta privonte atë nga financimi i Shtetit dhe përfitimet financiare të parapara me Aktin e Jetës Politike (Transparenca Financiare) e 11 marsit 1988; për shkak se nëse pranon financim nga burime të huaja, humb subvencionimin nga Shteti i Francës. Vendimi nuk ka ndikim që të ndalojë partinë aplikuese të vazhdojë aktivitetet e veta dhe të përdorë burime të tjera financimi. Qeveria në përputhje me këtë përfundoi se nuk kishte "ndërhyrje" në rastin aktual me ushtrimin e të drejtave të mbrojtura nga Nenet 10 dhe 11 të Konventës. Po ashtu, Qeveria pretendoi se ndalimi/refuzimi mori parasysh "interesat e sigurisë kombëtare" në kërkimin për të mbrojtur "shprehjen e sovranitetit kombëtar", në të cilin partitë politike kontribuan sipas Kushtetutës franceze.

Arsyetimi i Gjykatës

Rasti u konsiderua sipas Nenit 11 të Konventës, ku duke pasur parasysh ndikimin e rrethanave në fjalë në kapacitetin financiar të palës aplikuese për t'u angazhuar plotësisht në aktivitetet e veta politike, Gjykata konsideroi se kishte pasur "ndërhyrje", të cilat ishin "të përcaktuara me ligj". Qeveria kishte pohuar se ndalimi i financimit të partive politike franceze nga partitë ose qeveritë e huaja kishte për qëllim të shmangte krijimin e një lidhje varësie e cila do të ishte e dëmshme për shprehjen e sovranitetit kombëtar; qëllimi i ndjekur në këtë mënyrë ka lidhje, sipas pikëpamjes së tyre, me mbrojtjen e "rendit institucional". Gjykata pranoi që koncepti i "rendit" ("ordre") në kuptimin e verzionit francez të Neneve 10 dhe 11 të Konventës gjithashtu përfshinte "rendin institucional".

Sa i përket ndërhyrjes në një shoqëri demokratike, fakti që partive politike nuk u lejohej të merrnin fonde nga partitë e huaja nuk ishte në vetvete në kundërshtim me Nenin 11. Për më tepër, zgjedhja e legjislaturës franceze për të mos përjashtuar partitë politike në shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian nga ky ndalim ishte një vendim politik shumë i rëndësishëm, i cili në përputhje me rrethanat bie brenda margjinës së vlerësimit të çdo shteti.

Mbetet të përcaktohet se çfarë ndikimi kishte ndalimi/refuzimi në aftësinë e palës aplikuese për t'u angazhuar në aktivitete politike. Masa e ankuesit nuk e vuri në pikëpyetje ligjshmërinë e partisë aplikuese ose përbënte pengesë ligjore për pjesëmarrjen e saj në jetën politike apo për censurën e pikëpamjeve që kërkonte të shprehej në arenën politike. Megjithëse partia ankuese duhej të heqë dorë nga ndihma financiare nga Partia Kombëtare Baske, pasi ajo do të ishte ende në gjendje të financonte aktivitetet e saj politike nëpërmjet kontributeve dhe donacioneve të anëtarëve të saj nga individë, duke përfshirë edhe shtetasit jo-francezë.

Tutje Gjykata vëren se nuk kishte asgjë në ligj për ta parandaluar atë ose nga marrja e fondeve nga partitë e tjera politike franceze ose nga përfitimi i sistemit francez të financimit të Shtetit për fushatat zgjedhore. Ishte e vërtetë se këto burime financimi dukeshin hipotetike në rastin konkret të partisë kërkuese: duke pasur parasysh qëllimet e saj politike, nuk ka gjasa të fitojë përkrahjen e një partie franceze, ndërsa duke pasur parasysh sferën e saj gjeografike të saj, ka gjasa të të marrë pjesë në zgjedhjet lokale dhe jo në parlament, kështu që mezi duket të jetë në gjendje të përfitojë nga sistemi i financimit të shtetit (i cili bazohet në rezultatet në zgjedhjet parlamentare). Kandidatët

e saj zgjedhorë megjithatë do të gëzonin të gjitha përfitimet e njëjta si ato të partive të tjera në drejtim të financimit të fushatës së tyre zgjedhore.

Si përfundim, Gjykata konstaton se megjithëse ndalimi i marrjes së kontributeve nga Partia Nacionaliste Baske spanjolle kishte ndikim në financat e palës aplikuese, situata në të cilën u gjet si rezultat nuk ishte ndryshe nga ajo e ndonjë partie të vogël politike me të cilën ballafaqohej me një mungesë fondesh. Pra, Gjykata konsideroi se refuzimi i kërkesës për aprovim të shoqatës së fondeve përbënte ndërhyrje në ushtrimin e ankesës nga të drejtat e garantuara me Nenin 11. Ndërhyrja në fjalë ishte përcaktuar me ligj dhe kishte ndjekur qëllimin legjitim të parandalimit të trazirave.

Sa i përket asaj nëse ndërhyrja ishte e nevojshme, Gjykata vlerësoi se fakti që partive politike nuk u lejohej të merrnin fonde nga partitë politike të huaja nuk ishte në vetvete në kundërshtim me Nenin 11 të Konventës. Në lidhje me këtë, Gjykata vuri në dukje në veçanti se, ndërsa partia nuk mund të merrte ndihmë financiare nga Partia Kombëtare Baske spanjolle, ajo megjithatë mund të financojë aktivitetet e saj politike me ndihmën e kontributeve të anëtarëve dhe donacioneve nga individë - duke përfshirë edhe ata jashtë Francës - të cilat ajo mund t'i mbledhë përmes një agjenti financiar ose një asociacioni financimi të miratuar në bazë të një kërkesë të re. Për më tepër, nuk kishte asgjë për të parandaluar marrjen e fondeve nga partitë e tjera franceze ose për të përfituar nga sistemi i financimit publik të vënë në vend nga legjislativi francez.

Si përfundim, Gjykata gjeti se masa në fjalë nuk kishte një ndikim disproporcional në aftësinë e palës kërkuese për të kryer aktivitetet e saj politike. Ndërsa ndalimi i marrjes së kontributeve nga Partia Nacionaliste Baske spanjolle kishte një ndikim në financat e partisë, situatë në të cilën u gjet si rezultat, nuk ishte ndryshe nga ajo e ndonjë partie të vogël politike që përballonte një mungesë fondesh. Si rezultat Gjykata konstaton se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 10 në lidhje me Nenin 11 të Konventës. Tutje Gjykata konsideroi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej rasti sipas Nenit 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 11 në lidhje me Nenin 10 të Konventës. Ndërsa pretendimet sipas Nenit 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës i konsideron si të panevojshme për shqyrtim [*gjashtë vota për/ një kundër*].

Partidul Comunistilor (Nepeceristi) dhe Ungureanu kundër Rumanisë - 46626/99

3 shkurt 2005 [Seksioni i Tretë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 11 § 1

Refuzimi për të regjistruar një parti politike bazuar në parimet themelore demokratike ka rezultuar në shkeljen e të drejtës për të formuar asociacione / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *liri e asocimit / parti politike / komuniste / regjistrim / refuzim i regjistrimit / planprogram politik / interes i përgjithshëm / sistem demokratik / liri e shprehjes / pluralizëm*

Ankuesit: Një grup politik i quajtur Partidul Comunistilor - Partia e Komunistëve (KPP) (që nuk kanë qenë anëtarë të Partisë Komuniste Rumune - "PCN") (*partia ankuese*) dhe nga kryetari i saj (*ankuesi i dytë*)

Faktet e rastit

Në vitin 1996 gjykatat (Gjykata e Bukureshtit) refuzuan të regjistrojnë KPP si parti politike, duke pasur parasysh kushtetutën e saj dhe programin politik. Krijuesi i partisë dhe anëtarët e saj konsideruan se KPP ishte parti që kontribuon në krijimin e një shoqërie humane dhe demokratike të bazuar në doktrinën komuniste dhe se kjo nënkuptonte se programi i kesaj partie ishte në pajtim me rendin kushtetues dhe ligjor që ishte në fuqi që nga viti 1989. KPP nuk kishte qenë politikisht aktive para se të aplikonte për regjistrim.

Më 6 korrik 1994, ankuesit apeluan kundër vendimit për mos lejim të regjistrimit në Gjykatën e Apelit të Bukureshtit. Në një aktgjykim të dhënë më 28 gusht 1996, Gjykata e Apelit e hodhi poshtë ankesën me arsyetimin se vlerësimi i bërë në vendim ishte korrekt. Teksti i aktgjykimit u dërgua në Gjykatën e Rrethit të Bukureshtit për t'u arkivuar më 21 tetor 1996. Ankuesi i dytë pohon se ai mësoi për arsyet e aktgjykimit më 13 nëntor 1996.

Më 28 maj 1997, Prokurori i Përgjithshëm i Rumanisë njoftoi ankuesin e dytë se nuk mund të shihte arsye për të paraqitur një kërkesë (recurs în anulare) për të anuluar aktgjykimin e 28 gushtit 1996. Megjithatë, ankuesi i dytë depozitoi një kërkesë për anulim, të cilën Gjykata e Qarkut në Bukuresht e hodhi poshtë si jashtë afatit më 5 dhjetor 1997.

Pas vitit 1997, ankuesi i dytë vazhdoi të shprehë mendimet e tij politike në gazetën Socializmin Pentru ("Për socializmin"), të cilën edhe e redaktonte. Më 13 gusht 1998 botoi një artikull të titulluar "Manifestimi komunist", i cili shpalli lidhjen e tij me doktrinën komuniste dhe kritikoi drejtimin e udhëheqësve të Partisë Komuniste përpara vitit 1989 dhe politikën e ndjekur nga qeveritë e njëpasnjëshme që nga ajo kohë. Një numër i madh artikujsh të cilat ankuesi i dytë i botoi në gazetë në vitin 1998 dhe 1999 përmbanin slogane të tilla si "Punëtorët e të gjitha vendeve, bashkoheni!", "Lufta vazhdon!" dhe "Socializmi i gjallë!". Në një artikull ai deklaroi se, dikur në pushtet, ai do të "pranonte vetëm ata që e pranonin atë".

Në vitin 2000, ankuesi i dytë botoi një libër, me permbajtje kundër-socialiste, kundër-klasës të punës dhe kundër-revolucion antinacionale, në të cilën ai iu përgjigj rreth njëqind pyetjeve nga një gazetar. Në dhjetor 2003 ai dërgoi ne Gjykatë një kopje të librit. Në të, ai vendosi vizionin e tij politik, duke përshkruar angazhimin e tij ndaj doktrinës komuniste dhe klasave të punës dhe duke e përshkruar Marks-in si filozofin më të madh politik të të gjithë njerëzimit; ai kritikoi gjithashtu tradhtimin gradual të autoriteteve, sipas mendimit të tij, të idealeve komuniste para vitit 1989 - duke lavdëruar ish presidentin Ceausescu - dhe politikën e ndjekur nga ata që ishin në pushtet pas kësaj date.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit u ankuan që refuzimi nga gjykatat vendore i aplikimit për regjistrimin e KPP-së si parti politike kishte shkelur të drejtën e tyre për lirinë e asociimit, siç garantohet me Nenin 11 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata rithekson që, pavarësisht nga roli i saj autonom dhe sfera e veçantë e zbatimit, Neni 11 duhet të shqyrtohet edhe në bazë të Nenit 10. Mbrojtja e opinionëve dhe liria për t'i shprehur ato është një nga objektivat e lirisë të asociimit siç është përcaktuar në Nenin 11 të Konventës. Kjo vlen edhe më shumë në raport me partitë politike në funksion të rolit të tyre thelbësor në sigurimin e pluralizmit dhe funksionimit të duhur të demokracisë. Gjykata konsideron se nuk mund të ketë demokraci pa pluralizëm. Për këtë arsye, liria e shprehjes, e përcaktuar në Nenin 10, është e zbatueshme, në përputhje me paragrafin 2, jo vetëm për "informacionin" ose "idetë" që pranohen në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si joformale ose si çështje indiference,⁶⁷ por gjithashtu fakti që aktivitetet e tyre janë pjesë e një ushtrimi kolektiv të lirisë së shprehjes në vetvete u japin të drejtë partive politike të kërkojnë mbrojtjen e Neneve 10 dhe 11 të Konventës.⁶⁸ Gjykata rithekson se shqyrimi i çështjes nëse refuzimi për të regjistruar një parti politike ka përmbushur një "nevojë të ngutshme sociale" duhet të përqendrohet në pikat vijuese: (i) nëse ka prova të besueshme se rreziku për demokracinë ishte mjaft i afërt; (ii) nëse aktet e liderëve dhe fjalimet e marra në konsideratë në rastin në shqyrtim ishin të ngarkuar me partinë politike përkatëse; dhe (iii) nëse aktet dhe fjalimet e caktuara për partinë politike formuan një tërësi që dha një pasqyrë të qartë të një modeli të shoqërisë, të konceptuar dhe të mbrojtur nga partia e cila ishte e papajtueshme me konceptin e një "shoqërie demokratike". Shqyrtimi i përgjithshëm i pikave të mësipërme duhet gjithashtu të marrë parasysh kontekstin historik në të cilin ndodhi refuzimi për regjistrimin e palës në fjalë.

Detyra e Gjykatës nuk është që të zërë vendin e autoriteteve kombëtare kompetente, por më tepër të shqyrtojë sipas Nenit 11 vendimet që ato kanë dhënë në bazë të fuqisë së tyre të vlerësimit. Kjo nuk do të thotë që mbikëqyrja e Gjykatës është e kufizuar në përcaktimin nëse një shtet i paditur ka ushtruar lirinë e tij të arsyeshme, me kujdes dhe

⁶⁷ *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, gjykimi i 7 dhjetorit 1976, Seria A nr. 24, fq. 23, § 49, dhe *Jersild kundër Danimarkës*, aktgjykimi i 23 shtatorit 1994, Seria A, nr. 298, fq. 26, § 37

⁶⁸ *Partinë Komuniste të Bashkuar të Turqisë dhe të Tjerët kundër Turqisë*, 30 janar 1998, Raportet e Vendimeve 1998-I, f. 20-21, §§ 42-43)

me mirëbesim. Andaj Gjykata duhet të shqyrtojë ndërhyrjen e ankimuar në dritën e çështjes në tërësi, në mënyrë që të përcaktojë nëse ishte "në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur" dhe nëse arsyet e paraqitura nga autoritetet kombëtare për ta justifikuar atë janë relevante dhe të mjaftueshme. Duke vepruar kështu, Gjykata duhet të bindet se autoritetet kombëtare kanë aplikuar standarde të cilat janë në përputhje me parimet e mishëruara në Nenin 11 dhe, për më tepër, që i kanë bazuar vendimet e tyre në një vlerësim të pranueshëm të fakteve relevante. Në çështjen në fjalë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse ndërhyrja në fjalë, përkatësisht refuzimi nga Gjykatës së Apelit të Bukureshtit për të regjistruar KPP-në si një parti politike në një vendim të 28 gushtit 1996, u takua me një "nevojë urgjente sociale" dhe ishte "në proporcion me qëllimet legjitime të ndjekura".

Gjykata vëren në fillim se gjykatat kombëtare e bazuan refuzimin e aplikimit të ankuesve vetëm në një vlerësim nëse kushtetuta dhe programi politik i KPP-së janë në përputhje me dispozitat e Dekretit Legjislativ nr. 8/1989; dhe se KPP nuk kishte qenë politikisht aktive para se të aplikonte për regjistrim. Ajo vëren në lidhje me këtë që as Gjykata e Rrethit të Bukureshtit e as Gjykata e Apelit e Bukureshtit nuk i kanë bazuar vendimet e tyre përkatëse të datës 19 prill 1996 dhe 28 gusht 1996 në ndonjë dokument tjetër të përpiluar nga KPP ose në ndonjë pozitë të veçantë të marrë nga kërkuesi i dytë ose ndonjë tjetër udhëheqës i PCN. Ashtu si autoritetet kombëtare, Gjykata do të marrë përsipër programin dhe kushtetutën politike të KPP-së si bazë për të vlerësuar nëse ndërhyrja në fjalë është e nevojshme. Lidhur me këtë, Gjykata nuk mund të aprovojë në kërkesën e Qeverisë për të zgjeruar fushën e shqyrtimit të saj në deklaratat e politikave të bëra nga kërkuesi i dytë, disa vite pas ndërhyrjes në fjalë, në artikujt e shtypit të botuar në 1998 dhe 1999 dhe në librin "anti-socialisti, anti-punëtorë dhe kundër-revolucion antinacionale" botuar në vitin 2000. Gjykata në këto rast, nuk mund të zërë vendin e gjykatave vendase në vlerësimin e fakteve jashtë fushëveprimit të çështjes, pasi faktet e referuara nga Qeveria kanë ndodhur pas ndërhyrjes në fjalë. Sidoqoftë, Gjykata nuk mund të gjejë deklaratat në botimet e mëvonshme të ankuesit të dytë, përkundër gjuhës kritike dhe nganjëherë armiqësore të përdorur, që mund të interpretohen në mënyrë të arsyeshme si një thirrje për përdorimin e dhunës për qëllime politike ose si një politikë në kundërshtim me rregullat e demokracisë. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se, edhe në këto dokumente jozyrtare që synonin përkrahësit potencial të KPP-së, ankuesi i dytë deklaroi se ai ishte në favor të zgjedhjeve të lira, shumëpartiake dhe të një sistemi politik të bazuar në respektimin mendimeve politike të tjerëve.

Gjykata vëren se refuzimin e kërkesës për regjistrimin e KPP-së, Gjykata e Apelit e Bukureshtit e miratoi, pa elaboruar më tej, arsyetimin e Gjykatës së Rrethit të Bukureshtit, në të cilën KPN kërkonte të fitonte pushtet politik për të krijuar një shtet human i bazuar në doktrinën komuniste, e cila sipas mendimit të gjykatës nënkuptonte që ankuesit e konsideronin rendin kushtetues dhe ligjor që ishte në fuqi që nga viti 1989 si çnjerëzore dhe jo në bazë të demokracisë së vërtetë. Prandaj, gjykatat vendase konsideruan që KPP kishte shkelur Nenin 2 § § 3 dhe 4 të Dekretit Legjislativ nr. 8/1989. Vlerësimi i Gjykatës për domosdoshmërinë e ndërhyrjes në fjalë do të lidhet kryesisht me arsyet e dhëna nga gjykatat vendase për refuzimin e aplikimit të ankuesve. Andaj, duke shqyrtuar kushtetutën dhe programin politik të KPN-së, Gjykata vëren se këto dokumente theksojnë përkrahjen e sovranitetit kombëtar të vendit, integritetit

territorial dhe rendin juridik dhe kushtetues, si dhe parimet e demokracisë, duke përfshirë pluralizmin politik, të drejtën e përgjithshme dhe lirinë për të marrë pjesë në politika. Më tej Gjykata thekson se ato nuk përmbajnë asnjë paragraf që mund të konsiderohet thirrje për përdorimin e dhunës, kryengritjes ose ndonjë forme tjetër të refuzimit të parimeve demokratike - një faktor thelbësor që duhet marrë parasysh - ose për "diktaturën e proletariatit".⁶⁹ Gjykata vëren se programi politik dhe kushtetuta e KPN-së në të vërtetë përmbante pjesë që kritikonin të dy abuzimet e kryera para vitit 1989 nga ish-Partia Komuniste, nga e cila distancohej vetë - jo më pak me emrin e saj - dhe politikën e ndjekur që nga 1989.

Gjykata konsideron se një nga karakteristikat kryesore të demokracisë është mundësia që ajo ofron për të adresuar përmes dialogut, pa u mbështetur në dhunë, çështje të ngritura nga fusha të ndryshme të mendimit politik, madje edhe kur janë të tmerrshme ose shqetësuese. Demokracia lulëzon me lirinë e shprehjes. Për këtë nuk mund të ketë justifikime për pengimin e një grupi politik që përputhet me parimet themelore demokratike vetëm sepse ka kritikuar rendin kushtetues dhe ligjor të vendit dhe ka kërkuar një debat publik në arenën politike.⁷⁰ Në rastin në fjalë, gjykatat vendore nuk treguan se në të cilën pjesë të programit dhe dokumentit konstituiv të KPP-së ishin në kundërshtim me rendin kushtetues dhe ligjor të vendit dhe në veçanti me parimet themelore të demokracisë. Në lidhje me këtë, Gjykata nuk mund të pranojë argument se Rumania nuk mund të lejojë daljen e një partie të re komuniste në formimin e një debati demokratik.

Tutje Gjykata rikujton se përvoja politike e Shteteve Kontraktuese ka treguar se në të kaluarën partitë politike me synime në kundërshtim me parimet themelore të demokracisë nuk kanë zbuluar qëllime të tilla në botimet e tyre zyrtare deri pas marrjes së pushtetit. Programi politik i një partie mund t'i fshehë objektivat dhe qëllimet e ndryshme nga ato që ajo shpall. Për të verifikuar nëse nuk ka, përmbajtja e programit duhet të krahasohet me veprimet e liderëve të partisë dhe pozicionet që ata mbrojnë.

Në rastin aktual, programi i KPP-së vështirë se mund të ishte hedhur poshtë me ndonjë veprim në praktikë pasi që kërkesa për regjistrim u refuzua dhe rrjedhimisht nuk kishte as kohë për të ndërmarrë ndonjë veprim. Kështu u penalizua për sjellje që lidhej vetëm me ushtrimin e lirisë së shprehjes. Gjykata është gjithashtu e gatshme të marrë parasysh historinë e rasteve që i paraprijnë, në këtë rast përvojën e Rumanisë ndaj komunizmit totalitar para vitit 1989. Megjithatë, ajo vëren se ky kontekst nuk mund të justifikojë vetë nevojën për ndërhyrje, veçanërisht si partitë komuniste respektimi i ideologjisë marksiste ekziston në një numër vendesh që janë nënshkruese të Konventës. Prandaj, Gjykata vëren se kriteret që përcaktojnë një "nevojë të ngutshme sociale" nuk janë përmbushur në rastin në fjalë, për të vendosur se programi politik i ankuesve ishte i papajtueshëm me një "shoqëri demokratike", e lëre më se kishte prova për një rrezik të mjaftueshëm të drejtpërdrejtë për demokracinë. Prandaj, një masë aq drastike sa refuzimi i aplikimit të ankuesve për regjistrimin e KPP-së si një parti

⁶⁹ *Partia Socialiste e Turqisë (STP) dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 26482/95, § 45, 12 nëntor 2003, dhe anasjelltas, *Partia Komuniste e Gjermanisë kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, nr 250/57, Vendimi i Komisionit i 20 korrikut 1957, Libri vjetor I, f. 222

⁷⁰ *United Communist Party of Turkey dhe të tjerët kundër Turqisë* aktgjykim i 30 Janar 1998, *Raport i Aktgjykimeve dhe Vendimeve* 1998-I, f. 20-21, §§ 42-43

politike, përpara se aktivitetet e saj të kishin filluar, është jo proporcionale me qëllimin e ndjekur dhe rrjedhimisht të panevojshëm në një shoqëri demokratike. Prandaj, ka pasur shkelje të Nenit 11 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Nenit 11 të Konventës [*njëzëri*].

Nurettin Aldemir dhe të tjerëve kundër Turqisë - 32124/02, 32126/02, 32129/02, 32132/02, 32133/02, 32137/02 dhe 32138/02

18 dhjetor 2007 [Seksioni i Dytë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 11

Ndërhyrja me forcë e zyrtarëve të policisë ka qenë jopërpjestimore dhe nuk ka qenë e nevojshme për të parandaluar prishjen e rendit publik në mungesë të veprimeve të dhunshme nga ana e protestuesve / *ka shkelje*

Çështjet tjera / Nenet 1, 3, 5, 6, 7, 10, 13, 14 dhe 17

Gjykata nuk gjen asgjë në të dhënat e rastit që mund të shpërfaqin shkeljen e të drejtave të garantuara nga dispozitat e tjera të pretenduara nga ankuesit, dhe i shpallë këto kërkesa të papranueshme / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: *protestë / liri e tubimit / ndërprerje / ndërhyrje me forcë / autoritete / detyrime pozitive*

Ankuesit: z. Nurettin Aldemir, znj. Arzu Doğan, znj. Şehrinaz Artar, z. Ömer Buzludağ, z. Sami Evren, z. Ali Rıza Özer, z. Tacettin Yağdıran dhe znj. Elif Akgül, tetë shtetasë turqë. Disa prej tyre jetonin në Stamboll, të tjerë në Ankara

Faktet e rastit

Ankuesit janë anëtarë të “EĞİTİM-SEN” (Sindikata e Punëtorëve të Arsimit), një sindikatë kjo e cila është anëtare e konfederatës së sindikatave të punonjësve publikë, e njohur me shkurtesën “KESK”.

Në vitin 2001, Parlamenti i Turqisë kishte përgatitur një projektligj për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Sindikatat. Derisa projektligji diskutohej në Parlament, KESK-u kishte vendosur që të organizonte takime në Ankara për të protestuar kundër projektligjit. Qëllimi ishte që të tërhiqej vëmendja dhe të bëhej e mundur tërheqja e projektligjit, i cili, në pikëpamjen e tyre, nuk plotësonte standardet ndërkombëtare. Në ndërkohë, qeverisja e Ankarasë kishte lëshuar një qarkore, e cila ofronte udhëzime në lidhje me takimet dhe demonstratat e organizuara në qytetin e Ankarasë, në pajtim me Ligjin për Takimet dhe Marshet Demonstruese. Sipas qarkores, vendi i zgjedhur për takim nga KESK-u nuk ishte në listën e zonave të lejuara.

Në dy raste, derisa presidenti i KESK-ut po lexonte deklaratat, policia i kishte paralajmëruar protestuesitë se veprimi i tyre ishte në kundërshtim me ligjin dhe se ata duhet të shpërndaheshin. Pas këtij paralajmërimi, policia kishte ndërhyrë, duke përdorur gaz lotsjellës dhe shkopinj në përpjekje për të shpërndarë turmën. Ankuesit ishin lënduar gjatë incidenteve të shkaktuara me këtë rast.

Ankuesit kishin paraqitur ankesë në zyrën e prokurorit publik të Ankarasë kundër Guvernatorit të Ankarasë, drejtorit të Drejtoratit të Sigurisë së Ankarasë, drejtorit të Forcave për Ndërhyrje të Shpejtë, si dhe zyrtarëve policorë të përfshirë në incidente. Në ndërkohë, prokurori publik kishte ngritur aktakuza kundër 27 protestuesve,

përfshirë edhe dy prej ankuesve, për shkelje të Ligjit për Takimet dhe Marshet Protestuese.

Sa i përket, ndërkaq, kërkesës së ankuesve drejtuar prokurorisë, ajo ishte transferuar nga prokuroria te Ministria e Brendshme, me kërkesën për autorizim të fillimit të procedurave penale. Ministria e Brendshme kishte vendosur që të mos ndërmarrë veprime ndaj zyrtarëve dhe policëve të akuzuar nga ankuesit, pasi kishte konstatuar se akuzat ishin të një “natyre abstrakte”. Tutje, Ministria kishte vlerësuar se forca e përdorur ka qenë e ligjshme dhe e justifikuar në rrethanat e rastit.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit në mënyrë të veçantë janë ankuar me pretendimin se ata janë keqtrajtuar dhe liria e tyre e tubimit është cënuar nga zyrtarët e policisë së Drejtoratit të Sigurisë të Ankarasë. Ata kanë pretenduar shkelje të Neneve 1, 3, 5, 6, 7, 10, 11, 13, 14 dhe 17 të Konventës.

Qeveria ka paraqitur qëndrimin se në rastin konkret nuk ka pas ndërhyrje në të drejtën e ankuesve për tubim. Tutje, Qeveria ka deklaruar se forcat e sigurisë kanë shpërndarë protestuesitë me forcë pasi këta të fundit nuk i janë bindur paralajmërimeve rreth lokacionit dhe kanë vazhduar me marshimet e jashtëligjshme.

Ankuesit, nga ana e tyre, kanë deklaruar se forcat e sigurisë kanë ndërhyrë në mënyrë të jashtëligjshme në ushtrimin e të drejtës së tyre për tubim paqësor.

Më tej, Qeveria ka mbajtur qëndrimin se ndërhyrja në rastin konkret ka qenë e parashikuar me ligj dhe se ndërhyrja ka ndjekë një qëllim legjitim: në këtë rast, parandalimin e çrregullimit publik dhe ruajtjen e sigurisë publike. Ankuesit, ndërkaq, kanë argumentuar se ndërhyrja ka qenë jopërpjestimore.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata ka ritheksuar parimin se ndërhyrja do të paraqiste shkelje të Nenit 11 përveç nëse është e parashikuar me ligj, ndjek një nga qëllimet legjitime të përshkruara në paragrafin 2 dhe është e nevojshme në një shoqëri demokratike për arritjen e atyre qëllimeve.

Në ndërlidhje me këtë, Gjykata ka vënë re se ndërhyrja në rastin konkret ka pas bazë ligjore, më saktësisht në Nenin 22 të Ligjit për Takimet dhe Marshet Protestuese, dhe ka qenë kësajsoji e parashikuar me ligj. Sa u përket qëllimeve legjitime, Qeveria ka përmendur parandalimin e çrregullimit dhe ruajtjen e sigurisë publike, dhe Gjykata nuk ka gjetur arsye për të dalluar në këtë pikë.

Sa i përket pyetjes nëse ndërhyrja ka qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata ka rikujtuar se del qartë nga praktika e saj gjyqësore se autoritetet kanë detyrim për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zhvillimin paqësor të protestave dhe sigurinë e të gjithë qytetarëve. Gjykata, po ashtu, vëren se shtetet duhet jo vetëm të mbrojnë lirinë e tubimit paqësor, por duhet gjithashtu të kufizohen nga aplikimi i kufizimeve indirekte të paarsyeshme ndaj kësaj të drejte. Në fund, Gjykata konsideron se, ndonëse objekti thelbësor i Nenit 11 është të mbrojë individin kundër ndërhyrjeve arbitrare të autoriteteve publike në ushtrimin e të drejtave të tyre të mbrojtura, megjithatë mund të ketë detyrime pozitive për të siguruar gëzimin e tyre efektivë.

Në rastin konkret, Gjykata ka rikujtuar se KESK-ut ka mbajtur dy protesta dhe derisa presidenti i KESK-ut ka qenë duke lexuar deklaratat, policia ka ndërhyrë dhe u ka kërkuar protestuesve që të shpërndahen. Policia ka përdorur shkopinj dhe gaz lotjellës. Disa protestuar janë kundërpërgjigjur dhe kjo ka rezultuar pastaj në lëndimin e disa protestuesve, përfshirë pesë nga ankuesit, duke përfshir edhe një numër zyrtarësh policorë. Gjykata ka vërejtur se në rastin konkret nuk ka dëshmi se grupi në fjalë fillimisht ka paraqitur ndonjë rrezik serioz ndaj rendit publik. Sidoqoftë, është e mundur që ata do të mund të shkaktonin pak tollovi, veçanërisht në një shesh të ngarkuar të Ankarasë. Qëllimi i tyre ishte që të tërhiqnin vëmendjen ndaj një projektligji sensitiv të propozuar në Parlament dhe tubimi i tyre fillimisht ishte paqësor. Sidoqoftë, autoritetet kanë ndërhyrë me forcë të konsiderueshme për t'i shpërndarë ata, duke krijuar tension, dhe më pas shkaktuar përleshje.

Në opinionin e Gjykatës, kur protestuesit nuk angazhohen në veprime të dhunshme, është e rëndësishme që autoritetet publike të tregojnë një shkallë të tolerancës ndaj tubimeve paqesore, në mënyrë që liria e tubimit e garantuar në Nenin 11 të mos privohet nga e gjithë substanca e saj. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se, në rastin konkret, ndërhyrja me forcë e zyrtarëve të policisë ka qenë jopërpjestimore dhe nuk ka qenë e nevojshme për të parandaluar prishjen e rendit publik brenda kuptimit të paragrafit të dytë të Nenit 11 të Konventës. Në këtë mënyrë, Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 11.

Sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata nuk gjen asgjë në të dhënat e rastit që mund të shpërfaqin shkeljen e të drejtave të garantuara nga dispozitat e tjera të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosë se ka shkelje të Nenit 11 të Konventës Gjykata shpallë të papranueshme kërkesat për shkelje të dispozitave të tjera të pretenduara [*pesë votapër, kundër dy / njëzëri*].

Kasparov dhe të tjerët kundër Rosisë - 21613/07

3 tetor 2013 [Seksioni i Parë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6 § 1

Shkelje e të drejtës në proces gjyqësor si pasojë e mos ftuarjes së dëshmitarëve / *ka shkelje*

Neni 11

Sjellja e autoriteteve gjatë një proteste nuk ishte e arsyeshme dhe proporcionale / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *protestë / tubim paqësor / kufizime / rrezikshmëri / arrestim / jolegjitim / gjykim i drejtë / mungesë dëshmitarësh / interes publik / jo-proporcionale /*

Ankuesit: Garri Kasparov, Aleksey Tarasov, Nikolai Kharlamov, Nikolai Kalashnikov, Andrey Toropov, Aleksandr Stelmakh, Yuriy Orel, Vyacheslav Melikhov dhe Oksana Chelysheva, shtetas rusë që jetojnë në Moskë, në rajonin e Moskës dhe Nizhny Novgorod

Faktet e rastit

Tetë nga ankuesit u arrestuan më 14 prill 2007 përpara një demonstratë anti-qeveritare që do të zhvillohej në Moskë atë ditë. Ndërsa organizatorët kishin për qëllim të marshonin përgjatë disa rrugëve në qendër, autoritetet kishin lejuar vetëm një takim në mes të 12:00 dhe 13:30, afër një monumenti në një lokacion tjetër në qendër të Moskës. Katër nga aplikuesit - Z. Kasparov, Z. Tarasov, Z. Toropov dhe Znj. Chelysheva - po planifikonin të merrnin pjesë në demonstratën e autorizuar, dhe tre nga ata u arrestuan në orën 01:00 të mëngjesit, gjatë rrugës së tyre për në monument. Pesë ankuesit e mbetur parashtruan se ata ndodheshin përreth, por nuk kishin ndërmend të merrnin pjesë në demonstratë, kur u arrestuan dhe u dërguan në një stacion policor. Zonja Chelysheva pretendon se ajo ishte shqelmuar nga një oficer i policisë, përderisa ishte në rrugën e saj për tek demonstrata dhe ishte lënduar aq keq sa që ajo nuk ishte më në gjendje të marrë pjesë në demonstratë.

Po të njëjtën ditë, tetë ankuesit e parë u dënuan për kundërvajtje administrative, respektivisht për shkeljen e rregullave mbi mbajtjen e demonstratave dhe u urdhëruan të paguajnë një gjobë. Gjyqtari arriti në përfundimin se ata kishin tentuar të merrnin pjesë në një demonstratë të paautorizuar në rrugën ku ata u arrestuan. Gjatë seancave të tyre respektive, të gjithë ankuesit kontestuan dëshmitë e policisë lidhur me kohën dhe vendin e arrestimit të tyre dhe kërkuan nga gjykata që të thërrasin dhe të ekzaminonin dëshmitarë të tjerë okularë, por kërkesa e tyre u refuzua nga gjyqtari, i cili zbuloi se faktet ishin mjaftueshëm të vërtetuara. Në rastin e z. Toropov, seanca u mbajt në mungesën e tij dhe të avokatit të tij. Të gjitha ankesat e ankuesve ishin të pasuksesshme.

Përmbledhje e pretendimeve

Tetë nga ankuesit u ankuan për shkelje të Nenit 6 § 1 (e drejta për gjykim të drejtë), duke pretenduar në veçanti se dëshmitarët në mbrojtje të tyre nuk ishin thirrur. Të nëntë ankuesit u ankuan se sjellja e autoriteteve më 14 prill 2007 kishte shkelur të drejtat e tyre sipas Nenit 10 (liria e shprehjes) dhe Neni 11 (liria e tubimit dhe asociimit).

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me Nenin 6 § 1 të Konventës, Gjykata vuri në dukje se rrethanat e arrestimit të ankuesve ishin të papërputhshme midis palëve. Në veçanti, në procedurat para gjykatave ruse, z. Kasparov kishte pretenduar se kishte ecur me një grup të vogël njerëzish në vendin e demonstratës së autorizuar. Policia, nga ana tjetër, kishte pretenduar se ai kishte marrë pjesë në një marshim të paautorizuar pasi ngjarja e autorizuar afër monumentit kishte e mbaruar. Policia kontestoi pohimin e ankuesve se ata ishin arrestuar në orën 01:00, domethënë, përderisa ngjarja e autorizuar ishte ende duke u zhvilluar. Megjithatë, Qeveria Ruse i ka konfirmuar pjesërisht Gjykatës afatin e supozuar nga ankuesit. Për më tepër, sipas policisë, ankuesit ishin arrestuar kur demonstrata kërcënoi të përhapet në Sheshin e Kuq, një zonë e caktuar e sigurisë së lartë. Z. Kasparov, përkundrazi, këmbënguli që ai ishte arrestuar në një distancë të konsiderueshme nga Sheshi i Kuq. Deklaratat e ankuesve të tjerë në mënyrë të ngjashme ishin në kundërshtim me dëshmitë e policisë.

Duke qenë se dënimi i ankuesve ishte bazuar kryesisht në marrjen e qëndrimit të tyre në një vend të caktuar në një kohë të caktuar, e drejta e tyre për një gjykim të drejtë nënkuptonte se atyre duhej dhënë një mundësi e arsyeshme për të kundërshtuar në mënyrë efektive këtë supozim. Megjithatë, gjykatat ruse kishin kundërshtuar përpjekjet e ankuesit në fjalë për të sqaruar kohën dhe vendin e arrestimit të tij. Edhe pse thirrja e dëshmitarëve okularë, emrat e të cilëve ishin të njohur, do të mund të bëhej lehtësisht, gjyqtari e kishte konsideruar atë të tepërt në procedurë dhe kishte pranuar parashtresat e policisë pa hezitim. Gjykimet e ankuesve të tjerë ishin kryer të gjitha në një mënyrë krejtësisht identike, pa asnjë mundësi që ata të siguronin dëshmi në mbështetje të verzionit të tyre të ngjarjeve. Në rastin e z. Toropov, situata ishte përkeqësuar më tej nga fakti se gjykata atëbotë nuk e konsideronte praninë e tij ose të avokatit të tij, si të nevojshme në seancë. Gjykata arriti në përfundimin se të drejtat e ankuesve ishin kufizuar në një mënyrë të papërputhshme me garancitë për një gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 6.

Lidhur me Nenin 11 të Konventës, Gjykata deklaroi ankesat sipas Nenit 10 dhe Nenit 11 të pranueshme vetëm për tre nga anuesit Z. Kasparov, Z. Tarasov dhe Z. Toropov. Përderisa, ankesa e tyre sipas Nenit 11 duhej të konsiderohej në lidhshmëri me të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes (Neni 10), Gjykata e konsideroi të panevojshme ta shqyrtonte atë ndaras nga Neni 10.

Ishte e pakontestueshme që arrestimi i tyre dhe akuzat administrative që pasuan kishin përbërë ndërhyrje me të drejtën e tyre për tubim paqësor. Duke qenë se Gjykata nuk kishte material faktik të mjaftueshëm për të zgjidhur mosmarrëveshjet mes palëve për kohën dhe vendin e saktë të arrestimit të ankuesve, nuk ishte në gjendje të pranonte

verzionin e secilës palë si bazë për të vendosur nëse autoritetet kishin vepruar në mënyrë të ligjshme.

Gjykata ishte e gatshme të pranonte se arrestimi dhe dënimi i ankuesve kishin ndjekur qëllimin legjitim të mbajtjes së rendit publik, siç e kishte mbajtur Qeveria. Qeveria kishte argumentuar se arrestimi kishte ndodhur për shkak të rrezikut që demonstratat të dilnin në zonën e sigurisë të Sheshit të Kuq, dhe këto arsye ishin përmendur edhe nga policët që dhanë dëshmi. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se raportet e policisë të vetë ngjarjes nuk përmendën ndonjë rrezik të tillë. Për më tepër, vendi i arrestimit i treguar në aktgjykim ishte rreth 1.4 km larg nga Sheshi i Kuq. Prandaj, Gjykata nuk ishte e bindur se kërcënimi i marshuesve që të hynin në zonën e sigurisë kishte qenë i mundshëm.

Sipas materialit të paraqitur në Gjykatë, oficerët e policisë që morën pjesë në operacionin e kontrollit të trazirave kishin marrë udhëzime të qarta dhe përforcimet e policisë së trazirave ishin sjellë në Moskë nga rajone anembanë Rusisë në funksion të demonstratës së pritur. Gjykata, pra, nuk mund ta pranonte argumentin e Qeverisë Ruse se policia kishte kërkuar të arrestonte protestuesit, sepse ata ishin mbingarkuar nga demonstrata dhe përndryshe nuk do të ishin në gjendje të përballëshin me të.

Gjykata gjeti se ankuesit ishin arrestuar dhe akuzuar për arsyen e vetme që autoritetet e kishin parë se demonstrata e tyre ishte e paautorizuar. Prandaj, Qeveria nuk arriti të demonstronte se kishte ekzistuar një "nevojë urgjente sociale" për t'i arrestuar ata. Në këto rrethana, ndërhyrja e dhunshme e policisë ishte joproporcionale dhe jo e domosdoshme për parandalimin e trazirave, duke shkelur kështu Nenin 11 të Konventës.

Gjykata konstatoi se të drejtat e ankuesve ishin kufizuar në një mënyrë të papajtueshme me garancitë për një gjykim të drejtë, pasi kërkesa e tyre për të shqyrtuar dëshmitarët okularë ishte refuzuar e tyre, dhe arrestimi kishte qenë joproporcional me qëllimin e ruajtjes së rendit publik. Gjykata detyroi Rusinë t'i paguante secilit, z. Kasparov, Tarasov dhe Toropov, 10,000 EUR ndërsa Nikolai Kharlamov, Nikolai Kalashnikov Aleksandr Stelmakh, Yuriy Orel dhe Vyacheslav Melikhov, secilit nga 4,000 EUR në lidhje me dëmin jomaterial dhe një shumë agregate prej 10,500 EUR në lidhje me shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet që lidhen me tarifat e tre avokatëve që përfaqësojnë pesë ankuesit.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se kishte shkelje të Nenit 6 dhe 11 të Konventës [njëzëri].

Neni 12

E drejta për t'u martuar

Burri dhe gruaja, që kanë mbushur moshën për martesë, kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje, sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.

Christine Goodwin kundër Mbretësisë së Bashkuar - 28957/95

1 korrik 2002 [Seksioni i Tretë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 8

Deshtimi i shtetit që të jetë në harmoni me obligimet pozitive që të siguroj të drejtën për transformim të gjinise ka rezultuar në deshtimin e respektimit të drejtes në jeteë private / *ka shkelje*

Neni 12

Shkelje e të drejtes në martesë për shkak të mos njohjes së gjinisë, e cila ka ndërruar si pasojë e transformimit / *ka shkelje*

Neni 13

Mungesa e mjeteve efektive juridike për të adresuar shkeljet e të drejateve të pas ndryshimit të gjinse / *nuk ka shkelje*

Neni 14

Nënshtrimi ndaj trajtimit diskriminuese dhe paragjykimeve si rezultat i mungesës së njohjes ligjore të ndryshimit të gjinisë / *nuk ngritet çështje ndaras*

Fjalët kyçe: *martesë / ndërrim gjinie / (mos) njohje me ligj / trans-seksual / diskriminim / paragjykim / pengesa në punë / e drejtë ligjore*

Ankuesja: Christine Goodwin, lindi në vitin 1937 si një burrë, por ajo jetoi si grua që nga viti 1984

Faktet e rastit

Në vitin 1990 ankuesi iu nënshtrua një operacioni të ripranimit gjinor. Shumë kohë para operacionit ajo kishte qenë e martuar dhe kishte qenë 'babai' i katër fëmijëve. Ajo argumentoi se ishte ngacmuar dhe poshtëruar në vendin e saj të punës nga kolegët e saj në baza seksuale. Megjithatë, pasi ajo nuk konsiderohej se ishte grua ligjerisht, veprimi i saj për inicimin e anesave për diskriminim në bazë të seksit në punë ishte e pasuksesshme. Ankuesja u shkarkua më pas nga punësimi i saj për arsye të lidhura me shëndetin e saj, por pohon se arsyeja e vërtetë ishte se ajo ishte trans-seksuale. Asaj iu mohua gjithashtu edhe pensioni në moshën 60 vjeç, moshë kjo e percaktuar si drejtë për gratë në Mbretërinë e Bashkuar, dhe kështu u detyrua të vazhdojë të paguajë sigurimin kombëtar deri në moshën 65 vjeç. Në shumicën e rasteve ajo u kufizua nga përparësitë që mund të kishte, nëse ajo do të tregonte certifikatën e lindjes. Dosja e saj e të dhenave ishte e klasifikuar si sensitive ne DSS dhe nënkuptone se vetem zyrtarët e lartë mund të kishin qasje në këtë dosje. Nëse ankuesaj donte të shihte dosjen ajo duhej të caktonte një takim të veçantë.

Një nga pretendimet e saj të ishte se ajo nuk mund të martohej me partnerin e saj, meqenëse Akti i Lidhjeve Matrimoniale 1973 [6] (Matrimonial Causes Act) e ndalon

atë. Akti është mbështetur gjithashtu nga jurisprudenca, pasi është vendosur në rastin *Corbett v Corbett* se seksi duhet të përcaktohet me aplikimin e 'testeve kromosomale, gonadal dhe gjenitale'. Ky përdorim i kriterëve biologjike u miratua gjithashtu në *R v Tan*.

Ligji kërkon që gjinia e fëmijës të futet në certifikatën e lindjes. Kriteret për përcaktimin e gjinisë së fëmijës nuk janë përcaktuar në Aktin e 1953, por praktika tregon se Sekretari përdor kriteret biologjike, të përcaktuara më sipër. Korrigjimet mund të bëhen vetëm nëse ka ndonjë gabim. Kur bëhet fjalë për punësim, çdo qytetari i jepet vetëm një numër unik NI, prandaj, seksi i transeksualëve regjistrohët si ai në lindje.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesja parashtroi se, pavarësisht paralajmërimeve nga Gjykata në lidhje me nevojën për reforma ligjore Qeveria ende nuk kishte ndërmarrë ndonjë hap konstruktiv për të adresuar vuajtjet e përjetuara nga ankuesja si dhe transeksualët e tjerë. Mungesa e njohjes ligjore të gjinisë së saj të ndryshuar ka qenë shkak i përvojave të shumta diskriminuese dhe poshtëruese në jetën e përditshme. Në të kaluarën, në veçanti nga viti 1990 deri më 1992, ajo u keqtrajtua në vendin e saj të punës dhe nuk kan marrë mbrojtje të duhur kundër diskriminimit. Ajo pohoi se ndër morri të gjitha procedurat e veçanta përmes të cilave ajo do të duhej të përfitonte nga kontributet e saj, megjithatë ajo nuk arriti të marrë benefitet e kontributit për shkak të gjinisë, benefite këto që do ti gëzonte nëse ajo ishte njohur si një grua për qëllime ligjore. Ankuesaj me tutje theksoi se, vetë fakti se DSS praktikoi një politikë të shënimit të të dhënave të transeksualëve si të ndjeshëm paraqiste një ndryshim në trajtim. Për pasojë ankuesja nuk mund të merrte pjesë në DSS pa pasur nevojë të bëjë një takim të veçantë. Ankuesja më tej pohoi se rreziku fakti se ligjërisht nuk ishte ndërruar identitetin dhe gjinnëe saj ishte rrezik permanent për të sepse punëdhënësit e rinjë të saj mund të mësonin identitetin e saj të kaluar në bazë të numrit të saj të NI i cili nuk kishte ndërruar asnjëher.

Ankuesja u ankua se shteti kishte dështuar që të jetë në harmoni me obligimet positive që të siguroj të drejtën për transformim të gjinisë dhe për këtë ka rezultuar në dështimin e respektimit të së drejtës në jetë private të garantuar sipas Nenit 8 të Konventës. Tutje, ankuesja u ankua se e drejta e saj nën Nenin 12 të Konventës nuk realizua. Ajo u ankua se megjithëse ajo aktualisht gëzonte një marrëdhënie të plotë fizike me një burrë, ajo dhe partneri i saj nuk mund të martoheshin sepse atë ligji ende e trajtonte si një burrë. Ankuesja mbështetur në Nenin 14 të Konventës, gjithashtu u ankua se mungesa e njohjes ligjore të ndryshimit të gjinisë së saj ishte shkak i përvojave të shumta diskriminuese dhe paragjyqimeve. Së fundmi ankuesja pretendoi se kishte mungesa të mjeteve efektive juridike për të adresuar shkeljet.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata trajtoi fillimisht Nenin 8 të Konventës, përkatësisht pretendimet e ankueses se prova biologjike e pastër për përcaktimin e seksit ishte në kundërshtim me Nenin 8 të Konventës. Lidhur me këtë ankuesja kishte kërkuar lëshimin e certifikatave të rishikuara të lindjes postoperative. Ajo gjithashtu pohoi se dështimi i saj për tu promovuar në punë ishte e lidhur drejtpërdrejt me mundësinë e punëdhënësit për të

gjurmuar historinë e saj të punësimit dhe për të identifikuar të kaluarën e saj në bazë të numrit të saj NI. Kjo, sipas saj, ishte një shkelje e Nenit 8, po ashtu. Qeveria, nga ana e saj, pohoi se një punëdhënës nuk ishte në gjendje të zbulonte seksin e ankuesit nga numri i NI-së, sepse ishte e pamundur të gjente ndonjë referencë për seksin e saj në të. Për më tepër, qeveria deklaroi se ngacmimi në vendin e punës krijoi një kërkesë sipas Aktit të Diskriminimit Gjinator 1975, prandaj mbrojtja i ishte dhënë asaj në bazë të këtij akti. Gjykata mbajti njëzëri, se kishte pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Çështja e dytë para gjykatës ishte të gjente nëse kishte shkelje të Nenit 12 të Konventës. Nga parashtrimi i ankueses, mund të kuptohet se një fushë tjetër e diskutueshme ishte martesë. Ajo ishte e pakënaqur me kriteret biologjike, të përdorura në rastin *Corbett v Corbett*, dhe sugjeroi që edhe nëse Corbett ishte ende një "ligj i mirë", ai binte në kundërshtim me Nenin 12 të Konventës. Qeveria, nga ana tjetër, iu referua ligjit të mëparshëm të gjykatës dhe pohoi që leja e martesës transeksuale nuk kërkohet nga Neni 12 ose 8. Përveç kësaj, qeveria gjithashtu pohoi se meqenëse margjina e vlerësimit ishte e gjerë, ishte një çështje e shtetit që të vendos mbi këtë çështje. Së fundmi, qeveria kujtoi se çdo ndryshim mund të ketë pasoja të padëshiruara, p.sh. nga ana sociale. Gjykata duke analizuar rrethanat e rastit vëre se nuk shihte nonjë arsye pse një trans-seksual të mos mund të gëzonte të drejtat e garantuara nga Konventa, përkatësisht të drejtën në martesë. Andaj duke pas parasysh pamundësinë e ankueses për të realizuar këtë drejt Gjykata gjen se kishte pasur shkelje të Nenit 12 të Konventës.

Me pas Gjykata shqyrtoi pretendimet lidhur Nenin 14, ku ankuesja kishte argumentuar se fakti që ajo nuk ishte e njohur ligjërisht si grua ishte shkak i disa kufizimeve diskriminuese për privilegjet e saj. Qeveria parashtrroi se nuk u ngrit ndonjë çështje e veçantë, kështu që kërkesa duhet të dështojë. Gjykata ra dakord, njëzëri, me qeverinë se asnjë çështje e veçantë nuk u ngrit sipas Nenit 14.

Se fundmi Gjykata trajtoi ankesën sipas Nenin 13, ku ankuesja pretendoi se ajo nuk kishte ndonjë mjet efektiv juridik në dispozicion të saj lidhur me çështjet për të cilat ajo ankohej. Qeveria nuk u pajtua me këtë duke thënë se Akti për të Drejtat e Njeriut (HRA 1998) ishte në fuqi që nga tetori i vitit 2000 dhe kështu të drejtat e Konventës mund të mbështeteshin me lehtësi. Gjykata deklaroi se nuk ka asnjë shkelje të Nenit 13.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjeti se kishte shkelje të Nenit 8, dhe shkelje të Nenit 12 të Konventës. Gjykata tutje konstatoi se asnjë çështje e veçantë nuk u ngrit sipas Nenit 14, dhe se nuk ka asnjë shkelje të Nenit 13 [njëzëri].

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 12

Dështimi i autoriteteve vendore për të zhvilluar procedurat e divorcit brenda një kohe të arsyeshme, mundet, në rrethana të caktuara ngrit çështje kontestuese / *ka shkelje*

Neni 6 § 1

Periudha gjatë cilës gjykatat vendore kanë shqyrtuar rastin ka qenë e tejzgjatur dhe ka dështuar të plotësojë standardin e “kohës së arsyeshme” / *ka shkelje*

Neni 8

Pretendim se pasiguria në konfirmimin e aftësië si pasojë e zgjatjes së procedurës përbënte shkelje / *hedhet poshtë*

Neni 13

Mungesë e mjeteve efektive si pasojë e dështimit të gjykatave më të ulëta që të Gjykata ntë veprojë në pajtim me kufirin kohor të përcaktuar nga gjykatat më të lart lidhur me përfundimin e procedurave civile të rastit / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *divorc / ri-martesë / atësi / konfirmim / tej-zgjatje e procedurave / jetë familjare / mjete efektive*

Ankuesi: V.K., shtetas kroat, i lindur në vitin 1964 dhe jeton në Zagreb

Faktet e rastit

Në nëntor të vitit 2002, ankuesi ishte martuar me M., dhe në shtator të vitit 2003, nga martesa, kishte lindur një fëmijë, me inicialin K.

Në prill të vitit 2004, ankuesi kishte paraqitur kërkesë për divorc pranë Gjykatës Komunale të Zagrebit. Në seancë gjyqësore, ankuesi kishte paraqitur propozimin rreth kontakteve dhe kujdestarisë për K. Në të njëjtën seancë gjyqësore, palët ishin pajtuar që martesa të shpërbëhej. Më vonë, M. e kishte njoftuar Gjykatën se nuk pajtohej me propozimin e ankuesit në lidhje me kujdestarinë e fëmijës dhe i kishte kërkuar Gjykatës të përcaktonte një shumë të përshtatshme.

Në shkurt të vitit 2005, ankuesi kishte paraqitur një kërkesë për shpejtim të procedurave. Ndërsa, në gusht të të njëjtit vit, ankuesi kishte nisur një veprim tjetër gjyqësor pranë Gjykatës Komunale, ku e kontestonte atësinë e tij të fëmijës. Në qershor të vitit 2007, Gjykata Komunale kishte urdhëruar kryerjen e një testi të DNA-së dhe pagesën e një shume prej 10,000 kunash kroate.

Në nëntor të vitit 2007, ankuesi kishte paraqitur një ankesë në Gjykatën Kushtetuese për zgjatje të procedurave. Në ankesë, ai kishte argumentuar se procedurat e stërgjatura të divorcit kishin efekt negativ në jetën e tij private dhe dinjitetin e tij dhe se kjo vonesë e parandalonte martesën e tij me një grua tjetër, të planifikuar për qershor të vitit 2008.

Ndërkohë, në një seancë dëgjimore të mbajtur në shkurt 2008, Gjykata Komunale kishte konstatuar se ankuesi nuk kishte paguar shumën e plotë për testin DNA dhe kishte mbyllur seancën. Ankuesi kishte kërkuar lirim nga pagesa, duke u mbështetur në të drejtat e veteranëve të luftës, por kërkesa nuk ishte pranuar. Ndërsa Gjykata Kushtetuese në shtator të vitit 2009, kishte hedhur poshtë ankesën, duke deklaruar se gjykatat më të ulëta tashmë kishin adresuar kërkesat në mënyrën e duhur.

Testi DNA nuk ishte kryer si rezultat i mosparaqitjes së K. dhe M. Në nëntor dhe dhjetor të vitit 2009, ankuesi e kishte njoftuar Gjykatën Komunale për tërheqjen e kërkesës në lidhje me atësinë e K-së, mbi bazën se pagesa e kërkuar përbënte një barrë të papërbalueshme financiare, duke qenë se ishte i papunë dhe pa ndonjë burim të ardhurash. Ai, po ashtu, kishte kërkuar anulimin sa më parë të martesës, pasi përfitimet sociale vareshin nga statusi i tij martesor. Në një seancë dëgjimi në janar 2010, palët kishin arritur marrëveshje rreth kujdestarisë së fëmijës dhe kontakteve të ankuesit me K. Në njëjtën ditëm Gjykata Komunale kishte anuluar martesën. Më 11 shtator 2010, ankuesi ishte martuar me J.V.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi ka ngritur pretendime se zgjatja e procedurave civile para Gjykatës Komunale i ka çenuar të drejtën e gjykimit brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me Nenin 6 të Konventës. Ankuesi ka argumentuar se divorci duhej të jetë zgjidhur pesë vite më parë, kur palët kishin arritur marrëveshje, dhe atësia do të mund të zgjidhej më herët sikur Gjykata Komunale të kishte parandaluar palën tjetër nga pengimi i rrjedhës së procedurave.

Qeveria, nga ana e saj, ka pranuar gjetjet e gjykatave vendore se zgjatja e procedurave ka kaluar “kohën e arsyeshme”, por nuk është pajtuar se vonesat e shkaktuara pas vendimit të Gjykatës Supreme kanë qenë bërë për shkak të gjykatave vendore. Qeveria ka argumentuar, gjithashtu, se rasti ka qenë shumë kompleks, pasi është marrë me tri çështje të ndërlidhura (divorci, atësia dhe kujdestaria).

Ankuesi, gjithashtu, ka pretenduar shkeljen e Nenit 8, duke argumentuar se pasiguria e zgjatur në lidhje me atë nëse ai është babai i K., ka shkelur të drejtën e tij për respektim të jetës së tij private dhe familjare. Qeveria, nga ana e saj, ka deklaruar se asnjëherë nuk ka pas pasiguri në lidhje me atësinë e ankuesit të K., në dritë të faktit se ligji vendor përcakton supozimin ligjor se bashkëshorti i së ëmës është gjithashtu babai i fëmijës së lindur në martesë.

Ankuesi ka ngritur pretendime për shkelje edhe në lidhje me Nenin 12 të Konventës, duke argumentuar se zgjatja e procedurave gjyqësore ka keqësuar të drejtën e tij për t’u martuar sërish. Qeveria, ndërkaq, ka argumentuar se divorci nuk bie në fushëveprim të Nenit 12 të Konventës. Dhe, në cilindo rast, ankuesi ka dështuar që të mbështesë argumentet e tij, si para Gjykatës ashtu dhe autoriteteve vendore, se ai seriozisht dëshironte të rimartohej.

Ankesë është paraqitur edhe sa i përket mungesës së mjeteve efektive juridike sipas Nenit 13 të Konventës, me arsyetimin se Gjykata Themelore nuk ka vepruar në pajtim me urdhërat e gjykatave më të larta për të marrë vendim brenda një afati kohor të përcaktuar. Qeveria e ka kontestuar këtë pikëpamje, duke argumentuar se mjetet e brendshme juridike kanë qenë efektive në lidhje me ankesat për zgjatje të procedurave.

Arsyetimi i Gjykatës

Sa i përket Nenit 6 të Konventës, Gjykata ka rikujtuar se shpesh, në rastet e ngjashme si ky, ajo ka gjetur shkelje të Nenit 6 § 1. Gjykata ka mbajtur qëndrimin se periudha gjatë cilës gjykatat vendore kanë shqyrtuar rastin ka qenë e tejzgjatur dhe ka dështuar të plotësojë standardin e “kohës së arsyeshme”. Kësisoj, ka gjetur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

Në lidhje me Nenin 8, Gjykata ka theksuar se, kjo dispozitë, mbron jo vetëm familjen, por edhe jetën private. Dhe çështja e përcaktimit të marrëdhënieve me personat e tjera hyn në kuadrin e jetës private. Megjithatë, në rastin konkret, ankuesi ka tërhequr kërkesën për përcaktimin e atësisë, prandaj Gjykata ka vendosë që të hedhë poshtë këtë kërkesë.

Në kontekst të Nenit 12, Gjykata ka ridekluar se Neni 12 siguron të drejtën themelore të një burri dhe një gruaje për t’u martuar dhe krijuar familje. Ushtrimi i kësaj të drejta prodhon pasoja personale, shoqërore dhe ligjore. Gjykata rithekson se, ndonëse një e drejtë për divorc nuk mund të përcaktohet nga Neni 12 i Konventës, nëse legjislativi kombëtar e lejon divorcin, ai u siguron personave të divorcuar të drejtën e rimartesës pa kufizime të paarsyeshme. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se dështimi i autoriteteve vendore për të zhvilluar procedurat e divorcit brenda një kohe të arsyeshme, mundet, në rrethana të caktuara, të ngrisë çështje sipas Nenit 12. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata gjen se ka pas shkelje të Nenit 12 të Konventës.

Në lidhje me kërkesën për gjetje të shkeljes së Nenit 13, Gjykata ka vënë re se Gjykata Komonale ka dështuar të veprojë në pajtim me kufirin kohor të përcaktuar nga Gjykata e Qarkut për përfundimin e procedurave civile të rastit. Në këtë rrethanë, Gjykata nuk ka mundur të pranojë se mjetet juridike në lidhje me zgjatjen e procedurave kanë qenë efektive në rastin e ankuesit. Kësisoj, ka pas shkelje të Nenit 13 të Konventës.

Gjykata i akordon ankuesin një shumë në vlerën prej 4,000 EUR për dëmin jo-material, duke pranuar se dëmi jo-material që i është shkaktuar ankuesit nuk mund të kompensohet vetëm me gjetjen e shkeljeve të dispozitave të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës dhe Nenit 13 të Konventës [njëzëri]; gjithashtu vendosë se ka shkelje të Nenit 12 të Konventës [gjashhtë votapro/kundër një].

B. dhe L. kundër Mbretërisë së Bashkuar - 36536/02
13 shtator 2005 [Seksioni i Katërt]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 12

Shkelje e të drejtës në martesë si pasojë e pengesave ligjore për martesën e ish vjehrrit me renë e tij / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *divorc / fëmijë / familje / vjehri-nusja / ri-martesa / ndalesë / pengesa ligjore*

Ankuesit: B. (*ankuesi i parë*) dhe L. (*ankuesja e dytë*) janë shtetas britanikë që kanë lindur në vitin 1947 dhe 1968 dhe jetojnë në Warrington

Faktet e rastit

Aplikuesi i parë, u martua me A. dhe ajo martesë përfundoi me shkurorëzim në vitin 1987. Ankuesi dhe A. kishin një djalë së bashku, C. Ankuesi i parë më pas u ri-martua, por martesë përfundoi me shkurorëzim në korrik të vitit 1997.

Ankuesja e dytë, L., u martua me C, djalin e ankuesit të parë nga martesë e tij e parë. Ankuesi i parë dhe ankuesi i dytë ishin pra vjehri dhe nusja. Ankuesja e dytë dhe C janë ndarë në 1995 dhe shkurorëzimi i tyre u finalizua në maj të vitit 1997. Ankuesja e dytë dhe C kanë një djalë së bashku, W. Ankuesi i parë është, pra, gjyshi i W.

Ndërkohë, një marrëdhënie ndërmjet ankuesit të parë dhe të dytë u zhvillua në vitin 1995 pasi C ishte larguar nga shtëpia e ku jentonte me ankuesen e dytë. Aplikuesit kanë bashkëjetuar që nga viti 1996. W jetonte me ankuesit dhe kishte vetëm kontakt sporadik me babanë e tij, C. W tani e quan aplikuesin e parë "Babi". Ankuesit planifikojnë ta birësojnë W, gjë që lejohet nga ligji vendas i birësimi.

Në maj të vitit 2002, ankuesi i parë i shkroi Sekretariatit të Përhershëm të Vdekjeve dhe Martesave në Zyrën e Regjistrimit të Warrington për të pyetur nëse ai mund të martohej me ankuesen e dytë. Regjistruesi i mbikëqyresit u përgjigj se sipas legjislacionit përkatës vendas, do të ishte e pamundur që ankuesit të martoheshin, përveç nëse A. dhe C. do të kishin vdekur.

Ankuesit më pas kërkuan këshillë juridike nëse kishte ndonjë mjet juridik kundër vendimit të Sekretariatit të Përhershëm të Vdekjeve dhe Martesave, por u këshillua nga avokati se asnjë mjet juridik nuk ekzistonte pasi që baza e vendimit ishte legjislacioni primar, përkatësisht Akti i martesës, i vitit 1949, i ndryshuar nga Akti i Martesës së vitit 1986 (Aktet e Ndaluar të Marrëdhënieve).

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit u ankuan, sipas Neneve 12 (e drejta për t'u martuar) dhe 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës, nën arsyetimin se atyre u ishte ndaluar martesë me njëri-tjetrin.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata vuri në dukje se kufizimet e imponuara për të drejtën e burrit dhe gruas për t'u martuar dhe për të formuar familje nuk duhet të jenë aq të rënda sa të dëmtojnë vetë thelbin e kësaj të drejte.

Në rastin aktual, ankuesit jetonin së bashku në marrëdhënie të përhershme dhe të gjatë, por nuk ishin në gjendje të marrin njohjen ligjore dhe shoqërore të asaj marrëdhënieje për shkak të pengesës ligjore mbi martesën ndërmjet vjehrrit/vjehrrës dhe të resë/dhëndrrit. Fakti që, hipotetikisht, martesë mund të ndodhte në qoftë se të dy bashkëshortët e tyre të mëparshëm do të vdisnin, pasi fëmijët kanë tendencë të mbijetojnë prindërit e tyre, nuk e largonin dëmtimin e thelbit të së drejtës së tyre. E njëjta gjë vlen edhe për mundësinë e aplikimit në Parlament, pasi kjo ishte një procedurë e jashtëzakonshme dhe e kushtueshme, plotësisht në diskrecionin e organit legjislativ, dhe nuk i nënshtrohej rregullave ose precedenteve të dallueshme.

Gjykata vuri në dukje se pengesa për martesë, megjithëse duke ndjekur një qëllim legjitim në mbrojtjen e integritetit të familjes, nuk ka parandaluar që këto marrëdhënie të ndodhin. Për më tepër, duke qenë se asnjë incest ose dispozita të tjera penale nuk parandalonin marrëdhëniet jashtëmartesore midis vjehrrit/vjehrrës dhe të resë/dhëndrrit, nuk mund të thuhet se ndalimi i martesës së ankuesve e pengonte djalin e ankuesit të dytë të ekspozohej ndaj çdo konfuzioni të dyshuar ose pasigurisë emocionale.

Sipas ligjit të Mbretërisë së Bashkuar, pengesa për lidhjen e martesës të kësaj shkalle të afinitetit nuk i nënshtrohet ndalimit absolut. Martesat mund të lidhen, në pajtim me një akt/vendim vetanak të Parlamentit. Kjo i referohej një rasti të mëparshëm, të ngjashëm me atë të ankuesve, ku Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar kishte gjetur se ndalimi i martesës nuk shërbeu për qëllime të dobishme të politikës publike. Gjykata konsideroi se mospërputhja mes qëllimeve të deklaruara të paaftësisë dhe heqjes dorë, të aplikuar në disa raste, minoi racionalitetin dhe logjikën e ligjit në fjalë.

Qeveria ka argumentuar se rregulli i përgjithshëm mbetet i vlefshëm pasi që procedura parlamentare siguron që përjashtimet bëhen vetëm kur nuk do të ketë dëm. Gjykata konstatoi se nuk kishte asnjë indikacion që të bëheshin dispozita për hetime të hollësishme rreth rrethanave familjare. Sidoqoftë, një proces i tillë i vështirë dhe i shtrenjtë i verifikimit nuk duket se ofron një mënyrë praktike të arritshme ose efektive për individët që të mbrojnë të drejtat e tyre. Për më tepër, Gjykata do ta shihte me rezervë një sistem që do t'i kërkonte një personi në moshë madhore dhe me aftësi të plota mendore për t'iu nënshtuar një hetimi për të konstatuar nëse është i përshtatshëm të martohet. Andaj, Gjykata konstaton se ka shkelje të Nenit 12.

Po ashtu, Gjykata detyroi Mbretërinë e Bashkuar t'u paguante ankuesve 17,000 EUR në emër të shpenzimeve gjyqësore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se kishte shkelje të Nenit 12 të Konventës, dhe se konstatimi i kësaj shkeljeje përbën në vetvete satisfaksion për dëmin jo-material, të kërkuar nga ankuesit [njëzëri].

F. kundër Zvicrës - 11329/85

18 dhjetor 1987 [Gjykata]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 12

Pretendim se ndalimi trevjeçar për tu rimartuar ishte e papajtueshme me të drejtën për t'u martuar / ka shkelje

Fjalët kyçe: martesë / divorc / rimartesë / ndalesë e përkohshme / tri vite / divorce të shpeshhta / interes i palës

Ankuesi: F., shtetas Zviceran i lindur në 1943

Faktet e rastit

Ankuesi është martuar katër herë që nga viti 1963. Tri martesat e para u perfunduan me divorc; në rastin në fjalë ankuesi ankohet për ndalimin e përkohshëm të rimartimit të imponuar mbi atë pas divorcit të tretë. Ankuesi u martua me znj G. në 1963 dhe u divorcua më 8 maj 1964. Më 12 gusht 1966, ai u rimartua me znj B, e cila lindi atij një djalë më 26 nëntor të të njëjtit vit. Çifti u nda në dhjetor 1978. Ankuesi filloi të bashkëjeton me një grua tjetër. Znj. B mori një kërkesë për divorc më 27 tetor 1981. Gjykata i'a ndaloi ankuesit të ri-martohej brenda një viti, sipas Nenit 150 të Kodit Civil Zviceran.

Më pas ankuesi u martua me një grua vetëm 4 ditë pasi që e kishte njohur dhe punësuar si sekretare. Vetëm pas një muaji martese me 11 mars 1983, ankuesi filloi proceduar e divorcit në gjykatën Civile të Luzanës. Në fillim të muajit prill bashkëshortja e la pasi që ai kishte filluar të bashkë-jetonte me një dashnore.

Pas një përpjekjeje për pajtim palët nënshkruan një marrëveshje që mbulon efektet ndihmëse të divorcit më 16 maj 1983; në veçanti, ankuesi u zotua t'i paguante gruas së tij shumën prej 17,000 franga (CHF) zviceranë si kompensim për dëmin jomaterial. Gjykata Civile dha vendim më 21 tetor 1983 me të cilin hodhi poshtë ankesën ankuesit dhe aprovoi marrëveshjen e arritur mes tyre. Gjithashtu, Gjykata Civile i imponoi ankuesit ndalimin e martesës së re për një periudhë tre vjeçare.

Ankuesi u ankua në Divizionin e Apelit të Vaudit, duke kërkuar mos zbatimin e urdhrit për ndalimin e martesës. Ai mohoi se kushtet statutare ishin të plotësuar. Megjithatë, në 7 maj 1984, Divizioni i Apelit e miratoi vendimin e Gjykatës Civile.

Ankuesi apeloj në Gjykatën Federale për çështjet ligjore (recours en réformé), duke argumentuar se kushtet për zbatimin e Nenit 150 të Ligjit Nr Kodi Civil nuk ishin të plotësuar dhe se ndalimi i ri-martesës ka shkelur Nenet 12, 8 dhe 3 (Neni 12, Neni 8, Neni 3) të Konventës. Gjykata Federale, në vendimin e 18 tetor 1984, konstatoi se ankesa ishte e papranueshme në lidhje me papajtueshmërinë e pretenduar të Nenit 150 me Konventën, me arsyetimin se kjo ankesë duhet të ishte është ngritur me anë të një ankesë të ligjit publik (recours de droit public) dhe jo me anë të një ankimi në pikat e ligjit.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi u ankua kundër ndalimit tre vjeçar për tu rimartuar që Gjykata Civile e Qarkut Luzane i kishte imponuar atij më 21 Tetor 1986. Në parashtresën e tij, ankuesi u shpreh se Neni 150 i Kodit Civil Zviceran, në të cilin gjykata e divorcit e bazoi vendimin e vet në vetvete shkeli Konventën. Ankuesi solli çështjen e tij para Komisionit më 12 dhjetor 1984, duke pretenduar se ndalimi trevjeçar për tu ri martuar i vendosur ndaj tij nuk ishte në pajtueshmëri me të drejtën e tij për t'u martuar, dhe se detyrimi për respektimin e detyrimeve private dhe juridike ka ndikuar në jetën e tij familjare, si dhe vendimi për ndalimin e rimartesës paraqet dënim degradues.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht, Gjykata i referohet praktikës së saj të vendosur, në lidhje me procedurat që vijnë nga një ankesë individuale. Gjykata rikujton se në keso rast ajo do të kufizojë vëmendjen e saj, sa më shumë që të jetë e mundur, për çështjet e ngritura nga rasti konkret. Prandaj, detyra e saj nuk është vetem të rishikojë në mënyrë abstrakte pjesën e brendshme të ankesës, por edhe për të shqyrtuar mënyrën në të cilën ky ligj është aplikuar ndaj ankuesit dhe si e ka afektuar atë.

Gjykata rikujtoi se Neni 12 siguron të drejtën themelore të njeriut për t'u martuar dhe për të krijuar një familje. Ushtrimi i kësaj të drejte ngritë gjithashtu pasojat personale, sociale dhe ligjore. E drejta për tu martuar është subjekt i ligjeve kombëtare të Shteteve Kontraktuese, por kufizimet e paraqitura në këtë mënyrë nuk duhet të kufizojnë ose zvogëlojnë të drejtën në mënyrë të tillë ose në një masë të tillë sa vetë thelbi i së drejtës është i dëmtuar. Në të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës shfaqen këto "kufizime" si kushte dhe janë të mishëruara në rregulla procedurale ose substanciale.

Gjykata kujton praktikën e saj gjyqësore sipas së cilës Konventa duhet të interpretohet në dritën e kushteve të sotme.⁷¹ Megjithatë, fakti që, në fund të një evolucioni gradual, vendi respektiv e gjen veten në një pozicion të izoluar sa i përket një aspekti të legjislacionit të saj nuk nënkupton domosdoshmërisht se ky aspekt i është në kundërshtim me Konventën, veçanërisht në një fushë sensitive siq është martesja, e cila është aq e lidhur ngushtë me traditat kulturore dhe historike të secilës shoqëri.

Sipas praktikës së Gjykatës Federale të Zvicrës, masa e ndërmarrë në rastin konkret është një urdhër që rrjedh nga një faj i një peshe të jashtëzakonshme që ka luajtur një rol vendimtar në prishjen e martesave. Megjithëse është automatikisht e zbatueshme për shkak se është e detyrueshme sipas politikave publike, Neni 150 i Kodit Civil megjithatë u lejon gjykatave një shkallë diskrecioni, dhe periuda e ndalimit që do t'i imponohet palës në faj në rastin e divorcit të dhënë në bazë të shkeljeve të kurorës mund të shkojnë nga një deri në tre vjet. Në rastin në fjalë Gjykata Civile e Qarkut në Lausanne zgjodhi periudhën maksimale, bazuar në faktin se ishte e paparanueshme që ankuesi bëri aq shpesh prishje martesash. Prandaj, gjykata e divorcit nuk u kufizua vetëm në vlerësimin e pasojave të ndarjes së martesës dhe vlerësimin e marrëveshjes së bërë mes çiftit më 16 maj 1983, i cili parashikonte pagesën e kompensimi për dëmin jomonetar; ajo gjithashtu vlerësoi sjelljen e kaluar të ankuesit për të nxjerrë përfundime për të vlerësuar të drejtën e tij për t'u rimartuar.

⁷¹ Vendimin Airey i 9 tetorit 1979, Seria A nr. 32, par. 26

Qeveria fillimisht pretendoi se zbatimi i Nenit 150 në rastin në fjalë nuk ishte i paarsyeshëm, arbitrar e as joproporcional. Sanksioni i ankueshëm padyshim që rezultoi në një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës për t'u martuar, por kjo nuk e dëmtoi esencën e së drejtës së martesës. Si pjesë e konceptit zviceran të divorcit, sistemi i ndalimit ta përkohëshëm të rimartesës ishte shpjeguar me vendosmërinë e legjislaturës për të mbrojtur jo vetëm institucionin e martesës, por edhe të drejtat e të tjerëve dhe madje edhe të personit të prekur nga vet ndalimi. Gjykata nuk mund ta pranojë argumentin e ndalimi i përkohshëm i martesës është projektuar për të ruajtur të drejtat e të tjerëve, domethënë ato të bashkëshortit të ardhshëm të personit të divorcuar.

Qeveria më tej e konsideroi se një vendimm i tillë ndihmoi për ta mbrojtur vetë ankuesin. Sipas mendimit të Gjykatës, ky argument nuk ka peshë të mjaftueshme. Qeveria u mbështet gjithashtu në *rastin Johnston dhe të tjerët*⁷² sipas të cilit "ndalimi për divorc [nuk mundet], në një shoqëri që i përmbahet parimit të monogamisë,... të konsiderohet si dëmitim i substancës së së drejtës të garantuar me Nenin 12, duke pretenduar se e njëjta arsyeshmëri mund të zbatohet edhe më tej për një ndalim të përkohshëm të rimartesës. Sipas Gjykatës, situata e ankuesit është mjaft e dallueshme nga ajo e Johnston, pasi rastin e këtij të fundit bëhej fjalë e drejta e një njeriu që ishte ende i martuar e që martesa e tij u shpërbë. Sipas Gjykatës nëse legjislacioni kombëtar lejon divorcin gjë që nuk paraqet një kërkesë të Konventës, Neni 12, siguron për personat e divorcuar të drejtën për t'u rimartuar pa kufizime të paarsyeshme. Për këtëë sipas Gjykatës, masa e kontestuar, e cila ndikoi substancialisht në esencën e së drejtës për t'u martuar, ishte joproporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. Prandaj, Gjykata vie në përfundim se ka pasur një shkelje të Nenit 12. Shteti i paditur duhet të paguajë ankuesin 14,327 franga zvicerane në lidhje me shpenzimet dhe shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 12 të Konventës [*tetë vota pro një kundër*].

⁷² *Johnston dhe të tjerët*, aktgjykimi i 18 dhjetorit 1986, Seria A nr. 112, fq. 24, 52

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 8

Shkelje e të drejtës për respektim të jetës familjare si pasojë e mosnjohjes ligjore të marrëdhënies në mes të dy personave dhe mungesës së standardit të përbashkët evropian në lidhje me njohjen e të drejtave prindërore të transseksualëve / *nuk ka shkelje*

Neni 14

Mbështetur në gjetjen në lidhje me Nenin 8, Gjykata nuk e sheh të nevojshme që të shqyrtojë pretendimin për shkelje të Nenit 14 në kombinim me Nenin 8 të Konventës / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: *ndërrim gjinie / transseksual / atësi / regjistrim i atësisë / ndalesë / prind biologjik / mosnjohje e marrëdhënies / jetë familjare*

Ankuesit: X (*ankuesi i parë*), Y (*ankuesja e dytë*) dhe Z (*ankueja e tretë*), janë shtetas të Mbretërisë së Bashkuar

Faktet e rastit

Ankuesi i parë është transseksual, që ka kryer ndërhyrje kirurgjikale për ripërcaktim gjinor me qëllimin që të bëhet mashkull. Ai ka jetuar me Y., si partneri mashkull i saj, që nga viti 1979. Çifti ka aplikuar bashkërisht dhe i është ofruar trajtimi nga AID për të lejuar ankuesen e dytë që të ketë një fëmijë, Z-në.

Ankuesi i parë ka qenë i përfshirë gjatë gjithë procesit dhe është sjellë si “babai” i Z-së në çdo aspekt, që nga lindja. Ai ka kërkuar që të emërtohet si baba i Z-së në certifikatën e saj të lindjes, por është refuzuar pasi ligji ankez lejon regjistrimin e lindjes vetëm për etëritë biologjikë.

Ankuesit kanë paraqitur ankesë se mungesa e njohjes ligjore të marrëdhënies ndërmjet X dhe Z ka çuar në shkelje të Nenit 8 të Konventës dhe se situata që është krijuar dhe në të cilën ata janë vendosur është diskriminuese, në shkelje të Neneve 8 dhe 14.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit kanë ngritur pretendimin se njohjes ligjore të marrëdhënies ndërmjet ankuesit të parë dhe dytë përbën shkelje të Nenit 8 të Konventës. Qeveria, nga ana e saj, ka mohuar se Neni 8 është i zbatueshëm në këtë rast dhe, në cilëndo rrethanë, ka argumentuar se nuk ka shkelje.

Ankuesit kanë argumentuar se ata kanë një “jetë familjare” të përbashkët brenda kuptimit të Nenit 8 që pas lindjes së Z-së. Ata kanë nënvizuar se, sipas jurisprudencës së Komisionit dhe Gjykatës, realiteti social dhe jo statusi formal ligjor, është vendimtar. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të vërehet se ankuesi i parë, ka ndryshuar shumë nga karakteristikat fizike në mënyrë të pakthyeshme dhe ka ofruar

mbështetje financiare dhe emocionale dy ankueset tjera. Në të gjitha aspektet, ankuesit kanë pretenduar se jetonin si familje tradicionale.

Qeveria nuk ka pranuar konceptin e “jetës familjare” të aplikuar ndaj marrëdhënieve ndërmjet ankuesve. Qeveria ka argumentuar se X dhe Y duhej të trajtohen si dy gra që jetojnë së bashku, pasi X ende shihej si femër sipas ligjit vendor dhe se një ndryshim komplet i gjinisë nuk është i mundur sipas mjekësisë.

Tutje, Qeveria ka mbajtur qëndrimin se shtetet palë gëzonin margjinë të gjerë vlerësimi në lidhje me çështjet komplekse të ngritura nga transseksualiteti, në dritë të mungesës së një qasjeje uniforme ndaj problemit dhe gjendjes tranzitore të ligjit. Qeveria ka mohuar se ka pas ndonjë ndryshim të madh në pozicionin shkencor dhe ligjor në lidhje me transseksualët.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata fillimisht vëren se nuk ka standard të përbashkët evropian në lidhje me njohjen e të drejtave prindërore të transseksualëve dhe duke qenë se ligji duket të jetë në fazë tranzitore, shtetit ndaj të cilit është paraqitur ankesa i duhet dhënë një margjinë (hapësirë) më e gjerë vlerësimi.

Në këtë mënyrë, ligji i Mbretërisë së Bashkuar, që nuk njeh marrëdhënien ndërmjet X dhe Z nuk ka shkelur të drejtën e tyre për respektim të jetës familjare.

Sic është shprehur vetë Gjykata,

“marrë parasysh që transseksualiteti ngritë çështje komplekse shkencore, ligjore, morale dhe shoqërore, në lidhje me të cilin nuk ka një qasje përgjithësisht të zbatuar nga shtetet palë, Gjykata është e mendimit se Neni 8, në këtë kontekst, nuk mund të merret se krijon detyrim për shtetin që të njohë si prind të fëmijut një person i cili nuk është babai biologjik. Kjo duke qenë kështu, fakti se ligji i Mbretërisë së Bashkuar nuk lejon njohje ligjore të posaçme të marrëdhënies ndërmjet X dhe Z nuk shpie në dështim të respektimit të jetës familjare brenda kuptimit të asaj dispozite”.

Si rrjedhojë e kësaj më sipër, Gjykata vjen në përfundimin se nuk ka shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Mbështetur në gjetjen në lidhje me Nenin 8, Gjykata nuk e sheh të nevojshme që të shqyrtojë pretendimin për shkelje të Nenit 14. Në vlerësimin e Gjykatës, ankesa për shkelje të Nenit 14 i ngjan një rideklarimi të ankesës së bërë për shkelje të Nenit 8, dhe nuk ngritë çështje të reja, të veçanta.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se nuk ka shkelje të Nenit 8 të Konventës [me katërmëdhjetë vota kundër gjashtë]; vendosë se nuk është e nevojshme që të shqyrtojë ankesën sipas Nenit 14 në kombinim me Nenin 8 [shtatëmbëdhjetë vota kundër tri].

Lashin kundër Ruisë - 33117/02

22 janar 2013 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5 §§ 1 dhe 4

Mbajtje jologjore e ankuesit në spitalin psikiatrik kundër vullnetit të tij / *ka shkelje*

Neni 8

Pengesa në krijimin e familjes si pasojë e pamundësisë për martesë / *ka shkelje*

Neni 12

Pamundësi e realizimit të së drejtës për martesë si pasojë e marrjes së zotësisë juridike / *e panevojshme për shqyrtim*

Fjalët kyçe: *i sëmurë / skizofreni / trajtim spitalor / mbajtje e detyrueshme / zotësi fizike / e pamundësi martese / jetë familjare / pengesa*

Ankuesi: Aleksander Lashin, shtetas rus, i lindur në vitin 1960 dhe jeton në Omsk (Rusi)

Faktet e rastit

Ankuesi u diagnostikua me skizofreni dhe duke pasur parasysh statusin e aftësisë së kufizuar të shkallës së dytë u shtrua disa herë në spitale. Ekzaminimi në spital arriti në përfundimin se ankuesi ishte i paaftë të kuptonte veprimet e tij dhe nuk ishte në gjendje t'i kontrollonte ato. Pas një kërkesë nga prokurori publik, Gjykata e Qarkut në Omsk ia hoqi zotësinë e veprimit në një seancë dëgjimore të mbajtur në mungesë të tij në vitin 2000.

Babai i ankuesit, i emëruar si kujdestar i tij, bëri disa përpjekje për t'ia rikthyer zotësinë e veprimit ankuesit dhe kërkoi që një ekzaminim i ri psikiatrik të kryhej nga një shoqatë profesionale jo-shtetërore e psikiatërve. Këto përpjekje nuk kanë qenë të suksesshme as në vitin 2002, dhe Gjykata e Qarkut, përsëri në mungesë të ankuesit, refuzoi të autorizonte ekzaminimin e ri duke deklaruar se vetëm institucionet shtetërore të lejuara me ligj i kryejnë këto ekzaminime. Pastaj, kjo gjykatë arriti në përfundimin se shqyrtimi i vitit 2000 ishte akoma i vlefshëm dhe statusi i tij duhet të mbahej.

Në dhjetor të vitit 2002, në bazë të një urdhri për hospitalizim, ankuesi u vendos në spital dhe u zhvillua një ekzaminim i ri. Ekzaminimi arriti në përfundimin se ankuesi duhet të qëndronte në spital, edhe pse shqyrtimi ishte bazuar kryesisht në historinë e tij mjekësore dhe ankesat e shumta të ngritura kundër spitalit. Babait të tij shumë shpejt iu hoq kujdestaria. Përpjekjet nga ankuesi dhe babai i tij për të sfiduar izolimin dhe kërkesa për ekzaminim të ri u refuzuan. Spitali u bë kujdestar i ri i ankuesit. Spitali e tërhoqi kërkesën e tij largim nga spitali të ankuesit dhe Gjykata e Qarkut arriti në përfundimin se izolimi i tij në spital duhet të konsiderohet "vullnetar" në bazë të pëlqimit të spitalit.

Pas përpjekjeve të ndryshme të babait dhe vajzës së ankuesit për të kundërshtuar vendimin dhe izolimin, ankuesi u lirua nga spitali në dhjetor të vitit 2003, pas emërimit të vajzës së tij si kujdestare e tij të re.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi argumentoi se gjykatat ruse e kanë privuar nga zotësia e tij veprimit në qershor të vitit 2000, kur e kanë ekzaminuar atë në spitalin psikiatrik kundër vullnetit të tij dhe pa mundësinë e rishikimit në 2002-2003 dhe se kjo e pengoi atë të marotohej. Ai gjithashtu pretendoi shelje të Nenit 5 §§ 1 & 4 (e drejta për liri dhe siguri) në lidhje me izolimin e tij në spital psikiatrik në vitet 2002-2003; Nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) në lidhje me pamundësinë e tij për të shqyrtuar zotësinë e tij të veprimit; Nenit 12 (e drejta për t'u martuar) për shkak të pamundësisë së regjistrimit të martesës; dhe Nenit 13 (e drejta për mjet efektiv juridik) pasi ai nuk kishte mjete efektive në lidhje me ankesat e tij për të të drejtave të tij.

Në anën tjetër, qeveria ruse lidhur me Nenin 8 të Konventës argumentoi se vendimi i heqjes së zotësisë së veprimit ishte marrë kështu për të mbrojtur interesat e njerëzve të tjerë, si dhe interesat e ankuesit. Ndërsa, lidhur me Nenin 5, deklaroi se pas mbërritjes në spital, ankuesi ishte ekzaminuar menjëherë nga një mjek në detyrë. Dyzet e tetë orë pas, ai ishte ekzaminuar edhe nga një panel prej tre psikiatërve. Pas këtij ekzaminimi, spitali kishte dërguar një kërkesë për hospitalizim në gjykatë. Rrjedhimisht, izolimi tij ishte kërkuar dhe autorizuar në përputhje me rregullat procedurale vendase të parapara në Aktin e Kujdesit Psikiatrik të vitit 1992.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me Nenin 8 të Konventës, Gjykata konstatoi se ka pasur një shkelje të këtij neni pasi që konfirmimi i statusit të paafësisë së ankuesit në shkurt të vitit 2002 nga Gjykata e Qarkut ishte bazuar në raportin e mëparshëm të vitit 2000, nuk ishte bërë vlerësim i ri i gjendjes së tij mendore dhe vendimi i Gjykatës ishte marrë në mungesën e Ankuesit. Për më tepër, Gjykata gjeti se ishte e dyshimtë nëse gjendja e tij mendore kërkonte heqje të plotë të zotësisë së veprimit.

Gjykata gjithashtu konsideroi se Rusia kishte shkelur Nenin 8 pasi, pasi që si pasojë e izolimit të ankuesit në spital në dhjetor të vitit 2002 dhe përderisa vajza e tij mori rolin e kujdestarit në tetor 2003, ankuesi nuk ishte në gjendje t'i mbronte të drejtat e tij.

Lidhur me Nenin 5 të Konventës, Gjykata deklaroi se, për të qenë e ligjshme sipas këtij neni kufizimi i ankuesit gjatë mbylljes së tij në spitalin psikiatrik duhej të përputhej me dy kërkesa kryesore: Së pari, kufizimi duhet të jetë "i ligjshëm", që do të thotë se duhet të përputhet me të drejtën materiale dhe procedurale të vendit, dhe kufizimi duhet të jetë i nevojshëm sipas rrethanave të rastit. Së dyti, mbyllja/izolimi duhet të jetë në përputhje me qëllimet e Nenit 5, përkatësisht, për të mbrojtur individët nga arbitrariteti. Që kjo të ndodhë, një individ nuk mund të privohet nga liria e tij si "i sëmurë mendor" përveç nëse plotësohen tri kushtet minimale në vijim: së pari, ai duhet të duket në mënyrë të besueshme si i sëmurë mendor; së dyti, çrregullimi mendor duhet të jetë i llojit ose shkallës që garanton mbajtjen/izolimin e detyrueshëm (p.sh. kur personi ka nevojë për terapi, ilaçe ose trajtime të tjera klinike për të kuruar ose zbutur gjendjen e tij, ose ku ai ka nevojë për kontroll dhe mbikëqyrje për ta parandaluar atë, dëmi ndaj

vetes ose personave të tjerë), së treti, vlefshmëria e izolimit të vazhdueshëm varet nga vijueshmëria e çrregullimit të tillë".

Gjykata konstatoi se ndalimi i ankuesit kur ai ishte vendosur së pari në spital në dhjetor të vitit 2000, nuk ishte në përputhje me ligjin procedural rus sepse Rusia nuk zbatoi afatet kohore të parashikuara në ligj për ekzaminimin mjekësor dhe nxjerrjen e urdhrit të gjykatës. Gjykata gjithashtu deklaroi se fakti që kujdestari i një personi të sëmurë mendor jep një pëlqim, nuk e bën atë "vullnetar". Prej momentit kur izolimi/mbyllja e tij konsiderohej "vullnetare", Ankuesi nuk ishte në gjendje të hynte në një proces gjyqësor, duke shkelur më tej të drejtat e tij të garantuara në Nenin 5, respektivisht Nenin 5 § 4 të Konventës. Për më tepër, fakti që kujdestari i caktuar ishte i njëjti spital i cili fillimisht kërkoi urdhërin e hospitalizimit, e vë në dyshim paanësinë e kujdestarit. Ndërsa Gjykata gjeti se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej Neni 12 (e drejta për t'u martuar) ose Neni 13 (e drejta për mjet efektiv), sepse secila kërkesë ishte pasojë e faktorëve të njëjtë të analizuar gjatë shqyrtimit të Nenit 8 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendos se ka pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës, gjithashtu se ka shkelje të Nenit 5 § 1 dhe 5 § 4 të Konventës, dhe nuk e konsideron të arsyeshme të shqyrtojë pjesën tjetër të ankesës ndaras [*njëzëri*].

Neni 13

E drejta për zgjidhje efektive

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Oosterwijck kundër Belgjikës - 7654/76

6 nëntor 1980 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Nenet 3, 8, 12 në ndërlidhje me nenin 13

Pretendim se Konventës i mungon saktësia e kërkuar sa i përket ushtrimit të mjetit juridik efektiv të brendshëm, dhe se pamundësia e legalizimit të ndërrimit të gjinisë përbën shkelje të të drejtave të garantuara me Konventë, përkatësisht nuk kishte mjete efektive për të adresuar shkeljen / *nuk janë shterur mjetet e brendshme*

Fjalët kyçe: ndërrim gjinie / transeksual / legalizim i ndryshimit / pamundësi ligjore / mjete efektive / (mos) shterje e mjeteve

Ankuesi/ja: Danielle Van Oosterwijck, shtets belg

Faktet e rastit

Në kohën e dorëzimit të ankesës, ankuesja ka qenë duke punuar në Sekretariatën e Komisionit të Komuniteteve Evropiane nga viti 1963. Në të njëjtë kohë, ajo studioje në Universitetin e Lirë të Brukselit, në të cilin ka diplomuar për drejtësi në vitin 1979.

Në lindje, në vitin 1944, ankuesja ka poseduar të gjitha karakteristikat fizike dhe biologjike të një fëmijë të gjinisë femërore dhe ajo është regjistruar në certifikatën e lindjes si e bija e J. Van Oosterwijck. Sidoqoftë, sipas saj, nga mosha pesë vjeçare ajo është bërë e vetëdijshme se ka poseduar personalitet të dyfishtë: ndonëse fizikisht femër, ajo është ndjerë psikologjikisht si mashkull. Pasi ka kaluar një periudhë depresioni, në vitin 1962 kishte tentuar të vetëvritej dhe për këtë ishte trajtuar në spital. Mjekët kishin vendosur aplikimin e terapisës së hormoneve, si dhe një sërë terapisë të tjera, të cilat kishin arritur që të zëvendësonin fizikun e jashtëm të femrës me atë të mashkullit, ndonëse kromozomet kanë mbetur ato të gjinisë femërore.

Pas ndërhyrjeve dhe ndryshimeve të mësipërme, në vitin 1973, ankuesi/ja kishte kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Brukselit korrigjimin e cetifikatës së lindjes, ku do të shkruhej “fëmijë i gjinisë mashkullore...” Gjykata kishte hedhur poshtë kërkesën, duke arsyetuar se ankuesja nuk ka dëshmuar se regjistruesi ka bërë gabim gjatë lëshimit të certifikatës.

Ankuesi/ja kishte ankimuar vendimin në Gjykatën e Apelit në Bruksel, ku kishte argumentuar se një transeksual, sipas përkufizimit, ka gjininë e kundërt nga ajo që është dukur në momentin e lindjes dhe ka kritikuar Gjykatën e Shkallës së Parë për shpërfillje të konceptit të transeksualizimit. Edhe Gjykata e Apelit kishte hedhur poshtë kërkesën. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit kishte deklaruar se, në mënyrë që të korrigjohet, certifikata e statusit civil do të duhet të përmbante gabim ose gabime në momentin e lëshimit dhe se nuk kishte asnjë dispozitë në ligjin në fuqi që lejonte “marrjen parasysh të ndryshimeve artificiale në anatominë e një individi”, qoftë edhe nëse ato korrespondojnë me tendencat fizike të personit. Sidoqoftë, sipas Gjykatës, “as ekzaminimi fizik i ankuesit/es... dhe as dëshmia e propozuar shkencore e etiologjisë biologjike të transeksualizimit” nuk ishin në gjendje të dëshmonin ekzistimin, nga

fillimi të “karakteristikave fizike të gjinisë mashkullore ose madje tendencat transseksuale”.

Pas këtij vendimi, ankuesi/ja kishte vendosur që të mos e dërgonte rastin në Gjykatën e Kasacionit. Sipas raportit të Komisionit Evropian, ai më parë kishte konsultuar një numër personash të kualifikuar.

Në ankesën para Komisioni, ankuesi kishte pretenduar shkeljen e neneve 3, 8 dhe 12 të Konventës. Komisioni kishte pranuar ankesën dhe gjetur shkelje të neneve 8 dhe 11, si dhe nuk e kishte parë të nevojshme që të shqyrtonte pretendimin për shkelje të nenit 3, marrë parasysh faktin se çështjet që ishin subjekt ankese nuk dukeshin të ishin të asaj natyre serioze sa të hynin në kuadrin e asaj dispozite.

Përmbledhje e pretendimeve

Në dëgjimet e mbajtura nga Gjykata, Qeveria e kishte ftuar Gjykatën që të gjente se, për shkak të mos shterjes së mjeteve të brendshme juridike, ankesa ishte e papranueshme ose, si alternativë, të gjente se ankesa ishte e pabazuar dhe se nuk ishte dëshmuar që Belgjika ka shkelur Konventën.

Sipas Qeverisë, mjetet e brendshme juridike nuk ishin shteruar, sepse ankuesi nuk ka ankimuar vendimin pranë Gjykatës së Kasacionit, nuk ka përdorur dispozitat e Konventës si çështje ligji qoftë në instancë të parë apo në Gjykatë të Apelit, si dhe nuk ka kërkuar autorizim për të ndryshuar emrat.

Shkeljet e pretenduara nga ankuesi/ja kishin të bënin me dështimin për të respektuar ndalimin e trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës (neni 3), të drejtën për respektim të jetës private (neni 8), dhe të drejtë për martesë dhe krijim të familjes (neni 12). Pretendimi i ankuesit ishte se këto shkelje buronin nga legjislacioni dhe vendimet gjyqësore që, duke i atribuar vlerë definitive shkencore përcaktimeve në certifikatë të lindjes, e vendosnin atë në një situatë të patolerueshme ligjore dhe administrative.

Arsyetimi i Gjykatës

Në arsyetimin e saj, Gjykata ka vënë re, në praktikën e tyre, për të njëjtin tekst, gjykatat belge kanë arritur në përfundime të ndryshme. Gjykata e Kasacionit, në të cilën ankuesi nuk ka paraqitur ankesë, sipas Gjykatës, ka juridiksion për të shpallur ligjin e aplikueshëm dhe mënyrën e aplikimit të tij dhe kësisoji për të përcaktuar rrjedhën e vendimeve të mëpastajme gjyqësore. Prandaj, sipas Gjykatës, nuk ka asgjë që tregon se ankimimi në Gjykatën e Kasacionit, duke u bazuar *stricto sensu* në legjislacionin e aplikueshëm kombëtar në atë kohë, do të ishte qartazi i pavlerë.

Gjykata tutje ka vërejtur se Konventa përbën pjesë integrale të sistemit ligjor të Belgjikës dhe ka epërsi ndaj legjislacionit vendor, qoftë të mëhershëm apo të mëvonshëm. Pavarësisht kësaj, ankuesi nuk është thirrur në dispozitat e Konventës qoftë në procedurën gjyqësore në shkallë të parë apo në atë apelit dhe, për më tepër, nuk ka paraqitur fare ankesë pranë Gjykatës së Kasacionit.

Ankuesi do të mund të mbështetej në nenin 8 të Konventës në shtetin e tij dhe ka mundur të argumentojë shkeljen e të njëjtit. Gjykata hedh poshtë pretendimin se Konventës i mungon saktësia e kërkuar sa i përket ushtrimit të mjetit juridik efektiv të brendshëm.

Përfundimisht, sidoqoftë, sipas Gjykatës, çështja asnjëherë nuk është dërguar në Gjykatën e Kasacionit për vendimmarrje, dhe marrë parasysh faktin se nuk ka as praktikë gjyqësore relevante që do të mund të shihej si mundësi për të bërë ankimimin të pavlerë apo të padobishëm, duke u mbështetur në Konventë ose në argumente me efekt të njëjtë apo të ngjashëm.

Si rezultat i analizës së mësipërme, Gjykata vjen në përfundimin se, në rastin konkret, nuk janë shterur mjetet e brendshme juridike.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se, duke mos shterur mjetet e brendshme juridike, ajo nuk mund të merret me meritat e rastit konkret [*me trembëdhjetë vota kundër katër*].

Iliev dhe të tjerët kundër Bullgarisë - 4473/02; 34138/04

10 shkurt 2011 [Seksioni i Pestë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3

Trajtim çnjerëzor dhe degradues gjatë mbajtjes në paraburgim / *ka shkelje*

Neni 8

Shkelje e të drejtës së privatësisë si pasojë e monitorimit të korrespondencës së tyre / *ka shkelje*

Neni 13

Mungesë e mjeteve efektive lidhur me trajtimin në burg / *ka shkelje për një periudhë të qëndrimit në burg / nuk ka shkelje për monitorimin e korrespondencës*

Neni 14 ndërlidhur me Nenin 8 dhe 34

Diskriminim në ushtrimin e procedurave gjyqësore vendore the pranë gjykatës / *hedhet poshtë*

Fjalët kyçe: *burgosje / kushte të rënda / mungesë higjiene / trajtim degradues / korrespondencë / monitorim / mjete efektive / kompensim*

Ankuesit: z. Krasimir Iliev (*ankuesi i parë*), z. Mihail Ekimdzhiiev (*ankuesi i dytë*) dhe znj. Katina Boncheva (*ankuesja e tretë*), janë tre shtetas bullgarë që kanë lindur në vitin 1964, respektivisht vitet 1964 dhe 1979 dhe jetojnë në Bullgari

Faktet e rastit

Faktet lidhur me kushtet e qelisë gjatë burgimit

Ankuesi i parë është arrestuar dhe mbahet në burgun e Varnës që nga 15 marsi 1999. Periudhat e burgosjes ishin: nga data 4 deri më 25 tetor 2002; 18 deri 25 nëntor 2002; 24 mars deri më 2 prill 2003; 21 prill deri më 1 maj 2003; 19 qershor deri më 3 korrik 2003. Nga 11 shtatori deri më 17 tetor 2003, ai u transferua në burgun e Sofjes me qëllim që të paraqitej në gjykatë në procedurën penale kundër tij. Sipas ankuesit të parë, gjatë burgimit të tij në burgun e Varnës u mbajt në një qeli të vendosur në katin e tretë, me përmasa katër me shtatë metra, e cila akomodonte edhe shtatë persona të tjerë. Qelia ishte e ndotur dhe suva ishte shkoqur nga muret. Nuk kishte ndriçim natural, dhe u mundësohej qasje në toalet vetëm gjatë ditës nga ora 06:30 deri 21:30, ku kishte vetëm dy lavamana për tetëdhjetë të burgosur. Gjatë dimrit ishte shumë ftohtë në qeli, ndërsa verës shumë nxehtë.

Sipas ankuesit të parë, në rastet kur ai u transferua në burgun e Sofjes ai u mbajt në qelinë nr. 1 të grupit nr. 1, me përmasa katër me nëntë metra, e cila akomodonte katërmëdhjetë njerëz. Ajri i freskët dhe rrezet e diellit ishin të pamjaftueshme pasi kishte vetëm një dritare me përmasa 40 me 60 centimetra, e cila ishte e mbuluar me një fletë metalike të mbushur me vrima. Drita artificiale ishte gjithashtu e pamjaftueshme.

Qelia ishte e ndyrë, kundërmonte dhe e lagësht. Kushtet higjienike ishin shumë të këqija, ankuesi i parë nuk lejohej as të lahej dhe njëherë qelia ishte përmbytur nga uji dhe për shkak të lagështisë, ai ishte sëmurë.

Më 30 tetor 2003, ankuesi i parë ngriti padi kundër Ministrisë së Drejtësisë, duke pretenduar një total prej 1,000 leva bullgare (BGN, 511 EUR) për dëmet jomateriale që rrjedhin nga kushtet në të cilat ai kishte ëndruar në burgun e Sofjes. Në një aktgjykim të datës 4 maj 2005, Gjykata e Rrethit të Sofjes, pjesërisht e miratoi kërkesën. Kjo gjykatë konstatoi se ankuesi i parë ishte i mbyllur në një qeli me ndriçim dhe ventilim të pamjaftueshëm, pa tualet dhe ujë në qeli, me shtresa të pista dhe të lagështa; të burgosurit ishin lejuar të shkonin në tualet dy ose tri herë në ditë prej pesë deri në dhjetë minuta dhe u detyruan të përdorin një kovë plastike për të kryer nevojat e tyre në ndërkohë; të burgosurit që përkohësisht u transferuan në burgun e Sofjes, siç ishte ankuesi i parë, nuk iu ishte lejuar të lahen. Pasi që ankuesi i parë kishte qëndruar në burgun e Sofjes për një periudhë të shkurtër kohore, gjykata gjeti se BGN 300 (EUR 153) ishte kompensim i mjaftueshëm për shqetësimet që ankuesi i parë kishte vuajtur, ndërsa BGN 150 (77 EUR) në lidhje me dështimin e administratës së burgut për t'i siguruar trajtim mjekësor.

Më 27 shtator 2005, ankuesi i parë ka ngritur padi kundër Ministrisë së Drejtësisë, duke pretenduar një total prej 2,700 BGN (1,380 EUR) për dëmet jomateriale që rrjedhin nga kushtet në të cilat ai ishte ndaluar në burgun Varna në periudhën prej 6 qershorit 2002 deri më 26 shtator 2005 dhe për monitorimin e paligjshëm të korrespondencës së tij me avokatët e tij. Kërkesa e parë e ankuesit u aprovua pjesërisht nga Gjykata e Rrethit më 15 gusht 2006 dhe me ankesën e Gjykatës Rajonale të Varna më 24 prill 2007. Gjykata konfirmoi kushtet shumë të këqija hapësinore, higjienike dhe sanitare të qelisë në fjalë, dhe i caktoi BGN 1400 (EUR 716) dëmshpërblim për dëm jo material, megjithatë nuk vendosi se kishte vuajtur dëm mendor. Ndërkaq, sa i përket monitorimit të korrespondencës hyrëse të ankuesit të parë, gjykatat kanë gjetur se kjo ndërhyrje ishte e arsyetuar për verifikimin e identitetit të dërguesit.

Për më tepër, sa herë që ankuesi i parë ishte transferuar në gjykatë, ai u vendos në një qeli tjetër, me një lartësi prej 2.37 metra me 1.90 metra, me të gjithë të burgosurit e tjerë që prisnin të transferoheshin atë ditë - zakonisht pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë persona.

Faktet lidhur me monitorimin e korrespondencës së ankuesve

Ankuesi i dytë dhe i tretë ishin përfaqësuesit ligjor të ankuesit të parë, të cilët komunikonin me letra përmes postës. Më 11 mars 2004, ankuesi i parë i dërgoi një letër ankuesit të dytë dhe të tretë. Pas marrjes së saj, ky i fundit konstatoi se letra ishte hapur, kishte datë dhe ishte vulosur me një numër reference nga autoritetet e burgut dhe më pas ishte vendosur në një zarf të ri me një letër shoqëruese nga kujdestari i burgut të Varnës, me të njëjtën numrin e referencës. Letrat e ankuesit të parë të 18 majit, 8 qershorit, 16 qershorit, 23 korrikut dhe 10 gushtit 2004 u përpunuan në të njëjtën mënyrë dhe u paketuan në dy zarfa. Procedura e ndjekur në raste të tilla përfshinte ankuesin e parë që vendosi letrën që donte të dërgonte brenda zarfit të parë dhe t'ia dorëzonte autoriteteve të burgut. Pas pranimit, autoritetet e burgut i caktuan letrën një numër reference, të datës dhe vulosën atë me vulën e Ministrisë së

Brendshme, dhe dyshohet se e kopjuan atë. Pastaj vendosën zarfin e parë në një zarf të dytë, më të madh, i cili u vulos dhe u dërgua me postë në ankuesit e dytë dhe të tretë.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi i parë u ankua në veçanti se kushtet e paraburgimit të tij në burgjet e Sofjes dhe Varnës kishin shkelur Nenin 3 të Konventës dhe se ai nuk kishte pasur mjet efektiv juridik lidhur me to, siç kërkohet me Nenin 13. Ankuesit më tej pohonin që korrespondenca e shkëmbyer ndërmjet tyre ishte monitoruar nga administrata e burgjeve në kundërshtim me Nenin 8 dhe se ata nuk kishin pasur mjete efektive në lidhje me to, siç kërkohet me Nenin 13. Ata pretendonin se kjo gjithashtu kishte penguar ushtrimin efektiv të së drejtës së aplikuesit të parë i kërkesës individuale sipas Nenit 34 të Konventës dhe kishte diskriminuar ankuesin e dytë dhe të tretë në kundërshtim me Nenin 14 sepse e drejta e brendshme dallonte ndërmjet korrespondencës me përfaqësuesit ligjorë në procedurat e brendshme dhe korrespondencën me avokatët e tjerë.

Arsyetimi i Gjykatës

S ai përket pranueshmërisë së rastit Gjykata vëren se ankuesi i parë ka paraqitur ankesë kundër Ministrisë së Drejtësisë sipas Ligjit mbi Përgjegjësinë e Shteti dhe Komunave për Dëmet (SMRDA), në të cilin gjykatat vendase kanë pranuar se kushtet e burgimit të tij ishin jashtëzakonisht të ashpra dhe poshtëruese. Sidoqoftë, duke marrë parasysh periudhat relativisht të shkurtra kohore në të cilat ishte mbajtur në burgun e Sofjes, ata i ndanë atij dëmshpërblim në shumën prej 428 BGN (219 EUR). Sipas Qeverisë si pasojë ankuesi ka humbur statusin e viktimës.

Sipas Gjykatës një vendim ose masë e favorshme për ankuesin nuk është, në parim, i mjaftueshëm për ta privuar atë nga statusi i tij ose saj si viktimë, përveç nëse autoritetet kombëtare kanë pranuar dhe më pas kanë ofruar një dëmshpërblim adekuat për shkeljen e Konventës. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se ankuesi i parë ka qëndruar shkurtë në burgun e Sofjes dhe nuk është më i arrestuar atje. Kështu, kompensimi mund të konsiderohet si një dëmshpërblim adekuat për kushtet në të cilat ai ishte ndaluar atje. Duke pasur parasysh se gjykatat e brendshme vlerësuan të gjitha çështjet relevante lidhur me kushtet e paraburgimit të aplikuesit të parë, të tilla si kohëzgjatja dhe ashpërsia e tyre, si dhe efektet e tyre kumulative ndaj tij, Gjykata është e bindur se gjykatat vendase e kanë pranuar shkeljen, andaj kjo pjesë e ankesës për kohën në burgun e Sofjes është e papranueshme.

Sa i përket pjesës së ankesës në burgun e Varnas, Gjykata vëren fragmentimin e analizës së gjykatave të brendshme për kushtet e paraburgimit. Duket se gjykatat vendore e konsideronin secilin element të këtyre kushteve si një kërkesë të veçantë që kërkonte një analizë të veçantë lidhur me ndikimin e saj të mundshëm në mirëqenien e ankuesit të parë. Kjo qasje sugjeron, për shembull, se përdorimi i kovës për nevojat e tualetit, cilësia e ushqimit dhe mbipopullimi i qelisë duhet të vlerësohet në mënyrë të pavarur si burim i mundshëm i shqetësimit për paditësin, pa asnjë lidhje midis tyre. Gjykata konstaton se kjo analizë nuk i lejonte gjykatave vendase të shqyrtonin efektet kumulative të kushteve ndaj ankuesit të parë, siç kërkohet nga Konventa. Një qasje e tillë lehtë mund të çojë në përfundimin se asnjë nga ankesat nuk është mjaft serioze për të kërkuar kompensim edhe në rastet kur ndikimi i përgjithshëm mbi të burgosurin e

caktuar, nëse vlerësohet me këtë Konventë, do të kishte arritur pragun sipas Nenit 3 të Konventës. Nuk ka asnjë indikacion se kushtet në të cilat ankuesi i parë po mbahet në burgun e Varnës kanë ndryshuar, që do të thotë se shkelja e pretenduar e Nenit 3 të Konventës vazhdon e pandërprerë deri në ditët e sotme.

Gjykata rithekson që pas zhvillimit të praktikës gjyqësore vendase që nga viti 2003, padia nën SMRDA është bërë mjet kompensues efektiv i cili duhet të shterrohet në lidhje me periudhat e kaluara gjatë paraburgimit. Rrjedhimisht, ankuesi nuk mund të qortohet për mos përdorim të këtij mjete para vitit 2003. Sa u përket periudhave më të fundit, procedurat e brendshme ende janë në pritje dhe asgjë nuk sugjeron që ky mjet juridik nuk do t'i siguronte ankuesit të parë një dëmshpërblim adekuat. Mund të përfundohet se përderisa ankuesi i parë vazhdon të mbahet në të njëjtat kushte, kërkesa për dëmet nuk do të përbënte një mjet efektiv në vetvete. Meqë ankesa e tanishme nuk është e qartazi e pabazuar, gjykata e shpall këtë pjesë të ankësës të pranueshme.

Lidhur me meritat e rastit Gjykata vëren se periudha e paraburgimit të ankuesit të parë në burgun e Varnës, që merret parasysh, është nga data 15 mars 1999 deri më 13 prill 2009, pra dhjetë vjet e njëzet e nëntë ditë. Në procedurat nën SMRDA, gjykatat vendase kanë gjetur se kushtet në të cilat ankuesi i parë kishte qëndruar në burgun e Varnës ishin të dobëta. Gjykata nuk gjen arsye tjetër për të vënë në dyshim këto gjetje. Duke pasur parasysh periudhën e paraburgimit të ankuesit të parë dhe duke marrë parasysh efektet kumulative të këtyre kushteve, ajo konsideron se vuajtja dhe vështirësitë e duruara prej ankuesit e tejkaluan nivelin e pashmangshëm të vuajtjeve të natyrshme në paraburgim dhe shkuan përtej pragut të ashpërsisë sipas Nenit 3 të Konventës, andaj gjen shkelje të këtij Neni.

Lidhur me shkeljen e Nenit 13 të ndërlidhur me Nenin 3 të Konventës, në burgun e Sofjes, Gjykata gjen se nuk ka pasur ndonjë shkelje sepse i referohet gjetjes së mësipërme që ankesa nën SMRDA ka përbërë mjet efektiv juridik për ankuesin e parë. Ndërsa për në burgun e Varnës, veçse ka përfunduar se ankimimi nën SMRDA ka qenë mjet jo efektiv për shkak se nuk ka përmirësuar *status quo*-në e ankuesit të parë, ndaj të cilit shkelja e Nenit 3 të Konventës ishte e vazhdueshme. Prandaj, në këtë drejtim gjen shkelje të Nenit 13 të ndërlidhur me Nenin 3 të Konventës.

Lidhur me pretendimet për monitorim të korrespondencës së ankuesve, përkatësisht pranueshmëria e rastit, pasi që Gjykata konsideron se kriteret nën Nenin 35 § 1 i Konventës, pjesërisht lidhen me meritat e ankesave të ankuesve sipas Neneve 8 dhe 13 të Konventës, atëherë vendosi ta shqyrtojë pranueshmërinë e rastit së bashku me meritat e tij.

Pasi që autoritetet e burgjeve konfirmuan se korrespondenca e ankuesve ishte monitoruar, në këto rrethana, Gjykata përfundon se ka pasur ndërhyrje në të drejtën e ankuesve për respektimin e korrespondencës së tyre, e drejtë e garantuar nën Nenin 8 të Konventës. Për shqyrtimin e këtij neni, duhet të vlerësohen edhe kriteret nëse “ndërhyrja është e paraparë me ligj”, dhe se “a është e nevojshme në një shoqëri demokratike për të arritur një qëllim legjitim”. Neni 33(1)(c) i Ligjit për Zbatimin e Dënimeve (ESA) parasheh këtë lloj të ndërhyrjes.

Lidhur me kërkesën që ndërhyrja është "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për arritjen e një qëllimi legjitim, Gjykata vëren se të paktën shtatë letra të shkëmbyera ndërmjet ankuesit të parë dhe avokatëve të tij (ankuesi i dytë dhe i tretë), u hapën dhe

ndoshta janë lexuar nga administrata e burgut. Shpjegimi i administratës që kanë inspektuar letrat në mënyrë që të verifikonin nëse ato vërtetë ishin dërguar nga personi, emri i të cilit ishte shfaqur në zarf, nuk është bindës sipas Gjykatës. Ky veprim nuk bazohej në ndonjë fakt apo ndonjë konsideratë të rrezikimit të sigurisë dhe nuk kishte të bënte me ndonjë dyshim konkret në lidhje me ankuesit, por i ishte referuar mundësisë së përgjithshme hipotetike të abuzimit, të cilën administrata e burgjeve e konsideronte të mjaftueshme për të justifikuar një politikë të kontrollit sistematik. Pasi ndërhyrjet ishin paraparë në ESA, Gjykata përsërit se autoritetet e burgut mund të hapin një letër nga një avokat tek një i burgosur kur ata kanë dyshime të arsyeshme të besojnë se ajo përmban ndonjë të dhënë të paligjshme, të cilën mjetet normale të zbulimit nuk mund ta zbulojnë. Leximi i një letre të tillë, nga ana tjetër, duhet të lejohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur autoritetet kanë dyshime të arsyeshme të besojnë se privilegji avokat-klient është abuzuar. Vëzhgimi sistematik i korrespondencës së të burgosurve me avokatët e tyre nga ana e autoriteteve në Bullgari është gjetur tashmë si shkelje e Nenit 8 nga ana Gjykatës. Andaj, edhe në këtë rast është shkelur ky Nen ndaj të gjithë ankuesve. Sa i përket shkeljes së Nenit 13 të Konventës, për aq sa Qeveria e paditur ka parashtruar se ankuesit ishin kompensuar nën SMRDA për shkeljet që kishin ndodhur, Gjykata vuri në dukje se monitorimi i korrespondencës së ankuesve nuk ishte rezultat i një vendimi individual të marrë nga autoritetet, por drejtpërdrejt nga zbatimi i legjislacionit përkatës dhe arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje të Nenit 13 të Konventës, sepse kjo dispozitë nuk garanton një mjet që lejon legjislacionin primar të një Shteti Palë të kundërshtohet para një autoriteti kombëtar. Gjykata, më tej, vëren se një nga parakushtet për një kërkesë të suksesshme nën SMRDA është vërtetimi i gabimit të sjelljes që shkakton dëmin. Prandaj, duke parë që monitorimi i korrespondencës së ankuesve ka origjinën në dispozitat e ESA, duket se asnjë pretendim i tillë nuk do të kishte perspektivë suksesi. Andaj, përfundon se nuk ka shkelje të Nenit 13 të Konventës në këtë pjesë të ankesës.

Lidhur me pretendimet për shkeljen e Nenit 14 të ndërlidhur me Nenin 8 të Konventës, Gjykata e gjeti ankesën qartazi të pabazuar dhe e ka shpallur të papranueshme në bazë të Nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës. Kjo për shkak se në bazë të dëshmive, nuk duket se ka pasur ndonjë dallim në trajtumin ndërmjet avokatëve të mbrojtjes në procedurat e brendshme dhe përfaqësuesve ligjor përpara Gjykatës.

Lidhur me shkeljen e Nenit 34 të Konventës, Gjykata e gjeti ankesën qartazi të pabazuar dhe e ka shpallur të papranueshme në bazë të Nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës. Kjo për shkak se nuk ka gjetur prova se gjatë ushtrimit të së drejtës për parashtrimin e aplikacionit të tij në Gjykatën Evropiane, ankuesi i parë nuk ka hasur në ndonjë pengesë të orkestruar nga shteti i paditur (Bullgaria).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 3 të Konventës ndaj ankuesit të parë, gjithashtu se nuk ka shkelje të Nenit 13 të Konventës ndaj ankuesit të parë sa ishte në mbajtje në burgun e Sofjes po ka shkelje ka shkelje të Nenit 13 të Konventës ndaj ankuesit të parë për periudhën 6 qershor 2002 dhe 26 shtator 2005 sa ishte në burgun e Varnas. Lidhur me Nenin 8 të Konventës Gjykata gjen se ka shkelje ndaj të gjithë ankuesve [njëzëri].

Burdov kundër Ruisë - 59498/00

7 maj 2002 [Seksioni i Parë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6 § 1

Dështimi i autoriteteve kompetente shtetërore për të paguar përfitimet në tërësi dhe në kohë adekuate duke përfshirë ndryshimet valutore / *ka shkelje*

Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Dështimi i autoriteteve kompetente shtetërore për të njohur zhkeljen dhe zhdëmtuar dëmin si pasojë e vonesave në kompensim / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *katastrofë natyrore / çernobil / dëme trupore / kompensim / (mos)ekzekutim / status i viktimës / zhdëmtim / ndryshime valutore / mjete efektive*

Ankuesi: z. Anatolij Tikhonoviç Burdov, shtetas rus i lindur në vitin 1952 dhe jeton në Shakhty, në rajonin Rostov të Federatës Ruse

Faktet e rastit

Më 1 tetor 1986 ankuesi u thirr nga autoritetet ushtarake për të marrë pjesë në operacionet emergjente në vendin e katastrofës bërthamore të Çernobilit. Ai ishte i angazhuar në operacionet deri në 11 janar 1987 dhe, si rezultat, vuajti nga ekspozimi i gjerë ndaj emetimeve radioaktive. Këtë e vertetoi edhe eksperti mjekësor i cili ndërli dhi pasojat shëndetësore me aktivitetet e tij në situatën emergjente lidhur me katastrofën e Çernobilit. Bazuar në këtë ankuesi kishte të drejtë për përfitime të ndryshme sociale.

Në vitin 1997, ankuesi ngriti procedurë kundër Shërbimit të Sigurisë pasi kompensimi nuk ishte paguar. Më 3 mars 1997, Gjykata e Qytetit Shakhty vendosi në favor të ankuesit dhe i dha atij 23,786,567 rubla për dëmet shëndetësore të shkaktuara nga aktiviteti i tij në vitin 1998.

Në përputhje me Dekretin Presidential "mbi Modifikimin e Vlerave të Valutës Ruse dhe Standardet e Vlerës" të 4 gushtit 1997, u ndryshua vlera e shumës së alokuar për ankuesin (1.000" rubla "të vjetra u bënë" të reja ") ndryshim ky që rriti vlerën e përgjithëshme të kompensimit për ankuesin.

Pas një ankese për dështimin e zbatimit të aktgjykimit, më 12 nëntor 1999, ankuesi mori një njoftim nga prokurori i Shakhty-it se Shërbimi i Përmbarrimit ishte duke u munduar të realizonte pagesën por ishte i penguar nga mungesa e fondeve. Më 22 dhjetor 1999, Departamenti Rajonal i Drejtësisë i Rostov-it e informoi ankuesin se fondet për të paguar kompensimin e Çernobilit ishin ndarë nga buxheti federal dhe se pagesa do të bëhej pas marrjes se një transferimi të fondeve nga Ministria e Financave. Më 26 janar 2000, Prokuroria Rajonale e Rostov-it e informoi ankuesin se moszbatimi i vendimit për pages të kompensimit në asnjë mënyrë nuk mund t'i atribuohet Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor, dhe se kompensimi do të paguhej sapo të ishin bërë ndarjet e duhura nga buxheti federal. Më 22 mars 2000 Departamenti Rajonal i Drejtësisë i

Rostov-it e njoftoi ankuesin se kompensimi i viktimave të Çernobilit do të duhej të ishte financuar nga buxheti federal. Më pas, më 11 prill 2000 Shërbimi i Përmbartimit të Shakhty-it e njoftoi ankuesin që ishte e pamundur të zbatohet gjykimi në favor të tij sepse Ministria Rajonale e Punës dhe Zhvillimit Social të Rostov-it nuk kishte fonde. Tutje më 16 maj 2000 prokurori i Shakhty-it e njoftoi ankuesin se edhe pse Shërbimi i Sigurimeve Shoqërore kishte rillogaritur shumën e kompensimit në pajtim me aktgjykimin e 21 maj 1999, pagesat nuk ishin bërë për shkak të mungesës së fondeve. Më 9 mars 2000 Gjykata e Qytetit Shakhty urdhëroi indeksimin e shumave të dëmshpërblimit të dhënë më 3 mars 1997, e cila ende nuk i është paguar ankuesit. Një urdhër ekzekutimi shtesë për shumën prej RUR 44,095.37 është lëshuar. Pas një vendimi të marrë nga Ministria e Financave, më 5 mars 2001 Shërbimi i Sigurimeve Shoqërore Shakhty i pagoi ankuesit një shumë borxhi prej RUR 113,040.38. Sipas informacionit të ofruar nga shërbimi i sigurimeve shoqërore me 11 shkurt 2002, kompensimi që duhet t'i paguhet ankuesit për periudhën midis prillit 2001 dhe qershorit 2002 është vlerësuar në 2,500 rubla në muaj.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit pretendon se autoritetet kompetente shtetërore nuk arritën t'i paguajnë përfitime në tërësi dhe në kohë adekuate duke përfshirë ndryshimet valutore. Kjo bëri që ankuesi në mënyrë të përsëritur ti padiste autoritetet në gjykatat vendore që nga viti 1997 e tutje. Gjykatat i dhane vendimet e tyre bazuar në kërkesat e ankuesit, por një numër i ketyre vendimve mbetën të pa zbatuara duke shkelur kështu afatet kohore. Ankuesi pretendonte se vonesat substanciale dhe të pajustificuara në ekzekutimin e aktgjyqimeve përfundimtare shkelën të drejtat e tij të garantuara sipas Nenit 6 § 1 dhe Nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

Qeveria kundërshtoi pretendimet e ankuesit duke argumentuar se ky i fundit pushoi së qeni viktimë e shkeljeve të pretenduara të Konventës si rezultat i pagesës së borxhit më 5 mars 2001. Qeveria parashtroi se pretendimet e ankuesit ishin plotësuar, dëmtimi i interesave të tij monetare, gjoja shkaktuar nga moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Qytetit Shakhty pas ndryshimeve valutore ishin korrigjuar plotësisht. Qeveria gjithashtu argumentoi se shuma e RUR 113,040.38 e paguar me 5 mars 2001 duhet të merret për bazë për të përfshirë kompensimin për vonesën e pagesës së borxhit kryesor pasi që vlera e borgjit kryesor arriti vlerën vetëm RUR 45,158.44, ndërsa pjesa e mbetur e shumës përbëhej nga ndëshkimi për pagesë të vonuar të përfitimeve të ankuesit dhe rivlerësimi i saj. Së fundmi, Qeveria parashtroi se ankuesi kishte mundësi të bëjë një kërkesë gjyqësore për dëmin jomaterial që rrjedh nga dështimi i zbatimit të gjykimit nëse ai do të bënte një gjë të tillë. Ankuesi nuk u pajtua me keto pretendime.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet e Qeverisë për kundërshtimin e "statusit të viktimës" së ankuesit sipas Konventës, Gjykata përsërit se pavarësisht nëse ankuesi mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së pretenduar apo jo është e rëndësishme të kuptohet se a janë respektuar të gjitha fazat e procedurës sipas Konventës. Gjykata më tej përsërit se ekzistimi i një vendimi ose mase të favorshme për ankuesin nuk është në parim i mjaftueshëm për t'a privuar atë nga statusi i tij "viktimë" përveç nëse autoritetet

kombëtare kanë pranuar, ose shprehimisht ose në thelb, kete qëndrim dhe pastaj kanë ofruar zhdëmtim për shkeljen e Konventës.⁷³

Duke iu kthyer fakteve të rastit aktual, Gjykata vëren se mund të jetë e saktë që ankuesit i është paguar borxhi i papaguar në përputhje me aktgjykimet e gjykatave të vendit, megjithatë, pagesa, e cila u bë vetëm pas ankesave të ankuesit nuk përfshinë njohje të shkeljeve të pretenduara e as nuk i plotëson kërkesat e një zhdëmtimi të duhur. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se ankuesi mundet ende të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së Nenit 6 § 1 të Konventës dhe të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

Sa i përket meritave të rastit, Gjykata përsërit se Neni 6 § 1 i siguron të gjithëve të drejtën për një gjykatë e që përfshin edhe të drejtën për tu qasur në gjykatë përkatësisht për të filluar procedura gjyqësore. Megjithatë, kjo e drejtë do të ishte iluzore nëse sistemi ligjor i shtetit kontraktues lejon që edhe pse kishte një vendim përfundimtar dhe të detyrueshëm të një gjykate, ky i fundit të implementohej në dëm të pales. Sipas praktikës së Gjykatës, ekzekutim, i një vendim të dhënë nga çdo gjykatë duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e "gjykimit" për qëllimet e Nenit 6.⁷⁴ Gjykata thekson se nuk është e mundshme për një autoritet shtetëror që të citojë mungesën e fondeve si justifikim për mos respektimin e një borxhi gjyqësor. Një vonesë në ekzekutimin e një gjykimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa duhet të mos jetë e tillë që të dëmtojë thelbin e të drejtës së mbrojtur sipas Nenit 6 § 1.⁷⁵ Në rastin konkret, ankuesi nuk duhet të ishte penguar së përfituari nga suksesi i procesit gjyqësor, i cili kishte të bënte me kompensimin për dëmtimin e shëndetit të shkaktuar nga pjesëmarrja e detyrueshme në një rast emergjence shtetërore. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Qytetit Shakhty të 3 marsit 1997, 21 maj 1999 dhe 9 mars 2000 mbeti i pazbatuar tërësisht ose të paktën deri më 5 mars 2001, kur Ministria e Financave mori vendim për të paguar në tërësi borxhin. Duke dështuar për vite me radhë për të marrë masat e nevojshme për t'iu përmbajtur vendimit gjyqësor të fundit në rastin aktual, autoritetet ruse e privuan ankuesin nga garancionet që rrjedhin nga Neni 6 § 1. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit për shkeljen e të drejtave pronësore sipas Nenit 1 të Protokollit 1, Gjykata përsërit se një "kërkesë" mund të përbëjë një "pasuri" brenda kuptimit të këtij neni nëse është i mjaftueshëm i themeluar për të qenë i zbatueshëm. Vendimet e Gjykatës së Qytetit Shakhty të datës 3 mars 1997, 21 maj 1999 dhe 9 Mars 2000 i siguruan ankuesit kërkesa të zbatueshme konkrete dhe jo thjesht një të drejtë të përgjithshme për të marrë mbështetje nga shteti. Vendimet u bënë përfundimtare, pasi që asnjë ankesë nuk i inicua kundër tyre. Nga kjo rrjedh se pamundësia për ankuesin për të të marrë ekzekutimin e këtyre aktgjykimeve, të paktën deri më 5 mars 2001, përbënte një ndërhyrje në të drejtën e tij për gëzimin paqësor të pasurisë siç përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë të Nenit 1 i Protokollit 1. Qeveria nuk e ka prezantuar ndonjë justifikim për këtë ndërhyrje dhe Gjykata e konsideron se mungesa e fondeve nuk mund të justifikojë një lëshim të tillë. Si përfundim, Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit 1.

⁷³ *Amuur kundër Francës, vendimi i 25 qershorit 1996, Raportet e Aktgjykimet dhe vendimet 1996-III, f. 846, § 36, Dalban kundër Rumanisë* [DhM], nr. 28114/95, § 44, KEDNJ 1999-VI

⁷⁴ *Hornsby kundër Greqisë, aktgjykimi i 19 marsit 1997, Raportet 1997-II, fq. 510, § 40*

⁷⁵ *Immobiliare Saffi kundër Italisë* [DhM], nr. 22774/93, § 74, KEDNJ 1999-V

Gjykata vendos se shteti i paditur duhet të paguajë ankuesit, shumën prej 3,000 EUR për dëmin jo-material si dhe interesin e thjeshtë me një normë vjetore prej 23%.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ankuesi mund të pretendojë të jetë një "viktimë" për qëllimet e Neni 34 i Konventës; vendos se ka pasur shkelje të Neni 6 § 1 të Konventës; vendos se ka pasur shkelje të Neni 1 të Protokollit 1 [njëzëri].

Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar - 9659/82; 9658/82

27 prill 1988 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 8

Shkelje e të drejtës në privatësi si pasojë e hapjes nga autoritetet e burgut të korrespondencës personale / *ka shkelje*

Neni 13

Pretendim për mungesë të mjeteve efektive për adresimin e shkeljeve, veqanërisht në rastin e ndalimit të korrespondencës së një prej ankuesve / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: *vuajtje e dënimit / burgim / korrespondencë / ndalim / hapje e letrave / privatësi / leje vizite / vizitë familjare*

Ankuesit: James Boyle (*ankuesi i parë*), Sarah Boyle (*ankuesja e dytë*) Brian Rice (*ankuesi i tretë*) dhe John Rice (*ankuesi i katërt*), shtetas britanikë, të lindur më 1944, 1950, 1947 dhe 1920, respektivisht. Ankesat ishin dorëzuar në dy raste të ndara, marrë parasysh ngjashmëritë e rasteve, Komisioni vendosur që t'i bashkonte ankesat në një të vetme.

Faktet e rastit

Më 1967, ankuesi i parë ishte dënuar në Skoci me burgim të përjetshëm për vrasje. Ai ishte dënuar më vonë edhe për një seri veprash, përfshirë thyrje burgu dhe tentim për vrasje të një zyrtari policor. Ankuesja e dytë, është bashkëshortja e ankuesit të parë, me profesion doktoreshë.

Periudha relevante për procedurën gjyqësore përfshinë atë ndërmjet shtatorit të vitit 1980 dhe nëntorit të vitit 1981, kur ankuesi i parë po mbahej në një regjim të rregullt burgimi në burgun Saughton. Rregullat e komunikimit ishin asisoji që vetëm dërgimi me postë i një letre prej tri faqesh në javë paguhej nga fondet publike. Ai ishte në gjendje të paguante për letrat e tjera nga fitimet e punës në burg, por jo edhe nga burimet e përgjithshme financiare. Ai kishte paraqitur ankesë pranë Sekretarit të Shtetit në Skoci për numrin e kufizuar të letrave që ai mund të dërgonte. Letrat e ankuesit të parë të dërguara dhe të pranuar, kontrolloheshin nga autoritetet e burgjeve në pajtim me praktikën e zakonshme që ndiqej në burgje.

Në vitin 1981, një letër e dërguar për mikun e tij, z. Peter McDougall, ishte ndaluar nga guvernatori i burgut mbi bazën se z. McDougall ishte “personalitet medial”. Ankuesi ishte ankuar edhe rreth kësaj çështjeje te Sekretari i Shtetit, por ishte refuzuar se ekzistonte një ndalesë e përgjithshme. Ankuesi po ashtu, kishte të drejtë të kufizuar që të pranonte vizita deri në një orë brenda një muaji në një korridor burgu, që ishte nën mbikëqyrje të afërt. Ai e shfrytëzonte këtë kohë për të takuar gruan e tij. Por, ankohej se kjo kohë ishte e pamjaftueshme për të takuar edhe anëtarët e tjerë të familjes.

Ankuesi i tretë ishte dënuar me burgim të përjetshëm për vrasje. Ai i kishte kërkuar Sekretarit të Shtetit leje për të vizituar babain e tij në shtëpi, përkatësisht ankuesin e

katërt. Arsyeja ishte se babai i tij ishte “i sëmurë për një kohë të konsiderueshme”, por jo që ishte i sëmurë në mënyrë serioze, që do të mundësonte dhënien të lejes mëshiruese për vizitë. Prandaj, kërkesa e tij ishte refuzuar.

Përmbledhje e pretendimeve

Në lidhje me nenin 8, ankuesi i parë kishte pretenduar se ndalesa e letrës drejtuar mikut të tij nga guvernatori i burgut ka shkelur nenin 8 të Konventës. Në atë kohë, Sekretari i Shtetit kishte refuzuar kërkesën mbi bazën se letra, duke qenë e destinuar për publikim apo përdorim në televizion, kishte përmbajtje të diskutueshme sipas rregullave përkatëse të burgut.

Qeveria, nga ana e saj, kishte pranuar më pas se rregullat e burgut në këtë rast ishte zbatuar në mënyrë të gabueshme pasi letra ishte personale e pastërt dhe të duhej të lejohej të kalojë.

Sa i përket nenit 13, të katër ankuesit kishin paraqitur pretendime se, sipas ligjit skocez, ata nuk kishin mjete efektive në lidhje me ankesat e tyre të ndryshme. Ata pra kanë kërkuar gjetje të shkeljes së nenit 13 të Konventës. Pretendimet për shkelje të nenit 13 të Konventës, ndërkaq, ishin hedhur poshtë nga ana e Qeverisë.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 8 të Konventës, dhe duke pas parasysh pranimin e Qeverisë se rregullat e burgut ishte zbatuar në mënyrë të gabuar, pasi korrespondenca ishte personale, Gjykata kishte gjetur shkelje të nenit 8 të Konventës.

Lidhur me Nenin 13 të Konventës: sa i përket ankesës së dy ankuesve të parë, Gjykata kishte vlerësuar se rregullat e pagesës së postës nuk ishin vetpërvete të paarsyeshme. Prandaj, në këtë pikë nuk kishte gjetur shkelje të nenit 13.

Për sa i përket pretendimit të ankuesit të tretë në lidhje me vonesën ose refuzimin për të postuar letra të caktuara, Gjykata, njësoj sikurse Komisioni përpara, kishte gjetur se, në mungesë të një pretendimi të argumentueshëm për shkelje të nenit 8, nuk ka shkelje të nenit 13 në lidhje me këtë pikë.

Në lidhje me ankesën e ankuesve të parë për kontrollimin e korrespondencës, Gjykata ishte referuar te praktika e saj e mëhershme gjyqësore, që përmban se një masë e caktuar e kontrollit të korrespondencës së të burgosurve është e nevojshme dhe si e tillë nuk është e papajtueshme me Konventën. Prandaj, Gjykata gjen se nuk ka shkelje as të nenit 8 dhe, për pasojë, as të nenit 13 të Konventës. Gjykata nuk kishte gjetur shkelje as në pikën që lidhej me pretendimin e ankuesve se letra të caktuara të ankuesit të parë ishin lexuar me zë nga zyrtari i burgut.

Sa i përket ankesës së ankuesit të parë për ndalesën e letrës, Gjykata tashmë kishte gjetur se ka shkelje të nenit 8. Megjithatë, Gjykata ka vërejtur se, ndonëse Sekretari i Shtetit, siç e ka pranuar Qeveria tashmë, ka zbatuar gabimisht rregullat e burgut, vetëm ky fakt nuk mund të përcaktojë mungesën e mjeteve efektive. Ankuesi do të mund të kërkonte rishqyrtim gjyqësor të vendimit të Sekretarit të Shtetit mbi bazën se ai vendim ka qenë i paarsyeshëm, duke qenë i mbështetur në një zbatim të gabuar të rregullave. Kësisoj, Gjykata gjen se mjetet e disponueshme për ankuesin në lidhje me ankesën në këtë pikë kanë qenë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e nenit 13. Për pasojë,

nuk ka pas shkelje të nenit 13 të Konventës. Gjykata nuk ka gjetur shkelje të nenit 13 as sa u përket një sërë pretendimesh të tjera të ngritura nga palët ankuese.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të nenit 8 në rastin e ankuesit të parë [njëzëri]; gjen se nuk ka shkelje të nenit 13 në asnjërin prej rasteve [njëzëri].

Shalyavski dhe të tjerët kundër Bullgarisë - 67608/11

15 qershor 2017 [Seksioni i Pestë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3

Trajtimi nga policia përbënte trajtim poshtërues dhe çnjerëzor / *ka shkelje*

Neni 8

Vizitat e shpeshta nga policia gjatë arrestit shtëpiak përbënin cënim të së drejtës në shtëpi / e pabazë / *nuk ka shkelje*

Neni 13 në ndërlidhje me Nenin 3

Mungesë e mjeteve efektive për shkeljet e pretenduara / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *trajtimin çnjerëzor ose poshtërues / dhembje fizike dhe poshtërim publik / mjete efektive juridike / qëllim legjitim / ndërhyrje jo propocionale / e drejta në jetën private*

Ankuesit: z. Shalyavski (*ankuesi i parë*), dhe znj. Silvia Kotseva (*ankuesja e dytë*) janë partnerë bashkëjetues; Martin Kotsev (*ankuesi i tretë*) është i biri i ankuesit të parë, Yoana Shalyavska (*ankuesja e katërt*) është vajza e ankuesëve të parë dhe dytë. Ata kanë lindur në vitin 1966, 1967, 1988 dhe 2003, respektivisht dhe jetojnë në Blagoevgrad (Bullgari)

Faktet e rastit

Më 7 prill 2011, rreth orës 11:00, ankuesi i parë i cili kishte distrofi muskulare dhe mund të lëvizte vetëm kokën dhe duart e tij, u ndalua nga policia, përderisa e voziste ankuesja e dytë, e cila ishte njëkohësisht asistentja/kujdestarja e tij dhe partnerja bashkëjetuese. Ai u la i ngujuar në makinë para një stacioni policor për disa orë, ndërsa autoritetet hetimore kontrolluan shtëpinë dhe mjediset e tjera, si dhe kryenin formalitetet e nevojshme për të ngritur aktakuzë kundër tij. Gjatë kësaj kohe ai duhej t'i kryente nevojat e tij personale në publik, ndërsa asistentja e tij u arrestua nga policia, mirëpo u nxorr nga rojet dy herë gjatë ditës për ta lëvizur ankuesin e parë në një makinë tjetër dhe përfundimisht në orën 21:30 për të ndihmuar atë të marrë pjesë në një seancë dëgjimore ku u urdhërua arresti shtëpiak i tij. Ankuesja e dytë u lirua po atë mbrëmje.

Ankuesi i parë u mbajt nën arrest shtëpiak deri më 21 qershor 2011, me policinë duke e kontrolluar nëse ai ishte në shtëpi apo jo. Në mes të datës 8 dhe 14 prill 2011 nuk ka pasur kontrollë nga policia. Midis 16 prillit dhe 27 majit 2011 oficerët e policisë vizituan shtëpinë e ankuesve për të kontrolluar ankuesin e parë në njëzet e nëntë raste, një herë në ditë dhe pothuajse çdo ditë. Për tetë ditë nuk kishte kontrolla, dhe në katër ditët e tjera oficerët nuk shkuan në banesën e ankuesve, por observuan hyrjen e ndërtesës. Më 29 prill 2011, ankuesi u takua me oficerë para ndërtesës teksa mbërriti në makinën e tij. Më 28 maj 2011, zyrtarët kontrolluan në ankuesin e parë në tri raste dhe

në dy raste më 30 maj. Më 31 maj ata vizituan banesën në tri raste, por në një të tretën prej tyre nuk u lejua të hyjnë. Më 1 dhe 2 qershor 2011, ankuesja e dytë nuk e lejoi policinë në banesë. Më 3 qershor ata vizituan banesën pesë herë; në një nga vizitat askush nuk iu përgjigj derës së dyerve. Ndërmjet 4 dhe 20 qershorit 2011 zyrtarët vizituan banesën e ankuesve zakonisht tre ose katër herë në ditë. Një nga vizitat më 16 qershor ishte provokuar nga fakti se ankuesi, pasi kishte marrë autorizimin për të vizituar një fizioterapeut, nuk ishte paraqitur në termin e caktuar. Gjatë disa vizitave u paraqit edhe ankuesja e katërt, tetë vjeç. Zakonisht ajo është marrë nga nëna e saj në një dhomë tjetër. Ankuesi tretë, njëzet e tre vjeç, po punonte me orar të plotë gjatë kësaj periudhe.

Më 21 qershor 2011, ankuesi i parë u lirua nga arrestimi shtëpiak, me vendim të Gjykatës së Apelit të Sofjes, e cila vuri në dukje në veçanti gjendjen e tij të rëndë shëndetësore dhe faktin se shumë nga provat në hetimin kundër tij tashmë ishin i mbledhur.

Përmbledhje e pretendimeve

Duke u bazuar veçanërisht në Nenin 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës) të Konventës, ankuesi i parë pretendoi se trajtimi i tij më 7 prill 2011 i kishte shkaktuar atij dhembje fizike dhe poshtërim publik. Sipas Nenit 13 (e drejta për mjete efektive) të Konventës, ankuesit pretendonin në veçanti se nuk kishin pasur mjete efektive juridike në të drejtën e brendshme për ankesat e tyre sipas Nenit 3. Po ashtu, ankuesit u ankuan për vizitat e shpeshta të policisë gjatë kohës sa ankuesi ishte në arrest shtëpiak, duke u thirrur në të drejtën për jetë private dhe familjare të garantuar me Nenin 8 të Konventës.

Qeveria bullgare pretendonte se ankuesi i parë nuk kishte shterrur të gjitha mjetet juridike që ishin të qasshme, duke përfshirë ankimimin në bazë të Ligji mbi Përgjegjësinë e Shtetit dhe Komunave për dëmet, si dhe vuajtja e përjetuar nga ai nuk e arrinte shkallën që të përbënte shkelje të Nenit 3 të Konventës. Po ashtu, lidhur me vizitat e shpeshta dhe veprimet e autoriteteve policore, pretendonte se kishin qëllim legjitim, dhe nuk përbënin ndërhyrje jo propocionale në të drejtën për jetë private, të garantuar me Nenin 8 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me pranueshmërinë e rastit Gjykata ka vendosur që një kërkesë mund të refuzohet sipas Nenit 35 § 3 (a) të Konventës për shpërdorim të së drejtës së aplikimit individual, nëse për arsye të tjera ai ishte i bazuar me vetëdije në të pavërteta, ose nëse parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar informacion të paplotë ose mashtrues. Kjo do të jetë kështu kur informacioni çorientues ka të bëjë me "thelbin e rastit". Gjykata theksoi se ankuesi i parë ka paraqitur në mbështetje të ankesave të tij informata mashtruese, përkatësisht deklaratën e bërë nga A.Z., pasi ai nuk ka specifikuar se A.Z. ishte motra e tij dhe se ajo nuk ishte mjek i regjistruar. Megjithatë, ky konkluzion nuk mjafton që Gjykata 'i shpallë të paparanueshme ankesat e ankuesit të parë për shkak se nuk është e bindur ky informacioni mashtrues lidhet me "thelbin e çështjes", megjithatë këtë dëshmi nuk e ka marrë parasysh gjatë shqyrtimit të lëndës.

Po ashtu, lidhur e shterrjen e mjeteve juridike, Gjykata hodhi poshtë pretendimet e Qeverisë bullgare se ankuesi ka mundur të ankohet në bazë të Ligjit mbi Përgjegjësinë e Shtetit dhe Komunave për Dëmet, për shkak se ky akt ligjor nuk mbulonte hetimet penale. Andaj, shpalli rastin e pranueshëm.

Lidhur me Nenin 3 të Konventës, Gjykata ripërsëriti se keqtrajtimi duhet të arrijë një nivel minimal të ashpërsisë ashtu që të përfshihet nën këtë Nen. Vlerësimi i atij niveli është relativ; varet nga të gjitha rrethanat e rastit, të tilla si kohëzgjatja e trajtimit, efektet e saj fizike dhe mendore, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës.

Në rastin në fjalë, rrethana që ka rëndësi kryesore është hendikepi i rëndë fizik i aplikuesit të parë. Kjo kërkoi që autoritetet të kenë kujdes të veçantë kur të vazhdojnë ta arrestojnë atë gjatë hetimeve kundër tij. Imobilizimi i tij për më shumë se dhjetë orë ndodhi në një vend publik, parking, ku ai ishte i dukshëm për oficerët e policisë dhe kalimtarët, madje edhe kur ai po kryente nevojat personale. Ankuesi pretendonte se kjo situatë kishte provokuar vuajtjen e tij fizike dhe mendore, e cila u konfirmua nga një mjek dhe të afërm të cilët thanë se trupi i tij ishte “mpirë” dhe “ftohur”. Qeveria nuk ka dhënë asnjë arsye se pse ankuesi nuk mund të ishte lejuar, për shembull, që të kthehej në shtëpi, në pritje të ngritjes së akuzave. Në veçanti, nuk është pretenduar se prania e tij mund të kishte penguar kërkimin që po zhvillohej në shtëpinë e tij ose se ai do ta kishte penguar hetimin në ndonjë mënyrë tjetër. Duke marrë parasysh rrethanat specifike të rastit, Gjykata është e mendimit se trajtimi i ankimuar shkaktoi vuajtjen e ankuesit të parë me intensitet të mjaftueshëm për ta kualifikuar atë si trajtim degradues në kuptim të Nenit 3 të Konventës.

Për shkak të këtij përfundimi, Gjykata vendosi të mos e ekzaminojë rastin nën Nenin 8 të Konventës.

Lidhur me Nenin 13 të Konventës, Gjykata i referohet gjetjes së saj më sipër se ankimimi sipas Ligjit mbi Përgjegjësinë e Shtetit dhe Komunave për Dëmet nuk kishte paraqitur mjet efektiv për ankesën e ankuesit të parë sipas Nenit 3 të Konventës. Gjykata nuk është informuar për ndonjë mjet tjetër juridik në dispozicion në këto rrethana, të cilat mund të kishin parandaluar ose pushuar shkeljen e të drejtave të ankuesit, ose çuan në dhënien e kompensimit. Prandaj, ka pasur një shkelje të Nenit 13 të Konventës, të ndërlidhur me Nenin 3.

Në lidhje me vizitat e shpeshta të policisë në shtëpinë e ankuesit të parë gjatë arrestit shtëpiak, Gjykata konstatoi se për të pasur shkelje të së drejtës së privatësisë, të garantuar me Nenin 8 të Konventës, duhet që të ketë “ndërrhyrje”, “ndërrhyrja të jetë paraparë me ligj”, dhe “e nevojshme në një shoqëri demokratike për të arritur një qëllim legjitim”.

Qeveria nuk ka kontestuar se banesa ku ankuesi i parë ka kryer arrestin shtëpiak dhe ish-in kryer vizitat nga policia, ishte "shtëpia" e katër ankuesve. As palët nuk e kontestojnë faktin se këto vizita përbënin ndërhyrje në të drejtën e ankuesve për një "shtëpi", siç garantohet në Nenin 8 të Konventës. Është e qartë se kjo ndërhyrje është e paraparë me ligj, andaj kontestues është vetëm fakti se ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike për të arritur një qëllim legjitim. Duke shqyrtuar domosdoshmërinë e ndërhyrjes në të drejtat e ankuesve, Gjykata vëren se ndërmmjet 15 prillit dhe 20 qershorit 2011 policia ka vizituar shtëpinë e tyre në raste të shumta, deri në katër ose pesë herë në ditë, ndonëse zakonisht i kishte vizituar pak ose aspak. Megjithatë, nuk

është dëshmuar se përveç verifikimit të shpejtë nëse ankuesi i parë ishte atje, policia shqetësoi jetën e përditshme të ankuesve në ndonjë mënyrë tjetër. Policia nuk i ka vizituar asnjëherë gjatë natës. Për më tepër, është e rëndësishme që pavarësisht se policët nuk ishin lejuar të hynin në banesë në disa raste, policia kurrë nuk është përpjekur të hyjë me forcë/dhunë. Po ashtu, kjo ndërhyrje nuk është reflektuar tek ankuesit e tjerë. Ankuesja e katërt, e cila ishte e mitur, shumicën e rasteve gjatë vizitave nuk ishte prezente sepse ishte në shkollë, apo kur ishte në shtëpi, dërgohej në dhomë tjetër.

Për më tepër, në dy raste, përkatësisht 15 dhe 29 prill 2011, është gjetur se ankuesi i parë ka lënë shtëpinë pa autorizim, dhe një herë nuk është paraqitur tek termini i fizioterapeutit, andaj kjo ka ngjallur dyshime tek policia, e cila ka shpeshtuar vizitat. Prandaj, Gjykata gjeti se ankesat në shqyrtim janë qartazi të pabazuara dhe duhet të refuzohen në përputhje me Nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Vendos që shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit të parë, (i) 3,000 EUR (tre mijë EUR), në lidhje me dëmin jomaterial; dhe (ii) 2,500 EUR (dy mijë e pesëqind EUR), për shpenzimet gjyqësore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen shkelje të Nenit 3 dhe nuk e konsideron të nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas Nenit 8; Gjykata gjithashtu konstaton se ka pasur shkelje të Nenit 13 të Konventës të ndërlidhur me Nenin 3 [njëzëri].

Horvat kundër Kroacisë - 51585/99

26 korrik 2001 [Seksioni i Katërt]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6 § 1

Shkelje e të drejtës në gjykim si pasojë e te zgjatjes së procedurave civile për shlyerjen e kredive / *ka shkelje*

Neni 13

Mungesë e mjeteve efektive për të adresuar tej-zgjatjen e procedurave gjyqësore, që si pasojë kishin rezultuar në deshtim të realizimit të së drejtës / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *kredi / kreditorë / kthim i borxhit / dështim / procedura gjyqësore / (mos) prani e të paditurve / vonesë në identifikim / barrë / mjet efektiv*

Ankuesja: znj. Ankica Horvat, shtetase kroate

Faktet e rastit

Më 19 tetor 1992, ankuesja i kishte dhënë MJB-së, një kompani në Zagreb, 10.000 marka gjermane (DEM) për një periudhë prej tre muajsh me një normë interesi prej 27%. Më 23 nëntor 1992 ajo i huazoi ZIP-it, një kompani në Zagreb, 20,390 DEM për një periudhë prej një muaji me një normë interesi prej 20%. Pasi që kompanitë e përmendura nuk arritën të paguajnë kreditë, ankuesja ka ngritur procedura kundër ZIP dhe MJB në Gjykatën Komunale të Zagrebit.

Procedurat kundër ZIP dhe pronarit të saj të dyshuar Ž.M. kanë filluar më 29 mars 1995 kur ankuesja, paraqiti një veprim për ripagimin e kredive. Një seancë ishte caktuar për datën 4 tetor 1995, por ajo u shty pasi që të pandehurit nuk u paraqitën pasi adresa e treguar (nga ankuesja) doli të ishte pasaktë. Seanca e ardhshme ishte caktuar për 24 Janar 1996. Megjithatë, në ndërkohë ZIP kishte pushuar së ekzistuari dhe adresa e Ž.M. mbeti e panjohur. Më 20 qershor 1996 avokati ë ankueses e informoi gjykatën se: Qendra e Mirëqenies Sociale në Zagreb kishte, emëruar një përfaqësues ligjor për Ž.M. Më 13 shtator 1996 gjykata kërkoi këshillën e ankueses brenda tridhjetë ditësh të paraqesë një certifikatë nga regjistri i Gjykatës Ekonomike të Zagrebit lidhur me statusin ligjor te ZIP. Dëgjimi tjetër, ishte planifikuar për 2 dhjetor 1999, por u shty për shkak të mungesës së të pandehurve. Doli përsëri se ZIP dhe Ž.M. nuk kishte marrë njoftim për datën e dëgjimit pasi qe adresa ishte e pasaktë. Gjykata ftoi avokatin e ankueses që të informonte këtë të fundit brenda tridhjetë ditësh nëse ZIP në fakt kishte pushuar së ekzistuari. Sipas Qeverisë, gjatë seancës së caktuar më 7 qershor 2000, gjykata vendosi mbi kërkesën e palëve për kthimin e procedurave në status quo ante (kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme). Për shkak të mungesës së ZIP, seanca u shty për në 17 tetor 2000. Procedurat mbeten në pritje para Gjykatës Komunale të Zagrebit.

Procedura kundër kompanisë MJB dhe B.J. filluan ndaj pronarit të saj të dyshuar B.J. më 30 mars 1995 kur ankuesja, paraqiti një veprim për rimbursimin e kredive të tyre

pranë Gjykatës Komunale të Zagrebit. Më 25 gusht 1995, avokati i ankueses informoi gjykatën për adresën e B.J.. Seanca e caktuar për 2 tetor 1995 u shty për shkak të mungesës së të pandehurve. Doli se MJB nuk ishte më në të adresa e mëparshme dhe se B.J. ishte në paraburgim. Avokati i ankueses informoi gjykatën se B.J. ishte liruar nga paraburgimi dhe kërkoi që njoftimet për seancën e ardhshme t'i dërgohen në të njëjtat adresa si më parë. Seanca dëgjimore më 27 nëntor 1995 u shty përsëri për shkak të mungesës së të pandehurve. Duket se MJB në ndërkohë kishte ndërprerë ekzistencën dhe se B.J. kishte ndryshuar adresën e saj. Seancën e 14 shkurt 1996, gjithashtu u shty për shkak të mungesës së të pandehurve për të njëjtat arsye si më parë. Gjykata vendosi të shikojë në dosjen penale nr. KO-1574/93 në të njëjtën gjykatë, ku procedurat ishin nisur kundër B.J.. Me urdhër të 11 shtatorit 1996, avokatit të ankueses i ishte kërkuar nga gjykata të paraqiste një certifikatë nga regjistri i Gjykatës Ekonomike të Zagrebit lidhur me statusin ligjor të MJB. Te gjitha seancat e caktuara me pas u shtyn për shkak të mungesës së të pandehurit. Më 24 shtator 1998 gjykata mori një letër nga Gjykata Ekonomike e Zagrebit me një certifikatë që përmbante gabimisht informacione për një tjetër firmë, në vend të MJB. Më 13 prill 2000 gjykata përsëri i dërgoi një letër Gjykatës Ekonomike të Zagrebit duke pyetur nëse MJB ende ekziston. Në të njëjtën ditë gjykata gjithashtu kërkoi nga avokati i ankueses të paraqiste të njëjtin informacion. Rasti mbeti në pritje para Gjykatës Komunale të Zagrebit.

Përmbledhje e pretendimeve

Fillimisht Qeveria e ka ftuar Gjykatën që të refuzojë kërkesën duke deklaruar se ankuesja nuk arriti të shteronte mjetet e brendshme juridike. Qeveria pretendonte se ankuesja nuk arriti të paraqiste një ankesë në pajtim me Nenin 59 (4) të Kushtetutës së re të rishikuar. Qeveria argumentoi më tej se ankuesja, përveç mundësisë së ankesës në Gjykatën Kushtetuese, mund ti kishte kërkuar kryetarit të Gjykatës Komunale të Zagrebit si dhe Ministrisë së Drejtësisë për të përshpejtuar procedurat. Ankuesja pretendon se procedurave civile për shlyerjen e kredive nuk ishin përfunduar brenda një kohë të arsyeshme siç kërkohet nga Neni 6 § 1 i Konventës, duke rezultuar kështu në shkelje të këtij neni.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata rikujton se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme juridike sipas Neni 35 të Konventës, nënkupton se fillimisht çështja duhet të shqyrtohet nga organet gjyqësore vendore. Rrjedhimisht, Shtetet janë të përjashtuar nga përgjegjësia përpara një organi ndërkombëtar për veprimet e tyre para se ata të kenë pasur mundësi t'i vënë gjërat në rregull me anë të sistemit ligjor të tyre. Rregulli bazohet në Nenin 13 të Konventës - me të cilën ajo ka afinitet të ngushtë - që kërkon egzistencën e një mjeti efektiv juridik në dispozicion në lidhje me shkeljen e pretenduar në sistemin vendas,⁷⁶ dhe se ekzistenca e mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Në rastin konkret, Gjykata vëren se procedurat në pajtim me Neni 59

⁷⁶ *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, aktgjykimi i 7 dhjetorit 1976, Seria A nr. 24, f. 22, § 48, dhe Aksoy kundër Turqisë, aktgjykimi i 18 dhjetorit 1996, Raportet e aktgjykimeve dhe Vendimet 1996-VI, f. 2275-76, § 51*

(4) të Kushtetutes konsiderohet të jetë të ngritura vetëm nëse Gjykata Kushtetuese, pas një shqyrtimi paraprak të ankesës, vendos ta pranojë atë. Kështu, edhe pse personi i interesuar mund të parashtrijë ankesë drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, institucioni i procedurave varet nga liria e kësaj të fundit. Për më tepër, për një palë që të jetë në gjendje të paraqesë një ankesë në Gjykatën Kushtetuese sipas kësaj dispozite duhet të jenë të plotsuara dy kushte kumulative. Së pari, të drejtat kushtetuese të ankuesit duhet të jenë shkelur nga fakti se asnjë vendim nuk është lëshuar brenda një kohe të arsyeshme dhe, së dyti, duhet të ketë një rrezik serioz dhe me pasoja të pariparueshme për ankuesin. Gjykata konsideron se një ankesë sipas Nenit 59 (4) të Aktit të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të konsiderohet me një shkallë të mjaftueshme të sigurisë si një mjet efektiv në rastin e ankueses.

Sa i përket pretendimit të Qeverisë se ankuesja nuk ka marrë çdo hap për të përshpejtuar procedurat, Gjykata rikujton se në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve civile, çështjen e metodave me të cilat ankuesja mund të kishte përshpejtuar procedurat kanë të bëjnë me vet meritat/permbajtjen e rastit. Mjetet juridike të tjera të përmendura nga Qeveria, d.m.th kërkesë drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Komunës së Zagrebit ose Ministrisë së Drejtësisë për të përshpejtuar procedurat, përfaqësojnë ankesa hierarkike që në fakt nuk jënë asgjë më shumë se informacioni i dorëzuar organit mbikëqyrës me sugjerimin për të shfrytëzuar kompetencat e tij nëse ai e sheh të arsyeshme për ta bërë këtë. Nëse një ankesë e tillë bëhet, organi mbikëqyrës mund të vendos ta marrë ose të mos e marrë çështjen. Ankuesja nuk do të ishte palë në këto procedura dhe mund të informohet vetëm për mënyrën në të cilën organi mbikëqyrës ka trajtuar me ankesën e saj. Në rrethanat e mësipërme, Gjykata vëren se nuk ekziston një mjet ligjor i vërtetë që i mundëson një personi të ankohet për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave në Kroaci,⁷⁷ dhe konsideron se ankesa e ankueses ishte e justifikuar në konsiderimin se asnjë mjet tjetër juridik në nivelin kombëtar do të ishte efektiv në lidhje me ankesën e saj. Gjykata gjen, prandaj, se nuk ka pasur mjete të përshtatshme dhe efektive për qëllimet e Nenit 35 të Konventës, të cilat ankueses iu kërkua për të shëruar. Kështu, Gjykata vendos që kundërshtimi i Qeverisë për arsytet e mos-shëruimit të mjeteve juridike vendase nuk mund të merret parasysh, andaj e shpall kërkesën të pranueshme. Në lidhje me pretendimet e ankueses se procedurat civile për shlyerjen e kredive nuk ishin përfunduar brenda një kohe të arsyeshme siç kërkohet nga Neni 6 § 1 i Konventës, Gjykata vëren së pari se procedimet kanë filluar më 29 dhe më 30 mars 1995, përkatësisht, kur ankuesja paraqiti padi civile për veprimet për ripagimin e huave në Gjykatën Komunale të Zagrebit. Megjithatë, periudha që bie nën juridiksionin e Gjykatës nuk filloi në ato data, por më 5 nëntor 1997, kur Konventa hyri forcë në lidhje me Kroacinë. Gjykata vëren se në datën e hyrjes së Konventës në fuqi në lidhje me Kroacinë të dy procedurat kishin zgjatur rreth dy dhe një vit e gjysmë. Gjykata kujton se arsyeshmëria e gjatësisë së procedurave duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, veçanërisht në kompleksitetin e rastit, sjelljen e ankuesit dhe të autoritetet

⁷⁷ *Tomé Mota kundër Portugalisë* (vend.), nr. 32082/96, GJEDNj1999-IX

relevante, dhe rëndësinë e asaj që është në rrezik për ankuesin në procesin gjyqësor.⁷⁸ Qeveria argumentoi se të dyja rastet zbulojnë se as paditësit, e as Gjykata Komunale e Zagrebit nuk ishin në gjendje të konstatojnë adresat e sakta të të pandehurve. Ankuesja argumentoi se ishte detyrë e policisë të konstatonte adresat e të pandehurve. Megjithatë, sipas ligjit kroat, është e mundur të kërkohet nga Qendra e Mirëqenies Sociale të caktojë një përfaqësues ligjor për një të pandehur adresa e të cilit është e panjohur. Megjithëse ankuesja kishte filluar procedurën në në fund të marsit 1995, u deshën një vit përpara se një përfaqësues ligjor të ishte i emëruar në procedurën kundër Ž.M. dhe tre vjet në procedurat kundër B.J. Përndryshe Gjykata nuk gjen se lëndët zbulojnë ndonjë rrethanë që do t'i kualifikonte si komplekse.

Lidhur me sjelljen e ankueses, Qeveria parashtrroi se ankuesja ka kontribuar në kohëzgjatjen e procedurës pasi ajo nuk ka arritur të ofroi adresat e sakta të të pandehurve. Përveç kësaj, ajo dështoi të parashtrrojë kërkesë për përsheptimin e procedurës me Presidentin Gjyqësor Komunal të Zagrebit ose Ministrinë e Drejtësisë. Për çështjen e sjelljes së ankueses duhet të theksohet se Qeveria nuk ka treguar se mundësia që iu dha ankueses në lidhje me përsheptimin e procedurave ishte e vërtetë. Pavarësisht nga informacionet e ofruara nga Qeveria, Gjykata nuk sheh se eeksistonte një mjet juridik përdorimi i të cilit i grantonte ankueses perspektivë suksesi. Në këto rrethana, nuk duket se pretendimi i pasiviteti të ankueses kontribuoi në ngadalësimin e procedurës.

Sa i përket sjelljes së autoriteteve, qeveria pretendoi se gjykatat e vendit treguan kujdes në zhvillimin e procedurës. Ata parashtruan më tej se Gjykata Komunale e Zagrebit ishte vazhdimisht duke ballafaquar me probleme të ngarkesave të tepruara të punës (1,000 raste për gjyqtar). Gjykata vëren se në periudhën që duhet marrë parasysh çështja kundër ZIP dhe Ž.M. ka pushuar në mes të 5 nëntorit 1997 dhe 2 dhjetor 1999, e cila arrin më shumë se dy vjet. Rasti kundër MJB dhe B.J. kishte pushuar midis 22 korrikut 1998 dhe 13 prillit 2000, të cilat arrin deri në një vit, tetë muaj dhe njëzet e një ditë. Prandaj, Gjykata nuk është e bindur nga shpjegimet e Qeverisë për vonesat. Sipas Gjykatës u takon shteteve kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund t'i garantojnë të gjithëve të drejtën për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile brenda një kohë të arsyeshme. Në dritën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e saj dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procedurave në fjalë, të cilat janë ende në pritje para gjykatës së shkallës separë, nuk arriti të plotësojë kërkesën e arsyeshme kohore. Në përputhje me rrethanat, Gjykata gjene se ka shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me të dy grupet e procedurave.

Ne lidhje me pretendimet e ankueses se ajo nuk kishte zgjidhje efektive te rastit te saj me ç'rast ajo mund të ngrejë çështjen e zgjatjes së procedurës Gjykata rikujton së pari se interpretimi i saktë i Nenit 13 të Konventës është se kjo dispozitë garanton një zgjidhje efektive para një autoriteti kombëtar për një shkelje të supozuar. Sa i përket kërkesës për përsheptimin e procedurës, Gjykata përsërit se kërkesat e tilla

⁷⁸ *Humen kundër Polonisë* [DhM], nr. 26614/95, § 60, 15 tetor 1999, dhe *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë* [dhM], nr. 35382/97, GjEDNj 2000-IV

përfaqësojnë një apel hierarkik dhe nuk mund të konsiderohet si një mjet juridik në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve civile. Sa i përket kërkesës në pajtim me Nenin 59 (4) të Kushtetutës Gjykata Gjykata përsërit se nuk përfaqëson një mjet efektiv në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave civile. Prandaj, Gjykata konstaton se në rastin në fjalë ka pasur një shkelje të Nenit 13 të Konventës.

Gjykata konstaton se se shteti i paditur duhet të paguajë ankueses, 20,000 HRK në lidhje me dëmet jo-materiale; si dhe interesin e thjeshtë me një normë vjetore prej 18%.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me të dy grupet e procedurave; dhe vendos se ka pasur shkelje të Nenit 13 të Konventës [njëzëri].

Neni 14

Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Thlimenos kundër Greqisë - 34369/97

6 prill 2000 [Gjykata]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 6 § 1

Shkelje e të drejtës në proces gjyqësor si pasojë e kohëzgjatejes së procedurave / *ka shkelje*

Neni 14 ndërlidhur me Nenin 9

Diskriminim në rastin e emërimit të pozitë si pasojë e besimit fetarë / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *shërbim ushtarak / refuzim / bindje fetare / Dëshmitarë i Jehovahit / dënim / refuzim / anëtar bordi / diskriminim / proces gjyqësor / tej-zgjatje*

Ankuesi: z. Iakovos Thlimmenos, shtetas grek

Faktet e rastit

Në vitin 1983, ankuesi, një Dëshmitar i Jehovahit, u dënua nga një Gjykatë Ushtarake Permanente e Athinës për mosbindje pasi nuk kishte pranuar të vinte uniformë ushtarake në kohën e mobilizimit të përgjithshëm. Ankuesi u dënua me katër vjet burgim, por lirua me kusht pas dy vjetësh dhe një dite.

Në vitin 1988 ai doli i dyti nga gjashtëdhjetë kandidatë në një provim konkurrues për emërimin e dymbëdhjetë kontabilistëve të autorizuar. Megjithatë, Bordi përkatës nuk pranoi ta emërojë atë, me arsyetimin se ai ishte dënuar për një krim të rëndë. Ankuesi iu drejtua Gjykatës Supreme Administrative, duke pohuar, ndër të tjera, se vepra e tij ishte më pak serioze se një krim, por ankesa u refuzua përfundimisht me 28 qershor të vitit 1996. Ky refuzim u bazua nën arsyetimin se dështimi i Bordit përkatës për të emëruar ankuesin *kontabilist të certifikuar* nuk ishte i lidhur me besimin e tij fetar, por me faktin se ai ishte dënuar për vepër penale të rëndë.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi vuri në dukje se ai nuk ishte emëruar sepse kishte refuzuar të shërbente në forcat e armatosura; Duke refuzuar ta bëjë këtë, ai kishte manifestuar besimin e tij fetar si Dëshmitar i Jehovahit. Ankuesi më tej argumentoi se nuk mund të sillte asnjë dobi përjashtimi i dikujt nga profesioni i kontabilistit të akredituar për shkak të refuzimit për të shërbyer në forcat e armatosura për arsye fetare. Sipas pikëpamjes së ankuesit, ligji nuk duhet të kishte përjashtuar çdo person të dënuar për një krim të rëndë. Legjitimiteti i përjashtimit varet nga natyra e postit dhe e veprës, duke përfshirë motivet e kryerësit, koha e kaluar që nga vepra dhe sjellja e kryerësit gjatë asaj kohe. Nga këndvështrim, përjashtimi i ankuesit nuk ishte i nevojshëm. Klasa e personave të cilëve u takonte ankuesi, respektivisht Dëshmitarëve të Jehovahit, feja e të cilëve përfshinte arsye bindëse për refuzimin për të shërbyer në forcat e armatosura, ishte ndryshe nga klasa e shumicës së kriminelëve të tjerë. Për këtë, ankuesi u mbështet në Nenin 14 të Konventës të ndërlidhur me Nenin 9.

Qeveria argumentoi se Neni 14 i Konventës nuk zbatohet për shkak se faktet rastit nuk binin në kuadër të Nenit 9. Autoritetet që refuzonin të caktonin aplikuesin për kontabilist të akredituar nuk kishin mundësi tjetër përveç se të zbatonin rregullin që përjashtonte të gjithë personat e dënuar për krime të rënda nga një post i tillë. Për shkak të përgjithësimin të tij, ligji në fjalë ishte neutral dhe ishte në interes publik. Një person i dënuar për një vepër të rëndë nuk mund të emërohet në shërbim civil dhe, rrjedhimisht në një post të kontabilistit të autorizuar. Ky ndalim duhet të ish te absolut dhe asnjë dallim nuk mund të bëhet rast pas rasti. Po ashtu, qeveria theksoi se ligji për të kryer shërbimin ushtarak vliente për të gjithë meshkujt grekë pa dallim feje. Andaj, edhe nëse një grek ortodoks apo katolik do të kishte kryer donjë krim të rëndë do të përjashtohet nga marrja e një posti të tillë.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata rikujton që Neni 14 i Konventës nuk ka ekzistencë të pavarur, pasi ky nen ka efekt vetëm në lidhje me të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga dispozitat e tjera substanciale të Konventës dhe Protokollit e saj. Megjithatë, zbatimi i Nenit 14 nuk nënkupton shkelje të një ose më shumë dispozitave të tilla dhe në këtë masë është autonome.

Gjykata konsideron se ankuesi është trajtuar ndryshe për shkak të statusit të tij si person i dënuar dhe një sjellje e tillë nuk i bie nën fushëveprimin e Nenit 14 për aq sa ka të bëjë me të drejtën për një profesion të caktuar, pasi që kjo e drejtë nuk garantohet nga Konventa. Megjithatë, shqetësimet e ankuesit kanë të bëjnë me faktin se nuk është bërë donjë dallim në mes të dënuarve me vepra penale ekskluzivisht për shkak të besimit të tyre fetar dhe atyre të dënuar për vepra të tjera, andaj këto ankesa bien në kuadrin e Nenit 9.

E drejta për t'u mos diskriminuar shkelet edhe kur Shteti pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm dështon për të trajtuar personat ndryshe, gjendja e të cilëve ndryshon drastikisht, prandaj Neni 14 është i zbatueshëm. Si parim, shteti ka interes legjitim në përjashtimin e kriminelëve nga profesioni i kontabilistit të certifikuar, por mosbindja për të veshur uniformën ushtarake mbi baza fetare, nuk mund të nënkuptojë pandershmëri morale apo poshtërsi ashtu që të dëmtojë aftësinë e një personi për të ushtruar këtë profesion.

Përjashtimi i ankuesit për shkak se ai ishte i papërshtatshëm për profesionin nuk ishte e justifikuar. Ai në fakt kishte kryer dënimin me burg dhe sanksionimi i tij i mëtejshëm do të ishte joproporcional. Sanksionimi i dyshiftë nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për të mos e trajtuar ankuesin ndryshe nga të dënuar e tjerë për krim të rënda. Përderisa bordi përkatës për përzgjedhjen e kandidatëve nuk kishte zgjidhje, por për të zbatuar ligjin, ishte miratimi i legjislacionit, pa përjashtime e duhura nga ana e shtetit, arsyeja pse ishin shkelur të drejtat e aplikuesit. Rrjedhimisht, Gjykata gjeti se ishte shkelur Neni 14 i ndërlidhur me Nenin 9 të Konventës.

Pas gjetjes së shkeljes si më lartë, dhe pasi që refuzimi për emërimin e ankuesit kontabilist i certifikuar nuk ishte pasojë e ndërhyrjes në të drejtën e garantuar nën Nenin 9 të Konventës, Gjykata konsideroi se nuk ka nevojë të shqyrtojë më tej këtë pretendim.

Ankuesi ka pohuar se Neni 6 § 1 i Konventës aplikohet në procedurat e Gjykatës Supreme Administrative në shqyrtim sepse ato nuk kishin të bënin me qasjen në shërbimin civil, por me profesionet e lira, edhe pse ngushtë të rregulluara. Për më tepër, ankuesi ka argumentuar se procedurat nuk janë përfunduar brenda një kohe të arsyeshme. Çështja nuk përfshinte çështje komplekse ligjore. Çështjet që u janë referuar në seancën plenare të Gjykatës Supreme Administrative nuk janë ngritur nga ankuesi, por nga vetë Dhoma e Gjykatës Supreme Administrative. Sidoqoftë, kjo nuk mund të arsyetojë një vonesë prej më shumë se shtatë vjetësh.

Gjykata rikujton se, ndonëse e rregulluar nga e drejta administrative, profesioni i kontabilistëve të akredituar ishte një nga profesionet e lira në Greqi. Si rezultat, procedurat e ngritura nga ankuesi për të kundërshtuar dështimin e autoriteteve për ta emëruar këtë post, përfshijnë përcaktimin e të drejtave të tij civile në kuptim të Nenit 6 § 1 të Konventës.

Sipas Gjykatës, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës vlerësohet me ndihmën e kriterëve të mëposhtme: *kompleksiteti i çështjes, sjellja e palëve, sjellja e autoriteteve që kanë të bëjnë me çështjen dhe çfarë ka qenë me rëndësi/e domosdoshme për ankuesin.*

Gjykata vëren se rasti përfshinte çështje ligjore jo edhe jokomplekse. Megjithatë, ankuesi nuk ka shkaktuar ndonjë vonesë. Po ashtu, Gjykata vëren dy periudha të pasivitetit të një kohëzgjatje totale prej gati tre vjetësh. Shpjegimi i vetëm i ofruar nga Qeveria për këto periudha të pasivitetit është volumi i madh i lëndëve të pazgjidhura i Gjykatës Supreme Administrative. Gjykata nuk mund ta pranojë këtë shpjegim. Sipas jurisprudencës së saj, obligimi bie mbi shtetet palë që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në atë mënyrë që gjykatat e tyre të mund të garantojnë të drejtën e secilit për të marrë një vendim përfundimtar mbi mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat civile dhe brenda një kohe të arsyeshme. Andaj, duke u bazuar në këto argumente, Gjykata konstaton se kohëzgjatja e procedurave në fjalë dështon të përmbushë kriterin e “kohëzgjatjes së arsyeshme” andaj ka shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen shkelje të Nenit 14 të ndërlidhur me Nenin 9 të Konventës; dhe gjithashtu gjen shkelje të Nenit 6 § 1, ndërsa Konsideron se nuk ka nevojë ta shqyrtojë çështjen nën Nenin 9 të Konventës si të vetëm [njëzëri].

Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar - 24746/94

4 maj 2001 [Seksioni i Tretë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 2

Shkelje e të drejtës në jetë dhe dështimi në respektimin e kërkesave procedurale hetimore lidhur me vrasjen e Pearse Jordan nga policia / *ka shkelje*

Neni 6

Pretendime për vrasje arbitrare në rrethana ku një arrestim mund të ishte kryer nga zyrtarët policor / *nuk ka shkelje*

Neni 14

Pretendim për diskriminim bazuar në përkatësinë religjioze / *nuk ka shkelje*

Neni 13

Mungesë e një hetim tërësor dhe efektiv të aftë për të çuar në identifikimin dhe dënimin e atyre që ishin përgjegjës / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: *vrasje / forcë e tepërt / veprim i qëllimshëm / hetim joadekuat / konflikt / Irlandë Veriore / autoritet shtetëror / diskriminim / përkatësi religjioze*

Ankuesi: z. Hugh Jordan, me shtetësi të dyfishtë Irlandeze dhe Britanike

Faktet e rastit

Më 25 nëntor 1992, djali i ankuesit, Pearse Jordan, 22 vjeç, u qëllua dhe u vra në Belfast nga një oficer i Kolegjit Royal Ulster (RUC), më vonë i identifikuar si Rreshter A. Deklarata zyrtare e lëshuar nga RUC për mediat tregoi se një njësi RUC kishte ndjekur një makinë në Rrugën e Ujërave dhe e kishte ndërprerë atë. Në ndalimin e makinës, oficerët kishin qëlluar disa të shtëna në shoferin, duke e plagosur atë fatkeqësisht në një distancë të shkurtër nga ku makina e tij ishte braktisur. Asnjë armë, municion, eksploziv, maskë apo doreza nuk ishin gjetur në makinë dhe shoferi, Pearse Jordan, ishte i paarmatosur. Raporti pas vdekjes gjeti dy plagë hyrëse në pjesën e pasme të Pearse Jordan dhe një në pjesën e pasme të krahut të majtë, dhe vuri re një plagë në fytyrë. Sipas raportit ai ishte goditur nga tre plumba të cilat kishin ardhur nga prapa dhe nga e majta. Nuk kishte asgjë për të treguar gamën. Të shtënat e armëve u dëshmuuan nga katër civilë, të cilët më 26 nëntor 1992 bënë deklaratë në Komitetin për Administratën e Drejtësisë (CAJ), një organizatë e pavarur joqeveritare për të drejtat e njeriut me seli në Belfast. Faktet e rastit ishin kundërtëna pasi që Qeveria dhe ankuesi kishin versione të ndryshme në lidhje me rastin. Për këtë katër dëshmitarë dhanë dëshmi për vrasjen, e cila asnjeher nuk është pranuar nga Qeveria.

Për shkak të evidencës kontradiktore në mes të raportit final të policisë, ankuesit dhe dëshmitareve, rasti u dërgua në "Hetim". Më 29 nëntor 1993, RUC njoftoi Masonerin

se DPP nuk kishte drejtuar "asnjë ndjekje penale". Pas këtij vendimi, mjeku ligjorë vendosi të mbajë edhe një hetim.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi pretendoi se djali i tij Pearse Jordan ishte qëlluar dhe vrarë në mënyrë të pajustificuar nga një oficer policie dhe se nuk kishte pasur asnjë hetim efektiv, ose korrigjim për vdekjen e tij. Ai bazoi pretendimet në Nenet 2, 6, 13 dhe 14 të Konventës.

Ankuesi pohoi se vdekja e djalit të tij ishte rezultat i përdorimit të panevojshëm dhe joproporcional të forcës nga një oficer i RUC dhe se djali i tij ishte viktimë e një politike të drejtuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar në Irlandën e Veriut. Ai përmendi, ndër të tjera, raportet nga Amnesty International dhe Human Rights Watch, si dhe deklaratat e bëra nga z. John Stalker, një polic i lartë, i cili kreu një hetim mbi pohimet për një politikë të tillë. Ai argumentoi se ky rast nuk mund të shihej në izolim nga rastet e tjera në Irlandën e Veriut që përfshijnë përdorimin e forcës vdekjeprurëse nga agjentët shtetërorë. Në këtë kontekst, mund të shihet në analizën e vdekjeve me forcë vdekjeprurëse midis viteve 1969 dhe 1994, ishte një praktikë ku të dyshuarit u vranë në mënyrë arbitrare në vend që të arrestoheshin.

Ai vuri në dukje tiparet e përbashkëta të parapërgatitjes bazuar në inteligjencën nga informatorët, vendosjen e njësisë të specializuara ushtarake ose policore dhe përdorimin maksimal të forcës. Në këtë rast, rreshteri A nuk kishte dëshmi se Pearse Jordan ishte e armatosur dhe kishte drejtuar armen drejt e trupit, duke mos bërë asnjë përpjekje për të plagosur ose për të ndërmarrë veprime të paqëndrueshme si dhe kishte ndaluar prapa veturës së tij të blinduar për të mbrojtur veten. Kjo nuk mund të konsiderohet si përdorimi i forcës minimale ose proporcionale.

Sipas ankuesit hetimet joadekuate për këtë dhe raste të tjera ishin gjithashtu dëshmi e tolerancës zyrtare nga ana e shtetit ndaj përdorimit të forcës vdekjeprurëse të paligjshme. Këtu polici i përfshirë në të shtënat u lejua të largohej nga skena me armët e tij, një makinë që ishte përfshirë në incident ishte larguar nga vendi i ngjarjes dhe nuk u ndërmorën hapa adekuat për të gjetur dëshmitarë okularë të pavarur, ndërkohë që dëshmitarët që dolën përpara ishin subjekt i abuzimit dhe ngacmimit. Parashtruesi i kërkesës ka parashtruar se ndërsa ka pasur disa çështje të pazgjidhura faktike, p.sh. nëse Rreshteri A kishte dhënë ndonjë paralajmërim dhe nëse dhe në çfarë mënyre i ndjeri e ndryshoi drejtimin ndërsa po ikte.

Ankuesi më tej pohoi se nuk kishte pasur hetime zyrtare efektive të kryera në vrasjen, duke u mbështetur në standardet ndërkombëtare të përcaktuara në Protokollin e Minesotës. Ai argumentoi se hetimi i RUC ishte i pamjaftueshëm dhe i mangët nga mungesa e pavarësisë dhe mungesa e publicitetit. Roli i DPP-së ishte i kufizuar nga hetimi i RUC dhe ai nuk i bëri publike arsyet e tij për mosndjekje. Sondazhi ishte i mangët nga vonesat, nga fushëveprimi i kufizuar i hetimit, mungesa e ndihmës juridike për të afërmit, mungesa e qasjes në dokumente dhe deklaratat të dëshmitarëve, moskualifikimi i forcave të sigurisë ose dëshmitarëve të policisë dhe përdorimi i imunitetit të interesit publik certifikatat. Qeveria nuk mund të mbështetej në procedurat civile, sepse kjo varet nga iniciativa e familjes së të ndjerit.

Qeveria nuk i pranoi pretendimet e ankuesit sipas Nenit 2 se djali i tij ishte vrarë nga ndonjë përdorim i tepruar ose i pajustificuar i forcës, ata konsideronin se do të ishte tërësisht e papërshtatshme që Gjykata të kërkonte vetë të përcaktonte çështjet e fakteve që lindin çështjet thelbësore të Nenit 2. Qeveria parashtroi se në çdo rast kishte vështirësi të konsiderueshme praktike për Gjykatën që të vazhdonte shqyrtimin e aspekteve thelbësore të Nenit 2, pasi që çështjet faktike do të ishin të shumta dhe komplekse, duke përfshirë prova të drejtpërdrejta me një numër të konsiderueshëm dëshmitarësh. Qeveria mohoi se kishte pasur ndonjë pengesë për hetimin e policisë në këtë rast, duke theksuar se heqja e veturës nga vendi i ngjarjes ishte në përputhje me shqetësimet e ligjshme të sigurisë. Ata mohuan se kishte pasur ndonjë kërcënim ose abuzim me dëshmitarët. Qeveria më tej argumentoi se aspekti procedural i Nenit 2 ishte i arritur nga kombinimi i procedurave në dispozicion në Irlandën e Veriut, përkatësisht hetimi policor, i cili ishte mbikëqyrur nga KNDCP dhe DPP, procedurat e hetimeve dhe procedurat civile. Këto veprime siguruan qëllimin themelor të obligimit procedural, duke siguruar përgjegjësi efektive për përdorimin e forcës vdekjeprurëse nga agjentët shtetërorë. Ata gjithashtu theksuan se secili rast duhej të gjykohej mbi faktet e tij, pasi që efektiviteti i çdo përbërësi procedural mund të ndryshojë me rrethanat. Në rastin në fjalë, ata parashtroan se procedurat e disponueshme së bashku siguruan efektivitetin e nevojshëm, pavarësinë dhe transparencën përmes mbrojtjes kundër abuzimit.

Në lidhje me rastin u konsultua edhe Komisioni i të Drejtave të Njeriut nga Irlanda Veriore. Duke iu referuar standardeve përkatëse ndërkombëtare në lidhje me të drejtën për jetë Komisioni u shpreh se Shteti duhet të kryejë një hetim efektiv zyrtar kur një agjent i Shteti ishte përfshirë ose implikuar në përdorimin e forcës vdekjeprurëse. Procedurat e llogaridhënies së brendshme duhet të plotësonin standardet e efektivitetit, pavarësisë, transparencës dhe shpejtësisë, dhe të lehtësonin sanksionet ndëshkuese. Megjithatë, sipas mendimit të tyre, nuk ishte e mjaftueshme që një shtet të deklaronte se ndonëse disa mekanizma ishin të papërshtatshëm, një numër mekanizmash të tilla të konsideruara kumulativisht mund të siguronin mbrojtjen e nevojshme. Ata parashtroan se mekanizmat hetues të mbështetur në këtë rast, individualisht apo të kombinuar, nuk arritën ta bënë këtë. Ata përmendën, ndër të tjera, rolin problematik të RUC në Irlandën e Veriut, mangësitë e supozuara serioze në mekanizmat e përgjegjësisë së policisë, shtrirjen e kufizuar dhe vonesat në hetimet dhe mungesën e aftësisë së anëtarëve të forcave të sigurisë kanë përdorur forcë vdekjeprurëse për të dalë në hetimet. Ata tërhoqën vëmendjen e Gjykatës në formën e hetimit të kryer në Skoci nën një gjykatës i juridiksionit penal dhe civil, ku të afërmit kanë të drejtë të paraqiten. Ata i kërkuan Gjykatës të shfrytëzojë mundësinë për të dhënë udhëzime të sakta në lidhje me formën që duhet të ndërmarrin hetimet për përdorimin e forcës vdekjeprurëse nga agjentët shtetërorë.

Arsyetimi i Gjykatës

Kryetari i Dhomës që shqyrtoi rastin konstatoi se rasti aktual duhet të shqyrtohet njëkohësisht me rastet *McKerr kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kelly dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, dhe *Shanaghan kundër Mbretërisë së Bashkuar*.⁷⁹

⁷⁹ *McKerr kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 28883/95, *Kelly dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 30054/96 dhe *Shanaghan kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 37715/97

Në lidhje me pretendimet e ankuesit Gjykata fillimisht, konstaton se nuk i takon asaj të përcaktojë me hollësi se cilat procedura autoritetet duhet të miratojnë në sigurimin e shqyrtimit të duhur të rrethanave të vrasjes nga agjentët shtetërorë. Në lidhje me referencën që është bërë për modelin e hetimit skocez të kryer nga një gjyqtar i juridiksionit penal, Gjykata theksoi se nuk ka asnjë arsye të supozohet se kjo mund të jetë metoda e vetme në dispozicion. As nuk mund të thuhet se duhet të ketë një procedurë të unifikuar që siguron të gjitha kërkesat sipas Nenit 2 të Konventës. Nëse qëllimet e gjetjes së fakteve, hetimet penale dhe ndjekja penale kryhen ose ndahen midis disa autoriteteve, si në Irlandën e Veriut, Gjykata konsideron se kërkesat e Nenit 2 mund të përmbushen duke kërkuar të marrin në konsideratë interesa të tjera legjitime si siguria kombëtare ose mbrojtja e materialeve relevante për hetimet e tjera, që ato msa të sigurojnë masat mbrojtëse të nevojshme në mënyrë të arritshme dhe efektive. Në rastin në fjalë, procedurat në dispozicion nuk kanë arritur baraspeshën e kërkuar.

Gjykata me tutje theksoi se mangësitë në transparencë dhe efektivitet të identifikuar gjatë proceduarve hetimore janë në kundërshtim me qëllimin e identifikuar nga gjykatat vendase për heqjen e dyshimeve dhe thashethemeve. Procedurat e duhura për të siguruar llogaridhënien e agjentëve të shtetit janë të domosdoshme në ruajtjen e besimit të publikut dhe përmbushjen e shqetësimeve legjitime që mund të lindin nga përdorimi i forcës vdekjeprurëse. Mungesa e procedurave të tilla ngritë dyshime për frikën e motiveve të gabuara, siç ilustruhet, ndër të tjera, nga parashtrësit e bëra nga ankuesi lidhur me politikën e pretenduar për vrasje. Bauar në të gjitha keto, Gjykata konstaton se ka pasur mosrespektim të detyrimit procedural të vendosur nga Neni 2 i Konventës dhe se në këtë drejtim ka pasur shkelje të kësaj dispozite.

Lidhur me pretendimet për shkelje të Nenit 6, Gjykata vëren se procedurat janë në zhvillim e sipër në kohën e trajtimit të rastit andaj nuk konsideron se ka ndonjë prapavijë mbrapa sulmit, si rezultat konstaton se nuk ka shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

Lidhur me pretendimet për shkelje të Nenit 14 bazuar në argumentin e ankuesit se një ndër arsyet e vrasjes së tij ishte përkatësia e tij fetare, Gjykata vëren se edhe pse statistikave tregojnë se shumica e personave të vrarë nga forcat e sigurisë i përkisnin komuniteti katolik, Gjykata nuk konsideron se statistikave në vetvete shfaqin ndonjë praktikë e cila mund të konsiderohet diskriminuese. Andaj Gjykata nuk ka dëshmi që do ta dërgonte në një konkludim se këto vrasje rezultuan në një përdorim të tepërt të forcës, dhe si rezultat gjen se nuk ka shkelje të Nenit 14 të Konventës. Ngjashëm Gjykata konstaton se nuk ka shkelje të Nenit 13 të Konventës, duke pas parasysh se një pjesë e çështjeve janë trajtuar në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve bazuar në Nenin 2.

Gjykata i akordoi ankuesit një shumë prej 10,000 paund për dëmin jo-material dhe 30,000 paund për shpenzimet gjyqësore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen shkelje të Nenit 2 të Konventës; vendos se nuk ka shkelje të Nenit: 6 § 1, Nenit 14 dhe Nenit 13 të Konventës [njëzëri].

Leitner kundër Austrisë - 55740/10

8 qershor 2017 [Seksioni i Pestë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 8 në ndërlidhje me Nenin 14

Pretendim për diskriminim në pamundësi të marrjes së kujdestarisë së vetme ose të përbashkët në raport me nënën, dhe si rezultat i mos lejimit të vizitave se ka pasur shkelje të së drejtës së tij për respektimin e jetës së tij private dhe familjare /

Fjalët kyçe: fëmijë jashtëmartesor / ndarje / kujdestari / e përbashkët / diskriminim / pamundësi ligjore

Ankuesi: z. Hermann Leitner, shtetas austriak i lindur më 1961 dhe jeton në Blumau

Faktet e rastit

Ankuesi dhe ish partnerja i tij, S.O., kanë dy fëmijë, të lindur jashtë martese në vitin 2002 dhe 2004 respektivisht. S.O. gjithmonë kishte pasur kujdestarinë e fëmijëve si e vetme, pasi prindërit nuk kishin ranë dakord të kishin kujdestarinë e përbashkët. Ankuesi dhe S.O. asnjëherë nuk ka bashkëjetuar në baza të përhershme. Fëmijët gjatë javës jetonin me nënën e tyre, ndërsa në fundjavë, e gjithë familja zakonisht qëndronte në shtëpinë e ankuesit. Në prill të vitit 2008, ankuesi dhe S.O. u ndanë dhe fëmijët mbetën me nënën e tyre.

Më 27 qershor 2008, ankuesi inicioi procedurë në Gjykatën e Qarkut të Vjenës me të cilën kërkonte të shpalles si kujdestarë i vetëm ose të gëzonte kujdestari të përbashkët së bashku me S.O. Për më tepër ai aplikoi për një masë të përkohshme në lidhje me të drejtat e tij të vizitës, pasi ai nuk i kishte parë fëmijët e tij që nga 20 prilli 2008. Më 8 tetor 2008 prindërit ranë dakord që ankuesi të mund t'i shihe fëmijët e tij çdo të dytën të hënë nga ora 14:30 ose 15:00 deri në orën 18:00 dhe çdo të shtunë të dytë nga ora 10:00 deri në orën 18:00. Po të njëjtën ditë, ankuesi parashtrroi kërkesë për zgjatjen e të drejtës së tij të vizitës gjatë gjithë fundjavës.

Pas pesë vizitave nga ankuesi në periudhën tetor - nëntor 2008, S.O. ndaloi në mënyrë të njëanshme vizitat e mëtejshme, duke pretenduar se këto kishin një ndikim negativ mbi fëmijët. Midis Nentorit 2008 dhe Pashkëve 2009, me iniciativën e tij, ankuesi fshehurazi shkoi për të parë fëmijët e tij në shkollën e tyre dhe kopsht disa herë.

Në ndërkohë Zyra e Ndihmës për të Mitur të Gjykatës për të Mitur paraqiti deklaratën e saj më 10 mars 2009 dhe rekomandoi mbajtjen e kujdestarisë së vetme për nënën dhe të drejtat e vizitës për ankuesit sipas marrëveshjes që prindërit kishin lidhur më 8 tetor 2008. Më 6 prill 2009, Gjykata e Rrethit hodhi poshtë kërkesën e ankuesit për kujdestari të vetme vendosi t'i akordonte atij të drejtën për vizita çdo të shtunë të dytë nga ora 8 deri në orën 19.

Në ankesën e tij ndaj këtij vendimi ankuesi argumentoi se në thelb se ai ishte diskriminuar, në krahasim me nënën. Gjithashtu, ai u ankua se gjykata nuk kishte vendosur për çështjen nëse prindërit mund të merrnin kujdestarinë e përbashkët.

Gjykata Rajonale e Vjenës më 28 korrik 2009, e hodhi poshtë kërkesën e ankuesit si të pabazuar, dhe konfirmoi arsyetimin e Gjykatës së Rrethit dhe konstatoi se nuk kishte asnjë shenjë të rrezikut për interesin më të mirë të fëmijëve nëse nëna mbajti kujdestarinë e vetme. Ndaj këtij vendimi ankuesi paraqiti një ankesë të jashtëzakonshme në Gjykatën Supreme më 10 nëntor 2009, duke pretenduar përsëri se ai ishte diskriminuar krahasuar me nënën dhe se vendimi i shkallëve më të ulëta shkeli të drejtat e tij sipas nenit 8 të Konventës. Më 1 shtator 2010, Gjykata Supreme hodhi poshtë ankesën e jashtëzakonshme të ankuesit për mungesë të një çështjeje të rëndësishme të ligjit.

Pas ndryshimit të Kodit Civil ankuesi më 5 shkurt 2013 përsëri kërkoi kujdestarinë e përbashkët ose kujdestarinë e vetëm në alternativë. Menjëherë pas, S.O. u zhvendos me fëmijët në jug të Austrisë, rreth 400 kilometra nga Viena. Kërkesat e ankuesit për kujdestari të vetme ose të përbashkët u hodhen poshtë përfundimisht nga Gjykata Supreme më 7 maj 2014.

Përmbledhje e pretendimeve

Kërkuesi u ankua në bazë të nenit 8 i lexuar si i vetëm dhe në lidhje me nenin 14 të Konventës se ai ishte diskriminuar krahasuar me nënën e fëmijëve lidhur me dhënien e kujdestarisë së tyre dhe se ka pasur shkelje të së drejtës së tij për respektimin e jetës së tij private dhe familjare.

Ankuesi poashtu parashtrroi se si baba, nuk kishte mundësi që sipas ligjit austriak në fuqi në kohën përkatëse, të merrte pjesë në marrjen e vendimeve lidhur me edukimin e fëmijëve të tij. Ai gjithashtu u ankua se nënat ishin të favorizuara nga ligji kur ishte në pyetje kujdestaria e fëmijëve të paligjshëm. Ankuesi gjithashtu vuri në dukje se si pasojë e këtij diskriminimi kundër tij si baba, ai nuk i ka parë fëmijët e tij ndërmjet Pashkëve 2008 dhe 8 tetorit 2008 dhe përsëri ndërmjet 13 nëntorit 2008 dhe 25 prillit 2009, si dhe se ish partnerja e tij e pengoi atë që t'i shihnte ato gjatë këtyre periudhave kohore.

Qeveria në anën tjetër argumentoi se kur u bë kërkesa e kërkuesit për kujdestari të vetme, dispozitat ligjore në fuqi në kohën përkatëse nuk bënë dallime diskriminuese ndërmjet prindërve për shkak të gjinisë së tyre. Pavarësisht nga gjinia e prindit që aplikon për transferimin e kujdestarisë, kjo mund të bëhej vetëm në rast të tërheqjes nga prindi tjetër. Megjithatë, Qeveria pranoi që gjendja dispozitat ligjore deri më 31 janar 2013 krijonin një disavantazh për ankuesin në lidhje me kërkesën e tij për kujdestari të përbashkët. Pasi që nëna nuk pranoi kujdestarinë e përbashkët, gjykatat vendase nuk mund të shqyrtonin nëse kujdestaria e përbashkët mund të ishte në interesin më të mirë të fëmijëve. Qeveria shtoi se pas ndryshimeve ligjore ankuesi mund të aplikonte për kujdestari të përbashkët edhe pa aprovimin e nënës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata ripërsërit se Neni 14 nuk mund të shqyrtohet si i vetëm dhe shyrtohet në raport me pretendimet për shkelje të Neneve të tjera. Si pasojë gjykata duhet të shqyrtoj nëse faktet e rastit bien në fushëveprimin e Nenit 8 të Konventës.

Në rastin konkret, Gjykata vëren se ankuesi dhe fëmijët e tij nuk pasur bashkëjetesë të përhershme, por kanë kaluar rregullisht fundjavat së bashku. Gjykata konsideron se në

rrethana të tilla marrëdhënia e ankuesit me fëmijët e tij përbente "jetë familjare", një fakt që për më tepër nuk kontestohet nga palëve. Prandaj, Gjykata konstaton se faktet e çështjes në fjalë bien në kuadër të nenit 8 të Konventës dhe se, në përputhje me rrethanat, neni 14 është i zbatueshëm.

Sa i përket pjesës së parë të ankesës, lidhur me trajtimin e babait në mënyrë diskriminuese ndaj nënës, Gjykata vëren se ka gjetur tashmë në rastet të ngjashme *Zaunegger* dhe *Sporer*⁸⁰ që në pikëpamje të situatave të ndryshme jetësore në të cilën lindin fëmijët nga prindër të cilëve nuk janë të martuar, dhe në mungesë të një marrëveshjeje për kujdestarinë e përbashkët, ishte e justifikueshme ti atribuonte autoritetin prindëror mbi fëmijën fillimisht nënës, me qëllim që të sigurohej se kishte një person në lindje, i cili do të vepronte për fëmijën në mënyrë të detyrueshme ligjërish. Gjykata nuk sheh ndonjë arsye për të ardhur në një përfundim tjetër në rastin në fjalë.

Lidhur me ankesën e ankuesit lidhur me refuzimin e kujdestarisë së përbashkët, Gjykata përsërit se në dy rastet e lartpërmendura, të cilat ngritën çështje shumë të ngjashme me rastin në fjalë, ka gjetur shkelje të nenit 14 të marrë në lidhje me nenin 8 të Konventës. Në *Sporer*, Gjykata konstatoi se kishte një ndryshim në trajtim sipas ligjit austriak lidhur me atributin e kujdestarisë tek babai i një fëmije të lindur jashtë martesë, në krahasim me nënën.

Gjykata vëren se ligji austriak autoriteti prindëror mbi një fëmijë të lindur jashtë martesës i atribuohet nënës, nëse të dy prindërit nuk kanë pranuar të bëjnë një kërkesë për kujdestarinë e përbashkët. Në mungesë të pëlqimit të nënës, ligji austriak në kohën përkatëse nuk parashihte një ekzaminim gjyqësor në lidhje me atë nëse atribuimi i kujdestarisë së përbashkët do të shërbente në interesin më të mirë të fëmijës dhe as nuk lejonte ekzaminimin, në rast se kujdestaria e përbashkët ishte kundër interesave të fëmijës, nëse interesat e fëmijës u shërbenin më mirë duke dhënë vetëm nënën ose babanë kujdestarinë e vet. Kështu, mundësia e vetëm e një babai për të marrë kujdestarinë e fëmijës do të ishte përmes një kërkesë për kujdestarinë e vetme, por sic kishte konstatuar Gjykata në rastin *Sporer* kujdestaria mund t'i jepej babait në këto raste vetëm nëse nëna rrezikoi mirëqenien e fëmijës. Gjykata konkludoi në atë rast se nuk kishte arsye të mjaftueshme për të justifikuar një trajtim të ndryshëm për baballarët e fëmijëve të lindur jashtë martesë të cilët kurrë nuk kishin marrë kujdestari të përbashkët dhe gjeti shkelje të nenit 14 të marrë në lidhje me nenin 8 të Konventës.

Gjykata vëren se ankuesi në rastin në fjalë ishte në një situatë të krahasueshme me ankuesin në rastin *Sporer* dhe se kuadri i njëjtë ligjor ishte i zbatueshëm për kërkesat e tij për kujdestarinë e fëmijëve të tij. Fëmijët e ankuesit kanë lindur jashtë martesë, kështu që ai nuk kishte mundësi të merrte kujdestarinë e përbashkët, pasi kjo nuk ishte parashikuar nga ligji dhe gjithashtu nuk kishte mundësi të merrte kujdestarinë si i vetëm, pasi gjykatat vendore konsideronin se nëna e fëmijëve të tij nuk rrezikonte mirëqenien e tyre.

Gjykata prandaj konstaton se në rastin në fjalë, sikurse në rastet e mëhershme ka pasur shkelje të nenit 14 të marrë në lidhje me nenin 8 të Konventës.

⁸⁰ *Zaunegger kundër Germanisë* nr. 22028/04, § 34, 3 Dhjetor 2009; *Sporer kundër Austrisë* nr. 35637/03, §§ 37-38, 3 Shkurt 2011

Duke pasur parasysh këtë konkluzion, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të përcaktojë nëse ka pasur gjithashtu një shkelje të nenit 8 të Konventës të marrë si i vetëm.

Gjykata i akordon ankuesit vlerën prej 5,000 EUR për dëmet jomateriale.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 14 në ndërlidhje me me Nenin 8; dhe nuk e sheh të nevojshme të shqyrtojë pretendimet nën Nenin 8 ti të vetëm [njëzëri].

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 14

Diferenca në trajtimin e fëmijëve të ligjshëm dhe të paligjshëm në rastin e trashëgimisë paraqet diskriminim / *ka shkelje*

Neni 1 të Protokollit nr. 1

Shkelje e të drejtës në pronë si pasojë e aplikimit të legjislacionit që bën dallim në mes të fëmijës martesor dhe atij jomartesor / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: trashëgimi / pasuri / legjislacion në fuqi / fëmijë jashtëmartesor / pasuri më e ulët / diskriminim /

Ankuesi: z. Claude Mazurek, shtetas francez i lindur në Avignon në vitin 1942 dhe jeton në La Grande-Motte

Faktet e rastit

Nëna e ankuesit vdiq më 1 gusht 1990 nga encefalopati i HIV (virusi i imunitetit të njeriut), pasi ishte infektuar pas një transfuzioni të gjakut. Ajo la dy fëmijë: një djalë, Alain, i lindur jashtë martese në vitin 1936 dhe legjitimuar nga martesa e nënës së tij më 1937, dhe ankuesin, i lindur në vitin 1942, në certifikatën e lindjes së të cilit figuron vetëm emri i nënës së tij. Më 30 prill 1991, Alain ngriti një padi kundër ankuesit në tribunalin e gjykatës Nîmes duke kërkuar një urdhër që do të përcaktonte se pasuria e nënës së tij do të ndahej nga një noter, në atë mënyrë që ankuesi, si një fëmijë jolegjitim (i lindur jashtë martese) të mos ketë mundësi të kërkojë më tepër se gjysmën e pasurisë që i takon fëmijës së ligjshëm (martesor) nga pasuria e Nënës së tyre. Në parashtrimet e tij, ankuesi ra dakord për emërimin e një noteri për ndarjen e pasurisë, por argumentoi se Neni 760 i Kodit Civil, i cili kufizon të drejtat e trashëgimisë të fëmijëve të jashtëligjshëm ishte diskriminues dhe i papajtueshëm me Nenet 8 dhe 14 të Konventës, dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Nenin 334 të Kodit Civil, që përmbante parimin që fëmijët e lindur në martesë dhe fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta. Ai kërkoi nga gjykata të mbante se kishte të njëjtat të drejta në trashëgimi si një fëmijë legjitim. Ai gjithashtu pohoi se shuma që i ishte kërkuar të depozitohej tek noteri i ishte transferuar atij si një dhuratë nga nëna e tij.

Në një aktgjykim të datës 21 janar 1993 gjykata vendore urdhëroi ndarjen e pasurisë. Lidhur me të drejtat e ankuesit, ajo iu referua Neni 760 të Kodit Civil. Kjo gjykatë pranoi se Neni 760 i Kodit Civil paraqiste një shmangie nga parimi, i përcaktuar në paragrafin e parë të Neni 334 të Kodit Civil, që fëmijët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pavarësisht prejardhjes, por pohuan se qëllimi i saj nuk ishte të bënte dallime ndërmjet fëmijëve në bazë të lindjes së tyre, por për të siguruar pajtueshmëri minimale me angazhimet martesore nga ana e prindit të martuar që sjell në jetë një fëmijë të

paligjshëm. Rrjedhimisht, gjykata arriti në përfundimin se Neni 760 ishte i domosdoshëm për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve dhe se ishte një parim i politikës publike që nuk ishte në kundërshtim me Konventën.

Në lidhje me shumën e cila ishte tërhequr nga ankuesi dhe e transferuar në llogarinë e vet, gjykata e shkallës së parë konstatoi se ankuesi kishte ekzekutuar vetëm qëllimin e nënës së tij për t'i dhënë atij një shumë parash përveç pjesës së tij në pasuri dhe se megjithëse dhurata duhet të merret në konsideratë në llogaritjen e pjesës së disponueshme të pasurisë, ishte e papërshtatshme pasi që duhej të urdhëronin që shumën në fjalë të depozitohej pranë noterit që ndante pasurinë. Ankuesi apeloi, duke argumentuar ndër të tjera se Neni 760 i Kodit Civil ishte i papajtueshëm me Nenin 8 dhe 14 të Konventës dhe Nenin 1 të Protokollit 1. Në një aktgjykim të 24 marsit 1994, Gjykata e Apelit Nîmes mbështeti dispozitat e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me të cilën urdhëroi ndarjen e pasurisë dhe përcaktimin e të drejtave të trashëgimlënësit të ankuesit. Megjithatë, ai konsideroi se shumën e transferuar në llogarinë e ankuesit duhet të kthehej në pasuri për t'u ndarë, sepse ai nuk kishte provuar se nëna e tij e kishte menduar atë si një dhuratë. Ankuesi ka apeluar në Gjykatën e Kasacionit, e cila dha vendimin e saj më 25 qershor 1996 vlerësoi se të drejtat e trashëgimisë nuk kishin të bënin me respektimin e jetës private dhe familjare të garantuara me Nenin 8 të Konventës. Më 14 janar 1994, Komisioni i Fondit të Kompensimit për Pacientët dhe Hemofilikët e Transfuzionit i dha ankuesit, në cilësinë e tij personale, kompensimin prej 40,000 frangave franceze dhe vlerësoi humbjen e të ndjerës në 500,000 FRF, që u paguhet trashëgimtarëve të saj. Kjo shumë do të paguhej tek noteri që merrej me pasurinë dhe ankuesi më pas mori një të katërtën e saj.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi pretendoi se ishte viktimë e shkeljes së Neneve 8 dhe 14 të Konventës dhe të Nenit 1 të Protokollit 1, sepse dispozitat e zbatueshme në ligjin francez civil kufizuan të drejtat e trashëgimisë së tij mbi pasurinë e nënës së tij në krahasim me të drejtat e trashëgimisë së gjysëm vllaut të tij. Ankuesi u ankua se, për shkak të aplikimit nga gjykatat franceze të Nenit 760 të Kodit Civil, atij iu dha një pjesë më e vogël e pasurisë se nënës së tij, sesa pjesa që iu dha gjysmës së vëllait të tij. Parashtruesi i kërkesës deklaroi se edhe vëllai i tij ishte një fëmijë i lindur jashtë martesë, i cili më vonë u legjitimua nga martesë e prindërve të tij. Ai pohoi se dallimi i tërhequr, në lidhje me të drejtat e trashëgimisë, midis një fëmije të lindur jashtë martesë të legjitimuar më pas nga martesë dhe një fëmijë konkurrent nuk e ndoqi një qëllim legjitim. Ai shtoi se edhe nëse kërkohej të mbrohej institucioni tradicional i martesës dhe familjes, dallimi në trajtimin e një fëmije të lindur jashtë martesë në krahasim me një fëmijë të ligjshëm të lindur jashtë martesë ishte i papranueshëm. Kështu, barazia e të drejtave nuk do të pengonte në asnjë mënyrë zgjidhjen e një situate që nuk kishte lindur brenda martesës, por jashtë martesës. Për më tepër, mbrojtja e bashkëshortit jo-kurorëshkelës ishte një çështje e parëndësishme që kur divorci ishte shpallur më 4 korrik 1944. Lidhur me kufirin e vlerësimit të Shtetit, ankuesi argumentoi se nuk ishte paraqitur asnjë bazë ose dëshmi për të justifikuar një rast të veçantë për Francën në fushën e moralit, që të pamundësonte zbatimin e parimit të rigjallërimit të vazhdueshëm të barazisë.

Qeveria në anën tjetër parashtroi se dispozitat e Nenit 760 të Kodit Civil bazoheshin në arsye shumë të forta, të cilat ndoqën një qëllim të ligjshëm dhe përputheshin me marrëdhënien e proporcionalitetit të kërkuar nga Gjykata. Ata shtuan se, sipas jurisprudencës, një dallim ishte diskriminues nëse nuk kishte ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Qeveria theksoi se, në frymën e Ligjit të 3 janarit 1972 që pranonte trajtimin e barabartë të fëmijëve pavarësisht prejardhjes, Neni 760 i Kodit Civil ishte paraqitur si një përjashtim i projektuar për të mbrojtur familjen e ligjshme, duke u bazuar në institucionin e martesës nga i cili rrjedhin të drejtat dhe detyrimet, të tilla si detyra e besnikërisë. Ata gjithashtu pohuan se mjetet e përdorura ishin proporcionale me qëllimin e ndjekur dhe theksuan se shteti kishte një kufi vlerësimi në këtë fushë.

Qeveria e shqyrtoi, *mutatis mutandis*, se mungesa e një qasjeje të përbashkët brenda Këshillit të Evropës duhet të rezultojë në lejimin e një kufiri vlerësimi të mjaftueshëm. Shteteve për t'u lejuar atyre të përcaktojnë masat për të mbrojtur anëtarët e një familje të ligjshme ku ata ishin duke konkurruar me fëmijët jashtëmartesor në pasurinë e prindërve të tyre. Në çdo rast, Qeveria vlerësoi se masat e marra nuk ishin të papërshtatshme krahasuar me qëllimin e ndjekur.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata, para së gjithash, thekson se Neni 1 i Protokollit 1 në thelb garanton të drejtën e pasurisë. Meqenëse nëna e ankuesit tashmë ishte e vdekur, Gjykata vëren se ankuesi kishte fituar automatikisht të drejtat trashëgimore mbi pasurinë e saj sipas Neneve 745, 757 dhe 760 të Kodit Civil Francez. Pasuria ishte pronë e përbashkët e ankuesit dhe gjysmë vëllait të tij. Prandaj, faktet e rastit tërheqin shqyrtimin nën Nenin 1 të Protokollit 1 dhe Nenin 14 i Konventës.

Fillimisht Gjykata shqyrtoi nëse ka pasur një ndryshim në trajtim në mes të dy vëllezërve/fëmijëve. Gjykata vëren në fillim se Qeveria nuk e konteston faktin se, sipas neneve përkatëse të Kodit Civil, dy gjysmë vëllezërit nuk ishin në të njëjtën pozitë në lidhje me pasurinë e nënës së tyre. Gjykata vëren se për shkak të statusit të ankuesit si një fëmijë jashtë martese pjesa e pasurisë se tij u zvogëluar, në favor të gjysmës së vëllait të tij, nga gjysma e pjesës për të cilën do të kishte të drejtë nëse do të ishte një fëmijë i lindur në martesë. Gjykata përsërit në këtë pikë se në gëzimin e të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa, Neni 14 siguron mbrojtje kundër trajtimit të ndryshëm, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata të ngjashme. Prandaj, duhet të përcaktohet nëse diferenca e pretenduar në trajtim ishte e justifikuar.

Gjykata rikujtoi se për qëllimet e Nenit 14 të Konventës, dallimi i trajtimit është diskriminues nëse nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë nëse nuk ndjek një qëllim legjitim" ose nëse nuk ka një "arsye të justifikueshme për të arsyetuar marrëdhëniet e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të kërkuar për t'u realizuar."⁸¹ Gjykata thekson se shtetet anëtare të Këshillit të Evropës i kushtojnë rëndësi të madhe çështjes së barazisë midis fëmijëve të lindur në martesë dhe fëmijëve të lindur jashtë martese sa i përket të drejtave të tyre civile. Kjo është treguar nga Konventa Evropiane e vitit 1975 mbi Statusin Ligjor të Fëmijëve të lindur jashtë

⁸¹ *Karlheinz Schmidt kundër Gjermanisë*, 18 korriku 1994, Seria A jo 291-B, f. 32-33, § 24

kurorës, e cila nuk është ratifikuar nga Franca. Prandaj arsyet shumë të rënda duhet të avancohen përpara se një ndryshim i trajtimit në bazë të lindjes jashtë martesë mund të konsiderohet i pajtueshëm me Konventën⁸² Gjykata konsideron se qëllimi i mbështetur nga Qeveria, përkatësisht mbrojtja e familjes tradicionale, është padyshim legjitim. Gjykata vëren në fillim se institucioni i familjes nuk është fiks, qoftë historikisht, sociologjikisht apo edhe ligjërish. Pra, Akti i 3 janarit 1972 përbën, ndër të tjera, një hap të madh përpara në zhvillimin e ligjit familjar dhe pozitën e fëmijëve të lindur jashtë martesë, pasi që zgjidhte çështjen e përcaktimit të prejardhjes së të gjithë fëmijëve. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, e cila përmbante ndalimin e diskriminimit në bazë të lindjes, u miratua më 20 nëntor 1989. Më pas, në maj të vitit 1990, Conseil d'Etat botoi një raport që rekomandon, në dritën e të dhënave socio-demografike, heqjen e diskriminimit ndaj fëmijëve adulterorë në çështjet e trashëgimisë. Në dhjetor të vitit 1991 një projektligj propozoi që të drejtat e trashëgimisë së fëmijëve jashtë-martesor të ishin në përputhje me ato të fëmijëve të tjerë. Ministri i Drejtësisë krijoi dy projekte, të cilat u hartuan për të studiuar ndërrime në modelet familjare nga këndvështrimi sociologjik dhe tjetri për të shqyrtuar ndryshimet e mundshme në ligj në dritën e zhvillimeve faktike. Raporti i parë, i paraqitur më 14 maj 1998, kritikon, ndërsa raporti i dytë, i dorëzuar më 14 shtator 1999, rekomandoi heqjen e kufizimeve për të drejtat e trashëgimisë së fëmijëve jashtëmartesor.

Në lidhje me situatën në shtetet e tjera anëtare të Këshillit të Evropës, Gjykata vëren, në kundërshtim me pohimet e Qeverisë një tendencë të veçantë në favor të çrënjosjes së diskriminimit ndaj fëmijëve jashtëmartesor. Në lidhje me argumentin bazuar në dimensionin moral të çështjes, Gjykata nuk mund të marrë parasysh gjetjet socio-demografike në kohën materiale dhe, ndër të tjera, projektligjin e vitit 1991 që rekomandon heqjen e të gjitha formave të diskriminimit. Sidoqoftë Nuk është detyrë e Gjykatës të vendosë nëse nëna e ankuesit kishte ose nuk kishte shkelur angazhimet e lidhura me martesën e saj në lidhje me njësinë e ligjshme familjare. Ajo thjesht vë në dukje se nëna e ankuesit dhe bashkëshorti i saj jetonin veçmas kur ankuesi kishte lindur dhe se ata u divorcuan shumë shpejt pas kësaj. Çështja e vetme e paraqitur në Gjykatë ka të bëjë me çështjen e trashëgimit nga nëna nga dy fëmijët e saj, ku njëri është i lindur jashtë martesë. Gjykata nuk gjen ndonjë bazë në rastin në fjalë për të justifikuar diskriminimin në bazë të lindjes jashtë martesë. Në të kundërtën, Gjykata mban se një fëmijë jashtë martesë nuk mund të akuzohet për rrethana për të cilat ai ose ajo nuk është përgjegjës. Është një zbulim i pashmangshëm që ankuesi është ndëshkuar, për shkak të statusit të tij si një fëmijë jashtë martesë, në ndarjen e pasurisë. Duke marrë parasysh të gjitha sa më sipër, Gjykata konkludon se nuk kishte një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur. Prandaj, ka pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të marrë në lidhje me Nenin 14 të Konventës.

Në lidhje me pretendimet e shkeljes së Nenit 8 të Konventës në kombinim me Nenin 14 Gjykata konsideron është e panevojshme për shqyrtim. Gjykata konstaton se shteti i

⁸² *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 28 Maj 1985, Seria A nr. 94, f. 37-38, § 78

paditur duhet të paguajë ankuesin, (i) 376,034.61 FRF në lidhje me dëmin material dhe 20,000 FRF në lidhje me dëmin jomaterial; si dhe dhe 100,000 FRF (njëqind mijë franga franceze) në lidhje me shpenzimet dhe shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 1 të Protokollit 1 në kombinim me Nenin 14 të Konventës; dhe se është e panevojshme të shqyrtoj pretendimet lidhur me Nenin 8 në kombinim me Nenin 14 [njëzëri].

Di Trizio kundër Zvicrës - 7186/09

2 shkurt 2016 [Seksioni i Dytë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 14 ndërlidhur me Nenin 8

Diskriminim në përfitimet e pensionit invalidor mbi baza gjinore në raport me pozitën në familje / ka shkelje

Fjalët kyçe: pengesa shëndetësore / pension invalidor / lindje / grua / punë shtëpie / kujdes për fëmijë / orar i pjesshëm / pension i kombinuar / disavantazh / diskriminim / përfitim i ulët

Ankuesja: Vita Maria di Trizio, shtetase italiane, e lindur në vitin 1977 dhe jetonte në Rapperswil-Jona, në Kantonin e St Gall (Zvicër)

Faktet e rastit

Ankuesja, duhej të linte punën e saj si shitëse me kohë të plotë në qershor të vitit 2002 për shkak të problemeve me shpinë. Në tetor të vitit 2003 ajo aplikoi në Zyrën për Sigurimin e Aftësisë së Kufizuar (tani e tutje "Zyra") për kompensim invalidor. Në shkurt të vitit 2004, ajo lindi binjakë dhe si pasojë vuajti dhimbje më të forta të shpinës. Gjatë vlerësimit të nevojave shtëpiake të familjes së saj, ankuesja deklaroi në veçanti se për arsye financiare ajo do të duhej të vazhdonte të punonte me kohë të pjesshme pas lindjes së fëmijëve të saj. Raporti i vlerësimit arriti në përfundimin se kapaciteti i ankueses për të kryer detyra shtëpiake u zvogëlua për 44.6%.

Në një vendim të datës 26 maj 2006, Zyra konstatoi se ankuesja kishte qenë në punë me orar të plotë deri në fund të vitit 2003, kishte qenë shtëpiake nga janari deri në maj të vitit 2004 dhe kishte vendosur që të punonte me orar të pjesshëm nga qershori i vitit 2004 e në vazhdim ashtu që t'i kushtonte kohë kujdesit për shtëpinë dhe fëmijët e saj. Zyra i pagoi ankueses kompensim invalidor për periudhën prej 1 qershorit 2003 deri më 31 gusht 2004, dhe vendosi që ajo të mos kualifikohej për asnjë kompensim përtej kësaj periudhe. Zyra mori në konsideratë që ankuesja në çdo rast nuk do të kishte rifilluar punën e rregullt pas lindjes së fëmijëve të saj, duke deklaruar se ajo dëshironte të kushtonte një pjesë të kohës së saj në drejtimin e familjes.

Pas ankimit të pasuksesshëm në Zyrë, ankuesja u ankua në Gjykatën e Sigurimeve të Kantonit të Shën Gallit, e cila gjykatë lejoi pjesërisht kërkesat e saj. Gjykata konsideroi se shkalla e aftësisë së kufizuar së ankueses ishte vendosur në bazë të një sërë faktesh të paplota. Prandaj, kjo gjykatë e ktheu lëndën për hetime të mëtejshme në Zyrë. Zyra kishte apeluar kundër këtij vendimi të Gjykatës së Sigurimeve në Gjykatën Federale. Në arsyetimin e saj, Gjykata Federale vërejti se qëllimi i sigurimit të aftësisë së kufizuar ishte të siguronte individët nga rreziku për t'u bërë të paaftë - për arsye mjekësore - të angazhoheshin në punësim të paguar ose të kryenin detyra rutinë shtëpiake. Qëllimi nuk ishte të ofronte kompensim në lidhje me aktivitetet që personi i siguruar nuk do të kishte bërë kurrë edhe nëse ai ose ajo nuk kishte pasur aftësi të kufizuara. Së fundi, metoda e kombinuar kishte për qëllim të parandalonte të gjithë

njerëzit që e aftë dhe ata që nuk kishin punuar kurrë më parë, për të pretenduar përfitime bazuar në aftësinë e kufizuar edhe pse ata ndoshta nuk do të kishin punuar kurrë edhe pa aftësi të kufizuara. Sipas pikëpamjes së Gjykatës Federale, metoda e kombinuar nuk krijoi ndonjë diskriminim. Prandaj, kjo gjykatë vlerësoi se ankuesjanuk kishte të drejtë për kompensim invalidor.

Përmbledhje e pretendimeve

Duke u bazuar në Nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), ankuesja u ankua kryesisht për faktin se shkalla e saj e aftësisë së kufizuar ishte llogaritur duke zbatuar "metodën e kombinuar", e cila kishte rezultuar në ndalimin e pagesës së kompensimit invalidor për shkak se ajo punonte me orar të pjesshëm. Sipas ankuses, metoda bazohej në supozimin shumë tradicional se vetëm një partner në çift, më shpesh burri, do të bartte një profesion që paguhet, ndërsa partneri tjetër do të ishte angazhuar me orar të plotë në kujdesin për familjen dhe fëmijët. Në anën tjetër, qeveria zvicrane ka parashtruar se në kuadër të kësaj metode, personi i siguar do të duhej të bënte një zgjedhje, para se të llogaritej përfitimi, se si do të organizohej shpërndarja e detyrave nëse ai ose ajo do të ishin në shëndet të mirë. Duke u bazuar edhe në Nenin 14 (ndalimi i diskriminimit), i ndërlidhur me Nenin 6 (e drejta për gjykim të drejtë) dhe me Nenin 8 të Konventës, ajo u ankua për diskriminim në bazë të gjinisë së saj, pasi që legjislacioni në fuqi, në shumicën dërrmuese të rasteve ka prekur gratë pas lindjes së fëmijëve të tyre. Sipas Nenit 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme), ajo u ankua edhe për disa aspekte të procedurës së brendshme.

Arsyetimi i Gjykatës

Sa i përket mbrojtjes kundër diskriminimit, Gjykata përsëriti se Neni 14 vetëm plotëson dispozitat e tjera substanciale të Konventës dhe Protokolleve të saj. Ky nen nuk ka ekzistencë të pavarur, sepse ajo ka efekt vetëm në lidhje me "gëzimin e të drejtave dhe lirive" të mbrojtura nga këto dispozita. Zbatimi i Nenit 14 nuk nënkupton domosdoshmërisht shkeljen e një prej të drejtave substantive të mbrojtura nga Konventa. Është e nevojshme por edhe e mjaftueshme që faktet e rastit të bien "brenda kuadrit" të një ose më shumë Neneve të Konventës ose Protokolleve të saj.

Gjykata vëren se masa që i mundësojnë një prindi të qëndrojë në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët, promovon jetën familjare dhe kështu ka ndikuar në mënyrën se si është organizuar; masa të tilla ishin brenda fushës së Nenit 8. Rasti aktual gjithashtu kishte të bënte me çështje që lidhen me organizimin e jetës familjare, edhe pse në një mënyrë tjetër. Statistikat në dispozicion treguan se metoda e kombinuar, në shumicën e rasteve, kishte të bënte me gratë që dëshironin të punonin me kohë të pjesshme pas lindjes së fëmijëve të tyre. Në gjykimin e rastit të ankuses, Gjykata Federale kishte pranuar se metoda e kombinuar në disa raste mund të rezultojë në humbjen e kompensimit, veçanërisht për gratë që punonin me kohë të pjesshme pas lindjes së fëmijëve të tyre. Aplikimi i metodës së kombinuar tek ankuesja kishte ndikuar te ajo dhe bashkëshorti i saj në vendosjen e mënyrës së ndarjes së detyrave brenda familjes dhe, rrjedhimisht, ka pasur ndikim në organizimin e jetës familjare dhe karrierës.

Për më tepër, Gjykata Federale kishte pranuar në mënyrë eksplicite se metoda e kombinuar mund të kishte pasojë negative për individët që punonin me kohë të

pjesshme për arsye familjare, nëse ata paaftësohen/ bëhen me aftësi të kufizuara. Këto konsiderata ishin të mjaftueshme që Gjykata të konstatonte se ankesa hynte në kuadër të Nenit 8, nën nocionin e "jetës familjare". Gjithashtu, aspekti i "jetës private" të Nenit 8 hyri në lojë për atë që garantoj të drejtën për zhvillimin personal dhe autonominë. Në masën që metoda e kombinuar ka vendosur personat që dëshirojnë të punojnë me orar të pjesshëm në një disavantazh krahasuar me ata që punojnë me kohë të plotë dhe ata që nuk punojnë fare, nuk mund të përjashtohet mundësia se kjo metodë e llogaritjes së përfitimeve të aftësisë së kufizuar do të kufizonte kategorinë e parë të personave në zgjedhjen e tyre se si të ndajnë jetën e tyre private midis punës, detyrave shtëpiake dhe kujdesit për fëmijët e tyre.

Shumica dërrmuese e njerëzve të prekur nga metoda e kombinuar ishin gratë që dëshironin të reduktonin orarin e punës pas lindjes së një fëmije. Rrjedhimisht, ankuesi mund të pretendojë të jetë viktimë e diskriminimit në baza gjinore. Pra, Neni 14 i ndërlidhur me Nenin 8 ishte gjithashtu i zbatueshëm. Nuk ishte e nevojshme të konstatohej nëse refuzimi i dhënies së ndihmës për invalidë gjithashtu përbënte diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.

Lidhur me pretendimet për shkele të Nenit 14 të ndërlidhur me Nenin 8 të Konventës, Gjykata fillimisht analizon ekzistencën e një prezumimi të diskriminimit të tërthortë në rastin aktual. Gjykata vëren se në vitin 2009 metoda e kombinuar ishte zbatuar në 7.5% të të gjitha vendimeve mbi përfitimin e aftësisë së kufizuar. Nga këto raste, 97% kishin të bëjnë me gratë. Këto shifra mund të konsiderohen mjaftueshmërisht të besueshme, si dhe tregojnë prezumim të diskriminimit indirekt. Si rregull, Gjykata përsëriti se një dallim në trajtim është diskriminues nëse nuk ka arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë nëse nuk ndjek një "qëllim legjitim" ose nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

Qëllimi i sigurimit të aftësisë së kufizuar ishte të siguronte individët kundër rrezikut për t'u bërë të paaftë, pasi që për shkak të aftësisë së kufizuar, ata do të angazhoheshin në punësim të paguar ose do të kryenin detyra rutinore të cilat ata do të kishin qenë në gjendje t'i kryenin më parë dhe të cilat ata do të jenë ende në gjendje t'i kryejnë nëse do të kishin mbetur në shëndet të mirë. Kjo përbënte një qëllim të ligjshëm të aftë për të justifikuar dallimet e vërejtura. Në vetvete, ajo ishte në përputhje me thelbin dhe kufizimet e një skeme të tillë sigurimi, e cila kishte burime të kufizuara dhe një nga parimet udhëzuese të së cilës duhej të ishte kontrolli i shpenzimeve. Sidoqoftë, ky qëllim duhej të vlerësohej në parimin e barazisë gjinore. Arsye shumë të forta duhet të paraqiten para se një dallim në trajtim bazuar në gjini mund të konsiderohet si i pajtueshëm me Konventën. Prandaj, margjina e vlerësimit të autoriteteve zvicerane ishte shumë e ngushtë.

Gjykata vuri në dukje se ankuesja fillimisht kishte punuar me orar të plotë dhe kishte qenë e detyruar të heqë dorë nga puna në qershor të vitit 2002 për shkak të problemeve të shpinës. Asaj i ishte njohur paaftësia prej 50% gjatë periudhës nga qershori 2003 deri në lindjen e binjakëve të saj dhe kishte marrë kompensim invalidor për periudhën prej 1 qershorit 2003 deri më 31 gusht 2004. Ky kompensim invalidor më pas u ndalua për shkak të aplikimit të "metodës së kombinuar", e cila supozonte se, siç e kishte

deklaruar ajo vetë “ajo nuk do të kishte punuar me orar të plotë pas lindjes së fëmijëve të saj edhe nëse ajo nuk do të kishte pasur ndonjë paaftësi”.

Nëse ankuesja do të kishte punuar me orar të plotë ose do t’ia kushtonte kohën e saj tërësisht detyrave shtëpiake, ajo do të merrte kompensim të pjesshëm invalidor. Rrjedhimisht, vendimi që refuzonte të drejtën e saj për kompensim ishte bazuar në pohimin e saj se ajo dëshironte të reduktojë orarin e saj të punës në mënyrë që të kujdeset për fëmijët e saj dhe shtëpinë e saj. Në praktikë, për shumicën e madhe të grave që dëshironin të punonin me kohë të pjesshme pas lindjes së fëmijëve të tyre, metoda e kombinuar ishte burim diskriminimi.

Për më tepër, aplikimi i metodës së kombinuar ka qenë subjekt i kritikave për disa kohë nga autoritetet dhe komentatorët e caktuar vendas. Këto ishin tregues të qartë për një ndërgjegjësim në rritje se metoda e kombinuar nuk ishte më në përputhje me përpjekjet për të arritur barazinë gjinore në shoqërinë bashkëkohore, në të cilën gratë kërkonin legjitimisht gjithnjë e më shumë balancimin e jetës familjare me karrierën. Për më tepër, metodat alternative të llogaritjes ishin të mundshme, të cilat do të merrnin më shumë parasysh zgjedhjen e grave për të punuar me kohë të pjesshme pas lindjes së një fëmije. Kjo do të bënte të mundur ndjekjen e qëllimit për barazi gjinore më të madhe pa rrezikuar qëllimin e sigurimit të paaftësisë.

Përveç këtyre argumenteve të përgjithshme, refuzimi për t’i dhënë ankuesit të paktën kompensim të pjesshëm invalidor, kishte pasoja të rëndësishme praktike për të, madje duke supozuar që ajo të mund të punonte me kohë të pjesshme. Duke marrë parasysh këtë, nuk kishte pasur asnjë justifikim të arsyeshëm për dallimin në trajtim ndaj të cilit ankuesja ishte nënshtruar. Andaj, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të Nenit 14 të ndërlidhur me Nenin 8 të Konventës.

Gjykata vendosi se nuk është e nevojshme të shqyrtohet veçmas ankesa e cila pretendon shkelje të Nenit 14 të ndërlidhur me Nenin 6 ose shkelje të Nenit 6.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 14 të ndërlidhur me Nenin 8 të Konventës; shpall pjesën tjetër të pretendimeve si të panevojshme për shqyrtim [*me katër vota për dhe tri kundër*].

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 14 i lexuar bashkërisht me Nenin 2 të Protokollit 1.

Pretendim për diskriminim si pasojë e refuzimi për tu pranuar në Akademinë Kombëtare të Muzikës si rezultat i faktit të të qenurit e verbër, duke mos shqyrtuar mundësinë e akomodimit të paaftësisë së saj / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *edukim / detyrim i shtetit / verbër / pengesa fizike / mos pranim / shkollë muzike / arsye administrative / diskriminim / kushte të barabarta*

Ankuesja: Ceyda Evrim Çam, shtetase turke, e lindur në vitin 1989, dhe jeton në Stamboll

Faktet e rastit

Në vitin 2004, ankuesja, e cila është e verbër, ka kaluar testin e pranimit për Akademinë Kombëtare Turke të Muzikës, pjesë e Universitetit Teknik të Stambollit. Si pjesë e procedurave të pranimit, një komision nga spitali Bakırköy kishte hartuar një raport mjekësor që vinte në përfundim se ajo mund të merrte mësim në seksionet e akademisë së muzikës ku nuk kërkohej të pamurit.

Duke deklaruar se asnjë nga seksionet e akademisë nuk mund të konsiderohet se nuk kërkon shikim ose të pamur, Akademia e Muzikës kishte kërkuar nga zyrtari kryesor i spitalit që të hartonte një raport të ri për të sqaruar nëse, si rezultat i kësaj deklaratë, zonjusha e re do të mund të vijonte mësimet në Akademi të Muzikës. Akademia, gjithashtu, kishte refuzuar regjistrimin e ankueses.

Prindërit e ankueses, në emër të saj, kishin kërkuar nga Gjykata Administrative e Stambollit që të anulonte vendimin e Universitetit Teknik të Stambollit. Gjykata kishte lënë në fuqi vendimin e administratës së universitetit mbi bazën se ankuesja nuk kishte ofruar një raport nga një spital publik që deklaronte se ajo ishte plotësisht në gjendje për të qenë studente në Akademinë e Muzikës. Ankuesja dhe prindërit e kishin apeluar vendimin në Gjykatën Supreme Administrative të Turqisë, e cila kishte hedhur poshtë apelimin. Ata kishin bërë kërkesa paralele për të ndaluar ekzekutimin e vendimit në lidhje me aplikimin për regjistrim, pa sukses. Po ashtu, ata kishin paraqitur ankesë, ndonëse pa sukses, edhe kundër Spitalit Bakırköy, i cili ndërkohë kishte plotësuar raportin mjekësor dhe deklaronte përfundimisht se ankuesja nuk ishte në gjendje të përshtatshme për të vijuar Akademinë e Muzikës.

Duke u mbështetur në Nenin 2 të Protokollit Nr. 1 (e drejta për arsim), ankuesja ishte ankuar për shkelje të së drejtës së saj në arsim, me arsyetimin se shteti kishte dështuar t'i ofronte personave me aftësi të kufizuara të njëjtat mundësi sikurse të tjerëve. Ajo, po ashtu, ka deklaruar se është diskriminuar mbi bazë të verbërisë së saj, në shkelje të Nenit 14 të Konventës (ndalimi i diskriminimit).

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesja ka paraqitur ankesë për shkelje të së drejtës së saj për arsim. Ajo ka kontestuar argumentin se të pamurit është kërkuar për regjistrim në Akademi të Muzikës, duke theksuar se një kërkesë e tillë është në kundërshtim me të drejtën në arsim. Ajo më tej ka argumentuar se shteti nuk ka respektuar detyrimin e tij pozitiv për t'u ofruar personave me aftësi të kufizuara të njëjtat mundësi sikurse edhe të gjithë të tjerëve. Në pretendimet dhe argumentet e saj, ajo është mbështetur në Nenin 2 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, që ka këtë përmbajtje:

“Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.”

Ankuesja, gjithashtu, është ankuar se ajo ka është trajtuar në mënyrë diskriminuese mbi bazë të verbërisë së saj, në shkelje të Nenit 14 të Konventës.

Qeveria, nga ana e saj, ka kontestuar këto pretendime. Ajo u është referuar rregullave të pranimit dhe regjistrimit në kolegji. Sipas Qeverisë, rregullat e procedurës së Akademisë së Muzikës kanë qenë legjitime dhe të parashikueshme; tutje, se kriteret procedurale kanë qenë të publikuara dhe të qasshme për publikun, dhe se ato nuk kanë përmbajtje dispozita shprehimore që përjashtojnë personat e verbër, diçka që do të përbënte diskriminim të qartë të kësaj kategorie të personave.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata ka vënë re, si fillim, se legjislacioni në fuqi në kohën përkatëse ka përcaktuar se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtën në arsim, pa diskriminim. Gjithashtu, ka vënë re se përjashtimi i ankuesja është mbështetur në rregullat e procedurës së Akademisë, që kërkojnë lëshimin e një certifikate mjekësore të përshtatshmërisë fizike për të ndjekur mësimet në akademi.

Ndonëse këto rregulla të procedurës nuk përjashtonin personat e verbër dhe të gjitha personat kërkohej që të paraqisnin certifikatat, Gjykata ka vlerësuar se ajo nuk mund të anashkalojë efektet e një kërkesë të tillë tek personat që vuanë nga paaftësi fizike, sikurse në rastin e ankuesja. Më tej, Gjykata ka shtuar se ankuesja në fakt ka paraqitur certifikatën e përshtatshmërisë fizike, me përmbajtje të një rezervimi rreth verbërisë së saj, por Akademia e Muzikës e refuzuar atë, dhe madje ka kërkuar ndryshimin e saj nga zyrtari mjekësor i spitalit. Për pasojë, edhe pse Akademia e Muzikës ka bërë përpjekje që të justifikojë refuzimin për regjistrim të ankueses mbi bazën e dështimit të saj për t'u sjellë në pajtim me formalitetet e nevojshme administrative, sidomos në lidhje me certifikatën mjekësore, Gjykata ka vlerësuar se verbëria e ankueses ka qenë arsyeja e vetme e refuzimit.

Për më tepër, Gjykata ka vlerësuar se fakti që ka kaluar provimin pranues, e që ka qenë parakusht për çfarëdo kërkesë për regjistrim, ankuesja ka dëshmuar se ajo ka qenë plotësisht e kualifikuar për regjistrim në Akademinë Kombëtare të Muzikës.

Si pasojë e mungesës së infrastrukturës së përshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara, dhe duke vlerësuar se diskriminimi mbi bazë të paaftësisë përfshinë refuzimin për të bërë akomodime të arsyeshme për paaftësinë e saj, Gjykata ka gjetur se autoritetet kombëtare nuk kanë bërë përpjekje që të identifikojnë nevojat e ankueses

dhe ka dështuar të shpjegojnë se si verbëria e saj ja parandalon ndjekjen e mësimëve të muzikës. Gjithashtu, Gjykata ka vërejtur se Akademia nuk ka bërë asfarë përpjekjesh për t'ua përshtatur mësimet studentëve të verbër. Si rezultat, Gjykata ka ardhur në përfundimin se refuzimi për të regjistruar ankuesen, që ka qenë i mbështetur vetëm në verbërinë e saj, ka qenë i lidhur edhe me faktin se autoritetet kombëtare nuk e kanë shqyrtuar asnjëherë mundësinë për të bërë akomodime të arsyeshme për paaftësinë e saj.

Përfundimisht, Gjykata ka vlerësuar se ankueses i është mohuar, pa ndonjë justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, përfitimi nga arsimimi muzikor, dhe kësisoji ka gjetur shkelje të Nenit 14 të Konventës, i lexuar bashkërisht me Nenin 2 të Protokollit Nr. 1.

Në dritën e gjetjes së shkeljes së Nenit 14, Gjykata e ka vlerësuar të panevojshme që të shqyrtojë ankesën edhe mbi bazën e Nenit 2 të Protokollit Nr. 1

Gjykata ka urdhëruar shtetin turk që t'i paguaj ankuesja 10,000 EUR si dëmshpërblim për dëmin jo-material dhe 3,000 EUR në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 14 të Konventës në kombinim me Nenin 2 të Protokollit Nr. 1 [njëzëri].

Neni 15

Derogimi në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme

1. Në rast lufte ose rreziku tjetër publik që i kanoset jetës së kombit, çdo Palë e Lartë Kontraktuese mund të marrë masa që iu shmangen detyrimeve të parashikuara nga kjo Konventë, veçse në shkallën më të vogël që e kërkon situata, me kusht që këto masa të mos jenë të papajtueshme me detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare.
2. Dispozita e mësipërme nuk lejon asnjë shmangie nga Neni 2, me përjashtim të rastit të vdekjes që vjen si pasojë e akteve të ligjshme të luftës ose nga Nenet 3, 4 (paragrafi 1) dhe 7.
3. Çdo Palë e Lartë Kontraktuese, që ushtron këtë të drejtë derogimi, mban plotësisht të informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për të gjitha masat e marra dhe arsyet pse ato janë marrë. Gjithashtu, ajo duhet të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për datën në të cilën këto masa kanë humbur fuqinë dhe dispozitat e Konventës vihen sërish në zbatim të plotë.

Lawless kundër Irlandës - 332/57

1 korrik 1961 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5 dhe 6

Nenet 5 dhe 6 të Konventës nuk kanë dhënë bazë ligjore për ndalimin pa gjyq të ankuesit

Neni 7

Pretendim për shkelje si pasojë e masës së paraburgimit / *nuk ka shkelje*

Neni 15

Masat e ndërmarra nga qeveria ishin rezultat i një situatë të rëndë të sigurisë kur shteteve ju lejohet derogimi nga konventa / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: konflikt / Irlandë Veriore / siguri kombëtare / arrestim / paraburgim / derogim / interes i përgjithshëm

Ankuesi: z. Gerard Richard Lawless, i lindur në vitin 1936, punonte në një ndërmarrje ndërtimi dhe banonte në Dublin

Faktet e rastit

Me 21 shtator 1956, ankuesi u ndalua së bashku me tre burra, në një hangar të braktisur ku policia gjen armë. Gjykata Penale e Qarkut të Dublinit dha vendimin për lirimin e katër të akuzuarve me 23 nëntor 1956. I dyshuar për veprimtari të paligjshme, ankuesi ndalohet përsëri me 14 maj 1957. Gjatë një kontrolli në shtëpinë e tij, u gjet një dokument dorëshkrimor mbi guerilen. Me 16 maj, Gjykata Penale e Qarkut të Dublinit e dënoi me një muaj heqje lirie për këtë fakt, por jo për anëtaresimin në IRA⁸³.

Me 5 korrik 1957, në Gazetën Zyrtare, Qeveria Irlandeze shpall hyrjen në fuqi, që nga 8 korriku, të kompetencave për arrestim dhe paraburgim që u janë dhanë ministrave të shtetit në bazë të Ligjit nr. 2, të vitit 1940, i cili ndryshonte Ligjin e vitit 1939, mbi shkeljet e sigurisë shtetërore. Në zbatim të këtij ligji, Ministri i Drejtësisë, me 12 korrik 1956, nxjerr një vendim për paraburgimin e ankuesit, i cili ishte ndaluar një ditë më parë, kur ai po përpiqej të shkonte në Angli. Ankuesi internohet në një kamp ushtarak, në shoqërinë e pothuaj njëqind personave të tjerë, pa u paraqitur përpara një gjyqtari. Me 10 dhjetor 1956, ai paraqitet përpara Komisionit të paraburgimit: ai zotohet gojarisht se nuk do të merret me asnjë veprimtari të paligjshme sipas kuptimit të legjisllacionit të vitit 1939 dhe 1940. Të nesërmen, Ministri i Drejtësisë urdhëroi lirimin e tij.

⁸³ Që nga themelimi i Shtetit të Lirë Irlandez në vitin 1921, disa grupe të armatosura që u quajtën 'Ushtria Republikane e Irlandës' ('IRA') ishin formuar, me qëllim të dhënies fund të sovranitetit britanik në Irlandën e Veriut nëpërmjet akteve të dhunës.

Ndërkohë, me 11 tetor 1957, Gjykata e Lartë kishte dhënë një vendim që hidhte poshtë një ankimim për shkelje të *Habeas Corpus* të bërë nga i interesuari, i cili apeloj kundër këtij vendimi përpara Gjykatës Supreme, por pa sukses.

Ankuesi iu drejtua Komisionit Evropian të Drejtave të Njeriut me 8 nëntor 1957. Ai pretendonte se Konventa ishte shkelur për shkak të paraburgimit të tij pa një vendim gjykatë, që nga 13 gushti i vitit 1957. Në raportin e tij të 19 dhjetorit 1959, Komisioni konstatoi se Neni 7 nuk gjente zbatim dhe arrin në një përfundim në lidhje me Nenin 15. Sipas tij, përderisa një rrezik publik kërcënonte ekzistencën e shtetit masat e arrestimit dhe të paraburgimit të marra nga Qeveria Irlandeze justifikoheshin nga situata e jashtëzakonshme.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi, pohoi se ndalimi i tij shkeli të drejtën e tij për liri sipas Nenit 5, të drejtën e tij për gjykim të drejtë sipas Nenit 6 dhe ndalimin e ligjit penal retroaktiv sipas Nenit 7.

Në anën tjetër, Qeveria irlandeze argumentoi se veprimet e ankuesi binin nën kushtet e Nenit 17 dhe kështu ai nuk kishte më të drejtë të mbështetej në mbrojtjen e Konventës. Duke iu referuar përgatitjeve *travaux* dhe ndërtimit të Nenit 5 § 3, argumentoi se ndalimi i ankuesi nuk ishte në kundërshtim me Nenin 5, duke pretenduar se sipas Nenit 5 § 1 (c) nuk kishte asnjë detyrim për të sjellë personin e ndaluar para një autoriteti kompetent gjyqësor kur ishte kryer arrestimi për të parandaluar kryerjen e një veprë penale. Po ashtu, Irlanda argumentoi se Neni 6 ishte i parëndësishëm për rastin në fjalë, meqë nuk ishte ngritur aktakuzë kundër ankuesi.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me Nenin 17 të Konventës, Gjykata vlerësoi se ky nen ka një vlerë negative dhe nuk mund të privojë ankuesin nga të drejtat themelore të garantuara me Nenet 5 dhe 6. Në fakt, ankuesi nuk u mbështet në Konventë për të justifikuar ose kryer veprimet në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e garantuara prej saj.

Lidhur me Nenet 5 dhe 6 të Konventës, shtrohet pyetja nëse paraburgimi i ankuesit pa paraqitje në Gjykatë, ishte në kundërshtim me detyrimet e Irlandës në bazë të Nenit 5 dhe 6 të Konventës. Neni 6 nuk merrej parasysh, meqenëse ankuesi nuk iu nënshtrua ndonjë aktakuzë. Për sa i përket Nenit 5, bëhej fjalë vetëm për paragrafin 1 (c) dhe 3. Për Gjykatën ata krijojnë një tërësi dhe kanë një kuptim të qartë dhe natyral: ata imponojnë detyrimin e paraqitjes përpara një gjyqtari, me synimin për të shqyrtuar problemin e heqjes së lirisë ose të një vendimi lidhur me themelin e çështjes, të çdo personi të ndaluar që dyshohet se do të kryejë një veprë penale. Por, ky nuk ishte rasti i ankuesit. Paraburgimi i tij nuk mund të justifikohet në arsyet e paraqitura në Nenin 5 §§ 1 (c) dhe 3.

Lidhur me Nenin 7 të Konventës, se a ishte paraburgimi i a në kundërshtim me detyrimet e Irlandës në bazë të Nenit 7 të Konventës, Gjykata iu përgjigj negativisht kësaj çështje, sepse ky nen i cili ndalonte prapaveprimin e dënimit, ishte i pazbatueshëm në këtë çështje. Paraburgimi i ankuesit përbënte një masë parandaluese dhe nuk mund të konsiderohej si rezultat i një dënimi penal.

Lidhur me Nenin 15 të Konventës, se a bazohej paraburgimi i ankuesi mbi të drejtën e derogimit të shteteve palë të garantuar nga Neni 15 § 1. Gjykata shprehet pozitivisht, pasi kishte verifikuar se tre kushtet e kërkuara nga ky nen ishin plotësuar.

Në radhë të parë, qeveria mund të deklaronte, legjitimisht, se një rrezik publik i kanosej kombit gjatë periudhës në fjalë, në territorin e Republikës së Irlandës pasi që ndodhej një ushtri sekrete që vepronte jashtë kuadrit kushtetues dhe përdorte dhunë për të arritur objektivat e saj; kjo ushtri vepronte edhe jashtë territorit të shtetit, duke vështirësuar kështu marrëdhëniet e këtij të fundit me vendet fqinje; aktivitetet terroriste ishin rritur në mënyre alarmuese që nga vjeshta e vitit 1956 dhe gjatë semestrit të parë të vitit 1957.

Së dyti, paraburgimi pa paraqitje përpara një gjyqtari dukej si një masë që zbatohet vetëm për shkak të vështirësive të kohës. Në fakt, zbatimi i legjislacionit të zakonshëm nuk kishte mundur të frenonte rritjen e rrezikut që i kanosej Republikës në vitin 1957. Funksionimi i gjykatave penale të zakonshme, i gjykatave penale speciale ose i gjykatave ushtarake nuk mjaftonte për të vendosur paqen dhe rendin publik; në veçanti, mbledhja e provave të mjaftueshme për të bindur personat e lidhur me IRA-n dhe grupet e saj disidente ndeshesh me vështirësitë më të mëdha për arsye të karakterit ushtarak dhe sekret të tyre dhe të frikës që ata shkaktonin në popull. Për sa i përket mbylljes së kufirit me Irlandën e Veriut, ky veprim do të sillte për të gjithë popullatën, pasoja shumë të rënda që do të kishin tejkaluar kërkesat e rastit të urgjencës. Për këtë arsye paraburgimi administrativ i personave që dyshoheshin se donin të merrnin pjesë në veprimtari terroriste dukej i justifikueshem. Për më tepër, Gjykata vërejti se Ligji nr. 2 i vitit 1940 parashikonte një sërë garancish kundër abuzimeve: Kontroll i vazhdueshëm i Parlamentit mbi zbatimin e ligjit; krijimi i një komisioni paraburgimi i përbërë nga një oficer dhe dy magjistratë, të cilëve mund t'i drejtohet çdo i parahurgosur; vendimi i këtij komisioni për lirimin e këtij të fundit ishte i detyrueshem për qeverinë. Kjo e fundit i garanton lirimin personit të ndaluar, në qoftë se ai zotohet se do të respektojë ligjin. Së fundi, asnjë element nuk i lejonte Gjykatës që të vlerësonte se masat e marra nga qeveria duke deroguar nga Konventa binin ndesh me detyrimet e tjera që rridhnin nga e drejta ndërkombëtare.

Së fundi, Gjykata dha përgjigje edhe lidhur me çështjen se a përbënte një njoftim të mjaftueshem, letra e dërguar me 20 korrik 1957 nga qeveria, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, në bazë të Nenit 15 § 3 të Konventës. Përsëri, Gjykata dha një përgjigje pohuese. Ajo çmoi se njoftimi ishte bërë pa vonesë dhe se asgjë nuk e pengonte shtetin të shpallte në territorin e tij vendimin e derogimit.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në argumentimin si më lartë, Gjykata arriti në përfundimin se Konventa nuk ishte shkelur.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata hedh poshtë pretendimin në fjalë të nxjerrë nga Qeveria Irlandeze nga Neni 17 të Konventës; thekson se Nenet 5 dhe 6 të Konventës nuk kanë dhënë bazë ligjore për ndalimin pa gjyq të ankuesit; deklaroi se nuk ka pasur shkelje të Nenit 7 të Konventës; Gjykata gjithashtu konstaton se nuk ka shkelje të Nenit 15 të Konventës [*njëzëri*].

Aksoy kundër Turqisë - 21987/93

18 dhjetor 1996 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 15

Qeveria kishte deroguar detyrimet e saj të lejuara sipas Nenit 15 të Konventës përkitazi me zbatimin e Nenit 5 (e drejta për liri dhe siguri) në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme. Në këtë çështje, shtetet gëzojnë marginë të gjerë vlerësimi, ndonëse ky diskrecion nuk është i pakufizuar. I takon Gjykatës që të vendosë nëse shtetet kanë shkuar përtej shkallës së kërkuar në mënyrë strikte nga urgjenca e krizës

Neni 3

Trajtimi i ankuesit, siç është përshkruar, ka qenë i një natyre serioze dhe mizore asisoji që mund të cilësohet si torturë / *ka shkelje*

Neni 5(3)

Ankuesit nuk i ishin ofruar mbrojtjet e nevojshme; në veçanti, mungesa e qasjes te një avokat, mjek, i afërm apo familjar dhe mungesa e ndonjë mundësie realiste për ta sjellë atë para një gjykate për të vlerësuar ligjshmërinë e paraburgimit nënkupton se ai ishte lënë komplet në mëshirën e atyre që e mbanin / *ka shkelje*

Neni 6

Gjykata e kishte parë më të përshtatshme që të shqyronte pretendimin për shkelje të Nenit 6 në kontekst të detyrimit më të përgjithshëm të shteteve sipas Nenit 13, për të ofruar mjete efektive për shkelje të Konventës / *nuk ka shkelje*

Neni 13

Mohim i mjetit efektiv juridik në lidhje me ankesën për torturë si pasojë e me mungesës së hetimeve ndaj keqtrajtimit të tij, si dhe Qasja e një zyrtari shtetëror për të mos filluar hetime, sado që ka qenë nën detyrim për të ndërmarrë hetime, është e barasvlefshme me minimin e efektivitetit të mjeteve juridike që mund të kenë ekzistuar / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *përleshje / gjendje e jashtëzakonshme / arrestim / paraburgim / torturë / pasoja mjekësore / mungesë kujdesi / qasje në avokat / derogim / vdekje /*

Ankuesi: z. Zeki Aksoy, qenë shtetas turk. Ka lindur në vitin 1963 dhe është qëlluar dhe ka vdekur më 1994. Që nga kjo kohë, babai i tij ka shprehur dëshirën që të vazhdojë rastin

Faktet e rastit

Afërsisht nga viti 1985, janë zhvilluar përleshje serioze në Turqinë juglindore ndërmjet forcave të sigurisë dhe anëtarëve të PKK-së (Partisë së Punës së Kurdistanit). Ky

konfrontim deri në kohën e rastit kishte marrë jetët e 4,036 civilëve dhe 3,884 pjesëtarëve të forcave të sigurisë.

Faktet e rastit kanë qenë të diskutueshme. Sipas ankuesit, ai ishte dërguar në paraburgim më 24 nëntor 1992, ndërmjet orës 11 dhe 12 të mesnatës. Rreth njëzet policë kishin shkuar në shtëpinë e tij, të shoqëruar nga një i burgosur me emrin Metin, i cili dyshohet se e ka identifikuar ankuesin si anëtar të PKK-së, pavarësisht se ai u ka thënë policëve se nuk e njeh Metinin.

Qeveria ka deklaruar se ankuesi ishte arrestuar dhe dërguar në paraburgim më 26 nëntor 1992 rreth orës 08:30 të mëngjesit, bashkë me trembëdhjetë të tjerë, të dyshuar për ndihmë dhe mbështetje të terroristëve të PKK-së.

Sipas ankuesit, ai ishte mbyllur në qeli bashkë me dy të tjerë, në një dhomë me përmasa rreth 1.5 x 3 metra. Ai ishte marrë në pyetje rreth asaj se a e njohte Metinin (personin që e kishte identifikuar). Sipas ankuesit, atij i është thënë se “nëse nuk e njeh atë tash, do ta njohësh atë nën torturë”. Gjatë dy ditëve vijuese, ai ka deklaruar se është rrahur vazhdimisht në intervale prej dy orëve ose gjysëm ore. Si rezultat i torturës, ka deklaruar se ka humbur lëvizjen e krahëve dhe të duarve. Ankuesi kishte kërkuar që të shihte një doktor, por kjo i ishte mohuar. Sidoqoftë, më vonë, në dhjetor 1992, e kishte vizituar një doktor. Raporti mjekësor përmbante një fjali, që theksonte se ankuesi nuk kishte shenja të goditjeve ose dhunës. Sipas ankuesit, doktori e kishte pyetur se si i kishte lënduar krahët, për çfarë kishte reaguar polici, duke thënë se kishte pasur aksident.

Ankuesi ishte liruar më 10 dhjetor 1992 dhe disa ditë më vonë ishte shtruar në spital, ku ishte diagnostifikuar me paralizë radiale. Ai i kishte thënë doktorit që e ka trajtuar se ka qenë mbajtur në qeli me duart e lidhura mbrapa shpindës. Ankuesi ishte liruar nga spitali në fund të muajit. Ndërkohë, më 21 dhjetor 1992, prokurori publik kishte vendosur se nuk ka bazë për të filluar procedura penale kundër ankuesit, ndonëse njëmbëdhjetë të tjerëve që ishin burgosur bashkë me të u ishin ngritur aktakuza.

Sa i përket keqtrajtimit të pohuar nga ankuesi, nuk është filluar asnjë procedurë civile apo penale në gjykatat turke.

Ankuesi ishte qëlluar për vdekje më 16 prill 1994. Sipas përfaqësuesve të tij, ai ishte kërcënuar me vdekje në mënyrë që të tërhiqte ankesën e paraqitur në Komisionin Evropian për të Drejtat e Njeriut, kërcënimi i fundit i bërë me telefon më 14 prill 1994. Sipas Qeverisë, ndërkaq, vrasja ka ardhur si rezultat i mosmarrëveshjeve ndërmjet fraksioneve të ndryshme të PKK-së. Një i dyshuar, i supozuar si anëtar i PKK-së, ishte akuzuar për vrasjen.

Përmbledhje e pretendimeve

Në seancat dëgjimore të organizuara nga Gjykata, Qeveria i kishte bërë thirrje Gjykatës që të hidhte poshtë ankesën mbi bazën se nuk janë shterur mjetet e brendshme juridike ose, si alternativë, të gjejë se nuk ka pasur shkelje të Konventës.

Në të njëjtin rast, ankuesi i kishte kërkuar Gjykatës që të gjente shkelje të Neneve 3, 5, 6, 13 dhe 25 të Konventës. Gjithashtu, kishte kërkuar satisfaksion të drejtë sipas Nenit 50 të Konventës. Sa u përket meritave të rastit, ankuesi kishte pretenduar trajtim në kundërshtim me Nenin 3 të Konventës. Qeveria i kishte vlerësuar këto pretendime si të pabazuara. Komisioni, nga ana e tij, kishte gjetur se ankuesi ishte torturuar. Ankuesi

ishte ankuar edhe rreth shkeljes së Nenit 5 të Konventës, që ishte kontestuar nga ana e Qeverisë.

Ankesat tjera përfshijnë shkeljet e Neneve 6 § 1 për mohim të qasjes në gjykatë dhe Nenit 13 për mungesë të mjeteve efektive juridike. Qeveria është kundërpërgjigjur, duke deklaruar se ankuesi asnjëherë nuk ka filluar procedura gjyqësore, prandaj nuk do të duhej të kishte të drejtën e ankesës për mohim të qasjes në drejtësi. Tutje, ka deklaruar se ka pas në dispozicion një sërë mjetesh efektive juridike.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata së pari kishte shqyrtuar çështjen e pretendimeve rreth shterimit ose jo të mjeteve të brendshme juridike. Në këtë kontekst, Gjykata kishte rikujtuar se ankuesi ishte mbajtur në qeli për së paku katërbëdhjetë ditë pa asistencë ose përkrahje ligjore dhe mjekësore. Këto rrethana në vetvete do t'i jepnin atij arsye të ndihej i dobët, i pafuqishëm dhe i shqetësuar ndaj autoriteteve të shtetit. Gjykata kishte ardhur në përfundimin se, në rastin konkret, ekziston rrethana të jashtëzakonshme që e lironin ankuesin nga detyrimi për të shterur mjetet e brendshme juridike.

Sa u përket meritave, Gjykata kishte vendosur që të pranonte gjetjet e faktit të bëra nga Komisioni i të Drejtave të Njeriut, që ekzistonte në atë kohë. Në këtë drejtim, kishte ardhur në përfundimin se trajtimi i ankuesit, siç është përshkruar, ka qenë i një natyre serioze dhe mizore asisoji që mund të cilësohet si torturë. Në këtë pikë, Gjykata kishte gjetur shkelje të Nenit 3.

Sa i përket Nenit 5, Qeveria kishte deroguar detyrimet e saj të lejuara sipas Nenit 15 të Konventës përkitazi me zbatimin e Nenit 5 në kohë emergjence. Në këtë çështje, Gjykata ka deklaruar se shtetet gëzojnë margjinë të gjerë vlerësimi, ndonëse ky diskrecion nuk është i pakufizuar. I takon Gjykatës që të vendosë nëse shtetet kanë shkuar përtej shkallës së kërkuar në mënyrë strikte nga urgjenca e krizës. Në rastin konkret, Gjykata ishte e mendimit se shteti kishte kaluar këtë kufi, pavarësisht emergjencës publike të deklaruar. Ankuesit nuk i ishin ofruar mbrojtjet e nevojshme; në veçanti, mungesa e qasjes të një avokat, mjek, i afërm apo familjar dhe mungesa e ndonjë mundësie realiste për ta sjellë atë para një gjykate për të vlerësuar ligjshmërinë e paraburgimit nënkupton se ai ishte lënë komplet në mëshirën e atyre që e mbanin.

Gjykata ka rikujtuar se ankuesi ishte mbajtur në paraburgim për së paku katërbëdhjetë ditë pa u sjellë para një gjyqtari apo zyrtari tjetër. Gjykata ishte e mendimit se hetimi i veprave terroriste vërtetë paraqet problem për autoritetet, por megjithatë nuk mund të pranojë se ka qenë e nevojshme për të mbajtur një të dyshuar për katërbëdhjetë ditë pa ndërhyrje gjyqësore. Për më tepër, sipas Gjykatës, Qeveria nuk ka ofruar ndonjë arsyetim të hollësishëm se përse lufta kundër terrorizmit në Turqinë juglindore e ka bërë ndërhyrjen gjyqësore jopraktike. Në përfundim, Gjykata ka gjetur se ka pas shkelje të Nenit 5§ 3 të Konventës.

Sa i përket ankesës për shkelje të Nenit 6, Gjykata e kishte parë më të përshtatshme që të shqyrtonte atë në lidhje me detyrimin më të përgjithshëm të shteteve sipas Nenit 13, për të ofruar mjete efektive për shkelje të Konventës. Sa i përket Nenit 13, Gjykata ka vënë re se, sipas ligjit turk, në rrethanat e rastit të ankuesi, prokurori kishte detyrim që të fillonte hetimin në lidhje me dëmet e pësuar nga ankuesi. Qasja e tillë e një zyrtari shtetëror, i cili ka qenë nën detyrim për të ndërmarrë hetime, është e barasvlefshme me

minimin e efektivitetit të mjeteve juridike që mund të kenë ekzistuar. Prandaj, Gjykata gjen se, sidomos në lidhje me mungesën e hetimeve ndaj keqtrajtimit të tij, atij i është mohuar mjete efektiv juridik në lidhje me ankesën e tij për torturë. Kësisoj, Gjykata gjen shkelje të Nenit 13 të Konventës.

Marrë parasysh shkeljet skajshmërisht serioze të pësuara nga ankuesi dhe ankthin që këto padyshim i kanë shkaktuar babait të tij, i cili ka vazhduar me ankesën pas vdekjes së të birit, Gjykata ka vendosur që të ofrojë shumën e plotë të kërkuar si dëmshpërblim për dëmin material dhe jo-material. Gjithashtu, ka urdhëruar mbulimin e kostove dhe shpenzimeve të ankuesit, të cilat i ka vlerësuar të arsyeshme.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 3 të Konventës [*me tetë vota kundër një*]; gjen se ka shkelje të Nenit 5(3) [*me tetë vota kundër një*]; vendosë se nuk është e nevojshme të shqyrtojë ankesën sipas Nenit 6(1) [*me tetë vota kundër një*]; gjen se ka shkelje të Nenit 13 [*me tetë vota kundër një*]; gjen se nuk është përcaktuar ndonjë shkelje e Nenit 25(1) [*njëzëri*].

Sakik dhe të Tjerët kundër Turqisë - 23878/94, 23879/94, 23880/94, 23881/94,
23882/94, 23883/94

26 nëntor 1997 [Gjykata]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5 §§ 1, 3, 4 dhe 5

Arrestimi, koha e mbajtjes, mungesa e kompensimit si dhe mos pasja e mundësis që të merrnin masa për të sfiduar ligjshmërinë e vendimeve të prokurorit publik duke urdhëruar ndalimin e tyre në paraburgimin e policisë të vendosur nga një gjykatës ka rezultuar në shkelje / ka shkelje

Neni 15

Masat e ndërmarra përbëjnë shkelje dhe se shteti nuk ka pasur të drejtë të dërgoj nga Konventa / ky nen nuk është i aplikueshëm

Fjalët kyçe: konflikt / situatë e jashtëzakonshme / derogim / deklaram i shprehur / brenda zonës së konfliktit / arrestim / paraburgim / joligjorë / tej-zgjatur

Ankuesit: z. Sırrı Sakık, z. Ahmet Türk, z. Mahmut Alınak, znj. Leyla Zana, z. Mehmet Hatip Dicle dhe z. Orhan Doğan, gjashtë shtetas turq

Faktet e rastit

Ankuesit ishin gjashtë ish anëtarë të Asamblesë Kombëtare Turke, të cilët ishin zgjedhur më 20 tetor 1991 si anëtarë të Partisë Demokratike (Demokrasi Partisi). Më 2 mars 1994, Asambleja Kombëtare hoqi imunitetin e tyre parlamentar në një kërkesë të prokurorit publik të bashkangjitur në Gjykatën e Sigurisë Kombëtare të Ankarasë, i cili i kishte akuzuar ata për kryerjen e veprave penale të klasifikuara si krime terroriste. Dy nga ankuesit u arrestuan pasi po largoheshin nga ndërtesa e parlamentit dhe u morën në paraburgim në selinë e seksionit anti-terrorist të policisë së sigurisë të Ankarasë. Katër ankuesit e mbetur u arrestuan në mënyrë të ngjashme më 4 mars 1994. Më 4 mars 1994 prokurori publik i zgjati gjashtë paraburgimet e ankuesve në arrest policor deri më 16 mars 1994 me arsyetimin se nevojiten hetime të mëtejshme. Përderisa ishin në paraburgim ankuesit refuzuan të bënin ndonjë deklaratë. Më 17 mars 1994 një gjykatës i vetëm i Gjykatës së Sigurimit Kombëtar lëshoi një urdhër për ndalimin e ankuesve në pritje të gjykimit. Më 22 mars 1994, në ankesën e ankuesve, një gjykatë e përbërë prej tre gjyqtarëve të së njëjtës gjykatë miratoi urdhrin e 17 marsit 1994. Më 13 prill 1994 një kërkesë tjetër për lirim u hodh poshtë nga Gjykata e Sigurisë Kombëtare.

Më 21 qershor 1994, prokurori publik paraqiti parashtrësit që akuzonin ankuesit për separatizëm dhe minimin e integritetit të shtetit. Në Dhjetor të vitit 1994, Gjykata e Sigurisë Kombëtare dënoi dy nga ankuesit për 3 vjet dhe 6 muaj burgim për propagandë separatiste dhe pjesën e mbetur deri në 15 vjet burg për anëtarësim në një grup të armatosur. Më 26 tetor 1995, pas ankesës së ankuesve, Gjykata e Kasacionit anuloi dënimin e një prej paditësve të burgosur për 15 vjet dhe urdhëroi lirim; ankesat e ankuesve të mbetur u pranuan.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit sollën disa pretendime para Gjykatës, ku ndër tjera pohuan se: (a) nuk ishin sjellë "menjëherë" përpara një gjyqtari ose zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për ushtrimin e pushtetit gjyqësor, e që ishte në kundërshtim me Nenin 5 § 3 të Konventës; (b) se nuk kishin qenë në gjendje të merrnin masa për të sfiduar ligjshmërinë e vendimeve të prokurorit publik që urdhëronin ndalimin e tyre në paraburgimin e policisë të vendosur nga një gjyqtar, në kundërshtim me Nenin 5 § 4 të Konventës së vitit 1950; dhe (c) nuk kishin mundësi që të kërkonin kompensim për shkelje të Nenit 5 të Konventës së vitit 1950, në kundërshtim me Nenin 5 § 5 të saj.

Ne lidhje me këto pretendime përgjigja e Qeverisë ishte se: (a) se natyra dhe shkalla e kërcënimit terrorist në Turqi dhe vështirësitë e veçanta që hasën në ndërmarrjen e veprimeve për të shmangur atë kërcënim dhe për të hetuar sjelljen e ankuesve duhej të peshoheshin në bilanc; (b) se standardi i kërkuar nga Neni 5 § 4 ishte plotësuar nga gjyqtari i vetëm i cili urdhëroi paraburgimin e ankuesve në pritje të gjykimit dhe se Neni 19 § 8 i Kushtetutës turke, që ishte në terma të ngjashëm me Nenin 5 § 4 të Konventës së vitit 1950, siguroi një mjet juridik që ishte në dispozicion përpara Gjykatave të Sigurisë Kombëtare; dhe (c) se si ankuesit nuk kishin shfrytëzuar Nenin 19 të Kushtetutës Turke ose të Ligjit nr. 466 për pagesën e kompensimit për persona të arrestuar ose ndaluar në mënyrë të paligjshme, kompensimi duhet të refuzohet. Qeveria gjithashtu në përgjithësi pohoi se, meqë Turqia kishte ushtruar të drejtën e derogimit sipas Nenit 15 të Konventës së vitit 1950 më 6 gusht 1990 dhe 3 janar 1991, ajo nuk kishte shkelur asnjë pjesë të Nenit 5.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht Gjykata adresoi kundërshtimet e Qeverisë për derogim nga Konventa sipas Nenit 15 të Konventës. Gjykata rikujtoi se Neni 15 i Konventës autorizon përjashtimet nga detyrimet që rrjedhin nga Konventa vetëm 'deri në masën e kërkuar rreptësisht nga kërkesat e situatës'. Do të ishte në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e Nenit 15 nëse, gjatë vlerësimit të fushëveprimit territorial të derogimit në fjalë, Gjykata do të shtrijë efektet e saj në një pjesë të territorit turk që nuk është përmendur në mënyrë eksplicite në njoftimin e derogimit. Pasi që njoftimet e derogimit aplikoheshin vetëm në rajonin ku ishte shpallur gjendja e jashtëzakonshme dhe këtu nuk përfshihej Ankaraja, vendndodhja në të cilën ankuesit u arrestuan, çështja e derogimit nuk ishte e zbatueshme për rastin në fjalë.

Tutje, Gjykata shtoi se fakti që hetimi i akteve terroriste pa dyshim i paraqet shtetet kontraktuese me probleme të veçanta, nuk do të thotë që shtetet kontraktuese kishin një letër të bardhë sipas Nenit 5 të Konventës për të arrestuar të dyshuarit për pyetje, pa kontrollë efektive nga gjykatat vendase dhe, në fund të fundit, nga institucionet mbikëqyrëse të Konventës, sa herë që ata zgjedhën të pohonin se terrorizmi ishte përfshirë. Neni 5 ruan një të drejtë themelore të njeriut, përkatësisht mbrojtjen e individit kundër ndërhyrjeve arbitrare nga ekzekutivi me të drejtën e tij për liri. Rrjedhimisht, pasi që Gjykata më parë kishte konstatuar se paraburgimi për një periudhë prej 4 ditësh dhe 6 orësh pa kontroll gjyqësor ra jashtë kufizimeve të rrepta në kohën e përcaktuar me Nenin 5 § 3 dhe si ankuesit ishin ndaluar për periudha prej 12 deri në 14 ditë, nuk mund të thuhet, edhe nëse aktivitetet për të cilat ata u akuzuan ishin

të lidhura me një kërcënim terrorist, se ishte e nevojshme të ndaloheshin për këto periudha. Në përputhje me rrethanat, Gjykata vie në përfundim se kishte pasur shkelje të Nenit 5 § 3 të Konventës.

Gjykata shtoi se ndonëse gjyqtari vendor kur urdhëronte paraburgimin dhe gjykimin e ankuesve vendosi edhe për ligjshmërinë e paraburgimit të tyre të mëparshëm ai gjyqtar nuk kishte ndërhyrë deri në përfundimin e paraburgimit policor, përkatësisht 12 deri 14 ditë pas arrestimit të ankuesve. Duke pasur parasysh konkluzionin e arritur në lidhje me Nenin 5 § 3, një periudhë kaq e gjatë nuk ishte në përputhje me nocionin e "shpejtësisë" sipas Nenit 5 § 4 të Konventës. Gjithashtu, ekzistenca e Nenit 19 § 8 të Kushtetutës së Turqisë nuk përjashton një shkelje të Nenit 5 § 4 të Konventës. Ekzistenca e një mjeti juridik duhet të jetë mjaft i sigurt. Në rastin në fjalë, nuk kishte dëshmi të një instance në të cilën një person në paraburgim kishte përdorur me sukses Nenin 19 (8) të Kushtetutës Turke ose Nenin 5 § 4 të Konventës. Një mungesë e tillë e precedenteve tregoi pasigurinë e mjeteve juridike. Prandaj, kishte pasur një shkelje të 5 § 4 të Konventës.

Gjykata shtoi se nuk kishte dëshmi të një instance në të cilën pala kontestuese kishte marrë kompensimin e përmendur në Nenin 5 § 45 të Konventës duke u mbështetur në një nga dispozitat e përmendura nga Qeveria. Duke pasur parasysh veçanërisht Nenin 1 të ligjit nr. 466, me përjashtim të situatës kur një person nuk është kryer për gjykim ose është liruar ose shkarkohet pas gjykimit në gjyq, të gjitha rastet në të cilat kompensimi ishte i pagueshëm nën 1 vit kërkoi privimin e lirisë për të qenë i paligjshëm. Në rastin konkret, Qeveria pranoi se ndalimet në fjalë ishin në përputhje me ligjin turk. Pranimi i efektshëm i së drejtës të garantuar me Nenin 5 § 5 të Konventës së vitit 1950 nuk u sigurua me një shkallë të mjaftueshme sigurie. Prandaj, Gjykata gjen se kishte pasur një shkelje të Nenit 5 § 5 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se konstaton se derogimi i bërë nga Turqia sipas Nenit 15 të Konventës nuk është i zbatueshëm në këtë rast. Poashtu, Gjykata gjen se ka shkelje të Neni 5 §§ 1, 3, 4 dhe 5 [njëzëri]

Demir dhe të tjerët kundër Turqisë - 71/1997/855/1062-1064

23 shtator 1998 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5

Pretendim se aplikimi i derogimit nuk e arsyetonte paraburgimin për një kohë të gjatë dhe pa vendim gjyqësor përkundër rrethanave / *ka shkelje*

Neni 15

Qeveria kishte dorëzuar pranë Këshillit të Evropës një deklaratë për derogim për Anatinë jug-lindore

Fjalët kyçe: *situatë e jashtëzakonshme / derogim nga konventa / zonë e caktuar / arrestim / paraburgim / mbajtje / tej-zgjatje / pa vendim gjyqësor / siguri / e paarsyeshme*

Ankuesit: z. Hüseyin Demir (*ankuesi i parë*), z. Sukru Süsin (*ankuesi i dytë*), z. Faik Kaplan (*ankuesi i tretë*)

Faktet e rastit

Ankuesi i parë, dhe i dytë, të zgjedhur nga Rrethi Yenimahalle, Idil, ishin kryetari dhe ish-sekretari i Partisë Social Demokrate Populiste (SHP) - dega Idil. Ankuesi i tretë ishte korrespondent për gazetën Hürriyet dhe anëtar i bordit të Partisë Popullore të Republikës (CHP) - dega e Idilit.

Në atëbotë, ankuesit jetonin dhe punonin në Idil, në krahinën e Sirnak, e cila ishte ndër ato krahina të cilat që nga viti 1987 ishin shpallur në gjendje të jashtëzakonshme në Anatinë jug-lindore. Më 6 gusht 1990, Përfaqësuesi i Përherhëm i Turqisë në Këshillin e Evropës i dërgoi Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës njoftimin për derogim.

Ankuesi i parë u arrestua dhe u burgos më 22 janar 1993 (26 janar sipas Qeverisë); dy ankuesit e tjerë pësuan të njëjtin fat më 28 janar (më 26 dhe 30 janar, përkatësisht, sipas Qeverisë). Ata u akuzuan se ishin anëtarë të PKK (Partia e Punëtorëve të Kurdistanit). Me kërkesën e Drejtorisë së Policisë në Idil, ankuesit u ekzaminuan nga zyra e mjekësisë ligjore në Idil. Në raportet e tyre, mjekët deklaruan se nuk kishin vërejtur asnjë shenjë të rrahjeve apo dhunës tek personat në fjalë.

Më 12 shkurt 1993, avokati i ankuesit ngriti padi kundër kreut të Drejtorisë së Policisë që urdhëroi burgun në fjalë. Ky pretendim u refuzua më 2 prill 1993. Pasi secili i nënshtrohet ekzaminimit të ri mjekësor, ankuesit janë transferuar më 15 shkurt 1993 në rastin e parë dhe më 18 shkurt në dy të tjerë, para gjyqarit të Gjykatës Penale të Idilit, i cili i dërgoi në paraburgim të përkohshëm.

Më 11 qershor 1993, një procedurë penale filloi para Gjykatës së Sigurisë Kombëtare në Diyarbakir kundër tridhjetë e pesë të akuzuarve, duke përfshirë edhe ankuesit. Më 7 korrik 1993 ankuesit u paraqitën para Gjykatës së Sigurisë Kombëtare. Dy ankuesit e parë tërhoqën rrëfimet që kishin bërë në zyrat e policisë së sigurisë, duke pohuar se

këto ishin nxjerrë prej tyre me anë të detyrimit. Ankuesi i tretë tha se ai kishte vepruar nën frikën e hakmarrjes nga PKK. Ai u lirua me kusht në të njëjtën ditë ndërsa dy akuesit e tjerë më 3 shkurt 1994.

Gjykata e Sigurisë Kombëtare dha gjykimin më 14 nëntor 1996. Duke zbatuar Nenin 168 § 2 të Kodit Penal, gjykata dënoi ankuesin e parë dhe ankuesin e dytë me dymbëdhjetë vjet e gjashtë muaj burgim për anëtarësim në një bandë të armatosur; dhe dënoi ankuesin e tretë në bazë të Nenit 169 të kodit të njëjtë, me tre vjet e nëntë muaj burgim për dhënien e ndihmës një bande të armatosur dhe për strehimin e kriminelëve të njohur. Me aktgjykimin e 2 marsit 1998, Gjykata e Kasacionit konfirmoi këtë vendim.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit kërkuan nga Gjykata të konstatonte se paraburgimi i tyre në qendrën paraburgimit kishte shkelur Nenin 5 § 3 të Konventës dhe t'u jepte atyre të drejtën e satisfaksionit sipas Nenit 50.

Qeveria, nga ana tjetër, kërkoj nga Gjykata, të deklaronte se, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta rreth çështjes në fjalë, zbatimi i derogimit turk nuk ishte joproporcional; në alternativë, të deklarojë se jo të gjitha paditë e parashikuara në ligjin turk janë paraqitur në gjykatat e brendshme dhe... të deklarojnë se nuk ka pasur shkelje të Konventës".

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata vëren se në rastin *Brogan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*,⁸⁴ ka konstatuar se periudha e paraburgimit që ka zgjatur për katër ditë dhe gjashtë orë pa shqyrtim gjyqësor ka rënë jashtë kufizimeve të rrepta të kohës e lejuar sipas Nenit 5 § 3, madje edhe pse ajo ishte projektuar për të mbrojtur komunitetin si tërësi nga terrorizmi.

Në çështjen në fjalë ankuesi i parë dhe dytë u mbajtën në paraburgim për të paktën njëzet e tre ditë dhe ankuesi i tretë për të paktën gjashtëmbëdhjetë ditë, gjatë së cilës asnjë prej tyre nuk është paraqitur para një gjyqtari ose zyrtari tjetër gjyqësor. Duke pasur parasysh aktgjykimin e sipërpërmendur, Gjykata mund të përfundojë vetëm se periudhat e paraburgimit në fjalë nuk kanë arritur ta përmbushin kërkesën e shpejtësisë të përcaktuar në Nenin 5 § 3. Kërkesat e hetimit nuk mund t'i shfuqizojnë autoritetet nga detyrimi për të sjellë çdo person të arrestuar në përputhje me Nenin 5 § 1 (c) "menjëherë" përpara një gjyqtari, siç kërkohet nga Neni 5 § 3. Kur është e nevojshme, autoritetet duhet të zhvillojnë forma të kontrollit gjyqësor të cilat përshtaten me rrethanat, por që janë në përputhje me Konventën.

Lidhur me validitetin e derogimit të njoftuar nga Turqia nën Nenin 15 të Konventës, Gjykata rikujton se "*i takon çdo Shteti Palë, me përgjegjësinë e tij për jetën e kombit [të tij], të përcaktojë nëse kjo jetë kërcënohet nga një "emergjencë publike"*" dhe, nëse po, sa është e nevojshme të bëhet në përpjekje për të kapërcyer emergjencën. Prandaj, në këtë çështje duhet t'i lihet një hapësirë e gjerë vlerësimi autoriteteve kombëtare.

⁸⁴ *Brogan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, aktgjykim i datës 29 Nëntor 1988, Seria A nr. 145-B, p. 33, § 62*

Sidoqoftë, Shtetet Palë nuk gëzojnë diskrecion të pakufizuar. Është për Gjykatën të vendosë nëse, ndër të tjera, shtetet kanë shkuar përtej '*masës së kërkuar rreptësisht nga kërkesat*' e krizës. Sidoqoftë, kufiri/margjina i brendshëm i vlerësimit shoqërohet nga mbikëqyrja evropiane.

Sa i përket ekzistencës së emergjencës publike që kërcënon jetën e kombit, Gjykata përmendi aktgjykimin e saj në rastin e *Aksoy*,⁸⁵ ku kishte gjetur se "Shtetirja dhe ndikimi i veprimtarisë terroriste të PKK në Turqinë juglindore ka krijuar pa dyshim në këtë rajon *emergjencë publike që kërcënon jetën e kombit*". Pasi që asgjë nuk duket se ka ndryshuar në këtë rajon pak muaj pas këtij aktgjykimi, Gjykata konsideron se ekziston ende emergjenca publike në këtë rajon. Ndërsa sa i përket asaj se masat e zbatuara a kanë qenë rreptësisht të kërkua nga nevojat e situatës, Gjykata vëren se, duke kërkuar justifikimin e ndalimit të ankuesve, Qeveria i referohej kërkesave të veçanta të hetimeve policore në rajon, të cilat ishin objekt i një gjendjeje të jashtëzakonshme.

Në rastin e lartpërmendur *Aksoy*, Gjykata, në vlerësimin e vlefshmërisë së derogimit turk, mori në konsideratë në veçanti problemin e padiskutueshëm të terrorizmit në Turqinë juglindore dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet shteti në marrjen e masave efektive. Sidoqoftë, në këtë rast nuk u bind se situata e domosdoshme e detyroi mbajtjen e ankuesi me dyshimin për përfshirje në veprat terroriste për katërmëdhjetë ditë ose më shumë në paraburgim pa leje, pa pasur qasje në gjyqtar ose nëpunës tjetër gjyqësor. Rasti i tanishëm vështirë se ndryshon nga rasti *Aksoy*. Megjithatë, Qeveria theksoi se ankuesit u ekzaminuan dy herë nga një qendër e mjekësisë ligjore dhe se avokati i ankuesve kishte mundur të paraqiste ankesë kundër kreut të policisë së sigurisë, i cili kishte urdhëruar paraburgimin e tyre. Megjithatë, Gjykata i gjen këto argumente jo bindëse. Gjykata gjeti se: Së pari, sipas udhëzimeve të dërguara nga policia e sigurisë në qendrën e mjekësisë ligjore, detyra e qendrës ishte e kufizuar për të konstatuar nëse, në fillim dhe në fund të paraburgimit në qendrën e paraburgimit, trupat e ankuesve "*treguan shenjat e goditjeve apo dhunës*". Sipas mendimit të Gjykatës, ekzaminimet e tilla mjekësore, të ndara me periudha gjashtëmbëdhjetë ose njëzet e tre ditë, nuk janë në vetvete masa mbrojtëse të mjaftueshme për të justifikuar gjatësinë e tepërt të paraburgimit të ankuesve. Së dyti, fakti që avokati i ankuesve ishte në gjendje të parashtronte ankesë nuk mund të konsiderohet si garanci efektive kundër trajtimit arbitrar, veçanërisht pasi që, duke u mbajtur pa komunikim, ankuesit u privuan nga të gjitha kontaktet me të.

Rrjedhimisht, Gjykata nuk është e bindur se paraburgimi i paautorizuar i ankuesve për të paktën gjashtëmbëdhjetë ose njëzet e tre ditë, pa ndonjë mundësi për të parë një gjyqtar ose zyrtarë të tjerë gjyqësor, ishte rreptësisht e nevojshme gjatë krizës së shpallur nga Qeveria. Rrjedhimisht ka pasur shkelje të Nenit 5 § 3 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen derogimi i nga Turqia është i aplikueshëm sipas Nenit 15; gjithashu gjen se ka shkelje të Nenit 5 § 3 të Konventës [*njëlëri*].

⁸⁵ *Aksoy kundër Turqisë*, aktgjykim i datës 18 December 1996, Reporti 1996-VI, f. 2282, § 78

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3

Pretendim se gjatë mbajtjes në paraburgim ankuesja i ishte nënshtruar trajtimit çnjerëzor / *hedhet poshtë si pasojë e mos shterjes së mjeteve të brendshme juridike*

5 § 3

Mbajtja në paraburgim për njëmbëdhjetë ditë para se të sillet para një gjykatësi ose zyrtari tjetër gjyqësor, në rastin konkret, nuk ka qenë e nevojshme në mënyrë strikte / *ka shkelje*

Neni 13

Mungesë e mjeteve efektive juridike për të adresuar shkeljet / *shpallet e papranueshme për shkak të mospërputhshmërisë me rregullin gjashtë-mujor*

Fjalët kyçe: *konflikt / situatë e jashtëzakonshme / derogim / paraburgim / mbajtje pa gjykim / siguri / e panevojshme*

Ankuesja: znj. Nuray Şen, është shtetase turke, e lindur në vitin 1951 dhe jeton në Paris

Faktet e rastit

Ankuesja ka qenë drejtoreshë e Qendrës Kulturore Mesopotamia, me seli në Stamboll. Qendra ka si qëllim që të hulumtojë, shqyrtojë dhe pasqyrojë kulturën dhe artin e popujve që kanë jetuar ose janë duke jetuar në Mesopotami, në radhë të parë kurdëve. Në nëntor të vitit 1995, ankuesja kishte udhëtuar në Diyarbakir me qëllimin për të emëruar drejtorin e degës së Qendrës për këtë qytet. Më 10 dhjetor 1995, ajo së bashku me nëntë kolegë të saj që punonin për Qendrën Kulturore, ishin arrestuar dhe sjellë në qendrën kundër terrorizmit. Gjatë udhëtimit për në seli, koka e ankuses ishte vendosur nën ulësen e makinës me të cilën po udhëtonin. Ankuesja ishte mbajtur në qendrën e paraburgimit për njëmbëdhjetë ditë. Pavarësisht se ajo dhe nëntë kolegët e saj ishin dërguar për një ekzaminim mjekësor në Institutin e Mjekësisë Forenzike të Diyarbakir, në të vërtetë nuk kishte ndodhur asnjë kontroll apo ekzaminim. Gjatë periudhës së mbajtjes në paraburgim, ankuesja u ishte ekspozuar disa prej praktikave në vijim: ishte mbajtur në vazhdimësi me sy mbyllur, ishte goditur dhe rrahur dhe në mënyrë të vazhdueshme dhe të dhunshme, ishte abuzuar seksualisht, ishte zhveshur dhe mbajtur në ujë të ftohtë, ndaj saj ishte aplikuar elektro-shoku, ishte abuzuar verbalisht, si dhe ishte detyruar të vraponte në vend për perudha të gjata. Ankuesja nuk ishte vendosur në një qeli, por detyruar të ulej në një korridor të ngushtë. Ankuesja ishte marrë në pyetje dhe i ishte bërë presion që të pranonte se ishte e lidhur me PKK-në dhe se ajo punonte sipas udhëzimeve të PKK-së. Ajo kishte identifikuar njërin prej hetuesve, që ishte prezantuar si anëtar i njësisë kundër-terroriste. Hetuesit e

kishin kërcënuar me vrasje dhe detyruar që të nënshkruante një deklaratë pa e lexuar atë. Ajo s'kishte qasje në avokat mbrojtës dhe as të afërmit e saj nuk ishin njoftuar për arrestimin.

Tortura fizike ishte ndaluar disa ditë para se ajo të dërgohej në gjykatë. Ankuesja beson se kjo është bërë për ta lejuar atë që të marrë veten nga efektet e torturës.

Më 21 nëntor 1995, ankuesja ishte sjellë para prokurorit në Gjykatën e Sigurisë Shtetërore; arrestimi i saj ishte urdhëruar dhe ajo ishte dërguar më pas në Burgun e Sigurisë së Lartë të Diyarbakir. Ankuesja ishte liruar me kusht në seancën e parë dëgjimore të mbajtur më 15 shkurt 1996 në Gjykatën e Sigurisë Shtetërore të Diyarbakir.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesja ka paraqitur ankesë për aplikim të torturës derisa ishte mbajtur në qendër të paraburgimit dhe se autoritetet kishin dështuar që të hetonin në mënyrë të duhur ankesën. Ajo ishte thirrur në Nenit 3 dhe 13 të Konventës për të mbështetur ankesën.

Ankuesja, gjithashtu, ishte ankuar se ajo ishte mbajtur në paraburgim për njëmbëdhjetë ditë dhe nuk ishte sjellë para një gjykatësi brenda një kohe të arsyeshme. Ajo mbështetet në Nenin 5 § 3 të Konventës.

Qeveria, nga ana e saj, së pari kishte mbajtur qëndrimin se ankuesja nuk kishte shterur mjetet e brendshme juridike në kuptimin e nenit 35 § 1 të Konventës. Qeveria ka argumentuar se do të kishte qenë e mundur për të kërkuar korrigjim para gjykatave administrative. Qeveria, po ashtu, ka deklaruar se ankuesja do të mund të ngriste padi civile për kompensim të dëmit të shkaktuar nga veprimet ose sjelljet e paligjshme të zyrtarëve shtetërorë.

Sa i përket shterimit të mjeteve juridike, ankuesja kishte mbajtur qëndrimin se kjo nuk kërkohej nga ajo, duke qenë se mjetet ishin iluzore, jo adekuate dhe jo efikase.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme juridike, Gjykata kishte vërejtur se ankuesja nuk kishte ofruar ndonjë elementë që do të mbështeste pretendimin se ajo do të ishte kërcënuar sikur të paraqiste ankesë ndaj vendimit të prokurorit publik. Marrë në tërësinë e rrethanave të rastit, nuk mund të thuhet se ankuesja kishte vepruar në pajtim me rregullin për shterimin e mjeteve juridike. Në këtë mënyrë, Gjykata hedh poshtë ankesën sipas Nenit 3 të Konventës.

Sa i përket ankesë në bazë të Nenit 13 të Konventës, Gjykata vë re se kjo ankesë nuk ishte bërë deri pas komunikimit të kësaj ankese Qeverisë. Gjykata vëren në këtë kontekst se ankesa e saj sipas Nenit 13 i ishte dorëzuar Gjykatës më tepër se gjashtë muaj me vonë. Për këtë arsye, Gjykata e shpallë këtë ankesë të papranueshme për shkak të mospërputhshmërisë me rregullin gjashtë-mujor.

Gjykata ka vlerësuar se pavarësisht situatës së krijuar në Turqinë juglindore nga veprimet e PKK-së, si dhe karakteristikat e veçanta dhe vështirësitë në hetimin e veprave terroriste, mbajtja e ankueses në paraburgim për njëmbëdhjetë ditë para se të sillet para një gjykatësi ose zyrtari tjetër gjyqësor, në rastin konkret, nuk ka qenë e nevojshme në mënyrë strikte. Si pasojë Gjykata gjen se ka shkelje të Nenit 5 § 3 të konventës, përkundër ekzistimit të derogimit nga ana e shtetit.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se nuk ka shkelje të nenit 3 të Konventës [njëzëri]; gjen se ka shkelje të nenit 5 § 3 [njëzëri]; gjen se nuk ka shkelje të nenit 13 [njëzëri].

Şahin Alpay kundër Turqisë - 16538/17

20 mars 2018 [Seksioni i Dytë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5 § 4

Dështimi i autoriteteve në respektimin e kriterit “shpejtësisë” në lidhje me procedurat para Gjykatës Kushtetuese me qëllim të kundërshtimit të ligjshmërisë së paraburgimit / ankesa e papranueshme

Neni 10

Ndërhyrje në lirinë e shprehjes, për shkak të paraburgimit të vazhdueshëm / ka shkelje

Neni 15

Njoftim për derogim nga konventa si pasojë e shpalljes së situatës së jashtëzakonshme në përgjigje të grushtshtetit

Fjalët kyçe: *grusht-shtet / situatë e jashtëzakonshme / arrestime / paraburgim / organizatë terroriste / mbështetje e terrorizmit / gylenist / liri e shprehjes / procedura të tejzgjatura / mos-zbatim i vendimeve*

Ankuesi: z. Şahin Alpay, shtetas turk

Faktet e rastit

Ankuesi ishte një kolumnist në gazetën e përditshme Zaman, e cila u konsiderua si media kryesore e botimit të lëvizjes "Gülenist", e cila u akuzua për përpjekje për të kryer një grusht shteti ushtarak më 15 korrik 2016. Gjatë tentativës së grushtit të shtetit, ushtarët nën kontrollin e nxitësve bombarduan disa ndërtesa strategjike shtetërore, duke përfshirë ndërtesën e parlamentit dhe kompleksin presidencial, sulmuan hotelin ku po qëndronte Presidenti, mbajtën peng shefin e Shtabit të Përgjithshëm, sulmuan kanalet televizive dhe gjuajtën me të shtëna në demonstruesit. Gjatë asaj nate, më shumë se 300 vetë u vranë dhe më shumë se 2,500 u plagosën. Më 20 korrik 2016, qeveria shpalli gjendjen e jashtëzakonshme për një periudhë tre mujore e cila më pas u zgjat për periudha të mëvonshme, së fundmi me efekt nga data 19 janar 2018. Më 21 korrik 2016, autoritetet turke njoftuan Sekretarin e Përgjithshëm i Këshillit të Evropës për një derogim nga Konventa sipas Nenit 15.

Gazeta Zaman u mbyll me një dekret të jashtëzakonshëm të lëshuar më 27 korrik 2016. Më 30 korrik 2016, disa redaktorë dhe kolumnistë të gazetës, duke përfshirë ankuesin, u arrestuan dhe u futën në paraburgim, me dyshim duke qenë anëtarë të një organizate terroriste. Gjatë marrjes në pyetje para Gjykatës së 4-të të Gjykatës së Stambollit, ankuesi pretendoi se ai ishte bashkuar me Zamanin në mënyrë që të mund të shprehte mendimet e tij; se ai ishte në favor të një sistemi demokratik dhe të standardeve evropiane; se ai nuk ishte në dijeni të kërcënimit të paraqitur nga lëvizja Gylenist-e; dhe se ai ishte kundër çdo sulmi ndaj demokracisë. Gjykata e Magjistraturës, vendosi

që veprimet e anuesit kishin promovuar organizatën terroriste në fjalë dhe urdhëroi paraburgimin e tij. Të gjitha ankesat e tij u refuzuan.

Sipas aktakuzës së ngritur nga prokurori publik i Stambollit më 10 prill 2017, ankuesi u akuzua sipas Neneve 309, 311 dhe 312 në lidhje me Nenin 220 § 6 të Kodit Penal, për përpjekjen për të përmbysur rendin kushtetues, dhe kryerjen e veprave penale në emër të një organizate terroriste pa u bërë anëtarë e saj. Aktakuza propozoi të shqiptojë tre dënime të rënda të përgjeshme dhe një dënim me burgim deri në pesëmbëdhjetë vjet burg për ankuesin, në bazë të gjashtë artikujve të shkruar prej tij në vitin 2013 dhe 2014. Prokurori publik parashtrioi se artikujt në fjalë nuk mund të shihen si një shprehje e kundërshtimit apo kritikës ndaj qeverisë; se shprehjet kishin shkuar përtej kufijve të lirisë së shtypit dhe rreziku i paqes sociale dhe rendit publik. Prokurori publik vuri re më tej se ankuesi nuk kishte hezitur të bënte thirrje për një grusht shtet ushtarak dhe pohoi se ai kishte u shërbyer interesave të organizatës terroriste në fjalë. Më 8 shtator 2016, ankuesi paraqiti një kërkesë individuale në Gjykatën Kushtetuese dhe u ankua se paraburgimi i tij shkeli të drejtën e tij për liri dhe siguri dhe të drejtën e tij për lirinë e shprehjes dhe të shtypit. Ai gjithashtu i kërkoi Gjykatës të lejonte që ai të lirohej për shkak të gjendjes së tij shëndetësore dhe të vendoste një masë alternative të përkohshme për paraburgim. Më 26 tetor 2016, Gjykata Kushtetuese refuzoi të zbatonte një masë të përkohshme. Më 11 janar 2018, Gjykata lëshoi vendimin e saj me të cilën vendosi me njëmbëdhjetë vota në gjashtë se kishte pasur shkelje të së drejtës së tij për liri dhe siguri dhe të drejtën e tij për lirinë e shprehjes dhe të shtypit.

Gjykata Kushtetuese vërtetoi se paraburgimi i ankuesit për shkak të shkrimeve të tij përbënte një ndërhyrje në ushtrimin e së drejtës për lirinë e shprehjes. Lidhur me ligjshmërinë e paraburgimit, Gjykata vendosi që një masë e tillë, e cila kishte pasojë serioze që kur rezultonte me privimin e lirisë, nuk mund të konsiderohej si një ndërhyrje e nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike. Më tej vuri në dukje se nuk mund të përcaktohej qartë nga arsyet e dhëna për urdhërimin dhe shtrirjen e paraburgimit të parashtruesit të kërkesës nëse masa kishte një nevojë sociale të ngutshme ose pse ishte e nevojshme. Së fundmi, ajo gjeti se ishte e qartë se paraburgimi i ankuesit mund të kishte një efekt të frikshëm ndaj lirisë së shprehjes dhe shtypit, për aq sa nuk ishte bazuar në ndonjë dëshmi konkrete përveç artikujve të tij. Bazuar në sa më sipër, Gjykata Kushtetuese konstatoi se kishte pasur shkelje të lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit, siç është përcaktuar në Nenet 26 dhe 28 të Kushtetutës.

Përkundër vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, gjykata e 13 dhe 14 e Gjykatës së Apelit të Stambollit refuzoi të lirojë ankuesin. Megjithëse Gjykata Kushtetuese e dërgoi aktgjykimin në Gjykatën e 13-të të Gjykatës së Shkallës së Parë të Stambollit, në mënyrë që ajo të merrte "veprimin e duhur" dhe avokati i ankuesit të paraqiste kërkesën për lirimin e klientit të tij, Gjykata e 13-të e Gjykatës së Apelit refuzoi ta lirojë atë. Gjykata Assize vuri në dukje se shqyrtimi i bazueshmërisë së një kërkesë individuale në Gjykatën Kushtetuese kundër një vendimi gjyqësor kërkonte përcaktimin nëse kishte pasur shkelje të të drejtave themelore dhe çfarë masash do të ishin të përshtatshme për t'i dhënë fund shkeljes dhe se arsyet e apelit në pikat e ligjit nuk mund të shqyrtohej nga Gjykata Kushtetuese në kontekstin e një kërkesë individuale. Kështu, arriti në përfundimin se Gjykata Kushtetuese nuk kishte juridiksion për të vlerësuar provat në dosjen e lëndës. Sipas Gjykatës Kushtetuese,

gjkimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ishte në përputhje me ligjin dhe përbënte uzurpimin e pushtetit. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese ishin përfundimtare dhe detyruese. Pas refuzimit të kundërshtimit të ankuesit me vendim të Gjykatës së 14-të të Gjykatës më 15 janar, ai e ripërsëriti kërkesën e tij individuale në Gjykatën Kushtetuese më 1 shkurt 2018 dhe paraqiti një kërkesë në GJEDNJ më 28 shkurt 2017.

Përmbledhje e pretendimeve

Parashtruesi pohoi se procedurat që kishte sjellë para Gjykatës Kushtetuese me qëllim të kundërshtimit të ligjshmërisë së paraburgimit të tij nuk kishin respektuar kërkesat e Konventës në atë që Gjykata Kushtetuese nuk kishte respektuar kërkesën e "shpejtësisë". Ankuesi gjithashtu u ankua se ai nuk kishte pasur qasje në një mjet efektiv me të cilin ai mund të kishte marrë kompensimin për dëmin e shkaktuar për shkak të paraburgimit të tij. Ankuesi gjithashtu u ankua për ndërhyrje në lirinë e shprehjes së tij, duke shkelur Nenin 10 të Konventës, për shkak të paraburgimit të tij fillestar dhe të vazhdueshëm.

Arsyetimi i Gjykatës

Para shqyrtimit të bazueshmërisë së çështjes, Gjykata, adresoi pyetjen paraprake në lidhje me derogimin e Turqisë nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ"). Qeveria turke parashtrroi se masat e kundërshtuara u kërkonin nga kërkesat e situatës, në përgjigje të emergjencës publike që kërcënonte jetën e kombit për shkak të rreziqeve të shkaktuara nga grushti ushtarak në tentativë. Gjykata përsëriti se edhe pse Shtetet kishin një hapësirë të gjerë vlerësimi në këtë drejtim, ato nuk gëzonin një diskrecion të pakufizuar pasi kufiri i brendshëm i vlerësimit shoqërohej nga mbikëqyrja evropiane. Në rastin në fjalë, Gjykata vuri në dukje se Gjykata Kushtetuese, duke shqyrtuar nga një perspektivë kushtetuese faktet që shpjen në deklarimin e gjendjes së jashtëzakonshme, arriti në përfundimin se përpjekja e grushtit ushtarak kishte paraqitur një kërcënim të ashpër për jetën dhe ekzistencën e kombit. Në dritën e gjetjeve të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjitha materialeve të tjera në dispozicion të saj, Gjykata gjithashtu konsideroi se përpjekja e grushtit ushtarak zbuloi ekzistencën e një "emergjence publike që kërcënonte jetën e kombit" brenda kuptimit të Konventës. Megjithatë, për të vërtetuar nëse masat e marra në rastin në fjalë ishin të kërkuara rreptësisht nga kërkesat e situatës dhe në përputhje me detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare, Gjykata e konsideronte të nevojshme shqyrtimin e ankesave të ankuesit në bazë të bazueshmërisë.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për shkelje të lirisë së shprehjes, Qeveria argumentoi se masa e paraburgimit nuk ndërhynte në të drejtën e tij pasi që procedimet kundër tij nuk kishin të bënin me veprimtarinë e tij si gazetar. Pastaj shtoi se nëse Gjykata do të konkludonte se kishte pasur një ndërhyrje, ajo duhet të gjente se nëse ndërhyrja ishte "e përshkruar me ligj", kishte ndjekur një qëllim legjitim dhe kishte qenë "i nevojshëm në një shoqëri demokratike". Qeveria parashtrroi se ankuesi përdori të drejtën e tij për të shkatërruar të drejtat dhe liritë e tjera, duke konsideruar se artikujt në fjalë kishin promovuar një organizatë terroriste të armatosur dhe kishte përbërë nxitje për dhunë, duke pohuar se përdorimi i medias si mjet për shkatërrimin e lirive themelore mund të të mos tolerohet.

Ankuesi argumentoi se paraburgimi i tij pa ndonjë provë konkrete të krimit shkeli lirinë e shprehjes. Ndërhyrësit e tretë, përkatësisht Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, Raportuesi Special dhe organizatat joqeveritare theksuan shkelje të gjerë të lirisë së shprehjes dhe të shtypit në Turqi për shkak të zbatimit të gjerë dhe arbitrarisht të legjislacionit kundër terrorizmit. Ndërhyrësit pretenduan se qeveria e keqpërdori këtë legjislacion për të kriminalizuar mospajtimin ose kritikën.

Gjykata fillimisht e miratoi vendimin e Gjykatës Kushtetuese që paraburgimi i parashtruesit të kërkesës për shkak të shkrimeve të tij përbënte një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së tij për lirinë e shprehjes. Duke vërejtur se ndërhyrja kishte një bazë ligjore (Nenet 309, 311 dhe 312 në lidhje me Nenin 220 § 6 të Kodit Penal) dhe kishte ndjekur një qëllim legjitim, përkatësisht parandalimin e çrregullimeve dhe krimit, Gjykata vazhdoi të përcaktojë nëse ndërhyrja ishte e domosdoshme në një shoqëri demokratikë. Në lidhje me këtë, Gjykata, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, gjeti se paraburgimi i ankuesit pas shprehjes së mendimeve të tij, përbënte një masë të ashpër që nuk mund të konsiderohej si një ndërhyrje e nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike. Gjykata Kushtetuese kishte gjetur se gjyqtarët e gjykimit nuk kishin treguar se privimi i ankuesit për lirinë e tij plotësonte një nevojë sociale të ngutshme dhe se, për sa kohë që paraburgimi i tij nuk bazohej në ndonjë dëshmi konkrete përveç artikujve të tij, ajo mund të kishte pasur një efekt në lirinë e shprehjes dhe të shtypit.

Duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të rastit që rezultoi nga përpjekja e grusht shtetit, Gjykata vuri në dukje se ekzistenca e një "emergjence publike që kërcënon jetën e kombit" nuk duhet të shërbejë si pretekst për kufizimin e lirisë së debatit politik, e cila është në thelbin e konceptit të një shoqërie demokratike. Sipas Gjykatës, edhe në një gjendje të jashtëzakonshme, Shtetet Kontraktuese duhet të kenë parasysh se çdo masë e ndërmarrë duhet të kërkojë të mbrojë rendin demokratik nga kërcënimet ndaj tij dhe duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të ruajtur vlerat e një shoqërie demokratike, të tilla si pluralizmi, toleranca dhe mirëkuptimi. Së fundi, Gjykata theksoi se paraburgimi i kujtdo që shpreh pikëpamjet kritike mund të ketë efekte negative, si për të burgosurit vetë dhe për shoqërinë në tërësi, meqenëse vendosja e një mase që sjell privimin e lirisë, si në rastin në fjalë, do të ndikojë në mënyrë të pashmangshme në lirinë e shprehjes duke frikësuar shoqërinë civile dhe të gjithë ata/o që mendojnë ndryshe. Në bazë të arsyetimit të mësipërm, Gjykata arriti në përfundimin se Turqia shkeli të drejtën e ankuesit për lirinë e shprehjes.

Gjykata kerkon që Shteti përgjegjës të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'i dhënë fund ndalimit të paraburgimit të ankuesit dhe se shteti i paditur duhet të paguajë ankuesin, 21,500 EUR konvertuar në monedhën e shtetit të paditur në normën e aplikueshme në datën e shlyerjes, plus çdo taksë që mund të jetë e ngarkueshme.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se se nuk ka pasur shkelje të Nenit 5 § 4 të Konventës; mban, me gjashtë vota, se ka pasur shkelje të Nenit 10 të Konventës; dhe vendos njëzëri, se nuk ka nevojë të shqyrtohet veçmas ankesa sipas Nenit 18 të Konventës [njëzëri].

Shih gjithashtu mendimin konkurrues të gjyqtarit Spano mbështetur nga Gjyqtarët Bianku, Vučinić, Lemmens dhe Gričco në: [16538/17](#)

Neni 16

Kufizime ndaj veprimtarisë politike të të huajve

Asnjë nga dispozitat e Neneve 10, 11 dhe 14 nuk mund të konsiderohet se u ndalon Palëve të Larta Kontraktuese që të vendosin kufizime ndaj veprimtarisë politike të të huajve.

Piermont kundër Francës - 15773/89; 15774/89

27 prill 1995 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 2 i Protokollit Nr. 4

Pasi i është dhënë urdhëri i dëbimit, ankuesja nuk ka qenë më tej në territorin e Polinezisë dhe prandaj nuk ka vuajtur nga ndonjë ndërhyrje në të drejtën e saj për liri të lëvizjes / *nuk ka shkelje*

Neni 10

Dështim për të arritur është një ekuilibër i drejtë ndërmjet, në njërën anë, interesit publik që kërkon prishjen e rendit publik dhe, në anën tjetër, lirinë e shprehjes së individit / *ka shkelje*

Neni 14 në kombinim me nenin 10

Marrë parasysh faktin e gjetjes së shkeljes së nenit 10, Gjykata e vlerëson të panevojshme që të përcaktojë nëse ka pas shkelje edhe të nenit 14 në kombinim me nenin 10 / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: dëbim / territor / urdhër / liri e lëvizjes / shtetas i huaj / diskriminim

Ankuesja: znj. Dorothee Piermont, shtetase gjermane, e lindur në vitin 1943

Faktet e rastit

Ankuesja është anëtare e Parlamentit Evropian dhe banuese në Remagen (Gjermani). Ajo kishte paraqitur ankesë kundër Francës në lidhje me procedurat administrative të cilat kishin rezultuar në dëbimin dhe përjashtimin e një shtetase të huaj, në këtë rast ankuesja, nga Polinezia Franceze dhe Kaledonia e Re dhe territoret në varësi të saj.

Me ftesë të politikanëve separatist vendorë, ankuesja kishte vizituar Tahitin (Polinezia Franceze). Në arritje, ajo ishte paralajmëruar se duhej të priste një detyrim diskrecional. Më 1 mars 1986, ajo kishte marrë pjesë në një demonstratë kundër testeve bërthamore franceze dhe kishte folur në mbështetje të kërkesave kundër-bërthamore dhe separatiste, të paraqitura nga një numër i organizatave politike. Kjo ishte konsideruara nga ana e autoriteteve si veprim që mund të prishte paqen. Arsye të njëjta ishin ofruar në arsytimin për refuzim të autorizimit të vizitës së ankueses nv Kaledoninë e Re, ku ajo kishte planifikuar të shkonte në udhëtimin tjetër, sërish me ftesë të politikanëve separatistë.

Dy urdhëra ishin lëshuar nga autoritetet e këtyre territoreve kundër ankueses. Gjykatat administrative, ndërkaq, kishin vendosur për anulimin e këtyre urdhërave me kërkesë të ankueses.

Në instancë apeli, Këshilli Shtetëror i Francës në aktgjykimet e datës 12 maj 1989 kishte prishur vendimet e gjykatave administrative mbi bazë të ligjeve franceze, të drejtës së Bashkësisë Evropiane dhe të drejtës ndërkombëtare, duke mbajtur qëndrimin se sjellja e ankueses paraqiste kërcënim për rendin publik.

Në ankesën e saj para Komisionit dhe më pas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ankuesja kishte ngritur në veçanti pretendime për shkelje të nenit 2 të Protokollit Nr. 4 dhe neneve 10, 14 dhe 16 të Konventës.

Përmbledhje e pretendimeve

Në pretendimin e saj në lidhje me nenin 2 të Protokollit Nr. 4, ankuesja ka konsideruar se, pasi ka hyrë në mënyrë të ligjshme në territorin e Polinezisë Franceze dhe Kaledonisë së Re, ajo do të duhej të ishte në gjendje të vazhdonte të gëzonte lirinë e lëvizjes atje. Ajo, gjithashtu, ka mbajtur qëndrimin se masat e ndërmarra kundër saj, kanë qenë në kundërshtim me dispozitat e neneve 10 dhe 14 të Konventës.

Ankuesja ka konsideruar se masa e dëbimit, e kombinuar me ndalimin e hyrjes së sërishme në Polinezinë Franceze kishte si qëllim që të kufizonte opinionet e saj politike dhe lirinë e shprehjes; kjo pavarësisht faktit që ajo ishte anëtare e Parlamentit Evropian, që i jepte asaj të drejtë të interesohej për territorin.

Qeveria, nga ana e saj, ka mbajtur qëndrimin se pasi i janë komunikuar urdhërat e dëbimit, ankuesja nuk ka qenë duke qëndruar më tej në mënyrë të ligjshme në Polinezi. Gjithashtu, Qeveria ka paraqitur pikëpamjen se nuk ka pasur shkelje të lirisë së lëvizjes së ankueses. Kjo pasi, sipas Qeverisë, ajo nuk ka qenë duke udhëtuar as për dhe as nga vendi i takimit të Parlamentit Evropian, prandaj nuk mund të thirret në imunitetet e saj si anëtare e këtij Parlamenti.

Ndërkaq, në lidhje me lirinë e shprehjes, Qeveria ka pranuar se ka pas ndërhyrje nga autoriteti publik, porse e ka karakterizuar si minimale dhe se, për një mori arsyesh, përfshirë atë se ka qenë në pajtim me “kërkesat lokale”, nuk ka pas shkelje të nenit 10 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata nuk ka gjetur shkelje të nenit 2 të Protokollit Nr. 4. Kjo pasi ajo ka vlerësuar se, pasi i është dhënë urdhëri i dëbimit, ankuesja nuk ka qenë më tej në territorin e Polinezisë dhe prandaj nuk ka vuajtur nga ndonjë ndërhyrje në të drejtën e saj për liri të lëvizjes.

Në lidhje me nenin 10, Gjykata ka vlerësuar se ka pas ndërhyrje në lirinë e shprehjes së ankueses. Më tej, Gjykata ka vlerësuar se një situatë politike, qoftë edhe një sensitive, nuk mjafton për të interpretuar frazën “kërkesë lokale” si justifikim për ndërhyrje në të drejtën e garantuar me nenin 10.

Gjykata ka ardhur në përfundimin se, në rastin konkret, nuk është gjetur një baraspeshë e drejtë ndërmjet, në njërin anë, interesit publik që kërkon prishjen e rendit publik dhe, në anën tjetër, lirinë e shprehjes së ankueses. Prandaj, masa e aplikuar nga autoritetet publike nuk ka qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe prandaj ka pas shkelje të nenit 10.

Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 14 në kombinim me nenin 10, duke marrë parasysh faktin e gjetjes së shkeljes së nenit 10, Gjykata e vlerëson të panevojshme që të përcaktojë nëse ka pas shkelje edhe të nenit 14 në kombinim me nenin 10 të Konventës.

Në fund, në lidhje me dëmin jo-material, Gjykata ka vlerësuar se gjetja e shkeljes së nenit 10 paraqet satisfaksion mjaftueshëm të drejtë, sidomos pasi ankuesja nuk ka kërkuar heqjen e urdhërit të dëbimit.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se nuk ka shkelje të nenit 2 të Protokollit Nr. 4 [njëzëri]; gjen se ka pas shkelje të nenit 10 [pesë vota për, kundër katër]; gjen se është e panevojshme të shqyrtojë rastin sipas nenit 14 të Konventës në kombinim me nenin 10 [njëzëri].

Jevgenijs Jegorovs kundër Letonisë - 53281/08

1 korrik 2014 [Seksioni i Katërt]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 3

Trajtim çnjerëzor si pasojë e kushteve të këqija në burg; fitimi i tuberkulozit si pasojë, refuzimit të trajtimit mjekësor respektivisht operimit, të shkruara në gjuhë të huaj janë refuzuar nga autoritetet përkatëse përbënin shkelje / e papranueshme sepse nuk janë shterur mjetet e brendshme

Neni 14 dhe 17

Ndalesës për të shikuar televizion, humbje e pasaportës dhe mos-dhënies së kompensimit invalidor / e papranueshme

Fjalët kyçe: i burgosur / kushte të rënda / sëmundje / trajtim mjekësor / mungesë e kujdesit / refuzim i trajtimit / gjuhë zyrtare / mjete të brendshme

Ankuesi: z. Jevgenijs Jegorovs, shtetas letonez, i cili ka lindur në vitin 1981 dhe po vuan dënimin me burg në burgun Olaine

Faktet e rastit

Më 2 shtator 2005, ankuesi u arrestua. Në nëntor të vitit 2005, për shkak të një dëmtimi në kokë që e ka pasur para ndalimit/arrestimit, si dhe pas pretendimeve për pësim të sulmit epileptik, ankuesi iu nënshtrua një ekzaminimi mjekësor në Spitalin e Burgjeve të Letonisë, mirëpo nuk u regjistruan sulme epileptike. Nga qershori deri në shtator 2007, pas ankesave të ankuesit për kujdesin mjekësor në burgun Daugavpils, Inspektorati Shëndetësor (MADEKKI) filloi një hetim mbi cilësinë e kujdesit mjekësor. Asnjë shkelje nuk ishte identifikuar si rezultat i këtij hetimi. Në tetor të vitit 2007, ankuesi iu nënshtrua një ekzaminimi të përgjithshëm mjekësor, pas së cilës ai u diagnostikua si i sëmurë nga epilepsia. Ai u regjistrua si kategori e tretë me aftësi të kufizuara. Me 12 mars dhe 1 prill 2008, Inspektorati Shëndetësor pranoi kërkesa nga ankuesi që t'i nënshtruhej operacionit plastik sepse gjatë sulmeve epileptike mund të lëndohej në kokë.

Në vitin 2008, pas ankesave të shumta të ankuesit se personeli mjekësor i burgut Daugavpils nuk kishte arritur të regjistronte pësimet e sulmit të tij epileptik dhe të ofronte ndihmë mjekësore, Inspektorati Shëndetësor nuk gjeti shkelje të procedurës së kujdesit shëndetësor. Parashtruesi pretendoi se më 14 maj 2008 kishte apeluar kundër vendimit të mësipërm dhe ia kishte dorëzuar atë autoriteteve të burgut të cilët nuk ia kishin dorëzuar atë marrësit. Në maj të vitit 2008, ankuesi u ankua në Prokurori për kushtet e paraburgimit në burgun e Daugavpils. Përgjigjja e Autoritetit të Burgjeve njohu kushtet e dobëta materiale në një nga qelitë.

Në maj, Gjykata Kurzeme e Rrethit Gjyqësor të Rigas e njoftoi ankuesin se ankesa e tij kundër vendimit të Agjencisë Shtetërore të Sigurimeve Shoqërore (VSAA) nga e cila ishte ndërprerë pagesa e përfitimit të tij të aftësisë së kufizuar në pritje të shërbimit të

dënimit me burg, do të duhej të ishte depozituar në Gjykatën Administrative Rëzekne. Në maj 2009, pas ekzaminimit të tij vjetor mjekësor, ankuesi u diagnostikua si i sëmurë nga tuberkulozi. Në qershor 2009 ankuesi u transferua në një spital të burgut në Olaine. Në korrik të vitit 2009, ankuesi u ankua në Prokurori për kushtet e jetesës në burgun e Daugavpils dhe gjithashtu për faktin se ai kishte fituar tuberkulozin ndërsa ishte ndaluar atje. Zyra e Prokurorit e kishte transferuar ankesën tek Autoriteti i Burgjeve, duke kërkuar që ta shqyrtojë atë dhe ta informojë aplikuesin për rezultatin. Më 10 gusht 2009, Autoriteti i Burgjeve informoi ankuesin se kishte marrë letrën e ankesës së ankuesit të dërguar nga Prokuroria. Letra u la pa u shqyrtuar sepse ishte paraqitur në gjuhën ruse - gjuhë kjo jo zyrtare në Letoni. Autoriteti i Burgjeve u mbështet në udhëzimet për zbatimin e Ligjit Shtetëror të Gjuhëve (Valsts valodas likums), të cilat detyronin Autoritetin t'i shqyrtojë ankesat e parashtruara në një gjuhë jo zyrtare vetëm nëse kanë të bëjnë me çështje urgjente, kriter që nuk plotësohej për ankesën në fjalë sipas Autoritetit të Burgjeve.

Në gusht të vitit 2009, në një letër drejtuar Inspektoratit Shëndetësor, ankuesi si duket ka ngritur çështjen në lidhje me tuberkulozin të cilën ai supozonte se e kishte fituar përderisa vuante dënimin në kushte të varfra të paraburgimit. Inspektorati Shëndetësor sqaroi se ekzaminimi mjekësor në lidhje me infeksionin e tij të mundshëm me tuberkuloz ishte siguruar në përputhje me rregulloret në fuqi të Kabinetit të Ministrave. Ai e informoi atë se, për shkak të mungesës së kompetencës së saj, çështja në lidhje me kushtet e ndalimit në burgun e Daugavpils ishte dërguar në Autoritetin e Burgjeve përgjegjës për kushtet e ndalimit.

Më 27 gusht 2009, Autoriteti i Burgjeve i dërgoi ankuesit një letër identike me atë të dërguar më 10 gusht 2009, duke shpjeguar se çështja nuk kishte të bënte me një çështje urgjente që do të justifikonte shqyrtimin e një letre të parashtruar në një gjuhë jo zyrtare. Ky vendim mund t'i nënshtrohej apelit në Ministrinë e Drejtësisë.

Përmbledhje e pretendimeve

Duke u bazuar në Nenet 3, 14 dhe 17 të Konventës, ankuesi paraqiti disa ankesa në Gjykatë. i u ankua për kushte të këqija në burgun Daugavpils: qelitë, veçanërisht qelia nr. 205, ishte në gjendje të keqe. Kishte mungesa të ujit të nxehtë dhe infeksione të brejtësve dhe insekteve. Dushi nxehtë ishte në dispozicion vetëm një herë në javë. Përveç kësaj, ankuesi u ankua në lidhje me qelinë nr. 205, dërrasat e dyshemesë/llajnsnet ishin rrënuar, në dysheme kishte copëza të çimentos të thatë dhe vrima, guaska e tualetit ishte thyer dhe lavamani ishte dëmtuar, gjë që kishte shkaktuar rrjedhje. Gjithashtu, gjysma e llambave nuk kishin funksionuar. Dritaret ishin mbuluar me një shtresë të dyfishtë të shufrave, të cilat e kishin vështirësuar hyrjen e ajrit të freskët. Përveç qelisë nr. 205, kishte vetëm një qeli tjetër në Burgun Daugavpils (qelia nr. 206) në një gjendje të tillë.

Ankuesi argumentoi se ai kishte fituar tuberkulozin si rezultat i kushteve të këqija në burg. Ai pretendoi se ai kishte dashur të priste një vit e gjashtë muaj para se të ekzaminohej me rrezet X, edhe pse një ekzaminim të tillë e kishte kërkuar çdo vit. Ankuesi gjithashtu u ankua se gjatë qëndrimit në burg kishte frikë për jetën e tij. Që nga viti 2003, ana e majtë e trurit të tij nuk ishte mbrojtur nga një kockë dhe kishte frikë nga rrëzimi si pasojë e pësimit të sulmit epileptik dhe goditja e pjesës së

pambrojtur të kokës së tij. Ai theksoi se sipas diagnozës së tij, ai kishte përjetuar sulme epileptike. Bazuar në atë diagnozë ai ishte certifikuar me kategorinë 3 të paaftësisë. Ankuesi u ankua se njësia mjekësore e burgut Daugavpils nuk e kishte konsideruar se kishte nevojë për kirurgji plastike në kokën e tij.

Në anën tjetër, argumenti kryesor i qeverisë letoneze ishte që ankuesi nuk i kishte shterrur mjetet juridike në përputhje me Nenin 35 të Konventës. Specifikisht, ai nuk kishte apeluar vendimet e 12 qershorit 2008 dhe 10 dhe 27 gushtit 2009 të Autoritetit të Burgjeve pranë Ministrisë së Drejtësisë. Kjo mundësi ishte në dispozicion sipas paragrafit 14 të Rregullores së Kabinetit të Ministrave nr. 827 (2005). Për më tepër, legislacioni parashihet që ndaj vendimit të Ministrisë së Drejtësisë mund të deponohet ankesë në gjykatat administrative.

Ndaj argumenteve se edhe po të ankimoheshin këto vendime, Ministria e Drejtësisë dhe gjykatat administrative do të kishin të njejtën qasje dhe nuk të njihshin obligimin e Autoritetit të Burgjeve/Inspektoratit Shëndetësor që të shqyrtonin një ankesë në gjuhë të huaj, qeveria u kundërpërgjigj se jurisprudenca në këtë pikë varionte shumë, dhe se disa vendime ishin në të njejtën linjë si argumentet e ankuesit, andaj ankuesi duhej t'i shterre mjetet juridike vendore.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata rithekson që qëllimi i Nenit 35 të Konventës është t'u ofrojë Shteteve Kontraktuese mundësinë për të parandaluar ose vënë në rregull shkeljet e pretenduara kundër tyre përpara se këto pretendime t'i paraqiten atij. Ndërsa Neni 35 § 1 i Konventës duhet të zbatohet me njëfarë shkallësie fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar, nuk kërkon thjesht që ankesat të bëhen në gjykatat e përshtatshme të vendit, dhe të përdoren mjete efektive, të hartuara për të sfiduar vendimet tashmë të dhëna. Normalisht, kërkon që ankesat që synojnë të paraqiten më vonë para Gjykatës për të Drejtat e Njeriut, duhet të jenë paraqitur fillimisht në gjykatat vendase dhe të paktën në thelb duhen të jenë të njejtë, sidhe të jenë në përputhje me kërkesat formale dhe afatet kohore të përcaktuara në ligjin vendas.

Sa i përket pretendimeve për kushtet e këqija në burg, Gjykata vëren në fillim se, si dhe duke u ankuar tek autoritetet e tjera vendase, ankuesi gjithashtu i shkroi prokurorisë në lidhje me kushtet e parburgimit. Në rastet e mëparshme Gjykata ka hezituar të pranojë që një ankesë e tillë ishte një mjet efektiv juridik kur autoritetet e prokurorisë ishin në dijeni të gjendjes së një personi në parburgim, por nuk vepruan për të korrigjuar atë situatë. Gjithashtu, Gjykata nuk është bindur se një ankues kishte në dispozicion një mundësi për të kërkuar dëmshpërblim kompensues. Duke pasur parasysh jurisprudencën e Gjykatës, ankuesi nuk ka shpjeguar pse ai mendonte se ankesa në prokurori do të ishte mjet efektiv juridik. Për më tepër, nuk është plotësisht e qartë se cila është kërkesa e ankuesit ndaj prokurorit, pasi që një herë ai kërkoi që ankesa e tij të konsiderohet në thelb dhe në një tjetër që të jepet një koment. Po ashtu, Gjykata nuk e kupton pse ankuesi ka tërhequr njërin nga ankesat e tij në vitin 2008. Pavarësisht kësaj, Gjykata duke pasur parasysh jurisprudencën e zhvilluar të gjykatave administrative në Letoni, të ciat janë marrë me probmatikën e kushteve të këqija në burg, konsideron se ankuesi duhej ta shfrytëzonte këtë instancë. Gjykata thekson se vetëm refuzimi i vazhdueshëm i ankesave të llojit të njejtë do ta bënte këtë mjet juridik jo-efektiv. Por,

përderisa, jurisprudenca varionte në gjykatat administrative, dhe për më tepër këto nuk kishin ndërmarrë një qasje të njejtë formalistike lidhur me ankesat e shkruara në gjuhë të huaj, atëherë, ankuesi do të duhej t'i kishte shterretë të gjitha mjetet juridike, pra edhe instancat gjyqësore, sipas Nenit 35 të Konventës. Prandaj, Gjykata shpall këtë pjesë të ankesës të papranueshme.

Sa i përket pretendimeve për fitimin e tuberkulozit si pasojë e mostrajimit mjekësor në burg, Gjykata vëren se nuk është e qartë nëse, ankuesi i ka kërkuar njësisë mjekësore të burgut ekzaminimin me rrezet X në vitin 2008, të cilin ai nuk e ka pranuar; dhe, në rast se i ishte refuzuar kërkesa, a është ankuar sipas procedurës administrative. Siç është vërejtur nga Gjykata në rastin *Antonov*, ankesa në gjykatat administrative në kontekstin e procedimeve për mungesën e kujdesit mjekësor në burg ishte mjet juridik në dispozicion të një individi. Ajo çka dihet është se ankuesi e tërhoqi çështjen e radiografisë me rrezet X, në vëmendjen e autoriteteve vendase, duke përfshirë edhe zyrën e prokurorit, pasi që u diagnostikua me tuberkuloz në vitin 2009. Edhe nëse ishte e vërtetë që sipas ligjit të brendshëm një ekzaminim i tillë duhej të kryhej çdo dymbëdhjetë muaj, Gjykata nuk është në gjendje të pajtohet me atë se dështimi i burgut për të ofruar ekzaminimin me rreze X të ankuesit në vitin 2008 në vetvete ngre një çështje sipas Nenit 3. Ajo që është relevante këtu është nëse kujdesi mjekësor i ofruar ishte i përshtatshëm, duke marrë parasysh gjendjen shëndetësore të ankuesit. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se ankuesi nuk u ka treguar autoriteteve vendase se stafi mjekësor i burgut kishte lënë pas dore ankesat e tij për simptomat që kishin rezultuar në problemet e tij shëndetësore. Siç ka thënë Gjykata më parë, edhe nëse një aplikant do ta fitonte tuberkulozin gjatë kohës së paraburgimit, kjo në vetvete nuk do të nënkuptonte shkelje të Nenit 3, me kusht që ai të merrte trajtim për të. Në rastin në fjalë, nuk është ngritur asnjë ankesë nga ankuesi lidhur me trajtimin e tuberkulozit të tij. Po ashtu, Gjykata vëren ankuesi kishte qëndruar në periudha të kufizuara kohore në qelinë nr. 205: në një rast katërbëdhjetë ditë dhe në një tjetër, pesë ditë. Andaj mbi bazën e këtyre argumenteve, Gjykata nuk është e bindur se ankuesi ka sjellë para autoriteteve vendore një ankesë për neglizhencë nga ana e personelit të burgjeve që çon në fitimin e tuberkulozit, ashtu që të kërkojë hetim penal. Po ashtu, pavarësisht shqetësimeve lidhur me ankesat e shkruara në gjuhë të huaj, ai duhet të kishte ndjekur rastin e tij në gjykata administrative. Për shkak se nuk kishte shterretur mjetet juridike, kjo pjesë e ankesës shpallet e papranueshme.

Sa i përket pretendimeve për nevojën e operacionit plastik, Gjykata vëren se është kontestuar ndërmjet palëve nëse ankuesi ka apeluar vendimin e Inspektoratit Shëndetësor të datës 8 maj 2008. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkeses paraqiti disa ankesa tek Autoriteti i Burgjeve dhe Inspektoriati Shëndetësor. Megjithatë, ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë se ai ka paraqitur ankesë në gjykatat administrative që kontestojnë refuzimin e pretenduar nga stafi i burgut për të lejuar që ai të operohet, në kuadrin e procedurave për mungesën e kujdesit mjekësor në burgun e Daugavpils. Edhe në qoftë se ankuesi do të kishte insistuar në një vlerësim nga Inspektorati Shëndetësor, ai do të duhej të kishte paraqitur ankesë në gjykatat administrative. Pra, edhe pse ankuesi nuk kishte pranuar përgjigje nga kreu i Inspektoratit Shëndetësor ndaj ankesës së tij kundër vendimit të 8 majit 2008, nuk ka asnjë provë se ankuesi ka kërkuar të paraqiste ankesë të mëtejshme përpara gjykatave administrative. Andaj,

Gjykata shpall të papranueshme këtë pjesë të ankesës nën arsyetimin e mos-shterrjes së të gjitha mjeteve juridike vendore.

Lidhur me ankesat e tjera të bazuara në Nenin 3, 14 dhe 17, sidomos ndalesës për të shikuar televizion, humbjes së pasaportës dhe mos-dhënies së kompensimit invalidor, sa ishte në qelinë nr. 203, Gjykata vendosi se nuk duket të ketë shkelje të qarta të ndonjë nga të drejtat garantuara me Konventë andaj duhen refuzuar sipast Nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata shpall kërkesën si të papranueshme [njëzëri].

Perinçek kundër Zvicrës - 27510/08

15 tetor 2015 [Dhoma e Madhe]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 10

Shkelje e lirisë së shprehjes si pasojë e dënimit për deklarimin publik se nuk kishte pasur kurrë genocid armen / *ka shkelje*

Neni 7

Dënimi penal ishte bazuar në një nen që nuk ishte i qartë andaj shkeli parimin se "nuk ka dënim pa ligj" / *e panevojshme për shqyrtim*

Fjalët kyçe: *deklaratë / mohim gjenocidi / shtetas i huaj / ndalim me ligj / dënim me burgim / gjenocid armen / liri e shprehjes / nxitje e urrejtjes / e parashikuar me ligj*

Ankuesi: z. Doğu Perinçek, shtetas turk, lindur në vitin 1942 dhe jeton në Ankara

Faktet e rastit

Ankuesi është doktor i drejtësisë dhe kryetar i Partisë Turke të Punëtorëve. Në vitin 2005, ankuesi mori pjesë në tri ngjarje publike në Zvicër. Gjatë këtyre ngjarjeve publike, ai mbajti fjalime ku tha se "Gjenocidi armen' është një gënjeshtër ndërkombëtare" dhe akuzoi fuqitë e mëdha duke iu referuar SHBA-ve, Evropës dhe disa shteteve tjera.

Më 15 korrik 2005, Asociacioni Zvicër-Armeni paraqiti një ankesë penale kundër ankuesit për shkak të deklaratës së parë të lartpërmendur. Më pas, hetimi u zgjerua për të mbuluar edhe dy deklaratat e tjera dhëne në mënyrë verbale. Më 23 korrik 2005, ankuesi u intervistua nga prokurori publik i Winterthurit në lidhje me deklaratën që kishte bërë në hotelin Hilton në Opfikon. Më 20 shtator 2005 ai u intervistua nga një gjykatës kantonale hetues në Kantonin e Vaudit. Më 27 prill 2006, duke marrë parasysh se të tre deklaratat e bëra nga ankuesi binin në kuadër të Nenit 261 bis § 4 të Kodit Penal, gjyqtari kompetent kantonale i kantonit të Vaudit vendosi të dergoi kërkesën për gjykim. Gjykimi u zhvillua para Gjykatës së Rrethit Policor të Lozanës më 6 dhe 8 mars 2007.

Më 6 mars 2007, gjykata dëgjoi ankuesin, prokurorin publik dhe Shoqatën Zvicër-Armeni, e cila ishte ftuar si palë civile. Gjykata pastaj vazhdoi të dëgjonte gjashtë historianë profesionistë - një amerikan, tre francezë, një gjerman dhe një britanik - dhe një sociolog që partitë u kishin bërë thirrje për të dhënë dëshmi.

Më 8 mars 2007, avokati i kërkuetit i kërkoi gjykatës të mblidhte dëshmi të mëtejshme në lidhje me ngjarjet e vitit 1915 dhe vitet në vijim. Gjykata e hodhi poshtë kërkesën, duke e konsideruar si të vonuar dhe që do të çonte në një shtyrje të procedurës.

Më 9 mars 2007, Gjykata e Policisë së Qarkut në Luzanë e gjeti ankuesin fajtor për veprën penale sipas Nenit 261 bis § 4 të Kodit Penal dhe e urdhëroi atë të paguante gjobat prej 100 franga zvicerane (CHF - 62 EUR (EUR) në atë kohë) një gjobë prej 3.000 frangash (1.859 EUR në atë kohë), e cila mund të zëvendësohet me 30 ditë

burgim dhe shuma prej 1.000 frangave (620 EUR në atë kohë) në kompensim për Shoqatën Zvicër-Armeni për dëmtim jo-material.

Përmbledhje e pretendimeve

Në qershor 2008, ankuesi paraqiti një kërkesë në Gjykatën Evropiane kundër qeverisë së Zvicrës, duke pretenduar, ndër të tjera, se dënimi i tij shkeli të drejtën e tij për lirinë e shprehjes sipas Nenit 10 të Konventës. Ankuesi pretendoi se gjykatat zvicerane kishin shkelur lirinë e shprehjes duke e dënuar atë për deklarimin publik se nuk kishte pasur kurrë genocid armen. Ai në veçanti argumentoi se Neni 261 bis § 4 i Kodit Penal Zviceran nuk ishte mjaftueshëm i parashikueshëm në zbatimin e tij, se dënimi i tij nuk ishte justifikuar nga ndjekja e një qëllimi legjitim dhe se shkelja e supozuar e lirisë së shprehjes kishte nuk ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike".

Gjithashtu ankuesi pretendoi se të drejtat e tij sipas Nenit 7 të Konventës ishin shkelur duke argumentuar se formulimi i Nenit 261 bis § 4 i Kodit Penal Zviceran ishte shumë i paqartë. Per këtë ankuesi pohoi se dënimi i tij penal shkeli parimin "nuk ka dënim pa ligj" të parashikuar në Nenin 7 të Konventës. Duke u bazuar në Nenin 6 të Konventës, ankuesi u ankua se nuk i ishte dhënë viza nga ana e Qeverisë Zvicerane dhe për këtë arsye nuk kishte qenë në gjendje të takohej me avokatin e tij gjatë procedurave gjyqësore. Ai gjithashtu u ankua se Gjykata e Qarkut në Lausanne dhe Gjykata Federale nuk kishin shqyrtuar disa dokumente të paraqitura prej tij. Ai më tej pohoi se këto gjykata kishin kryer një "gabim të madh në vlerësimin e provave", pa dhënë ndonjë shpjegim, në lidhje me një aktgjykim të Gjykatës së Rrethit Berne-Laupen.

Së fundmi, ankuesi u mbështet në Nenet 14, 17 dhe 18 të Konventës. Ai parashitroi se gjykatat zvicerane kishin përdorur gjuhën diskriminuese kundër tij në gjykimet e tyre. Gjykata i hodhi poshtë këto pretendime si ta pabazuara.

Arsyetimi i Gjykatës

Çështja e parë përpara Gjykatës ishte nëse dënimi penal i ankuesit mund të justifikohet sipas Nenit 16 të Konventës. Sipas Nenit 10 të Konventës, secili ka të drejtën e marrjes dhe dhënies së informacionit dhe ideve "pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. "Ushtrimi i kësaj lirie, megjithatë, mund të jetë subjekt i" formaliteteve, kushteve, kufizimeve apo dënimeve të tilla siç janë të përcaktuara me ligj dhe janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike... ". Për më shumë Neni 16 i Konventës thotë: "Asgjë në Nenet 10, 11 dhe 14 nuk do të konsiderohet se pengon Palët e Larta Kontraktuese të vendosin kufizime mbi veprimtarinë politike të të huajve." Andaj Qeveria zvicerane argumentoi se dënimi i ankuesit dhe dënimi ishte i justifikuar sipas këtij neni. Gjykata vuri në dukje se Neni 16 u përdor vetëm një herë në kontekstin e lirisë së shprehjes në *Piermont kundër Francës*,⁸⁶ ku një shtetase gjerman u përjashtua nga Franca si rezultat i fjalës së saj. Gjykata u shpreh se Neni 16 nuk ishte i zbatueshëm për shkak se ajo ishte shtetas i një shteti tjetër anëtar të Bashkimit Evropian dhe për këtë arsye ajo nuk ishte një i huaj në kuptim të Nenit 16. Këtu, Gjykata vendosi që "Neni 16 duhet të interpretohet si i aftë vetëm për të autorizuar

⁸⁶ *Piermont kundër Francës*, Seria A nr. 314 (1995)

kufizimet mbi "aktivitetet" që ndikojnë drejtpërdrejt në procesin politik të partisë shtetërore "dhe jo të drejtën e të huajit për liritë e mendimit dhe shprehjes.

Çështja e dytë ishte nëse dënimi penal i ankuesit përbënte një ndërhyrje të justifikuar sipas Nenit 10 të Konventës. Sipas Gjykatës, që një ndërhyrje të konsiderohet e justifikuar, duhet ti plotësoj disa kushte: duhet të ketë qenë e përcaktuar me ligj; e synuar për një ose më shumë qëllime legjitime dhe; e nevojshme në një shoqëri demokratike për të arritur këtë qëllim apo synime. Veç kësaj, Gjykata theksoi se fraza "e përcaktuar me ligj" nënkupton se masat kufizuese të qeverive duhet të formulohen me saktësi të mjaftueshme për ti mundësuar personit në fjalë që të rregullojë sjelljen e tij / saj. Andaj Gjykata fillimisht adresoi çështjen nëse në kohën e shprehjes së deklaratave të tij, ankuesi e dinte ose duhet të kishte ditur se këto deklaratat mund ta bënë atë përgjegjës penalisht. Qeveria pretendoi sipas Nenit 261 bis § 4 i Kodit të tij Penal, mohimi i gjenocidit dhe krimeve kundër njerëzimit përbën një kundërvajtje dhe se mund të ketë pak mosmarrëveshje se mizoritë e kryera kundër armenëve përbënin krime të tilla të rënda. Gjykata vuri në dukje pranimin e mëparshëm të ankuesit tek autoritetet ndjekëse, duke pranuar se Këshilli Kombëtar Zviceran kishte njohur ngjarjet e vitit 1915 si gjenocid kundër armenëve. Në dritën e këtij fakti, Gjykata vlerëson se dënimi i tij ishte "i parashikueshëm në mënyrë të mjaftueshme dhe, për rrjedhojë, i përcaktuar me ligj në kuptim të Nenit 10 § 2 të Konventës.

Çështja e tretë ishte nëse bindja e tij ishte në përputhje me një ose më shumë qëllime legjitime të njohura sipas Nenit 10 të Konventës, si siguria kombëtare, parandalimi i trazirave ose krimi, ose mbrojtja e reputacionit ose e të drejtave të të tjerëve. Qeveria zvicerane argumentoi se ndërhyrja në të drejtën e ankuesit për lirinë e shprehjes ishte në përputhje me dy qëllime legjitime, përkatësisht për për parandalimin e çrregullimit dhe mbrojtjen e identitetit dhe dinjitetit të armenëve. Përsa i përket parandalimit të çrregullimit, Gjykata e vendosi barrënte tek qeveria zvicerane për të treguar se mohimi i gjenocidit armen nga ankuesi ishte i aftë të "çonte ose çoi në çrregullim". Gjykata gjeti se qeveria nuk arriti të paraqiste ndonjë dëshmi specifike që tregon se deklaratat e ankuesit ishin të afta të çonin në shqetësime ose trazira publike. Sa i përket qëllimit të mbrojtjes së të drejtës së armenëve ndaj identitetit dhe dinjitetit, Gjykata u shpreh se ndërhyrja e qeverisë kishte për qëllim të mbrojë këtë objektiv. Ndërsa ankuesi nuk i drejtoi në mënyrë specifike deklaratat e tij ndaj komunitetit armen, përjashtimisht deklaratës së parë ku i kishte quajtur ata 'vrasës. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se ndërhyrja në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes ishte në përputhje me kriteret që kërkohen siç duhet për të arritur qëllimin e mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve në kuptim të Nenit 10.

Çështja e fundit ishte nëse ndërhyrja e tillë ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Në pajtim me jurisprudencën e saj, Gjykata vuri në dukje se mbiemri "i domosdoshëm" sipas Nenit 10 nënkupton ekzistencën e një nevojë urgjente sociale. Por shtetet palë në Konventë gëzojnë një hapësirë vlerësimi në vlerësimin nëse ekziston një nevojë e tillë. Në *Aksu kundër Turqisë*,⁸⁷ Gjykata u shpreh se stereotipet negative të një grupi etnik, veqanërisht kur arrihet një nivel i caktuar, të ndikojë në ndjenjën e identitetit të grupit dhe në ndjenjat e vetëvlerësimit dhe vetëbesimit të anëtarëve të tij

⁸⁷ *Aksu kundër Turqisë*, Kërkesat nr. 4149/04 dhe 41029/04 (2012)

dhe për këtë arsye stereotipet e tilla negative hynin në kuptim të Nenit 8 të Konventës për të drejtën e jetës private. Duke pas parasysh identitetin e popullit armen i perceptuar si një grup që pësoi mizori gjatë ngjarjeve të 1915, Gjykata vlerësoi nëse ishte arritur një baraspeshë e drejtë në mes të së drejtës për lirinë e shprehjes dhe të drejtës për jetën private. Lidhur me deklaratat e ankuesit, Gjykata kujtoi praktikën e saj gjyqësore lidhur me mohimin e Holokaustit, duke përfshirë deklaratat që mohonin ekzistencën e dhomave të gazit ose duke përshkruar Holokaustin si sham ose mit. Megjithatë, Gjykata theksoi se vlerësimi i saj për domosdoshmërinë e ndërhyrjes në deklaratat që kanë të bëjnë me ngjarjet historike ka qenë "mjaft specifike për rastin dhe ka varur në ndërveprimin midis natyrës dhe efekteve të mundshme të deklaratave të tilla dhe kontekstit në të cilin ato janë bërë. Prandaj, Gjykata vlerësoi mohimin publik të genocidit armen nga ankuesi përmes një numri faktorësh, gjegjësisht: (1) natyrën e deklaratave të tij; (2) vendi dhe koha kur janë bërë deklaratat; (3) shkalla deri në të cilën të drejtat e armenëve u prekën; (4) ekzistenca ose mungesa e konsensusit midis shteteve palë për kriminalizimin e mohimit të genocidit, dhe (5) aspirimin e ndërhyrjes.

Sa i përket natyës së deklaratave të ankuesit, sipas jurisprudencës së Gjykatës, e dretja në "shprehje" për çështje me interes publik në parim ka të drejtën e mbrojtjes së fortë, ndërsa shprehja që nxit ose justifikon dhunën, urrejtjen, ksenofobinë ose një formë tjetër të jotolerancës normalisht nuk mund të pretendojë mbrojtje. Gjykata vlerësoi se deklaratat e ankuesit kishin të bënin me një çështje me interes publik, sepse ai shprehte pikëpamjet e tij si politikan, më tepër sesa një studiues historik dhe nëse genocidi ishte kryer kundër armenëve, ishte debatuar publikisht në Zvicër. Gjykata arriti në përfundimin se ndërsa vërejtjet e tij ishin virulente dhe se pozita e tij ishte e papërshtatshme, por duhet të kuptohej se këto deklarata me sa duket përfshinin një element të ekzagjerimit ndërsa kërkonin të tërhiqnin vëmendjen. Në lidhje me faktorët gjeografikë dhe historikë Gjykata pranoi se mohimi i Holokaustit mund të jetë veçanërisht i rrezikshëm në vendet që kanë përjetuar tmerret naziste, të cilat mund të kërkojnë përgjegjësi të posaçme morale për të nxjerrë jashtë ligjit këtë mohim. Në këtë rast, Gjykata nuk gjeti një lidhje të drejtpërdrejtë midis Zvicrës dhe ngjarjeve që ndodhën në Perandorinë Osmane në vitin 1915 dhe vitet pasuese. Në veçanti, ajo vlerësoi se është e vështirë të thuhet se çdo armiqësi që ekziston ndaj pakicës armene në Turqi është produkt i deklaratave të tij në Zvicër ose se dënimi penal i tij në Zvicër ka mbrojtur të drejtat e pakicave në çdo mënyrë reale ose e bëri atë të ndihet më e sigurt. Tutje në lidhje me faktorin kohor Gjykata gjithashtu konsideroi kalimin e kohës midis deklaratave të ankuesit dhe ngjarjeve të vitit 1951. Ajo theksoi se ndonëse ngjarjet relativisht të kohëve të fundit mund të jenë aq traumatike sa të garantojnë për një periudhë kohore një shkallë më të lartë e rregullimit të deklaratave që kanë të bëjnë me ta, nevoja për një rregullim të tillë është e detyruar të pakësohet me kalimin e kohës.

Së fundi Gjykata analizoi nëse shtetet e tjera kriminalizojnë mohimin e ngjarjeve historike, ku vërejtje se Austria, Belgjika, Franca, Gjermania, Holanda dhe Rumania e kriminalizojnë vetëm mohimin e krimeve të Holokaustit dhe nazistëve, ndërsa Andorra, Qipro, Hungaria, Letonia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Maltë, Sllovakia, Sllovenia dhe Zvicra dënojnë

penalisht mohimin e çdo gjenocidi. Pavarësisht nga kjo, Gjykata gjeti se Zvicra "qëndron në një fund të spektrit krahasues" pasi që penalizon mohimin e çdo genocidi pa kërkesën që ajo të kryhet në një mënyrë që ka gjasa të nxisë dhunën ose urrejtje. Më vonë, Gjykata vlerësoi se dënimi penal i ankuesit, i cili mund të rezultonte me burgim, ishte subjekt i një shqyrtimi të rreptë dhe, për rrjedhojë, ishte e rëndë sidomos kur mund të vendoseshin mjete të tjera sanksionesh nga qeveria zvicerane.

Duke marrë parasysh të gjithë faktorët e lartpërmendur, Gjykata arriti në përfundimin se ndërhyrja e qeverisë zvicerane në të drejtën e ankuesit për lirinë e shprehjes nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Si rezultat, ai gjeti se kishte shkelje të Nenit 10 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Nenit 10 të Konventës; se nuk ka nevojë të shqyrtohet veçmas pranueshmëria ose meritat e ankesës sipas Nenit 7 të Konventës; [*me shtatë vota pro dhe tri kundër*].

Neni 17

Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individi, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.

Vajnai kundër Hungarisë - 33629/06
8 korrik 2008 [Seksioni i Dytë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 10

Vendosja e masës së ndalimit për shkak të përdorimit të simbolit totalitar (yllit të kuq) të ndaluar me ligj është në kundërshtim me lirinë e shprehjes / *ka shkelje*

Neni 17

Pretenim për shkelje të së drejtës në peticion pranë Gjykatës / *hedhet poshtë*

Fjalët kyçe: *protestë / e ligjshme / parti politikë / simbol / yll i kuq / simbol i punëtorëve / propagandë / totalitarizëm / dënim / liri e shprehjes*

Ankuesi: z. Attila Vajnai, shtetas hungarez i lindur në vitin 1963 dhe jeton në Budapest

Faktet e rastit

Ankuesi ishte nënkryetari i Partisë së Punëtorëve, një parti politike e majtë. Ai ishte udhëheqës në një protestë të ligjshme në Budapestin qendror. Gjatë fjalimit, në protestë në xhaketën e tij, mbante një yll të kuq me pesë krahe: një simbol i lëvizjes ndërkombëtare të punëtorëve. Një patrullë policore i bëri thirrje ankuesit për të hequr yllin në përputhje me Nenin 269 / B (1) të Kodit Penal, të cilin ai e bëri. Më pas, procedura penale u ngritën kundër ankuesit shkak i mbajtjes në publik të një simboli totalitar. Ai u mor në pyetje si i dyshuar më 10 mars 2003. Më 11 mars 2004, Gjykata Qendrore e Rrethit Pest dënoi ankuesin për veprën penale të përdorimit të një simboli totalitar. Megjithatë, gjykatat nuk vendosen sanksione për një periudhë provuese prej një viti. Ankuesi apeloi në Gjykatën Rajonale të Budapestit. Më 16 nëntor 2005, Gjykata rajonale e Budapestit mbështeti ankesën e ankuesit.

Më 24 qershor 2004, ajo gjykatë vendosi të pezullojë procedurën dhe t'ia referojë rastin Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJED) për një vendim paraprak në bazë të Nenit 234 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian. Referenca - e marrë në GJED më 28 korrik 2004 - ka të bëjë me interpretimin e parimit të mosdiskriminimit si një parim themelor i së drejtës komunitare. Në urdhërin për referim, Gjykata Rajonale vërejtë se në disa shtete anëtare të Bashkimit Evropian, si Republika e Italisë, simboli i partive të krahut të majtë është yll i kuq ose çekiçi dhe drapëri. Prandaj, u ngrit pyetja nëse një dispozitë në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian që ndalonte përdorimin e simboleve të lëvizjes ndërkombëtare të punës për shkak të vuajtjes së ndjekjes penale ishte diskriminuese, kur një shfaqje e tillë në një shtet tjetër anëtar nuk u sanksionua. Më 6 tetor 2005, GJED deklaroi se nuk kishte juridiksion për t'iu përgjigjur pyetjes së parashtruar nga Gjykata Rajonale.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi u ankua se fakti që ai ishte ndjekur penalisht pasi që kishte mbajtur një yll të kuq shkeli të drejtën e tij për lirinë e shprehjes të garantuar me Nenin 10 të Konventës.

Ai argumentoi se kishte një ndryshim të thellë midis ideologjive fashiste dhe komuniste dhe se, në çdo rast, ylli i kuq nuk mund të lidhej ekskluzivisht me "diktaturën komuniste". Sipas ankuesit në lëvizjen ndërkombëtare të punëtorëve, ylli i kuq - ndonjëherë i kuptuar si përfaqësues i pesë gishtave të dorës së një punëtori ose të pesë kontinenteve - ishte konsideruar që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë si një simbol i luftës për drejtësinë sociale, çlirimin e punëtorëve dhe lirinë e njerëzve, dhe, përgjithësisht, të socializmit në një kuptim të gjerë. Ankuesi pranoi se përpara kalimit në demokraci në Evropën Qendrore dhe Lindore, krimet e rënda ishin kryer nga forcat e sigurisë të regjimeve totalitare, simbole zyrtare të të cilave përfshinin yllin e kuq. Këto shkelje të të drejtave të njeriut, megjithatë, nuk mund të diskreditojnë ideologjinë e komunizmit si të tillë, e lëre më të sfidojnë vlerat politike të simbolizuara nga ylli i kuq. Ankuesi tërhoqi vëmendjen tek fakti se, ndryshe nga propaganda fashiste, promovimi i komunizmit nuk ishte nxjerrë jashtë ligjit nga instrumentet e së drejtës ndërkombëtare. Ylli i kuq u kuptua për të përfaqësuar idetë dhe lëvizjet e ndryshme të krahut të majtë dhe mund të shfaqet lirisht në shumicën e shteteve evropiane. Në fakt, Hungaria ishte i vetmi shtet kontraktues në të cilin shfaqja e saj publike ishte një veprë penale. Së fundi, ankuesi theksoi se Qeveria nuk kishte treguar ekzistencën e një "nevoje sociale të ngutshme" që kërkonte një ndalim të përgjithshëm në shfaqjen publike të këtij simboli. Sipas tij, nuk ka gjasa që stabiliteti i demokracisë pluraliste të Hungarisë të dëmtohet nga përdorimi i një logoje politike për të shprehur një përkatësi ideologjike dhe identitet politik. Përkundrazi, ndalimi i përgjithshëm për përdorimin e yllit të kuq si një simbol politik minonte pluralizmin duke e penguar atë dhe politikanët e tjerët të krahut të majtë për të shprehur lirshëm pikëpamjet e tyre politike.

Qeveria kundërshtoi këto argumente duke u referuar në gjetjet e Gjykatës Kushtetuese se kufizimi në fjalë, duke pasur parasysh përvojën historike të shoqërisë hungareze, kishte qenë një përgjigje ndaj "nevojës sociale të ngutshme" në ndjekje të qëllimeve legjitime të parandalimit të trazirave dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kjo gjykatë ishte e bindur se këto synime nuk mund të arriheshin me mjete më pak të rënda sesa ato të ligjit penal. Qeveria gjithashtu pohoi se vepra penale në fjalë nuk ishte cilësuar si një krim, por vetëm si kundërvajtje e dënueshme me gjobë penale që ishte sanksioni më i vogël në ligjin penal hungarez. Për më tepër, sipa Qeverisë ankuesi ishte vënë në provë, e cila nuk ishte dënim por një "masë" ligjore.

Arsyetimi i Gjykatës

Në kundërshtimet preliminare Qeveria kishte argumentuar se rasti nuk ishte në përputhje me Konventën *ratione materiae*, për shkak të aplikimit të nenit 17 që i lejonte një shteti ndalimin e veprimtarisë politike një individi në territorin e vet. Gjykata vëren se ankuesi ishte, në kohën një zyrtar i një partie politike të majtë të regjistruar dhe e veshi yllin e kuq të kontestuar në një nga demonstratat e tij të ligjshme. Në këto rrethana, Gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin se shfaqja e saj kishte për qëllim të justifikonte ose të përhapte shtypjen totalitare që shërbente ndaj "grupeve totalitare". Ishte thjesht simbol i lëvizjeve të ligjshme politike të krahut të majtë. Rrjedhimisht, për Gjykatën, kërkesa nuk përbën keqpërdorim të së drejtës së kërkesës për qëllimet e nenit 17 të Konventës, andaj e shpall atë të pranueshme.

Në lidhje me meritat e rastit Gjykata shqyrtoi fillimisht nëse ka pasur ndonjë ndërhyrje nga ana e Qeverisë. Gjykata konsideron se sanksionet penale në fjalë përbënin një ndërhyrje në të drejtat e ankuesit të sanksionuara ng Nenin 10 § 1 të Konventës. Në lidhje me atë se ndërhyrja në fjalë a ka ndjek një qëllim legjitim Gjykata u shpreh se ndërhyrja ndoqi qëllimet legjitime të parandalimit të çrregullimit dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Më pas Gjykata analizoi nëse ndërhyrja në fjalë ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Në lidhje e natyrën dhe domethënien e yllit ankuesi edhe qeveria kishin argumente te ndryshme. Ankuesi kishte argumentuar se kishte një ndryshim të thellë midis ideologjive fashiste dhe komuniste dhe se ylli i kuq nuk mund të lidhej ekskluzivisht me "diktaturën komuniste". Ndryshe nga propaganda fashiste, promovimi i komunizmit nuk ishte nxjerrë jashtë ligjit në të drejtën ndërkombëtare dhe ylli i kuq u kuptua të përfaqësonte lëvizjet e krahut të majtë në shumicën e shteteve evropiane. Megjithatë, Hungaria ishte i vetmi Shtet Kontraktues në të cilin shfaqja publike e këtij simboli ishte një vepër penale. Në përgjigje, Qeveria parashtroi se, në Hungari, ylli i kuq nuk ishte vetëm simbol i lëvizjes së punëtorëve ndërkombëtar, siç pohohet nga ankuesi. Historia e kohëve të fundit në Hungari kishte ndryshuar kuptimin e saj për të simbolizuar një regjim totalitar të karakterizuar nga ideologji dhe praktika që kishin justifikuar shkeljet masive të të drejtave të njeriut dhe sekuestrimin e dhunshëm të pushtetit. Të mbante këtë simbol në publik kishte të bënte me identifikimin me qëllimin për të propaganduar ideologjitë e një natyre totalitare që karakterizonte diktaturat komuniste. Qeveria pohoi se qëllimet legjitime të cilat i identifikuan nuk mund të arriheshin me masa më pak të rënda sesa ato të së drejtës penale, të cilat kishin qenë një përgjigje proporcionale. Qeveria gjithashtu pohoi se vepra penale mori sanksionin më pak të ashpër në ligjin penal të Hungarisë dhe se ankuesit i ishte caktuar periudha provuese.

Në fillim, Gjykata vuri në dukje se dy dekada kishin kaluar që nga tranzicioni i Hungarisë në pluralizëm dhe se vendi tani është një demokraci e qëndrueshme. Gjykata identifikoi se një ndalim i përgjithshëm i simboleve që kanë kuptime të shumta mund të kufizojë përdorimin e tyre në kontekste në të cilat asnjë kufizim nuk do të ishte justifikim. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, ylli i kuq nuk mund të kuptohet se përfaqëson vetëm sundimin totalitar komunist, pasi simbolizon gjithashtu lëvizjen e punëtorëve ndërkombëtarë dhe partitë e tjera të ligjshme politike. Gjykata u shpreh se qeveria nuk kishte treguar se veshja e yllit të kuq do të thotë ekskluzivisht identifikim me idetë totalitare, sidomos duke pasur parasysh faktin që kërkuesi e bëri këtë në një demonstrim të organizuar në mënyrë të ligjshme si nënkryetar i një partie të regjistruar politike të krahut të majtë, pa ndonjë qëllim të njohur për të sfiduar sundimin e ligjit. Rrjedhimisht, Gjykata pohoi që shqyrtimi i kujdesshëm i kontekstit është i domosdoshëm për të dalluar shprehjen që është tronditëse dhe ofenduese dhe atë që e humb mbrojtjen sipas Nenit 10. Rrjedhimisht, Gjykata e konsideronte ndalimin të jetë shumë i gjerë duke pasur parasysh kuptimet e shumëfishta të këtij simboli. Ndalimi konsiderohej të përfshinte aktivitete dhe ide të cilat mbrohen nga Neni 10 dhe se nuk kishte asnjë mënyrë të kënaqshme për të prerë kuptimet e ndryshme të simbolit. Për më tepër, edhe nëse ekzistonin dallime të tilla, paqartësitë mund të kenë ndikuar në një efekt ngricues në lirinë e shprehjes dhe vetëcensurimit.

Gjykata vuri në dukje se Qeveria nuk kishte referuar asnjë instancë në të cilën edhe një rrezik i largët i çrregullimit ishte shkaktuar nga shfaqja publike e një ylli të kuq. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, mbajtja e një rreziku spekulativ thjesht për mbrojtjen e demokracisë nuk mund të shihet si një "nevojë urgjente sociale". Në çdo rast, ekzistojnë një numër veprash të sanksionuara nga ligji hungarez, të cilat synojnë të shtypin shqetësimet publike, dhe Neni 269 / B i Kodit Penal Hungarez nuk provon se shfaqja aktuale e simbolit ishte një propagandë totalitare. Kjo veçori e ndalimit konfirmoi gjetjen se është e pa pranueshme. Gjykata pranoi se shfaqja e yllit të kuq, i cili ishte i pranishëm gjatë sundimit komunist në Hungari, mund të krijojë shqetësim midis viktimave të së kaluarës dhe familjeve të tyre. Megjithatë, Gjykata komentoi se duke pasur parasysh sigurimet që Hungaria u dha viktimave të komunizmit, emocione të tilla nuk mund të konsiderohen si frikë racionale. Gjykata deklaroi se një sistem ligjor i cili zbaton kufizime për të drejtat e njeriut me qëllim të përmbushjes së diktateve të ndjenjës publike nuk mund të konsiderohet se përmbush nevojat e ngutshme sociale të një shoqërie demokratike, pasi një shoqëri demokratike duhet të mbetet e arsyeshme në gjykimin e saj. Gjykata u shpreh se dënimi i ankuesit nuk mund të konsiderohej si përgjigje ndaj "nevojës sociale të ngutshme". Për më tepër, Gjykata nuk e konsideronte sanksionin e vendosur të jetë në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur. Kështu, Gjykata konstatoi se ndërhyrja shkeli Nenin 10 të Konventës. Lidhur me dëmet e pretenduara Gjykata vendos se konstatimi i një shkelje përbën një kompensim të mjaftueshëm të duhur për çdo dëm jomaterial që ankuesi mund të ketë vuajtur.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Nenit 10 të Konventës [*njëzëri*].

Garaudy kundër Francës - 65831/01

7 korrik 2003 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 17

Libri i ankuesit ku tentohej mohimi ose rishkrimi i një fakti të tillë historik është i papërputhshëm me demokracinë dhe të drejtat e njeriut dhe pa dyshim bie në kategorinë e qëllimeve të ndaluara sipas nenit 17 ku parashihet se akush nuk mund të keqpërdor ndonjë të drejtë të garantuar me Konventë për t'u përfshirë në aktivitete ose për të kryer veprime që synojnë cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë

Neni 10

Pretendim për shkelje të lirisë së shprehjes si pasojë e dënimit për publikimin e një libri që mohimte e ekzistencës së krimeve kundër njerëzimit, përmbante shpifje publike kundër një grupi të njerëzve, që do të thotë komunitetin hebraik në këtë rast, dhe nxitje për diskriminim dhe urrejtje racore / e paparnueshme

Neni 6

Pretendim për shkelje të së drejtës në gjykatë në mungesë së informimit të duhur lidhur me akuzat dhe paanshmërinë e gjykatësve / nuk ka shkelje

Fjalët kyçe: botim / libër / mohim i krimeve / ndërrim i historisë / liri e shprehjes / keqpërdorim i Konventës

Ankuesi: z. Roger Garaudy, shtetas francez, i lindur në vitin 1913 dhe që jeton Chennevières-sur-Marne (Val de Marne)

Faktet e rastit

Ankuesi ishte filozof, shkrimtar dhe ish-politikan. Ai është autor i librit *Mitet Themeltare të Izraelit Modern*, që ishte shpërndarë përmes mjeteve jo-komerciale më 1995 dhe më pas ribotuar me mjetet e tij personale. Një seri padish penale, bashkë me kërkesat për t'u bashkuar në procedura si palë civile, ishin paraqitur kundër tij nga asociacionet e ish anëtarëve të rezistencës, të deportuarve dhe organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që: sfidonin ekzistimin e krimeve kundër njerëzimit, shpifjen racore në publik dhe nxitjen e urrejtjes racore. Si rezultat i ankesave, lidhur me paragrafë të ndryshëm të librit, kishin filluar pesë hetime gjyqësore në lidhje me sjelljen e ankuesit.

Pesë procedura të ndryshme gjyqësore kishin filluar sipas Aktitit për Lirinë e Shtypit. Ankuesi kishte aplikuar për bashkimin e tyre, por pa sukses. Në pesë gjykime të ndara, Gjykata e Apelit të Parisit kishte gjetur ankuesin fajtor për mohimin e ekzistencës së krimeve kundër njerëzimit, shpifjen publike kundër një grupi të njerëzve, që do të thotë komunitetin hebraik në këtë rast, dhe nxitje për diskriminim dhe urrejtje racore.

Vendimet e Gjykatës së Apelit të Parisit ishin lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Kasacionit. Dënimet me burgim duhej vuajtur paralelisht. Gjyba arrinte 25,900 euro dhe një dëmshpërblim në vlerë prej 33,500 eurosh u ishte dhënë palëve civile.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi ankohej mbi bazën e nenit 10 të Konventës se atij i ishte cënuar liria e shprehjes. Në mesin e argumentave të paraqitur, ankuesi argumentonte se libri i tij ishte punë politike, i shkruar me qëllimin për të luftuar Zionizmin dhe për të kritikuar Izraelin. Sipas ankuesit, libri nuk kishte përmbajtje raciste apo anti-semite. Më tej, ankuesi ka argumentuar se, pasi ai nuk mund të shihej si revizionist, atij i duhej dhënë liria e pakufizuar e shprehjes.

Gjithashtu, ankuesi është ankuar se procedurat gjyqësore në gjykatat vendore kanë qenë të padrejta, në shkellje të nenit 6 (e drejta për gjykim të drejtë), e marrë bashkërisht ose e konsideruar si e ndarë nga dispozita e nenit 4 të Protokollit Nr. 7 (e drejta për të mos u gjykuar apo dënuar dy herë). Në fund, ai ka ngritur pretendime edhe në lidhje me shkelljen e nenit 9 (liria e mendimit, ndërjegjes dhe fesë) dhe nenit 14 (ndalimi i diskriminimit).

Qeveria ka hedhur poshtë këto pretendime.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me dënimet gjyqësore të ankuesit për mohimin e ekzistencës së krimeve kundër njerëzimit, Gjykata i është referuar nenit 17 (ndalimi i shpërdorimit të të drejtave), që kishte si qëllim të parandalonte përdorimin e ndonjë të drejte të garantuar me Konventë për t'u përfshirë në aktivitete ose për të kryer veprime që synojnë cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë. Prandaj, sipas Gjykatës, asnjë person nuk mund të angazhohet ose përfshihet në ndonjë veprim që është në kundërshtim me dispozitat e Konventës.

Pasi ka analizuar librin, Gjykata ka gjetur, sikurse kanë dëshmuar edhe gjykatat vendore, se ankuesi ka miratuar teoritë revizioniste dhe në mënyrë sistematike ka mohuar ekzistimin e krimeve kundër njerëzimit që nazistët kanë kryer kundër komunitetit hebraik. Prandaj nuk ka dyshim se mohimi i ekzistencës së ndodhive historike qartë të përcaktuara, siç është Holokausti, nuk përbën hulumtim të ngjashëm me kërkimin e të vërtetës. Qëllimi real i këtij libri ka qenë rehabilitimi i regjimit nacional-socialist dhe, si pasojë, akuzimi i viktimave të Holokaustit për falsifikim të historisë. Mohimi ose rishkrimi i një fakti të tillë historik është i papërputhshëm me demokracinë dhe të drejtat e njeriut dhe pa dyshim bie në kategorinë e qëllimeve të ndaluara sipas nenit 17 të Konventës.

Ankuesi ka pasur për qëllim që të largojë nenin 10 të Konventës nga qëllimi i synuar, duke përdorur lirinë e shprehjes si mjet për të arritur qëllime që janë në kundërshtim me Konventën. Për rrjedhojë, Gjykata ka gjetur se ankuesi nuk mund të mbështetet në nenin 10 dhe ka shpallur ankesën e tij si të papajtueshme me Konventën.

Në lidhje me pretendimet për shkellje të nenit 6 të Konventës, Gjykata nuk ka gjetur shkellje të së njëjtës dispozitë. Gjykata ka vlerësuar se ankuesi ka qenë në mënyrë të duhur dhe plotësisht i informuar në lidhje me natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij. Për më tepër, Gjykata vlerësuar se shqetësimet e ankuesit në lidhje me

paanshmërine e gjykatësve që kanë vendosur rastin nuk mund të shiheshin si legjitime. Përfundimisht, Gjykata ka gjetur të gjitha pretendimet për shkelje të nenit 6 të Konventës si të pathemelta.

Gjykata ka shpallur të papranueshme ankesat mbi bazën e neneve 9 dhe 14 për arsye të mos-shterimit të mjeteve të brendshme juridike.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka shpallur ankesën e paraqitur si të papranueshme [njëzëri].

Lehideux dhe Isorni kundër Francës - 55/1997/839/1045

23 shtator 1998 [Gjykata]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 10

Gjykatat penale kishin dënuar ankuesit për "mbrojtjen publike të krimeve të luftës ose krimet e bashkëpunimit", pas paraqitjes në një gazetë të përditshme kombëtare, së një reklame që paraqiste pozitivisht disa akte të Philippe Pétain veprime këto që paraqesin shkelje të lirisë së shprehjes / *ka shkelje*

Neni 17

Pretendim nga Qeveria se ankesa nuk ishte në përputhje me dispozitat e Konventës / *nuk aplikohet*

Fjalët kyçe: *shkrime / mbrojtje e politikave të caktuara / publikime / liri e shprehjes / dënim / keqpërdorim i së drejtës*

Ankuesit: z. Marie-François Lehideux (*ankuesi i parë*) dhe z. Jacques Isorni (*ankuesi i dytë*), shtetas francez, kanë lindur në vitin 1904 dhe 1911 dhe kanë vdekur në vitin 1998, përkatësisht 1995

Faktet e rastit

Ankuesi i parë ishte dikur administrator dhe më vonë drejtor i disa kompanive. Nga shtatori 1940 deri në prill 1942 ai ishte ministër në qeverinë e Marshall Petain dhe, nga 1959 deri në 1964, anëtar i Komiteti Ekonomik dhe Social. Ankuesi i dytë ishte më parë avokat, profesion që e ushtronte në Paris dhe ishte avokat i emëruar zyrtarisht nga Marshall Petain në gjyqin e tij para Gjykatës së Lartë të Drejtësisë.

Gazeta ditore Le Monde, në edicionin e saj të 13 korrikut 1984 botoi një faqe reklamë me titullin 'Populli i Francës, keni kujtesë të shkurtë' me shkronja të mëdha të shtypit dhe në me shkronja të vogla italiane fjalët 'Philippe Petain, 17 qershor 1941'. Teksti, i cili ishte shkruar nga dy ankuesit dhe nga z. M., përfundoi me një ftesë për të shkruar në Shoqatën për Mbrojtjen e Kujtimit të Marshallit Petain dhe Shoqatës Kombëtare Petain-Verdun. Shkrimi ishte ndarë në një numër seksionesh, secila duke filluar me një titull me shkronja të mëdha që lexojnë: 'Populli i Francës, keni kujtesë të shkurtë, nëse keni harruar...', dhe përmblodhi, në një seri të pohimeve, fazat kryesore të jetës së Philippe Petain si figurë publike nga viti 1916 deri më 1945, duke paraqitur pozitivisht veprat e tij.

Më 10 tetor 1984, Asociacioni Kombëtar i Ish-Anëtarëve të Rezistencës paraqiti ankesë, së bashku me një kërkesë për t'iu bashkuar si palë civile procedurës kundër z. L., që ishte menaxher i botimeve të Le Monde, duke pretenduar se ai kishte mbrojtur publikisht krimet e bashkëpunimit me armikun. Po ashtu, kërkesa referohej edhe kundër ankuesit të parë, si kryetar i Shoqatës për Mbrojtjen e Kujtesës së Marshall Petain, kundër ankuesit të dytë, si autor i tekstit fyes, dhe kundër z. M., si kryetar i

Shoqatës Kombëtare Petain-Verdun për dhënien e ndihmës dhe nxitjen e mbrojtjes publike të krimeve të bashkëpunimit me armikun.

Më 29 maj 1985 prokurori publik parashtriu se nuk kishte rast sepse asnjë veprë penale nuk ishte kryer, por gjyqtari hetues refuzoi të ndiqte këto parashtrësia. Më 4 qershor 1985 filloi gjykimi kundër z. L., ankuesve dhe z. M. në Gjykatën Penale. Komiteti i Veprimit të Rezistencës dhe Federata Kombëtare e Anëtarëve të Internuar dhe Deportuar të Rezistencës, si dhe Patriotët iu bashkuan procedurës si palë civile.

Në një aktgjykim të 27 qershorit 1986, Gjykata Penale e Parisit i liroi të pandehurit për shkak se vepra nuk ishte kryer dhe vendosi që nuk kishte juridiksion për të dëgjuar pretendimet e palëve civile. Pas apelimit nga Asociacioni Kombëtare e Ish-Anëtarëve të Rezistencës dhe Komitetit të Veprimit për Rezistencën, Gjykata e Apelit në Paris shpalli me 8 korrik 1987 se akuzat dhe procedurat e mëvonshme ishin të pavlefshme, me arsyetimin se palët civile nuk kishin të drejtë të institucionin procedura penale dhe se kërkesa e prokurorit lidhur me ankesat civile të palëve nuk kishin përmbushur kushtet si në formën e përcaktuar në arsyetimin e pavlefshmërisë.

Më 20 dhjetor 1988, në ankesën e Shoqatës Kombëtare të Ish-Anëtarëve të Rezistencës dhe Komitetit të Veprimit të Rezistencës, lidhur me mënyrën e zbatimit të dispozitave përkatëse të ligjit, Gjykata e Kasacionit konstatoi se Gjykata e Apelit kishte zbatuar keq legjislacionin përkatës. Rrjedhimisht, kjo gjykatë e prishi atë aktgjykim dhe ia ktheu në rigjykim një paneli tjetër të apelit.

Në aktgjykimin e datës 26 janar 1990, Gjykata e Apelit në Paris konstatoi se tre elementet përbërëse të veprës penale për të justifikuar veprimet e bashkëpunimit me armikun ishin plotësuar. Rrjedhimisht, kjo gjykatë shpalli dy kërkesat e palëve civile për t'u bashkuar në procedurë të pranueshme, la mënjanë lirimet dhe, në lidhje me pretendimet e palëve civile, iu dha atyre dëmshpërblim prej një frank, si dhe përveç kësaj urdhëroi që ekstrakte nga ky aktgjykim të publikoheshin në Le Monde.

z. M., z. L. dhe ankuesit u ankuan lidhur me mënyrën e zbatimit të dispozitave përkatëse të ligjit, duke argumentuar, veçanërisht, se ata ishin dënuar për shkak të mendimeve të tyre, në kundërshtim me Nenin 10 të Konventës. Më 16 nëntor 1993 Gjykata e Kasacionit hodhi poshtë ankesat e tyre.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesit argumentuan se teksti në fjalë reflektonte një mendim historik dhe dha informacion në lidhje me një subjekt me interes të përgjithshëm. Dënimi i tyre kishte për qëllim të vendoste një version "historikisht korrekt" të historisë. Ankuesit nuk kishin kontestuar as mizoritë dhe barbarizmin nazist, as Holokaustin. Ata nuk kishin miratuar këtë politikë. Ata thjesht thanë: "Ndoshta diçka tjetër ndodhi", diçka tjetër përveç asaj që njerëzit mendonin, domethënë se, për shkak të bëmave të tij të pakrahasueshme në të kaluarën si udhëheqës ushtarak, njeriu që kishte qenë kreu i shtetit francez mund të kishte dëshiruar fitore nga Aleatët. Prandaj, ankuesit kërkuan nga Gjykata të konstatojë se kishte pasur shkelje të Nenit 10 të Konventës.

Në anën tjetër, Qeveria konsideroi se botimi në fjalë e shkeli vetë shpirtin e Konventës dhe vlerave thelbësore të demokracisë, si dhe argumentoi se kërkesa e ankuesve ishte në shpërputhje me Nenin 17. Andaj, kërkoi nga Gjykata që të hedh poshtë kërkesën e

parashtruar nga ankuesit së pari si të papajtueshme me dispozitat e Konventës sipas Nenet 17 dhe në alternativë, për shkak se nuk kishte pasur shkelje të Nenet 10.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata vendosi të gjykojë zbatimin e Nenet 17 duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit dhe për këtë do të fillonte nga shqyrtimi i përputhshmërisë me Nenin 10 të Konventës, i cili do të vlerësohej nën prizmin e kriterëve të Nenet 17 të Konventës.

Neni 10 i Konventës përmban kriteret e mëposhtme juridike, të cilat nëse plotësohen kumulativisht, atëherë nuk ka shkelje të Konventës nën atë nen. Gjegjësisht, duhet të vlerësohet nëse sjellja përkatëse është “ndërhyrje”. Nëse po, atëherë a është “ndërhyrja e paraparë me ligj”, “a ka ndjekur ndonjë qëllim legjitim” dhe “a është e nevojshme në një shoqëri demokratike”?

Gjykata konsideroi se dënimi në fjalë ishte "ndërhyrje" në ushtrimin e të drejtës së tyre për lirinë e shprehjes, që ishte 'që paraparë me ligj' dhe se kishte ndjekur disa nga qëllimet legjitime të parashtruara nën Nenin 10 § 2, përkatësisht mbrojtjen e reputacionit ose e të drejtave të të tjerëve dhe parandalimi e çrregullimit ose krimit. Rrjedhimisht ajo që mbeti për Gjykatën të përcaktojë ishte nëse ndërhyrja ishte 'e nevojshme në një shoqëri demokratike' për arritjen e këtyre qëllimeve.

Sipas Qeverisë, argumentet se ankuesit ishin fajtor ishin prodhuar nga dy metoda të ndryshme: autorët e publikimit në fjalë ndonjëherë kanë bërë përpjekje të justifikonin vendimet e Philippe Petain duke u përpjekur t'i jepnin një kuptim të ndryshëm dhe në kohë të tjeër, thjesht nuk përmbanin fakte historike të cilat dihehin botërisht dhe ishin të pashmangshme dhe thelbësore për politikat në fjalë. Teknika e parë ishte përdorur në paragrafin në lidhje me politikën e Philippe Petain në Montoire. Duke e përshkruar këtë politikë në tekst si 'jashtëzakonisht të aftë', ankuesit kishin rritur besueshmërinë e të ashtuquajturës teori e 'lojës së dyfishtë', edhe pse ata e dinin se deri në vitin 1984 të gjithë historianët, francezë dhe jofrancezë, e hodhën poshtë këtë teori.

Gjykata konsideroi se nuk ishte detyra e saj për të zgjidhur këtë pikë, e cila ishte pjesë e një debati të vazhdueshëm midis historianëve rreth ngjarjeve në fjalë dhe interpretimit të tyre. Si e tillë, ajo nuk i përket kategorisë së fakteve historike të përcaktuara qartë - siç është Holokausti - mohimi ose rishikimi i të cilave do të hiqej nga mbrojtja e Nenet 10 nga Neni 17.

Gjykata më tej vuri në dukje se ankuesit nuk kishin vepruar në kapacitetet e tyre personale, pasi emrat e vetëm që u paraqitën në fund të tekstit në fjalë ishin ato të Shoqatës për Mbrojtjen e Kujtesës së Marshallit Petain dhe Shoqatës Kombëtare Petain-Verdun, në të cilën lexuesit u ftuan për të shkruar. Meqenëse këto asociacioni u themeluan ligjërisht dhe u përpoqën të promovonin rehabilitimin e Philippe Petain, nuk ishte aspak e habitshme për t'i mos i paraqisnin teoritë historike rivale në një botim për të cilin kishin paguar, si dhe ku favorizonin njeriun - kujtimin e kujt ata kërkonin ta mbronin.

Gjykata theksoi se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Parisit për të dënuar aplikuesit ishte bazuar kryesisht në faktin se autorët e tekstit nuk ishin distancuar ose nuk kishin kritikuar aspekte të caktuara të sjelljes së Philippe Petain dhe veçanërisht faktin që ata nuk kishin vënë asgjë në tekst mbi ngjarjet e tjera, veçanërisht lidhur me “nënshkrimin e të ashtuquajturit Akt të 3 tetorit 1940, që lidhet me të huajt e racës hebreje, të cilët më

vonë do të internoheshin në kampet e ngritura në Francë për këtë qëllim, ashtu që të lehtësohej bartja e tyre në kampet naziste të përqendrimit ku ishte destinimi i synuar i tyre”. Gjykata në përputhje me rrethanat duhej të shqyrtojë nëse këto kritika mund të justifikonin *ndërrhyrjen* në fjalë.

Nuk kishte asnjë dyshim se, si çdo shkrim tjetër i drejtuar kundër vlerave themelore të Konventës, arsytimi i një politike pro-naziste nuk mund të lejohej të gëzonte mbrojtjen e ofruar nga Neni 10 i Konventës. Në rastin konkret, megjithatë, ankuesit kishin deklaruar në mënyrë eksplicite mosmiratimin e tyre për “mizoritë dhe përndjekjet naziste” si dhe “fuqinë gjermane dhe barbarizmin”. Kështu, ata nuk e kishin lavdëruar aq shumë politikën e këtij njeriu por kishin vepruar në funksion të rishikimit të bindjeve për Philippe Petainin. Së paku në këtë pikë, Gjykata e Apelit kishte vlerësuar këmbënguljen dhe legjitimitetin e ankuesve, megjithatë jo edhe mjetet e përdorura për arritjen e këtij qëllimi.

Sa i përket lëshimeve për të cilat autorët e tekstit ishin kritikuar, Gjykata nuk kishte ndërmend të vendosë mbi këtë në themel. Këto nuk ishin lëshime mbi fakte pa asnjë pasojë, por për ngjarje të lidhura drejtpërdrejt me Holokaustin. Pa dyshim, autorët e tekstit i referoheshin 'barbarizmit nazist', por pa treguar se Philippe Petain kishte kontribuar me vetëdije, veçanërisht nëpërmjet përgjegjësisë së tij për persekutimin dhe dëbimin në kampet e vdekjes së dhjetëra mijëra hebrenjve në Francë. Rëndesa e këtyre fakteve, që përbënin krime kundër njerëzimit, rriti rëndësinë e çdo përpjekjeje për të mbuluar ata. Edhe pse ishte moralisht e dënueshme, megjithatë, fakti që teksti nuk përmendte ato ngjarje/fakte duhej të vlerësohej duke marrë parasysh rrethanat e tjera të rastit.

Këto rrethana përfshinin faktin se prokuroria, roli i të cilës ishte të përfaqësonte të gjitha ndjeshmëritë që përbëjnë interesin e përgjithshëm dhe të vlerësonte të drejtat e të tjerëve, së pari vendosi të mos vazhdonte me rastin kundër ankuesve në Gjykatën Penale, më pas u përmbajtë nga parashtrimi i ankesës ndaj aktgjykimeve liruese, të shpallura nga kjo gjykatë dhe nga ankesa në Gjykatën e Kasacionit kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Paris të datës 8 korrik 1987.

Gjykata më tej vuri në dukje se ngjarjet e përmendura në botimin në fjalë kishin ndodhur më shumë se dyzet vjet më parë. Megjithëse shkrimet si ato të ankuesve gjithmonë kishin mundësi të rihapin polemikat dhe të sillnin kujtimet e vuajtjeve të kaluara, kalimi i një kohe kaq të madhe - dyzet vjet, e bënte të papërshtatshme adresimin e këtyre shkrimeve, me të njëjtën ashpërsi si dhjetë apo njëzet vjet më parë. Kjo përbënte pjesë të përpjekjeve që çdo vend.shtet duhej të bënte për të debatuar hapur dhe me gjakftohtësi historinë e vet.

Për më tepër, botimi në fjalë korrespondonte drejtpërdrejt me qëllimin e asociacionive që e kishin prodhuar atë, Shoqatën për Mbrojtjen e Kujtesës së Marshallit Petain dhe Shoqatën Kombëtare Petain-Verdun. Këto asociacioni u formuan ligjërisht dhe asnjë procedurë, para ose pas vitit 1984, nuk ishte ngritur kundër tyre për përndjekjen e objektivave të tyre.

Së fundmi, Gjykata theksoi seriozitetin e një dënimi penal për mbrojtjen publike të krimeve të bashkëpunimit, duke pasur parasysh ekzistencën e mjeteve të tjera të ndërhyrjes dhe kundërshtimit, veçanërisht nëpërmjet mjeteve juridike civile.

Si përfundim, Gjykata e konsideron dënimin penal të ankuesve në mënyrë joproporcionale dhe, si të tillë, të panevojshëm në një shoqëri demokratike. Prandaj, gjen se kishte pasur një shkelje të Nenit 10. Duke arritur këtë përfundim, Gjykata konsideroi se nuk ishte e përshtatshme të aplikohet Neni 17 i Konventës.

Gjykata konsideroi se gjetja e shkeljes së Nenit 10 përbën kompensim të mjaftueshëm për dëmin jomaterial të pretenduar nga ankuesit. Gjykata vlerësoi shpenzimet gjyqësore në baza të barabarta.

Gjykata konstaton se gjetja e shkeljes në vetvete përbën kompensim të mjaftueshëm për dëmin jomaterial të pretenduar nga ankuesit dhe se, se shteti duhet t'iu paguajë ankuesve, brenda tre muajsh, 100,000 (njëqind mijë) franga franceze për shpenzimet gjyqësore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi që ka pasur shkelje të Nenit 10; andaj nuk është e nevojshme të aplikohet neni 17 i Konventës [*pesëmbëdhjetë vota për dhe gjashtë kundër*]

Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar - 8225/78

28 maj 1985 [Gjykata]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5 §§ 1 dhe 4

Pretendim se mbajtja në institucion mjekësor për shkak të sëmundjes mendore ka rezultuar me heqjen e lirisë, dhe ka penguar të drejtën për ankesë në gjykatë me qëllim të vertetimit të ligshmërisë së mbajtjes / *nuk ka shkelje*

Neni 6 § 1

Pretendime për mungesë të mjeteve juridike adekuate / *nuk ka shkelje*

Fjalët kyçe: i sëmurë mendor / skizofreni / rrezikshmëri / regjim spitali / siguri e lartë / lirim nga institucioni / qasje në gjykatë

Ankuesi: z. Leonard John Ashingdane, shtetas britanik

Faktet e rastit

Më 23 nëntor 1970, ankuesi u dënua nga një gjykatë në Rochester, Kent, në Angli për shkak të ngasjes së makinës në mënyrë të rrezikshme, si dhe për shkak të katër veprave tjera penale përfshirë edhe posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit. Dëshmia mjekësore tregoi se ai vuante nga sëmundja mendore (skizofrenia paranojake) dhe çrregullimi i tij mendor ishte i një shkalle që e kërkonte shërimin e tij në një spital psikiatrik. Gjykata bëri një urdhër spitalor bazuar në Nenin 60 të Aktit të Shëndetit Mendor 1959 ("Akti i vitit 1959"). Ankuesi pas një periudhe të shkurtër burgimi fillimisht i u mbajt në spitalin psikiatrik lokal, Spitali Oakwood, në Maidstone, Kent. Më 13 prill 1971, ankuesi u transferua në Spitalin Broadmoor një "spital special" për ata që kërkojnë trajtim nën kushte të sigurisë së posaçme për shkak të rrezikut të tyre. Midis prillit 1971 dhe tetorit 1978, rasti i ankuesit ishte shqyrtuar në katër raste nga një Gjykatë për Shqyrtimin e Shëndetit Mendor, e cila këshillonte në çdo rast se ai nuk ishte gati për t'u liruar ose transferuar. Sekretari i Shtetit të Departamentit për Çështje të Brendshme ("Sekretari i Brendshëm"), i cili ishte përgjegjës sipas Aktit 1959 për kontrollin e ankuesit, iu permbajte këtyre këshillave dhe e mbajti ankuesin në spitalin mendor. Raportet periodike u dërguan edhe nga zyrtari i tij përgjegjës mjekësor tek Sekretari i Shtetit për Shërbimet Sociale. Më 31 tetor 1978, Dr Maguire, një psikiatër mjekësor mjeko-ligjor i cili ishte kujdestari i përgjegjshëm mjekësor i ankuesit në Spitalin Broadmoor, raportoi se ankuesi nuk paraqiste më "kërcënim si më parë" dhe mund të trajtohet si duhet në një spital të hapur. Dr Maguire rekomandoi transferimin e tij në Spitalin Oakwood. Ankuesi u vlerësua gjithashtu nga Dr Sherry, një psikiatër konsulent në Spitalin Oakwood, i cili e konfirmoi këtë mendim. Në dhjetor 1978, në përputhje me rregulloret përkatëse Sekretari i Shtetit për Shërbimet Sociale u pajtua me rekomandimin e Dr Maguire. Më 1 mars 1979, Sekretari i Shtetit dha pëlqimin e tij për transferimin e ankuesit në spitalin psikiatrik lokal. Megjithatë, Autoriteti i Shëndetit të Zonës Kent, autoriteti lokal përgjegjës për Spitalin Oakwood, refuzoi të pranonte

ankuesin në Okwood dhe Sekretari i Shtetit për Shërbimet Sociale refuzoi ta drejtonte transferimi atje. Rasti i ankuesit u konsiderua përsëri nga Tribunali i Shëndeti Mendor më 23 gusht 1979. Tribunali këshilloi se ishte thelbësore për mirëqenien e ankuesit që ai të mbetet nën mbikëqyrje për të siguruar që ai vazhdoi të marrë medikamentet e tij, por u pajtuan se gjendja e tij ishte përmirësuar mjaftueshëm për të garantuar transferimin në një spital lokal. Më 17 shtator 1979, Sekretari i Brendshëm ripohoi qendrimin e tijë në lidje me transferimin e ankuesit. Ndërkohë, duke marrë ndihmë juridike, ankuesi ka filluar Procedurat panë Gjykatës së Lartë në gusht të vitit 1979 për të sfiduar ligjshmërinë e tij vazhdimi i paraburgimit në Broadmoor.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi ankua kryesisht për paraburgimin e tij të zgjatur në spital "të veçantë" midis tetorit 1978 dhe tetorit 1980 pasi ai është shpallur i përshtatshëm për transferim në një spital psikiatrik të zakonshëm. Ankuesi pranoi se paraburgimi i tij ishte "në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj" dhe se ka pasur dëshmi mbi të cilat autoritetet mund të konkludojnë siç duhet se ai ishte një "person i një mendjeje të paqëndrueshme". Ai, megjithatë, ka parashtuar se ndalimi i tij ishte jo "i ligjshëm" për qëllimet e nënparagrafit (e) të paragrafit 1 të Nenit 5. Ankesa e dytë e ankuesit ishte se procedurat në sistemin gjyqësor të brendshëm nuk i jepnin atij qasje në një gjykatë për të vendosur në lidhje me pretendimin e tij se ndalimi i tij i vazhdueshëm në Spitalin Broadmoor pas tetorit 1978 ishte i paligjshëm.

Ankuesi u ankua për vendimin e Gjykatës së Apelit ku veprimet e tij kundër Departamentit të Shëndetësisë dhe Sigurisë Sociale dhe Autoritetit Shëndetësor lokal lidhur me dyshimin e shkeljes se "të drejtave civile" brenda kuptimit të Nenit 6 § 1. Ankuesi pretendonte se vendimi për vendosjen e kufizimeve nën Nenin 141 i Aktit të vitit 1959 përbente shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës. Në pretendimet e tij ankuesi gjithashtu kishte invokuar aplikimin e Nenit 17 dhe Nenit 18 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet e ankuesit për shkeljen e Nenit 5 § 1, Gjykata, në praktikën e saj të mëparshme, ka deklaruar se duhet të plotësohen tre kushte minimale në mënyrë që ndalimin i një personi me një mendje të paqëndrueshme të jetë "i ligjshëm" brenda kuptimit të këtij neni: përveç rasteve emergjente, një çrregullim i vërtetë mendor duhet të vërtetohet para një autoriteti kompetent në bazë të ekspertizës mjekësore; çrregullimi mendor duhet të jetë i një lloji apo shkalle që kërkon mbylljen e detyrueshme; dhe vlefshmëria e izolimit të vazhdueshëm varet nga zgjatja e një çrregullimi të tillë.⁸⁸ Detyra e Gjykatës në verifikimin e përmbushjes së këtyre kushteve është e kufizuara në shqyrtimin e vendimeve të marra nga autoriteteve kombëtare. Raportet mjekësore të paraqitura, përfshirë ato të bëra nga mjekët e pavarur me kërkesën e ankuesit, dhanë arsye për paraburgimin e tij fillestar dhe të vazhdueshëm pasi që ai u diagnostifikua si i sëmurë me skizofrenia paranojake, dhe gjithashtu shtuan se gjendja e tij duhej të kontrollohej nga ilaçe dhe mbikëqyrje dhe se ai nuk ishte i gatshëm ose nuk ishte në gjendje të bashkëpunonte vullnetarisht në një trajtim të tillë, dhe nëse ai lirohej në

⁸⁸ Vendimi i *Winterwerp* i 24 tetorit 1979, Seria A nr. 33, f. 18, par. 39

komunitetit ai mund të jetë i rrezikshëm. Prandaj Gjykata nuk ka arsye për të dyshuar në objektivitetin dhe besueshmërinë e këtij mendimi unanim se vendimi i ndalimit të ankuesit është justifikuar gjatë gjithë periudhës relevante.

Gjykata rikujtoi se "ligjshmëria" e çdo paraburgimi është e nevojshme në lidhje me të dyja masat përkatësisht - urdhërimin dhe ekzekutimin e masës që privon individin nga liria e tij. Një ligjshmëri e tillë nënkupton konformitetin me ligjin vendas në vend dhe gjithashtu, siç konfirmohet nga Neni 18, përputhshmëria me qëllimet e kufizimeve të lejuara nga Neni 5 § 1. Gjykata vëren më tej se duhet të ketë njëfarë marrëdhënie midis bazës se privimit të lejuar të lirisë që u mbështet në vendin dhe kushtet e paraburgimit. Në parim, "ndalimi" i një personi në cilesi të pacientit me semundje mendore do të jetë "i ligjshëm" për qëllimet e nënparagrafit (e) të paragrafit 1 nëse kryhet në një spital, klinikë ose institucion të përshtatshme dhe të autorizuar për këtë qëllim. Bazuar në provat e paraqitura, Gjykata nuk ka arsye për të gjetur se privimi i lirisë së ankuesit si një person i një mendjeje të paqëndrueshme gjatë periudhës së kontestuar ishte "i paligjshëm" në kuptimin që nuk ishte në përputhje me ligjin përkatës vendas. Siç vuri në dukje Qeveria, në gjyqin e tij të brendshëm ankuesi vetë nuk e sfidoi bazën ligjore për paraburgimin e tij nën Aktin 1959 e as që kërkoi lirimin e tij nga paraburgimi, por po pretendonte një të drejtën për akomodim dhe trajtim me "të përshtatshëm" si dhe kushte të një kategorieme të ndryshme të spitalit psikiatrik.

Provat e deponuara para Gjykatës sugjerojnë që çdo kurs tjetër nga ai i miratuar nga autoritetet përgjegjëse ndoshta do të kishin qenë të pazbatueshme. Gjykata është e bindur se ndalimi i vazhdueshëm i ankuesit nuk ishte arbitrar ose i kryer për një qëllim të mëvonshëm, në kundërshtim me Nenin 5 § 1 i lexuar në lidhje me Nenin 18. Si pasojë nuk ka shkelje të nenit 5 § 1 të konventës.

Në lidhje me shkeljet e pretenduara në Nenin 5 § 4 Gjykata rikujtoi se përmbajtja e Nenit 5 kur lexohet si një tërësi nënkupton se në lidhje me të njëjtën heqjes së lirisë nocioni i "ligjshmërisë" duhet të ketë të njëjtën rëndësi. Kështu, mjeti juridik i brendshëm në dispozicion sipas paragrafit 4 të këtij neni duhet mundësojë rishikimin e kushteve që, sipas paragrafit 1 (e) janë thelbësore për "ndalimin e ligjshëm" të një personi me semundje mendore. Megjithatë, pretendimet se ankuesi ishte penguar nga veprimi i Nenit 141 i Aktit të vitit 1959 nga ndjekja para gjykatave kombëtare nuk përfshihen në fushën e drejtësisë dhe përcaktimit të "ligjshmërisë" që garanton Neni 5 § 4. Siç u tha më lart, në procesverbalin e tij të brendshëm ankuesi nuk e kundërshtoi bazën ligjore për arrestimin e tij si një person me mendje të paqëndrueshme nën Aktin e 1959. Prandaj, gjykata është e mendimit se autoritetet nuk kanë shkaktuar një shkelje të Nenit 5 § 4.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit për shkeljet e Nenit 6 § 1 Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të shqyretoj këtë pretendim pasi që ka arrit në përfundimin se, edhe nëse Nenin 6 § 1 do të ishin të zbatueshme, kërkesat e kësaj dispozite nuk janë shkelur. Ankuesi kishte qasje në Gjykatën e Lartë dhe më pas në Gjykatën e Lartë të Apelit. Në këtë masë, ai kështu kishte qasje në mjetet juridike që ekzistonin brenda sistemit vendas.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se nuk ka pasur shkelje të paragrafit 1 apo paragrafit 4 të Nenit 5 të Konventës; gjithashtu gjen se nuk ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 [me gjashtë vota / njëzëri].

Neni 18

Kufiri i zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave

Kufizimet e lejuara sipas kësaj Konvente ndaj të drejtave dhe lirive të sipërpërmendura nuk do të zbatohen për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë parashikuar.

Gusinskiy kundër Rosisë - 70276/01

19 maj 2004 [Seksioni i Parë]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5

Shkelje e të drejtës ë liri si pasojë e arrestimit dhe paraburgimit përkundër gëzimit të amnestisë të paraparë në Ligjin mbi Amnistinë / *ka shkelje*

Neni 18 ndërlidhur me Nenin 5

Pretentim kufizimi i lirisë ishte bërë për arsye të tjera përveç atyre të shprehura / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: arrestim / paraburgim / amnisti / detyrim / shitje e kompanisë / arsye shtesë / kufizime të lejuara

Ankuesi: Vladimir Aleksandrovich Gusinskiy, është një shtetas rus dhe izraelit, i lindur në vitin 1952

Faktet e rastit

Ankuesi, ishte në atëbotë Kryetar i Bordit dhe aksionar i shumicës së kompanisë ZAO Media Most, ku përfshihej edhe NTV, një kanal televiziv popullor rus. Më 13 qershor 2000, ankuesi u arrestua nën dyshimin për mashtrim. Pretendohej se, duke krijuar subjekte të ndryshme tregtare (duke përfshirë Media Most), ai kishte transferuar në mënyrë mashtruese funksionet e transmetimit nga videoja ruse, një kompani shtetërore, në kompani private OOO Russian Video, duke zhveshur në mënyrë efektive Videon Ruse të kanalit televiziv 11, nga një vlerë të llogaritur prej 10 milionë dollarë amerikanë. Gjatë kësaj procedure, prokurori i rastit shkruajti në dosje faktin se ankuesi mbante dekoratën e Miqësisë së Rendit të Popujve. Ankuesi u ankua se paraburgimi i tij ishte në kundërshtim me dekoratën e lartpërmendur dhe Aktin e Amnestisë së 26 majit 2000. Më 16 qershor, pasi u akuzua për mashtrim nga prokurori, ankuesi u lirua nga burgu në këmbim të premtimit që ai nuk do të largohej nga vendi.

Gjatë arrestimit të ankuesit, ushtruesi i detyrës së Ministrit për Shtyp dhe Komunikimet Masive kishte ofruar të heqë aktakuzat kundër ankuesit nëse ai do të shiste Media Most në Gazprom (një kompani shtetërore që kontrollonte monopolin e gazit natyror, dhe e cila ishte në mosmarrëveshje me Media Most për borxhet e këtij të fundit në favor të saj) me një çmim që do të përcaktohet nga Gazprom. Pas nënshkrimit të një marrëveshjeje të tillë në korrik të vitit 2000, procedura penale u ndërpre. Sapo urdhri ndalues për të mos u larguar nga vendi u hoq në gusht të vitit 2000, ankuesi shkoi në Spanjë. Më pas Media Most refuzoi të përmbushte "Marrëveshjen e korrikut" duke pretenduar se ajo ishte lidhur nën detyrim.

Në shtator të vitit 2000 u ngritën aktakuza të tjera kundër ankuesit lidhur me marrjen e huave në mënyrë mashtruese nga Media Most. Në dhjetor të vitit 2000, ankuesi u arrestua në Spanjë në bazë të një urdhër arresti ndërkombëtar, por më vonë u lirua me kusht dhe u vendos nën arrest shtëpiak në vilën e tij në Sotogrande. Më 4 prill 2001,

Gjykata Spanjolle "Audencia Nacional" refuzoi kërkesën për ekstradim të paraqitur nga autoritetet ruse.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi u ankua se ndalimi i tij ishte i paligjshëm dhe arbitrar në kundërshtim me Nenin 5 të Konventës. Në veçanti nuk kishte dyshime të arsyeshme se ai kishte kryer një vepër penale, dhe se paraburgimi i tij nuk kishte respektuar procedurën e brendshme. Sipas tij, ai duhet të kishte përfituar nga amnistia që i jepte atij imunitet nga burgu pasi që ai kishte marrë dekoratën e Miqësisë së Rendit të Popujve. Ai supozoi, në përgjithësi, se duke e arrestuar atë, autoritetet kishin në fakt për qëllim ta detyronin atë të shiste biznesin e tij të medias në kushte të pafavorshme.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me Nenin 5 të Konventës, Gjykata konstatoi se, sa i përket kërkesës së "dyshimit të arsyeshëm" nën Nenin 5 § 1 (c), provat e mbledhura nga autoritetet hetuese mund të kishin përmbushur vëzhguesin objektiv se ankuesi mund të kishte kryer veprën penale.

Sa i përket ekzekutimit të paraburgimit "në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj" Gjykata kujtoi se kjo nënkupton jo vetëm pajtueshmërinë me ligjin kombëtar, por gjithashtu që ky ligj duhet të arrijë një cilësi të caktuar; në veçanti duhet të jetë mjaft i arritshëm dhe i saktë në mënyrë që të shmanget çdo rrezik i arbitraritetit. Sipas Kodit rus të procedurës penale, paraburgimi para ngritjes së akuzave (si në rastin e ankuesit) ishte lejuar "në rrethana të jashtëzakonshme". Palët ranë dakord që kjo shprehje nuk u shpjegua në Kodin Penal dhe Qeveria nuk paraqiste raste të kaluara të rasteve në të cilat ishin gjetur të tilla "rrethana të jashtëzakonshme". Prandaj, rregulli nuk ishte treguar të përmbushë cilësinë e ligjit në Nenin 5 § 1.

Kishte qenë gjithashtu shkelje e ligjit kombëtar në atë që në bazë të Aktit të Amnistsisë, zyrtari hetues duhet të kishte ndaluar procedurën penale kundër ankuesit sapo të mësonte se ai mbante dekoratën e Miqësisë së Rendit të Popujve. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se kishte pasur shkelje të Nenit 5 të Konventës.

Lidhur me Nenin 18 të Konventës të ndërlidhur me Nenin 5, specifikisht, ankesën e ankuesit se qëllimi i vërtetë i ndalimit të tij ishte ta detyronte atë të shiste biznesin e tij mediatik në Gazprom në kushte të pafavorshme, Gjykata vuri në dukje se Neni 18 i Konventës nuk kishte një rol autonom dhe mund të zbatohet vetëm së bashku me nenet e tjera të Konventës. Për më tepër, mundësia e shkeljes së Nenit 18 mund të lindë vetëm kur e drejta apo liria e mbrojtur ishte subjekt i kufizimeve të lejuara sipas Konventës. Duke gjetur se liria e ankuesit ishte e kufizuar, Gjykata duhej të konstatoonte nëse ai ishte ndaluar për ndonjë qëllim tjetër nga ai i parashikuar në Nenin 5 § 1 (c), dhe si pasojë do të ishte shkelur Neni 18.

Nuk ishte e diskutueshme se "marrëveshja e korrikut" ishte e lidhur ngushtë me përfundimin e hetimit penal kundër ankuesit dhe shitjen e organizatës së tij mediatike në Gazprom, e cila ishte kompani e kontrolluar nga shteti. Sipas mendimit të Gjykatës, nuk ishte qëllimi i çështjeve të tilla të së drejtës publike, pasi procedurat penale dhe paraburgimi do të përdroshin si pjesë e strategjive të negociatave komerciale. Në rrethanat e çështjes, Gjykata nuk mund të gjente se kufizimi i lirisë së ankuesit të lejuar

sipas Nenit 5 § 1 (c) ishte zbatuar vetëm për qëllim të paraqitjes së kërkesës para autoritetit ligjor kompetent mbi dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një vepër penale, por edhe për arsye të huaj / tjetër. Prandaj, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të Nenit 18 të ndërlidhur me Nenin 5 të Konventës.

Gjykata vendos se shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën aktgjykimi bëhet i formës së prerë sipas Nenit 44 § 2 të Konventës, 88,000 EUR (tetëdhjetë e tetë mijë EUR) në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Nenit 5 të Konventës, gjithashtu se se ka pasur shkelje të Nenit 18 të Konventës të ndërlidhur me Nenin 5 [*njëzëri*].

Cebotari kundër Moldavisë - 35615/06

13 nëntor 2007 [Seksioni i Katërt]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neñit 5 §§ 3 dhe 5 §§ 4

Mos deklarimi i arsyeve për paraburgim, dhe mungesa e qasjes në materialet dhe në dosjen penale në bazë të të cilave gjykatat kishin vendosur ndalimin / *e panevojshme për shqyrtim*

Neni 18 marrë së bashku me Nenin 5 § 1

Pretendim se arrestimi dhe paraburgimi kishin pasur një qëllim dytësor / *ka shkelje*

Neni 34

Sjelljet dhe veprimet e autoriteve vendore kanë rezultuar në pengesat për paraqitjen e rastit para Gjykatës / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *heqje e lirisë / arrestim / paraburgim / qëllim i paraburgimit / qëllim i dyfishtë / biseda private / qasje në avokat*

Ankuesi: z. Mihail Cebotari, shtetas moldavez

Faktet e rastit

Sfondi i këtij rasti qëndron në një seri kontratash komplekse dhe marrëveshjet e bëra në vitin 1997 në lidhje me importimin e energjisë elektrike nga Ukraina në Moldavi dhe përfshin, përveç Moldtranselectro, një Kompani shtetërore të shpërndarjes së energjisë në pronësi të Ukrainës, edhe një kompani private moldave të quajtur Oferta.⁸⁹ Marrëveshja në të cilën Moldtranselectro ishte një palë me kusht, përfshinë mes tjerash, që Oferta Plus do të paguante kompaninë private të Ukrainës për Furnizim me energjinë elektrike në Moldtranselectro në dollarë amerikanë (USD) dhe më vonë do të paguhet nga Moldtranselectro në lei moldave (MDL) sipas kursit zyrtar të këmbimit në ditën e pagesës.

Në përputhje me këto marrëveshje, Oferta Plus pagoi më shumë se 33 milionë dollarë. Megjithatë, Ministria e Financave e Moldavisë refuzoi të paguajë një pjesë të shumës. Në tetor të vitit 1998, Oferta Plus filloi procedime civile kundër Ministrisë së Financave dhe Moldtranselectro, dhe gjykatat e ndryshme gjetën në favor të Oferta Plus dhe konfirmuan të drejtën e saj për t'u paguar MDL 20, 000, 000. Më 7 shkurt 2001, Gjykata Supreme e Moldavisë hodhi poshtë kërkesën e Ministrisë së Financave. Në prill 2004 Oferta Plus paraqiti një padi për moszbatimin e vendimeve përfundimtare në favor të saj. Ministria kërkoi ndihmë nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm e cila më 19 tetor 2004 filloi një çështje penale. Më 10 shkurt, Gjykata Supreme shqyrtoi aktgjykimin e saj në favor të Ministrisë së Financave. Më 25 tetor 2005 çështja penale

⁸⁹ *Oferta Plus SRL kundër Moldavisë*, nr. 14385/04, § 7, 19 dhjetor 2006

u ndërpre. Në vitin 2006 Oferta Plus paraqiti një kërkesë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pas kësaj, më 26 prill 2006 filloi një çështje penale dhe më 9 gusht 2006 ankuesi u shpall i dyshuar në procedurën penale. Në veçanti ai u akuzua se kishte shkruar letrën e 25 marsit 1998 në Ministrinë e Financave duke i kërkuar kësaj të fundit të lëshonte një obligacion të Thesarit në favor të Oferta Plus për përdorimin e energjisë elektrike. Drejtori i Oferta Plus u padit me akuza të ngjashme. Të njëjtën ditë, të dy burrat u arrestuan dhe u mbajtën në arrest për dhjetë ditë. Sipas ankuesit para se të arrestohej, hetuesi i bëri të qartë atij se arrestimi ose lirimi i tij varet nëse ai do të pajtohej të bënte deklaratat që priten prej tij. Ankuesi u mbajt në paraburgim deri më 19 nëntor 2006, dhe më pas u lirua me kusht. Më 27 qershor 2007 ai u lirua.

Përmbledhje e pretendimeve

Ankuesi u ankua sipas Nenit 5 § 1 të Konventës se paraburgimi i tij ishte vendosur në mungesë të një dyshimi të arsyeshëm se ai kishte kryer një vepër penale, dhe sipas Nenit 18 që paraburgimi i tij kishte pasur një qëllim tjetër nga ai i parashikuar në Nenin 5 § 1 (c). Ankuesi u ankua gjithashtu në bazë të Nenit 5 § 4 që gjatë procedurave lidhur me ndalimin e tij ai dhe avokatët e tij nuk kishin pasur qasje në materialet në dosjen e tij penale në bazë të të cilave gjykatat kishin urdhëruar ndalimin e tij. Ai gjithashtu pohoi se nuk kishte qenë në gjendje të takohej me avokatët e tij në kushtet e konfidencialitetit dhe që të gjitha dokumentet të cilat kishte kaluar mes tij dhe avokatëve të tij ishte shqyrtuar nga autoritet e burgut. Së fundi, ankuesi u ankua sipas Nenit 34 të Konventës se refuzimi për të lejuar avokatët e tij për ta parë atë në kushte të konfidencialiteti kishte ndikuar në të drejtën e tij për peticion.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me shkeljet e pretenduara të Nenit 5 § 1 dhe të Nenit 18 të konventës të marrë në bashkë me Nenin 5 Gjykata përsërit se në mënyrë që një arrestim të jetë i arsyeshëm sipas Nenit 5 § 1 (c) nuk është e nevojshme vetëm që policia të ketë marrë dëshmi të mjaftueshme për të ngritur akuza, ose te ndërmarrë arrestimin ose vetëm vendosjen e ankuesit në paraburgim. As nuk është e nevojshme që personi i ndaluar duhet në fund të fundit të jetë i akuzuar ose sjellë para një gjykate. Objekti i mbajtjes në paraburgim është mbajtja e një të dyshuari për sqarimin e pyetjeve dhe çështjeve për të vazhduar një hetim penal duke konfirmuar ose hedhur poshtë dyshimet që kanë dërguar te arsyet për paraburgim. Megjithatë, kërkesa që dyshimi duhet të bazohet në baza të arsyeshme, përbën një pjesë thelbësore të mbrojtjes kundër arrestimit arbitrar dhe paraburgimit. Fakti që një i dyshuar është mbajtur në mirëbesim siç pretendon Qeveria është i pamjaftueshëm. Fjalët "dyshim të arsyeshëm" nënkuptojnë ekzistencën e fakteve ose informacionit që do të kënaqte një vëzhgues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer veprën penale.⁹⁰ Gjykata thekson në lidhje me këtë se në mungesë të një dyshimi të arsyeshëm arrestimi ose ndalimi i një individi nuk duhet të imponohet me qëllim që ta bëjë atë të rrefejë ose të dëshmojë kundër të tjerëve ose për të nxjerrë fakte apo

⁹⁰ Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, aktgjykimi i 30 gushtit 1990, Seria A nr. 182, f. 16-17, § 32

informata të cilat mund të shërbejnë për të kontribuar në dyshimin e arsyeshëm ndaj tij. Gjykata më tej përsërit se Neni 18 i Konventës, sikurse Neni 14, nuk ka rol autonom. Mund të aplikohet vetëm së bashku me nenet e tjera të Konventës. Ashtu si në rastin e Nenit 14, mund të ketë shkelje të Nenit 18 në lidhje me një tjetër nen, edhe pse nuk ka shkelje të atij neni të marrë vetëm. Më tej rrjedh nga kushtet e Nenit 18 që një shkelje mund të lindë vetëm aty ku e drejta ose liria në fjalë i nënshtrohen kufizimeve të lejuara sipas Konventës. Gjykata rikujton se kufizimi i së drejtës për liri nën Neni 5 § 1 (c) duhet të justifikohet me qëllimin të kësaj dispozite. Në rastin aktual, Qeveria nuk ka arritur të bindë Gjykatën që ka pasur një dyshim të arsyeshëm se ankuesi kishte kryer një vepër penale. Nga kjo rezulton se nuk kishte asnjë justifikim për arrestimin dhe ndalimin e tij. Prandaj, konstaton se kufizimi i të drejateve të ankuesit për liri u aplikua për një qëllim tjetër nga ai të parashikuara në Nenin 5 § 1 (c). Për këtë arsye ka pasur një shkelje të Neni 18 i Konventës së marrë në lidhje me Nenin 5 § 1.

Në lidhje me shkeljet e ndryshme të Nenit 5 §§ 3 dhe 4 Ankuesi u ankua për mungesën e arsyeve për paraburgimin e tij dhe se gjatë procedurave lidhur me ndalimin e tij ai dhe avokatët e tij nuk kishin pasur qasje në materialet dhe në dosjen penale në bazë të të cilave gjykatat kishin vendosur ndalimin e tij. Ai gjithashtu pohoi se nuk kishte qenë në gjendje të takohej me avokatët e tij në kushtet e konfidencialitetit dhe që të gjitha dokumentet të cilat ishin shkëmbyer mes tij dhe avokatëve të tij ishin shqyrtuar nga autoritetet e burgut. Duke pasur parasysh konstatimin e se paraburgimi i ankuesit ishte arbitrar, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të shqyrtohen këto ankesa veç e veç.

Në lidhje me shkeljet e pretenduara të Nenit 34 të Konventës ankuesi u ankua se nuk i ishte lejuar të takohej privatisht me avokatin e tij dhe se në të gjitha takimet ishte ndarë nga ai me një ndarje qelqi pa asnjë hapje, duke parandaluar diskutimin normal ose duke punuar me të në dokumente. Si rezultat, ata kishin dashur të bërtisnin për të dëgjuar njëri-tjetrin dhe nuk kishin ishin në gjendje të kalonin dokumentet me njëri-tjetrin. Prandaj, ankuesi ishte penguar nga nënshkrimi i formularit të aplikimit dhe kishte autorizuar gruan e tij për të nënshkruaj ato. Në lidhje me pretendimet e Qeverisë, se ndarja e qelqit ishte e nevojshme për të mbrojtur të burgosurit dhe avokatët dhe se kjo ndarje nuk e pengon komunikimin normal Gjykata konsideron se është një ndërhyrje në raportin avokati-klient dhe kështu paraqet ndërhyrjen në të drejtën e petitionit të garantuar me Nenin 34 të Konventës. Gjykata vëren se problemi i mungesës së pohuar të konfidencialitetit të avokati-klientit në qendrën e paraburgimit CFECC ka qenë çështje shqetësuese serioze për të gjithë komunitetin e avokatëve në Moldavi për një kohë të gjatë dhe se ka qenë edhe shkaku i një greve të organizuar nga Asociacioni e Avokatëve të Moldavisë. Kërkesat e Asociacionit që të verifikohet pranina e pajisjeve të përgjimit në ndarjen e qelqit ishin refuzuar nga administrata e CFECC, dhe kjo duket se ka kontribuar në dyshimin e avokatëve. Një shqetësim i tillë dhe protesta nga ana e Asociacionit të Avokatëve do të ishte, sipas mendimit të Gjykatës i mjaftueshem për të ngritur dyshime rreth konfidencialitetit. Prandaj, Gjykata konkludon se ankuesi dhe avokati i tij mund të kenë arsye të kenë frikë se biseda në Dhomat e takimit të avokatit-klient CFECC nuk ishte konfidenciale. Për më tepër, Gjykata vëren se, në kundërshtim me pohimin e Qeverisë se ankuesi dhe avokati i tij mund të shkëmbejnë lehtësisht dokumente, fotografi dhe të dhëna nga Qeveria tregojnë se ky nuk ishte rasti për shkak të mungesës së ndonjë hapjeje në ndarjen e xhamit. Kjo, sipas pikëpamjes së Gjykatës,

e bëri edhe detyrën e avokatit më të vështirë. Në rastin në fjalë, përfaqësimi efektiv i ankuesit para Gjykatave gjithashtu duket të jetë penguar seriozisht, në një mënyrë të tillë që ai nuk ishte në gjendje të nënshkruante formularin e aplikimit ose autorizimin. Gjykata shton se arsyet e sigurisë të thirrura nga Qeveria nuk janë bindëse, për këtë Gjykata konsideron se pamundësia për ankuesin të diskutojë me avokatit tij çështjet lidhur me rastin e tij pa qenë i ndarë nga një ndarje xhami ndikoi në të drejtën e tij për peticion. Prandaj, gjen se ka pasur një shkelje të Neni 34 i Konventës. Gjykata deklaroi se shteti përgjegjës duhet të paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën aktgjykimi bëhet i formës së prerë 10,000 EUR në lidhje me demet e shkaktuara si dhe 2.500 EUR në lidhje me shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Neni 18 të Konventës lidhur me Neni 5 § 1 të Konventës; vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohen veçmas ankesat sipas Neni 5 §§ 3 dhe 4 të Konventës; si dhe mban se ka pasur shkelje të Neni 34 të Konventës [njëzëri].

Ilgar Mammadov kundër Azerbaixhanit - 15172/13

22 maj 2014 [Dhoma]

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar

Neni 5

Ankuesi, që ka një histori të kritikave kundër Qeverisë, është arrestuar dhe paraburgosur pa ndonjë dëshmi për dyshim të arsyeshëm se ai ka kryer veprën për të cilën është akuzuar, pra organizimin e veprimeve që kanë çuar në prishjen e rendit publik / *ka shkelje*

Neni 6 § 2

Shkelje e të drejtës në prezumim të pafajsisë si pasojë e Deklaratvee Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila u ka bërë thirrje banorëve lokalë për destabilizim politik dhe social, lexuar në tërësi, kanë inkurajaur publikun të besojë ankuesi është fajtor para se të provohet fajësia e tij sipas ligjit / *ka shkelje*

Neni 18

Kufizimet e lirisë janë aplikuar për qëllime të tjera nga ato të sjelljes së ankuesit para një autoriteti kompetent ligjor nën dyshimin e arsyeshëm të kryerjes së një vepre penale / *ka shkelje*

Fjalët kyçe: *protesta / kundërshtim i qeverisë / blog / arrestim / paraburgim / etiketim / prezumim i pafajësisë / qëllim i dyfishtë*

Ankuesi: Ilgar oglu Mammadov, shtetas i Azerbaixhanit, i lindur në vitin 1970 dhe që jeton në Baku

Faktet e rastit

Ankuesi, më parë ka qenë i përfshirë në një numër organizatash politike. Ai është bashkthemelues i partisë opozitare Lëvizja Alternative Republikane Civile, me të cilën e kishte shqyrtuar mundësinë e kandidimit në zgjedhjet presidenciale të vitit 2013. Ai gjithashtu mbajtur një ‘blog’ interneti në të cilin ka komentuar rreth çështjeve politike. Në veçanti në nëntor 2012, ai ka kundërshtuar fuqishëm një ligj të miratuar nga Asambleja Kombëtare përmes të cilit parashihen sanksione të rënda ndaj tubimeve publike të paautorizuara.

Në janar 2013, ankuesi ka udhëtuar në qytetin Ismayili, në veriperëndim të kryeqytetit Baku, për të raportuar në lidhje me protestat në rrugë që kishin shpërthyer një ditë më parë. Në blogun e tij, ankuesi kishte ndarë përshtypjet e tij në lidhje me protestat. Ai kishte raportuar se ngjarjet ishin shkaktuar nga “tensioni i përgjithshëm i krijuar nga korrupsioni dhe paturpësia” e zyrtarëve publikë.

Ministria e Punëve të Brendshme kishte lëshuar më pas një komunikatë, që theksonte përveç tjerash se dy politikanë, përfshirë ankuesin, u kishin bërë thirrje qytetarëve lokalë në Ismayili me qëllimin për destabilizim social dhe politik. Ministria kishte deklaruar edhe se “veprimet e tyre të paligjshme” do të hetoheshin.

Më pas, ankuesi ishte marrë në pyetje nga prokurori në lidhje me rolin e tij në ngjarjet protestuese. Në shkurt 2013, ankuesi ishte akuzuar për veprat e organizimit ose pjesëmarrjes aktive në veprime kundër rendit publik. Një gjykatë qarku kishte urdhëruar paraburgimin prej dy muajve. Paraburgimi i tij ishte zgjatur disa herë dhe apelimet kundër urdhërave të paraburgimit ishin hedhur poshtë nga gjykatat. Në mars 2014, ankuesi ishte dënua me shtatë vite burgim. Nominimi i tij për të kandiduar në zgjedhjet presidenciale në Azerbaixhan ishte refuzuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Përmbledhje e pretendimeve

Duke u mbështetur në nenin 5 §§ 1, 3 dhe 4, ankuesi ishte ankuar në veçanti se ai ishte arrestuar pa “dyshim të arsyeshëm” se ai ka kryer vepër penale, se gjykatat vendore kanë dështuar që të ofrojnë arsye të mjaftueshme dhe relevante që kanë justifikuar nevojën për paraburgim të zgjatur, dhe se ai nuk ka pas qasje në shqyrtim gjyqësor adekuat të paraburgimit të tij.

Duke u mbështetur në nenin 6 § 2 ai është ankuar se prezumimi i pafajësisë së tij është çenuar kur Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministria e Punëve të Brendshme kanë deklaruar se ankuesi u ka bërë thirrje banorëve lokalë për destabilizim politik dhe social.

Tutje dhe duke u mbështetur në nenin 18 të Konventës (kufiri i zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave), ai është ankuar se të drejtat e tij janë kufizuar për qëllime të tjera nga ato që janë parashikuar në Konventë. Ai ka mbajtur qëndrimin e arrestimi dhe procedurat penale ndaj tij kanë qenë një masë represive e Qeverisë për ta heshtur atë si kritik të Qeverisë dhe potencialisht si një kundërshtar serioz në zgjedhjet presidenciale. Qeveria i ka hedhur poshtë këto pretendime të ngritura nga ankuesi.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me Nenin 5, Gjykata ka vlerësuar se ankuesi, që ka një histori të kritikave kundër Qeverisë, është arrestuar dhe paraburgosur pa ndonjë dëshmi për dyshim të arsyeshëm se ai ka kryer veprën për të cilën është akuzuar, pra organizimin e veprimeve që kanë çuar në prishjen e rendit publik. Gjykata ka ardhur në përfundimin se, në thelb, qëllimi i Qeverisë ka qenë që të heshtë dhe ndëshkojë ankuesin për kritikën në adresë të Qeverisë dhe për publikimin e informacioneve që Qeveria ka tentuar t'i fshehtë. Gjykata ka vërejtur se akuza fillestare “e organizimit të prishjes së rendit publik” është zëvendësuar më vonë me “prishje masive të rendit”, pa i ndryshuar fare faktet e rastit. Si rezultat Gjykata gjen se ka pasur shkelje të Nenit 5 të Konventës.

Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 6 § 2 (prezumimit të pafajësisë), Gjykata ka vlerësuar se deklaratat e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme se ankuesi u ka bërë thirrje banorëve lokalë për destabilizim politik dhe social, lexuar në tërësi, kanë inkurajuar publikun të besojë se ankuesi është fajtor para se të provohet fajësia e tij sipas ligjit. Andaj ka shkelje të nenit 6 të konventës.

Gjykata tashmë ka gjetur se akuzat ndaj ankuesi nuk kanë qenë të mbështetura në “dyshime të arsyeshme” për qëllime të nenit 5. Mund të nxirret si përfundim nga kjo se autoritetet nuk kanë vepruar në mirëbesim. Gjykata ka deklaruar se është i rëndësishëm fakti se ankuesi ka qenë politikan opozitar, që ka qenë kritik ndaj Qeverisë. Për më

tepër, Gjykata ka vlerësuar se arrestimi i tij ka qenë i lidhur me postime soecifike në blogun e tij në internet, Rrethanat tregojnë se qëllimi i vërtetë i masave të ndërmarra ka qenë heshtja ose ndëshkimi i ankuesi për kritikën e tij ndaj Qeverisë dhe zbulimin e informacioneve që ka besuar se janë të vërteta dhe të cilat i ka fshehur Qeveria. Gjykata kështu ka ardhur në përfundimin se kufizimet e lirisë së ankuesit janë aplikuar për qëllime të tjera nga ato të sjelljes së tij para një autoriteti kompetent ligjor nën dyshimin e arsyeshëm të kryerjes së një veprë penale. Kjo ka qenë bazë e mjaftueshme që Gjykata të gjejë se ka pas shkelje të nenit 18 në ndërlidhje me nenin 5. Gjykata ka urdhëruar Azerbaixhanin që t'i paguajë ankuesi një shumë prej 20,000 EUR në lidhje me dëmin jo-material dhe 2,000 EUR për kostot dhe shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka gjetur shkelje të neneve 5, 6 dhe 18 në kombinim me nenin 5 [njëzëri].

